

**PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI
PËR BARAZINË GJINORE,
MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DHE DHUNËN NË FAMILJE**

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2021

ISBN: 978-9928-01-134-3

Adresa

Rruga: “Nikolla Jorga”

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.qbz.gov.al

PËRMBAJTJA

I. Dhuna në familje

Ligj nr. 9669, datë 18.12.2006	Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare <i>-ndryshuar me ligjet: nr. 9914, datë 12.5.2008; nr. 10 329, datë 30.9.2010; nr. 47/2018, datë 23.7.2018; nr. 125/2020, datë 15.10.2020.</i>	5
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.6.2021	Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës	23
Udhëzim i MPÇSSHB-së nr. 13, datë 17.12.2012	Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike	35
Udhëzim i MSHMS-së nr. 816, datë 27.11.2018	Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale	139
Udhëzim i MB-së, MSHMS-së nr. 866, datë 20.12.2018	Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje	158
Udhëzim i MB-së, MSHMS-së nr. 912, datë 27.12.2018	Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme	164
Udhëzim i MSHMS-së nr. 744, datë 15.11.2019	Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)	167
Udhëzim i MD-së, KLGJ-së nr. 9, datë 17.6.2020	Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre <i>-ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 17.6.2020</i>	190
Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012	Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”	193
Urdhër i MSHMS-së nr. 100, datë 21.2.2020	Për Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR)	218
Urdhër i MSHMS-së nr. 101, datë 21.2.2020	Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit (MKR)	253

Urdhër i MSHMS-së nr. 102, datë 21.2.2020	Për miratimin e “Për Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, në situata të emergjencave civile”	279
--	---	-----

BARAZIA GJINORE. MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI

Ligj nr. 9970, datë 24.7.2008	Për barazinë gjinore në shoqëri	314
Udhëzim i MPCSSHB-së nr. 1220, datë 27.5.2010	Për përcaktimin e treguesve të vlerësimit dhe të monitorimit të treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, mbikëqyrjen, mbledhjen dhe përpunimin e tyre	326
Ligj nr. 10 221 datë 4.2.2010	Për mbrojtjen nga diskriminimi <i>-ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020</i>	340

I. Dhuna në familje

LIGJ Nr.9669, datë 18.12.2006

PËR MASA NDAJ DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE

(Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e 20 mijë zgjedhësve,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Ky ligj ka për qëllim:

1. Parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme.
2. Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji, sipas nenit 3 të tij.

Neni 2

Objekti

(ndryshuar fjalë në shkrorjen "c" me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

Ky ligj ka si objekt:

- a) krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- b) orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
- c) fuqizimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
- ç) sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Neni 3

Përkufizimet

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Në këtë ligj, përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

3. “Dhunues” është çdo person i dyshuar dhe/ose i paditur për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare përpara organeve kompetente.

4. “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç. Termi “i mitur”, i përdorur në këtë ligj, ka të njëjtin kuptim.

5. “Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

6. “Njësi shtëpiake” është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes.

7. “Pjesëtarë të familjes” janë:

a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues;
b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake;

c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimi;

ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/ thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi;

d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit /es ose bashkëjetuesit/es;

dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es;

e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues;

ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje;

f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes.”.

8. “Marrëdhënie intime” është marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional.

9. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

10. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit.

11. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

12. “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme” është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1, të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

Neni 3/1

Legjislacioni i zbatueshëm

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Masat e veçanta mbrojtëse, të parashikuara në nenin 10 dhe në nenin 13/1, të këtij ligji, që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në marrëdhëniet familjare, nuk konsiderohen diskriminim nëse zbatohen sipas rregullave dhe kriterëve të parashikuar në këtë ligj.

Neni 4

Subjektet

(ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Subjektet që mbrohen nga ky ligj janë të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji, që janë shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekte që mbrohen nga ky ligj janë edhe shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë, dhe të huajt me qëndrim të rregullt për motive të ndryshme, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt, që përfshihen në kategorinë e subjekteve të përcaktuara në nenin 3, pika 7, të këtij ligji.

KREU II

ORGANET PËRGJEGJËSE

Neni 5

Autoritetet përgjegjëse

(shtuar shkronja “d” me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritete të tjera përgjegjëse të linjës janë:

- a) ministria përgjegjëse për çështjet sociale;
- b) ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike;
- c) ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë;
- ç) ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë;
- d) ministria përgjegjëse për çështjet e arsimit;
- dh) ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit;
- e) ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe formimit profesional;
- ë) njësitë e vetëqeverisjes vendore.

3. Lista e autoriteteve të tjera përgjegjëse të linjës, të parashikuara në pikën 2, të këtij neni, ndryshon nëse njëri prej tyre merr rolin e autoritetit kryesor përgjegjës. Në këtë rast, ky autoritet ka edhe rol kryesor përgjegjës dhe mbulon çështjet në fushën përkatëse.

Neni 6

Detyrat e autoritetit kryesor përgjegjës

(shtuar shkronjat "f" dhe "g" me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, shtuar shkronja "gj" me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat "e", "ç", "d", "g", "gj" dhe shtuar shkronjat "b" dhe "i" me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

a) hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

b) financimin ose bashkëfinancimin e projekteve, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen dhe konsolidimin e familjes, si dhe kujdesin ndaj viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare;

c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e "përshtatjes së arsyeshme", që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) organizimin e trajnimeve për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje për punonjësit e shërbimeve sociale, të cilët ofrojnë shërbime, pranë çdo njësie të vetëqeverisjes vendore, strukturat e Policisë së Shtetit, stafit mjekësor dhe për punonjësit e OJF-ve të licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale. Trajnimet mund të organizohen në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, me Shkollën e Magjistraturës, me Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social ose me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës në marrëdhëniet familjare, për të gjitha autoritetet përgjegjëse administrative, ligjzbatuese dhe gjyqësore;

d) bashkërendimin e punës për mbajtjen dhe mbledhjen e të dhënave statistikore, për rastet e dhunës në familje, duke përfshirë dhe analizimin, publikimin dhe raportimin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave për rastet e dhunës në familje bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Botimi i tyre bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.

dh) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për viktimat e dhunës në familje;

e) mbështetjen dhe mbikëqyrjen e krijimit të qendrave të rehabilitimit për shkaktarët e dhunës në marrëdhëniet familjare;

ë) licencimin e OJF-ve të ndryshme që do të ofrojnë shërbime sociale për viktimat dhe dhunuesit;

f) marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;

g) harton politikat dhe mbikëqyr marrjen e masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, nëpërmjet vendosjes në përkujdesje alternative ose dhënies së masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës;

gj) ofrimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për viktimat e dhunës në familje.

h) hartimin, në bashkëpunim edhe me autoritetet e tjera të linjës, të procedurave, standardeve ose protokolleve, lidhur me vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

i) koordinimin dhe monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që do të ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

Neni 7

Detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës

(shtuar pika 3/1 me ligjin nr.9914, datë 12.5.2008, ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike ka këto detyra:

a) krijimin e sektorëve të veçantë për parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje pranë drejtorive të policisë;

b) trajnimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të trajtojnë rastet e dhunës në familje, me qëllim rritjen e kapaciteteve në identifikimin e rasteve të dhunës në familje, vlerësimin e riskut dhe intervistimin e viktimës e të dhunuesit dhe me aspekte të tjera të lidhura me zbatimin e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj;

b/1) miratimin, me udhëzim të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, të modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje.

2. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë siguron ndihmën mjekësore në familje, në shërbimet e urgjencës, të mjekut të familjes dhe në qendrat shëndetësore pranë njësive të vetëqeverisjes vendore:

a) për të ofruar në çdo kohë ndihmë mjekësore, sociale e psikologjike për viktimat e dhunës në familje;

b) për të bërë në çdo kohë ekzaminimet e nevojshme në institucionet shëndetësore publike përkatëse;

c) për të evidentuar rastet e dhunës në familje në dokumentacionin përkatës mjekësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë;

ç) për të pajisur edhe viktimën me raportin mjekësor përkatës;

d) për të referuar dhe orientuar viktimën pranë shërbimeve të tjera të mbështetjes dhe mbrojtjes nga dhuna në familje.

2/1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë kryen edhe këto detyra:

a) organizon trajnime dhe specializime për stafin mjekësor, psikologjik e të punonjësve sociale në fushën e dhunës në familje, duke përgatitur edhe një listë të profesionistëve të trajnuar e të specializuar në këto fusha, në bashkëpunim me urdhrat e ngritur sipas legjislacionit në fuqi;

b) monitoron përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj, nga ana e personelit mjekësor;

c) parashikon ngritjen e qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, që të sigurojnë mundësinë e funksionimit të dhomave, që shërbejnë për emergjenca pranë spitaleve ku viktimat trajtohet. Standardet e ngritjes dhe funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Ministria përgjegjëse për drejtësinë ka këto detyra:

a) të trajnojë ekspertët mjeko-ligjorë në njohjen, diagnostikimin, vlerësimin dhe raportimin e dhunës në familje dhe akteve të dhunës ndaj fëmijëve;

b) merr masa për përgatitjen profesionale dhe specializimin e përmbaruesve gjyqësorë në ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes, si dhe mbikëqyr veprimtarinë e tyre në realizimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj;

b/1) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, për përgatitjen e programeve të trajnimit për çështje të lidhura me dhunën në familje, si dhe vë në dispozicion të autoriteteve përgjegjëse listën e përditësuar të të trajnuarve për këto çështje;

c) mbikëqyr funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike për viktimat e dhunës në familje, sipas rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

ç) bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor, për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe siguron unifikimin e regjistrimit të këtyre çështjeve;

d) harton formularë të posaçëm për përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje, si dhe publikon këto të dhëna në vjetarin statistikor;

dh) nëpërmjet strukturave përgjegjëse të varësisë, siguron zbatimin e detyrimit të përgatitjes së raportit mjeko-ligjor dhe psikiatriko-ligjor nga ana e stafit të mjekësisë ligjore, bazuar në kërkesën e institucioneve kompetente dhe/ose të viktimës.

3/1. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulojnë, kanë këto detyra:

a) harton programet mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje;

b) përgatit tekste shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare;

c) parashikon programe për arsimimin parauniversitar e profesional të të miturve dhe të rinjve nga 18 deri në 21 vjeç, që janë dhunues, dhe të të miturve që janë viktima, me qëllim rehabilitimin, riintegrimin dhe rishoqërimin e tyre.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

a) angazhimin në krijimin e strukturave të specializuara të shërbimit social për rastet e dhunës në familje, lidhur me mënyrën e referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes e të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

c) ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

ç) marrjen e masave, në bashkëpunim me organet ligjzbatuese, për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve;

d) marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës;

dh) bashkëpunimin me shërbimin e provës, për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor.

Për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë nen, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve të përbashkëta, në përputhje me legjislacionin në fuqi për vetëqeverisjen vendore.

5. Ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit, mbështet me financime njësitë e vetëqeverisjes vendore për sigurimin e banesave të specializuara, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

Neni 7/1

Garancia për mbrojtjen

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Çdo organ ose autoritet, që është përgjegjës për të trajtuar dhunën në familje, pranë të cilit drejtohet viktimë, garanton mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës.

2. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Neni 8

Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse

(shtuar pikat 7 dhe 8 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, shtuar shkronja “dh” e pikës 3 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Autoritetet përgjegjëse kanë për detyrë krijimin e strukturave të posaçme dhe caktimin e personave përgjegjës për zbatimin e këtij ligji. Përbushja e këtij detyrimi mbikëqyret nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

2. Autoritetet përgjegjëse kanë detyrimin t’i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të treguar në këtë ligj, në rastet e dhunës apo kërcënimit për dhunë ose dhe në rastet e shkeljes së urdhrat të mbrojtjes apo urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes. Ato mbajnë raportin përkatës dhe një kopje ia dorëzojnë viktimës ose shoqëruesit të saj.

3. Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës me anë të:

a) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj për masat që do të merren sipas ligjit në fuqi dhe për institucionet të cilave duhet t’u drejtohet;

b) informimit të viktimës apo shoqëruesit të saj në lidhje me shërbimet sociale ekzistuese dhe shoqërimin në qendrat dhe institucionet përkatëse;

c) sigurimit të transportit për viktimën dhe shoqëruesin e saj në qendra shërbimesh mjekësore apo sociale;

ç) vënies në dispozicion të një punonjësi të policisë në rastet e rrezikut për jetën.

dh) hartimit nga punonjësi social për çështjet e dhunës në familje pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe njësisë së vlerësimit të nevojave e referimit, në bashkëpunim me Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të një plani individual të ndërhyrjes që përmban masat dhe shërbimet e nevojshme që duhen marrë për të mbrojtur viktimën nga dhuna në vazhdimësi, ofrimin e shërbimeve të menjëhershme dhe minimizimin e pasojave të dhunës dhe të një raporti për shëndetin mendor e gjendjen psikosociale të viktimës.

4. Nëse ekziston dyshimi se dhunuesi ka kërcënuar ose ka ushtruar dhunë në familje apo ka thyer urdhrat e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, organet e policisë do të bëjnë konstatimet e menjëhershme.

5. Personat të cilët marrin dijeni për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji dhe nuk veprojnë në zbatim të tij, ngarkohen me përgjegjësi administrative dhe/ose penale, duke zbatuar sanksione të përcaktuara në nenet 248 dhe 251 të Kodit Penal.

6. Organet e policisë kanë për detyrë të regjistrojnë konstatimet përkatëse në një raport të shkruar, si dhe të fillojnë hetimet kryesisht. Viktima vihet në dijeni nga policia për numrin përkatës të rastit të raportuar.

7. Punonjësit e shërbimit e të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktimat jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktimat.

8. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Subjektet që mund të vënë në dijeni organet përgjegjëse

(ndryshuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Në rast të dhunës në familje, viktimë mund t'i drejtohet me anë të një kërkesë stacionit të policisë më të afërt (të zonës ku banon ose ndodhet), njësisë përkatëse vendore (komunë, bashki), qendrës shëndetësore të zonës ku banon apo ndodhet ose me kërkesë-padi gjykatës së rrethit të vendbanimit, vendndodhjes së saj ose të dhunuesit, për të marrë masat e nevojshme.

2. Çdo person që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës në familje mund t'u drejtohet me anë të një kërkesë autoriteteve të mësipërme për të ndërmarrë masat e nevojshme.

KREU III MASAT MBROJTËSE

Neni 10

Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje

(ndryshuar fjalë në pikën 1 dhe pika 4 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronjat "j", "k", "m", shtuar shkronja "m/1" dhe pikat 3/1 dhe 3/2 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a", "b", "ç", "d", "e", "f", "g", "h", "l", "dh", shfuqizuar shkronjat "i", "m" dhe "m/1, ndryshuar pika 2 dhe pika 3 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna.

Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, sigurohet dhe në këto mënyra:

a) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprë të dhunës në familje ndaj paditësit (viktimës) apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

b) duke urdhëruar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë apo të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën apo pjesëtarë të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

c) shfuqizuar;

ç) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, siç përcaktohet në nenin 3 pika 3 të këtij ligji apo siç emërtohet në urdhër;

d) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t'i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën ose viktimat dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

e) duke kufizuar ose duke të paditurin (dhunuesin) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

ë) duke i ndaluar të paditurit (dhunuesit) hyrjen ose qëndrimin në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës, ose në ndonjë pjesë të saj, pavarësisht nga të drejtat e pronësisë apo të posedimit të dhunuesit;

f) duke urdhëruar një person të autorizuar nga gjykata (punonjës i rendit ose përmbaues gjyqësor) që të shoqërojë viktimën ose të paditurin (dhunuesin) deri në banesën e viktimës dhe të mbikëqyrë largimin e pasurisë personale;

g) duke urdhëruar organet zbatuese të ligjit që të sekuestrojnë çdo armë që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo të urdhërojë dhunuesin për të dorëzuar çdo armë që i përket atij;

gj) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të lejojë viktimën të posedojë banesën të cilën e përdorin së bashku me viktimën dhe dhunuesin/ja ose ndonjë pjesë të saj;

h) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

i) për sa kohë urdhri mbrojtës është në fuqi, trajtimi i pasurisë kryhet në përputhje me Kodin e Familjes, nenet 57, 58 dhe 60;

j) duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi;

k) duke urdhëruar organet kompetente, shërbimet sociale të njëjtit përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;

l) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të bëjë një pagesë periodike në favor të personave bashkëjetues, të cilët, për efekt të masës së mësipërme, mbeten të privuar nga mjetet e jetesës. Për të siguruar pagesën, gjykata mund të vendosë që shuma të derdhet nga punëdhënësi në favor të përfituesit. Një vendim i tillë përbën titull ekzekutiv;

ll) duke përfshirë viktimën e dhunës në familje në programe rehabilitimi;

m) shfuqizuar;

m/1) shfuqizuar.

2. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat mbrojtëse të parashikuara në shkronjat “a” deri në “ll” të pikës 1 të këtij neni.

3. Në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, përveç masës që parashikohet në paragrafin e parë të pikës 1 të këtij neni, në varësi të rrethanave të çështjes, mund të vendoset dhe një ose disa nga masat e parashikuara në shkronjat “a” deri në “g” të pikës 1 të këtij neni.

3/1 Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

3/2 Vendimi për zgjidhjen e martesës, i shpallur nga gjykata gjatë kohës së zbatimit të UMM/UM-së për pasojat e njëkohshme, fillon të zbatohet nga dita e përfundimit të UMM/UM-së. Në rast se gjykata ka vendosur detyrime të ndryshme ushqimore për fëmijët në këto vendime, zbatohet vendimi më i favorshëm për fëmijët.

4. Në rastin e zbatimit të shkronjës “g”, vendimi i gjykatës parashikon:

a) pezullimin e lejes së armës deri në plotësimin e afatit të urdhrit të mbrojtjes, si dhe njoftimin e autoritetit përkatës administrativ, nëse arma është sekuestruar dhe personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje;

b) kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes.

Neni 10/1

Rehabilitimi i dhunuesit

(shtuar me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, urdhërohet dhunuesi të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private.

2. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij në mënyrë periodike dhe rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi nuk merr pjesë në program, përveç rasteve kur ka arsye objektive dhe shkaqe të përligjura për mospjesëmarrjen, me kërkesë të mbledhjes *ad-hoc* të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes.

3. Në urdhrin e mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykatë, urdhërohet i padituri ose dhunuesi, nëse është rasti, të marrë pjesë në programe rehabilitimi pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorie ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkoologjisë ose shërbime të toksikologjisë.

4. Përgjegjësit e programit të rehabilitimit vënë në dijeni koordinatorin vendor pranë Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij.

5. Një dhunues, i dënuar me vendim gjykatë për të kryer dënimin në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, mund të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale. Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi në program mbahet parasysht në vlerësimin e rrezikut të të dënuarit në rastet e lirimit me kusht, lejeve shpërblyese ose të veçanta, të vizitave.

Neni 11

Efektet e urdhrit të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Pavarësisht prej ndonjë urdhri apo vendimi tjetër të nxjerrë nga gjykata apo ndonjë institucion tjetër, urdhri i mbrojtjes që përmban masat e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji do të nxirret me vendim gjykatë për rastet e parashikuara nga ky ligj.

2. Urdhri i mbrojtjes ose urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i nxjerrë me vendim gjykatë, apo përfundimi i efekteve të tij nuk cenon në mënyrë të përhershme të drejtat e pronësisë apo të kujdestarisë.

KREU IV
GJYKIMI PËR LËSHIMIN E URDHËRIT TË MBROJTJES

Neni 12

**Organi kompetent për lëshimin e urdhrave
mbrojtës në rastin e dhunës në familje**

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Organi kompetent për lëshimin e urdhrave mbrojtës në rastin e dhunës në familje është gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë.

Për të vendosur sigurimin e masave mbrojtëse të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, gjykata lëshon urdhra mbrojtjeje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje.

2. Pala e interesuar mund t'i kërkojë gjykatës, sipas rastit, konform dispozitave të këtij ligji, lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

3. Pasi gjykata të ketë lëshuar një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, pala e interesuar mund të kërkojë lëshimin e një urdhri mbrojtës, siç parashikohet në këtë ligj. Urdhri mbrojtës përkatës shërben për të rikonfirmuar vazhdimësinë e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe siguron masat mbrojtëse të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 13

Subjektet që kanë të drejtën për të kërkuar urdhrin e mbrojtjes

(shtuar shkronjat "dh" dhe "e" të pikës 2 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010)

1. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktimë;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia / prokuroria.

2. Kërkesën për urdhër mbrojtjeje të një të mituri mund ta paraqesin:

- a) prindi ose kujdestari i të miturit;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) të afërmit;

ç) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

d) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

dh) policia/prokuroria;

e) personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët.

3. Kërkesën për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje mund ta paraqesin:

- a) vetë viktimë;
- b) përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;
- c) policia/prokuroria;
- ç) personi me të cilin viktimë ka marrëdhënie familjare;

d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë bashkisë ose komunës, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës;

dh) qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

4. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

(shtuar me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në pikën 1, ndryshuar paragrafi i parë i pikës 2, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a", "b", "c" të pikës 2, shtuar pika 3/1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës ose viktimave dhe për ndalimin e dhunës.

2. Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, sipas pikës 1 të këtij neni, derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes, urdhërohet largimi i menjëhershëm i dhunuesit nga banesa, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara, si dhe/ose përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme:

a) urdhërimi i dhunuesit që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes së viktimës;

b) urdhërimi i dhunuesit që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;

c) ndalimi menjëherë i dhunuesit, që t'i afrohet strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;

d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës "ç", të kësaj pike;

dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;

e) bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer apo sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

3. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna sipas procedurës dhe modelit, të përcaktuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

Një kopje e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme i njoftohet menjëherë koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

3/1. Kur në të gjithë vendin ose në një pjesë të territorit të tij janë vendosur masat e jashtëzakonshme, përkatësisht, titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit detyrohet të lëshojë urdhrin për masat paraprake për mbrojtjen e menjëhershme, sipas pikës 2 të këtij neni, në çdo rast kur konstaton se është ushtruar dhunë. Gjatë gjithë periudhës së zgjatjes së masave të jashtëzakonshme, në kërkesën drejtuar gjykatës për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes, të marra përmes urdhrit për masat paraprake për mbrojtjen e menjëhershme të lëshuar, policia duhet t'i kërkojë gjykatës lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

4. Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

5. Brenda 48 orëve nga marrja e masave, sipas përcaktimit të pikës 1, të këtij neni, organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprahe të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes.

6. Të drejtën për të kërkuar vlerësimin e urdhrit për masat paraprahe të mbrojtjes së menjëhershme përpara gjykatës e ka edhe viktima dhe subjektet e parashikuara nga neni 13, pika 3, e këtij ligji, brenda 48 orëve, nga dita e lëshimit të tij.

7. Gjykata, 48 orë nga dita e paraqitjes së kërkesës, në seancë gjyqësore vendos:

a) vlerësimin e masave mbrojtëse të vendosura në urdhrin për masat paraprahe të mbrojtjes së menjëhershme dhe lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

b) anulimin e urdhrit për masat paraprahe të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndërprerjen e pasojave të tij, nëse nuk provohen faktet dhe rrethanat për të cilat është lëshuar.

8. Gjykata, për nevoja të gjykimin, mund të thërrasë përfaqësuesin e Policisë së Shtetit dhe/ose koordinatorin vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të paraqiten në seancë gjyqësore për të dhënë shpjegime.

Neni 14

Forma e kërkesë-padisë

(shtuar një fjali në fund të pikës 3 dhe ndryshuar pika 4 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar pikat 3, 4, 5 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 1, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kërkesë-padia për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes duhet të përmbajë edhe:

a) të dhëna personale rreth familjes ose marrëdhënieve farefisnore mes viktimës dhe dhunuesit;

b) përshkrimin e qartë të fakteve dhe rrethanave, në të cilat ka ndodhur akti i dhunës në familje, duke përfshirë arsyet që sqarojnë cenimin e sigurisë, të shëndetit apo të mirëqenies së viktimës nga i padituri (dhunuesi) të parashikuara në nenin 3 pikat 1 dhe 2 të këtij ligji;

c) masat mbrojtëse të posaçme që kërkohen;

ç) nënshkrimin e kërkuesit.

2. Kërkesë-padia për urdhër mbrojtjeje mund të paraqitet në çdo kohë para gjykatës nga ana e personave që legjitimohen për ta kërkuar atë. Në rastet kur kërkohet ndihmë e menjëhershme, kërkesa mund të plotësohet dhe të paraqitet pranë komisariatit më të afërt të policisë dhe punonjësi i policisë vepron në përputhje me ligjin "Për Policinë e Shtetit".

3. Për hartimin e kërkesëpadisë, përgatitjen e akteve dhe përfaqësimin në procesin gjyqësor, kërkuesi asistohet nga një avokat që ofron ndihmën juridike detyësore, në përputhje me kushtet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.

4. Kërkuesi i UMM/UM-së dhe mbajtësi i UPMM-së përjashtohen nga:

a) pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

b) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit pranë shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti;

c) pagimi i akteve të ekspertimit psikosocial, të interpretit të gjuhës së shenjave, të ekspertimit mjeko-ligjor, të ekspertimit për vlerësimin e rrezikut të dhunës në familje ose të ndonjë akti ekspertimi tjetër.

Pas lëshimit të UMM/UM-së, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje.

5. Kërkesëpadia regjistrohet në një regjistër të veçantë, protokollohet ditën e dorëzimit të saj dhe hidhet në short ditën e nesërme. Gjykata kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj

dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, për palët ose subjektet e tjera. Për nevoja të zhvillimit të gjykimit, kur rrethanat e çështjes e diktojnë, gjykata, sipas nevojës, mund të zhvillojë seancën gjyqësore në mungesë të palëve, pavarësisht nga konfirmimi i marrjes dijeni.

6. Gjykata, në vendimin e lëshimit të urdhrit të mbrojtjes, vendos edhe për rastet e parashikuara në pikën 4 të këtij neni.

Neni 15

Provat në procesin gjyqësor

(ndryshuar fjalia e fundit e pikës 2 dhe shtuar pika 2/1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Provat që duhet t'i paraqiten gjykatës mund të jenë: dëshmi, raporte të policisë, raport mjekësor, akt-ekspertimi, ekzaminime dhe shpjegime/pohime të palëve, dokumente të tjera të lëshuara nga punonjësit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësive vendore, dokumente të lëshuara nga persona juridikë (OJF), të regjistruara sipas dispozitave në fuqi.

2. Kur nga të dhënat e kërkesës bëhet e qartë se komisaritet e policisë, organet e pushtetit vendor apo qendrat shëndetësore kanë prova shkresore lidhur me ushtrimin e dhunës në familje, ato lëshojnë menjëherë një kopje të certifikuar (kopje me vulë) për këtë në bazë të kërkesës së paraqitur nga kërkuesi ose të vetë gjykatës. Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë pikë, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi i kërkesës mund të bëhet shkak për vonesa, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike, që e disponojnë atë.

2/1 Moslëshimi i dokumentacionit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj personit përgjegjës, bazuar në dispozitat e legjislacionit të posaçëm.

3. Kur nuk disponon të gjitha provat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes, bazuar vetëm në përshkrimin e rrethanave dhe fakteve në të cilat është kryer dhuna në familje, duke u bazuar në bindjen e vet.

Neni 16

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 2, me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata vendos për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës.

2. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për urdhër mbrojtjeje, gjykata dëgjon me radhë personat në vijim:

- a) viktimën, përfaqësuesin ligjor apo avokatin e saj;
- b) të paditurin (dhunuesin), përfaqësuesin ligjor apo avokatin e tij/saj;
- c) prokurorin, nëse ky ka paraqitur kërkesën;
- ç) përfaqësuesit e policisë;
- d) përfaqësuesit e zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë në të cilën jeton përherë ose përkohësisht personi i përmendur, kur kërkuesi është nën 18 vjeç, nuk ka zotësi për të vepruar apo dhuna e ushtruar në familje ka ndikim mbi personat e lartpërmendur;
- dh) punonjësit e qendrave shëndetësore apo të qendrave të shërbimit dhe rehabilitimit, të cilët kanë asistuar viktimën pas ushtrimit të dhunës mbi të;
- e) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

3. Në rastin kur kërkesa është paraqitur nga policia/prokuroria, tërheqja e viktimës nga procesi nuk sjell si pasojë mosgjykimin e çështjes së filluar.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në shkronja "b" të pikës 1, hequr togfjalësh në shkronjën "ç" të pikës 3, shtuar pika 6 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata mund të lëshojë me vendim një urdhër mbrojtjeje vetëm ndaj dhunuesit të përmendur në kërkesë-padi. Ky vendim përmban vetëm masat mbrojtëse që përshkruhen në nenin 10 të këtij ligji. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e mbrojtjes duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse vërteton se:

a) ekzistojnë dyshime të arsyeshme për të besuar se dhunuesi përbën rrezik për kryerjen e ndonjë akti të dhunës në familje;

b) lëshimi i urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës ose viktimave, urdhër në të cilin, përveç kërkuesit, gjykata çmon se mund të përfshihen edhe persona të tjerë, me të cilët kërkuesi ka lidhje familjare ose intime, që mund të bëhen shkak për ushtrimin e dhunës ndaj këtyre të fundit.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrit të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;

c) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

4. Urdhri i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile. Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevoja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarariatit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

6. Vendimi për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili administrohet pranë çdo gjykate sipas modelit, rregullave dhe procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 18

Gjykimi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010, ndryshuar shkronja "b" e pikës 2 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata vendos në lidhje me kërkesën për mbrojtje të menjëhershme:

a) të një të mituri, brenda 24 orëve pas parashtrimit të kërkesës;

b) të subjekteve të tjera të dhunës në marrëdhëniet familjare, brenda 48 orëve pas parashtrimit të kërkesës.

2. Në rastin e shqyrtimit të kërkesës për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje, gjykata mban një seancë ku dëgjojnë personat në vijim:

- a) viktimë, përfaqësuesi ligjor apo avokati i saj;
- b) dhunuesi, përfaqësuesi apo avokati i tij;
- c) prokurori, nëse merr pjesë;
- ç) kërkuarët e tjerë, të parashikuar në nenin 13 të këtij ligji;
- d) dëshmitarët, të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm.

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

(shtuar shkronja "d" në pikën 5 me ligjin nr.10 329, datë 30.9.2010, shtuar pika 2/1, shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 3 dhe ndryshuar pika 6 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, zëvendësuar fjalë në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjykata lëshon me vendim urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, duke caktuar një ose më shumë prej masave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji, nëse konstaton se:

- a) ekzistojnë bazat për të besuar se i padituri (dhunuesi) ka kryer ose ka kërcënuar se do të kryejë ndonjë vepër të dhunës në familje; ose
- b) i padituri (dhunuesi) paraqet kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin ose mirëqenien e viktimës dhe të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës; ose
- c) lëshimi i urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes me vendim gjykate është i nevojshëm për të mbrojtur sigurinë, shëndetin, mirëqenien e viktimës apo të anëtarëve të tjerë të familjes së viktimës, që mbrohen me anë të urdhrin të mbrojtjes.

2. Gjykata nuk mund të refuzojë lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes për shkak të një procesi tjetër gjyqësor, ku përfshihet njëra prej palëve.

2/1 Gjykata lëshon urdhrin e mbrojtjes edhe në rastet kur palët pretendojnë se konflikti është zgjidhur ose duhet të zgjidhet me pajtim ose ndërmjetësim.

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

- a) masën e caktuar nga gjykata;
- b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;
- c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;
- ç) Shfuqizuar;
- d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

4. Urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar me vendim gjykate, i njoftohet menjëherë dhunuesit, i cili nuk ka qenë i pranishëm gjatë seancës gjyqësore, sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile.

Viktima duhet të pajiset nga gjykata me dy kopje të vendimit origjinal, në mënyrë që njërin prej tyre ta mbajë për vete dhe tjetrën ta vërë në dispozicion të policisë në momentin që paraqitet nevojja.

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

- a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;
- b) kërkuarëve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;
- c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimë dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;
- ç) komisaritetit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimë dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

d) zyrave përbarimore të vendit të ekzekutimit.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përbarimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

(ndryshuar fjalia hyrëse me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16, të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:

a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b) refuzon lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;

c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate.

Neni 21

Ankimi

(shfuqizuar pika 1 dhe ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018, ndryshuar me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Gjykata e apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kundër vendimit të gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankim nga viktimat, përveç rastit kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk garantojnë mbrojtje.

2. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrit të mbrojtjes.

Neni 22

Rrethanat për ndryshimin, ndërprerjen dhe vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

1. Nëse rrethanat kanë ndryshuar rrënjësisht, viktimat (përfaqësuesi i saj), dhunuesi ose prokurori, nëse ka marrë pjesë në proces, mund të paraqesë kërkesë për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes.

2. Pas marrjes së kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

a) lënien në fuqi të urdhrit të mbrojtjes;

b) ndryshimin e urdhrit të mbrojtjes nëse kjo kërkohet nga rrethanat që kanë ndryshuar rrënjësisht; ose

c) ndërprerjen e tij, nëse kriteret e përcaktuara në nenin 10 pika 1 të këtij ligji nuk vlejnë më, për shkak të ndryshimit rrënjësor të rrethanave.

3. Parashtrimi i kërkesës për ndryshimin ose ndërprerjen e urdhrit të mbrojtjes nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes.

4. Viktima ose përfaqësuesi i autorizuar prej saj, 15 ditë para përfundimit të efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, mund të parashtrojë kërkesën për vazhdimin e tij. Nëse nuk parashtrohet kërkesa, urdhri i mbrojtjes ndërpritet automatikisht në ditën e përfundimit të efekteve të tij.

5. Pas marrjes së kërkesës për vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes, gjykata vazhdon me shqyrtimin e kërkesës, në bazë të nenit 16 të këtij ligji. Në fund të shqyrtimit gjykata vendos:

- a) vërtetimin e ndërprerjes së urdhrit të mbrojtjes në datën e përfundimit të efekteve të tij; ose
- b) vazhdimin e efekteve të vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, nëse vlejnë kriteret e përcaktuara në nenin 17 pika1 të këtij ligji.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

(ndryshuar pika 1 dhe 6, shtuar pika 3/1 dhe shfuqizuar pikat 2 dhe 5 me ligjin nr. 47/2018, datë 23.7.2018)

1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbarrimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

2. Shfuqizuar.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

3/1 Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

4. Institucionet, qendrat rezidenciale, qendrat e shërbimeve, OJF-të e licencuara për ofrim shërbimesh zbatojnë masat e parashikuara në vendimin gjyqësor dhe koordinojnë punën e tyre me njësitë e qeverisjes vendore dhe drejtoritë e policisë, si ekzekutuese direkt të këtyre vendimeve.

5. Shfuqizuar.

6. Në rast të mosekzekutimit vullnetar nga palët ose të pengimit të ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes nga organet zbatuese, siç parashikohet në dispozitat e këtij ligji dhe/ose në vendimin e gjykatës, ndaj personave përgjegjës zbatohen dispozitat e Kodit Penal për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me detyrat e lindura nga urdhrat e mbrojtjes.

KREU V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 24

Procedimi penal

(shtuar fjali në fund të paragrafit me ligjin nr. 125/2020, datë 15.10.2020)

Lëshimi i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë nuk i ndalon palët e interesuara të nisin procesin penal, për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale. Në çdo rast, punonjësi i policisë, ku paraqitet për mbrojtje viktimë, e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Neni 25

Aktet nënligjore

Këshilli i Ministrave nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 26

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Shpallur me dekretin nr.5182, datë 12.1.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

VENDIM

Nr. 327, datë 2.6.2021

**PËR MEKANIZMIN E BASHKËRENDIMIT TË PUNËS NDËRMJET
AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE, PËR REFERIMIN E RASTEVE TË DHUNËS
NË MARRËDHËNIET FAMILJARE, SI DHE PROCEDIMIN E TIJ, PËR
MBËSHTETJEN E REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË DHUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 8, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon procedurat standarde bazë për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për parandalimin e dhunës në familje, për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinore, si edhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare**”, punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;

b) **“Menaxhim i rastit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave”**, veprimtaria efektive që siguron ndihmën e mbështetjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, me qëllim mbrojtjen, garantimin e të drejtave dhe rehabilitimin e tyre;

c) **“Rast urgjent”**, rasti kur dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e personit dhe merren masa paraprake të menjëhershme për mbrojtjen e viktimave, për ndalimin e dhunës dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të saj;

ç) **“Shporta e shërbimeve”**, tërësia e shërbimeve që ofrohen nga njësi vendore për mbrojtjen urgjente dhe afatgjatë të viktimës;

d) **“Riviktimizim”**, shkaktimi në mënyrë të përsëritur i dëmtimeve të mëtejshme viktimës së dhunës në familje nga ana e dhunuesit, si pasojë e një veprimi që ka lidhje me raportimin/denoncimin e dhunës;

dh) **“Viktimizimi dytësor”**, shkaktimi i një gjendjeje, që rëndon më tej dëmin që viktimë e dhunës ka pësuar për shkak të pjesëmarrjes në procedura ligjore, si rezultat i raportimit dhe/ose pjesëmarrjes në procesin e drejtësisë;

e) **“REVALB”**, sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësive vendore.

II. BASHKËRENDIMI I INSTITUCIONEVE PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

1. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje krijohet pranë çdo bashkie dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

2. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga:

a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

b) ekipet teknike ndërdisiplinore (në vijim, ETN);

c) koordinatorët vendorë (në vijim, KV).

3. Këshilli bashkiak, me propozimin e kryetarit të bashkisë, përcakton numrin e KV-ve dhe përbërjen e njësive kundër dhunës në familje. Për këtë vendimmarrje merret në konsideratë numri i popullsisë së bashkisë dhe numri i rasteve të dhunës në familje, sipas statistikave në dispozicion. Këshilli bashkiak siguron që:

a) në bashkitë e mëdha me mbi 200 000 (dyqind mijë) banorë krijohet një njësi kundër dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) koordinatorë vendorë me kohë të plotë, që bashkëpunojnë me nga një administrator shoqëror/punonjës social, për çdo njësi administrative;

b) në bashkitë e mesme dhe të vogla njësi kundër dhunës në familje përbëhet nga një KV me kohë të plotë, që bashkëpunon me nga një administrator shoqëror/punonjës social, për çdo njësi administrative.

4. Veprimtaria e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje mbështetet e udhëhiqet nga këto parime:

a) shërbime të aksesueshme lehtë dhe të arritshme;

b) trajtimi me respekt e dinjitet i viktimave;

c) ndalimi i viktimizimit, riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor;

ç) konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale;

d) siguria e jetës dhe e shëndetit;

dh) ndalimi i diskriminimit;

e) trajtimi efektiv dhe përkujdesja individuale;

ë) mbështetja dhe partneriteti.

5. Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje funksionojnë pranë çdo bashkie.

6. Komiteti drejtues kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe ka në përbërje:

a) përfaqësuesin e strukturës së Policisë së Shtetit;

b) përfaqësuesin e drejtorisë arsimore;

- c) përfaqësuesin e Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;
 - ç) drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë;
 - d) përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në bashki ose qark;
 - dh) përfaqësuesin e prefektit të qarkut;
 - e) kryetarin e qarkut në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki;
 - ë) përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit;
 - f) drejtuesit e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të specializuara dhe punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
 - g) drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë bashki ose në qarkun në juridiksionin e të cilit janë këto njësi, si dhe qendrave të rehabilitimit për dhunuesit;
 - gj) përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;
 - h) drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit dhe përfaqësuesin e Drejtorisë së Ndhmës Juridike;
 - i) KV-në, i cili, për rastet kur bashkia ka 2 (dy) të tillë, caktohet nga kryetari i bashkisë.
7. Përbërja e anëtarëve të komitetit drejtues, sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, zbatohet, për aq sa dhe është e mundur, duke mbajtur në vëmendje strukturat që gjenden në atë bashki.
8. Sipas rastit, në varësi të rendit të ditës, në mbledhjet e komitetit drejtues, mund të ftohen edhe përfaqësues nga:
- a) gjykata e rrethit gjyqësor;
 - b) prokuroria e rrethit;
 - c) zyra e përmbartimit;
 - ç) Qendra e Menaxhimit të Dhunës Seksuale;
 - d) Shërbimi i Provës;
 - dh) Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve;
 - e) Urdhri i Psikologut;
 - ë) Urdhri i Punonjës Social;
 - f) kryetari i fshatit;
 - g) mjekësia ligjore;
 - gj) mediet lokale;
 - h) autoritetet apo shërbimet e tjera në nivel vendor me rëndësi për pjesëmarrje nisur nga çështjet e rendit të ditës;
 - i) çdo specialist që konsiderohet me rëndësi për marrjen e vendimeve të komitetit drejtues.
9. Përfaqësuesit në komitetin drejtues janë në nivel drejtuesish, nëse pranë bashkive, ku këto komitete ngrihen, funksionojnë institucione të sistemit të drejtësisë, të strukturave arsimore, shëndetësore dhe të punësimit. Nëse pranë bashkive nuk funksionojnë institucionet e sipërpërmendura, institucionet që funksionojnë në qendrën e prefekturës dërgojnë përfaqësues të tyre në komitetet e këtyre bashkive.
10. Përzgjedhja e drejtuesve të organizatave jofitimprurëse bëhet nga kryetari i bashkisë në bashkëpunim me drejtuesin e strukturës së shërbimeve sociale të kësaj njësie të vetëqeverisjes vendore, në përfundim të një procedure aplikimi të hapur duke pasur në vëmendje, por pa u kufizuar në rolin dhe veprimtarinë e OJF-ve në çështje të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore, diskriminimit, mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare ose fusha të ngjashme.
11. Komiteti drejtues mbledhet së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e komitetit drejtues dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës, si dhe të ftuarve sipas pikës 8, të këtij kreu, e kanë kryetari i bashkisë ose jo më pak se tre anëtarë.
12. Njoftimi për mbledhjen e zakonshme bëhet me shkrim, përfshirë këtu dhe dërgimin në adresën elektronike, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes. Në rastin e mbledhjeve

të jashtëzakonshme njoftimi bëhet të paktën 24 (njëzet e katër) orë përpara. Në çdo rast, njoftimi për mbledhjen e komitetit drejtues përmban datën, orën, vendin dhe detaje për rendin e ditës. Vendimet e komitetit drejtues me rëndësi për publikun publikohen në faqen *web* të secilës njësi të vetëqeverisjes vendore.

13. Pjesëmarrja e anëtarëve të komitetit drejtues në mbledhjet e tij është e detyrueshme. Në rastet kur njëri nga anëtarët e komitetit drejtues nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, mungesa duhet të justifikohet me anë të një njoftimi me shkrim, në mënyrë elektronike dhe në formë shkresore. Në këtë rast, titullari i institucionit përkatës cakton një zëvendësues për të marrë pjesë në atë mbledhje të komitetit drejtues. Mungesa e pajustificuar në më shumë se dy mbledhje radhazi sjell zëvendësimin e anëtarit.

14. Komiteti drejtues, në veprimtarinë e tij:

a) ndjek zbatimin e detyrimeve dhe të politikave që burojnë nga ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për organet e vetëqeverisjes vendore përfshirë, por pa u kufizuar në detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nevojat specifike të viktimave;

b) ndjek identifikimin e problemeve për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare në territorin e të bashkisë/qarkut, brenda të cilit ushtrojnë kompetencat anëtarët e tij;

c) analizon efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës e shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor në varësi të funksioneve e të përgjegjësisë që ka secili anëtar i komitetit drejtues;

ç) kujdeset për ndërgjegjësimin dhe orienton organizimin e fushatave e takimeve ndërgjegjësuere kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe në publikimin e materialeve ndërgjegjësuere dhe informuese;

d) ndjek identifikimin e çështjeve që lidhen me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje përmes të dhënave të gjeneruara nga sistemi REVALB, si dhe përditësohet me të dhënat nga ky sistem;

dh) bën propozime dhe kërkesa konkrete, të cilat u drejtohen autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror e vendor për mënyrën e zgjidhjes së problematikave në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjithësi dhe me fokus të veçantë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, grave të minoriteteve, të grave nga komuniteti LGBTI, grave të moshës së tretë, të vajzave nëna dhe nënave kryefamiljare, grave të zonave rurale, shtetasve të huaj dhe atyre pa shtetësi sipas ligjit në fuqi për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ndikuar në zgjidhje përmes kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e grupeve të ndryshme të grave, të cilat pësojnë diskriminim të shumëfishtë;

e) bën vlerësimin e punës së ekipit teknik ndërdisiplinor mbështetur në informacionet dhe raportet periodike të paraqitura nga ky ekip për çdo rast, si dhe marrjen e vendimeve për përmirësimin e funksionimit të tij;

ë) miraton në parim marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit në fuqi, për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare;

f) kujdeset për rritjen profesionale të anëtarëve të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta ndërdisiplinore të personelit në varësi të tyre, që ndjekin çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe sigurimin për njohjen e qytetarëve me funksionet e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe me mënyrat e kontaktimit të tyre;

g) nxit aktivizimin e individëve, të shoqërisë civile dhe të përfaqësuesve të njësive administrative drejt bashkëpunimit dhe referimit të rasteve, duke garantuar fshehtësinë e të dhënave personale të viktimave të dhunës dhe të profesionistëve apo institucioneve /organizatave, të cilat ofrojnë informacion për rastet;

gj) miraton rregulla për procedurat e funksionimit të ETN-së dhe protokollin e menaxhimit të rasteve.

15. Çdo anëtar i komitetit drejtues është i detyruar të informojë me shkrim titullarin e institucionit përkatës, si dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse për vendimet ose masat e marra nga komiteti drejtues, me qëllim marrjen në kohë të masave që lidhen me veprimtarinë e asaj strukture.

16. Komiteti drejtues në marrëdhëniet me organet e pushtetit qendror dhe vendor përfaqësohet nga kryetari i bashkisë.

17. Komiteti drejtues për veprimtarinë e tij i raporton çdo tre muaj ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

Pjesë e raportimit janë të dhënat e problemet e evidentuara për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, në territorin ku komiteti drejtues shtrin juridiksionin e vet, duke paraqitur sipas rastit edhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga autoriteti kryesor përgjegjës ose/dhe autoritetet e tjera të linjës.

18. Komiteti drejtues, sipas problematikës së evidentuar, vë në dijeni, për sa më sipër, njërin prej ose të gjitha autoritetet përgjegjëse të linjës sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Një kopje e raportit i vihet në dispozicion këshillit bashkiak dhe këshillit të qarkut.

19. Përfaqësuesit e autoriteteve të tjera shtetërore në nivel vendor, të cilët janë anëtarë të komitetit drejtues, raportojnë çdo tre muaj në institucionet e tyre qendrore për veprimtarinë e tyre në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Në raportimet periodike që paraqiten, komiteti drejtues kujdeset që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

20. Ekipi teknik ndërdisiplinor ngrihet me vendim të komitetit drejtues me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe drejtohet nga KV-ja.

21. ETN-ja përbëhet nga përfaqësues teknikë të institucioneve që janë të përfaqësuara në komitetin drejtues, përfaqësues nga prefektura përkatëse, nga Shërbimi i Provës, nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të vetëqeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë nga fushat sociale, të psikologjisë, avokatisë, të shërbimit shëndetësor, të mjekësisë ligjore, përmbarrimit dhe Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas.

22. Përfaqësuesit e institucioneve, që janë anëtarë të ETN-së, kanë mandat dyvjeçar me të drejtë ripërtëritje, i cili mund të ndërpritet vetëm në rastin e transferimit në një detyrë tjetër.

23. ETN-ja mbledhet në mbledhje të zakonshme çdo muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave.

24. ETN-ja, në bashkëpunim me grupin teknik ndërdisiplinor për të drejtat e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta rast pas rasti, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare.

25. Punonjësi social pranë strukturave të posaçme të shërbimeve sociale në nivel vendor referon para ekipit teknik ndërdisiplinor rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare, ku përfshihen rastet e identifikuara, rastet e referuara dhe të raportuara që kanë ndodhur në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Punonjësi social referon edhe rastet e identifikuara të dhunës ndaj grave që janë dhunuar jashtë marrëdhënieve familjare, kur viktimat ka nevojë për shërbime mbështetëse.

26. ETN-ja ka këto detyra:

a) ndjekjen e rastit me kërkesën e personave të interesuar ose kryesisht dhe respektimin e të drejtave të viktimave, si dhe plotësimin e nevojave të viktimave sipas dispozitave të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi, lidhur me procedurat për menaxhimin e rastit;

b) koordinimin, ofrimin e shërbimeve përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Urdhrin e Psikologut, me shërbimet komunitare, shërbimet në qendrat e zhvillimit, strehëzat, qendrat e trajtimit të emergjencave dhe të ngjashme me to, që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të administrimit vendor. Në këto marrëveshje përcaktohet roli dhe detyrimet institucionale për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe për zgjidhjen e pasojave, duke ofruar shërbime bazë edhe në zonat rurale e periferike;

c) bashkërendimin e punës me strukturat përkatëse në komisaritet e policisë lidhur me referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë dhunën ndaj grave. Strukturat policore vendore janë struktura pritëse për referimet e rasteve dhe kanë në disponim linjën kombëtare për komunikim pas orës 17:00, për shkak të shërbimit 24-orësh nga ana e Policisë së Shtetit;

ç) koordinimin e ndihmës për dhunën në familje, përfshirë dhunën ndaj grave, që evidentohet në rastet e emergjencave civile dhe të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, si dhe dhunën ndaj shtetasve të huaj dhe të atyre pa shtetësi;

d) ndjekjen në bashkëpunim edhe me koordinatorët vendorë e me punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve të zbatimit të masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo në rastin kur fëmijët jetojnë në familje, ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin;

dh) marrjen e masave për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative ose dhënien e masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, kur ata vuajnë pasojat e dhunës në familje;

e) përcjelljen e raportit mujor me të dhëna për rastet konkrete KV-së si drejtues i ekipit teknik ndërdisiplinor. Të gjithë anëtarët e ETN-së kanë detyrimin të përcjellin të dhënat e përditësuara për fushën e tyre të përgjegjësisë për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje çdo muaj të KV-ja që këto të reflektohen në REVALB në mënyrë sistematike;

ë) monitorimin e raportimin mujor me shkrim në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave;

f) monitorimin e raportimin mujor me shkrim të përfaqësuesve të institucioneve në përbërje të ETN-së për titullarët e këtyre institucioneve lidhur me veprimtarinë dhe mbledhjet e ETN-së, rastet që janë referuar dhe mënyrën e menaxhimit të tyre;

g) bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

gj) ndjekjen e zbatimit të protokolleve dhe të standardeve për vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje.

27. Pranë çdo bashkie caktohet KV-ja, në zyra të dedikuara posaçërisht për kryerjen e këtij funksioni, i cili nuk ka në përshkrimin e punës mbivendosje me detyra të tjera.

28. KV-ja ndërton një platformë pune për parandalimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë të tij lehtësohet nga një ekip mbështetës për ndjekjen e rastit në terren. Në ekipin mbështetës marrin pjesë KV-ja dhe përfaqësues nga shërbimet mbështetëse brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore. Staf i mbështetës lehtëson KV-në në përballimin e ngarkesës, veçanërisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore më të mëdha dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë më shumë raste dhune.

29. KV-së i sigurohet akses i informacionit lidhur me shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, me qëllim ndjekjen e rastit e të historikut të tij.

30. KV-ja merr informacion:

a) përmes raporteve mujore nga shërbimet sociale të njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe për monitorimin e respektimit të urdhrave të mbrojtjes (në vijim, UM) nga palët;

b) nga përgjegjësit e programit të rehabilitimit për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, për rastin kur dhunuesi është urdhëruar të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private lidhur me pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike, si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit;

c) nga përgjegjësit e programit të rehabilitimit, kur i padituri dhunues është vendosur pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatorë ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkoologjisë ose shërbime të toksikologjisë për pjesëmarrjen e të paditurit dhunues në program dhe ecurinë e tij.

31. KV-ja ka këto detyra:

a) drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

b) koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për situatat më emergjente dhe siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;

c) koordinon punën me GTN-në dhe raporton në mbledhjet e përbashkëta të ETN-së me GTN-në, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare;

ç) koordinon punën, duke bashkëpunuar me punonjës social pranë strukturave të posaçme të shërbimeve sociale në bashki dhe administratorët shoqërorë/punonjës social në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron veprimtarinë;

d) koordinon punën me administratorët shoqërorë/punonjës socialë të njësive të vetëqeverisjes vendore në rastin kur bashkitë janë të organizuara me disa njësi të tilla, duke mbuluar me shërbime edhe zonat rurale e periferike;

dh) bashkëpunon me organet ligjzbatuese për marrjen dhe zbatimin e masave për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve dhe për zbatimin e vendimit gjyqësor;

e) bashkëpunon me shërbimin e provës për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor;

ë) harton një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim) dhe e përditëson atë vazhdimisht;

f) ndërmjetëson me OJF-të, Policinë e Shtetit, shërbimet shëndetësore, gjykatat, Shërbimin e Provës, strukturat e shërbimit të ndihmës juridike, shërbimet sociale dhe institucione/organizata të tjera referimi për të marrë e dhënë informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;

g) koordinon punën me qendrat sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse e qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe me qendrat publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

gj) sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth viktimave të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar. Merr një kopje të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndjek zbatimin e tij;

h) përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ETN-ja në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave, si dhe ndan një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e këtij ekipi. Për këtë qëllim, secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor ka përgjegjësi që të përcjellë te KV-ja, një herë në muaj, informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet;

i) sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, si dhe sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin;

j) asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (në vijim, UMM), si dhe për hapat që duhen ndjekur, nëse urdhri shkelet;

k) shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe/ose pranë shërbimeve të tjera;

l) harton planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN), sikurse parashikohet në këtë vendim;

ll) monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit;

m) bashkëpunon për të siguruar vizitat në banesën e viktimës sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm;

n) koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, sipas ligjit nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, ‘Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’, të ndryshuar”, për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;

nj) mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuere për dhunën;

o) harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim;

p) paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhje nga komiteti drejtues;

q) identifikon protokollet ekzistuese në komunitet ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme;

r) propozon krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

rr) është anëtar i grupit që përgatit planet sociale, ku analizohen nevojat sociale dhe parashikohen masat për përmirësimin ose ngritjen e shërbimeve të reja për subjektet e përfshira në dhunën në familje, si dhe anëtar i grupit që përgatit planet vendore për barazinë gjinore në nivel vendor.

III. PROCEDURAT BAZË PËR MENAXHIMIN E RASTIT TË DHUNËS NË FAMILJE

1. Raportimi dhe identifikimi i rastit të dhunës në familje kryhet nga koordinatori vendor pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përmes:

- a) verifikimit të raportimeve nga personi i dhunuar;
- b) referimit të rastit nga strukturat e Policisë së Shtetit;
- c) referimit të rastit nga çdo institucion i përfaqësuar në ETN;
- ç) verifikimit të raportimeve nga çdo person tjetër fizik a juridik, publik ose privat;
- d) verifikimit të njoftimeve nga media e shkruar, elektronike ose mediat sociale.

1.1 KV-ja raporton e identifikon edhe rastet e tjera të dhunës së ushtruar ndaj grave, të parashikuara në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, sipas kësaj pike.

2. Viktima e dhunës dhe/ose çdo person fizik a juridik, publik ose privat, që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës, raporton rastin pranë KV-së, Policisë së Shtetit ose çdo institucioni anëtar të ETN-së. Pavarësisht se në cilin prej institucioneve të ETN-së raportohet rasti i dhunës, secili prej tyre, nëse konstaton se ka nevojë për ndërhyrje, njofton KV-në, i cili merr masat e nevojshme për vlerësimin e nevojave dhe trajtimin e rastit.

3. Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut për rastet e dhunës në familje realizohet nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse, të cilët e kryejnë këtë proces sipas udhëzimeve të përbashkëta të ministrit të Brendshëm dhe ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, për procedurat e vlerësimit të riskut dhe lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM).

4. Kur nga vlerësimi i riskut rezulton se rasti është urgjent, struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit lëshon menjëherë UMPMM-në dhe, në bashkëpunim me KV-në, merr masat mbrojtëse të përshtatshme për zbatimin e tij.

5. Koordinimi i masave mbrojtëse të menjëhershme realizohet, si më poshtë vijon:

a) koordinatori vendor bashkërendon veprimet në rastin urgjent, për zbatimin e UMPMM-së të lëshuar nga Policia e Shtetit dhe/ose UMM-së të lëshuar nga gjykata;

b) Policia e Shtetit, në bashkëpunim me KV-në, dhe, nëse është rasti, me përfaqësuesin e zyrës së përmbarrimit, marrin masa për largimin e dhunuesit nga banesa;

c) KV-ja përcakton me urgjencë nevojat për shërbime të specializuara dhe burimet përkatëse;

ç) KV-ja, në bashkëpunim me përfaqësuesin e Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH në ETN), kryejnë shoqërimin e viktimës në institucionet e shëndetit parësor;

d) kur viktima e dhunës në familje dhe fëmijët nuk janë të sigurt në shtëpi, KV-ja, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe përfaqësuesin e Zyrës së Përmbarrimit në ETN, me pëlqimin e saj, kryejnë shoqërimin dhe transportimin e viktimës në një vend të sigurt, strehëza, në një banesë sociale a vendbanim tjetër;

dh) në rastin kur viktima shoqërohet nga fëmijët e mitur, shoqërimi në strehëza kryhet mbi bazën e përcaktimeve të UMPMM-së në bashkëpunim me NJMF-në;

e) KV-ja bashkëpunon me subjektet publike ose private që ofrojnë ndihmë ligjore për ofrimin e këshillimeve dhe ndihmës ligjore falas, për lëshimin e urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes, si dhe nevojave të tjera për të cilat paraqitet rasti;

ë) KV-ja bashkëpunon me qendrat që ofrojnë këshillim psikologjik, shërbime shëndetësore dhe mbështetje të tjera të nevojshme, të cilat parashikohen në protokollin përkatës të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje;

f) nëse nga vlerësimi i riskut rezulton viktima e dhunuar seksualisht, KV-ja, së bashku me strukturën përgjegjëse të Policisë së Shtetit, dërgojnë menjëherë viktimën në një qendër të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale;

g) Në të gjitha rastet që nevojiten shërbime të tjera, KV-ja, në bashkëpunim me anëtarët e ETN-së, referojnë e shoqërojnë viktimën pranë subjekteve publike ose private që ofrojnë shërbimet përkatëse, siç është parashikuar në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje ose në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale;

gj) KV-ja bashkëpunon me Policinë e Shtetit dhe autoritetet e tjera përgjegjëse sipas detyrave që përcakton ligji në fuqi kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe procedurës së parashikuar në këtë vendim;

h) kur dhuna është ushtruar ndaj një fëmije ose në prani të fëmijëve, KV-ja bashkëpunon me njësinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Në këtë rast zbatohen masat sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të atij kundër dhunës në marrëdhëniet familjare;

i) gjatë kohëzgjatjes së UMM-së, KV-ja monitoron respektimin e masave që urdhërohen për palën e paditur. Nëse nga monitorimi konstatojnë veprime të kryera nga i padituri që janë në kundërshtim me këtë urdhër, KV-ja njofton menjëherë Policinë e Shtetit.

6. Koordinimi i masave mbrojtëse afatgjata kryhet, si më poshtë vijon:

a) pas dhënies së ndihmës së parë me masat mbrojtëse të menjëhershme, KV-ja dhe anëtarët e ETN-së hartojnë planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN) për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar, duke u bazuar edhe në masat mbrojtëse të vendosura nga UM-ja e lëshuar me vendim gjykatë;

b) si rregull, PPN-ja parashikon:

- i. masat konkrete për të ulur nivelin e rrezikut dhe parandaluar përsëritjen e dhunës;
- ii. shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat e viktimës së dhunës, në mënyrë të veçantë nevojat për strehim, punësim, ndihmë juridike të garantuar nga shteti;
- iii. shërbimet dhe ndihmën e nevojshme për rehabilitimin e viktimës;
- iv. ndihmën dhe mbështetjen e viktimës për lëshimin e UMM-së dhe/ose UM-së;
- v. ndihmën dhe mbështetjen për rehabilitimin e dhunuesit, nëse kjo është parashikuar në UMM-në/UM-në e lëshuar me vendimin e gjykatës;

vi. afatet kohore;

vii. autoritetet përgjegjëse;

viii. institucionet, organizatat ose individët që do të ofrojnë shërbimet publike dhe jopublike.

7. KV-ja mban një dosje dhe u dërgon anëtarëve përkatës të ETN-së raportin e referimit të rastit me të dhënat shoqëruese për viktimën e dhunës në familje, analizën e riskut, urdhrin e mbrojtjes që është lëshuar, si dhe dokumente të tjera bashkëshoqëruese, duke caktuar detyrat për secilin prej tyre, afatet përkatëse, si dhe shërbimet që kanë nevojë të mbulohen me shpenzime.

8. KV-ja i paraqet, për miratim, drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, PPN-në, së bashku me analizën e riskut. Drejtori, pasi vlerëson shpenzimet që nevojiten, brenda së njëjtës ditë, miraton PPN-në dhe merr masat për prokurimin e shërbimeve që kërkojnë shpenzime. Në pamundësi financiare, drejtori orienton kryerjen e shërbimeve në mënyrë progresive në varësi të shtimit të fondeve ose kërkon bashkëpunimin e anëtarëve të tjerë të ETN-së për përmbushjen e shërbimeve. KV-ja u dërgon zyrtarisht të gjithë anëtarëve të ETN-së që do të mbështesin rastin PPN-në përfundimtare ditë e nesërme.

9. Koordinimi i masave mbrojtëse të menjëhershme, si dhe i masave të koordinuara nga PPN-ja mund të zbatohen edhe për mbështetjen e viktimave të dhunës ndaj grave që dhunohen jashtë marrëdhënieve familjare.

10. Viktimat në moshë të mitur trajtohen në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë njësisë vendore përkatëse.

11. Viktimat e trafikimit dhe të shfrytëzimit për prostitucion referohen nga KV-ja pranë Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave.

12. Në rastet kur në të gjithë vendin ose në njësinë e vetëqeverisjes vendore janë shpallur masat e jashtëzakonshme, do të ndiqen procedurat e posaçme të menaxhimit të rasteve të

miratuara nga autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

13. Administrimi dhe raportimi i të dhënave realizohet, si më poshtë vijon:

a) KV-ja, në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e ETN-së që kanë menaxhuar rastin, dokumenton:

i. të dhënat për informacionin, veprimet e kryera, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të dhunës në familje;

ii. të dhënat për dhunuesin që ka ushtruar dhunë ndaj viktimave të dhunës në familje;

iii. të dhënat për fëmijët që kanë pësuar dhunë, si dhe për viktimat e dhunës seksuale në familje;

iv. të dhënat për të gjitha llojet e mbrojtjes dhe trajtimit deri në rehabilitimin e viktimës si dhe gjurmimin e monitorimit të ekzekutimit të tyre;

b) këto të dhëna regjistrohen dhe përditësohen nga KV-ja, përpunohen dhe administrohen prej tij në sistemin elektronik të ruajtjes së të dhënave pranë bashkisë www.revalb.org, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore përkatëse. Për sa është e mundur, dokumentohen edhe të dhënat për mbështetjen e viktimave të dhunës ndaj grave, që dhunohen jashtë marrëdhënieve familjare;

c) sistemi REVALB përfshin hedhjen e përditësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje, veprimet e kryera, shërbimet e ofruara, si dhe të elementeve që kanë lidhje me monitorimin e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje. Ai ka qëllim:

i. mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e tyre, si dhe ndjekjen e tyre në kohë reale;

ii. koordinimin e përpjekjeve ndërinstucionale, në mënyrë që të mundësohet ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet e dhunës në familje;

iii. unifikimin dhe kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave në lidhje me dhunën në familje;

ç) çdo anëtar i ekipit ndërdisiplinor, një herë në muaj, nëpërmjet formularit të mbledhjes së të dhënave, përcjell tek KV-ja informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda institucionit;

d) KV-ja dokumenton të dhënat në lidhje me takimet e ETN-së dhe komitetin drejtues, pjesëmarrjen, diskutimet dhe ndjekjen e tyre. Këto të dhëna regjistrohen nga KV-ja dhe përpunohen e administrohen prej tij në një seksion të veçantë të sistemit elektronik REVALB;

dh) KV-ja, punonjësi i Policisë së Shtetit dhe të gjithë personat e institucionet që përfshihen në menaxhimin e rastit të dhunës kanë detyrimin të ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale për viktimat e dhunës në familje, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe të dhënave për dhunuesin;

e) drejtoria e shërbimeve sociale dhe KV-ja, me qëllim harmonizimin e të dhënave, bashkëpunojnë me organet e tjera që gjenerojnë të dhëna për rastet e dhunës në familje, sipas legjislacionit në fuqi, duke nënshkruar marrëveshje për bashkëpunimin ndërmjet tyre;

ë) KV-ja ndan një herë në muaj raportet e përditësuara që gjeneron sistemi REVALB, si dhe një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e ekipit multidisiplinor. Sipas rastit, këto raporte mund të jenë të koduara, që sigurojnë fshehtësinë e emrit të viktimës;

f) KV-ja, bazuar në të dhënat e sistemit REVALB, paraqet raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues dhe autoritetit kryesor përgjegjës. Në raport përfshihen në formë të përmbledhur të dhëna për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet që janë ndeshur gjatë menaxhimit të rastit dhe mund të kërkojnë zgjidhje nga komiteti drejtues ose autoriteti kryesor përgjegjës.

14. Monitorimi i zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës realizohet, si më poshtë vijon:

a) gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, KV-ja dhe/ose punonjësi social i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki monitoron respektimin e masave të urdhrit të mbrojtjes nga pala përkatëse dhe harton raportin e monitorimit për zbatimin e masave mbrojtëse. Ky raport i bëhet i njohur menjëherë Policisë së Shtetit, së bashku me rekomandimet e KV-së;

b) kur nga monitorimi i zbatimit të masave të UMM-së/UM-së rezulton kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me masat e veçanta që urdhërohen prej saj, njoftohet menjëherë Policia e Shtetit, në çdo kohë, pa prituri të përmbushet afati 60-ditor;

c) nëse është rasti, KV-ja i kërkon të urdhëruarit të paraqitet dhe i bën me dije shkeljet e konstatuara, duke i tërhequr vëmendjen;

ç) raporti u paraqitet anëtarëve të ETN-së në mbledhjen më të parë, të cilët marrin masat e nevojshme sipas detyrave të lëna në raport;

d) raporti hartohet me shkrim, sipas një formati tip, siç është parashikuar në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Në çdo rast, raporti përmban:

i. veprimet e kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për UM-në nga pala e urdhëruar, të cilat renditen të shkruara në një vend të dukshëm dhe i adresohen Policisë së Shtetit;

ii. mbarëvajtja e shërbimeve të ofruara nga subjektet që janë urdhëruar në vendimin e gjykatës;

iii. progresi i PPN-së;

iv. detyrat për të ardhmen.

15. ETN-ja, në bazë të raportit të paraqitur nga KV-ja, vlerëson mbarëvajtjen e rastit. Në vlerësimin e saj, ETN-ja mban parasysh:

a) nëse është ulur ose minimizuar niveli i riskut;

b) nëse janë kryer shërbimet e parashikuara në PPN;

c) nëse pas këtyre shërbimeve është kaluar trauma e dhunës së përjetuar nga viktimat dhe janë kryer shërbimet për rehabilitimin e saj.

16. Kur nga vlerësimi i rastit rezulton se afati i urdhrit të mbrojtjes ka përfunduar dhe nuk kërkohet zgjatja e afatit të tij, si dhe kur rezultojnë të përmbushura detyrat e parashikuara në PPN, ETN-ja merr vendim për mbylljen e rastit.

17. Vendimi për mbylljen e rastit, kur rezulton se risku është i ulët, merret nga KV-ja, pasi ai ka hartuar raportin e vlerësimit. Ky vendim miratohet nga ETN-ja në mbledhjen më të parë të radhës.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij vendimi, ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje miraton formatin bazë të protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave përmes mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe e boton atë në faqen zyrtare të internetit në një program që qaset lehtësisht nga publiku.

2. Vendimi nr. 334, datë 17.2.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", shfuqizohet.

3. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, si dhe institucionet e tyre të varësisë, që lidhen me zbatimin e këtij vendimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

UDHËZIM
Nr. 13, datë 17.12.2012

PËR ZBATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES
SHOQËRORE, PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE, NË QENDRAT
REZIDENCIALE, PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, në nenin 18 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar dhe në zbatim të vendimit nr. 505, datë 13.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”,

UDHËZOJ:

Qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje ofrojnë shërbime në përputhje me standardet dhe procedurat e mëposhtme:

1. Deklarata e qëllimit

1.1. Çdo qendër rezidenciale publike dhe jopublike e përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje harton një formular përmbledhës të ofruesit të shërbimit, i cili përshkruan qartë misionin e qendrës, shërbimet që ofron, qëllimet dhe objektivat e saj.

1.2. Në formularin përmbledhës të ofruesit të shërbimit përcaktohet misioni, objektivat e qendrës, profili që ka, shërbimet që ofrohen, kriteret për të përfituar këto shërbime, struktura organike e qendrës për zbatimin e shërbimeve të deklaruara, detyrat dhe detyrimet e stafit, procedurat e shërbimeve, mbrojtja dhe siguria e përfitueseve, lidhja me familjarët dhe të afërmit, procedura e ankimimit, deklarata e konfidencialitetit, referimi në një qendër tjetër apo largimi nga qendra (aneksi 1: Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit).

1.3. Misioni, vizioni, qëllimet dhe objektivat afishohen në një vend të dukshëm dhe të disponueshëm për të gjithë stafin dhe përfitueset.

1.4. Përfitueset duhet të konfirmojnë se janë njohur me formularin përmbledhës të ofruesit të shërbimit dhe kanë marrë një kopje të tij.

1.5. Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimeve duhet të deklarojë qartë se si ofrohen shërbimet, drejtpërdrejt nga ofruesi i shërbimeve ose nëpërmjet referimit nga institucionet ose organizatat e tjera. Formulari përmbledhës bëhet baza e deklaratës së pranimit.

Deklarata e pranimit është një pranim nga ana e përfitueses për të marrë shërbimet në bazë vullnetare dhe të pranojë kuptimin dhe respektimin e rregullave të ofruesit të shërbimeve.

Njëkohësisht ky dokument është edhe si pranim nga ana e ofruesit të shërbimeve të përfitueses në programin e tij (aneksi 1: Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit; aneksi 2: Deklaratë pranimi për të rriturit mbi 18 vjeç; aneksi 3: Deklaratë pranimi për të miturit nën moshën 18 vjeç).

1.6. Për përfituesit që janë nën moshën 18 vjeç, prindërit ose kujdestarët ligjorë duhet të nënshkruajnë deklaratën e pranimit. Në këtë mënyrë sigurohet që prindi/kujdestari i përfituesit të mitur është plotësisht i informuar rreth shërbimeve që merr i mituri përfitues, si dhe mbi rregullat që do të funksionojnë gjatë kohës së qëndrimit të të miturit në qendrën rezidenciale (aneksi 3: Deklaratë pranimi për të miturit nën moshën 18 vjeç).

1.7. Formulari përmbledhës i ofruesit të shërbimit rishikohet dhe përditësohet sa herë që ofruesi i shërbimeve zgjeron aktivitetin e tij, por që asnjëherë nuk del jashtë objektit të licencimit të qendrës.

2. Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes për përfitueset

i) Vlerësimi i nevojave

2.1. Nevojat e personave të dhunuar vlerësohen nga një ekip multidisiplinar, ku profesionistët punojnë së bashku për të diskutuar rastin, në përputhje me moshën dhe nevojat e tyre respektive, me qëllim hartimin e planit përkatës të ndihmës.

2.2. Për çdo përfitues caktohet një punonjës social, i cili menaxhon rastin. Menaxheri i rastit udhëheq procesin e vlerësimit të nevojave të përfitueses, hartimin e planit të ndihmës dhe zbatimin e tij. Ajo takohet rregullisht me përfituesen për të diskutuar progresin e përgjithshëm në arritjen e qëllimeve të saj individuale dhe planit të ndihmës. Ajo drejton organizimin e referimeve dhe e ndihmon përfituesen për të identifikuar dhe arritur burimet e nevojshme.

2.3. Vlerësimi i nevojave përfshin këto fusha: vlerësimin e nevojave shëndetësore, psikosociale, ligjore, arsimore, profesionale, të punësimit, të sigurisë, të akomodimit afatgjatë, të lidhjeve me familjen etj. (anekset: 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11).

2.4. Vlerësimi i nevojave individuale për përfituesen duhet të përfundojë brenda dy javësh nga dita e hyrjes së përfitueses në qendër.

2.5. Pasi kryhet vlerësimi i nevojave, ekipi multidisiplinar mbledhet si një grup për të diskutuar rastin dhe për të hartuar planin përkatës të ndihmës.

ii) Planifikimi i ndihmës

2.6. Plani i ndihmës hartohet pas vlerësimit të nevojave dhe përfshin masat afatmesme dhe afatgjata të nevojave të identifikuara për përfituesen.

2.7. Plani i ndihmës hartohet brenda 30 ditësh nga dita e akomodimi të përfitueses në qendër.

2.8. Përfituesja përfshihet në procesin e hartimit të planit të ndihmës në përputhje me grupmoshën, kapacitetin dhe aftësitë individuale të saj.

2.9. Menaxheri i rastit është përgjegjës për grumbullimin e informacionit dhe hartimin e planit të ndihmës. Menaxheri i rastit bashkëpunon për këtë me ekipin multidisiplinar. Ai përdor rezultatet e diskutimit, si dhe formularët e vlerësimit të nevojave për të hartuar së bashku me përfituesen një plan ndihme tërësor. Plani i ndihmës është formatuar në përputhje me formularët e vlerësimit të nevojave, në mënyrë që t'i korrespondojë me lehtësi procesit të vlerësimit të nevojave (anekset: 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11).

2.10. Përfituesja dhe menaxheri i rastit duhet të nënshkruajnë planin për të treguar që të dyja palët janë të angazhuar për zbatimin e tij.

2.11. Për përfituesit e mitur, nën moshën 18 vjeç, hartohen plane të ndihmës të përshtatur me nevojat e tyre, duke përdorur formularët e planit të ndihmës të dhënë në manualin për zbatimin e standardeve për fëmijë në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike në Shqipëri.

2.12. Plani i ndihmës përditësohet e përshtatet me ndryshimet e nevojave dhe rrethanave të përfitueses. Menaxheri i rastit dhe përfituesja duhet të takohen për të diskutuar progresin e bërë deri në atë moment dhe ndonjë ndryshim të nevojshëm të planit.

2.13. Nëse përfituesja transferohet në një qendër tjetër për kujdeses shoqërore, një kopje e planit të ndihmës duhet t'i dërgohet ofruesit të ri të shërbimeve (me pëlqimin e përfitueses), në mënyrë që ndihma e filluar të vazhdojë të ofrohet, si dhe ofruesi i ri të kuptojë se cilat shërbimet i janë ofruar përfitueses deri në atë moment.

3. Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitueses

3.1. Ofruesit e shërbimeve hartojnë dokumentacion të qartë të të drejtave të përfitueses që qëndrojnë në qendër. Këto të drejta duhet të jenë të shkruara në gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Të drejtat duhet të përfshijnë minimalisht të drejtën për t'u trajtuar me respekt dhe dinjitet, për t'u larguar në çdo moment nga qendra ose programi, për t'u ankuar pa pasur frikën e pasojave negative dhe për akomodim të sigurt, ushqim të mjaftueshëm dhe të shëndetshëm gjatë qëndrimit në qendër.

3.2. Ofruesit e shërbimeve hartojnë rregullat e qendrës. Këto rregulla duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Këtu përfshihen të gjitha rregullat që ka qendra. Ofruesit e shërbimeve duhet të rivlerësojnë rregullisht rregulloret e tyre për t'u siguruar që ato nuk kanë ndonjë rregull të pavlefshëm ose të panevojshëm, të cilët vendosin kufizime mbi jetën e përfitueses.

3.3. Ofruesit e shërbimeve duhet të shkruajnë detyrat dhe përgjegjësitë e përfitueseve. Këto detyrime duhet të jenë të shkruara në një gjuhë të qartë e të lehtë për t'u kuptuar. Ato duhet të përfshijnë të gjitha detyrimet që ka përfituesja kur merr pjesë në programin e ofruesit të shërbimeve ose qëndrojnë në qendër.

3.4. Të gjitha dokumentet e mësipërme, të drejtat e përfitueses, rregullat dhe detyrimet (ose përgjegjësitë) e përfitueses duhet të afishohen në qendrën rezidenciale. Ato duhet të afishohen në një mënyrë që të mund të shihen dhe të lexohen lehtësisht nga përfitueset dhe stafi. Nëse ato zbehen ose grisen, duhet të zëvendësohen menjëherë.

3.5. Të gjitha dokumentet e mësipërme, të drejtat e përfitueses, rregullat dhe detyrimet (ose përgjegjësitë) e përfitueses, duhet të firmosen dhe nga përfituesja. Përmbajtja e këtyre dokumenteve duhet të përfshihet në deklaratën e pranimi. Deklarata e pranimi nënshkruhet si nga përfituesja, ashtu dhe nga ofruesi i shërbimeve (dhe në rastin e të miturve, nga prindi ose kujdestari ligjor) (aneks: 2 dhe 3)

3.6. Përpara se përfituesja të nënshkruajë deklaratën e pranimi, asaj i shpjegohen, në detaje e me një gjuhë të thjeshtë, e gjithë përmbajtja e deklaratës, përfshirë listën e të drejtave të përfitueses, rregullat, detyrimet (ose përgjegjësitë) e përfitueses, dhe çështjet e konfidencialitetit. Ofruesi i shërbimeve duhet të sigurohet gjatë intervistës që përfituesja kupton jo vetëm fjalët e dokumenteve, por dhe qëllimin dhe arsyen e tyre.

3.7. Ofruesi i shërbimeve duhet të përfshinë përfituesen në funksionimin e qendrës dhe në vendimarrjen që lidhet me jetën e përditshme të saj në qendër. Përfituesja nxitet të japë mendime për shërbimet dhe rregullat e vendosura, për orarin e ngrënies, të aktiviteteve, orarin e pastrimit etj.

3.8. Përfituesja inkurajohet dhe merr pjesë në planifikimin e menysë, përgatitjen e vakteve, shtrimin e tavolinës. Sugjerimet dhe preferencat e saj duhet të plotësohen për sa kohë ato janë brenda buxhetit dhe sigurojnë një dietë të balancuar dhe ushqyese.

3.9. Qëndrimi në qendrat rezidenciale është vullnetar. Qendrat kanë procedura për të siguruar që përfitueset janë të lira të largohen me vullnetin e tyre të lirë. Në rastet kur një përfituese e rritur dëshiron të largohet, përfituesja, menaxheri i rastit të saj dhe punonjësi epror në turn, plotësojnë dhe nënshkruajnë formularin e listëkontrollit të largimit. Në rastin e të miturve, prindi ose kujdestari ligjor duhet të miratojnë largimin e përfituesit të mitur nga qendra (aneks 18: Listëkontrolli i largimit).

3.10. Nëse një përfituese largohet pa njoftuar nga qendra, duhet të informohet policia, në mënyrë që të fillojë menjëherë kërkimi i përfitueses. Një kërkim i tillë bëhet për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e përfitueses. Pas gjetjes së përfitueses, stafi i qendrës diskuton me të për arsyet e largimit, mundësinë për të qëndruar në qendër apo organizimin e largimit zyrtar nga qendra. Nëse përfituesja kërkon të largohet, duhet të ndërmerren hapat e mësipërm për një largim të sigurt dhe me dinjitet.

3.11. Ofruesi i shërbimeve siguron një procedurë legjitime dhe funksionale për ankimimet. Përfituesja mund të ankohet rreth çdo aspekti të jetesës së saj në qendër, si dhe për shërbimet që ka marrë ose jo. Ofruesi i shërbimeve duhet t'i konsiderojë këto ankesa si një mundësi për të përmirësuar performancën e tij. Asnjë pasojë negative nuk mund të ketë për përfituesen për shkak të paraqitjes së një ankese.

3.12. Çdo ofrues shërbimesh duhet të ketë procedura të qarta me shkrim për trajtimin e ankesave. Këto procedura duhet të shpjegojnë mënyrat e ndryshme të ankimimit që mund të përdoren nga përfituesja (aneksi 20: Procedurat e ankimimit).

3.13. Çdo ofrues shërbimesh do të mbajë dhe një regjistër ankesash. Në këtë regjistër duhet të përfshihet personi përgjegjës për t'iu përgjigjur ankesës, rezultatet nga hetimi i ankesës, si është trajtuar ankesa dhe dokumentacion të shkruar mbi përgjigjen që i është dhënë personit që ka bërë ankesën, nëse ankesa nuk ishte anonime.

3.14. Çdo anëtar stafi i ofruesit të shërbimeve që merr një ankesë me gojë nga një përfituese, duhet ta regjistrojë këtë ankesë në regjistrin e ankesave, së bashku me datën e ankesës dhe të dokumentojë aty mënyrën se si është trajtuar ankesa.

3.15. Të gjitha ankesat duhet të marrin përgjigje me shkrim dhe një kopje e përgjigjes me shkrim të përfshihet në regjistrin e ankesave. Inspektimi i ankesave vërteton se ato janë trajtuar me seriozitet dhe në kohën e duhur.

4. Të dhënat personale të përfitueses dhe mënyrat e menaxhimit të tyre

4.1. Për secilën përfituese që qëndron në qendër, ofruesi i shërbimeve duhet të hapë dhe të mbajë një dosje individuale. Kjo dosje individuale duhet të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

a) Deklaratën e pranimit të firmosur (aneks 2 dhe deklaratë pranimi).

b) Shënime nga takimet fillestare me organizatën apo agjencinë referuese (nëse nuk është vetëreferuar).

c) Procesverbal të nënshkruar (nëse nuk është vetëreferuar): Për përfitueset që janë referuar nga një organizatë tjetër, publike ose jopublike, apo nga agjencitë e zbatimit të ligjit, në dosje duhet të përfshihet një procesverbal për të dokumentuar “dorëzimin” e përfitueses. Ai duhet të jetë nënshkruar nga agjencia referuese, agjencia pritëse dhe përfituesja.

Për personat nën moshën 18 vjeç, ai duhet të nënshkruhet dhe nga prindi ose kujdestari ligjor. Nëse jo, dosja duhet të përmbajë informacion që shpjegon përse nuk ka një firmë të prindit ose të kujdestarit (aneks 21: Procesverbal referimi).

d) Shënime nga intervistat/diskutimet. Ofruesi i shërbimeve duhet të mbajë shënime me shkrim mbi të gjitha takimet dhe diskutimet me përfituesen, familjen e saj, ofruesit e tjerë të shërbimeve apo autoritetet, që lidhen me rastin dhe përkujdesjes ndaj përfitueses. Shënimet duhet të përfshihen në dosje.

e) Formular vlerësimi fillestar i plotësuar. Formulari i hartuar standard i vlerësimit paraparak për të identifikuar të mbijetuarën e dhunës në familje. Ky formular duhet të plotësohet për të gjithë pjesëmarrëset që ndihmohen si viktime të dhunës në familje (aneks 22: Procesverbal i vlerësimit).

f) Formularë të plotësuar të vlerësimit të nevojave. Këto formularë ndihmojnë ofruesin e shërbimeve në vlerësimin e nevojave për ndihmë që mund të ketë e mbijetuara e dhunës në familje (aneks: 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11: Formular vlerësimi të nevojave).

Këto formularë përfshijnë:

- vlerësimin e sigurisë (aneksi 9);
- vlerësimin e akomodimit (aneksi 11);
- vlerësimin ligjor (aneksi 6);
- vlerësimin shëndetësor (aneksi 4);
- vlerësimin profesional/punësimi (aneksi 8);
- vlerësimin psikosocial (aneksi 5);
- vlerësimin familjar (aneksi 10);
- vlerësimin e arsimimit (aneksi 7);

- për të miturit nën moshën 18 vjeç (aneksi 23 dhe referohuni standardeve të përkujdesjes për fëmijët) (aneksi 34: Mbajtja e të dhënave personale të përfitueses).

g) Informacion shëndetësor. Përfshin çdo të dhënë mjekësore, regjistrime të vizitave, rezultate analizash dhe trajtimet.

h) Dokumentet e kujdestarisë (vetëm për të miturit, nën moshën 18 vjeç).

4.2. Të dhënat personale përfshijnë gjithçka që është në dosjen personale që përshkruhet më lart, si dhe çdo dokument tjetër që mund të zbulojë identitetin ose vendndodhjen e përfitueses, p.sh. qytetin e origjinës (nëse ata vijnë nga një qytet i vogël), informacion shëndetësor, informacion rreth familjes së saj/tij ose situatës familjare, ose ndonjë detaj tjetër personal apo privat.

4.3. Dokumentacioni i përfitueses/it (dosja e përfitueses/it dhe të dhënat personale) duhet të jenë konfidenciale. Dokumentacioni mbahet në një vend të sigurt. Dokumentacioni aksesohet

vetëm nga punonjësi social, menaxheri i rastit, drejtuesi i qendrës dhe nga përfituesja. Administrimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.4. Pjesëmarrëset kanë akses në dosjet e tyre. Pjesëmarrëset informohen se kanë akses në dosjen e tyre, nëse ata dëshirojnë.

4.5. Ofruesi i shërbimeve duhet të mbrojë të gjitha të dhënat personale të pjesëmarrësës. Ofruesi i shërbimeve është i detyruar të sigurojë që dosjet e printuara dhe dosjet elektronike me të dhëna të ruhen të sigurt. Për dosjet e printuara, kjo duhet të bëhet nëpërmjet ruajtjes së dosjeve në rafte të mbyllura me çelës në një dhomë që është e kyçur. Për dosjet elektronike, ato duhet të ruhen me fjalëkalim (aneksi 34).

4.6. Ofruesi i shërbimeve duhet të vendosë kufizime se kush mund të vizitojë qendrën, sa njerëz mund ta vizitojnë njëherazi, çfarë mund t'u lejohet vizitorëve që të bëjnë dhe sa shpesh do të lejohen vizitorët. Këto rregulla për vizitat duhet të jenë të shkruara (aneksi 24 dhe 24.1: Marrëveshja dhe rregullat për vizitat në qendër).

4.7. Të gjithë vizitorët nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti përpara ose sapo të mbërrijnë në qendër (aneksi 24: Marrëveshje konfidencialiteti për vizitorët).

4.8. Kur pjesëmarrëset transferohen në një qendër tjetër, bëhet dhe transferimi i dosjeve (me miratimin e përfitueses). Shërbimi referues mban kopjet origjinale në dosjet e tij, ndërsa fotokopjet i dërgon te ofruesi i ri i shërbimeve, me qëllim që të vazhdohet ndihma në bazë të shërbimeve që i janë dhënë përfitueses deri në atë kohë dhe jo të fillojë gjithçka nga e para (aneksi 25: Transferimi i dosjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve).

5. Menaxhimi i brendshëm i qendrës së shërbimit

5.1. Ofruesi i shërbimit ka një strukturë të nevojshme të personelit në përputhje me nevojat e përfitueses. Organograma e ofruesit të shërbimeve paraqet në mënyrë grafike të gjitha pozicionet brenda organizatës ose agjencisë që lidhen me funksionimin e qendrës rezidenciale, si edhe marrëdhëniet e varësisë dhe të mbikëqyrjes së saj (organograma e miratuar).

5.2. Staf i duhet të rekrutohet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe transparent.

5.3. Ofruesi i shërbimeve duhet të mbajë dosje për të gjithë punonjësit që janë marrë në punë. Secila dosje individuale e punonjësit përfshin: CV-në e punonjësit, diplomë, dëshmi penaliteti, certifikatat profesionale, rekomandime, përshkrimin e detyrave, kontratën e punës, vlerësimet e performancës, certifikata mjekësore etj.

5.4. Ofruesi i shërbimeve përgatit dhe shpërndan materiale të shkruara (broshura, fletëpalosje etj.) rreth organizatës/agjencisë dhe shërbimeve të ofruara në mënyrë që përfitueset të jenë të informuara mirë rreth mundësive që kanë për t'u ndihmuar.

6. Staf i ofruesit të shërbimeve dhe zhvillimi i tij

6.1. Për secilin pozicion, ofruesi i shërbimeve duhet të hartojë përshkrimin e vendeve të punës, ku përcaktohen përgjegjësitë, detyrat, arsimimi, kualifikimi. Pozicionet dhe kualifikimet duhet të korrespondojnë me shërbimet e ofruara.

6.2. Staf i duhet të nënshkruajë një kontratë pune që është në përputhje me Kodin e Punës. Kontrata e punës duhet të përfshijë minimalisht: përshkrimin e detyrave, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit, marrëdhëniet e varësisë, referencat te çdo rregullore e brendshme, siç janë kodet e etikës, marrëveshjet e konfidencialitetit etj.

6.3. Detyrimet e stafit ndaj përfitueses duhet të afishohen në qendër që të gjithë përfitueset të mund t'i shohin (aneksi 28: Detyrimet e stafit ndaj pjesëmarrësve).

6.4. Punonjësjë e re merr një trajnim të brendshëm për të kuptuar më mirë misionin e ofruesit të shërbimeve dhe rolin e tij në ndihmën ndaj përfituesëve. Çdo ofrues shërbimesh duhet të ketë një plan trajnimi për punonjësit e punësuar rishtas. Plan i trajnimit duhet të përfshijë të gjitha fushat kryesore të nevojshme të trajnimit, objektivat për secilin sesion dhe mënyrën se si do të ofrohet trajnimi.

6.5. Punonjësit marrin trajnim të vazhdueshëm profesional gjatë kohës që janë të punësuar në qendër. Fuqizimi i stafit është shumë i dobishëm në rritjen e motivimit të tij dhe reduktimin e konsumimit profesional, duke i lejuar ata të ndihmojnë përfitueset dhe të përmbushin rolin e tyre.

6.6. Ofruesit e shërbimeve organizojnë takime të rregullta të menaxhimit të rasteve. Në këto takime mblidhet i gjithë stafi, ekipi multidisiplinar dhe drejtuesit për të shqyrtuar së bashku situatat e përfitueseve. Këto takime duhet të organizohen rregullisht: minimalisht çdo javë, çdo dy javë ose çdo muaj.

6.7. Shërbimet e këshillimit duhet të ofrohen nga profesionistë të trajnuar, siç është një punonjës social ose psikologu. Prandaj, minimalisht, çdo ofrues shërbimesh duhet të ketë në stafin e tij një profesionist të tillë të pranishëm kur përfitueset janë në qendër.

6.8. Ofruesit e shërbimeve mund të përdorin shërbimet e agjencive ose organizatave të tjera. Për shembull, ato mund të kenë një marrëveshje me një klinikë mjekësore ose spital, i cili ofron shërbime mjekësore, me një organizatë të ndihmës ligjore e cila ofron shërbime ligjore ose me një shkollë lokale e cila ofron arsimimin. Po kështu, qendra e shërbimit rezidencial mund të bëjë marrëveshje bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore apo OJF-të lokale për të plotësuar gamën e shërbimeve jashtë qendrës, të tilla si: takimet me familjarët, strehimin e përkohshëm jashtë qendrës, punësimin etj., në varësi të nevojave specifike të çdo përfitueseje.

6.9. Puna e personelit vlerësohet një herë në vit. Raporti i vlerësimit nënshkruhet si nga personi të cilit i bëhet vlerësimi, ashtu edhe nga ofruesi i shërbimeve.

7. Siguria e përfitueses së shërbimit dhe e stafit

7.1. Ofruesi i shërbimeve duhet të ndërmarrë një vlerësim të plotë dhe profesional të sigurisë për godinën ku do të strehohen përfitueset. Vlerësimi duhet të deklarojë qartë të gjitha masat e sigurisë që duhet të vendosen. Raporti final nga vlerësimi i sigurisë duhet të ruhet në dosjet e ofruesit të shërbimeve. Vlerësimi i sigurisë së godinës duhet të përditësohet rregullisht. Niveli i sigurisë duhet të rivlerësohet minimalisht çdo vit.

7.2. Në përputhje me kërkesën për siguri të përfitueseve dhe të stafit, ofruesi i shërbimit merr masa për garantimin e sigurisë së institucionit nga policia e shtetit ose policia private.

7.3. Për çdo përfituese në qendër kryhet një vlerësim individual i sigurisë. Ky vlerësim merr në konsideratë situatën individuale të përfitueses, marrëdhëniet e saj me familjen e vet, marrëdhëniet e familjes me dhunuesin e saj, marrëdhëniet e fëmijëve me nënën dhe babanë. Ofruesit e shërbimeve duhet të marrin në konsideratë këndvështrimin personal të përfitueses për këto çështje, si dhe mendimin e autoriteteve ligjore ose agjencive referuese (aneksi 9: Vlerësimi i sigurisë; aneksi 29 dhe 30: Procedurat e sigurisë për stafin dhe përfitueset).

7.4. Çdo dosje e përfitueses duhet të ketë një kopje të vlerësimit të sigurisë dhe dokumentacion mbi masat e marra për mbrojtje kundër kërcënimeve të identifikuara. Ofruesi i shërbimeve duhet të vendosë nëse situata e sigurisë së përfitueses e lejon atë të marrë pjesë në programin e tyre dhe të qëndrojnë në qendrën e tyre.

7.5. Qendrat me siguri minimale nuk duhet të pranojnë përfituese me shkallë të lartë kërcënimi të sigurisë. Jo vetëm që përfitueset do të jenë më pak të mbrojtur, por stafi dhe përfitueset e tjera mund të rrezikohen.

7.6. Vlerësimet e sigurisë individuale rivlerësohen periodikisht. Ndryshimet në çështjet ligjore të përfitueses, situata e saj familjare, ose dhe lëvizjet e pritura (për shembull, për të shkuar në gjykatë ose për një vizitë në familje), përbëjnë kërcënim të mundshëm dhe duhet të jetë arsye për një vlerësim të ri.

7.7. Ofruesi i shërbimeve ka vendosur rregulla dhe procedura sigurie për qendrën.

a) Procedurat e evakuimit të menjëhershëm në rast zjarri ose arsye tjetër për evakuim të godinës. Këto duhet të jenë me shkrim dhe të afishuara në qendër. Ofruesit e shërbimeve duhet të kenë një plan se ku do të dërgohen përfitueset në rast të evakuimit të qendrës. Për këtë qëllim, këshillohet përdorimi i rrjetit të shërbimeve të tjera.

b) Duhet që të afishohen informacionet e kontaktit në qendër për policinë, urgjencën, spitalin, zjarrfikësit dhe kontakte të tjera të emergjencës.

c) Gjithashtu, duhet të ketë rregullore dhe procedura sigurie të hartuara posaçërisht për stafin. Këto duhet të përfshijnë trajnime të rregullta dhe informacione të sigurisë, procedura për takimin dhe intervistimin e klientëve të rinj etj. (aneksi 29: Procedurat e sigurisë së stafit).

d) Ka rregulla të sigurisë, veçanërisht për përfitueset. Rregullat e sigurisë përfshijnë masa të sigurisë personale, shërbime shoqërimi për lëvizjet e rrezikshme, rregulla për dhënien e informacionit rreth vendndodhjes së qendrës, stafit ose përfitueseve të tjera, përdorimi i celularëve etj. (aneksi 30: Procedurat e sigurisë së përfitueseve).

e) Duhet të ketë procedura sigurie për vizitorët në godinën e qendrës. Këto përfshijnë masa për mbrojtjen e vendndodhjes së qendrës, ruajtjen e qendrës nga dhunuesit, respektimin e privatësisë dhe konfidencialitetit të përfitueseve, dhe mbrojtjen e identitetit të stafit dhe përfitueseve (aneksi 24/1: Rregullat për vizitat në qendër).

7.8. Ofruesit e shërbimeve trajnojnë stafin e tyre rreth sigurisë. Kjo duhet të përfshihet në trajnimin fillestar për të gjithë individët e marrë në punë rishtas. Ky trajnim duhet t'i jepet të gjithë stafit, jo vetëm stafit profesional, por dhe kuzhinierëve, pastruesve, shoferëve dhe të tjerëve, meqenëse secili ka një rol për të luajtur për sa i përket sigurisë. Trajnimi i sigurisë mund të përfshijë:

- a) një rishikim të procedurave dhe rregullave për stafin, përfitueset dhe vizitorët;
- b) njohja e sistemeve të sigurisë së qendrës;
- c) teknika bazë të vetëmbrojtjes;
- d) dhënien e ndihmës së parë.

8. Mjedisi dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve

8.1. Ofruesit e shërbimeve duhet të ofrojnë një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm për të përmbushur nevojat e çdo përfitueseje për strehim, kujdes, intimitet, këshillim dhe argëtim. Përveç dhomave të gjumit dhe banjave, duhet të ketë dhe hapësira të përcaktuara për ngrënie, gatim dhe pushim. Qendra duhet të ketë mjedise të përbashkëta, ku përfitueset mund të lexojnë, shikojnë televizor, të flasin ose të pushojnë pa ndërprerë veprimtaritë e tjera në qendër.

8.2. Dhoma e gjumit është e mobiluar duke plotësuar nevojat jetike të përfitueses. Çdo person i akomoduar duhet të ketë shtratin e tij, komodinën dhe dollapin e rrobave. Çdo dhomë gjumi duhet të ketë ngrohjen, ajrosjen dhe ndriçimin e përshtatshëm.

8.3. Dhoma e gjumit garanton ruajtjen e sendeve personale që përfituesja i mendon si me vlerë. Përfituesja duhet të kenë një hapësirë që mund ta mbyllë me çelës, si p.sh. një dollap personal apo një kuti ose raft të vogël me çelës, për të cilin përfitueses i lejohet të mbajë çelësin.

8.4. Nëse në qendër akomodohen përfituese me aftësi të kufizuara, mjediset e qendrës duhet të aksesohen edhe nga këto përfituese.

8.5. Ofruesi i shërbimeve ka rregulla të shkruara rreth përdorimit të hapësirave/mjediseve të ndryshme të strehëzës. Rregullat shpjegojnë qëllimin e dhomës, kush mund ta përdorë atë, oraret dhe rregullat për përdorimin e dhomës. Këto rregulla duhet të hartohen së bashku me përfitueset, me qëllim që çdo përfituese t'i kuptojë dhe t'i respektojë këto rregulla. Këto rregulla afishohen jashtë secilës dhomë (aneksi 26: Rregullat për përdorimin e mjediseve dhe pajisjeve).

8.6. Zyrat duhet të përmbajnë pajisjet e nevojshme për stafin për të kryer punën e tyre, duke përfshirë një tavolinë dhe kompjuter, karrige, telefon, raftet e dosjeve, raftet e librave, kasafortë etj. Zyrat e qendrës duhet të jenë të mbyllura me çelës gjatë kohës që nuk përdoren.

8.7. Dhoma e këshillimit duhet të jetë e mbrojtur nga zhurmat dhe të ketë privatësi në mënyrë që të sigurohet intimiteti dhe konfidencialiteti i përfitueses.

8.8. Nëse në qendër janë akomoduar fëmijë, të shoqëruar me prindin ose të pashoqëruar, ofruesi i shërbimit ofron një mjedis të mobiluar dhe të pajisur me qëllim krijimin e një mjedisi të ngrohtë e familjar për ta. Stafit i qendrës plotëson nevojat e fëmijëve për akomodim, kujdes, zhvillim e argëtim. Fëmijët duhet të kenë materiale të përshtatshme për zhvillimin e tyre, duke përfshirë libra, lojëra, lapsa me ngjyra etj. Po kështu, në qendër organizohen rregullisht veprimtari argëtuese dhe lojëra për fëmijë.

9. Bashkëpunimi në rrjet, veprime të koordinuara dhe partneritet me struktura dhe shërbime të tjera.

9.1. Ofruesit e shërbimeve bëjnë çdo përpjekje për të gjetur partneritet me strukturat dhe shërbimet e tjera, duke siguruar ndjekjen e ecurisë dhe plotësimin e nevojave të përfituesve dhe rikthimin e tyre në jetën normale.

9.2. Çdo ofrues shërbimesh zhvillon marrëdhënie formale bashkëpunimi me institucione dhe organizata, me qëllim ofrimin e një game më të gjerë të mundësive të ndihmës për përfitueset.

9.3. Marrëdhëniet mund të formalizohen nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi të nënshkruar, por ato mund të jenë dhe informale. Dokumentacioni mbi këto marrëveshje duhet të ruhet dhe mund të përfshijë kopje të marrëveshjeve formale, shënime nga takimet, planet e veprimit dhe dokumentacioni i referimeve.

9.4. Në vendosjen e këtyre marrëdhënieve është e rëndësishme që të drejtat e përfituesve për privatësi dhe konfidencialitet nuk do të shkelen. Ofruesit e shërbimeve mund të mendojnë se si të prezantojnë shërbimin e tyre pa bërë të ditur që përfitueset e tyre janë të mbijetuara të dhunës në familje.

9.5. Ofruesit e shërbimeve duhet të ndihmojnë përfitueset për vendosjen e kontaktit me organizatën ose agjencinë partnere. Lloji i ndihmës së kërkuar varet nga kapaciteti i përfitueses dhe lloji i agjencisë tek e cila është referuar. Ndihma mund të përfshijë një telefonatë për të lënë një takim fillestar, shoqërimi i përfitueses në takimin e parë, ndihma e përfitueses në plotësimin e formularëve të nevojshëm të aplikimit ose grumbullimi i informacionit të nevojshëm, apo dokumentacionit për aplikimet.

9.6. Ofruesit e shërbimeve duhet të mbajnë një libër referimi që dokumenton referimet e bëra dhe ndihmën e dhënë si një rezultat i këtyre referimeve. Ofruesi i shërbimeve mund të mbajë një libër për të gjitha referimet ose dosje të veçantë për secilën organizatë partnere ose lloj shërbimi (ndihmë ligjore, ndihmë sociale, trajnim profesional, ndihmë shëndetësore etj.). Data e referimit, shërbimet e kërkuara, shërbimet e marra dhe data kur janë marrë, çdo shënim që shpjegon se si shkoi procesi i referimit dhe çdo vështirësi e hasur, duhet të dokumentohen në këtë libër. Mbajtja e këtij informacioni do të ndihmojë ofruesin e shërbimeve në zhvillimin e mëtejshëm të këtyre marrëdhënieve dhe në identifikimin e fushave problematike dhe mënyrën se si të trajtohen ato.

9.7. Ofruesit e shërbimeve duhet, gjithashtu, të vlerësojnë procesin e referimeve. Sa kohë kërkohet për veprim, sa përpjekje pasuese kërkohen, cila ishte cilësia e shërbimeve të ofruara. Ky proces do të përbëjë bazën e trajtimit të problemeve të identifikuara dhe do të ndihmojë në përcaktimin e agjencive më të mira të cilat do të bëhen referime në të ardhmen (aneksi 27: Formulari i vlerësimit në dalje).

9.8. Për përfitueset që transferohen në një qendër tjetër, duhet të organizohet procesi i referimit. Me qëllim që të sigurohet që përfituesve nuk u kërkohet të përsëritin historikun e tyre dhe përvojën e abuzimit, është e rëndësishme që të shkëmbehet informacioni i duhur me ofruesin e shërbimeve të cili po transferohet përfituesja. Me miratimin me shkrim të përfitueses, ofruesit të ri të shërbimeve duhet t'i dërgohen kopje të dokumenteve kryesore nga dosja e përfitueses (aneksi 25: Transferimi i dosjeve ndërmjet ofruesve të shërbimeve).

Formularët kryesorë për t'u transferuar ndërmjet ofruesve të shërbimit/organizatave përfshijnë:

- a) formularin e vlerësimit paraprak;
- b) formularët e vlerësimit të nevojave;
- c) plani i plotësuar i ndihmës dhe raportet progresive më të fundit;
- d) dokumente të tjera, që gjykohen të rëndësishme dhe të nevojshme.

10. Monitorimi dhe vlerësimi

10.1. Ofruesit e shërbimeve u kërkojnë përfituesve të plotësojnë në mënyrë anonime formularin e vlerësimit të shërbimit. Në këtë formular përfitueset vlerësojnë shërbimet e qendrës, në mënyrë që shërbimet të përmirësohen sipas nevojave. Formulari plotësohet çdo tre muaj ose dhe më shpesh, në rastet kur janë ndërmarrë veprime për të trajtuar ankesat apo kritikën e përfitueses (aneksi 27: Formulari i vlerësimit të shërbimit).

10.2. Në momentin e largimit nga qendra, përfituesja duhet të plotësojë formularin e vlerësimit para largimit. Në këtë formular përfituesja vlerëson shërbimet dhe jep detajet e kontaktit për monitorim të vazhdueshëm (aneksi 13: Formulari i vlerësimit të përfitueses në largim).

10.3. Ofruesit e shërbimeve bëjnë çdo përpjekje të mundshme për të ndjekur përfitueset rregullisht edhe pas largimit të tyre nga qendra, për një periudhë nga 6 muaj deri në 2 vjet. Ofruesit e shërbimeve nuk mund të mbajnë kontakte me të gjitha përfitueset. Monitorimi mund të bëhet nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit, siç janë telefonat, nëpërmjet internetit etj.

10.4. Monitorimi afatgjatë vlerëson asistencën e dhënë apo aspekte të jetës së përfitueses, të cilat mund të jenë ndikuar nga ndihma, gjendja e tyre psikologjike, marrëdhënia e tyre me të tjerët, përfshirë familjen dhe miqtë, gjendja e tyre në punë apo nivelin e të ardhurave, progresi në shkollë etj. (aneksi 14: Formulari i monitorimit afatgjatë).

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

ANEKSI 1 FORMULARI PËRMBLEDHËS I OFRUESIT TË SHËRBIMIT

Emri i organizatës: Përditësimi i fundit: Shkruani muajin dhe vitin kur është përditësuar

Qëllimi i organizatës

Synimi kryesor i Strehëzës Kombëtare kundër Dhunës në Familje është të ofrojë nëpërmjet shërbimeve, ndërhyrjes dhe trajtimit në programet kundër dhunës në familje mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe e fëmijëve të tyre, duke rritur, në të njëjtën kohë, llogaridhënien e abuzuesve për dhunën që kanë ushtruar. Synimi i dytë lidhet me fuqizimi e pjesëmarrëseve që të ecin drejt pavarësisë dhe mbështetjes te vetvetja.

Ekspertiza e organizatës dhe e stafit të saj

Strehëza rezidenciale është një objekt i cili u ofron pjesëmarrëseve dhe fëmijëve të tyre një vendqëndrim të përkohshëm të sigurt, jashtë rrezikut, duke u ofruar, në të njëjtën kohë, edhe përmbushjen e nevojave, të tilla si: ushqim dhe veshmbathje. Strehëza qëndron hapur 24 orë në ditë, shtatë ditët e javës. Ajo është e pajisur me personelin e programit.

Stafi i strehëzës përbëhet nga një ekip multidisiplinar, anëtarët e të cilit kanë profesione dhe eksperiencë të ndryshme, të tilla si: punonjës socialë, këshillues, menaxherë rasti, specialistë për fëmijë dhe kujdestar. Të gjithë anëtarët e stafit duhet të kenë mbaruar studimet në punë sociale ose shkenca sociale, bachelor ose master (në varësi të pozicionit dhe përgjegjësisë), si dhe eksperiencë pune të paktën 2 vjet në shërbime të ngjashme.

Shërbimet e ofruara drejtpërdrejt nga organizata

Fuqizimi është baza e shërbimeve në strehëz. Fuqizimi është aftësia për të pasur ndikim te forcat të cilat prekin jetën e personit, në favor të këtij të fundit. Punonjësit e programeve duhet ta kuptojnë se dhuna në familje është e rrënjësuar në sistemin shoqëror, çka përforcon pabarazinë e grave dhe fëmijëve në shoqëri, dhe nuk vjen nga psikopatologjia e pjesëmarrëseve të strehëzës apo e dhunuesve të tyre. Ata duhet të kuptojnë edhe rëndësinë e të drejtës së pjesëmarrëseve të strehëzave për vetëvendosje dhe për të marrë vendimet për veten.

Në lëvizjen kundër dhunës në familje, fuqizimi nënkupton edukimin pa forcë dhe mbështetjen e pjesëmarrëses për të vendosur vetë drejtimin e tyre, pa ushtruar mbi to asnjë kontroll psikologjik, fizik apo emocional. Fuqizimi në punën e avokatisë përfshin asistencën që u jepet pjesëmarrëseve në fushat e vendimmarrjes, vetëbesimit, rritjes së mbështetjes dhe planifikimit për të qëndruar jashtë rrezikut.

Fuqizimi në planifikimin e rastit ka të bëjë me angazhimin e pjesëmarrëseve si planifikuese parësore të synimeve dhe objektivave të tyre dhe dhënia e informacionit vetëm në kuadër të qëllimit, në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë alternativat e mundshme. Për rrjedhojë, është mirë që pjesëmarrëseve të mos u diktohet asnjëherë të marrin pjesë në shërbime apo të përjashtohen prej tyre. Kjo përputhet me standardet e shërbimeve sociale në Shqipëri.

Fuqizimi në hartimin e programit ka të bëjë me zhvillimin nga secili program të strukturave vendimmarrëse të cilat të sigurojnë shpërndarjen e autoritetit dhe përgjegjësisë dhe t'i fuqizojë pjesëmarrëset, stafin, vullnetarët dhe anëtarët e bordit. Edhe kjo përputhet me standardet e shërbimeve sociale në Shqipëri.

Për t'i përmbushur këto synime është mirë të nxiten pjesëmarrëset të marrin pjesë në hartimin e programit dhe në vendimmarrje, ose duke shërbyer si vullnetare dhe anëtare komiteti, ose duke u zgjedhur në organin vendimmarrës pasi të mos jenë duke i përdorur më aktivisht shërbimet e programit. Brenda një viti që merr shërbime nga strehëza, personi ka të drejtë të merret në punë nga kjo strehëz, brenda procedurave normale të marrjes në punë.

Pjesëmarrëset duhet të japin kontributin e tyre për hartimin e udhëzuesve që duhen përdorur në rastet kur pjesëmarrëset e programit nuk i respektojnë rregullat e programit ose nuk përmbushin përgjegjësi të caktuara. Kjo nuk duhet ta pengojë stafin të kërkojë zbatimin e rregullave ose politikave të brendshme në ato raste kur veprimet e një pjesëmarrëseje mund të vënë në rrezik sigurinë e saj ose atë të pjesëmarrëseve të tjera të programit, apo edhe vetë programin.

Shërbime rezidenciale

Program rezidencial është pjesa e programit të strehëzës kundër dhunës në familje, që u shërben kryesisht viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre.

Shërbimet përfshijnë:

- Linjë telefonike në rast krize/ndërhyrje në rast krize;
- Grupe mbështetëse/terapeutike;
- Menaxhim rasti/avokati individuale;
- Avokati për sistemet;
- Shërbime juridike/shërbime asistence në gjykatë;
- Programim të fëmijëve;
- Shërbime të mbështetura në komunitet për pjesëmarrësit në tranzicion mbështetje/këshillim individual;
- Konsultime dhe trajnim në komunitet.

Programi i fëmijëve përfshin ato aktivitete që përmbushin nevojat sociale, zhvillimore dhe materiale të fëmijëve që marrin shërbime nga një program kundër dhunës në familje.

Mbështetja individuale dhe ajo në grup është metoda sistematike e planifikuar për të lehtësuar ose zgjidhur problemet e identifikuar nga pjesëmarrësja e strehëzës me një konsulent individual dhe/ose me një grup pjesëmarrësish të tjerë të strehëzës.

Mbrojtja e interesave të rasteve individuale është mbrojtja e interesave në emër dhe për llogari të viktimës së dhunës në familje brenda sistemeve juridike, mjekësore shërbimeve sociale dhe sistemeve të tjera.

Mbrojtja e interesave në sistem ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të viktimave të dhunës në familje si grup ose klasë njerëzish, por jo individualisht. Kjo mund të përfshijë promovimin e politikave dhe procedurave standarde për rastet e dhunës në familje brenda sistemeve juridike, mjekësore, shërbimeve sociale ose sistemeve të tjera. Mund të përfshijë edhe edukimin ose trajnimin e personelit për të siguruar zbatimin e duhur të politikave dhe procedurave. Mbrojtja e interesave në sistem mund të përfshijë hartimin e protokolleve, trajnimin e punonjësve të sistemeve të tjera në lidhje me dinamikën e dhunës në familje dhe/ose lidhur me asistencën për zbatimin e protokolleve të tilla që mund të kenë ndikim të shumë gra dhe fëmijë të tyre.

Menaxhimi i rastit. Të gjitha banoret që qëndrojnë në strehëz më shumë se 72 orë u caktohet një menaxherë rasti. Përgjegjësia e menaxheres së rastit është ta ndihmojë banoren të krijojë një

plan i cili do ta ndihmojë të kthehet nga strehëza në komunitet. Plani plotësohet pasi banorja ka kaluar 72 orë në strehëz. Menaxherja e rastit do të punojë me pjesëmarrëset për t'i ndihmuar të arrijnë objektivat. Për shembull, të ndihmojë me çështje, të tilla si: punësimi, strehimi, kujdesi për fëmijët, arsimi dhe shqetësime të tjera që mund të kenë. Menaxherët e rasteve janë të ndjeshëm ndaj çështjeve të dhunës në familje. Ata dëgjojnë për të mësuar shqetësimet e pjesëmarrëseve, të përshtaten me jetën në strehëz, të hartojnë një plan sigurie për ta zbatuar pasi të largohen nga strehëza, orientojnë për agjencitë mbështetëse dhe ndihmojnë pjesëmarrëset të bëjnë ndryshimet që dëshirojnë. Objektivi është t'u plotësohen nevojat dhe t'i ndihmojmë t'i bëjnë ballë efektit që ka në jetën e tyre dhuna në familje. Nëse pjesëmarrëset dëshirojnë të vazhdojnë shërbimet pasi të jenë larguar nga strehëza, mund të takohen me menaxheren e rastit për të marrë informacion për shërbimet e strehëzës.

Shërbime të veçanta

- Grupi mbështetës ofrohet çdo (dita dhe ora) çdo javë. Grupi mbështetës mund të ketë deri në 10 persona dhe qendra e kujdesit për fëmijët do kujdeset për fëmijët tuaj gjatë kësaj periudhe, nëse kanë kapacitet. Banoret janë të lira të organizojnë vetë mbledhje të grupeve të tjera mbështetëse.

- Strehëza mund të ketë fatin të ketë disa stazhierë të këshillimit për shëndetin mendor të cilët ofrojnë këshillim falas për shëndetin mendor të banoreve. Nëse është kështu, këta stazhierë mbikëqyren nga një mbikëqyrës i kualifikuar. Takimet mund t'i organizoni përmes menaxherit të rastit tuaj.

Shërbimet e ofruara nëpërmjet referimit

Stafi i strehëzës bazuar në nevojat specifike të çdo rasti/familjeje duhet t'i referojë ata në organizata apo institucione publike, të tilla si:

- Institucione arsimore, çerdhe, kopshte apo shkolla publike;
- Institucione shëndetësore, si qendra shëndetësore të kujdesit parësor, spitale apo klinika të specializuara publike;
- Shërbimi ligjor falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, Nisma Ligjore Qytetare, Klinika Ligjore për të Miturit etj.;
- Zyrat e punës në institucionet lokale, bashki e komuna;
- Shërbimi Social Shtetëror, në rastet e strehimit të përkohshëm për fëmijët, kujdestari, shtëpia e fëmijës etj.;
- Bashkia e Tiranës për strehim të subvencionuar;
- Aksesit në mikrokredi.

Rregulla dhe kufizime

Në ruajtjen e frymës së filozofisë së fuqizimit dhe mbështetjes, është e rëndësishme që strehëza t'i shqyrtojë rregullat e vendosura për jetën brenda strehëzës, për të siguruar që këto rregulla të mos jenë shtypëse dhe t'u japin mundësi pjesëmarrëseve t'i marrin vetë vendimet për vetveten. Sigurisht, është e rëndësishme që të ketë ca rregulla për jetesën në strehëz, për të ruajtur sigurinë e të gjithë pjesëmarrëseve në program. Por, strehëza duhet të mos i rikrijojë dinamikat e pushtetit që janë të pranishme në marrëdhëniet abuzuese. Për shembull, këto dinamika rikrijohen kur stafi i strehëzës merr përsipër rolin e “vendosësit të rregullave”, gjë që i vendos pjesëmarrëset në pozicionin e njohur për ta, të “ndjekësit të rregullave”.

Strehëzat duhet të bëjnë kujdes që të mos vendosin rregulla, qëllimi i vetëm i të cilave është lehtësimi i funksionimit të strehëzës, pa i kushtuar kujdes sigurisë së banoreve.

Siguria dhe zvogëlimi i rrezikut duhet të jetë politikë e strehëzës

Stafi duhet të marrë të gjitha masat e kujdesshme për të siguruar shëndetin dhe jetën e të gjithë stafit dhe pjesëmarrëseve dhe duhet të përpiqet rregullisht të identifikojë dhe zgjidhë faktorët e rrezikut të mundshëm që mund të prekin pjesëmarrëset ose shërbimet e ofruara. Stafi duhet të trajnohet në fillim dhe më pas rregullisht në lidhje me të gjithë komponentët e planit të administrimit të rrezikut.

Rregullat e brendshme të strehëzës

1. Të kryhen punët e caktuara të shtëpisë brenda afateve të caktuara dhe të merret pjesë në përgatitjen e ushqimit dhe të pastrohet kuzhina sipas detyrave të ngarkuara. Të kryhen punët e mëngjesit jo më vonë se ora 10 paradite dhe punët e mbrëmjes jo më vonë se ora 10 pasdite dhe stafi të verifikojë plotësimin e çdo pune shtëpie pas kryerjes së tyre. Përgatitja e darkës fillon në ora 4:30 ndërsa pastrimi i sallës së ngrënies duhet të përfundojë brenda orës 7 të pasdites.

2. Dhoma të mbahet e rregullt (të rregullohen shtretërit, të mos ketë sende në shtretërit e fëmijëve, të largohen teshat nga dyshemeja, të mos ketë ushqim ose enë në dhomat e gjumit, pelenat e natës të largohen paradite). Dhoma të jetë në rregull përpara se pjesëmarrësja të largohet prej saj për aktivitetet e ditës. Gjatë javës përgjegjësi i shtëpisë bën kontrolle të dhomave të gjumit dhe banjave për t'u siguruar që janë respektuar standardet e pastërtisë dhe higjienës. Këto kontrolle gjatë fundjavës i bën stafi. Pas çdo përdorimi, kovat për larjen e dyshemesë duhen zbratur.

3. Të pastrohen banjat pas çdo përdorimi nga ju ose nga fëmijët tuaj.

4. Nuk lejohen fëmijët në zonën e kuzhinës, për arsye sigurie.

5. Familjet të mbajnë higjienën e duhur (të bëjnë banjë ose dush rregullisht). Artikujt emergjentë të higjienës mund të kërkojnë sipas nevojës. Artikujt e higjienës që nuk i siguron strehëza dhe nuk kërkojnë për arsye mjekësore, duhet të blihen nga vetë pjesëmarrësja.

6. Të jenë në kohë për mbledhjet dhe takimet e planifikuara. Të njoftohet stafi nëse keni probleme me respektimin e orareve (për përfundimin e punëve të shtëpisë, për orarin e sigurisë, për kujdesin e fëmijëve, për takimet e këshillimit dhe menaxhimit të rastit dhe për orët e mësimin në grup). Orët e mësimin për banorët në moshë madhore zhvillohen (përcaktoni orët) dhe në orë të ndryshme gjatë gjithë ditës. Të gjithë banorët marrin pjesë në mbledhjen e shtëpisë çdo (caktoni ditën e javës) dhe nxiten të marrin pjesë në orë shtesë mësimi, nëse ka. Pjesëmarrëset janë të lira të organizojnë mbledhje mbështetëse me pjesëmarrëset e tjera në çdo kohë.

7. Të pastrohet vendi i ngrënies (duke përfshirë edhe dyshemenë) pas çdo përdorimi nga ju vetë ose nga fëmijët tuaj (të mos lihet asnjë enë në banak, tryezë, karrige fëmije apo lavapjatë). Karriget e posaçme të fëmijëve të vegjël duhet të pastrohen dhe të lahen pas çdo përdorimi, nga personi që është përgjegjësi e kujdestarit të fëmijës.

8. Ushqimet dhe pijet lejohen vetëm në këndin e ngrënies (nuk lejohen enët prej qelqi në verandë). Me përjashtim të ujit, nëpër dhomat e gjumit nuk lejohen ushqimet apo pijet. Nuk lejohen ushqimet apo pijet në bibliotekë/sallën e kompjuterit.

9. Të gjithë anëtarët e familjes duhet të veshin tesha dhe këpucë të përshtatshme në çdo kohë. Përgjegjësjë e shtëpisë kontaktohet nëse ka nevojë për veshje apo këpucë për pjesëmarrësen apo për fëmijët.

10. Të tregohet kujdes në kursimin e energjisë, duke fikur aparatit e televizorit, dritat, pajisjet etj., gjatë kohës kur nuk përdoren.

11. Televizori në dhomën e gjumit të fiket në orën 10 të darkës. Televizori në këndet e përbashkëta (dhomën e familjes dhe dhomën e ndenjjes) të fiket para mesnate nga e diela deri të enjten dhe brenda orës 1 të natës nga e premija deri të shtunën. Volumi i aparateve të televizorit duhet të mbahet brenda një niveli të arsyeshëm në çdo kohë, në mënyrë që të mos shqetësohen të tjerët.

12. Të gjitha dyert dhe dritaret duhet të mbahen të mbyllura dhe të siguruara në çdo kohë. Dritaret e mbrojtura me shufra hekuri mund të mbahen të hapura për ajrim.

13. Të mos hiqet apo zhvendoset asnjë orendi pa lejen e një anëtari të stafit. Sendet, shtrojat, ushqimet etj., që u janë dhënë për përdorim gjatë qëndrimit këtu janë pronë e strehëzës dhe nuk duhet të largohen nga strehëza gjatë qëndrimit tuaj këtu apo kur të largoheni prej këtu. Të lihet një takim me përgjegjësen e shtëpisë për të marrë sendet që mund të nevojiten për të ngritur familjen e re dhe stafi do të ndihmojë me ato që mundet.

14. Të gjitha ushqimet dhe pijet e blera nga strehëza të konsiderohen ushqime të shtëpisë dhe duhet të mbeten në mjediset e strehëzës për t'u përdorur nga banorët. Individët mund të blejnë

ushqimet e tyre, nëse duan, por strehëza nuk garanton dhe nuk zëvendëson asnjë ushqim që ka blerë një banor dhe që nuk gjendet më. Asnjë ushqim nuk mund të hyjë në strehëz pa marrë në fillim lejen e stafit.

15. Për çdo hyrje-dalje në strehëz të përdoret dera kryesore e saj. Të gjithë banorët duhet të nënshkruajnë në librin e hyrje-daljeve në hollin e hyrjes, për të treguar se ku shkojnë kur dalin nga strehëza dhe se kur mund të kthehen. Orari i sigurt është (vendosni orarin e sigurt), nëse nuk është rënë dakord për një zgjatje të orarit të sigurt.

16. Telefoni në ambientet e banorëve mund të përdoret nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 10 të mërkurës (dhe duhet të shkëputet gjatë seancave në grup). Të respektohen nevojat e njëritjetrit dhe të kufizohen telefonatat pa i zgatur më shumë se 10 minuta. Telefoni duhet të qëndrojë në dhomën e familjes dhe të mos nxirret jashtë. Thirrjet telefonike me larg për arsye urgjente mund të bëhen nga telefoni i recepsionit vetëm pasi është marrë leja nga stafi dhe thirrjet telefonike me larg duhet të kufizohen në 3-5 minuta duke qenë se koston e mbulon strehëza. Të gjitha thirrjet telefonike me larg duhet të dokumentohen në regjistrin e telefonatave me larg të mbajtur në recepsion.

17. Brenda strehëzës nuk lejohet duhani. Duhani lejohet (caktoni vendin). Në strehëz nuk lejohet djegia e asnjë sendi. Të mbahen të gjithë artikujt që mund të marrin flakë (çakmakë, qirinj, shkrepëse, djegëse aromatike, lule të thata etj.), në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.

18. Prej banorëve pritët që fëmijët nën 12 vjeç t'i fusin në dhomat e gjumit brenda orës 9 të mërkurës çdo ditë të javës.

19. Të gjitha dritat e dhomave të gjumit të fiken brenda orës 10 të mërkurës. Përjashtim bëhet vetëm me miratimin e stafit dhe me miratimin e të gjithë personave që e përdorin dhomën në fjalë.

20. Ju lutemi, të mos largoheni nga kuzhina kur të jeni duke gatuar, duke qenë se kjo përbën rrezik kundër jetës. Të mos gatuhet pas orës 9 e mërkurës. Pas orës 9 të mërkurës mund të hahen vakte të vogla.

21. Fëmijët duhet të monitorohen dhe mbikëqyren nga prindërit ose kujdestari i caktuar, në çdo kohë. Fëmijët nën 6 vjeç nuk duhet të lihen vetëm në asnjë moment ndërkohë që janë në vaskë. Ju lutemi, të tregohet vëmendje e veçantë sa i takon fëmijëve dhe ujit. Marrëveshjet për kujdesin e fëmijës duhet të plotësohen me kujdes dhe të miratohen nga stafi nëse një banor përdor punonjës të kujdesit të fëmijës ose një banor tjetër për t'ia mbikëqyrur fëmijët. Fëmijët nën 6 vjeç nuk lejohet të qëndrojnë në shtretërit e lartë.

22. Kërkesat e veçanta (domethënë zgjatja e orarit të sigurt) duhet t'i dorëzohen me shkrim menaxherit të rastit brenda ditës së mërkurë të çdo jave, për t'u shqyrtuar gjatë mbledhjes së stafit të enjteve.

23. Të gjitha produktet e pastrimit (dezinfektues, zbardhues etj.) apo lëndët e tjera të rrezikshme (diluent për heqjen e llakut të thonjve, alkool) duhet të mbyllen me çelës në dollapë të sigurt në kuzhinën e pjesëmarrëseve ose në lavanderi.

24. Taksitë lejohen të vijnë në strehëz vetëm me miratimin e stafit dhe pas njoftimit paraprak.

Kriteret e pranimit/ripranimit

Vendimet në lidhje me ndërprerjen e shërbimit nuk duhet të bazohen në personalitetet e pjesëmarrëseve apo në vendimin e tyre për t'u kthyer te dhunuesi. Programet kundër dhunës në familje duhet të tregojnë kujdes në lidhje me përdorimin e kriterëve kufizues gjatë marrjes së vendimit për pranimin ose ripranimin e një pjesëmarrëseje. Programet duhet të shmangin marrjen e vendimeve në bazë të nocioneve subjektive lidhur me atë se kush është viktimë “e denjë” ose “e padenjë” dhe duhet të jenë të ndërgjegjshme për përdorimin e normave dominante kulturore si faktorë të marrjes së vendimit për pranimin/ripranimin.

Në ato programe ku fokusi është larguar nga siguria dhe vetëvendosja, dhe ku ekzistojnë paragjykime ndaj viktimave, personat e mëposhtëm mund të konsiderohen si “viktimë e padenjë”:

Pret “shumë gjatë” për të raportuar një incident të dhunshëm □

Nuk punon në mënyrë aktive në drejtim të ndërprerjes së marrëdhënies kur programi ka mendimin se ajo apo ai nuk duhet të kthehet te dhunuesi □

Nuk e përdor sistemin ligjor për t'i dhënë zgjidhje dhunës në familje në jetën e vet □ Vazhdon të ketë kontakt me dhunuesin pas largimit □

Duket e zemëruar, armiqësore apo nuk ka personalitet të ngrohtë e miqësor □

Nuk është “bashkëpunuese” ose “mirënjohëse” për shërbimet □

Përdor drogë apo alkool □

Ka vështirësi në mbajtjen në kontroll të fëmijëve të saj □

Nuk ndjek rregullat ose një orar të rregullt □

Ka ide, të cilat nuk janë “femërore” □

Është diagnostikuar me një sëmundje mendore ose aktualisht merr barna □

Është seksualisht provokuese □

Ka një aftësi të kufizuar □

Është e shëmtuar □

Është person i një kombësie tjetër normat e së cilës nuk dihen □

Është e infektuar me virusin HIV □

Është lesbike, homoseksuale, biseksuale ose e ka ndërruar seksin □

Asnjëri prej këtyre gjykimeve nuk është i pranueshëm. Këto gjykime duhet të trajtohen në mbledhjet e stafit dhe në takimet individuale me stafin. Nëse një punonjës vazhdon të ketë mendime të tilla, kjo përbën arsye për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Refuzimi për dhënien e shërbimeve ose për t'u ripranuar në shërbime duhet të mbështetet vetëm në shkeljen e ruajtjes së fshehtësisë së informacionit ose shkeljen e standardeve të shëndetit/sigurisë. Nëse për këto arsye një pjesëmarrëse nuk pranohet ose nuk ripranohet, ose bëhet ndërprerje e shërbimeve, duhet të përdoret një plan i përshtatshëm dhe i veçantë referimi. Ky plan duhet të bazohet në burimet e komunitetit dhe në shërbimet që mund të ofrohen.

Pjesëmarrëset të cilave u janë mohuar shërbimet ose të cilave u janë ndërprerë shërbimet duhen rivlerësuar sa herë që kërkojnë për t'u ripranuar. Kjo mund të kërkojë lidhjen e një marrëveshjeje me to, si pjesë e procesit të ripranimit.

Mosdhënia e shërbimeve një pjesëmarrëseje mund të çojë në lëndime të rënda ose edhe vdekje, kështu mirë është që shërbimet të mos refuzohen shpesh. Përgjegjësia parësore e një programi është të ofrojë siguri për çdo pjesëmarrëse.

Programi e vlerëson çdo pjesëmarrëse që kërkon të pranohet në strehëz, parë në kontekstin e problemeve, të cilat mund ta vështirësojnë qëndrimin e tyre në strehëz (probleme me drogat/alkoolin, probleme gjatë ose përpara qëndrimit etj.), por programi nuk duhet të përdorë një listë të “refuzimit të strehimit” përpara se të bëjë vlerësimin individual.

Kriteret specifike për pranim në shërbimin e strehëzës janë:

- Të jenë gra, me ose pa fëmijë;
- Fëmijët djem nën moshën 14 vjeç;
- Rastet të vlerësuara në rrezik apo të kërcënuara nga dhuna në familje;
- Nuk kanë asnjë mundësi alternative të mbështetjes nga burime vetjake apo familjare;

Vendimet në lidhje me pranimin ose ripranimin nuk bazohen te fakti nëse një pjesëmarrëse largohet ose qëndron me dhunuesin apo nëse pjesëmarrësja konsiderohet apo jo pjesëmarrëse “e denjë”.

Kundërrindikimet/përgjashtimet: Nëse një nga situatat e mëposhtme është e vërtetë, personi në fjalë nuk është i përshtatshëm për t'u ndihmuar nga organizata jonë:

Në vlerësimet për pranim stafi duhet të ketë parasysh situatat e mëposhtme për të identifikuar rastet që nuk mund të përfitojnë nga shërbimi:

- Varësi nga substancat, alkool apo droga;
- Aftësi të kufizuara mendore;
- Aftësi të kufizuara fizike;

Për më shumë informacion rreth organizatës dhe shërbimeve që ofrojmë, ju lutemi kontaktoni:

- Emri i kontaktit;
- Organizata;
- Adresa postare;
- Adresa elektronike;
- Faqja e internetit;
- Numri i telefonit;
- Numri i faksit.

ANEKSI 1.1

PROCEDURAT DHE KRITERET E PRANIMIT/RIPRANIMIT

A. Procedurat

Në momentin e hyrjes në strehëz, pjesëmarrësja përshëndetet duke i uruar mirëseardhjen.

1. Këshillohet se si fillim ajo mund të pyetet se çfarë dëshiron të bëjë:

- të ushqehet;
- të pushojë;
- të bëjë një dush;
- të bisedojë; apo
- diçka tjetër.

2. Pjesëmarrësja pajiset me materialet më të domosdoshme: peshqirë, çarçafë, veshje apo artikuj të tjerë të kujdesit vetjak.

3. Pjesëmarrësja dhe fëmijët orientohen në strehëz: ku janë dhomat e gjumit, kuzhina, tualetet, dhoma e lojës për fëmijët, zyrat etj.

4. Orientohen mbi politikën ushqimore të strehëzës, ku t'i mbajë sendet dhe ushqimin personal, ku t'i lajë teshat dhe ku të pijë duhan apo të bëjë telefonata. Kërkoni ndihmën e banorëve të tjerë në mënyrë që pjesëmarrësja e re të ndjehet rehat. Kjo do të mundësonte bashkëpunimin grave pjesëmarrëse në program.

5. Mblidhni informacion në momentin e pranimi dhe regjistrojeni në një dosje individuale. Me vazhdimin e procesit të pranimi, mbështetuni në informacionin e mbledhur më parë, gjatë kontaktit të parë. Shpjegoni se çfarë mund të presë ajo, shpjegoni rregullat e strehëzës, sa kohë mund të qëndrojë në strehëz etj.

6. Vendosni ilaçet në një mjedis të caktuar dhe të mbyllur më çelës.

7. Jepni informacion me shkrim, në mënyrë që banorja e re të mund ta lexojë këtë informacion edhe më vonë. Mund t'ju ndihmojë nëse këtë informacion e jepni në një dosje me letra bosh dhe stilolaps, në mënyrë që ajo të mbajë edhe shënime, të mbajë ditar apo të shënojë informacione gjatë kohës që qëndron në strehëz.

8. Punonjësja e strehëz punon për mbledhjen e informacionit shtesë, në mënyrë që brenda 72 orëve të ketë kompletuar dosjen me informacionin bazë. Disa informacione mund të mblidhen edhe më vonë, në varësi të rrethanave.

9. Stafit duhet të kujdeset që të nënshkruhen të gjitha kontratat, duke përfshirë edhe dhënien e pëlqimit për shërbimet, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrëseve, procedurën e ankimit dhe përshkrimin/pritshmëritë e programit. Të gjitha këto dokumente duhet të vendosen në dosjet e pjesëmarrëseve.

B. Kriteret

Vendimet në lidhje me ofrimin e shërbimit të strehëzës nuk duhet të bazohet në personalitetet e pjesëmarrëseve apo në vendimin e tyre për t'u kthyer te dhunuesi.

Programet kundër dhunës në familje duhet të tregojnë kujdes në lidhje me përdorimin e kriterëve kufizuese gjatë marrjes së vendimit për pranimin ose ripranimin e një pjesëmarrëseje. Programet duhet të shmangin marrjen e vendimeve në bazë të nocioneve subjektive lidhur me atë

se kush është viktimë “e denjë” ose “e padenjë” dhe duhet të jenë të ndërgjegjshme për përdorimin e normave dominante kulturore si faktorë të marrjes së vendimit për pranimin/ripranimin.

Ndalohet përjashtimi nga shërbimi ose mohimi i këtij shërbimi nëse viktimat:

- pret “shumë gjatë” për të raportuar një incident të dhunshëm;
- nuk punon në mënyrë aktive në drejtim të ndërprerjes së marrëdhënies kur programi ka mendimin se ajo nuk duhet të kthehet te dhunuesi;
- nuk e përdor sistemin ligjor për t’i dhënë zgjidhje dhunës në familje në jetën e vet;
- vazhdon të ketë kontakt me dhunuesin pas largimit;
- duket e zemëruar, armiqësore apo nuk ka personalitet të ngrohtë e miqësor;
- nuk është “bashkëpunuese” ose “mirënjohëse” për shërbimet;
- ka vështirësi në mbajtjen në kontroll të fëmijëve të saj;
- nuk ndjek rregullat ose një orar të rregullt;
- ka ide, të cilat nuk janë “femërore”;
- është diagnostikuar me një sëmundje mendore ose aktualisht merr barna;
- është seksualisht provokuese;
- ka një aftësi të kufizuar;
- është e shëmtuar;
- është person i një kombësie tjetër normat e së cilës nuk dihen;
- është e infektuar me virusin HIV;
- është lesbike, homoseksuale, biseksuale ose e ka ndërruar seksin.

Asnjëri prej këtyre gjykimeve nuk është i pranueshëm. Këto gjykime duhet të trajtohen në mbledhjet e stafit dhe në takimet individuale me stafin. Nëse një punonjës vazhdon të ketë mendime të tilla, kjo përbën arsye për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

Refuzimi për dhënien e shërbimeve ose për t’u ripranuar në shërbime duhet të mbështetet vetëm në shkeljen e ruajtjes së fshehtësisë së informacionit ose shkeljen e standardeve të shëndetit/sigurisë. Nëse për këto arsye një pjesëmarrëse nuk pranohet ose nuk ripranohet, ose bëhet ndërprerje e shërbimeve, duhet të përdoret një plan i përshtatshëm dhe i veçantë referimi. Ky plan duhet të bazohet në burimet e komunitetit dhe në shërbimet që mund të ofrohen.

Pjesëmarrëset, të cilave u janë mohuar shërbimet ose të cilave u janë ndërprerë shërbimet, duhen rivlerësuar sa herë që kërkojnë për t’u ripranuar. Kjo mund të kërkojë lidhjen e një marrëveshjeje me to, si pjesë e procesit të riprimit.

Mosdhënia e shërbimeve një pjesëmarrëseje mund të çojë në lëndime të rënda ose edhe vdekje, kështu mirë është që shërbimet të mos refuzohen shpesh. Përgjegjësia parësore e një programi është të ofrojë siguri për çdo pjesëmarrëse.

Programi e vlerëson çdo pjesëmarrëse që kërkon të pranohet në strehëz, parë në kontekstin e problemeve, të cilat mund ta vështirësojnë qëndrimin e tyre në strehëz (probleme me drogat/alkoolin, probleme gjatë ose përpara qëndrimit etj.), por programi nuk duhet të përdorë një listë të “refuzimit të strehimit” përpara se të bëjë vlerësimin individual.

Vendimet në lidhje me pranimin ose ripranimin nuk bazohen te fakti nëse një pjesëmarrëse largohet ose qëndron me dhunuesin apo nëse pjesëmarrësja konsiderohet apo jo pjesëmarrëse “e denjë”.

ANEKSI 1.2

POLITIKAT DHE PROCEDURAT PËR PRANIMIN NË STREHËZ

Çdo strehëz ka politikat dhe procedurat e veta, të cilat stafi i tyre duhet t’i respektojë në momentin e pranimin të një të mbijetuar të dhunës në familje. Politikat dhe procedurat e pranimin marrin parasysh nevojat në përgjithësi të kategorisë së prekur nga fenomeni i dhunës në familje, si dhe kapacitetet profesionale dhe fizike të çdo institucioni. Udhëzimet e mëposhtme janë vetëm orientuese. Ato duhen përshtatur sipas profilit të çdo shërbimi strehëze.

Kontakti i parë/pranimi

Strehëza pranon gra dhe fëmijë që janë viktimë të dhunës në familje, sikurse vërtetohet nga informacioni i mbledhur gjatë një interviste depistuese përmes telefonit, kontaktit të drejtpërdrejtë apo informacionit të grumbulluar nga partnerë e bashkëpunëtorë të tjerë. Pjesëmarrësja duhet të përmbushë kriteret e pranimi dhe të shprehë verbalisht gatishmërinë për t'u strehuar në strehëz dhe për të respektuar kërkesat e shërbimit. Strehëza nuk është një objekt i siguruar/i izoluar dhe pjesëmarrëset janë të lira të lëvizin lirisht gjatë ditës për të përmbushur nevojat e tyre, me kusht që të kthehen brenda orarit të përcaktuar.

Pjesëmarrëset janë përgjegjëse për sigurinë e tyre dhe të fëmijëve të tyre.

Personi në nevojë për t'u pranuar në strehëz mund të mos jetë personi që bën kontaktin e parë. Kontaktin e parë mund ta bëjë një mikeshë, një familjar, një efektiv i policisë ose një punonjës social. Pavarësisht se kush e bën kontaktin e parë, është përgjegjësia e stafit që në këtë moment të vlerësojë situatën dhe të vendosë se si do të veprojë.

Së pari, stafi duhet të vlerësojë shkallën e rrezikut që i kanoset viktimës. Kjo bëhet nëpërmjet pyetjeve të drejtpërdrejta ndaj viktimës.

Kur kontakti i parë bëhet përmes telefonit:

Procesi i vlerësimit paraprak duhet të përdoret për lejuar hyrjen e një individi apo familjeje dhe jo për ta përjashtuar atë. Nëse, gjatë këtij procesi konstatohet se shërbimet e strehëzës nuk janë të përshtatshme për nevojat e saj apo nëse ka një organizatë tjetër e cila mund t'i përmbushë më mirë nevojat e saj, atëherë kjo mundësi duhet diskutuar me të. Edhe këtu duhet thënë se refuzimi i mundësisë për të marrë shërbimet duhet të mbështetet te nevojat dhe shqetësimet e gruas.

Vlerësoni rrezikun që i kanoset viktimës. Pyeteni:

“A ndodheni në rrezik tani?”

“A jeni lënduar?”

“A ndodhet aty me ju dhunuesi?”

“A ka armë dhunuesi (armë zjarri, armë të ftohtë, mjete të forta, çekiq, sëpatë, armë të tjera)?”

“A është i dehur dhunuesi? A ka marrë ndonjë lloj droge?”

Është e rëndësishme që stafi që punon me viktimat të konstatojë në fillim nëse është apo jo jashtë rrezikut telefonuesja kur kontakti i parë me viktimën bëhet përmes telefonit. Nëse viktimë nuk është jashtë rrezikut ose nëse është plagosur/lënduar, sugjerojini të telefonojë policinë ose merrini leje që policinë ta telefononi ju në emër të saj. Nëse është plagosur, informojeni që një punonjës i strehëzës mund të takohet me të në një spital publik për t'i ofruar shërbime mbështetëse. Informojeni se shërbimet e strehëzës mund të diskutohen në këtë moment, nëse ajo është e interesuar.

Nëse viktimë nuk ka nevojë për ndihmë mjekësore dhe nëse stafi konstaton se viktimë ndodhet jashtë rrezikut, atëherë ky është momenti më i mirë për t'i dhënë mundësi viktimës të shkarkojë gjithë emocionet negative. Ajo mund të mos dojë të vijë në strehëz pasi mund të mos jetë e sigurt se cilat janë mundësitë që i ofron shërbimi. Në këtë moment jepini mundësi të flasë me ritmin e saj dhe sigurojeni se vendimi për të telefonuar është një vendim i mirë dhe se ju, si staf i strehëzës, jeni personi i duhur për ta dëgjuar. Ofroni referimet sipas nevojës dhe sugjeroni alternativa sa herë të jetë e mundur, por mos jepni këshilla!

Bëni pyetje për të parë se kur dhe si ka ndodhur kriza e tanishme:

“Kur ndodhi incidenti për të cilin po flisni?”

Sapo ka ndodhur, apo ka ndodhur përpara dy javësh? (Përcaktoni nëse pjesëmarrësja tani po paraqet një reagim të vonuar për incidentin apo nëse ajo vetëm tani e ka gjetur guximin për të shprehur nevojën për të folur me dikë lidhur me krizën.)

Bëni pyetje për të vlerësuar statusin dhe nevojat fizike të viktimës:

“Sa vjeç jeni?”

“A jeton me ju dhunuesi juaj?”

“A jeni e martuar me të?”

“A keni fëmijë?”

“A ndodhen me ju fëmijët?”

“A keni një familje, fqinje apo mikeshë tek e cila të keni besim dhe t’i kërkonti këshilla dhe/ose ndihmë?”

“A keni nevoja të veçanta mjekësore apo ndonjë gjendje të veçantë mjekësore?”

“A jeni duke marrë ndonjë shërbim këshillimi?”

“Këshillimin e bëni pa dhunuesin tuaj apo edhe ai vjen me ju në seancat e këshillimit?”

“A përdorni lëndë narkotike apo barna me recetë?”

“A konsumoni alkool tani?”

Bëni pyetje për të vlerësuar gjendjen emocionale të viktimës:

“Si ndjeheni tani?”

“Si ndjeheni kur dhunuesi juaj ...?”

Si person mbështetës, gjithmonë duhet të përpiqeni të vlerësoni gjendjen emocionale të viktimës, si gjatë bisedës telefonike, ashtu edhe kontaktit të drejtpërdrejtë.

Mbështetja juaj emocionale është e rëndësishme edhe për faktin se largon prej saj mendimet (dhe veprimet) për të vrarë veten apo për të vrarë dikë tjetër.

Gjatë procesit të dëgjimit, ndaluni herë pas here për të vlerësuar gjendjen emocionale të viktimës (si flet, si reagon, a është e qartë, a kupton, a kërcënon etj.).

Ndodh që stafi kupton se viktima është e pavëmendshme ndaj komunikimit me stafin. Ato janë të fokusuara te trauma dhe duan të flasin vetëm për të. Duhet respektuar kjo nevojë e tyre dhe duhen lënë në ritmin e tyre të shkarkojnë gjithë emocionet negative të akumuluar. Duke e ndihmuar atë t’i shprehë ndjenjat për atë që ka ndodhur, mund ta ndihmoni t’i kuptojë rrethanat në të cilat ndodhet, atë që i ka ndodhur dhe atë që mund të bëjë lidhur me këtë.

Bëni pyetje të drejtpërdrejta për të parë se çfarë dëshiron të bëjë viktima:

“A ju ka ndodhur më parë kjo?”

“Çfarë keni bërë atëherë?”

“Mënyra si e keni përballur këtë në të shkuarën a ka pasur sukses?”

“A mund të funksionojë e njëjta strategji tani?”

“A i keni përdorur shërbimet e strehëzës më parë?”

“Çfarë mendoni se ju duhet tani?” (Për shembull: thjesht të flasë me dikë, të ketë dikë i cili ta dëgjojë, ose viktima dëshiron të shfryjë inatin, dëshiron informacion ose dëshiron ta ndihmojë dikush për të krijuar një plan sigurie ose t’i shikojë me radhë mundësitë që ka përpara?)

“Çfarë dëshironi të bëni tani?”

Mos harroni, ju nuk duhet të merrni përgjegjësi për jetën apo situatën e viktimës!

Pyetjet duhet të orientohen te pjesëmarrësja dhe të përqendrohen te niveli i rrezikut të saj. Pasi të konstatohet se ndodhet jashtë rrezikut imediat, stafi mund të vlerësojë nevojat mjekësore që mund të ketë ajo.

- A ka nevojë për kujdes mjekësor?

Stafi mund të bëjë pyetje edhe për konsumimin e alkoolit apo drogave nga dhunuesi ose kandidatja për pjesëmarrëse.

Shënim. Secila strehëz, në varësi të profilin të shërbimit të saj dhe specialitetit të stafit, vendos nëse duhet të bëjë apo jo pyetje për konsumimin e alkoolit/drogave.

Informacioni që duhet t’u jepet telefonuesve përfshin çështjet e mëposhtme:

- Numrin e linjës së këshillimit për viktimat e dhunës;

- Shërbimet kundër dhunës në familje, shërbimet sociale, institucionet mjekësore, transporti, shërbimet juridike etj.;

- Të drejtat e tyre dhe ligjin që i mbron;

- Çfarë shërbimesh mund të marrë në strehëz;

- Mundësitë që kanë në dispozicion (domethënë, qëndrimi brenda marrëdhënies, planifikimi i sigurisë, qëndrimi me një mikeshë apo familjare, marrja e shërbimeve mbështetëse, hyrja në një strehëz etj.)

- Planifikimi i sigurisë për shtëpinë, punën, shkollën dhe fëmijët e tyre, familjen, miqtë, fqinjët, kolegët apo eprorët.

Mundësitë e ofruara varen nga rreziku, preferencat, burimet dhe pasja e shërbimeve dhe hapësirës në strehëz.

Pjesëmarrësja e mundshme duhet të vendosë hapin e ardhshëm pasi të marrë informacion për të gjitha alternativat e mundshme. Nëse stafi nuk flet drejtpërdrejt me pjesëmarrësen e mundshme, hapi tjetër duhet të jetë të prisni gjersa t'i jetë paraqitur informacioni personit dhe ajo t'i drejtohet stafit për hapin e ardhshëm.

Strehëzës mund t'i interesojë të vendosë protokolle me strehëza të tjera në lidhje me referimin e grave në krizë kur të mos keni vend në strehëz. Krahës kësaj, nëse strehëza nuk është njëra prej mundësive, ofroni shërbime të tjera të mundshme (për shembull, grupe mbështetëse, shërbime të punës afëruese etj.).

Siguria e telefonave

Nuk ndodh rrallë që dhunuesit të marrin edhe numrat e telefonit dhe adresat e strehëzave, vendndodhja e të cilave mbahet e fshehtë. Nëse ju vjen një telefonatë kur viktimë është strehuar te ju, mos harroni se personi që telefonon mund të jetë duke telefonuar për llogari të dhunuesit apo mund të jetë vetë dhunuesi. Reagimi i duhur ndaj çdo telefonate të marrë në një strehëz e cila e kërkon me emër një viktimë të strehuar (ose e cila kërkon informacion për një viktimë të strehuar) është si vijon:

“Më vjen keq, por në bazë të ligjit, nuk mund t’ju jap asnjë informacion për asnjë person që merr shërbime te ne apo që banon këtu. Nuk mund të konfirmoj nëse është apo jo këtu personi për të cilin po telefononi”.

Ardhja në strehëz

Nëse konstatohet se viktimë kërkon strehim, atëherë duhet të caktoni një vend dhe orë për t’u takuar me viktimën dhe për të kryer një intervistë pranimit ballë për ballë.

Shumica e strehëzave e ruajnë rreptësisht fshehtësinë e informacionit për vendndodhjen dhe adresën e strehëzës. Në këto kushte, mund të jetë e nevojshme që takimi të lihet jashtë strehëzës. Vend takimi mund të jenë zyrat e linjave të këshillimit, zyrat rajonale të shërbimeve sociale, zyrat e qeverisjes vendore, zyrat e shoqatave, postat e policisë apo urgjencat e spitale.

Punonjëset e strehëzës nuk duhet të shkojnë në shtëpinë e viktimës për ta marrë atë!

Viktimë mund të orientohet për të kërkuar ndihmën e policisë për t’u larguar nga shtëpia.

Sa herë që stafi komunikon me policinë apo personelin e urgjencës në spital, stafi duhet të prezantohet me profesionalizëm dhe respekt kundrejt personelit të strukturave të tjera të menaxhimit të krizave, njësoj siç do të donte të silleshin të tjerët me të.

Mbështetja për një të mbijetuar të dhunës në familje, viktimë përdhunimi apo viktimë të përndjekur nga një person tjetër ndryshon nga mbështetja që të ofron një mik.

Ndërhyrja për krizat është një ndërhyrje imediate profesionale dhe e drejtpërdrejtë në një pikë kritike të jetës së viktimës.

Nëse pjesëmarrësja e mundshme kërkon strehim, stafi duhet të shikojë nëse shërbimet janë të përshtatshme dhe të gatshme për të në këtë moment.

Duhet minimizuar në maksimum shkaqet e përjashtimit të viktimës nga shërbimi i strehëzës.

Nga ana tjetër, duhet siguruar që strehëza ka kapacitetin për të plotësuar nevojat e viktimës. Strehëza nuk duhet të kthehet në një institucion ku abuzohet me nevojat e viktimës!

Problemet e shëndetit mendor, drogës apo alkoolit, numrit të fëmijëve, moshës së fëmijëve, moshës së fëmijëve djem, apo mungesës së një dokumenti që provon dhunë, duhen trajtuar rast pas rasti dhe në përputhje me politikat pranuese të strehëzës. Pyetja bazë që duhet bërë është: “A është ky vendi më i mirë për këtë person?” Nëse jo, duhen bërë referime të përshtatshme dhe të përgjegjshme. Nëse strehëza është plot, atëherë stafi duhet t’ia referojë personin një strehëze tjetër, nëse ka një të tillë.

Nëse vendoset për strehimin e viktimës në strehëz, porositeni të sjellë dokumente identifikimi dhe dokumente shkollore, informacione financiare dhe punësimi, dokumente për pronat dhe gjendjen mjekësore.

Jepni informacion për mundësitë e transportit: linjat e autobusit, patrullën e policisë, taksi etj.

Shënim. Transporti dhe arritja në strehëz është një çështje e rëndësishme për t'u pasur parasysh. Institucionet që ofrojnë shërbimin e strehëzës duhet të mendojnë edhe për organizimin e këtij shërbimi. Bashkëpunimi me disa taksi, me forcat e policisë, me qeverisjen vendore, apo me vullnetarë janë disa prej alternativave.

PROCEDURAT E PRANIMIT

Në momentin e hyrjes në strehëz, pjesëmarrësja përshëndetet duke i uruar mirëseardhjen.

1. Këshillohet se si fillim ajo mund të pyetet se çfarë dëshiron të bëjë:

- të ushqehet;
- të pushojë;
- të bëjë një dush;
- të bisedojë; apo
- diçka tjetër.

2. Pjesëmarrësja pajiset me materialet më të domosdoshme: peshqirë, çarçafë, veshje apo artikuj të tjerë të kujdesit vetjak.

3. Pjesëmarrësja dhe fëmijët orientohen në strehëz: ku janë dhomat e gjumit, kuzhina, tualetet, dhoma e lojës për fëmijët, zyrat etj.

4. Orientoheni mbi politikën ushqimore të strehëzës, ku t'i mbajë sendet dhe ushqimin personal, ku t'i lajë teshat dhe ku të pijë duhan apo të bëjë telefonata. Kërkoni ndihmën e banorëve të tjerë në mënyrë që pjesëmarrësja e re të ndjehet rehat. Kjo do të mundësonte bashkëpunimin grave pjesëmarrëse në program.

5. Mblidhni informacion në momentin e pranimit dhe regjistrojeni në një dosje individuale. Me vazhdimin e procesit të pranimit, mbështetuni në informacionin e mbledhur më parë, gjatë kontaktit të parë. Shpjegoni se çfarë mund të presë ajo, shpjegoni rregullat e strehëzës, sa kohë mund të qëndrojë në strehëz etj.

6. Vendosni ilaçet në një mjedis të caktuar dhe të mbyllur më çelës.

7. Jepni informacion me shkrim në mënyrë që banorja e re të mund ta lexojë këtë informacion edhe më vonë. Mund t'ju ndihmojë nëse këtë informacion e jepni në një dosje me letra bosh dhe stilolaps në mënyrë që ajo të mbajë edhe shënime, të mbajë ditar apo të shënojë informacione gjatë kohës që qëndron në strehëz.

8. Punonjësja e strehëz punon për mbledhjen e informacionit shtesë në mënyrë që brenda 72 orëve të ketë kompletuar dosjen me informacionin bazë. Disa informacione mund të mblidhen edhe më vonë, në varësi të rrethanave.

9. Staf i duhet të kujdeset që të nënshkruhen të gjitha kontratat, duke përfshirë edhe dhënien e pëlqimit për shërbimet, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrëseve, procedurën e ankimit dhe përshkrimin/pritshmëritë e programit. Të gjitha këto dokumente duhet të vendosen në dosjet e pjesëmarrëseve.

Bashkëngjitur:

1. Formulari i vlerësimit të dhunës te personi i rritur;
2. Formulari i vlerësimit të dhunës te fëmijët.

ANEKSI 1.3 ORIENTIMI I BANORËVE

Mirë se vini në (emri i strehëzës).

Politika e strehëzës është që të gjithë banorëve t'u jepen shërbime të barabarta.

Cilat janë shërbimet tona?

Strehëza ofron një shumëllojshmëri shërbimesh për të mbijetuarit e dhunës në familje. Misioni ynë është (citoni misionin)

Gjatë kohës që do të qëndroni në strehëz, mund të prisni shërbimet e mëposhtme: (Shërbimet janë orientuese. Ato mund të përshtaten sipas profilit të strehëzës.)

- Stafit do të jetë në dispozicion tuaj për këshillim për krizat, planifikim të sigurisë dhe menaxhim të rastit. Strehëza ka administratorë të rasteve të cilët ju ndihmojnë me planet tuaja të tranzicionit dhe përmes sigurimit të nevojave tuaja bazë gjatë qëndrimit tuaj në strehëz. Kohëzgjatja e qëndrimit në strehëz është maksimumi deri në 6 muaj.

- Strehëza ka staf, i cili ju ndihmon për depozitim të një kërkesë për urdhër mbrojtjeje kundër dhunës tuaj. Ky mund të jetë një hap i rëndësishëm në planin tuaj të sigurisë.

- Strehëza ka një qendër për kujdesin e fëmijëve e cila mund të përdoret përmes regjistrimit të fëmijës për këtë shërbim, pas kryerjes së orientimit dhe plotësimit të një formulari çdo ditë sa herë dëshironi ta përdorni këtë shërbim. (Jepni një kopje të formularit.)

- Strehëza beson se shërbimet e ndjekjes pas daljes nga strehëza janë një shërbim i rëndësishëm të cilat mund t'ju ofrojnë pasi të keni dalë nga strehëza. Strehëza ka punonjës mbrojtës të cilët ofrojnë shërbime avokatie për t'ju ndihmuar pasi ta keni kaluar fazën e tranzicionit.

Jeta në strehëz

Ruajtja e fshehtësisë së informacionit

- Kur të mbërrini në strehëz, një anëtar i stafit do t'ju bëjë pyetje për familjen tuaj, për rrethanat që ju sollën këtu dhe për të ardhurat tuaja. Ky informacion do të regjistrohet në atë që më pas do të jetë dosja juaj si banorë e strehëzës, në përputhje me ligjin.

I gjithë informacioni do të mbahet i fshehtë. Informacioni do t'i jepet një të treti vetëm pasi të keni nënshkruar një deklaratë pëlqimi për nxjerrjen e informacionit, ku të përcaktoni emrin dhe informacionin që mund të nxjerrim. Nga ky rregull ka katër përjashtime:

- Kur ju përbëni rrezik për veten apo të tjerët;
- Kur ka abuzim apo moskujdesje ndaj një fëmije;
- Kur ka abuzim apo moskujdesje ndaj një të moshuari apo një personi me aftësi të kufizuara;
- Kur ka vendim gjykate për këtë;
- Një strehëz kundër dhunës në familje duhet ta mbrojë jetën private të personave të mbijetuar përmes mosdhënies së identitetit apo vendndodhjes së personave banues në një strehëz kundër dhunës në familje dhe përmes kufizimit të ardhjes së vizitorëve në strehëz.

Ju lutemi, mos harroni se ndodheni në një strehëz emergjence dhe, për sigurinë tuaj dhe atë të personave të tjerë, është e rëndësishme ta mbani të fshehtë informacionin për vendndodhjen tonë, pikat e takimit, pjesëmarrëset dhe përshkrimin e automjeteve.

Administratori i rastit tuaj do të punojë me ju dhe me planin e sigurisë për ardhjen dhe largimin nga vendndodhja. Shkelja e fshehtësisë së informacionit përmes dhënies së informacionit për vendndodhjen e strehëzës një personi të paautorizuar apo përmes dhënies së emrit të një personi tjetër të strehëzës një personi të paautorizuar, mund të sjellë largimin e paplanifikuar.

Të drejtat e pjesëmarrësës

- Pjesëmarrëset kanë të drejtën për të marrë shërbimet e ofruara nga strehëza pa dallime dhe kufizime për arsye moshe, race, etnie, besimi etj.;

- Pjesëmarrëset kanë të drejtën të trajtohen me respekt dhe dinjitet;

- Pjesëmarrëset kanë të drejtën e ankimit. Ankesa mund të paraqitet verbalisht te punonjësi social apo drejtuesi i shërbimit, mund të paraqitet formalisht apo në mënyrë anonime. Kjo e

fundit mund të hidhet në kutinë e ankesave që gjendet në një vend të arritshëm në strehëz. Drejtori do t'ju përgjigjet brenda 5 ditësh. Nëse nuk është e kënaqur me përgjigjen, banorja ka të drejtën të paraqesë një ankesë pranë bordit.

Pesë përjashtime kryesore/rregulla:

Ju lutemi, ta kuptoni se këto pesë rregulla janë për sigurinë e të gjithëve. Shkelja e këtyre rregullave mund të sjellë largimin e detyrueshëm nga strehëza. Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

1. Ju lutemi, respektojin banoret e tjera, stafin, vullnetarët dhe fëmijët, duke mos i kërcënuar apo duke mos kryer akte të dhunës fizike.

2. Respektojeni strehëzën, duke mos e dëmtuar apo shkatërruar mjediset e saj.

3. Respektojeni pronën vetjake të të tjerëve, duke mos vjedhur prej banoreve të tjera, stafit/vullnetarëve të strehëzës apo nga vetë strehëza.

4. Për sigurinë tuaj, strehëza nuk lejon përdorimin apo mbajtjen e drogave, të alkoolit ose të armëve në mjediset e saj.

5. Merrni vendime të mira për sigurinë tuaj vetjake dhe mos e shkelni fshehtësinë e informacionit për strehëzën dhe banorët.

Kujdesi për fëmijët

Sikurse, ju kemi informuar më lart, strehëza ofron shërbime të kujdesit të fëmijëve. Hë për hë, strehëza nuk mund t'u ofrojë shërbime kujdesi të gjithë fëmijëve në strehëz. Prioritet u jepet nënave që punojnë, pas të cilave prioritet u jepet nënave që kanë takime pune ose në shërbim të zgjidhjes së situatës së tyre. Është përgjegjësia e vetë banores të caktojë orën për kujdesin e fëmijës dhe ta anulojë takimin nëse vendos se ky shërbim nuk i nevojitet. Me këtë ndihmoni banoret e tjera të cilat mund të kenë nevojë për kujdes për fëmijët e tyre atë ditë. Ju lutemi, dorëzoheni formularin që ju është dhënë, ku shpjegohet orari gjatë të cilit do të ofrohet kujdesi për fëmijët atë ditë.

Strehëza mund t'u japë mundësi me raste banoreve të tjera të kujdesen për fëmijët tuaj. Duhet të informohet një punonjësve mbrojtëse nëse një banore tjetër ka ndër mend të kujdeset për fëmijët tuaj. Kujdesi për fëmijët midis banoreve mund të bëhet e shumta për 3 orë nëse nuk bëhet përjashtim nga një punonjëse mbrojtëse. Banoret duhet të plotësojnë një marrëveshje banore me banore ÇDO herë që ia lejojnë një banoreje tjetër të kujdeset për fëmijën a fëmijët e saj. Nuk i lejohet një banoreje tjetër të kujdeset për më shumë se 5 fëmijë njëherësh, përfshirë këtu edhe fëmijët e vet. Banoret të cilat kanë rënë dakord të kujdesen për fëmijët kanë të drejtën të vendosin të mos e ofrojnë këtë shërbim kur mendojnë se nuk mund ta ofrojnë më (këtu jepet marrëveshja "banore me banore").

Sikurse thuhet në standardet e strehëzës, nënat duhet medoemos t'i vëzhgojnë fëmijët e tyre në çdo kohë. Mosndjekja e kësaj kërkesë mund të konsiderohet moskujdesje.

Fëmijët mund të luajnë vetëm në vendet e përcaktuara për këtë gjë në strehëz. Fëmijët nuk mund të luajnë në parking dhe përreth barakave të shërbimit apo mbrapa shtëpive.

Llojet e lodrave që nuk lejohen:

- patinat, skejtbordet;
- lodrat armë/lodrat shpatë;

Llojet e aktiviteteve që nuk lejohen:

- lufta;
- mundja;
- lëvizja me skejtbord;
- lëvizja me biçikletë brenda oborrit të strehëzës;

Vendet ku nuk mund të luhet:

- rruga dhe trotuari;
- parking;

Si pritet të mbikëqyren fëmijët nga prindërit e tyre, gjatë lojës:

- t'i kenë në rrezen e shikimit;
- t'i kenë pranë vetes;
- pjesëmarrëset e rritura duhet të jenë jashtë kur jashtë janë edhe fëmijët;
- duhani nuk lejohet në vendet e caktuara ku lozin fëmijët.

Shkolla

Stafi i strehëzës i ndihmon nënat t'i regjistrojnë fëmijët në shkollën më të afërt mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit/drejtorinë arsimore rajonale. Banoret duhet t'i regjistrojnë në shkollë fëmijët e tyre brenda 2 ditësh pasi hyjnë në strehëz. Nënata mbeten përgjegjëse për rrezikun që u kanoset fëmijëve të cilët shkojnë në shkollë vetëm, të shoqëruar apo që nuk shkojnë për një periudhë kohe. Stafi do t'i asistojë nënat për regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Nënata sigurojnë transportin e fëmijës për në shkollë. Distanca e vogël mundëson lëvizjen në këmbë.

Ushqimi

- Strehëza ju siguron juve dhe fëmijëve tuaj ushqim nga furnizimet e veta gjersa ju të keni të ardhura për të përmbushur nevojat tuaja ushqimore.

- Blerja dhe përgatitja e ushqimeve është aktivitet i përbashkët, me gratë e tjera të strehëzës.

- Kuzhinën mund ta përdorni lirisht gjër në orën 21:00.

- Për vendosjen e ushqimeve mund të përdorni dollapin e ushqimeve dhe frigoriferin (mbulojini të gjitha ushqimet me qese).

- Ju lutemi, vendosni emrin tuaj në ushqimet personale që do të vendosni në frigorifer.

- Pastrojeni kuzhinën mbasi ta keni përdorur.

- Nëse banorja dëshiron ushqime të tjera shtesë apo gjellë të veçanta, këtë duhet ta sigurojë vetë.

- Nëse banorja ka nevoja ushqimore të veçanta për arsye mjekësore ju lutemi, informojeni stafin për këtë, në mënyrë që të mund të merren masat e nevojshme të arsyeshme.

Asistenca financiare

Sipas ligjit shqiptar për mbrojtjen sociale (nr. i ligjit), kur një grua largohet nga shtëpia për arsye të sigurisë, ajo fiton të drejtën e mbështetjes financiare. Këtë mbështetje mund ta marrë vetëm pranë njësisë së qeverisjes vendore ku ajo është banore. Nëse ju duhet ndihmë për të arritur këtë këshillohuni, flisni me administratoren e rastit tuaj.

Transporti

Sipas ligjit "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", policia ka detyrimin për të bërë transportimin për në strehëz dhe për të siguruar mbrojtjen në situatat ku ka rrezik për jetën.

Hyrje-daljet

Banoret që mendojnë të lëvizin nga strehëza për të kryer punë apo shërbime në komunitet, duhet të sigurohen për sigurinë e daljes dhe të hyrjes. Ato duhet të përdorin derën për lëvizjen e këmbësoreve. Në kthim, kur ju duhet të hyjnë në strehëz, duhet të përdorin zilen dhe të presin që dera të hapet nga brenda.

Vendi ku pihet duhani

Strehëza ka vende ku lejohet duhani. Tabelat "KËTU PIHET DUHAN" tregojnë këto vende. Duhani nuk lejohet në asnjë mjedis tjetër jashtë dhe brenda shtëpive.

Kontributet për komunitetin

Është përgjegjësi e çdo banoreje të marrë pjesë në mbajtjen pastër të mjedisit. Të gjitha banoreve do t'u caktohen detyra konkrete për pastrimin e mjedisit, në bazë të rotacionit. Disa prej këtyre detyrave përfshijnë pastrimin e kuzhinës, pastrimin e tualeteve, pastrimin e oborrit, nxjerrjen e plehrave etj. Nëse një banore vendos të kryejë detyra shtesë në komunitet, ato do të shpërblehen përmes një sistemi që ndërtohet në çdo strehëz.

Përdorimi i telefonit

Strehëza e ka për kënaqësi t'ju ofrojë shërbimin e telefonit për telefonata personale. Banoreve NUK u lejohet ta bllokojnë telefonin për periudha të gjata. Banoret janë të lutura të tregojnë

respekt dhe mirësjellje ndaj të gjitha banoreve të tjera, duke mos e monopolizuar telefonin. Telefonatat duhet të kufizohen maksimumi 10 minuta, nëse janë duke pritur të tjera për ta përdorur telefonin.

Përdorimi i kompjuterit

Strehëza e ka për kënaqësi të ofrojë shërbime interneti për përdorim vetjak dhe për të punuar për planin tuaj të shërbimit. Banoret duhet të regjistrohen për të përdorur kompjuterin në zyrën e administratorit të rastit. Secila banore mund ta përdorë kompjuterin për 30 minuta, nëse nuk është duke pritur dikush tjetër për ta përdorur kompjuterin. Banoret mund ta përdorin kompjuterin edhe më gjatë, me lejen e administratorit të rastit, nëse banorja punon për planin e shërbimit. Nuk lejohet të përdoret asnjë hapësirë në internet e cila mund të konsiderohet e dhunshme ose pornografike. Nuk lejohen programet e shkëmbimit të mesazheve të çastit (messenger) apo shkarkimet në kompjuter. Të gjithë fëmijët duhet të mbahen nën mbikëqyrje kur janë duke përdorur telefonin apo kompjuterin.

Sendet vetjake të banorëve

- Strehëza nuk mban përgjegjësi për humbjen a vjedhjen e sendeve personale. Banoret mund t'i vendosin sendet e tepërta në magazinë gjatë qëndrimit të tyre, deri në 30 ditë pasi largohen nga strehëza. Pas 30 ditëve, sendet personale do të hidhen poshtë. Nxiten banoret t'i vendosin në magazinë sendet e tepërta, për të evituar vjedhjen dhe rrëmujën. Sendet, të tilla si: letërnjoftime, karta krediti, çanta dore etj., duhet t'i mbajë banorja me vete gjatë çdo çasti ose t'i vendosë në një vend të sigurt. Stafit nuk duhet të ruajë sende brenda zyrave të stafit.

- Çdo banoreje mund t'i caktohet një dollap personal me kyç. Kjo mundësi u jepet vetëm atyre banoreve të cilat nuk kanë hapësira personale ku të mund t'i vendosin sendet vetjake të tyre.

Siguria

- Strehëza ka vendosur procedura sigurie, në rast të hyrjes së një personi të jashtëm të padëshiruar në mjedise. Normalisht, strehëza funksionon sipas hipotezës “çdo gjë në rregull”, që do të thotë se nuk ka shenja të një të paftuari apo rreziku të ditur. Nëse stafi mëson për një rrezik të mundshëm, mund të shpallet “alarm i kodit të verdhë”. Ky alarm do të thotë se është identifikuar një rrezik i mundshëm i hyrjes së një të paftuari në strehëz. Banoret dhe stafi mund të vazhdojnë të kryejnë veprimet e përditshme, duke treguar kujdes shtesë dhe duke qëndruar brenda mjediseve nëse nuk është e nevojshme të dalin. Nëse shihet një person i jashtëm i padëshiruar rreth mjediseve ose brenda tyre dhe nëse ekziston mundësia për rrezik, stafi mund të shpallë “kodin e kuq” që do të thotë se të gjitha banoret duhet të futen brenda strehëzës dhe të presin gjersa të shpallet largimi i rrezikut. Kur është shpallur “kodi i kuq” banoret dhe stafi duhet të qëndrojnë medoemos në mjediset e strehëzës dhe askujt nuk i lejohet të largohet nga mjediset. Secila shtëpi e strehëzës ka një “vend të sigurt” ku duhet të mbledhen banoret.

- Vlen gjithmonë të theksohet se strehëza mbështetet te fshehtësia e informacionit për vendndodhjen e saj, për t'ju mbajtur juve dhe fëmijët tuaj jashtë rrezikut. Është absolutisht e nevojshme të mbahet i fshehtë informacioni për vendndodhjen e strehëzës. Thyerja e fshehtësisë së informacionit mund të çojë në largimin e paplanifikuar nga strehëza.

- Strehëza nuk lejon asnjë lloj arme në mjediset e veta. Armët e zjarrit, armët e ftohta apo çdo gjë tjetër që mund të konsiderohet si armë mund të konfiskohet dhe kjo mund të përbëjë arsye për largim të paplanifikuar.

- Strehëza e vlerëson qëndrimin jashtë rrezikut të gjithë banoreve dhe stafit dhe bën ushtrime për mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin në rast zjarri. Evakuimi në rast zjarri bëhet atëherë kur sistemi kundër zjarrit ndjen se ka një problem, ndërsa ushtrimi kundër zjarrit është një aktivitet i paraplanifikuar. Politika për evakuimin në rast zjarri u kërkon banoreve që nëse bie një alarm i cili tregon nevojën për t'u evakuar, të largohen menjëherë të gjitha nga ndërtesa dhe të paraqiten në zonën e caktuar për t'u mbledhur, që ndodhet në (shkruani pikën e mbledhjes). Nuk lejohet rihyrja në ndërtesa gjersa që shpallet kalimi i situatës së rrezikshme nga zjarrfikësit. Rrugët e largimit në rast rreziku afishohen në të gjithë strehëzën dhe paraqesin rrugët e largimit për të shkruar në pikën e mbledhjes. Gjatë evakuimit në rast zjarri do të ndihmohet çdo banore me probleme që e pengojnë për të lëvizur.

Hapësira në dollap dhe frigorifer

Strehëza ofron hapësirë të mjaftueshme në frigorifer dhe dollap për banoret që hyjnë në strehëz. Banoret duhet t'i mbajnë artikujt ushqimorë në vendin e caktuar. Vjedhja e ushqimeve të një banoreje tjetër mund të sjellë largimin e paplanifikuar.

Administrimi i rastit

- Të gjitha banoreve që qëndrojnë në strehëz më shumë se 72 orë u caktohet një administrator rasti. Përgjegjësia e administratorit të rastit është ta ndihmojë banoren të krijojë një plan i cili do ta ndihmojë të kthehet nga strehëza në komunitet. Plan i plotësohet pasi banorja ka kaluar 72 orë në strehëz.

- Një administrator rasti do të punojë me ju që t'ju ndihmojë të arrini objektivat tuaja. Për shembull, mund t'ju ndihmojmë me çështje, të tilla si: punësimi, strehimi, kujdesi për fëmijët, arsimit dhe shqetësime të tjera që mund të keni.

Shërbime të veçanta

- Në strehëz ofrohet punë me grupet sipas nevojave dhe problematikave. Grupi mbështetës mund të ketë deri në 10 persona dhe qendra e kujdesit për fëmijët do të kujdeset për fëmijët tuaj gjatë kësaj periudhe, nëse kanë kapacitet. Banoret janë të lira të organizojnë vetë mbledhje të grupeve të tjera mbështetëse.

- Strehëza mund të ketë edhe shërbime vullnetare nga studentë. Ata do të ofrojnë këshillim për çështje të shëndetit mendor, punën me fëmijët etj. Ju mund të lini takime me ta përmes administratorit të rastit tuaj.

Mbledhjet e shtëpisë

- Frekuentimi i mbledhjeve të shtëpisë rekomandohet jashtë mase dhe, në disa raste, është i detyrueshëm. Mbledhjet e shtëpisë zhvillohen sipas një plani të hartuar nga drejtuesit e strehëzës. Nëse nuk mund të merrni pjesë në mbledhjet e shtëpisë, stafi do të takohet individualisht me ju për t'ju informuar për problemet e rëndësishme të diskutuara në mbledhje.

Orari i sigurt, kalimi i natës jashtë strehëzës dhe orari i gjumit

- Në respekt të qetësisë së banoreve të strehëzës, ulni volumen e TV-së pas orës 22:00. Bëni dushin para orës 22:00. Tregoni kujdes kur të hyni në dhomën e gjumit pas orës 22:00.

- Vetëm dy net lejoheni t'i kaloni jashtë strehëzës gjatë qëndrimit tuaj në strehëz. Kalimi i natës jashtë strehëzës, për shkak të turnit të tretë apo urgjenca mjekësore, nuk llogaritet në këtë sasi të lejuar të netëve jashtë strehëzës, nëse jepet dokumentacioni i duhur.

- Orari i sigurt për banoret është deri në 24:00 gjatë ditëve të javës dhe deri në 1:00 të premtë dhe të shtunë.

- Orari i gjumit është në dorë të çdo prindi. Por, pritët nga fëmijët që të mos bëjnë zhurmë pas orës 21:00, në respekt të orarit të gjumit të të tjerëve.

- Largimi nga strehëza

- Lajini dhe kthejini shtrajt e shtratit;

- Pastrojeni dhomën tuaj;

- Futini në valixhe/çanta të gjitha sendet tuaja;

- Plotësoni dokumentacionin e daljes, duke përfshirë edhe planin e sigurisë të daljes.

ANEKSI 2

DEKLARATË PRANIMI PËR TË RRITURIT

Unë (emri i përfituesit), lindur më (datë) në (qyteti dhe vendi), deklaroj sot më (datë) që më janë shpjeguar dhe kuptoj plotësisht programin e (emri i organizatës), si dhe të drejtat, detyrimet e mia, dhe kushtet për të përfituar nga programi i tyre. Unë i kuptoj dhe jam i pranoj këto të drejta, detyrime dhe kushte, siç përshkruhen në faqet e mëposhtme.

Qëllimi i organizatës

Synimi kryesor i Strehëzës Kombëtare kundër Dhunës në Familje është të ofrojë nëpërmjet shërbimeve, ndërhyrjes dhe trajtimit në programet kundër dhunës në familje mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe e fëmijëve të tyre, duke rritur, në të njëjtën kohë, llogaridhënien e abuzuesve për dhunën që kanë ushtruar. Synimi i dytë lidhet me fuqizimi e pjesëmarrëseve që të ecin drejt pavarësisë dhe mbështetjes te vetvetja.

Ekspertiza e organizatës dhe stafit të saj

Strehëza rezidenciale është një objekt i cili u ofron pjesëmarrëseve dhe fëmijëve të tyre një vendqëndrim të përkohshëm të sigurt, jashtë rrezikut, duke u ofruar, në të njëjtën kohë, edhe përmbushjen e nevojave, të tilla si: ushqim dhe veshmbathje. Strehëza qëndron hapur 24 orë në ditë, shtatë ditët e javës. Ajo është e pajisur me personelin e programit.

Stafi i strehëzës përbëhet nga një ekip multidisiplinar, anëtarët e të cilit kanë profesione dhe eksperiencë të ndryshme, të tilla si: punonjës socialë, këshillues, menaxherë rasti, specialistë për fëmijë dhe kujdestar. Të gjithë anëtarët e stafit duhet të kenë mbaruar studimet në punë sociale ose shkenca sociale, bachelor ose master (në varësi të pozicionit dhe përgjegjësisë), si dhe eksperiencë pune të paktën 2 vjet në shërbime të ngjashme.

Shërbimet e ofruara drejtpërdrejt nga organizata

Fuqizimi është baza e shërbimeve në strehëz. Fuqizimi është aftësia për të pasur ndikim te forcat të cilat prekin jetën e personit, në favor të këtij të fundit. Punonjësit e programeve duhet ta kuptojnë se dhuna në familje është e rrënjësuar në sistemin shoqëror, çka përforcon pabarazinë e grave dhe fëmijëve në shoqëri, dhe nuk vjen nga psikopatologjia e pjesëmarrëseve të strehëzës apo e dhunuesve të tyre. Ata duhet të kuptojnë edhe rëndësinë e të drejtës së pjesëmarrëseve të strehëzave për vetëvendosje dhe për të marrë vendimet për veten.

Në lëvizjen kundër dhunës në familje, fuqizimi nënkupton edukimin pa forcë dhe mbështetjen e pjesëmarrëses për të vendosur vetë drejtësinë e tyre, pa ushtruar mbi to asnjë kontroll psikologjik, fizik apo emocional. Fuqizimi në punën e avokatisë përfshin asistencën që u jepet pjesëmarrëseve në fushat e vendimmarrjes, vetëbesimit, rritjes së mbështetjes dhe planifikimit për të qëndruar jashtë rrezikut.

Fuqizimi në planifikimin e rastit ka të bëjë me angazhimin e pjesëmarrëseve si planifikuese parësore të synimeve dhe objektivave të tyre dhe dhënia e informacion vetëm në kuadër të qëllimit, në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë alternativat e mundshme. Për rrjedhojë, është mirë që pjesëmarrëseve të mos u diktohet asnjëherë të marrin pjesë në shërbime apo të përjashtohen prej tyre. Kjo përputhet me standardet e shërbimeve sociale në Shqipëri.

Fuqizimi në hartimin e programit ka të bëjë me zhvillimin nga secili program të strukturave vendimmarrëse të cilat të sigurojnë shpërndarjen e autoritetit dhe përgjegjësisë dhe t'i fuqizojë pjesëmarrëset, stafin, vullnetarët dhe anëtarët e bordit. Edhe kjo përputhet me standardet e shërbimeve sociale në Shqipëri.

Për t'i përmbushur këto synime është mirë të nxiten pjesëmarrëset të marrin pjesë në hartimin e programit dhe në vendimmarrje, ose duke shërbyer si vullnetare dhe anëtare komiteti, ose duke u zgjedhur në organin vendimmarrës pasi të mos jenë duke i përdorur më aktivisht shërbimet e programit. Brenda një viti që merr shërbime nga strehëza, personi ka të drejtë të merret në punë nga kjo strehëz, brenda procedurave normale të marrjes në punë.

Pjesëmarrëset duhet të japin kontributin e tyre për hartimin e udhëzuesve që duhen përdorur në rastet kur pjesëmarrëset e programit nuk i respektojnë rregullat e programit ose nuk përmbushin përgjegjësi të caktuara. Kjo nuk duhet ta pengojë stafin të kërkojë zbatimin e rregullave ose politikave të brendshme në ato raste kur veprimet e një pjesëmarrëseje mund të vënë në rrezik sigurinë e saj ose atë të pjesëmarrëseve të tjera të programit, apo edhe vetë programin.

Shërbime jorezidenciale

Program rezidencial është programi që mund të jetë pjesë e strehëzës kundër dhunës në familje ose pjesë e një programi tjetër më vete që u shërben kryesisht viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre.

Shërbimet mund të përfshijnë:

- linjë telefonike në rast krize/ndërrhyrje në rast krize;
- grupe mbështetëse/terapeutike;
- menaxhim rasti/avokati individuale;
- avokati për sistemet;
- shërbime juridike/shërbime asistence në gjykatë;
- programim të fëmijëve;
- shërbime të mbështetura në komunitet për pjesëmarrësit në tranzicion Mbështetje/këshillim individual;
- konsultime dhe trajnim në komunitet.

Programimi i fëmijëve përfshin ato aktivitete që përmbushin nevojat sociale, zhvillimore dhe materiale të fëmijëve që marrin shërbime nga një program kundër dhunës në familje.

Mbështetja individuale dhe ajo në grup është metoda sistematike e planifikuar për të lehtësuar ose zgjidhur problemet e identifikuar nga pjesëmarrësja e strehëzës me një konsulent individual dhe/ose me një grup pjesëmarrësish të tjerë të strehëzës.

Mbrojtja e interesave të rasteve individuale është mbrojtja e interesave në emër dhe për llogari të viktimës së dhunës në familje brenda sistemeve juridike, mjekësore shërbimeve sociale dhe sistemeve të tjera.

Mbrojtja e interesave në sistem ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të viktimave të dhunës në familje si grup ose klasë njerëzish, por jo individualisht. Kjo mund të përfshijë promovimin e politikave dhe procedurave standarde për rastet e dhunës në familje brenda sistemeve juridike, mjekësore, shërbimeve sociale ose sistemeve të tjera. Mund të përfshijë edhe edukimin ose trajnimin e personelit për të siguruar zbatimin e duhur të politikave dhe procedurave. Mbrojtja e interesave në sistem mund të përfshijë hartimin e protokolleve, trajnimin e punonjësve të sistemeve të tjera në lidhje me dinamikën e dhunës në familje dhe/ose lidhur me asistencën për zbatimin e protokolleve të tilla që mund të kenë ndikim të shumë gra dhe fëmijët e tyre.

Menaxhimi i rastit. Të gjitha banoret që qëndrojnë në strehëz më shumë se 72 orë u caktohet një menaxherë rasti. Përgjegjësia e menaxheres së rastit është ta ndihmojë banoren të krijojë një plan i cili do ta ndihmojë të kthehet nga strehëza në komunitet. Plani plotësohet pasi banorja ka kaluar 72 orë në strehëz. Menaxherja e rastit do të punojë me pjesëmarrëset për t'i ndihmuar të arrijnë objektivat. Për shembull, të ndihmojë me çështje, të tilla si: punësimi, strehimi, kujdesi për fëmijët, arsimi dhe shqetësime të tjera që mund të kenë. Menaxherët e rasteve janë të ndjeshëm ndaj çështjeve të dhunës në familje. Ata dëgjojnë për të mësuar shqetësimet e pjesëmarrëseve, të përshtaten me jetën në strehëz, të hartojnë një plan sigurie për ta zbatuar pasi të largohen nga strehëza, orientojnë për agjencitë mbështetëse dhe ndihmojnë pjesëmarrëset të bëjnë ndryshimet që dëshirojnë. Objektivi është t'u plotësohen nevojat dhe t'i ndihmojmë t'i bëjnë ballë efektit që ka në jetën e tyre dhuna në familje. Nëse pjesëmarrëset dëshirojnë të vazhdojnë shërbimet pasi të jenë larguar nga strehëza, mund të takohen me menaxheren e rastit për të marrë informacion për shërbimet e strehëzës.

Shërbime të veçanta

- Grupi mbështetës ofrohet çdo (dita dhe ora) çdo javë. Grupi mbështetës mund të ketë deri

në 10 persona dhe qendra e kujdesit për fëmijët do kujdeset për fëmijët tuaj gjatë kësaj periudhe, nëse kanë kapacitet. Banoret janë të lira të organizojnë vetë mbledhje të grupeve të tjera mbështetëse.

- Strehëza mund të ketë fatin të ketë disa stazhierë të këshillimit për shëndetin mendor të cilët ofrojnë këshillim falas për shëndetin mendor të banoreve. Nëse është kështu, këta stazhierë mbikëqyren nga një mbikëqyrës i kualifikuar. Takimet mund t'i organizoni përmes menaxherit të rastit tuaj.

- Ministria e Shëndetësisë ofron shërbime mjekësore për gratë dhe fëmijët e strehëzës. Orari është: (shkruani orarin).

Shërbimet e ofruara nëpërmjet referimit

Stafi i strehëzës bazuar në nevojat specifike të çdo rasti/familjeje duhet t'i referojë ata në organizata apo institucione publike, të tilla si:

- Institucione arsimore, çerdhe, kopshte apo shkolla publike;
- Institucione shëndetësore, si qendra shëndetësore të kujdesit parësor, spitale apo klinika të specializuara publike.

- Shërbimi ligjor falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, Nisma Ligjore Qytetare;
- Zyrat e punës në institucionet lokale, bashki e komuna;
- Shërbimi Social Shtetëror në rastet e strehimit të përkohshëm për fëmijët, kujdestari, shtëpia e fëmijës etj.;

- Bashkia e Tiranës për strehim të subvencionuar;

- Akses në mikrokredi.

Rregulla dhe kufizime

Në ruajtjen e frymës së filozofisë së fuqizimit dhe mbështetjes, është e rëndësishme që strehëza t'i shqyrtojë rregullat e vendosura për jetën brenda strehëzës, për të siguruar që këto rregulla të mos jenë shtypëse dhe t'u japin mundësi pjesëmarrëseve t'i marrin vetë vendimet për vetveten. Sigurisht, është e rëndësishme që të ketë ca rregulla për jetesën në strehëz, për të ruajtur sigurinë e të gjithë pjesëmarrëseve në program. Por, strehëza duhet të mos i rikrijojë dinamikat e pushtetit që janë të pranishme në marrëdhëniet abuzuese. Për shembull, këto dinamika rikrijohen kur stafi i strehëzës merr përsipër rolin e "vendosësit të rregullave", gjë që i vendos pjesëmarrëset në pozicionin e njohur për ta të "ndjekësit të rregullave".

Strehëzat duhet të bëjnë kujdes që të mos vendosin rregulla, qëllimi i vetëm i të cilave është lehtësimi i funksionimit të strehëzës, pa i kushtuar kujdes sigurisë së banorëve.

Siguria dhe zvogëlimi i rrezikut duhet të jetë politikë e strehëzës.

Stafi duhet të marrë të gjitha masat e kujdesshme për të siguruar shëndetin dhe jetën e të gjithë stafit dhe pjesëmarrëseve dhe duhet të përpaket rregullisht të identifikojë dhe zgjidhë faktorët e rrezikut të mundshëm që mund të prekin pjesëmarrëset ose shërbimet e ofruara. Stafi duhet të trajnohet në fillim dhe më pas rregullisht në lidhje me të gjithë komponentët e planit të administrimit të rrezikut

Rregullat e brendshme të strehëzës

1. Të kryhen punët e caktuara të shtëpisë brenda afateve të caktuara dhe të merret pjesë në përgatitjen e ushqimit, dhe të pastrohet kuzhina sipas detyrave të ngarkuara. Të kryhen punët e mëngjesit jo më vonë se ora 10 paradite dhe punët e mbrëmjes jo më vonë se ora 10 pasdite dhe stafi të verifikojë plotësimin e çdo pune shtëpie pas kryerjes së tyre. Përgatitja e darkës fillon në ora 4:30, ndërsa pastrimi i sallës së ngrënies duhet të përfundojë brenda orës 7 të pasdites.

2. Dhoma të mbahet e rregullt (të rregullohen shtretërit, të mos ketë sende në shtretërit e fëmijëve, të largohen teshat nga dyshemeja, të mos ketë ushqim ose enë në dhomat e gjumit, pelenat e natës të largohen paradite). Dhoma të jetë në rregull përpara se pjesëmarrësja të largohet prej saj për aktivitetet e ditës. Gjatë javës përgjegjësi i shtëpisë bën kontrollë të dhomave të gjumit dhe banjave për t'u siguruar që janë respektuar standardet e pastërtisë dhe higjienës. Këto kontrollë gjatë fundjavës i bën stafi. Pas çdo përdorimi kovat për larjen e dyshemesë duhen zbratur.

3. Të pastrohen banjat pas çdo përdorimi nga ju ose nga fëmijët tuaj.
4. Nuk lejohen fëmijët në zonën e kuzhinës, për arsye sigurie.
5. Familjet të mbajnë higjienën e duhur (të bëjnë banjë ose dush rregullisht). Artikujt emergjentë të higjienës mund të kërkohen sipas nevojës. Artikujt e higjienës që nuk i siguron strehëza dhe nuk kërkohen për arsye mjekësore duhet të blihen nga vetë pjesëmarrësja.
6. Të jenë në kohë për mbledhjet dhe takimet e planifikuara. Të njoftohet stafi nëse kanë probleme me respektimin e orareve (për përfundimin e punëve të shtëpisë, për orarin e sigurisë, për kujdesin e fëmijëve, për takimet e këshillimit dhe menaxhimit të rastit dhe për orët e mësimi në grup). Orët e mësimi për banorët në moshë madhore zhvillohen (përcaktoni orët) dhe në orë të ndryshme gjatë gjithë ditës. Të gjithë banorët marrin pjesë në mbledhjen e shtëpisë çdo (caktoni ditën e javës) dhe nxiten të marrin pjesë në orë shtesë mësimi, nëse ka. Pjesëmarrëset janë të lira të organizojnë mbledhje mbështetëse me pjesëmarrëset e tjera në çdo kohë.
7. Të pastrohet vendi i ngrënies (duke përfshirë edhe dyshtemenë) pas çdo përdorimi nga ju vetë ose nga fëmijët tuaj (të mos lihet asnjë enë në banak, tryezë, karrige fëmije apo lavapjatë). Karriget e posaçme të fëmijëve të vegjël duhet të pastrohen dhe të lahen pas çdo përdorimi, nga personi që është përgjegjësi e kujdestarit të fëmijës.
8. Ushqimet dhe pijet lejohen vetëm në këndin e ngrënies (nuk lejohen enët prej qelqi në verandë). Me përjashtim të ujit, nëpër dhomat e gjumit nuk lejohen ushqimet apo pijet. Nuk lejohen ushqimet apo pijet në bibliotekë/sallën e kompjuterit.
9. Të gjithë anëtarët e familjes duhet të veshin tesha dhe këpucë të përshtatshme në çdo kohë. Përgjegjësjë e shtëpisë kontaktohet nëse ka nevojë për veshje apo këpucë për pjesëmarrësen apo për fëmijët.
10. Të tregohet kujdes në kursimin e energjisë duke fikur aparatën e televizorit, dritat, pajisjet etj., gjatë kohës kur nuk përdoren.
11. Televizori në dhomën e gjumit të fiket në orën 10 të darkës. Televizori në këndet e përbashkëta (dhomën e familjes dhe dhomën e ndenjes) të fiket para mesnate nga e diela deri të enjten dhe brenda orës 1 të natës nga e premtdja deri të shtunën. Volumi i aparateve të televizorit duhet të mbahet brenda një niveli të arsyeshëm në çdo kohë, në mënyrë që të mos shqetësohen të tjerët.
12. Të gjitha dyert dhe dritaret duhet të mbahen të mbyllura dhe të siguruara në çdo kohë. Dritaret e mbrojtura me shufra hekuri mund të mbahen të hapura për ajrim.
13. Të mos hiqet apo zhvendoset asnjë orendi pa lejen e një anëtarit të stafit. Sendet, shtrorjat, ushqimet etj., që ju janë dhënë për përdorim gjatë qëndrimit këtu janë pronë e strehëzës dhe nuk duhet të largohen nga strehëza gjatë qëndrimit tuaj këtu apo kur të largoheni prej këtu. Të lihet një takim me përgjegjësen e shtëpisë për të marrë sendet që mund të nevojiten për të ngritur familjet e re dhe stafi do ndihmojë me ato që mundet.
14. Të gjitha ushqimet dhe pijet e blera nga strehëza të konsiderohen ushqime të shtëpisë dhe duhet të mbeten në mjediset e strehëzës për t'u përdorur nga banorët. Individët mund të blejnë ushqimet e tyre, nëse duan, por strehëza nuk garanton dhe nuk zëvendëson asnjë ushqim që ka blerë një banor dhe që nuk gjendet më. Asnjë ushqim nuk mund të hyjë në strehëz pa marrë në fillim lejen e stafit.
15. Për çdo hyrje-dalje në strehëz të përdoret dera kryesore e saj. Të gjithë banorët duhet të nënshkruajnë në librin e hyrje-daljeve në hollin e hyrjes, për të treguar se ku shkojnë kur dalin nga strehëza dhe se kur mund të kthehen. Orari i sigurt është (vendosni orarin e sigurt), nëse nuk është rënë dakord për një zgjatje të orarit të sigurisë.
16. Telefoni në ambientet e banorëve mund të përdoret nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 10 të mbrëmjes (dhe duhet të shkëputet gjatë seancave në grup). Të respektohen nevojat e njëri-tjetrit dhe të kufizohen telefonatat pa i zgatur më shumë se 10 minuta. Telefoni duhet të qëndrojë në dhomën e familjes dhe të mos nxirret jashtë. Thirrjet telefonike me larg për arsye urgjente mund të bëhen nga telefoni i recepsionit vetëm pasi është marrë leja nga stafi dhe thirrjet telefonike me larg duhet të kufizohen në 3-5 minuta duke qenë se koston e mbulon strehëza. Të

gjitha thirrjet telefonike me larg duhet të dokumentohen në regjistrin e telefonatave me larg të mbajtur në reception.

17. Brenda strehëzës nuk lejohet duhani. Duhani lejohet (caktoni vendin). Në strehëz nuk lejohet djegia e asnjë sendi. Të mbahen të gjithë artikujt që mund të marrin flakë (çakmakë, qirinj, shkrepe, djegëse aromatike, lule të thata etj.) në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.

18. Prej banorëve pritët që fëmijët nën 12 vjeç t'i fusin në dhomat e gjumit brenda orës 9 të mbrëmjes çdo ditë të javës.

19. Të gjitha dritat e dhomave të gjumit të fikën brenda orës 10 të mbrëmjes. Përgjithësisht bëhet vetëm me miratimin e stafit dhe me miratimin e të gjithë personave që e përdorin dhomën në fjalë.

20. Ju lutemi, të mos largoheni nga kuzhina kur të jeni duke gatuar, duke qenë se kjo përbën rrezik kundër jetës. Të mos gatuhet pas orës 9 e mbrëmjes. Pas orës 9 e mbrëmjes mund të hahen vakte të vogla.

21. Fëmijët duhet të monitorohen dhe mbikëqyren nga prindërit ose kujdestari i caktuar, në çdo kohë. Fëmijët nën 6 vjeç nuk duhet të lihen vetëm në asnjë moment ndërkohë që janë në vaskë. Ju lutemi, të tregohet vëmendje e veçantë sa i takon fëmijëve dhe ujit. Marrëveshjet për kujdesin e fëmijës duhet të plotësohen me kujdes dhe të miratohen nga stafi nëse një banor përdor punonjës të kujdesit të fëmijës ose një banor tjetër për t'ia mbikëqyrur fëmijët. Fëmijët nën 6 vjeç nuk lejohet të qëndrojnë në shtretërit e lartë.

22. Kërkesat e veçanta (domethënë zgjatja e orarit të sigurisë) duhet t'i dorëzohen me shkrim menaxherit të rastit brenda ditës së mërkurë të çdo jave, për t'u shqyrtuar gjatë mbledhjes së stafit të enjteve.

23. Të gjitha produktet e pastrimit (dezinfektues, zbardhues etj.) apo lëndët e tjera të rrezikshme (diluent për heqjen e llakut të thonjve, alkool) duhet të mbyllën me çelës në dollapë të sigurt në kuzhinën e pjesëmarrësve ose në lakanderi.

24. Taksitë lejohen të vijnë në strehëz vetëm me miratimin e stafit dhe pas njoftimit paraprak.

Pesë përjashtime kryesore/rregulla

Ju lutemi, ta kuptoni se këto pesë rregulla janë për sigurinë e të gjithëve. Shkelja e këtyre rregullave mund të sjellë largimin e detyrueshëm nga strehëza. Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

1. Ju lutemi, respektojnë banoret e tjera, stafin, vullnetarët dhe fëmijët, duke mos i kërcënuar apo duke mos kryer akte të dhunës fizike.

2. Respektojnë strehëzën, duke mos e dëmtuar apo shkatërruar mjediset e saj.

3. Respektojnë pronën vetjake të të tjerëve, duke mos vjedhur prej banoreve të tjera, stafit/vullnetarëve të strehëzës apo nga vetë strehëza.

4. Për sigurinë tuaj, strehëza nuk lejon përdorimin apo mbajtjen e drogave, alkoolit ose armëve në mjediset e saj.

5. Merrni vendime të mira për sigurinë tuaj vetjake dhe mos e shkelni fshehtësinë e informacionit për strehëzën dhe banorët.

Të drejtat e përfituesit

Strehëza duhet të ofrojë një mjedis jetese i cili i fuqizon pjesëmarrëset, nxit vetëvendosjen dhe u jep pjesëmarrësve të drejtat e mëposhtme, në përputhje me standardet e licencimit:

1. Të trajtohen me dinjitet, respekt dhe konsideratë.

2. Të marrin shërbime pa diskriminim, të mbështetur në racën, ngjyrën, kombësinë, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzëninë, të qenit prind, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, aftësitë e kufizuara, përkatësinë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera, në përputhje me ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

3. Të dorëzojnë ankesa lidhur me kufizime apo ndëshkime dhe t'u shqyrtohen ankesat me drejtësi, në kohë dhe pa anshmëri.

4. Të mos u nxirret informacioni dhe evidencat.

5. T'u ruhet e drejta e jetës private në korrespondencën, komunikim, vizita dhe punët financiare.

6. Të shohin evidencat e veta.

7. Të mos abuzohen dhe shfrytëzohen.

8. Pjesëmarrëset duhet të informohen për të gjitha drejtat në gjuhën që kërkojnë.

9. Të mos pranojnë të bëjnë deklarata publike për të shprehur mirënjohjen për programin apo të performojnë në tubime publike.

10. Të kenë mundësi të komunikojnë me një anëtar të stafit për të kuptuar, ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e pjesëmarrëseve.

11. Të kenë një mjedis ku nuk pihet duhani.

12. Liria e ushtrimit të të drejtave civile të pjesëmarrësës.

13. Fotografitë e pjesëmarrësës të përdoren nga strehëza vetëm në përputhje me pëlqimin e dhënë me shkrim nga pjesëmarrësja ose nga prindi apo kujdestari i pjesëmarrësës.

14. Të kenë mundësi të përdorin barnat me recetë në përputhje me politikën e barnave të pjesëmarrëseve në strehëz.

15. Një plan me objektiva të individualizuara, shqyrtim periodik dhe rivlerësim të nevojave dhe rishikim të planit, duke përfshirë përshkrimin e shërbimeve që mund të jetë e nevojshme për ndjekjen në vijimësi.

16. Pjesëmarrje të vazhdueshme në planifikimin e shërbimeve që jepen, si edhe pjesëmarrje në hartimin dhe rishikimin periodik të planit të objektivave.

17. Zgjedhja për të mos pranuar të marrin pjesë në punë kërkimore pa pëlqimin e informuar vullnetar me shkrim të pjesëmarrësës, prindit ose kujdestarit dhe e drejta për t'u mbrojtur e lidhur me këtë pjesëmarrje, si edhe e drejta dhe mundësia për ta rikthyer pëlqimin e dhënë.

18. Liria nga izolimi a veçimi. Izolimi dhe veçimi mund të përdoren vetëm në situata rreziku të afërt, në të cilat pjesëmarrësja mund të lëndojë veten ose të tjerët dhe për të parandaluar çrregullimin e regjimit në strehëz dhe vetëm atëherë kur janë shteruar të gjitha metodat e tjera kontrolluese kufizuese.

Detyrimet (përgjegjësitë) e përfituesit

1. T'i trajtojnë ata që u japin shërbimet me respekt dhe dinjitet.

2. T'u japin ofruesve të shërbimeve informacionin që u duhet. Kjo i ndihmon ofruesit t'u realizojnë shërbimet më të mira të mundshme.

3. Të bëjnë pyetje për shërbimet. Kjo i ndihmon t'i kuptojnë shërbimet.

4. Të ndjekin planin e shërbimit. Pjesëmarrësi dhe ofruesi duhet të bien dakord për planin e shërbimit.

5. Të ndjekin planin e mjekimit të miratuar nga mjeku.

6. T'i tregojnë ofruesit dhe mjekut për ndryshimet në mjekim, duke përfshirë edhe barnat që u kanë dhënë të tjerët.

7. Të respektojnë takimet e lëna. Pjesëmarrësit duhet t'i telefonojnë sa më parë ofruesit me të marrë vesh që u duhet ta anulojnë një takim.

8. T'i informojnë ofruesit kur plani i shërbimit nuk po i kënaq.

9. Ta informojnë ofruesin për problemet që kanë për të paguar tarifat, nëse ka.

10. Të kallëzojnë mashtrimet dhe abuzimet.

11. Të raportojnë haptazi shqetësimet për cilësinë e shërbimeve që marrin.

Kujdesi për fëmijët

- Sikurse ju kemi informuar më lart, strehëza ofron shërbime të kujdesit të fëmijëve. Hë për hë, strehëza nuk mund t'u ofrojë shërbime kujdesi të gjithë fëmijëve në strehëz. Prioritet u jepet nënave që punojnë, pas të cilave prioritet u jepet nënave që kanë takim. Është përgjegjësia e vetë banores të caktojë orën për kujdesin e fëmijës dhe ta anulojë takimin nëse vendos se ky shërbim

nuk i nevojitet. Me këtë ndihmoni banoret e tjera të cilat mund të kenë nevojë për kujdes për fëmijët e tyre atë ditë. Ju lutemi dorëzojeni formularin që ju është dhënë, ku shpjegohet orari gjatë të cilit do të ofrohet kujdesi për fëmijët atë ditë.

- Strehëza mund t'u japë mundësi me raste banoreve të tjera të kujdesen për fëmijët tuaj. Duhet të informohet një punonjëse mbrojtëse nëse një banore tjetër ka ndër mend të kujdeset për fëmijët tuaj. Kujdesi për fëmijët midis banoreve mund të bëhet e shumta për 3 orë nëse nuk bëhet përjashtim nga një punonjëse mbrojtëse. Banoret duhet të plotësojnë një marrëveshje banore me banore ÇDO herë që ia lejojnë një banoreje tjetër të kujdeset për fëmijën a fëmijët e saj. Nuk i lejohet një banoreje tjetër të kujdeset për më shumë se 5 fëmijë njëherësh, përfshirë këtu edhe fëmijët e vet. Banoret të cilat kanë rënë dakord të kujdesen për fëmijët kanë të drejtën të vendosin të mos e ofrojnë këtë shërbim kur mendojnë se nuk mund ta ofrojnë më (këtu jepet marrëveshja "banore me banore").

- Sikurse thuhet në standardet e strehëzës, nënat duhet medoemos t'i vëzhgojnë fëmijët e tyre në çdo kohë. Mosndjekja e kësaj kërkesë mund të konsiderohet moskujdesje.

- Fëmijët mund të luajnë vetëm në vendet e përcaktuara për këtë gjë, në strehëz. Fëmijët nuk mund të luajnë në parking dhe përreth barakave të shërbimit apo mbrapa shtëpive.

Llojet e lodrave që nuk lejohen:

- patinat, skejtboardet, skuterat;
- lodrat armë/lodrat shpatë.
- Llojet e aktiviteteve që nuk lejohen:
- lufta;
- mundja;
- lëvizja me skejtboard;
- lëvizja me biçikletë brenda oborrit të strehëzës.

Vendet ku nuk mund të luhet:

- rruga dhe trotuari;
- parkingu.

Si pritët të mbikëqyrin fëmijët nga prindërit e tyre, gjatë lojës:

- t'i kenë në rrezen e shikimit;
- t'i kenë pranë vetes;
- pjesëmarrëset e rritura duhet të jenë jashtë kur jashtë janë edhe fëmijët;
- duhani nuk lejohet në vendet e caktuara ku lozin fëmijët.

Shkolla

- Staf i strehëzës i ndihmon nënat t'i regjistrojnë fëmijët në shkollën më të afërt mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit. Banoret duhet t'i regjistrojnë në shkollë fëmijët e tyre brenda 2 ditësh pasi hyjnë në strehëz. Nënat mbeten përgjegjëse për rrezikun që u kanoset fëmijëve të cilët shkojnë në shkollë vetëm, të shoqëruar apo që nuk shkojnë për një periudhë kohe. Staf mund t'i asistojë nënat për regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Nënat sigurojnë transportin për në shkollë më këmbë.

Ushqimi

- Strehëza ju siguron juve dhe fëmijëve tuaj ushqim nga furnizimet e veta gjersa ju të keni të ardhura për të përmbushur nevojat tuaja ushqimore.

- Blerja dhe përgatitja e ushqimeve është aktivitet i përbashkët, me gratë e tjera të strehëzës.
- Ju lutemi, kuzhinën mund ta përdorni lirisht gjer në orën 21:00.
- Mund të përdorni dollapin e ushqimeve dhe frigoriferin (mbulojini të gjitha ushqimet me qese)
- Ju lutemi, vendosni emrin tuaj në ushqimet që do të vendosni në frigorifer, ndërsa konservat vendosini në dollapin e kuzhinës.
- Ju lutemi, pastrojeni kuzhinën mbasi ta keni përdorur.
- Nëse banorja dëshiron ushqime të tjera shtesë apo gjellë të veçanta, këtë duhet ta sigurojë vetë.

- Nëse banorja ka nevoja ushqimore të veçanta për arsye mjekësore, ju lutemi, informojeni stafin për këtë, në mënyrë që të mund të merren masat e nevojshme të arsyeshme.

Asistenca financiare

Duhet të keni mundësi të kërkonit asistencë financiare. Mirëpo, kjo, me ligjet shqiptare, është e ndërlikuar për shkak të dispozitave antikushtetuese të cilat i japin mundësi vetëm bashkëshortit ta kërkojë ndihmën financiare, nëse çifti nuk është shkurorëzuar. Ky problem është në proces zgjidhjeje. Nëse ju duhet ndihmë për të arritur këto burime, ju lutemi flisni me administratorin e rastit tuaj.

Transporti

Sipas ligjit “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, policia ka detyrimin për të bërë transportimin për në strehëz dhe për të siguruar mbrojtjen në situatat ku ka rrezik për jetën.

Hyrje-daljet

- Banoret të cilat kanë ndër mend të largohen nga strehëza për të dalë në komunitet, duhet të përdorin “portën e këmbësorëve” nëse largohen më këmbë nga strehëza. Për të dalë nga porta duhet të shtypin butonin mbi kutinë që ndodhet brenda derës përpara portës së këmbësorëve dhe pastaj ta hapin derën. Kur të ktheheni duhet të shtypni butonin e citofonisë mbi kutinë e citofonisë jashtë portës dhe roja do t’ju hapë derën.

Vendet ku pihet duhani

- Strehëza ka vende ku lejohet duhani. Këto janë (shkruani vendet). Duhani nuk lejohet në asnjë mjedis tjetër jashtë dhe brenda shtëpive.

Kontributet për komunitetin

- Është përgjegjësi e çdo banoreje të marrë pjesë në mbajtjen e pastërtisë në komunitet. Të gjitha banoreve do t’u caktohen detyra konkrete për komunitetin, në bazë të rotacionit. Disa prej këtyre detyrave përfshijnë pastrimin e kuzhinës, nxjerrjen e plehrave etj. Nëse një banore vendos të kryejë detyra shtesë në komunitet, ato do të shpërblehen përmes një sistemi dyqani me pikë, i cili është për çdo banore. Banoret marrin kupona sa herë kryejnë kontribute të ndryshme shtesë dhe u lejohet t’i shpenzojnë këto kupona në dyqanin me pikë. Për shembull, kontribute të tilla do të ishin pastrimi i plintusave apo i skarave të ajrimit.

Përdorimi i telefonit

- Strehëza e ka për kënaqësi t’ju ofrojnë shërbimin e telefonit për telefonata personale. Banoreve nuk u lejohet ta zhbllokojnë numrin në këto telefona. Kjo do të ishte shkelje e fshehtësisë së informacionit dhe mund të çojë në largim të detyrueshëm nga strehëza. Banoret janë të lutura të tregojnë respekt dhe mirësjellje ndaj të gjitha banoreve të tjera, duke mos e monopolizuar telefonin. Telefonatat duhet të kufizohen maksimumi 10 minuta, nëse janë duke pritur të tjera për ta përdorur telefonin.

Përdorimi i kompjuterit

- Strehëza e ka për kënaqësi të ofrojë shërbime interneti për përdorim vetjak dhe për të punuar për planin tuaj të shërbimit. Banoret duhet të regjistrohen për të përdorur kompjuterin në zyrën e administratorit të rastit. Secila banore mund ta përdorë kompjuterin për 30 minuta nëse nuk është pritur kush tjetër për ta përdorur kompjuterin. Banoret mund ta përdorin kompjuterin edhe më gjatë, me lejen e administratorit të rastit, nëse banorja punon për planin e shërbimit. Nuk lejohet të përdoret asnjë hapësirë në internet e cila mund të konsiderohet e dhunshme ose pornografike. Nuk lejohen programet e shkëmbimit të mesazheve të çastit (messenger) apo shkarkimet në kompjuter. Të gjithë fëmijët duhet të mbahen nën mbikëqyrje kur janë duke përdorur telefonin apo kompjuterin.

Sendet vetjake të banoreve

- Strehëza nuk mban përgjegjësi për humbjen a vjedhjen e sendeve. Banoret mund t’i vendosin sendet e tepërta në magazinë gjatë qëndrimit të tyre, deri në 30 ditë pasi largohen nga strehëza. Pas 30 ditëve, sendet personale do të hidhen poshtë. Nxiten banoret t’i vendosin në magazinë sendet e tepërta, për të evituar vjedhjen dhe rrëmujën. Sendet, të tilla si: letërnjoftime, karta krediti, çanta dore etj., duhet t’i mbajë banorja me vete gjatë çdo çasti ose t’i vendosë në një vend të sigurt. Stafit nuk duhet të ruajë sende brenda zyrave të stafit.

- Çdo banoreje që dëshiron, do t'i caktohet një dollap personal me kyç. Kjo mundësi u jepet vetëm atyre banoreve të cilat nuk kanë automjete personale ku të mund t'i vendosin sendet vetjake të tyre.

Siguria

- Strehëza ka vendosur procedura sigurie, në rast të hyrjes së një personi të jashtëm të padëshiruar në mjedise. Normalisht, strehëza funksionon sipas hipotezës “çdo gjë në rregull”, që do të thotë se nuk ka shenja të një të paftuari apo rreziku të ditur. Nëse stafi mëson për një rrezik të mundshëm, mund të shpallet “alarm i kodit të verdhë”. Ky alarm do të thotë se është identifikuar një rrezik i mundshëm i hyrjes së një të paftuari në strehëz. Banoret dhe stafi mund të vazhdojnë të kryejnë veprimet e përditshme, duke treguar kujdes shtesë dhe duke qëndruar brenda mjediseve nëse nuk është e nevojshme të dalin. Nëse shihet një person i jashtëm i padëshiruar rreth mjediseve ose brenda tyre dhe nëse ekziston mundësia për rrezik, stafi mund të shpallë “kodin e kuq” që do të thotë se të gjitha banoret duhet të futen brenda strehëzës dhe të presin gjersa të shpallet largimi i rrezikut. Kur është shpallur “kodi i kuq” banoret dhe stafi duhet të qëndrojnë medoemos në mjediset e strehëzës dhe askujt nuk i lejohet të largohet nga mjediset. Secila shtëpi e strehëzës ka një “vend të sigurt” ku duhet të mblidhen banoret.

- Vlen gjithmonë të theksohet se strehëza mbështetet te fshehtësia e informacionit për vendndodhjen e saj, për t’ju mbajtur juve dhe fëmijët tuaj jashtë rrezikut. Është absolutisht e nevojshme të mbahet i fshehtë informacioni për vendndodhjen e strehëzës. Thyerja e fshehtësisë së informacionit mund të çojë në largimin e paplanifikuar nga strehëza.

- Strehëza nuk lejon asnjë lloj arme në mjediset e veta. Armët e zjarrit, armët e ftohta apo çdo gjë tjetër që mund të konsiderohet si armë mund të konfiskohet dhe kjo mund të përbëjë arsye për largim të paplanifikuar.

- Strehëza e vlerëson qëndrimin jashtë rrezikut të gjithë banoreve dhe stafit dhe bën ushtrime për mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin në rast zjarri. Evakuimi në rast zjarri bëhet atëherë kur sistemi kundër zjarrit ndjen se ka një problem, ndërsa ushtrimi kundër zjarrit është një aktivitet i paraplanifikuar. Politika për evakuimin në rast zjarri u kërkon banoreve që nëse bie një alarm i cili tregon nevojën për t’u evakuuar, të largohen menjëherë të gjitha nga ndërtesa dhe të paraqiten në zonën e caktuar për t’u mbledhur, që ndodhet në (shkruani pikën e mbledhjes). Nuk lejohet rihyrja në ndërtesa gjersa që shpallet kalimi i situatës së rrezikshme nga zjarrfikësit. Rugët e largimit në rast rreziku afishohen në të gjithë strehëzën dhe paraqesin rugët e largimit për të shkuar në pikën e mbledhjes. Gjatë evakuimit në rast zjarri do të ndihmohet çdo banore me probleme që e pengojnë për të lëvizur. Krahas politikës së evakuimit në rast zjarri, periodikisht kryhen ushtrime kundër zjarrit për t’u ushtruar banoret që të jenë të gatshme për t’u larguar përmes të gjitha pikave të daljes, duke përfshirë edhe masat që duhen marrë nëse është bllokuar rruga parësore e largimit. Ushtrimet kundër zjarrit zhvillohen nga çdo përgjegjës objekti dhe një anëtar i stafit të objektit apo ekipit drejtues duhet të shpallë kalimin e rrezikut, për të treguar se lejohet kthimi. Zbatimi nga ana e banoreve dhe stafit e politikës së evakuimit në rast zjarri dhe ushtrimeve kundër zjarrit është i detyrueshëm dhe moszbatimi i tyre vendos në rrezik si banoret, stafin dhe strehëzën. Secila strehëz duhet të ketë një plan specifik evakuimi në varësi të ndërtesës.

Hapësira në dollap dhe frigorifer

- Strehëza ofron hapësirë të mjaftueshme në frigorifer dhe dollap për banoret që hyjnë në strehëz. Banoret duhet t’i mbajnë artikujt ushqimorë në vendin e caktuar. Vjedhja e ushqimeve të një banoreje tjetër mund të sjellë largimin e paplanifikuar.

Mbledhjet e shtëpisë

- Frekuentimi i mbledhjeve të shtëpisë rekomandohet jashtë mase dhe, në disa raste, është i detyrueshëm. Mbledhjet e shtëpisë zhvillohen më (dita, ora, vendi). Nëse nuk mund të merrni pjesë në mbledhjet e shtëpisë, stafi do takohet individualisht me ju për t’ju informuar për problemet e rëndësishme të diskutuara në mbledhje. Mbledhjet organizohen që banoret dhe stafi të shkëmbejnë informacion, të diskutojnë për shqetësimet në lidhje me drejtimin e strehëzës dhe çështjet e lidhura me jetesën në komunitet. Krahas këtyre, mbledhjet e shtëpisë shërbejnë edhe si

momenti kur administratorët e rasteve dhe përgjegjësi i strehëzës japin informacion edukativ për dhunën në familje.

Orari i sigurt, kalimi i natës jashtë strehëzës dhe orari i gjumit

- Për respekt të banoreve të tjera, ju lutemi ta ulni volumin e televizorëve dhe radiove pas orës 22:00. Ju lutemi, dushin ta bëni përpara orës 22:00 dhe të tregoni vëmendje ndaj faktit se personat me të cilët ndani dhomën mund të jenë në gjumë, pra ju lutemi të tregoni kujdes kur të hyni në dhomën e gjumit pas orës 22:00.

- Vetëm dy net lejoheni t'i kaloni jashtë strehëzës gjatë qëndrimit tuaj në strehëz. Kalimi i natës jashtë strehëzës, për shkak të turnit të tretë apo urgjenca mjekësore, nuk llogaritet në këtë sasi të lejuar të netëve jashtë strehëzës, nëse jepet dokumentacioni i duhur. Banoreve të cilat e kalojnë numrin e netëve të kaluara jashtë strehëzës për shkak të urgjencave mjekësore mund t'u kërkohej të paraqesin dokumentacion dhe u kërkohej të lidhen përditë me përgjegjësin e strehëzës ose t'i lënë mesazh në sekretarinë telefonike.

- Orari i sigurt për banoret është deri në 24:00 gjatë ditëve të javës dhe deri në 1:00 të premte dhe të shtunë.

- Orari i gjumit është në dorë të çdo prindi. Por, pritet nga fëmijët që të mos bëjnë zhurmë pas orës 21:00, në respekt të orarit të gjumit të të tjerëve.

Largimi nga strehëza

- Lajini dhe kthejini shtrijat e shtratit;

- Pastrojeni dhomën tuaj;

- Futini në valixhe/çanta të gjitha sendet tuaja;

- Plotësoni dokumentacionin e daljes, duke përfshirë edhe planin e sigurisë të daljes.

Detyrimet e stafit ndaj përfituesve

Përfshirje

Të gjithë punonjësit duhet të respektojnë udhëzimet e mëposhtme gjatë realizimit të detyrave të tyre. Punonjësit nxiten të bëjnë pyetje lidhur me sjelljen etike dhe kufijtë gjatë ndërveprimit me eprorët e tyre. Moszbatimi i udhëzimeve të mëposhtme mund të çojë në masa korrigjuese, deri në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

1. Punonjësit duhet t'i realizojnë gjithmonë detyrat me mirësjellje dhe respekt për pjesëmarrëset, për publikun dhe për kolegët, dhe pa asnjë diskriminim në fjalët që thonë dhe në sjelljen e tyre.

2. Punonjësit duhet t'u japin pjesëmarrëseve pëlqimin e informuar, i cili të përfshijë një recitim me gojë të shqetësimeve të pjesëmarrëses dhe planin e propozuar të veprimit, duke përfshirë rezultatin e synuar, natyrën e planit të propozuar dhe procedurat e përfshira në planin e propozuar, çdo rrezik apo efekte anësore që mund të vijnë nga plani i propozuar dhe çdo alternativë ndaj planit të propozuar.

3. Punonjësit duhet të respektojnë të drejtën e pjesëmarrëses për vetëvendosje dhe të drejtën e pjesëmarrëses për t'i pranuar ose refuzuar shërbimet.

4. Punonjësit duhet të jenë të ndërgjegjshëm se në marrëdhëniet e tyre me pjesëmarrëset pushteti dhe statusi janë jo të barabartë. Për rrjedhojë, duhet të pranojnë se marrëdhëniet e dyfishta ose të shumëfishta mund të rrisin rrezikun e lëndimit ose të shfrytëzimit të pjesëmarrëseve dhe mund ta pengojnë gjykimin e tyre profesional. Por, në disa komunitete e situata, mund të mos jetë e realizueshme shmangia e kontaktit social apo jo profesional me pjesëmarrëset.

5. Punonjësit duhet ta mbështesin besimin e nënkuptuar në marrëdhënien e ndihmës përmes shmangies së marrëdhënieve të dyfishta të cilat mund ta pengojnë gjykimin profesional, mund të rrisin rrezikun e lëndimit të pjesëmarrëseve apo mund të çojnë në shfrytëzim.

6. Punonjësit duhet t'i njohin kulturat ose komunitetet ku ushtrojnë aktivitet. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e kulturave në shoqëri dhe për ndikimin që ka ky fakt në komunitet, si edhe te individët brenda komunitetit. Ata duhet t'i respektojnë individët dhe grupet, kulturat dhe besimet e tyre.

7. Punonjësit duhet t'i realizojnë detyrat në mënyrë të atillë që u shërben më mirë interesave të pjesëmarrëseve, dhe jo për t'u shërbyer interesave të vetë punonjësve.

8. Punonjësit duhet të veprojnë me ndershmëri, sinqeritet dhe objektivitet me pjesëmarrëset dhe kolegët, për të nxitur interesin më të mirë të pjesëmarrës.

9. Punonjësit duhet të ruhen me korrektesë nga çdo informacion shfrytëzues që jep pjesëmarrësja dhe nuk duhet ta shfrytëzojnë postin e veçantë dhe pushtetin që u jep situata për të mos ndikuar te pjesëmarrësja në asnjë mënyrë e cila nuk do të ndihmonte drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të pjesëmarrës.

10. Punonjësit nuk duhet t'i braktisin apo neglizhojnë pjesëmarrëset. Ata duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të organizuar vazhdimin e shërbimit nëse ata vetë nuk mund ta japin këtë shërbim. Duhet bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar shërbime për ato pjesëmarrëse të cilat nuk i përmbushin më kriteret për shërbimet e strehëzës apo të cilat kanë nevojë për shërbime të ndryshme.

11. Punonjësit nuk duhet të përzihen në aktivitete seksuale me pjesëmarrëset dhe as në aktivitete të cilat mund të perceptohen nga pjesëmarrëset apo nga persona të tjera, si ngacmime seksuale. Marrëdhëniet seksuale me pjesëmarrëse ekzistuese apo të mëparshme nuk konsiderohen se janë në interesin më të mirë të pjesëmarrës dhe janë të ndaluara rreptësisht.

12. Punonjësit nuk duhet ta përdorin marrëdhënien profesionale për t'u imponuar pjesëmarrëseve besimet e veta, duke përfshirë besimet politike, ideologjike dhe fetare.

13. Punonjësit duhet të respektojnë jetën private të pjesëmarrëseve dhe të ruajnë me fshehtësi çdo informacion që marrin nga pjesëmarrëset, kolegët apo persona të tjerë në rrjedhën e ofrimit të shërbimeve profesionale. Punonjësit nuk duhet t'ia tregojnë askujt informacionin e mbajtur të fshehtë lidhur me pjesëmarrëset, me përjashtim:

a) kur këtë e kërkon ose e lejon ligji;

b) kur duhet parandaluar një rrezik i qartë dhe i afërt që i kanoset një personi apo disa personave;

c) kur është në cilësinë e të pandehurit ose të dëshmitarit në një proces civil, penal ose disiplinor që lind nga shërbimet e dhëna (në këtë rast, informacion i mbajtur i fshehtë në lidhje me pjesëmarrësen mund të jepet vetëm në rrjedhën e këtij procesi) ose kur e lejon ligji;

d) kur duhet dhënë sipas parimit "nevoja për të ditur" me punonjës të tjerë të cilët janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve për pjesëmarrësen ose të cilët janë duke hetuar shqetësimet ose ankesat e pjesëmarrës;

e) kur duhet dhënë informacion minimal i nevojshëm për të shqyrtuar kërkesat për pagesë.

14. Punonjësit duhet të mbajnë një marrëdhënie profesionale dhe të sjellshme me pjesëmarrëset, në çdo kohë, dhe duhet të ruajnë kufijtë e duhur profesionalë me pjesëmarrëset ekzistues dhe ato të mëparshme. Nëse një punonjës ka pyetje lidhur me atë se çfarë është një kufi i duhur për një rast specifik, për këtë duhet të konsultohet me eprorin e drejtpërdrejtë. Lista e mëposhtme e shkeljeve të kufijve profesionalë nuk është shteruese, por jepet vetëm si listë orientuese.

a) Favorizimi i një ose disa pjesëmarrëseve të caktuara

b) Nëse i jepet një pjesëmarrëseje informacion për veten, si për shembull, numri i telefonit në shtëpi apo adresa e shtëpisë.

c) Përzierja në marrëdhënie joprofesionale (domethënë, marrëdhënie miqësie, marrëdhënie seksuale) me një pjesëmarrëse ekzistuese apo të mëparshme, brenda mjedisve ose jashtë tyre. Me pjesëmarrëset e mëparshme, punonjësi duhet të ndjekë udhëzimet e parashtruara në Kodin Etik dhe/ose kodin etik profesional të punonjës.

d) Pranimi i dhuratave nga një pjesëmarrëse, të cilat e kalojnë vlerën 2500 lekë. Çdo pranim dhurate duhet bërë me njoftimin e eprorit. Nuk duhen pranuar dhuratat nga pjesëmarrëset, kur pranimi i dhuratës nuk këshillohet dhe kur kjo nuk është në interesin më të mirë të pjesëmarrës apo pjesëmarrëseve. Dhuratat që u jepen pjesëmarrëseve, u jepen nga organizata dhe jo nga një punonjës i veçantë.

e) Përfshirja në një bashkëbisedim me një pjesëmarrëse për një punonjës tjetër ose për një pjesëmarrëse tjetër. Kjo do të përbënte edhe shkelje të fshehtësisë së informacionit për pjesëmarrëset dhe/ose punonjësit e tjerë.

f) Përfshirja në një shkëmbim parash me një pjesëmarrëse, me përjashtim të arkëtimit të tarifave për shërbimet e dhëna.

15. Punonjësit mund të marrin pjesë, me raste, në aktivitete të planifikuara sociale ose zbavitëse me pjesëmarrëset, siç janë aktivitetet për gjetje fondesh, aktivitetet e bamirësisë dhe aktivitete të ngjashme. Nëse përfshihen në aktivitete të tilla, pritjet prej punonjësit që ky të sillet brenda kufijve të duhur profesionalë me pjesëmarrëset dhe të mos përzihet në konsumimin e alkoolit apo drogave të paligjshme në praninë e pjesëmarrësve dhe në asnjë moment gjatë aktivitetit.

16. Punonjësit nuk duhet të përfshihen apo të kërkojnë marrëdhënie dashurie me një pjesëmarrëse. Nëse e bëjnë një gjë të tillë, kjo çon në shkëputjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës dhe njoftimin e këshillave përkatës të licencimit dhe certifikimit.

17. Punonjësit nuk duhet të t'u japin hua pjesëmarrësve fonde apo sende të tyre vetjake dhe as nuk duhet të marrin hua nga pjesëmarrëset fonde apo sende. Punonjësit nuk duhet të japin dhe as të marrin shërbime personale nga pjesëmarrëset ekzistuese.

18. Kur lind një konflikt midis përmbushjes së përgjegjësisë përpara punëdhënësit dhe përgjegjësisë përpara pjesëmarrëses, punonjësi duhet t'i njoftojë të dy për këtë konflikt dhe të punojë së bashku me të gjithë personat e përfshirë për ta menaxhuar konfliktin.

Ankesat

Pjesëmarrëset kanë të drejtën për ankesë formale nëse kanë një ankesë për shërbimet apo nëse mendojnë se u janë mohuar pa të drejtë shërbimet. Formularët e ankesave mund t'i gjeni në tabelat e njoftimeve ose mund t'i kërkonin një punonjësi mbrojtës t'ju japë një formular. Pasi ta ketë mbushur formularin, banorja duhet t'ia japë atë punonjësit mbrojtës i cili ia përcjell drejtorit. Drejtori do t'ju përgjigjet brenda 5 ditësh. Nëse nuk është e kënaqur me përgjigjen, banorja ka të drejtën të paraqesë një ankesë pranë Bordit.

Çdo pjesëmarrëse e strehëzës e cila mendon se është diskriminuar, abuzuar, i janë mohuar shërbimet e arsyeshme dhe të duhura (është neglizhuar) ose është shfrytëzuar mund të depozitojë një ankesë zyrtare pa u shqetësuar se do të diskriminohet. Kjo përfshin, pa kufizim, përshtatjet e duhura të arsyeshme për një aftësi të kufizuar. Staf i strehëzës mund ta asistojë pjesëmarrësen gjatë një ankimi pa frikën e diskriminimit.

Nxitet pjesëmarrësja t'i zgjidhë ankesat në mënyrë joformale me palën ose palët e tjera dhe/ose me koordinatorin e programit, përpara depozitimit të një ankese formale.

Procedura e depozitimit të një ankese formale

(Mund të merret asistencë për depozitimin e ankës duke i kërkuar një anëtar të stafit për të asistuar në shkrimin e ankës).

Ankesa formale duhet të përfshijë:

1. Natyrën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri te ankesa;
2. Datën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri te ankesa;
3. Palën kundër së cilës depozitohet ankesa; dhe
4. Emrin e plotë, adresën dhe numrin e telefonit të personit që ankohet.

Ankesa duhet të depozitohet pranë drejtorit, jo më vonë se 10 ditë pas incidentit që ka shkaktuar ankesën e lidhur në mënyrë specifike me shërbimet e programit.

Pas marrjes së ankës, drejtori vendos brenda 3 ditësh pune:

1. Nëse mund ta zgjidhë apo jo çështjen personalisht. Nëse e trajton personalisht çështjen, duhet t'ia paraqesë konstatimet e veta pjesëmarrëses brenda 5 ditësh pune.

2. Nëse do të caktohet një komision ankese, për ta zgjidhur çështjen. Nëse caktohet një komision ankese, mbledhja e komisionit të ankës duhet të bëhet brenda 2 ditësh pune për të hetuar ankesën dhe komisioni i ankës duhet të raportojë për konstatimet e veta brenda 3 ditësh pune.

Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje e ankesës në nivel drejtori të programit apo drejtori të strehëzës apo komisioni të ankesës, ankesa duhet t'i kalohet Bordit i cili i shqyrton konstatimet/rekomandimet e mëparshme dhe ia paraqet me shkrim rekomandimet/konstatimet e veta pjesëmarrësës brenda 5 ditësh pune.

Një kopje e kësaj politike duhet të mbetet e afishuar në ambientet që përdoren kryesisht nga pjesëmarrëset. Një kopje e kësaj politike i jepet pjesëmarrësës gjatë pranimit.

Pjesëmarrësit nuk duhet të largohen nga programi gjatë procesit të ankimit, me përjashtim të rastit kur përfundon afati i programit ose kur pjesëmarrësja kthehet në një rrezik për strehëzën gjatë procesit të hetimit.

Unë i nënshkruari, vërtetoj që informacioni i shkruar më sipër është diskutuar me mua në detaje nga stafi i organizatës dhe që kuptoj plotësisht të drejtat dhe detyrimet e mia, detyrimet e stafit karshi meje, shërbimet e disponueshme, rregullat e strehës dhe procedurat e ankimit. Unë e kuptoj që rregullat synojnë mbrojtjen dhe respektimin e të gjithë përfituesve në strehë, përfshirë dhe mua. Gjithashtu, unë kam marrë me shkrim një përshkrim të plotë të procedurës së ankimit që është e disponueshme për mua.

Unë (këtu shkruani emrin e përfituesit), pranoj me vullnetin tim rregullat dhe detyrimet e deklaruara më sipër, dhe dëshiroj të jem përfitues i programit dhe të qëndroj në këtë strehë duke filluar nga dita e sotme.

Përfituesi:

Emri me shkronja shtypi

Firma

Data

Përfaqësuesi i strehës

Emri me shkronja shtypi

Firma

Data

ANEKSI 3 DEKLARATË PRANIMI PËR TË MITURIT

Unë (emri i përfituesit), lindur më (datë) në (qyteti dhe vendi), së bashku me (emër i prindit ose kujdestari ligjor), deklaroj sot më (datë) që më janë shpjeguar dhe kuptoj plotësisht programin e (emri i organizatës), si dhe të drejtat, detyrimet e mia, dhe kushtet për të përfituar nga programi i tyre. Unë i kuptoj dhe jam i pranoj këto të drejta, detyrime dhe kushte, siç përshkruhen në faqet e mëposhtme.

Qëllimi i organizatës

Synimi kryesor i Strehëzës Kombëtare kundër Dhunës në Familje është të ofrojë nëpërmjet shërbimeve, ndërhyrjes dhe trajtimit në programet kundër dhunës në familje mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe e fëmijëve të tyre, duke rritur, në të njëjtën kohë, llogaridhënien e abuzuesve për dhunën që kanë ushtruar. Synimi i dytë lidhet me fuqizimi e pjesëmarrëseve që të ecin drejt pavarësisë dhe mbështetjes te vetvetja.

Ekspertiza e organizatës dhe stafit të saj

Strehëza rezidenciale është një objekt i cili u ofron pjesëmarrëseve dhe fëmijëve të tyre një vendqëndrim të përkohshëm të sigurt, jashtë rrezikut, duke u ofruar, në të njëjtën kohë, edhe përmbushjen e nevojave, të tilla si: ushqim dhe veshmbathje. Strehëza qëndron hapur 24 orë në ditë, shtatë ditët e javës. Ajo është e pajisur me personelin e programit.

Stafi i strehëzës përbëhet nga një ekip multidisiplinar, anëtarët e të cilit kanë profesione dhe eksperiencë të ndryshme, të tilla si: punonjës socialë, këshillues, menaxherë rasti, specialistë për

fëmijë dhe kujdestarë. Të gjithë anëtarët e stafit duhet të kenë mbaruar studimet në punë sociale ose shkenca sociale, bachelor ose master (në varësi të pozicionit dhe përgjegjësisë), si dhe eksperiencë pune të paktën 2 vjet në shërbime të ngjashme.

Shërbimet e ofruara drejtpërdrejt nga organizata

Fuqizimi është baza e shërbimeve në strehëz. Fuqizimi është aftësia për të pasur ndikim te forcat, të cilat prekin jetën e personit, në favor të këtij të fundit. Punonjësit e programeve duhet ta kuptojnë se dhuna në familje është e rrënjësuar në sistemin shoqëror, çka përforcon pabarazinë e grave dhe fëmijëve në shoqëri, dhe nuk vjen nga psikopatologjia e pjesëmarrësve të strehëzës apo e dhunuesve të tyre. Ata duhet të kuptojnë edhe rëndësinë e së drejtës së pjesëmarrësve të strehëzave për vetëvendosje dhe për të marrë vendimet për veten.

Në lëvizjen kundër dhunës në familje, fuqizimi nënkupton edukimin pa forcë dhe mbështetjen e pjesëmarrësës për të vendosur vetë drejtimin e tyre, pa ushtruar mbi to asnjë kontroll psikologjik, fizik apo emocional. Fuqizimi në punën e avokatisë përfshin asistencën që u jepet pjesëmarrësve në fushat e vendimmarrjes, vetëbesimit, rritjes së mbështetjes dhe planifikimit për të qëndruar jashtë rrezikut.

Fuqizimi në planifikimin e rastit ka të bëjë me angazhimin e pjesëmarrësve si planifikuese parësore të synimeve dhe objektivave të tyre dhe dhënia e informacion vetëm në kuadër të qëllimit, në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë alternativat e mundshme. Për rrjedhojë, është mirë që pjesëmarrësve të mos u diktohet asnjëherë të marrin pjesë në shërbime apo të përjashtohen prej tyre. Kjo përputhet me standardet e shërbimeve sociale në Shqipëri.

Fuqizimi në hartimin e programit ka të bëjë me zhvillimin nga secili program të strukturave vendimmarrëse, të cilat të sigurojnë shpërndarjen e autoritetit dhe përgjegjësisë dhe t'i fuqizojë pjesëmarrëset, stafin, vullnetarët dhe anëtarët e bordit. Edhe kjo përputhet me standardet e Shërbimeve sociale në Shqipëri.

Për t'i përmbushur këto synime është mirë të nxiten pjesëmarrëset të marrin pjesë në hartimin e programit dhe në vendimmarrje, ose duke shërbyer si vullnetare dhe anëtare komiteti, ose duke u zgjedhur në organin vendimmarrës pasi të mos jenë duke i përdorur më aktivisht shërbimet e programit. Brenda një viti që merr shërbime nga strehëza, personi ka të drejtë të merret në punë nga kjo strehëz, brenda procedurave normale të marrjes në punë.

Pjesëmarrëset duhet të japin kontributin e tyre për hartimin e udhëzuesve që duhen përdorur në rastet kur pjesëmarrëset e programit nuk i respektojnë rregullat e programit ose nuk përmbushin përgjegjësi të caktuara. Kjo nuk duhet ta pengojë stafin të kërkojë zbatimin e rregullave ose politikave të brendshme në ato raste kur veprimet e një pjesëmarrëseje mund të vënë në rrezik sigurinë e saj ose atë të pjesëmarrësve të tjerë të programit, apo edhe vetë programin.

Shërbime jorezidenciale

Program rezidencial është programi që mund të jetë pjesë e strehëzës kundër dhunës në familje ose pjesë e një programi tjetër më vete që u shërben kryesisht viktimave të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre.

Shërbimet mund të përfshijnë:

- Linjë telefonike në rast krize/ndërrhyrje në rast krize;
- Grupe mbështetëse/terapeutike;
- Menaxhim rasti/avokati individuale;
- Avokati për sistemet;
- Shërbime juridike/shërbime asistence në gjykatë;
- Programim të fëmijëve;
- Shërbime të mbështetura në komunitet për pjesëmarrësit në tranzicion mbështetje/këshillim individual;
- Konsultime dhe trajnim në komunitet.

Programimi i fëmijëve përfshin ato aktivitete që përmbushin nevojat sociale, zhvillimore dhe materiale të fëmijëve që marrin shërbime nga një program kundër dhunës në familje.

Mbështetja individuale dhe ajo në grup është metoda sistematike e planifikuar për të lehtësuar ose zgjidhur problemet e identifikuar nga pjesëmarrësja e strehëzës me një konsulent individual dhe/ose me një grup pjesëmarrësish të tjerë të strehëzës.

Mbrojtja e interesave të rasteve individuale është mbrojtja e interesave në emër dhe për llogari të viktimës së dhunës në familje brenda sistemeve juridike, mjekësore shërbimeve sociale dhe sistemeve të tjera.

Mbrojtja e interesave në sistem ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të viktimave të dhunës në familje si grup ose klasë njerëzish, por jo individualisht. Kjo mund të përfshijë promovimin e politikave dhe procedurave standarde për rastet e dhunës në familje brenda sistemeve juridike, mjekësore, shërbimeve sociale ose sistemeve të tjera. Mund të përfshijë edhe edukimin ose trajnimin e personelit për të siguruar zbatimin e duhur të politikave dhe procedurave. Mbrojtja e interesave në sistem mund të përfshijë hartimin e protokolleve, trajnimin e punonjësve të sistemeve të tjera në lidhje me dinamikën e dhunës në familje dhe/ose lidhur me asistencën për zbatimin e protokolleve, të tilla që mund të kenë ndikim të shumë gra dhe fëmijët e tyre.

Menaxhimi i rastit. Të gjitha banoret që qëndrojnë në strehëz më shumë se 72 orë u caktohet një menaxher rasti. Përgjegjësia e menaxheres së rastit është ta ndihmojë banoren të krijojë një plan i cili do ta ndihmojë të kthehet nga strehëza në komunitet. Plani plotësohet pasi banorja ka kaluar 72 orë në strehëz. Menaxherja e rastit do të punojë me pjesëmarrëset për t'i ndihmuar të arrijnë objektivat. Për shembull, të ndihmojë me çështje të tilla si: punësimi, strehimi, kujdesi për fëmijët, arsimi dhe shqetësime të tjera që mund të kenë. Menaxherët e rasteve janë të ndjeshëm ndaj çështjeve të dhunës në familje. Ata dëgjojnë për të mësuar shqetësimet e pjesëmarrëseve, të përshtaten me jetën në strehëz, të hartojnë një plan sigurie për ta zbatuar pasi të largohen nga strehëza, orientojnë për agjencitë mbështetëse dhe ndihmojnë pjesëmarrëset të bëjnë ndryshimet që dëshirojnë. Objektivi është t'u plotësohen nevojat dhe t'i ndihmojmë t'i bëjnë ballë efektit që ka në jetën e tyre dhuna në familje. Nëse pjesëmarrëset dëshirojnë të vazhdojnë shërbimet pasi të jenë larguar nga strehëza, mund të takohen me menaxheren e rastit për të marrë informacion për shërbimet e strehëzës.

Shërbime të veçanta

- Grupi mbështetës ofrohet çdo (dita dhe ora) çdo javë. Grupi mbështetës mund të ketë deri në 10 persona dhe qendra e kujdesit për fëmijët do kujdeset për fëmijët tuaj gjatë kësaj periudhe, nëse kanë kapacitet. Banoret janë të lira të organizojnë vetë mbledhje të grupeve të tjera mbështetëse.

- Strehëza mund të ketë fatin të ketë disa stazhierë të këshillimit për shëndetin mendor të cilët ofrojnë këshillim falas për shëndetin mendor të banoreve. Nëse është kështu, këta stazhierë mbikëqyren nga një mbikëqyrës i kualifikuar. Takimet mund t'i organizoni përmes menaxherit të rastit tuaj.

- Ministria e Shëndetësisë ofron shërbime mjekësore për gratë dhe fëmijët e strehëzës. Orari është: (shkruani orarin).

Shërbimet e ofruara nëpërmjet referimit

Stafi i strehëzës, bazuar në nevojat specifike të çdo rasti/familjeje, duhet t'i referojë ata në organizata apo institucione publike, të tilla si:

- Institucione arsimore, çerdhe, kopshte apo shkolla publike;
- Institucione shëndetësore, si qendra shëndetësore të kujdesit parësor, spitale apo klinika të specializuara publike.
- Shërbimi ligjor falas pranë Ministrisë së Drejtësisë, Nisma Ligjore Qytetare, Klinika Ligjore për të Miturit.
- Shërbimi Social Shtetëror, në rastet e strehimit të përkohshëm për fëmijët, kujdestari, shtëpia e fëmijës etj.

Rregulla dhe kufizime

Në ruajtjen e frymës së filozofisë së fuqizimit dhe mbështetjes, është e rëndësishme që strehëza t'i shqyrtojë rregullat e vendosura për jetën brenda strehëzës, për të siguruar që këto

rregulla të mos jenë shtypëse dhe t'u japin mundësi pjesëmarrëseve t'i marrin vetë vendimet për vetveten. Sigurisht, është e rëndësishme që të ketë ca rregulla për jetesën në strehëz, për të ruajtur sigurinë e të gjithë pjesëmarrëseve në program. Por, strehëza duhet të mos i rikrijojë dinamikat e pushtetit që janë të pranishme në marrëdhëniet abuzuese. Për shembull, këto dinamika rikrijohen kur stafi i strehëzës merr përsipër rolin e “vendosësit të rregullave”, gjë që i vendos pjesëmarrëset në pozicionin e njohur për ta të “ndjekësit të rregullave”.

Strehëzat duhet të bëjnë kujdes që të mos vendosin rregulla, qëllimi i vetëm i të cilave është lehtësimi i funksionimit të strehëzës, pa i kushtuar kujdes sigurisë së banorëve.

Siguria dhe zvogëlimi i rrezikut duhet të jetë politikë e strehëzës.

Stafi duhet të marrë të gjitha masat e kujdesshme për të siguruar shëndetin dhe jetën e të gjithë stafit dhe pjesëmarrëseve, dhe duhet të përpiqet rregullisht të identifikojë dhe të zgjidhë faktorët e rrezikut të mundshëm që mund të prekin pjesëmarrëset ose shërbimet e ofruara. Stafi duhet të trajnohet në fillim dhe më pas rregullisht në lidhje me të gjithë komponentët e planit të administrimit të rrezikut.

1. Nuk lejohen fëmijët në zonën e kuzhinës, për arsye sigurie.

2. Ushqimet dhe pijet lejohen vetëm në këndin e ngrënies (nuk lejohen enët prej qelqi në verandë). Me përjashtim të ujit, nëpër dhomat e gjumit nuk lejohen ushqimet apo pijet. Nuk lejohen ushqimet apo pijet në bibliotekë/sallën e kompjuterit.

3. Të gjithë anëtarët e familjes duhet të veshin tesha dhe këpucë të përshtatshme në çdo kohë. Përgjegjësja e shtëpisë kontaktohet nëse ka nevojë për veshje apo këpucë për fëmijët.

4. Të tregohet kujdes në kursimin e energjisë, duke fikur aparatën e televizorit, dritat, pajisjet etj., gjatë kohës kur nuk përdoren.

5. Televizori në dhomën e gjumit të fiket në orën 10 të darkës. Televizori në këndet e përbashkëta (dhomën e familjes dhe dhomën e ndenjes) të fiket para mesnate nga e diela deri të enjten dhe brenda orës 1 të natës nga e premtdja deri të shtunën. Volumi i aparateve të televizorit duhet të mbahet brenda një niveli të arsyeshëm në çdo kohë, në mënyrë që të mos shqetësohen të tjerët.

6. Të gjitha dyert dhe dritaret duhet të mbahen të mbyllura dhe të siguruara në çdo kohë. Dritaret e mbrojtura me shufra hekuri mund të mbahen të hapura për ajrim.

7. Të mos hiqet apo zhvendoset asnjë orendi pa lejen e një anëtarit të stafit. Sendet, shtrojat, ushqimet etj., që iu janë dhënë për përdorim gjatë qëndrimit këtu janë pronë e strehëzës dhe nuk duhet të largohen nga strehëza gjatë qëndrimit tuaj këtu apo kur të largoheni prej këtu. Të lihet një takim me përgjegjësen e shtëpisë për të marrë sendet që mund të nevojiten për të ngritur familjet e re dhe stafi do të ndihmojë me ato që mundet.

8. Të gjitha ushqimet dhe pijet e blera nga strehëza të konsiderohen ushqime të shtëpisë dhe duhet të mbeten në mjediset e strehëzës për t'u përdorur nga banorët. Individët mund të blejnë ushqimet e tyre, nëse duan, por strehëza nuk garanton dhe nuk zëvendëson asnjë ushqim që ka blerë një banor dhe që nuk gjendet më. Asnjë ushqim nuk mund të hyjë në strehëz pa marrë në fillim lejen e stafit.

9. Për çdo hyrje-dalje në strehëz të përdoret dera kryesore e saj. Të gjithë banorët duhet të nënshkruajnë në librin e hyrje-daljeve në hollin e hyrjes, për të treguar se ku shkojnë kur dalin nga strehëza dhe se kur mund të kthehen. Orari i sigurt është (vendosni orarin e sigurt), nëse nuk është rënë dakord për një zgjatje të orarit të sigurt.

10. Telefoni në ambientet e banorëve mund të përdoret nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 10 të mbrëmjes (dhe duhet të shkëputet gjatë seancave në grup). Të respektohen nevojat e njëritjetrit dhe të kufizohen telefonatat pa i zgatur më shumë se 10 minuta. Telefoni duhet të qëndrojë në dhomën e familjes dhe të mos nxirret jashtë. Thirrjet telefonike me larg për arsye urgjente mund të bëhen nga telefoni i recepsionit vetëm pasi është marrë leja nga stafi dhe thirrjet telefonike me larg duhet të kufizohen në 3-5 minuta, duke qenë se koston e mbulon strehëza. Të gjitha thirrjet telefonike me larg duhet të dokumentohen në regjistrin e telefonatave me larg të mbajtur në recepsion.

11. Brenda strehëzës nuk lejohet duhani. Duhani lejohet (caktoni vendin). Në strehëz nuk lejohet djegia e asnjë sendi. Të mbahen të gjithë artikujt që mund të marrin flakë (çakmakë, qirinj, shkrepëse, djegëse aromatike, lule të thata etj.) në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.

12. Prej banorëve pritet që fëmijët nën 12 vjeç t'i fusin në dhomat e gjumit brenda orës 9 të mbrëmjes çdo ditë të javës.

13. Të gjitha dritat e dhomave të gjumit të fiken brenda orës 10 të mbrëmjes. Përrjashtim bëhet vetëm me miratimin e stafit dhe me miratimin e të gjithë personave që e përdorin dhomën në fjalë.

14. Fëmijët duhet të monitorohen dhe mbikëqyren nga prindërit ose kujdestari i caktuar, në çdo kohë. Fëmijët nën 6 vjeç nuk duhet të lihen vetëm në asnjë moment ndërkohë që janë në vaskë. Ju lutemi, të tregohet vëmendje e veçantë sa i takon fëmijëve dhe ujit. Marrëveshjet për kujdesin e fëmijës duhet të plotësohen me kujdes dhe të miratohen nga stafi nëse një banor përdor punonjës të kujdesit të fëmijës ose një banor tjetër për t'ia mbikëqyrur fëmijët. Fëmijët nën 6 vjeç nuk lejohet të qëndrojnë në shtretërit e lartë.

15. Kërkesat e veçanta (domethënë zgjatja e orarit të sigurisë) duhet t'i dorëzohen me shkrim menaxherit të rastit brenda ditës së mërkurë të çdo jave, për t'u shqyrtuar gjatë mbledhjes së stafit të enjteve.

16. Taksitë lejohen të vijnë në strehëz vetëm me miratimin e stafit dhe pas njoftimit paraprak.

Pesë përjashtime kryesore/rregulla

Ju lutemi, ta kuptoni se këto pesë rregulla janë për sigurinë e të gjithëve. Shkelja e këtyre rregullave mund të sjellë largimin e detyrueshëm nga strehëza. Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

1. Ju lutemi, respektojini banoret e tjera, stafin, vullnetarët dhe fëmijët, duke mos i kërcënuar apo duke mos kryer akte të dhunës fizike.

2. Respektojeni strehëzën, duke mos e dëmtuar apo shkatërruar mjediset e saj.

3. Respektojeni pronën vetjake të të tjerëve, duke mos vjedhur prej banoreve të tjera, stafit/vullnetarëve të strehëzës apo nga vetë strehëza.

4. Për sigurinë tuaj, strehëza nuk lejon përdorimin apo mbajtjen e drogave, alkoolit ose armëve në mjediset e saj.

5. Merrni vendime të mira për sigurinë tuaj vetjake dhe mos e shkelni fshehtësinë e informacionit për strehëzën dhe banorët.

Të drejtat e pjesëmarrësës

Strehëza duhet të ofrojë një mjedis jetese i cili i fuqizon pjesëmarrëset, nxit vetëvendosjen dhe u jep pjesëmarrëseve të drejtat e mëposhtme, në përputhje me standardet e licencimit:

1. Të trajtohen me dinjitet, respekt dhe konsideratë.

2. Të marrin shërbime pa diskriminim të mbështetur në racën, ngjyrën, kombësinë, gjuhën, gjininë, orientimin seksual, bindjet politike, fetare apo filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzëninë, të qenit prind, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozitat gjenetike, aftësitë e kufizuara, përkatësinë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera, në përputhje me ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

3. Të dorëzojnë ankesa lidhur me kufizime apo ndëshkime dhe t'u shqyrtohen ankesat me drejtësi, në kohë dhe paanshmëri.

4. Të mos u nxirret informacioni dhe evidencat.

5. T'u ruhet e drejta e jetës private në korrespondencën, komunikim, vizita dhe punët financiare.

6. Të shohin evidencat e veta.

7. Të mos abuzohen dhe të mos shfrytëzohen.

8. Pjesëmarrëset duhet të informohen për të gjitha drejtat në gjuhën që kërkojnë.

9. Të mos pranojnë të bëjnë deklarata publike për të shprehur mirënjohjen për programin apo të performojnë në tubime publike.

10. Të kenë mundësi të komunikojnë me një anëtar të stafit për të kuptuar, ushtruar dhe mbrojtur të drejtat e pjesëmarrëseve.

11. Të kenë një mjedis ku nuk pihet duhani.

12. Liria e ushtrimit të të drejtave civile të pjesëmarrësës.

13. Fotografitë e pjesëmarrësës të përdoren nga strehëza vetëm në përputhje me pëlqimin e dhënë me shkrim nga pjesëmarrësja ose nga prindi apo kujdestari i pjesëmarrësës.

14. Të kenë mundësi të përdorin barnat me recetë në përputhje me politikën e barnave të pjesëmarrëseve në strehëz.

15. Një plan me objektiva të individualizuar, shqyrtim periodik dhe rivlerësim të nevojave dhe rishikim të planit, duke përfshirë përshkrimin e shërbimeve që mund të jetë e nevojshme për ndjekjen në vijimësi.

16. Pjesëmarrje të vazhdueshme në planifikimin e shërbimeve që jepen, si edhe pjesëmarrje në hartimin dhe rishikimin periodik të planit të objektivave.

17. Zgjedhja për të mos pranuar të marrin pjesë në punë kërkimore pa pëlqimin e informuar vullnetar me shkrim të pjesëmarrësës, prindit ose kujdestarit dhe e drejta për t'u mbrojtur e lidhur me këtë pjesëmarrje, si edhe e drejta dhe mundësia për ta rikthyer pëlqimin e dhënë.

18. Liria nga izolimi a veçimi. Izolimi dhe veçimi mund të përdoren vetëm në situata rreziku të afërta, në të cilat pjesëmarrësja mund të lëndojë veten ose të tjerët dhe për të parandaluar çrregullimin e regjimit në strehëz dhe vetëm atëherë kur janë shteruar të gjitha metodat e tjera kontrolluese kufizuese.

Detyrimet (përgjegjësitë) e pjesëmarrësës

1. T'i trajtojnë ata që u japin shërbimet me respekt dhe dinjitet.

2. T'u japin ofruesve të shërbimeve informacionin që u duhet. Kjo i ndihmon ofruesit t'u realizojnë shërbimet më të mira të mundshme.

3. Të bëjnë pyetje për shërbimet. Kjo i ndihmon t'i kuptojnë shërbimet.

4. Të ndjekin planin e shërbimit. Pjesëmarrësi dhe ofruesi duhet të bien dakord për planin e shërbimit.

5. Të ndjekin planin e mjekimit të miratuar nga mjeku.

6. T'i tregojnë ofruesit dhe mjekut për ndryshimet në mjekim, duke përfshirë edhe barnat që u kanë dhënë të tjerët.

7. Të respektojnë takimet e lëna. Pjesëmarrësit duhet t'i telefonojnë sa më parë ofruesit me të marrë vesh që u duhet ta anulojnë një takim.

8. T'i informojnë ofruesit kur plani i shërbimit nuk po i kënaq.

9. Ta informojnë ofruesin për problemet që kanë për të paguar tarifat, nëse ka.

10. Të kallëzojnë mashtrimet dhe abuzimet.

11. Të raportojnë haptazi shqetësimet për cilësinë e shërbimeve që marrin.

Kujdesi për fëmijët

- Sikurse ju kemi informuar më lart, strehëza ofron shërbime të kujdesit të fëmijëve. Hë për hë, strehëza nuk mund t'u ofrojë shërbime kujdesi të gjithë fëmijëve në strehëz. Prioritet u jepet nënave që punojnë, pas të cilave prioritet u jepet nënave që kanë takim. Është përgjegjësia e vetë banores të caktojë orën për kujdesin e fëmijës dhe ta anulojë takimin nëse vendos se ky shërbim nuk i nevojitet. Me këtë ndihmoni banoret e tjera, të cilat mund të kenë nevojë për kujdes për fëmijët e tyre atë ditë. Ju lutemi, dorëzojeni formularin që ju është dhënë, ku shpjegohet orari gjatë të cilit do të ofrohet kujdesi për fëmijët atë ditë.

- Strehëza mund t'u japë mundësi me raste banoreve të tjera të kujdesen për fëmijët tuaj. Duhet të informohet një punonjëse mbrojtëse nëse një banore tjetër ka ndër mend të kujdeset për fëmijët tuaj. Kujdesi për fëmijët midis banoreve mund të bëhet e shumta për 3 orë nëse nuk bëhet përjashtim nga një punonjëse mbrojtëse. Banoret duhet të plotësojnë një marrëveshje banore me banore çdo herë që ia lejojnë një banoreje tjetër të kujdeset për fëmijën a fëmijët e saj. Nuk i lejohet një banoreje tjetër të kujdeset për më shumë se 5 fëmijë njëherësh, përfshirë këtu edhe fëmijët e vet. Banoret, të cilat kanë rënë dakord të kujdesen për fëmijët kanë të drejtën të

vendosin të mos e ofrojnë këtë shërbim kur mendojnë se nuk mund ta ofrojnë më. (Këtu jepet marrëveshja “banore me banore”).

- Sikurse thuhet në standardet e strehëzës, nënat duhet medoemos t’i vëzhgojnë fëmijët e tyre në çdo kohë. Mosndjekja e kësaj kërkesë mund të konsiderohet moskujdesje.

- Fëmijët mund të luajnë vetëm në vendet e përcaktuara për këtë gjë, në strehëz. Fëmijët nuk mund të luajnë në parking dhe përreth barakave të shërbimit apo mbrapa shtëpive.

Llojet e lodrave që nuk lejohen:

- patinat, skejtbordet, skuterat;
- lodrat armë/lodrat shpatë.

Llojet e aktiviteteve që nuk lejohen:

- lufta;
- mundja;
- lëvizja me skejtbord;
- lëvizja me biçikletë brenda oborrit të strehëzës.

Vendet ku nuk mund të luhet:

- rruga dhe trotuari;
- parkingu.

Si pritet të mbikëqyren fëmijët nga prindërit e tyre, gjatë lojës:

- t’i kenë në rrezen e shikimit;
- t’i kenë pranë vetes;
- pjesëmarrëset e rritura duhet të jenë jashtë kur jashtë janë edhe fëmijët;
- duhani nuk lejohet në vendet e caktuara ku lozin fëmijët.

Shkolla

- Staf i strehëzës i ndihmon nënat t’i regjistrojnë fëmijët në shkollën më të afërt mbështetur në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit. Banoret duhet t’i regjistrojnë në shkollë fëmijët e tyre brenda 2 ditësh pasi hyjnë në strehëz. Nënat mbeten përgjegjëse për rrezikun që u kanoset fëmijëve të cilët shkojnë në shkollë vetëm, të shoqëruar apo që nuk shkojnë për një periudhë kohe. Staf mund t’i asistojë nënat për regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Nënat sigurojnë transportin për në shkollë në këmbë.

Ushqimi

- Strehëza ju siguron juve dhe fëmijëve tuaj ushqim nga furnizimet e veta gjersa ju të keni të ardhura për të përmbushur nevojat tuaja ushqimore.

- Blerja dhe përgatitja e ushqimeve është aktivitet i përbashkët me gratë e tjera të strehëzës.

- Ju lutemi, kuzhinën mund ta përdorni lirisht gjer në orën 21:00.

- Mund të përdorni dollapin e ushqimeve dhe frigoriferin (mbulojini të gjitha ushqimet me qese).

- Ju lutemi, vendosni emrin tuaj në ushqimet që do të vendosni në frigorifer, ndërsa konservat vendosini në dollapin e kuzhinës.

- Ju lutemi, pastrojeni kuzhinën mbasi ta keni përdorur.

- Nëse banorja dëshiron ushqime të tjera shtesë apo gjellë të veçanta, këtë duhet ta sigurojë vetë.

- Nëse banorja ka nevoja ushqimore të veçanta për arsye mjekësore, ju lutemi informojeni stafin për këtë, në mënyrë që të mund të merren masat e nevojshme të arsyeshme.

Asistenca financiare

Duhet të keni mundësi të kërkonit asistencë financiare. Mirëpo, kjo, me ligjet shqiptare, është e ndërlikuar për shkak të dispozitave antikushetuese të cilat i japin mundësi vetëm bashkëshortit ta kërkojë ndihmën financiare, nëse çifti nuk është shkurorëzuar. Ky problem është në proces zgjidhjeje. Nëse ju duhet ndihmë për të arritur këto burime, ju lutemi flisni me menaxheren e rastit tuaj.

Transporti

Sipas ligjit “Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare”, policia ka detyrimin për të

bërë transportimin për në strehëz dhe për të siguruar mbrojtjen në situatat ku ka rrezik për jetën.

Hyrje-daljet

- Banoret, të cilat kanë ndër mend të largohen nga strehëza për të dalë në komunitet, duhet të përdorin “portën e këmbësorëve”, nëse largohen më këmbë nga strehëza. Për të dalë nga porta duhet të shtypin butonin mbi kutinë që ndodhet brenda derës përpara portës së këmbësorëve dhe pastaj ta hapin derën. Kur të ktheheni duhet të shtypni butonin e citofonisë mbi kutinë e citofonisë jashtë portës dhe roja do t’ju hapë derën.

Përdorimi i telefonit

- Strehëza e ka për kënaqësi t’ju ofrojnë shërbimin e telefonit për telefonata personale. Banoreve nuk u lejohej ta zhblokojnë numrin në këto telefona. Kjo do të ishte shkelje e fshehtësisë së informacionit dhe mund të çojë në largim të detyrueshëm nga strehëza. Banoret janë të lutura të tregojnë respekt dhe mirësjellje ndaj të gjitha banoreve të tjera, duke mos e monopolizuar telefonin. Telefonatat duhet të kufizohen maksimumi 10 minuta, nëse janë duke pritur të tjera për ta përdorur telefonin.

Përdorimi i kompjuterit

- Strehëza e ka për kënaqësi të ofrojë shërbime interneti për përdorim vetjak dhe për të punuar për planin tuaj të shërbimit. Banoret duhet të regjistrohen për të përdorur kompjuterin në zyrën e menaxherit të rastit. Secila banore mund ta përdorë kompjuterin për 30 minuta nëse nuk është pritur kush tjetër për ta përdorur kompjuterin. Banoret mund ta përdorin kompjuterin edhe më gjatë, me lejen e administratorit të rastit, nëse banorja punon për planin e shërbimit. Nuk lejohej të përdoret asnjë hapësirë në internet e cila mund të konsiderohet e dhunshme ose pornografike. Nuk lejohen programet e shkëmbimit të mesazheve të çastit (messenger) apo shkarkimet në kompjuter. Të gjithë fëmijët duhet të mbahen nën mbikëqyrje, kur janë duke përdorur telefonin apo kompjuterin.

Sendet vetjake të banoreve

- Strehëza nuk mban përgjegjësi për humbjen a vjedhjen e sendeve. Banoret mund t’i vendosin sendet e tepërta në magazinë gjatë qëndrimit të tyre, deri në 30 ditë pasi largohen nga strehëza. Pas 30 ditëve, sendet personale do të hidhen poshtë. Nxiten banoret t’i vendosin në magazinë sendet e tepërta, për të evituar vjedhjen dhe rrëmujën. Sendet, të tilla si: letërnjoftime, karta krediti, çanta dore etj., duhet t’i mbajë banorja me vete gjatë çdo çasti ose t’i vendosë në një vend të sigurt. Stafi nuk duhet të ruajë sende brenda zyrave të stafit.

- Çdo banoreje që dëshiron, do t’i caktohet një dollap personal me kyç. Kjo mundësi u jepet vetëm atyre banoreve të cilat nuk kanë automjete personale ku të mund t’i vendosin sendet vetjake të tyre.

Siguria

- Strehëza ka vendosur procedura sigurie, në rast të hyrjes së një personi të jashtëm të padëshiruar në mjedis. Normalisht, strehëza funksionon sipas hipotezës “çdo gjë në rregull”, që do të thotë se nuk ka shenja të një të paftuari apo rreziku të ditur. Nëse stafi mëson për një rrezik të mundshëm, mund të shpallet “alarm i kodit të verdhë”. Ky alarm do të thotë se është identifikuar një rrezik i mundshëm i hyrjes së një të paftuari në strehëz. Banoret dhe stafi mund të vazhdojnë të kryejnë veprimet e përditshme, duke treguar kujdes shtesë dhe duke qëndruar brenda mjedisve nëse nuk është e nevojshme të dalin. Nëse shihet një person i jashtëm i padëshiruar rreth mjedisve ose brenda tyre dhe nëse ekziston mundësia për rrezik, stafi mund të shpallë “kodin e kuq” që do të thotë se të gjitha banoret duhet të futen brenda strehëzës dhe të presin gjersa të shpallet largimi i rrezikut. Kur është shpallur “kodi i kuq” banoret dhe stafi duhet të qëndrojnë medoemos në mjediset e strehëzës dhe askujt nuk i lejohej të largohet nga mjediset. Secila shtëpi e strehëzës ka një “vend të sigurt” ku duhet të mblidhen banoret.

- Vlen gjithmonë të theksohet se strehëza mbështetet te fshehtësia e informacionit për vendndodhjen e saj, për t’ju mbajtur juve dhe fëmijët tuaj jashtë rrezikut. Është absolutisht e nevojshme të mbahet i fshehtë informacioni për vendndodhjen e strehëzës. Thyerja e fshehtësisë së informacionit mund të çojë në largimin e paplanifikuar nga strehëza.

- Strehëza nuk lejon asnjë lloj arme në mjediset e veta. Armët e zjarrit, armët e ftohta apo çdo gjë tjetër që mund të konsiderohet si armë mund të konfiskohet dhe kjo mund të përbëjë arsye për largim të paplanifikuar.

- Strehëza e vlerëson qëndrimin jashtë rrezikut të të gjitha banoreve dhe stafit dhe bën ushtrime për mbrojtjen kundër zjarrit dhe evakuimin në rast zjarri. Evakuimi në rast zjarri bëhet atëherë kur sistemi kundër zjarrit ndjen se ka një problem, ndërsa ushtrimi kundër zjarrit është një aktivitet i paraplanifikuar. Politika për evakuimin në rast zjarri u kërkon banoreve, që nëse bie një alarm, i cili tregon nevojën për t'u evakuuar, të largohen menjëherë të gjitha nga ndërtesa dhe të paraqiten në zonën e caktuar për t'u mbledhur, që ndodhet në (shkruani pikën e mbledhjes). Nuk lejohet rihyrja në ndërtesa gjersa të shpallet kalimi i situatës së rrezikshme nga zjarrfikësit. Rrugët e largimit në rast rreziku afishohen në të gjithë strehëzën dhe paraqesin rrugët e largimit për të shkuar në pikën e mbledhjes. Gjatë evakuimit në rast zjarri do të ndihmohet çdo banor me probleme që e pengojnë për të lëvizur. Krahës politikës së evakuimit në rast zjarri, periodikisht kryhen ushtrime kundër zjarrit për t'u ushtruar banoret që të jenë të gatshme për t'u larguar përmes të gjitha pikave të daljes, duke përfshirë edhe masat që duhen marrë nëse është bllokuar rruga parësore e largimit. Ushtrimet kundër zjarrit zhvillohen nga çdo përgjegjës objekti dhe një anëtar i stafit të objektit apo ekipit drejtues duhet të shpallë kalimin e rrezikut, për të treguar se lejohet kthimi. Zbatimi nga ana e banoreve dhe stafit e politikës së evakuimit në rast zjarri dhe ushtrimeve kundër zjarrit është i detyrueshëm dhe moszbatimi i tyre vendos në rrezik si banoret, stafin dhe strehëzën. Secila strehëz duhet të ketë një plan specifik evakuimi në varësi të ndërtesës.

Hapësira në dollap dhe frigorifer

- Strehëza ofron hapësirë të mjaftueshme në frigorifer dhe dollap për banoret që hyjnë në strehëz. Banoret duhet t'i mbajnë artikujt ushqimorë në vendin e caktuar. Vjedhja e ushqimeve të një banoreje tjetër mund të sjellë largimin e paplanifikuar.

Orari i sigurt, kalimi i natës jashtë strehëzës dhe orari i gjumit

- Për respekt të banoreve të tjera, ju lutemi ta ulni volumnin e televizorëve dhe radiove pas orës 22:00. Ju lutemi, dushin ta bëni përpara orës 22:00 dhe të tregoni vëmendje ndaj faktit se personat me të cilët ndani dhomën mund të jenë në gjumë, pra ju lutemi të tregoni kujdes kur të hyni në dhomën e gjumit pas orës 22:00.

- Vetëm dy net lejoheni t'i kaloni jashtë strehëzës gjatë qëndrimit tuaj në strehëz. Kalimi i natës jashtë strehëzës, për shkak të turnit të tretë apo urgjencave mjekësore, nuk llogaritet në këtë sasi të lejuar të netëve jashtë strehëzës, nëse jepet dokumentacioni i duhur. Banoreve të cilat e kalojnë numrin e netëve të kaluara jashtë strehëzës për shkak të urgjencave mjekësore mund t'u kërkohej të paraqesin dokumentacion dhe u kërkohej të lidhen përditë me përgjegjësin e strehëzës ose t'i lënë mesazh në sekretarinë telefonike.

Orari i sigurt për banoret është deri në 24:00 gjatë ditëve të javës dhe deri në 1:00 të premtë dhe të shtunë.

Orari i gjumit është në dorë të çdo prindi. Por, pritet nga fëmijët që të mos bëjnë zhurmë pas orës 21:00, në respekt të orarit të gjumit të të tjerëve.

Detyrimet e stafit ndaj përfituesve

Të gjithë punonjësit duhet të respektojnë udhëzimet e mëposhtme gjatë realizimit të detyrave të tyre. Punonjësit nxiten të bëjnë pyetje lidhur me sjelljen etike dhe kufijtë gjatë ndërveprimit me eprorët e tyre. Moszbatimi i udhëzimeve të mëposhtme mund të çojë në masa korrigjuese, deri në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

1. Punonjësit duhet t'i realizojnë gjithmonë detyrat me mirësjellje dhe respekt për pjesëmarrëset, për publikun dhe për kolegët, dhe pa asnjë diskriminim në fjalët që thonë dhe në sjelljen e tyre.

2. Punonjësit duhet t'u japin pjesëmarrëseve pëlqimin e informuar i cili të përfshijë një recitim me gojë të shqetësimeve të pjesëmarrëses dhe planin e propozuar të veprimit, duke përfshirë rezultatin e synuar, natyrën e planit të propozuar dhe procedurat e përfshira në planin e

propozuar, çdo rrezik apo efekte anësore që mund të vijnë nga plani i propozuar dhe çdo alternativë ndaj planit të propozuar.

3. Punonjësit duhet të respektojnë të drejtën e pjesëmarrësës për vetëvendosje dhe të drejtën e pjesëmarrësës për t'i pranuar ose refuzuar shërbimet.

4. Punonjësit duhet të jenë të ndërgjegjshëm se në marrëdhëniet e tyre me pjesëmarrëset pushteti dhe statusi janë jo të barabartë. Për rrjedhojë, duhet të pranojnë se marrëdhëniet e dyfishta ose të shumëfishta mund të rrisin rrezikun e lëndimit ose të shfrytëzimit të pjesëmarrësëve dhe mund ta pengojnë gjykimin e tyre profesional. Por, në disa komunitete e situata, mund të mos jetë e realizueshme shmangja e kontaktit social apo jo profesional me pjesëmarrëset.

5. Punonjësit duhet ta mbështesin besimin e nënkuptuar në marrëdhënien e ndihmës përmes shmangies së marrëdhënieve të dyfishta të cilat mund ta pengojnë gjykimin profesional, mund të rrisin rrezikun e lëndimit të pjesëmarrësëve apo mund të çojnë në shfrytëzim.

6. Punonjësit duhet t'i njohin kulturat ose komunitetet ku ushtrojnë aktivitet. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për shumëllojshmërinë e kulturave në shoqëri dhe për ndikimin që ka ky fakt në komunitet, si edhe te individët brenda komunitetit. Ata duhet t'i respektojnë individët dhe grupet, kulturat dhe besimet e tyre.

7. Punonjësit duhet t'i realizojnë detyrat në mënyrë të atillë që u shërben më mirë interesave të pjesëmarrësëve dhe jo për t'u shërbyer interesave të vetë punonjësve.

8. Punonjësit duhet të veprojnë me ndershmëri, sinqeritet dhe objektivitet me pjesëmarrëset dhe kolegët, për të nxitur interesin më të mirë të pjesëmarrësës.

9. Punonjësit duhet të ruhen me korrektesë nga çdo informacion shfrytëzues që jep pjesëmarrësja dhe nuk duhet ta shfrytëzojnë postin e veçantë dhe pushtetin që u jep situata për të mos ndikuar te pjesëmarrësja në asnjë mënyrë e cila nuk do të ndihmonte drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të pjesëmarrësës.

10. Punonjësit nuk duhet t'i braktisin apo neglizhojnë pjesëmarrëset. Ata duhet të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të organizuar vazhdimin e shërbimit nëse ata vetë nuk mund ta japin këtë shërbim. Duhet bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar shërbime për ato pjesëmarrëse të cilat nuk i përmbushin më kriteret për shërbimet e strehëzës apo të cilat kanë nevojë për shërbime të ndryshme.

11. Punonjësit nuk duhet të përzihen në aktivitete seksuale me pjesëmarrëset dhe as në aktivitete të cilat mund të perceptohen nga pjesëmarrëset apo nga persona të tjera si ngacmime seksuale. Marrëdhëniet seksuale me pjesëmarrëse ekzistuese apo të mëparshme nuk konsiderohen se janë në interesin më të mirë të pjesëmarrësës dhe janë të ndaluara rreptësisht.

12. Punonjësit nuk duhet ta përdorin marrëdhënien profesionale për t'u imponuar pjesëmarrësëve besimet e veta, duke përfshirë besimet politike, ideologjike dhe fetare.

13. Punonjësit duhet të respektojnë jetën private të pjesëmarrësëve dhe të ruajnë me fshehtësi çdo informacion që marrin nga pjesëmarrëset, kolegët apo persona të tjerë në rrjedhën e ofrimit të shërbimeve profesionale. Punonjësit nuk duhet t'ia tregojnë askujt informacionin e mbajtur të fshehtë lidhur me pjesëmarrëset, me përjashtim:

a) kur këtë e kërkon ose e lejon ligji;

b) kur duhet parandaluar një rrezik i qartë dhe i afërt që i kanoset një personi apo disa personave;

c) kur është në cilësinë e të pandehurit ose të dëshmitarit në një proces civil, penal ose disiplinor që lind nga shërbimet e dhëna (në këtë rast, informacioni i mbajtur i fshehtë në lidhje me pjesëmarrësen mund të jepet vetëm në rrjedhën e këtij procesi) ose kur e lejon ligji;

d) kur duhet dhënë sipas parimit “nevoja për të ditur” me punonjës të tjerë të cilët janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve për pjesëmarrësen ose të cilët janë duke hetuar shqetësimet ose ankesat e pjesëmarrësës;

e) kur duhet dhënë informacion minimal i nevojshëm për të shqyrtuar kërkesat për pagesë.

14. Punonjësit duhet të mbajnë një marrëdhënie profesionale dhe të sjellshme me pjesëmarrëset, në çdo kohë, dhe duhet të ruajnë kufijtë e duhur profesionalë me pjesëmarrëset ekzistuese dhe ato të mëparshme. Nëse një punonjës ka pyetje lidhur me atë se çfarë është një kufi i duhur për një rast specifik, për këtë duhet të konsultohet me eprorin e drejtpërdrejtë. Lista e mëposhtme e shkeljeve të kufijve profesionalë nuk është shteruese por jepet vetëm si listë orientuese.

- a) Favorizimi i një ose disa pjesëmarrëseve të caktuara;
- b) Nëse i jepet një pjesëmarrëseje informacion për veten, si për shembull numri i telefonit në shtëpi apo adresa e shtëpisë;
- c) Përzierja në marrëdhënie joprofesionale (domethënë, marrëdhënie miqësie, marrëdhënie seksuale) me një pjesëmarrëse ekzistuese apo të mëparshme, brenda mjediseve ose jashtë tyre. Me pjesëmarrëset e mëparshme, punonjësi duhet të ndjekë udhëzimet e parashtruara në Kodin Etik dhe/ose kodin etik profesional të punonjësit.
- d) Pranimi i dhuratave nga një pjesëmarrëse, të cilat e kalojnë vlerën 2500 lekë. Çdo pranim dhurate duhet bërë me njoftimin e eprorit. Nuk duhen pranuar dhuratat nga pjesëmarrëset, kur pranimi i dhuratës nuk këshillohet dhe kur kjo nuk është në interesin më të mirë të pjesëmarrëses apo pjesëmarrëseve. Dhuratat që u jepen pjesëmarrëseve, u jepen nga organizata dhe jo nga një punonjës i veçantë.
- e) Përfshirja në një bashkëbisedim me një pjesëmarrëse për një punonjës tjetër ose për një pjesëmarrëse tjetër. Kjo do të përbënte edhe shkelje të fshehtësisë së informacionit për pjesëmarrëset dhe/ose punonjësit e tjerë.
- f) Përfshirja në një shkëmbim parash me një pjesëmarrëse, me përjashtim të arkëtimit të tarifave për shërbimet e dhëna.

15. Punonjësit mund të marrin pjesë, me raste, në aktivitete të planifikuara sociale ose zbavitëse me pjesëmarrëset, siç janë aktivitetet për gjetje fondesh, aktivitetet e bamirësisë dhe aktivitete të ngjashme. Nëse përfshihen në aktivitete të tilla, pritjet prej punonjësit që ky të sillet brenda kufijve të duhur profesionalë me pjesëmarrëset dhe të mos përzihet në konsumimin e alkoolit apo drogave të paligjshme në praninë e pjesëmarrëseve dhe në asnjë moment gjatë aktivitetit.

16. Punonjësit nuk duhet të përfshihen apo të kërkojnë marrëdhënie dashurie me një pjesëmarrëse. Nëse e bëjnë një gjë të tillë, kjo çon në shkëputjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës dhe njoftimin e këshillave përkatës të licencimit dhe certifikimit.

17. Punonjësit nuk duhet të t'u japin hua pjesëmarrëseve fonde apo sende të tyre vetjake dhe as nuk duhet të marrin hua nga pjesëmarrëset fonde apo sende. Punonjësit nuk duhet të japin dhe as të marrin shërbime personale nga pjesëmarrëset ekzistuese.

18. Kur lind një konflikt midis përmbushjes së përgjegjësisë përpara punëdhënësit dhe përgjegjësisë përpara pjesëmarrëses, punonjësi duhet t'i njoftojë të dy për këtë konflikt dhe të punojë së bashku me të gjithë personat e përfshirë për ta menaxhuar konfliktin.

Ankesat

Pjesëmarrëset kanë të drejtën për ankesë formale nëse kanë një ankesë për shërbimet apo nëse mendojnë se u janë mohuar pa të drejtë shërbimet. Formularët e ankesave mund t'i gjeni në tabelat e njoftimeve ose mund t'i kërkonit një punonjësi mbrojtës t'ju japë një formular. Pasi ta ketë mbushur formularin, banorja duhet t'ia japë atë punonjësit mbrojtës i cili ia përcjell drejtorit. Drejtori do t'ju përgjigjet brenda 5 ditësh. Nëse nuk është e kënaqur me përgjigjen, banorja ka të drejtën të paraqesë një ankesë pranë bordit.

Çdo pjesëmarrëse e strehëzës e cila mendon se është diskriminuar, abuzuar, i janë mohuar shërbimet e arsyeshme dhe të duhura (është neglizhuar) ose është shfrytëzuar mund të depozitojë një ankesë zyrtare pa u shqetësuar se do të diskriminohet. Kjo përfshin, pa kufizim, përshtatjet e duhura të arsyeshme për një aftësi të kufizuar. Staf i strehëzës mund ta asistojë pjesëmarrësen gjatë një ankimi pa frikën e diskriminimit.

Nxitet pjesëmarrësja t'i zgjidhë ankesat në mënyrë joformale me palën ose palët e tjera dhe/ose me koordinatorin e programit, përpara depozitimit të një ankese formale.

Procedura e depozitimit të një ankese formale

(Mund të merret asistencë për depozitimin e ankësës duke i kërkuar një anëtar të stafit për të asistuar në shkrimin e ankësës).

Ankesa formale duhet të përfshijë:

1. Natyrën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri te ankesa;
2. Datën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri te ankesa;
3. Palën kundër së cilës depozitohet ankesa; dhe
4. Emrin e plotë, adresën dhe numrin e telefonit të personit që ankohet.

Ankesa duhet të depozitohet pranë drejtorit, jo më vonë se 10 ditë pas incidentit që ka shkaktuar ankesën e lidhur në mënyrë specifike me shërbimet e programit.

Pas marrjes së ankësës, drejtori vendos brenda 3 ditësh pune:

1. Nëse mund ta zgjidhë apo jo çështjen personalisht. Nëse e trajton personalisht çështjen, duhet t'ia paraqesë konstatimet e veta pjesëmarrësës brenda 5 ditësh pune.

2. Nëse do të caktohet një komision ankese, për ta zgjidhur çështjen. Nëse caktohet një komision ankese, mbledhja e komisionit të ankësës duhet të bëhet brenda 2 ditësh pune për të hetuar ankesën dhe komisioni i ankësës duhet të raportojë për konstatimet e veta brenda 3 ditësh pune.

Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje e ankësës në nivel drejtori të programit apo drejtori të strehëzës apo komisioni të ankësës, ankesa duhet t'i kalohet bordit, i cili i shqyrton konstatimet/rekomandimet e mëparshme dhe ia paraqet me shkrim rekomandimet/konstatimet e veta pjesëmarrësës brenda 5 ditësh pune.

Një kopje e kësaj politike duhet të mbetet e afishuar në ambientet që përdoren kryesisht nga pjesëmarrëset. Një kopje e kësaj politike i jepet pjesëmarrësës gjatë pranimit.

Pjesëmarrësit nuk duhet të largohen nga programi gjatë procesit të ankimit, me përjashtim të rastit kur përfundon afati i programit ose kur pjesëmarrësja kthehet në një rrezik për strehëzën gjatë procesit të hetimit.

Unë i nënshkruari vërtetoj që informacioni i shkruar më sipër është diskutuar me mua në detaje nga stafi i organizatës dhe që kuptoj plotësisht të drejtat dhe detyrimet e mia, detyrimet e stafit karshi meje, shërbimet e disponueshme, rregullat e strehës dhe procedurat e ankimit. Unë e kuptoj që rregullat synojnë mbrojtjen dhe respektimin e të gjithë përfituesve në strehë, përfshirë dhe mua. Gjithashtu, unë kam marrë me shkrim një përshkrim të plotë të procedurës së ankimit që është e disponueshme për mua.

Unë (këtu shkruani emrin e përfituesit), pranoj me vullnetin tim rregullat dhe detyrimet e deklaruar më sipër, dhe dëshiroj të jem përfitues i programit dhe të qëndroj në këtë strehë duke filluar nga dita e sotme.

Përfituesi:

Emri me shkronja shtypi

Firma

Data

Përfaqësuesi i strehës

Emri me shkronja shtypi

Firma

Data

ANEKSI 4
VLERËSIMI I NEVOJAVE – SHËNDETI

Emri i përfituesit: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

Shënim. Ky formular ka për synim të përdoret nga një profesionist jomjekësor për të parë nevojat e mundshme mjekësore të përfituesit në rastet kur një profesionist mjekësor nuk është i disponueshëm për ta bërë vlerësimin. Ky nuk synon të zëvendësojë protokollet apo procedurat mjekësore.

1. Si ndjehet në këtë moment përfituesja? Përshkruani ndonjë problem apo ankesë të kohëve të fundit:

2. A ka përfituesja ndonjë problem mjekësor të vazhdueshëm, kronik apo të përsëritur? Nëse po, specifikoni:

3. A merr përfituesja mjekim apo trajtim për këto probleme? Nëse po, specifikoni:

4. A ndikojnë këto shqetësime në ushqimin apo veprimtarinë e përfitueses? Nëse po, specifikoni:

5. Ekzaminimi i fundit mjekësor:

a) Data:

b) Emri i mjekut:

c) Diagnoza:

d) Trajtimi i rekomanduar:

e) A po vazhdon ose ka përfunduar trajtimi? Nëse ka përfunduar, a ndjen përfituesja që simptomat janë zhdukur? A është bërë një ekzaminim për të konfirmuar që trajtimi ishte i suksesshëm?

6. A ka problem përfituesja me një nga të mëposhtmet:

a) Fjetja;

b) Ngrënia/dhimbje stomaku;

c) Marrje ose humbje peshe;

d) Dhimbje koke;

e) Cikli menstrual;

f) Tjetër.

7. A mund të jetë shtatzënë përfituesja? Data e menstruacioneve të fundit:

8. A shfaq përfituesja veprime dhe reagime në bazë të emocioneve dhe jo të arsyes?

- A po tregon shenja histerie viktime, a po qan apo është e qetë?

- A po e thotë pas një emocion incidentin, pa ndryshim të intonacionit të zërit, sikur të mos ketë asnjë ndjenjë a të jetë indiferente, apo nuk është në gjendje të reagojë me emocion ndaj asaj që i ka ndodhur?

- Si reagon ajo zakonisht ndaj këtij lloj incidenti?

- A duket e paqartë?

- A duket se e kupton tërësisht atë që i ka ndodhur?

- A po ndryshon gjendja e saj emocionale gjatë kohës që jua beson juve historinë e saj? Nëse po, si ndryshon? A po qetësohet apo po bëhet më emocionale? A shpërthen, ndonjëherë, në të qara gjatë kohës kur ju tregon ngjarjet? A i ndryshon humori nga lotë në inat, e anasjelltas?


9. A shfaq përfituesja ndonjë shenjë depresioni apo vetëvrasjeje?

- A shfaq përfituesja ndonjë shenjë vetëgjymtimi ose vetëdëmtimi?

- A kërcënon të vrasë veten apo dikë tjetër?

10. A shfaq përfituesja shenja të përdorimit të alkoolit apo qetësuesve të ndryshëm?

Analiza e informacionit të mbledhur:



VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I SHËNDETTT

- Mirë. Nuk ka probleme shëndetësore të tanishme që mund të paraqesin shqetësim. Përfituesja nuk ka më shumë se kollë, të ftohur apo grip dhe këto ose nuk ndodhin shpesh ose nuk zgjatin më shumë sesa pritet. Nuk ka probleme të vazhdueshme që të ndikojnë mbi shkollën, trajnimin, punën apo marrëdhëniet sociale dhe nuk ka sjellje të rrezikshme shëndetësore. Aftësitë e kufizuara nuk prekin punën, lojën apo marrëdhëniet sociale. Përfituesja ha mirë dhe shfaq një dietë të shëndetshme dhe ushtrim fizik. Përfituesja nuk shfaq shenja të sëmundjeve mendore apo depresionit.

- Kënaqshëm. Përfituesja është në përgjithësi mirë, por mund të vuajë shpesh sëmundje të lehta. Megjithatë, problemet e menjëhershme shëndetësore mund të trajtohen pothuajse gjithmonë nga vetë përfituesi dhe ata që kujdesen për të. Problemet kronike shëndetësore, sëmundjet mendore dhe aftësitë e kufizuara menaxhohen mirë dhe nuk ndikojnë mbi shkollën, punën dhe marrëdhëniet sociale. Nuk ka probleme shëndetësore që kërkojnë mjekim të rregullt apo kontrolle të rregullta nga ana e shërbimeve mjekësore të specializuara. Përfituesi nuk shfaq shenja depresioni.

- Disa vështirësi. Përfituesi ka disa probleme shëndetësore të vazhdueshme apo të përsëritura akute që ndikojnë mbi shkollën, trajnimin, punën apo veprimtarinë sociale. Këto mund të përfshijnë periudha të shpeshta azme, ekzema të rënda, alergji, probleme të frymëmarrjes dhe kardiake ose shenja depresion. Problemet kronike shëndetësore dhe aftësitë e kufizuara kërkojnë ndërhyrje të shpeshta dhe po ndikojnë mbi rutinën dhe marrëdhëniet sociale të përfituesit. Një veçori përcaktuese është ekzistenca e disa kufizimeve të jetës së përditshme.

- Vështirësitë për momentin i tejkalojnë pikat e forta. Përfituesja ka probleme të mëdha akute apo kronike shëndetësore që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme mjekësore dhe/ose ndihmë të veçantë nga kujdestarët. Aftësitë e kufizuara nuk janë trajtuar siç duhet. Përfituesja shfaq shenja të depresionit apo të vetëvrasjes së mundshme. Problemet shëndetësore dhe/ose fizike të përfituesit ndikojnë shumë mbi rutinën dhe/ose marrëdhëniet e tyre sociale.

- Në bazë të vlerësimit të parë dhe informacionit të marrë gjatë intervistës së pranimit, stafi do të përcaktojë nevojat dhe do të bëjë rekomandime në lidhje me vlerësimin tjetër shtesë.

Rekomandimet për vlerësimet shtesë futen në kartelë brenda pesë ditësh pune pas pranimit dhe mund të përfshijnë:

1. Vlerësim psikiatrik ose psikologjik;
2. Ekzaminim fizik;
3. Ekzaminim neurologjik;
4. Analiza laboratike;
5. Testim arsimor;
6. Vlerësime të terapisë profesionale ose rekreative;
7. Vlerësim profesional dhe riaftësues;
8. Vlerësim të sjelljes përshtatëse ose vëzhgim të drejtpërdrejtë të sjelljes;
9. Vlerësime të të folurit dhe të gjuhës;
10. Analiza për tuberkuloz dhe/ose virusin HIV.

ANEKSI 5
VLERËSIMI I NEVOJAVE – PSIKOSOCIALE (TË RRITURIT)

Emri i përfituesit: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

Shënim. Ky formular ka për synim të përdoret nga një anëtar stafi joprofesionist për të parë nevojat e mundshme psikosociale të përfituesit në rastet kur një psikiatër ose psikolog profesionist nuk është i disponueshëm për ta bërë vlerësimin. Ky nuk synon të zëvendësojë protokollat, testet apo procedurat profesionale.

	PO	JO
--	----	----

Pagjumësi:	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Gjumë i tepërt	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Ka makthe të shpeshta:	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Zgjohet shpesh natën	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

	PO	JO
--	----	----

Dhimbje e shpeshtë koke	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Dhimbje e shpeshtë stomaku	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Të vjella	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Të fikët	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Probleme të tjera mjekësore	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

	PO	JO
--	----	----

Impulsivitet i lartë:	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Ndjeshmëri e lartë	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Gjendje e lartë emocionale (eufori)	☐	☐
Nëse po, përshkruani ...		

Gjendje e ulët emocionale (depresion) Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Gjendje alternative emocionale (alternim ndërmjet euforisë dhe depresionit) Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Mungesë reagimi emocional: Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Mungesë kontrolli/stabiliteti emocional Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Shenja depresioni Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Kërcënim/rrezik vetëvrasjeje Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Vetëgjymtim, vetëdëmtim, Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Vështirësi kognitive	PO	JO
Shkëputje mendimi Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Paaftësi për t'u përqendruar Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Vështirësi kujtese, Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
E folur e varfër Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Konfuzion i shpeshtë Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
I reziston mësimet të gjërave dhe aftësive të reja Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Reagim i vonuar Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Vështirësi motivimi	PO	JO
Mungesë iniciative për kryerjen e një detyre ose veprimi Nëse po, përshkruani ...	☐	☐

Varësi e tepruar nga të tjerët Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Pesimizëm i shpeshtë Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Mungesë e të folurit spontan (flet vetëm kur i flasin) Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Shqetësime të sjelljes, performancës dhe funksionimit	PO	JO
Neglizhon higjienën dhe paraqitjen personale Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Performancë e dobët kur ndërmeret detyrat Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Nuk mëson nga gabimet Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Përdor dhunë ose gjuhë fyese Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Marrëdhëniet sociale	PO	JO
Shtytje e ulët për veprimtari sociale (Preferon të jetë vetëm/ndërmeret detyra të vetmuara) Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Qëndron/ulet veçmas grupit Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Sjellje e pahijshme Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Shfaq afeksion të papërshtatshëm ndaj të tjerëve (tepër ose shumë pak) Nëse po, përshkruani	☐	☐
Kontakte sociale të papërshtatshme nga ana kulturore (p.sh. prekje të papërshtatshme, mungesë kontakti me sy, qëndrim shumë afër ose shumë larg) Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Armiqësi ndaj normave sociale Nëse po, përshkruani ...	☐	☐

Problem në përfshirje në bisedë (p.sh. nuk flet ose nuk u përgjigjet pyetjeve, ndërpret të tjerët, flet kur të tjerët flasin etj.) Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Ka marrëdhënie të ngrohtë, të besueshme me të tjerët Përshkruani ...	☐	☐
Tregon interesim për të tjerët Përshkruani ...	☐	☐
Ka treguar empati dhe afeksion për të tjerët Përshkruani ...	☐	☐
Vetëkoncept	PO	JO
Ka një qëndrim pozitiv për veten Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Pranon vetitë e mira dhe të këqija të tij/saj Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Dëshiron të jetë ndryshe nga ç'është Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Ka vështirësi në administrimin e punëve të përditshme Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Është në gjendje të marrë vendime për veten Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Varet nga gjykimi i të tjerëve për të marrë vendime Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Pajtohet tepër për shkak të presionit social Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Është i/e hapur ndaj përvojave të reja Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Shikon përmirësim në veten e tij/saj me kalimin e kohës Nëse po, përshkruani ...	☐	☐
Ka qëllime dhe ambicie për të ardhmen Nëse po, përshkruani ...	☐	☐

I mungon ndjenja e kuptimit të jetës ☐ ☐
 Nëse po, përshkruani ...
 Ndjehet i mërzhitur ose i painteresuar në jetë ☐ ☐
 Nëse po, përshkruani ...

Analiza e informacionit të mbledhur:

VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I NEVOJAVE PSIKOSOCIALE

- Mirëpërshtatur. Përfituesi ka shumë pika të forta dhe nuk shfaq shenja të problemeve emocionale apo psikologjike. Përfituesi ka një kuptim të qartë të aftësive dhe kufizimeve të tij/saj dhe është në gjendje të ndjehet mirë për aftësitë dhe të mos shqetësohet për kufizimet. Përfituesi shkon mirë me të tjerët. Ai/ajo është i/e ndjeshëm/e ndaj ndjenjave të të tjerëve dhe është në gjendje të përshtatë sjelljen e tij/saj sipas situatës dhe rrethanave. Ai/ajo merr pjesë në veprimtari, shkëmben me përfituesit e tjerë, por është në gjendje të mbrojë veten kur kjo është e nevojshme. Përfituesi vendos kontakte të mira me të tjerët, mund të mbajë një bashkëbisedim dhe nuk përfaqëson një sfidë të madhe për punonjësit dhe përfituesit e tjerë ose nuk është tepër i tërhequr apo të kërkojë të jetë në qendër të vëmendjes. Përfituesi dhe punonjësit e përkujdesjes kanë një marrëdhënie të dyanshme të kënaqshme. Përfituesi u drejtohet punonjësve për këshillim dhe mbështetje kur ka nevojë për të dhe përfituesi ndjehet i mbështetur dhe i sigurt. Plani i riintegrit të përfituesit duhet të përfshijë një plan për t'i dhënë mbështetje përfituesit sipas nevojës.

- Kënaqshëm. Gjendja psikosociale e përfituesit është në përgjithësi pozitive dhe përfituesi shfaq një numër pikash të forta dhe vetëm disa vështirësi të cilat punonjësit i shohin si kalimtare (p.sh. një reagim ndaj ngjarjeve të kohëve të fundit). Përfituesi ka një mendim përgjithësisht pozitiv për veten dhe mendon që ka aftësi dhe veti personale të cilat pëlqehen nga njerëzit e tjerë. Përfituesi zakonisht është në gjendje të bashkohet në veprimtari dhe të bashkëpunojë me përfituesit e tjerë dhe punonjësit. Përfituesi ka marrëdhënie të mira sociale, por mund të shfaqë pak padurim ose mosangazhim herë pas here. Vëmendja ndaj paraqitjes fizike dhe higjienës nganjëherë mund të mungojë. Përfituesi ka përgjithësisht marrëdhënie pozitive me punonjësit që kujdesen për të, por mund të ketë mosmarrëveshje ose acarime të shpeshta. Plani i riintegrit të përfituesit duhet të përfshijë një plan për t'i dhënë mbështetje përfituesit sipas nevojës.

- Disa vështirësi. Ndërkohë që pikat e forta janë të dukshme, përfituesi shfaq disa shenja shqetësimi emocional ose psikologjik. Sjellja sfiduese mund të jetë më e vështirë për t'u trajtuar, periudhat e hidhërimit apo të mërzhisë janë më të shpeshta dhe më të vështira për të vendosur kontakt, apo nervozizmi dhe hutimi mund të ndërhyjnë në disa aspekte të jetës. Përfituesi mund të demonstrojë dyshime të vazhdueshme rreth vetes dhe vlerës së tyre. Ai/ajo mund të shqetësohet se ku bëjnë pjesë nga ana sociale dhe nëse pranohet apo pëlqehet nga familja apo bashkëmoshatarët. Përfituesi mund të duket i izoluar nga ana sociale ose sepse ai/ajo ka tendencë të tërhiqet dhe të shkëpusë marrëdhëniet ose nuk u pëlqen dhe injorohet nga të tjerët. Pamja e

jashtme e përfituesit mund të japë përshtypjen e një mungese interesi në shfaqjen sociale dhe higjienë ose në të kundërt një preokupim i tepërt në paraqitje. Marrëdhënia me punonjësit e përkujdesjes, ndonëse është shpesh pozitive, është e shënuar nga vështirësi dhe mundime. Përfituesi mund të ketë marrëdhënie negative me më shumë se një anëtar të stafit. Plani i riintegrit të përfituesit duhet të përfshijë një plan për t'i dhënë mbështetjen e nevojshme përfituesit, përfshirë konsultime të mundshme me ekspertë psikologjikë, neurologjikë ose psikiatrikë, siç tregohet nga nevojat specifike të individit.

- Vështirësitë për momentin i tejkalojnë pikat e forta. Problemet i tejkalojnë pikat e forta për momentin. Ka dukshëm disa probleme shqetësuese emocionale dhe të sjelljes, të cilat ndërhyjnë në jetën e përfituesit dhe vënë në dukje nevojën për këshillim apo ndihmë profesionale. Përfituesi ka mendime të vazhdueshme negative për veten. Përfituesi ka probleme me marrëdhëniet me të barabartët, nuk është në gjendje të modifikojë veprimet e tij/saj për t'u përshtatur në veprimtaritë e grupit apo të harmonizojë emocionet e tij me ato të të tjerëve. Ai/ajo mund të jetë i/e tërhequr, i/e zyrtë, sfidues ose agresiv në shumë situata dhe marrëdhënie ose mund të ngrejë zërin dhe të shkaktojë situata të sikletshme në publik. Ai/ajo ka vështirësi të përshtatë sjelljen ose paraqitjen me njerëz të ndryshëm dhe situata të ndryshme. Për përfituesit e tjerë dhe punonjësit ai/ajo mund të duket i çuditshëm ose i vështirë për të komunikuar. Pamja e jashtme mund të duket qëllimisht e neglizhuar ose fyese ose e zgjedhur për të reflektuar një nevojë për t'u shkëputur nga jeta sociale më shumë se për t'u përshtatur në një pjesë të saj. Përfituesi duket që merr një ndjenjë sigurie dhe mbështetjeje nga marrëdhënia e tij/saj me punonjësit. Marrëdhënia është karakterizuar nga një mungesë afekcioni dhe besimi, dhe nganjëherë nga konflikte të rregullta. Plani i riintegrit të përfituesit duhet të përfshijë një plan për t'i dhënë mbështetjen e nevojshme përfituesit, përfshirë konsultime të menjëhershme me ekspertë psikologjikë, neurologjikë ose psikiatrikë, siç tregohet nga nevojat specifike të individit.

- Parandalimi i vetëvrasjes. Në rastet kur përfituesi shfaq shenja depresioni apo vetëvrasjeje të mundshme, duhet të merren veprime të menjëhershme. Duhet të konsultohen ekspertët e duhur, diskutime me përfituesin duhet të mbahen vetëm nga ana e profesionistëve të trajnuar për këtë, dhe përfituesi duhet të mbikëqyret me kujdes për të parandaluar çdo përpjekje vetëvrasjeje.

ANEKSI 6 VLERËSIMI I NEVOJAVE LIGJORE

Emri i përfituesit: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

Statusi familjar

1. Nëse përfituesja është e martuar, a dëshiron ajo të divorcohet ose a dëshiron partneri ta divorcojë atë? Nëse po, a ka probleme pronësie apo kujdestarie?

2. A ka përfituesja fëmijë? Nëse po, a ka probleme kujdestarie që përfshijnë fëmijët? Nëse po, specifikoni (kërkesë kujdestarie drejtuar ose kërkuar nga bashkëshorti, vendosja e fëmijëve në një institucion etj.):

Çështje penale ndaj përfitueses

3. A po hetohet ose akuzohet përfituesi për vepra penale? Nëse po, specifikoni:

Çështje penale ndaj dhunuesit

4. A dëshiron përfituesja të ndërmarrë veprime ligjore kundër dhunuesit? Nëse po, diskutoni me përfituesen mbi rezultatet pozitive dhe negative nga dëshmia.

a) A ka ndonjë mundësi përfituesja të kërkojë dëmshpërblim?

b) A do të ishin në gjendje dhunuesi të kërcënojnë përfituesen ose familjen e saj? (shih vlerësimin e sigurisë për më shumë informacion rreth vlerësimit të rreziqeve të dëshmimit kundër dhunuesit);

- c) Sa ka të ngjarë të zgjasë një hetim dhe gjyq?
- d) Ku do të jetonte përfituesja gjatë kohës së hetimit dhe gjyqit?
- e) Çfarë dënimesh ka të ngjarë të marrë dhunuesi?

5. Cilat nga gjërat e mëposhtme ajo po merr në konsideratë:

- Denoncimi në polici
- Dhënia e informacionit vetëm policisë
- Dëshmia kundër dhunuesit

Analiza e informacionit të mbledhur:

VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I NEVOJAVE LIGJORE

- Asnjë. Përfituesja nuk ka shqetësime ligjore apo nevojë për ndihmë ligjore.
- Probleme të identifikuar. Përfituesja ka probleme ligjore që kërkojnë ndihmë në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme
 - Legjislacioni i familjes. Përfituesja ka nevojë për ndihmë ligjore në lidhje me familjen e saj/tij, siç janë problemet e divorcit apo kujdestarisë së fëmijëve. Plani i ndihmës të përfitueses duhet të përfshijë një plan për trajtimin e këtyre problemeve ligjore të familjes.
 - Akuza penale kundër përfitueses. Përfituesja është akuzuar për krime të kryera gjatë kohës që ka qenë e dhunuar. Plani i ndihmës së përfituesit, duhet të përfshijë një plan për trajtimin e këtyre akuzave penale.
 - Kërkesa për dëmshpërblim. Përfituesja dëshiron të bëjë një kërkesë kundër dhunuesit për dëmshpërblim. Plani i ndihmës së përfituesit duhet të përfshijë një plan për ta ndihmuar atë për të bërë një kërkesë të tillë.
 - Përfituesi ka probleme të tjera ligjore që kërkojnë ndihmë. Plani i ndihmës duhet të përfshijë një plan për të trajtuar këto probleme ligjore.

ANEKSI 7

VLERËSIMI I NEVOJAVE - ARSIMIMI (16+)

Emri i përfitueses: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

1. Moshë e përfitueses: _____

2. A dëshiron përfituesja të vazhdojë shkollën?

3. Viti i fundit shkollor që është përfunduar:

4. Numri i viteve shkollore që përfituesja ka humbur:

5. A ka programe të disponueshme për të ndihmuar përfituesen që të zëvendësojë vitet e humbura shkollore me qëllim që të arrijë bashkëmoshatarët?

6. A ka përfituesja probleme sigurie që mund të ndikojnë mbi aftësinë e tyre për të shkuar në shkollën lokale? Nëse po, çfarë masash alternative janë të mundshme?

7. Nëse përfituesja është tashmë në shkollë, si po përparon? Çfarë ndihme shtesë kërkon (mbikëqyrje, vend i qetë për detyrat e shtëpisë, libra dhe materiale etj.)?

Analiza e informacionit të mbledhur:



VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I ARSIMIMIT

- Nuk interesohet për arsimim të mëtejshëm formal. Përfituesja nuk dëshiron të vazhdojë arsimimin e saj.

- Ndjek shkollën me sukses. Përfituesja po ndjek shkollën dhe po përparon mirë.

- Ndjek shkollën me probleme. Përfituesja po ndjek shkollën por ka vështirësi. Vështirësitë mund të jenë akademike ose sociale.

- Nuk është regjistruar. Përfituesja dëshiron të ndjekë shkollën, nuk ka humbur kohë në shkollë dhe nuk ka kërcënime sigurie që do ta pengonin atë të ndiqte shkollën. Përfituesja duhet të regjistrohet në shkollë sa më shpejt të jetë e mundur.

- Nuk është regjistruar/ka humbur vite. Përfituesja dëshiron të ndjekë shkollën, por ka humbur disa vite shkolle. Ofruesi i shërbimeve duhet të punojë me drejtorinë lokale arsimore për të identifikuar zgjidhje të mundshme për përfituesen. Plani i ndihmës së përfituesit duhet të përfshijë një plan për të ndihmuar përfituesen të vazhdojë arsimimin e saj, duke zëvendësuar vitet e humbura.

- Nuk është regjistruar/probleme sigurie. Përfituesja dëshiron të ndjekë shkollën, por ka kërcënime sigurie që e bëjnë të pamundur largimin nga streha. Ofruesi i shërbimeve duhet të punojë me drejtorinë lokale arsimore për të hartuar një mekanizëm për të shkolluar përfituesen ose fëmijën në sigurinë e strehëzës.

ANEKSI 8

VLERËSIMI I NEVOJAVE - PROFESIONAL/PUNËSIMI

Emri i përfitueses: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

1. Cili është viti i fundit i shkollës që ka përfunduar?

2. Nëse përfituesja ka filluar apo përfunduar arsimin e lartë, a është specializuar përfituesja?

3. Përshkruani historinë e punës së përfitueses, përfshirë llojin e punësimit, punëdhënësin, numrin e viteve që është punësuar etj.

4. Përshkruani çdo lloj tjetër aftësish për punë ose gjenerim të ardhurash që ka përfituesi: p.sh. bujqësi, kujdes për kafshët, qepje, gatim etj.

5. Çfarë do të donte të bënte përfituesja për të nxjerrë jetesën? Cilët hapa janë të nevojshëm për të arritur këtë qëllim? Jini specifikë - çfarë lloj arsimimi ose trajnimi profesional? Sa do të zgjasë etj.? A përshtatet kjo me afatet e qëndrimit në strehëz? A është kjo realiste?

6. Nëse përfituesja nuk është e qartë rreth asaj që dëshiron për të bërë për të nxjerrë jetesën, përshkruani fushat e interesit për përfituesen. A dëshiron të krijojë gjëra: gatim, modë, bukuri, bujqësi, kompjuter, ndërtim, makina etj.?


7. Çfarë arsimimi do të nevojitet për të filluar një karrierë në fushën e interesit për përfituesen? Sa do të zgjatë kjo? A përshtatet kjo me afatet e qëndrimit në strehëz? A është kjo realiste?

8. Për cilat punë përfituesja mund t'i plotësonte kushtet menjëherë, pa pasur nevojë për edukim dhe trajnim të mëtejshëm? Sa mund të fitojë realisht me këtë punë përfituesja?

9. A mundet përfituesja të marrë përsipër një punë tani, në kohën që ndjek arsimim të mëtejshëm apo trajnim profesional?

10. A ka probleme përfituesja të cilat mund të kenë ndikim mbi llojin e punës që mund të marrë përsipër (p.sh. probleme shëndetësore, kujdesi për fëmijën etj.)?

Analiza e informacionit të mbledhur:



VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I TRAJNIMIT PROFESIONAL DHE E PUNËSIMIT

- Nuk i intereson ndihma për trajnim profesional ose punësim. Përfituesja ose ka të ardhura të mjaftueshme ose nuk dëshiron të ndjekë trajnim profesional apo të ketë ndihmë në gjetjen e punës.

- Përfituesja ka synime punësimi që kërkojnë arsimim apo trajnim profesional të mëtejshëm. Plani i ndihmës së përfitueses duhet të përfshijë një plan për mënyrën sesi do të arrihen këto kualifikime të nevojshme.

- Përfituesja ka synime punësimi, për të cilat ajo është tashmë e kualifikuar, por kërkon ndihmë në gjetjen e një pune. Plani i ndihmës së përfitueses duhet të përfshijë një plan sesi ajo do të ndihmohet për të gjetur punë.

- Përfituesja nuk e di se çfarë do të bëjë për t'u punësuar. Plani i ndihmës së përfitueses duhet të përfshijë veprimtari dhe/ose testim për të ndihmuar përfituesin në gjetjen e llojit të punës që ajo do të dëshironte të ndiqte.

ANEKSI 9
VLERËSIMI I NEVOJAVE – SIGURIA

Emri i përfituesit: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

Rreziqet e lidhura me përfituesin

1. A ka viktima ndonjë problem mjekësor?
2. A ka viktima ndonjë problem psikologjik që do të krijonte rreziqe gjatë udhëtimit, rikthimit në banesën e mëparshme, vendosjes në një banesë të re apo ndonjë alternativë tjetër strehimi?
(Alkoolizëm/varësi nga drogat/shqetësime psikologjike/tendenca apo episode të dhunshme/paafësi apo refuzim për të vlerësuar nevojën për masa sigurie.)
3. A ka viktima ndonjë problem fizik i cili do të krijonte rreziqe gjatë udhëtimit, kthimit në shtëpi apo kalimit të mundshëm të saj në një tjetër qendër rezidenciale? Nëse po, specifikoni:
Rreziqet e lidhura me familjen e përfitueses
8. A ka histori dhune në familje? Nëse po, specifikoni.
9. A ka të ngjarë që familja të reagojë në mënyrë agresive ndaj viktimës?
10. A ka faktorë të tjerë që mund të prekin mundësinë e rikthimit në familje? Nëse po, specifikoni:
Rreziqet e lidhura me dhunuesin
12. A e njeh dhunuesi vendndodhjen e tanishme të viktimës?
13. A ka të dhëna që dhunuesi është në dijeni që viktima po ndihmohet dhe nga kush?
14. A ka pasur ndonjë formë kontakti ndërmjet viktimës dhe dhunuesit që nga koha e largimit të saj?

Analiza e informacionit të mbledhur:

VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I SIGURISË

- Rrezik i lartë. Përfituesja duket se është në rrezik të lartë prej kërcënimeve nga dhunuesi. Duhet të merren masa për ta zhvendosur përfituesen në një qendër tjetër më të sigurt (me miratimin e përfitueses) dhe të organizohet puna me forcat e ligjit për mbrojtjen e përfitueses apo eventualisht familjes së saj.
- Rrezik mesatar. Ka disa të dhëna që përfituesja ose familja e saj mund të jetë e rrezikuar nga dhunuesi, por këto rreziqe mund të mbahen nën kontroll. Duhet të ndërmerret menjëherë një plan për mbrojtjen e përfitueses nga këto rreziqe.
- Rrezik i ulët: Përfituesja duket që nuk ka ndonjë kërcënim ndaj saj ose familjes. Nuk ka nevojë për të vepruar në këtë moment, por duhet të ndërmerren vlerësime të vazhdueshme nëse ka ndryshim në gjendjen e përfitueses.

ANEKSI 10
VLERËSIMI I NEVOJAVE – AKOMODIM AFATGJATË

Emri i përfitueses: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

1. A ka përfituesja persona në ngarkim të cilët do të jetonin me të? Specifikoni moshën e personave në ngarkim dhe lidhjen me ta, si dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm siç janë problemet mjekësore ose të sjelljes).

2. Ku dëshiron të jetojë përfituesja pasi të largohet nga streha?

3. A ka familje apo miq atje përfituesja me të cilët mund të jetojë?

4. Nëse po, a ka pasur ndonjë kontakt me ta kohët e fundit?

5. A ka pengesa të tjera për jetesën e përfitueses atje (p.sh. ata nuk mund të pranojnë fëmijët e përfitueses, ka tashmë shumë njerëz që jetojnë atje etj.)?

6. Renditni alternativat e tjera për akomodimin afatgjatë të përfitueses dhe përfshini analizën e alternativave bazuar në pyetjet 3-5 më sipër, nëse është e rëndësishme:

a) Qëndrimi me anëtarë të tjerë të familjes;

b) Apartament i ndarë me shoqë;

c) Apartament i subvencionuar nga shteti ose qeveria vendore;

d) Tjetër (specifiko).

Analiza e informacionit të mbledhur:

VLERËSIM I PËRMBLEDHUR I AKOMODIMIT

- Zgjidhur. Ka një shtëpi të sigurt, të shëndetshme ku përfituesja të kthehet pasi të largohet nga qendra rezidenciale. Përfituesja dëshiron të banojë atje. Shtëpia nuk ka abuzim dhe banorët kanë burime të mjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë të tyre, përfshirë ato të përfitueses.

- Kufizime të identikuara. Ka një banesë ku përfituesja dëshiron të kthehet pasi të largohet nga qendra rezidenciale. Megjithatë, ka disa kufizime që duhet të zgjidhen përpara se përfituesja të mund të shkojë atje. Kufizimet mund të përfshijnë: konflikte në familje, mungesë burimesh për të plotësuar nevojat bazë të familjes, punësimi i përfitueses etj. Plani i ndihmës të përfitueses duhet të përfshijë një plan për zgjidhjen e këtyre kufizimeve të identikuara.

- Transferim në një qendër tjetër. Përfituesja ka nevoja të cilat kërkojnë kujdes afatgjatë në një tjetër qendër rezidenciale. Kjo mund të përfshijë përfitues me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, fëmijë që nuk mund të kthehen te shtëpia prindërore apo te një i afërm tjetër etj.

- Kërkon një plan për strehim të pavarur. Përfituesja nuk mund ose nuk dëshiron të kthehet te prindërit apo anëtarë të tjerë të familjes. Përfituesja kërkon një zgjidhje jetese të pavarur. Planet për një zgjidhje të tillë, duhet të përfshihen në planin e ndihmës së përfitueses.

- Transferim në një vend tjetër. Problemet e sigurisë ndaj përfitueses janë të tilla, që nuk mund të jepet një akomodim i sigurt afatgjatë në vend. Plani i riintegrit duhet të përfshijë veprimet që nevojiten për të lehtësuar transferimin në një vend tjetër.

ANEKSI 11
VLERËSIMI I NEVOJAVE – FAMILJA

Emri i përfitueses: _____

Data e vlerësimit: _____

Emri i personit që plotëson formularin: _____

Pozicioni i personit që plotëson formularin: _____

I. Prezantim: ☐ Prezantohuni te familja duke thënë emrin dhe organizatën për të cilën punoni për vlerësimin e familjes.

1. Pyetni familjen e nëse kanë dijeni që përfituesja është larguar nga vendbanimi i saj.

2. Nëse jo, informojini ata mbi shërbimin e strehëzës dhe sigurojini për mirëqenien e përfitueses dhe fëmijëve të saj, eventualisht.

4. Cili është reagimi i prindërve ndaj informacionit tuaj? (Vëzhgoni me kujdes reagimin e prindërve dhe i shkruani vëzhgimet tuaja.)

II. Genograma e familjes

Shënoni emrin, moshën, gjininë dhe lidhjen me përfituesen e të gjithë njerëzve që jetojnë në shtëpi (“Lidhja me përfituesen” mund të jetë baba, nënë, njerë, gjysh, gjyshe, motër, vëlla, dajë, xhaxha, teze, hallë etj.):

Shënoni adresën dhe informacionin e kontaktit të familjes:

III. Jeta e familjes përpara largimit të përfitueses

1. Çfarë di familja mbi marrëdhënien abuzive të përfitueses?

2. Çfarë roli kanë pasur ata? E kanë mbështetur/refuzuar/nuk duan të dinë për problemet e saj?

3. A kishte pasur ndonjëherë probleme familja me përfituesen?

4. Nëse po, çfarë lloj problemesh?

5. Çfarë kanë bërë familjarët për t’i zgjidhur këto probleme?

IV. Gjendja aktuale

1. A ka familja ushqim të mjaftueshëm? Nëse jo, specifikoni:

2. Cila është gjendja e strehimit e familjes? Specifikoni madhësinë e shtëpisë për numrin e njerëzve, gjendjen e shtëpisë, kushtet higjienike, aksesin në ujë dhe energji etj.

3. Cilat janë burimet e të ardhurave për familjen?

4. A sjellin këto aktivitete të ardhura të mjaftueshme? Nëse jo, specifikoni:

5. A ka familja borxhe? Nëse po, specifikoni:

6. A është familja më e varfër krahasuar me të tjerët që jetojnë në të njëjtën zonë?

7. A është familja e kënaqur me kushtet e tyre të jetesës? Nëse jo, specifikoni:

8. A ka ofrues të tjerë shërbimesh shëndetësore pranë? Nëse po, specifikoni:

9. A ka mundësi arsimimi për fëmijën? Nëse po, specifikoni:

10. A ka mundësi punësimi (e vlefshme vetëm për të rriturit dhe fëmijët mbi 16 vjeç).

11. A ka një organizatë që zbaton projekte në zonë?

Nëse po, jepni emrin dhe adresën e organizatës:

Aktivitetet e organizatës:

12. A dëshiron familja kthimin e përfitueses për të jetuar me familjen? Nëse jo, specifikoni përse:

13. A mendon familja që mund t’i ofrojnë mjaftueshëm përfitueses? Nëse jo, specifikoni:

15. Çfarë pret familja që përfituesja të bëjë pasi të jetë kthyer?

16. A do të donte familja që përfituesja të qëndrojë në Tiranë apo qytet tjetër për të kërkuar përsëri një punë/jetë më të mirë?

17. Shënime të tjera: (shkruani çdo çështje tjetër që familja ju tha ose që keni zbuluar rreth familjes).

18. Përshkruani komunitetin ku jeton familja e fëmijës:

- Informacion gjeografik:

- Numri i banorëve/popullatës:
 - Strukturat e udhëheqjes:
 - Burimet e disponueshme (shkolla, qendra mjekësore, banka, organizata etj.):
 - Probleme me të cilat përballen njerëzit në zonë:
19. Informacion tjetër që ju është dhënë nga komuniteti:

Analiza e informacionit të mbledhur:



VLERËSIM PËRMBLEDHËS I FAMILJES

- Zgjidhur: Familja nuk ishte e përfshirë në dhunimin e përfitueses. Familja dëshiron të ketë marrëdhënie me përfituesen dhe nuk shfaq agresivitet ndaj saj. Familja ka burime të mjaftueshme për të mbajtur dhe një person tjetër. Komuniteti ka burime të mjaftueshme për plotësuar nevojat afatgjata të përfitueses për ndihmë.

- Vështirësi. Familja nuk është e përfshirë në dhunimin e përfitueses dhe dëshiron të ketë një marrëdhënie me të. Megjithatë, ka vështirësi që duhet të zgjidhen. Vështirësitë mund të përfshijnë konflikte në familje, keqkuptime ndërmjet familjes dhe përfitueses, kërcënime sigurie nga dhunuesi, mungesë burimesh në familje ose komunitet etj. Plani i ndihmës të përfituesit duhet të përfshijë një plan për zgjidhjen e vështirësive të identifikuar.

- Nevoja për hetim të mëtejshëm. Vlerësimi nuk ishte në gjendje të mohojë përfshirjen e familjes në dhunimin e përfitueses. Vlerësimi, gjithashtu, nuk ishte në gjendje të sigurohej që familja nuk përbën një kërcënim të vazhdueshëm për përfituesen. Plani i ndihmës të përfituesit duhet të përfshijë një plan për një vlerësim më të detajuar të familjes.

- Asnjë. Përfituesja është e rritur dhe nuk dëshiron të ketë kontakte të mëtejshme me familjen e saj.

ANEKSI 12 PLANI I NDIHMËS

Plani i ndihmës duhet të bazohet në nevojat individuale të përfituesit, siç vlerësohen nga formularët e vlerësimit të nevojave që jepen në shtojcat e udhëzimeve. Formularët e vlerësimit të nevojave janë dhënë për fushat e mëposhtme: ndihmë para largimit, siguria, akomodimi afatgjatë, problemet ligjore, shëndeti, punësimi, mbështetja psikosociale, marrëdhëniet familjare, dhe arsimimi. Plani i ndihmës është formatuar në të njëjtën mënyrë që t'u korrespondojë me lehtësi nevojave të procesit të vlerësimit. Një përfitues individual mund të ketë nevojë apo të dëshirojë ndihmë pak a shumë në secilën prej këtyre fushave të ndryshme ose asnjë ndihmë në disa prej tyre. Nëse nuk ka nevojë për ndihmë në një fushë të veçantë ose nuk do t'i jepet gjatë kohës që përfituesi qëndron në strehën tuaj, ju lutemi përfshini vetëm një shpjegim të shkurtër mbi arsyen. Përfshini në plan vetëm ndihmën që do t'i jepet gjatë kohës që përfituesi po ndihmohet nga organizata apo agjencia juaj. Mos futni ndihmën që është e nevojshme por që nuk do t'i jepet.

Shpjegim i shkurtër i kolonave të përfshira në plan:

Objektivi: Cilat janë qëllimet finale që duhet të arrihen? Për shembull, përfituesi është në gjendje të flejë natën. Mos përfshini objektiva të shumëfishtë në një rresht. Ndani objektivat në qëllime të qarta dhe të arritshme.

Veprime/aktivitete. Këto janë hapat ose veprimet që nevojiten për të arritur objektivat. Përsëri, mos përfshini veprime të shumëfishta në një rresht. Ndajini në veprime të qarta, të cilat mund t'i caktohen një individ i cili të jetë përgjegjës për zbatimin e këtij veprimi. Për shembull: a) punë me përfituesin rreth problemeve të ankthit që po pengojnë gjumin; b) eliminimi i kafeinës në mbrëmje; c) ndërmarrja e ushtrimeve fizike për 30 minuta në ditë, të paktën 3 herë në javë.

Personi përgjegjës: Kjo duhet të tregojë personin kryesor përgjegjës për zbatimin e veprimit. Këtu duhet të përfshihen veprimet e stafit, si dhe të përfituesit. Për shembull: a) punonjësi social i rastit dhe përfituesja; b) përfituesja; c) përfituesja.

Data për shqyrtim/vlerësim. Kjo duhet të jetë një datë e arsyeshme për të shqyrtuar progresin. Çdo veprim mund të ketë një datë të ndryshme në varësi të asaj që është e arsyeshme. Afati duhet të japë kohë të mjaftueshme për të vlerësuar progresin por nuk duhet të jetë aq e vonuar sa të humbet momenti.

Treguesi i suksesit. Ky duhet të jetë një tregues i qartë dhe i matshëm i arritjes me sukses të objektivit. Gjithashtu, mund të përfshijë një seri treguesish që do të dokumentonin progresin drejt arritjes së objektivave më të ndërlikuar. Në këtë shembull, një tregues i suksesit mund të ishte që përfituesi fle një numër të caktuar orësh çdo natë. Mund të fillojë me 6 dhe të rritet deri në 8, për shembull.

Ndihma para largimit

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Siguria

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Akomodim afatgjatë

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Probleme ligjore

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Shëndeti

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Punësimi

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Mbështetja psikosociale

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Objektivi	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Objekti	Veprimet/aktivitetet	Personi përgjegjës	Data e shqyrtimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Përfutësja: _____

Emri	Firma	Data
------	-------	------

Përfaqësuesi i strehës: _____

Emri Firma Data

Për fëmijët nën moshën 18 vjeç kërkohet dhe firma e prindit ose kujdestarit ligjor. Nëse prindi apo kujdestari nuk ka mundësi të nënshkruajë formularin, këtu duhet të bashkëngjitet dokumentacioni që shpjegon arsyet.

Prindi/kujdestari i përfutuesit: _____

Emri Firma Data

ANEKSI 13
VLERËSIMI I PJESËMARRËSES NË MOMENTIN E LARGIMIT

Emri: _____ Numri i klientes: _____
Data e pranimit: _____ Data e largimit: _____
Koha e qëndrimit: _____ Numri i fëmijëve në strehëz: _____

Adresa: _____ Numra telefonikë: _____

Përmbledhje e progresit të pjesëmarrës:

Arsyeja e largimit:

Statusi i largimit të pjesëmarrës:

Çfarë është e rëndësishme të ndiqet:

Firma e stafit që plotëson raportin

Data

ANEKSI 14
MONITORIMI AFATGJATË

Emri i përfitueses: _____
Data e mbërritjes në strehë: _____
Data e largimit nga strehëza: _____

Ky formular monitorimi është hartuar për të gjurmuar ndryshimet në kohë në disa fusha të dhëna. Këto fusha korrespondojnë me ato të vlerësimit të nevojave dhe të planeve të ndihmës, në mënyrë që të mund të vlerësohet ndikimi i shërbimeve të ofruara. Ndërkohë që një përfitues individual mund të ketë marrë më shumë ose më pak ndihmë në secilën prej këtyre fushave të ndryshme ose asnjë ndihmë në disa fusha, të gjitha fushat duhet të vlerësohen gjatë monitorimit meqenëse ato mund të jenë tregues i fushave të cilat kërkojnë ndjekje. Ky informacion mund të përdoret dhe për të vlerësuar pikat ku duhet të përqendrohet ndihma për përfituesit e ardhshëm.

SIGURIA

Referojuni vlerësimit të nevojave të sigurisë (shtojca) për udhëzim të detajuar mbi pyetjet për t'u marrë në konsideratë në vlerësimin e rreziqeve të sigurisë. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar nivelin aktual të sigurisë së përfituesit dhe familjes së tij/saj:

- Rrezik i lartë: Përfituesja dhe familja e tij/saj duket që janë në rrezik të lartë hakmarrjeje ose kërcënimesh nga dhunuesi. Duhet të merren masa për të transferuar përfituesen në një strehëz tjetër në një qytet tjetër (me miratimin e përfitueses).

- Rrezik i moderuar: Ka disa të dhëna që përfituesja mund të jetë e rrezikuar nga dhunuesi, por këto rreziqe mund të kontrollohen. Duhet të ndërmerret menjëherë një plan për mbrojtjen e përfitueses nga këto rreziqe.

- Rrezik i ulët: Përfituesja nuk duket që ka ndonjë kërcënim kundër saj. Nuk nevojitet një veprim në këtë moment, por duhet të ndërmerren vlerësime të vazhdueshme të sigurisë në rast se ka ndryshime në gjendjen e përfitueses.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
I lartë				
I moderuar				
I ulët				

Për çdo rritje në nivelet e identifikuara të rrezikut gjatë monitorimit ndjekës, përfshini cilat veprime mund të ndërmerren për të përmirësuar sigurinë e përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Akomodimi afatgjatë

Referojuni vlerësimit të nevojave të akomodimit (shtojca) për një udhëzim të detajuar mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e statusit të akomodimit. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar nivelin e situatës së akomodimit të përfitueses:

- E zgjidhur. Përfituesja jeton në një shtëpi të sigurt e të shëndetshme. Në shtëpi nuk ka abuzim. Banorët kanë burime të mjaftueshme për të plotësuar nevojat bazë të tyre, përfshirë ato të përfitueses. Strehimi është i qëndrueshëm dhe përfituesja mund të vazhdojë të banojë atje në të ardhmen e parashikueshme.

- Kufizime të identifikuara. Përfituesja jeton në një strehim të pranueshëm. Megjithatë, ka disa kufizime që duhet të zgjidhen përpara se situata mund të konsiderohet e zgjidhur. Kufizimet mund të përfshijnë: konflikte në familje, mungesë burimesh për të plotësuar nevojat bazë të familjes, mungesë e të ardhurave për të paguar qiranë etj.

- Transferim në një qendër tjetër. Përfituesja ka nevoja të cilat kërkojnë kujdes afatgjatë në një qendër rezidenciale. Kjo mund të përfshijë përfitues me aftësi të kufizuara mendore ose fizike, fëmijë që nuk mund të kthehen te shtëpia prindërore apo te një i afërm tjetër etj.

- Kërkon një plan për strehim të pavarur. Përfituesja vazhdon të kërkojë një zgjidhje jetese të pavarur.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
E zgjidhur				
Kufizime të identifikuar				
Transferim në një qendër				
Strehim i pavarur				
Transferim				

Për çdo situatë, përveç atyre “të zgjidhura”, të identifikuar gjatë monitorimit të rastit, përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e akomodimit të përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Shqetësimet ligjore

Referojuni vlerësimit të nevojave ligjore (shtojca) për udhëzime të detajuara mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e nevojave të ndihmës ligjore. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar gjendjen e ndihmës ligjore të përfitueses:

- Asnjë. Përfituesja nuk ka pasur dhe vazhdon të mos ketë shqetësime ligjore apo nevojë për ndihmë ligjore.

- E zgjidhur në mënyrë të kënaqshme. Problemi ligjor i përfitueses (siç është identifikuar gjatë vlerësimit të nevojave ose gjatë monitorimit të mëparshëm) është zgjidhur në mënyrë të kënaqshme për përfituesen.

- E zgjidhur në mënyrë të pakënaqshme. Problemi ligjor i përfitueses (siç është identifikuar gjatë vlerësimit të nevojave ose gjatë monitorimit të mëparshëm) është zgjidhur, por përfituesja nuk është e kënaqur me rezultatin.

- Probleme të identifikuar. Përfituesja vazhdon të ketë probleme ligjore (ose ka probleme të reja ligjore), të cilat kërkojnë ndihmë.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
Legjislacioni i familjes				
Asnjë				
E zgjidhur në mënyrë të kënaqshme				
E zgjidhur në mënyrë të pakënaqshme				
Probleme të identifikuar				
Akuza penale kundër përfitueses				
Asnjë				
E zgjidhur në mënyrë të kënaqshme				
E zgjidhur në mënyrë të pakënaqshme				
Probleme të identifikuar				
Bashkëpunimi me forcat e zbatimit të ligjit				
Asnjë				

E zgjidhur në mënyrë të kënaqshme				
E zgjidhur në mënyrë të pakënaqshme				
Probleme të identifikuara				
Kërkesa për dëshmipërblim				
Asnjë				
E zgjidhur në mënyrë të kënaqshme				
E zgjidhur në mënyrë të pakënaqshme				
Probleme të identifikuara				

Për çdo situatë, përveç atyre “të zgjidhura në mënyrë të kënaqshme”, të identifikuara gjatë monitorimit të rastit, përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen ligjore të Përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/ vlerësimit	Treguesi i suksesit

Shëndeti

Referojuni vlerësimit të nevojave shëndetësore (shtojca) për udhëzime të detajuara mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të përfitueses. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar gjendjen aktuale shëndetësore të përfitueses:

- Mirë. Nuk ka probleme shëndetësore të tanishme që mund të paraqesin shqetësim. Përfituesja nuk ka më shumë se kollë, të ftohur apo grip dhe këto ose nuk ndodhin shpesh ose nuk zgjatin më shumë se sa pritët. Nuk ka probleme të vazhdueshme që të ndikojnë mbi shkollën, trajnimin, punën apo marrëdhëniet sociale dhe nuk ka sjellje të rrezikshme shëndetësore. Aftësitë e kufizuara nuk prekin punën, lojën apo marrëdhëniet sociale. Përfituesja ha mirë dhe shfaq një dietë të shëndetshme dhe ushtrim fizik. Përfituesja nuk shfaq shenja të sëmundjeve mendore apo depresionit.

- Kënaqshëm. Përfituesja është në përgjithësi mirë por mund të vuajë shpesh sëmundje të lehta. Megjithatë, problemet e menjëhershme shëndetësore mund të trajtohen pothuajse gjithmonë nga vetë Përfituesja dhe ata që kujdesen për të. Problemet kronike shëndetësore, sëmundjet mendore dhe aftësitë e kufizuara menaxhohen mirë dhe nuk ndikojnë mbi shkollën, punën dhe marrëdhëniet sociale. Përfituesja po merr përkujdesje për çdo problem shëndetësor që kërkon mjekim të rregullt apo kontrollë të rregullta nga ana e shërbimeve mjekësore të specializuara. Përfituesja nuk shfaq shenja depresioni.

- Disa vështirësi. Përfituesja ka disa probleme shëndetësore të vazhdueshme apo të përsëritura akute që ndikojnë mbi shkollën, trajnimin, punën apo veprimtarinë sociale. Këto mund të përfshijnë periudha të shpeshta azme, ekzema të rënda, alergji, probleme të frymëmarrjes dhe kardiake, ose depresion. Problemet kronike shëndetësore dhe aftësitë e kufizuara kërkojnë ndërhyrje të shpeshta dhe po ndikojnë mbi rutinën dhe marrëdhëniet sociale të përfitueses. Përfituesja ka vështirësi në aksesin në kujdes shëndetësor ose mjekim për kushte mjekësore akute ose kronike. Një veçori përcaktuese është ekzistenca e disa kufizimeve të jetës së përditshme.

- Vështirësitë për momentin i tejkalojnë pikat e forta. Përfituesja ka probleme të mëdha akute apo kronike shëndetësore që kërkojnë ndërhyrje të vazhdueshme mjekësore dhe/ose ndihmë të veçantë nga kujdestarët. Aftësitë e kufizuara nuk janë trajtuar siç duhet. Përfituesja shfaq shenja të depresionit apo të vetëvrasjes së mundshme. Problemet shëndetësore dhe/ose fizike të përfitueses ndikojnë shumë mbi rutinën dhe/ose marrëdhëniet e tyre sociale.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
Mirë				
Kënaqshëm				
Disa vështirësi				
Vështirësitë i tejkalojnë pikat e forta				

- Për vështirësitë e identifikuar gjatë monitorimit të rastit, përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen shëndetësore të përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Punësimi

Referojuni vlerësimit të nevojave profesionale/punësimit (shtojca) për udhëzime të detajuara mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e gjendjes së punësimit të përfitueses. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar gjendjen e punësimit të përfitueses:

- Nuk është i interesuar. Përfituesja është e interesuar të gjejë punësim apo të ndërmarrë trajnim profesional.
- Synim i arritur. Përfituesja është e punësuar ose ka të ardhura nga fusha që plotëson synimet e tij/saj. Përfituesja është i kënaqur me punën dhe të ardhurat e saj.
- E kënaqur. Përfituesja ka një punësim që është i kënaqshëm por nuk i plotëson krejtësisht synimet e saj. Përfituesja mendon që të ardhurat janë të mjaftueshme.
- E pakënaqur. Përfituesja është e punësuar, por është e pakënaqur me punën ose me të ardhurat e saj.
- Në trajnim. Përfituesja aktualisht po ndjek trajnim profesional.
- E papunë. Përfituesja dëshiron të punësohet, por aktualisht është e papunë.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
Nuk është e interesuar				
Synim i arritur				
E kënaqur				
E pakënaqur				
Në trajnim				
E papunë				

- Për përfitueset që shikohen që janë të papuna ose të pakënaqura me punësimin ose të ardhurat e tyre, përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e punësimit të përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Gjendja psikosociale

- Referojuni vlerësimin të nevojave psikosociale (shtojca) për udhëzime të detajuara mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e gjendjes psikosociale të përfitueses. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar gjendjen psikosociale të përfitueses:

- Mirëpërshtatur. Përfituesja ka shumë pika të forta dhe nuk shfaq shenja të problemeve emocionale apo psikologjike. Përfituesja ka një kuptim të qartë të aftësive dhe kufizimeve të tij/saj dhe është në gjendje të ndjehet mirë për aftësitë dhe të mos shqetësohet për kufizimet. Përfituesja shkon mirë me të tjerët dhe ka marrëdhënie pozitive me familjen dhe miqtë. Ajo është e ndjeshme ndaj ndjenjave të të tjerëve dhe është në gjendje të përshtatë sjelljen e saj sipas situatës dhe rrethanave. Sjellja e përfitueses nuk ka ndikim negativ mbi punën apo aktivitetin social të saj.

- Kënaqshëm. Gjendja psikosociale e përfitueses është në përgjithësi pozitive dhe përfituesja shfaq një numër pikash të forta dhe vetëm disa vështirësi, të cilat mund të shihen si kalimtare (p.sh. një reagim ndaj ngjarjeve të kohëve të fundit). Përfituesja ka një mendim përgjithësisht pozitiv për veten dhe mendon që ka aftësi dhe veti personale, të cilat pëlqehen nga njerëzit e tjerë. Përfituesja zakonisht është në gjendje të bashkohet në veprimtari dhe të bashkëpunojë me miqtë, kolegët dhe familjen. Përfituesja ka marrëdhënie të mira sociale, por mund të shfaqë pak padurim ose mosangazhim herë pas here. Sjellja e përfitueses nganjëherë mund të ndikojë negativisht mbi punën apo aktivitetin social të saj. Vëmendja ndaj paraqitjes fizike dhe higjienës nganjëherë mund të mungojë.

- Disa vështirësi. Ndërkohë që pikat e forta janë të dukshme, përfituesja shfaq disa shenja shqetësimi emocional ose psikologjik. Sjellja sfiduese mund të jetë më e vështirë për t'u trajtuar, periudhat e hidhërimit apo mërzisë janë më të shpeshta dhe më të vështira për të vendosur kontakt, apo nervozizmi dhe hutimi mund të ndërhyjnë në disa aspekte të jetës. Përfituesja mund të demonstrojë dyshime të vazhdueshme rreth vetes dhe vlerës së tyre. Ajo mund të shqetësohet se ku bëjnë pjesë nga ana sociale dhe nëse pranohet apo pëlqehet nga familja, miqtë apo kolegët. Përfituesja mund të duket i izoluar nga ana sociale ose sepse ajo ka tendencë të tërhiqet dhe të shkëpusë marrëdhëniet ose nuk u pëlqen dhe injorohet nga të tjerët. Pamja e jashtme e përfitueses mund të japë përshtypjen e një mungese interesi në pamjen sociale dhe higjienë ose në të kundërt një preokupim i tepërt në paraqitje.

- Vështirësitë i tejkalojnë pikat e forta. Problemet i tejkalojnë pikat e forta për momentin. Ka dukshëm disa probleme shqetësuese emocionale dhe të sjelljes, të cilat ndërhyjnë në jetën e përfitueses dhe venë në dukje nevojën për këshillim apo ndihmë profesionale. Përfituesja ka mendime të vazhdueshme negative për veten. Përfituesja ka probleme me marrëdhëniet me familjen, marrëdhëniet sociale ose të punës, nuk është në gjendje të modifikojë veprimet e saj për t'u përshtatur me të tjerët apo të harmonizojë emocionet e tij me ato të të tjerëve. Ajo mund të jetë e tërhequr, e zymtë, sfiduese ose agresive në shumë situata dhe marrëdhënie ose mund të ngrejë zërin dhe të shkaktojë situata të sikletshme në publik. Ajo ka vështirësi të përshtatë sjelljen ose paraqitjen me njerëz të ndryshëm dhe situata të ndryshme. Pamja e jashtme mund të duket qëllimisht e neglizhuar ose fyese, ose e zgjedhur për të reflektuar një nevojë për t'u shkëputur nga jeta sociale, më shumë sesa për t'u përshtatur me një pjesë të saj.

- Alarm. Përfituesja shfaq shenja të depresionit të rëndë ose vetëvrasjeje të mundshme.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
Mirëpërshtatur				
Kënaqshëm				
Disa vështirësi				
Vështirësitë i tejkalojnë pikat e forta				
Alarm				

Për përfitueset që shikohen që kanë vështirësi të vazhdueshme psikosociale , përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen psikosociale të përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/ vlerësimit	Treguesi i suksesit

Parandalimi i vetëvrasjes. Në rastet kur përfituesja shfaq shenja depresioni apo vetëvrasjeje të mundshme, duhet të merren veprime të menjëhershme. Duhet të konsultohen ekspertët e duhur, diskutimet me përfituesen duhet të mbahen vetëm nga ana e profesionistëve të trajnuar për këtë, dhe përfituesja duhet të mbikëqyret me kujdes për të parandaluar çdo përpjekje vetëvrasjeje

Familja

Referojuni vlerësimit të nevojave të familjes (shtojca) për udhëzime të detajuara mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e marrëdhënieve familjare të përfitueses. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar gjendjen familjare të përfitueses:

E zgjidhur. Përfituesja është e kënaqur me marrëdhënien që ka me familjen e saj.

- Kufizime. Përfituesja ka një marrëdhënie me familjen por ka kufizime në këtë marrëdhënie. Këto kufizime mund të përfshijnë konflikte në familje, probleme ekonomike, ndarja gjeografike etj.

- Asnjë. Përfituesja është e rritur dhe nuk dëshiron të ketë kontakte të mëtejshme me familjen e saj.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
E zgjidhur				
Kufizime				
Asnjë				

Për përfitueset që shikohen që kanë kufizime në marrëdhëniet e tyre familjare, përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/ vlerësimit	Treguesi i suksesit

Edukimi

Referojuni vlerësimit të nevojave të arsimimit (shtojca) për udhëzime të detajuara mbi pyetjet që duhet të merren në konsideratë në vlerësimin e nevojave të përfitueses për arsimim. Përdorni udhëzimet e mëposhtme për të vlerësuar gjendjen arsimore të përfitueses:

Përfunduar. Përfituesja ka përfunduar arsimimin formal.

- Ndjek me sukses. Përfituesja ndjek shkollën dhe po përparon mirë.

- Ndjek me probleme: Përfituesja po ndjek shkollën por ka vështirësi. Vështirësitë mund të jenë akademike ose sociale.

- Nuk është regjistruar. Përfituesja dëshiron të ndjekë shkollën, por nuk është regjistruar aktualisht.

Nuk është i interesuar. Përfituesja nuk dëshiron të vazhdojë arsimimin e saj.

Statusi	Në momentin e hyrjes në program	Në momentin e largimit nga streha	Gjashtë muaj pas largimit	Një vit pas largimit
Përfunduar				
Ndjek me sukses				
Ndjek me probleme				
Nuk është regjistruar				
Nuk është e interesuar				

Për përfitueses që shikohen që kanë probleme në shkollë apo në regjistrimin në shkollë, përfshini këtu hapat që mund të ndërmerren për të përmirësuar gjendjen e përfitueses.

Veprimet/veprimtaritë	Personi përgjegjës	Data e rishikimit/vlerësimit	Treguesi i suksesit

Emri i personit që kryen analizën gjashtëmujore: _____

Data e analizës gjashtëmujore: _____

Analiza e Kryer: ☐ Personalisht ☐ Me telefon ☐ Tjetër: _____

Emri i personit që kryen analizën vjetore: _____

Data e analizës vjetore: _____

Analiza e kryer: ☐ Personalisht ☐ Me telefon ☐ Tjetër: _____

ANEKSI 15 DETYRIMET E PJESËMARRËSEVE

Gjatë qëndrimit në strehëz pjesëmarrëset janë të detyruara të respektojnë disa rregulla që mundësojnë shërbimin dhe bashkëjetesën në këtë institucion. Thyerja e këtyre rregullave mund të çojë në largimin e paplanifikuar të tyre nga strehëza.

- Pjesëmarrëset ruajnë fshehtësinë (konfidencialitetin): Pjesëmarrësja nuk do të shkëmbejë, gjatë apo pas qëndrimit në strehëz, me pjesëmarrëset e tjera apo individë jashtë programit, me të cilët ajo ka kontakte (përfshirë anëtarët e familjes, të afërmit, miqtë etj.), informacion identifikues që paraqet rrezik për sigurinë e saj apo të përfitueseve të tjera dhe stafit.

Një informacion i tillë që nuk duhet të shkëmbehet përfshin emra apo informacion tjetër që identifikon përfitueset e tjera apo stafin, vendndodhjen e strehëzës, historitë personale të tjerave, numrat e telefonit të stafit apo zyrës etj.

- Pjesëmarrësja duhet të njoftojë menjëherë stafin në turn mbi çdo shqetësim që ajo ka në lidhje me individë apo rrethana që e kërcënojnë atë, pjesëmarrëset e tjera apo stafin e strehëzës.

- Pjesëmarrësja në moshë madhore është përgjegjëse për sigurinë e jetës së saj dhe të fëmijëve. Ajo vlerëson shkallën e rrezikut dhe merr masa në përputhje me situatën e saj për lëvizjet jashtë strehëzës.

- Pjesëmarrësja ka për detyrë të trajtojë me respekt dhe dinjitet personelin që i ofron shërbimet dhe pjesëmarrëset e tjera.

- Pjesëmarrëset kanë për detyrë t'u japin ofruesve të shërbimeve informacionin që u duhet. Kjo i ndihmon ofruesit të realizojnë shërbimet e ndihmës në mënyrën më të mirë të mundshme.

- Pjesëmarrëset kanë për detyrë të bëjnë pyetje për shërbimet. Kjo i ndihmon ato të kuptojnë shërbimet dhe rezultatet e pritshme të tyre.
- Pjesëmarrësja ka për detyrë të ndihmojë në mirëmbajtjen e strehëzës. Pjesëmarrësja kontribuon në mënyrë të barabartë me pjesëmarrëset e tjera në pastrimin dhe mirëmbajtjen e strehëzës, përgatitjen e ushqimit, dhe në mënyra të tjera që kontribuojnë në jetën e përditshme të strehëz.
- Pjesëmarrësja ka për detyrë të ruajë një mjedis të shëndetshëm në strehëz. Përfitueses nuk i lejohet të sjellë nga jashtë ushqime, alkool, droga apo substanca të tjera të dëmshme. Ajo është e detyruar të njoftojë menjëherë stafin nëse individë të tjerë sjellin brenda substanca të tilla.
- Pjesëmarrësja ka për detyrë të kujdeset dhe të mirëmbajë sendet që i jepen nga institucioni, përfshirë ato për përdorim personal dhe të përbashkët.
- Pjesëmarrësja ka për detyrë të marrë pjesë në hartimin dhe realizimin e objektivave për trajtimin e saj. Pjesëmarrësja është e detyruar të jetë e sinqertë dhe e hapur me punonjës social që ndjek rastin e saj. Çdo rast mospërputhje midis aftësive të punonjës social dhe planit të ndihmës, nëse ka, duhet bërë evident sa më shpejt të jetë e mundur. Pjesëmarrësja ka për detyrë të marrë pjesë në të gjitha takimet apo aktivitetet individuale apo në grup të përcaktuara në planin e saj të ndihmës.
- Pjesëmarrësja ka për detyrë të zbatojë orarin ditor të strehëzës dhe të marrë pjesë në aktivitetet ditore.
- Pjesëmarrëset që kanë fëmijë duhet të mbajnë përgjegjësi për fëmijët e tyre. Përgjegjësia për fëmijët nuk duhet t'u kalojë pjesëmarrëseve të tjera apo stafit të strehës. Bëjnë përjashtim rastet kur pjesëmarrëset bien dakord për një kujdes afatshkurtër për fëmijët.

ANEKSI 16

TË DREJTAT E PJESËMARRËSES NË SHËRBIMET E STREHËZËS

Pjesëmarrëset e shërbimit të strehëzës për viktimat e dhunës në familje kanë të drejta të padiskutueshme që duhet të respektohen gjatë procesit të ndihmës. Pjesëmarrëset duhet të jenë të informuara për këto të drejta dhe të kërkojnë respektimin e tyre gjatë procesit të ndihmës.

Strehëza duhet të garantojë që të gjithë pjesëmarrëseve t'u sigurohen këto të drejta bazë:

1. Të trajtohen me dinjitet, respekt dhe konsideratë.
2. Të mos diskriminohen pavarësisht nga mosha, origjina, seksi, raca, etnia apo besimi fetar.
3. Të marrin shërbim i cili:
 - mbështet dhe respekton individualitetin, zgjedhjet, pikat e dobëta dhe aftësitë e pjesëmarrëses;
 - mbështet lirinë vetjake të pjesëmarrëses dhe e kufizon lirinë vetjake të pjesëmarrëses vetëm me pëlqimin e pjesëmarrëses apo vetëm për të siguruar jetën;
 - nuk vë në rrezik marrëdhëniet e punës.
4. Të mos pengohen nga ushtrimi i të drejtave civile të pjesëmarrëses, me përjashtim të rastit kur pjesëmarrësja gjykohet si e pazonja ose kur një vendim gjykate kompetente ka konstatuar se pjesëmarrësja nuk është në gjendje të ushtrojë një të drejtë konkrete ose një kategori të drejtash.
5. Qëndrimi në strehë dhe pjesëmarrja në program është vullnetar. Përfituesja ka të drejtë të largohet nga programi në çdo moment, për sa kohë largimi bëhet ditën, ndërmjet orës 8:00 dhe 16:00. Përfituesja duhet të bëjë përpjekje për të njoftuar për largimin e saj të paplanifikuar të paktën dy ditë përpara.
6. Pjesëmarrësja ka të drejtën të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga programi, sipas një plani të përgjithshëm dhe individual të hartuar nga vetë pjesëmarrësja dhe punonjësi social që ndjek rastin e saj, në konsultim edhe me punonjës të tjerë të stafit.
7. Pjesëmarrësja ka të drejtën e vetëvendosjes në identifikimin dhe përcaktimin e qëllimeve, hartimin e planeve të ndihmës, dhe vendimin për llojet e shërbimit që duhet marrë.

8. Gjatë qëndrimit në strehëz, pjesëmarrësja ka të drejtë të ketë një akomodim të pastër dhe të sigurt, si dhe vakte të rregullta dhe të ushqyeshme.

9. Pjesëmarrësja ka të drejtën të ketë akses në dosjen e saj kur ka interes apo i kërkohet për t'u përdorur sipas interesave të saj. Të dhënat e saj mbahen të fshehta dhe tregohen vetëm me lejen e saj.

10. Pjesëmarrësja ka të drejtë të ankohet nëse shërbimet nuk i ofrohen, nëse këto shërbime nuk janë me cilësi të mirë ose nëse ajo nuk trajtohet në mënyrë të barabartë dhe me respekt e dinjitet.

11. Pjesëmarrësja ka të drejtë të sugjerojë përmirësime në shërbime dhe funksionim të strehëzës.

12. Ankesat dhe sugjerimet hidhen në kutinë përkatëse që është e vendosur në vende të dukshme të strehëzës.

13. Pjesëmarrëset kanë të drejtën të kërkojnë, të bisedojnë dhe të ndihmohen nga një avokat, të cilin mund ta zgjedhë vetë pjesëmarrësja. Kur avokati zgjidhet prej saj shpenzimet i paguan pjesëmarrësja.

14. Të kenë mbrojtje të jetës private gjatë letërkëmbimit, komunikimit, vizitave, punëve financiare dhe higjienës vetjake, me përjashtim të rasteve kur siguria e kërkon ndryshe.

15. Të kenë mbrojtje të jetës private gjatë shërbimeve, duke përfshirë të drejtën për të mos i dhënë gjurmët e gishtave, për të mos u fotografuar apo për të mos u regjistruar pa dhënë pëlqimin e vet, me përjashtim të:

- regjistrimeve të përkohshme në video të përdorura për qëllime sigurie.

16. Të shqyrtojnë, pas kërkesës me shkrim, evidencat e vetë pjesëmarrëses gjatë orarit zyrtar të strehëzës ose në një kohë për të cilën është rënë dakord.

17. Të japin pëlqimin për shërbimet pasi u është bërë një shpjegim me gojë të shërbimit të propozuar, duke përfshirë rezultatit e synuar, procedurat e përfshira në shërbimin e propozuar, çdo rrezik apo efekte anësore që mund të vijnë nga shërbimi i propozuar dhe çdo alternativë ndaj planit të propozuar.

18. Të marrin referime për ofrues të tjerë të shërbimeve nëse strehëza nuk është në gjendje të ofrojë një shërbim që e kërkon pjesëmarrësja ose që përcaktohet në planin e ndihmës së pjesëmarrëses. Për më tepër, kanë të drejtën të dinë, nëse e kërkojnë, informacion për grupet e avokatisë dhe të komunitetit dhe për shërbimet e parandalimit.

19. Të mos pranojnë shërbime apo ta tërheqin pëlqimin për shërbimet, me përjashtim të rastit kur një shërbim i tillë është i nevojshëm për t'i shpëtuar jetën ose shëndetin fizik pjesëmarrëses;

20. Të mos vuajnë nga:

- a) abuzimi;
- b) moskujdesja;
- c) shfrytëzimi;
- d) shtrëngimi;
- e) manipulimi;
- f) ndëshkimi për shkak se paraqesin një ankesë në ndonjë subjekt;
- g) trajtimi që përfshin:
 - i) mosdhënien e ushqimit;
 - ii) mosdhënien e mundësisë për të fjetur; ose
 - iii) mosdhënien e mundësisë për të përdorur tualetin; dhe
 - iv) kufizimin e lëvizjeve ose izolimin e çfarëdo forme.

21. pjesëmarrëset kanë të drejtë të mbajnë nën kontroll financat e veta.

22. pjesëmarrëset kanë të drejtë të marrin pjesë ose të mos pranojnë të marrin pjesë në veprimtari fetare.

23. Pjesëmarrëset kanë të drejtë të kenë leje të përkohshme nga strehëza. Pjesëmarrëset kanë të drejtë të largohen përkohësisht nga strehëza pas nënshkrimit të një deklarate për leje të përkohshme që përcakton qëllimin dhe kohën e kthimit.

24. Pjesëmarrëset kanë të drejtë të ruajnë dhe rivendosin kontaktet me anëtarët e familjes dhe institucionet e ndihmës, të cilët janë pranuar nga vetë pjesëmarrëset si të besueshëm. Pjesëmarrësja ndihmohet nga stafi për të hartuar një plan të qartë dhe të sigurt takimesh apo kontaktesh me anëtarët e familjes. Pjesëmarrësja ka të drejtë të shoqërohet nga stafi në takimet me anëtarët e familjes dhe institucionet e besuara nëse ajo dëshiron apo e vlerëson si të nevojshme.

25. Pjesëmarrëset kanë të drejtë të mos pranojnë të bëjnë punë, që nuk lidhem me qëndrimin e tyre në strehëz, me përjashtim të punëve të shtëpisë dhe aktiviteteve të nevojshme për ruajtjen e shëndetit dhe të higjienës vetjake.

26. Pjesëmarrëset kanë të drejtë të marrin pjesë ose të mos pranojnë të marrin pjesë në veprimtari kërkimore apo eksperimentale.

27. Të marrin shërbime në mjedise ku nuk konsumohet duhani.

Të gjithë pjesëmarrëset duhet të marrin një njoftim zyrtar të “Të drejtave të pjesëmarrëses”, i cili duhet të lexohet dhe nënshkruhet nga secila prej tyre dhe të vendoset në kartelat e tyre përkatëse. Krahës kësaj, një kopje e këtyre të afishohet në vende të dukshme në secilën strehëz, si edhe në Zyrën e Administratës.

ANEKSI 17 RREGULLORJA E STREHËZËS

Kjo rregullore u drejtohet të gjitha përfitueseve në moshë të rritur. Rregullat dhe kufizimet e përfshira në të janë të vlefshme për personat që qëndrojnë në strehëzës ose marrin shërbime të tjera nga organizatat e rjetit të shërbimeve kundër dhunës (p.sh. linjat e këshillimit).

- Trajtoni përfitueset e tjera dhe stafin me respekt dhe mirësjellje.
- Respektoni detyrimet për ruajtjen e sekretit dhe konfidencialitetit të strehëzës.
- Mos hani derën e strehëzës pa u siguruar për personin që është pas saj. Shikoni te syri magjik përpara se të hapni derën.
- Pranoni dhe ndërmerrni detyrat që ju caktohen në strehëz.
- Mbani të rregullt dhe të pastër hapësirën tuaj personale të fjetjes në strehëz.
- Respektoni pronën dhe burimet e strehëzës dhe përdorini ato me kujdes dhe me përgjegjësi.
- Respektoni orarin e strehëzës, duke përfshirë orët e gjumit dhe zgjimit.
- Merrni leje nga stafi i strehëzës përpara se të largoheni dhe kur hyni në strehëz.
- Përfitueset nuk lejohen të largohen nga strehëza pa lejen e punonjësve të strehëzës edhe në rastet kur duhet të marrin shërbim mjekësor ose për t'u takuar me autoritetet e zbatimit të ligjit.
- Edhe në rastet e daljes me urgjencë nga strehëza, përfitueset duhet të gjejnë mënyrën e informimit të punonjësve.
- Përfitueset janë të detyruara të respektojnë trajtimet e rekomanduara nga mjekët, psikologët dhe stafi i strehëzës.
- Mjekimet duhet të merren në përputhje me dozën dhe kohën e rekomanduar.
- Banorëve u kërkohet të marrin pjesë në veprimtaritë e mëposhtme: këshillim individual sipas një plani të hartuar në bashkëpunim dhe mirëkuptim me punonjësën e rastit; këshillim në grup sipas tematikave të paracaktuara nga punonjësja sociale e strehëzës; kujdes dhe vëmendje të vazhdueshme ndaj fëmijës/fëmijëve të tyre; pastrim dhe mirëmbajtje të mjediseve të gjumit, kuzhinës, tualeteve dhe gatim; mirëmbajtje të mjediseve rreth godinës; aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnimi që ofrohen në mjediset e strehëzës ose diku tjetër sipas programit të punës së strehëzës.
- Të gjitha përfitueset duhet të mbajnë një higjienë të rreptë personale.
- Nuk lejohen të folurit me zë të lartë, të bërtiturat ose zhurmat e tjera në strehëz.
- Nuk lejohet përdorimi i çfarëdolloj forme të dhunës ndaj përfitueseve të tjera apo pjesëtareve të stafit, si dhe nuk lejohet përdorimi i një gjuhë fyese apo denigruese ndaj personave të tjerë në strehëz.

- Nuk lejohet përdorimi i objekteve që mund të konsiderohen të rrezikshme apo armë. Ato janë të detyruara t'i dorëzojnë ato pranë personelit të strehëzës. Vendimarrja është e stafit të strehëzës.

- Ndalohet rreptësisht përdorimi i alkoolit, drogave ose barnave të tjera që nuk janë rekomanduar nga mjeku.

- Pirja e duhanit lejohet vetëm në zonat që janë caktuar për këtë qëllim.

- Përfitueset që konsumojnë duhan duhet t'i mbulojnë vetë shpenzimet për duhanin. Kostoja e duhanit nuk është në listë e shërbimeve të ofruara nga strehëza.

- Përfitueset nuk mund të tymosin më shumë se një paketë cigare në ditë.

- Përfitueset mund të konsumojnë deri në 5 (pesë) kafe në ditë. Pirja e kafesë bëhet në mjediset e përbashkëta (kuzhinë, dhomë ndenjeje, verandë, oborr).

- Përfitueseve nuk u lejohet të hyjnë në mjediset e zyrave pa trokitur dhe pa lejen e punonjëseve.

- Të gjitha objektet personale me vlerë duhet t'i jepen stafit për ruajtje dhe fleta e dorëzimit duhet të mbajë firmën tuaj dhe të anëtarit të stafit. Strehëza nuk është përgjegjëse për objektet personale që nuk i janë dhënë stafit në ruajtje.

- Për arsye sigurie, përfitueset duhet të dorëzojnë te stafi telefonat e tyre celularë. Ata do të kthehen vetëm pas largimit të përfitueses nga strehëza. Përdorimi i tyre për arsye personale bëhet vetëm me lejen e punonjëseve të strehëzës.

- Për arsye sigurie, telefonatat personale lejohen vetëm për anëtarët e familjes. Këto telefonata mund të bëhen me lejen dhe sipas rastit edhe në prani të një punonjësi social.

- Ndalohen rreptësisht vizitat e familjarëve apo të njohurve në strehëz.

- Përfitueset mund të vizitojnë anëtarët e familjes vetëm me lejen dhe miratimin e punonjëses së strehëzës.

- Respektoni rregullat për përdorimin e pajisjeve dhe dhomave, si p.sh. orari për larjen e rrobave, orari i gatimit, orari i dushit, orari i ndjekjes së programeve të televizionit apo orari i gjumit.

ANEKSI 18 LISTËKONTROLI I LARGIMIT

Anëtari i stafit: _____

Pjesëmarrësja: _____

Data dhe ora e largimit: _____

Kjo listë përgatitet për të konfirmuar që procedurat e mëposhtme janë ndjekur përpara largimit të pjesëmarrëses nga strehëza:

- Pjesëmarrësja dhe punonjësja e rastit diskutuan arsyet për largimin e pjesëmarrëses.

- Pjesëmarrësja ka një vend ku të qëndrojë. Adresa dhe kontakti me telefon i pjesëmarrëses:

- Procedurat dhe masat për udhëtimin janë marrë dhe i janë shpjeguar pjesëmarrëses. Më poshtë janë detajet e udhëtimit:

- Pjesëmarrëses i është kërkuar të plotësojë një pyetësor anonim vlerësimi të shërbimit të strehëzës.

- Pjesëmarrëses i janë dhënë kopje të dosjes së saj mjekësore.

- Pjesëmarrëses i është dhënë informacioni i kontaktit për organizatat ose agjencitë që mund ta ndihmojnë atë në të ardhmen. Më poshtë janë detajet e kontakteve:

- Pjesëmarrëses i janë dhënë paratë ose sendet e vlefshme që i janë mbajtur nga organizata ofruese e shërbimeve.

- Pjesëmarrësit i janë dhënë çanta për udhëtim dhe ajo ka paketuar të gjitha sendet personale dhe është gati të nisët.
- Pjesëmarrësja ka veshmbathje të përshtatshme për stinën.
- Pjesëmarrësja ka kthyer të gjitha sendet që janë pronësi e ofruesit të shërbimeve.
- Nënshkrimi im më poshtë vërteton se unë po largohem nga strehëza pasi kam marrë shërbimin e nevojshëm për një kohë të caktuar kohore sipas planit të vlerësimit dhe ndihmës.
- Nënshkrimi im më poshtë vërteton që unë po largohem vullnetarisht nga strehëza.
- Unë i kuptoj masat e marra për mua, nëse këto janë marrë për arsye të shkeljes së rregullores/detyrimeve.
- Nëse unë kam zgjedhur të largohem pa u ndihmuar, unë marr përsipër përgjegjësinë dhe nuk bëj përgjegjësi ofruesin e shërbimeve për çdo pasojë të vendimit tim për t'u larguar nga strehëza pa masa dhe ndihmë paraprake.

Nënshkruani formularin në dy kopje. Një kopje e këtij formulari duhet të mbahet në dosjen e pjesëmarrësës dhe një kopje t'i jepet pjesëmarrësës.

Përfituesja:

Emri

Firma

Data

Stafi i strehës:

Emri

Firma

Data

Vetëm për pjesëmarrësit nën moshën 18 vjeç (fëmijë që vijnë në strehëz së bashku me nënat e tyre):

Prindi/kujdestari i përfituesit

Emri

Lidhja me përfituesin

Firma

Data

Shënim. Një përfituese e rritur nuk duhet të mbahet kundër dëshirës së saj në strehëz. Ofruesi i shërbimeve nuk duhet të kontaktojë autoritete të tjera mbështetëse pa pëlqimin e shprehur të përfitueses, përfshirë dhe policinë e familjen. Në rastin e të miturve, prindi ose kujdestari ligjor duhet të miratojnë largimin e përfitueses nga strehëza.

ANEKSI 20

PROCEDURA E ANKIMIMIT

Pjesëmarrëset kanë të drejtë të ankohen rreth çdo aspekti të rastit të tyre dhe rreth shërbimeve që ata kanë ose nuk kanë marrë. Pjesëmarrëset mund të dorëzojnë ankesat e tyre me shkrim ose me gojë. Ata kanë, gjithashtu, të drejtë të ankohen në mënyrë anonime. Ankesat mund t'i drejtohen stafit të strehëzës, drejtuesve të strehëzës, ose drejtorisë rajonale të shërbimeve sociale. Përveç ankimit në mënyrë të drejtpërdrejtë verbale, pjesëmarrëset kanë në dispozicion edhe kutinë e ankimit. Kutia hapet nga të paktën dy punonjëse të strehëzës (.....).

Një përkthim i plotë i procedurës së ankesave jepet më poshtë. Për pjesëmarrëset që kanë bërë një ankesë nuk duhet të ketë pasoja negative ose mohim shërbimi.

Ankesa personale me gojë ose me shkrim:

- Pjesëmarrësja mund t'ia adresojë ankesën e saj çdo anëtar të stafit të strehëzës. Megjithatë, rekomandohet që pjesëmarrësja në fillim t'ia drejtojë ankesën punonjëses sociale që ndjek rastin e tyre.

- Nëse punonjësjë e rastit nuk mund të zgjidhë ankesën ose pjesëmarrësja nuk ndjehet mirë që t'ia adresojë ankesën e saj punonjëses së rastit, pjesëmarrësja duhet t'ia adresojë ankesën e saj eprorit të punonjëses (drejtores së strehëzës ose supervizorit).

- Nëse supervizori nuk mund ta adresojë ankesën e saj ose pjesëmarrësja nuk ndjehet mirë që t'ia adresojë ankesën e saj supervizorit, ajo duhet t'ia adresojë ankesën drejtores.

- Çdo anëtar stafi apo drejtues i ofruesit të shërbimeve që merr një ankesë me gojë ose me shkrim nga një pjesëmarrës duhet ta regjistrojë këtë ankesë në regjistrin e ankesave, së bashku me datën e ankesës dhe mënyrën se si është adresuar ankesa.

Ankesa formale duhet të përmbajë:

1. Natyrën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri tek ankesa;
2. Datën e veprimit ose mosveprimit që ka çuar deri tek ankesa;
3. Palën kundër së cilës depozitohet ankesa; dhe
4. Emrin e plotë, adresën dhe numrin e telefonit të personit që ankohet.

Përdorimi i kutisë së ankesave

Për të ndihmuar ata që parapëlqejnë të ankohen në mënyrë anonime ose me shkrim, është vënë në dispozicion një kuti e ankesave.

- Kutia e ankesave hapet një herë në javë nga të paktën dy anëtarë të stafit. Këta dy punonjës zakonisht do të jenë supervizori dhe drejtori. Në mungesë të njërit prej tyre, tjetri do të hapë kutinë në praninë e një punonjësi social tjetër. Hapja e kutisë dhe shqyrtimi i ankesave nga dy anëtarë të stafit i jep më shumë legjitimitet procesit, duke siguruar më mirë që personi që hap kutinë nuk mund të vendosë në mënyrë të njëanshme që të shpërfillë një ankesë.

- Pasi të hapen dhe shqyrtohen, ankesat do të hidhen në regjistrin e ankesave, duke përfshirë datën kur është regjistruar ankesa dhe dokumentacionin se si është marrë ankesa.

- Kutia e ankesave duhet të vendoset në një vend, i cili është i arritshëm për të gjithë banorët e strehëzës dhe ku një ankesë mund të hidhet pa u parë nga persona të tjerë.

Trajtimi i ankesave

- Ankesa duhet të depozitohet pranë drejtorit, jo më vonë se 10 ditë pas incidentit që ka shkaktuar ankesën e lidhur në mënyrë specifike me shërbimet e programit.

- Pas marrjes së ankesës, drejtori vendos brenda 3 ditësh pune:

1. Nëse mund ta zgjidhë apo jo çështjen personalisht. Nëse e trajton personalisht çështjen, duhet t'ia paraqesë konstatimet e veta pjesëmarrësës brenda 5 ditësh pune.

2. Nëse caktohet një komision ankesë, mbledhja e komisionit të ankesës duhet të bëhet brenda 2 ditësh pune për të hetuar ankesën dhe komisioni i ankesës duhet të raportojë për konstatimet e veta brenda 3 ditësh pune.

3. Nëse nuk mund të arrihet një zgjidhje e ankesës në nivel drejtori të programit apo drejtori të

strehëzës apo komisioni të ankesës, ankesa duhet t'i kalohet bordit, i cili shqyrton konstatimet/rekomandimet e mëparshme dhe ia paraqet me shkrim rekomandimet/konstatimet e veta pjesëmarrëses brenda 5 ditësh pune.

- Në rastet kur pjesëmarrëset kanë ankesë për autoritetet apo politikat e ndjekura nga shërbimi i strehëzës, ato mund ta drejtojnë ankesën edhe pranë Shërbimit Social Kombëtar apo Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social. Në këtë rast ato e postojnë ankesën pranë këtyre institucioneve. Këto ankesa nuk shqyrtohen nga drejtuesit e strehëzës.

Një kopje e kësaj politike duhet të jetë e afishuar në ambientet që përdoren kryesisht nga pjesëmarrëset. Një kopje e kësaj politike i jepet pjesëmarrëses gjatë pranimi.

Shënim. Pjesëmarrësja nuk duhet të largohen nga programi gjatë procesit të ankimit, me përjashtim të rastit kur përfundon afati i trajtimit ose kur pjesëmarrësja kthehet në një rrezik për strehëzën gjatë procesit të hetimit.

ANEKSI 21 PROCESVERBAL

Për pjesëmarrëset, të cilat janë referuar nga një organizatë tjetër, institucione qeveritare ose private apo agjenci të ligjit, mund të përdoret një procesverbal për të dokumentuar “dorëzimin” e pjesëmarrëses.

_____ (emri i pjesëmarrëses), shtetase e _____ (emri i vendit të shtetësisë), ka rënë dakord të akomodohet dhe të ndihmohet në strehëz _____.

Firmat e mëposhtme përfaqësojnë organizatat ose agjencitë e përfshira në referimin e individit të përmendur më sipër në këtë strehëz rezidenciale.

Pjesëmarrësja:

_____ Emri

_____ Firma _____ Data

Stafi i strehëzës:

_____ Emri

_____ Firma _____ Data

Stafi organizatës ose agjencisë

_____ Referuese (zbatimi i ligjit, Emri
qendër tjetër rezidenciale,
drejtoria e shërbimeve sociale etj.)

_____ Firma _____ Data

ANEKSI 22 PROCESI I VLERËSIMIT

Pasi bëhet një referim për në strehëz ose pasi sillet pjesëmarrësja në strehëz, asaj i caktohet një intervistë vlerësimi. Të gjitha pjesëmarrëset e regjistruara në strehëz vlerësohen sipas kësaj procedure:

1. Paraqitja e problemeve nga pjesëmarrësja;
2. Njohja me historikun mjekësor; me dokumentacion për alergjitë e ditura, dietat e posaçme të nevojshme dhe mjekimet (barnat) e tanishme dhe të kaluara;
3. Njohja me të kaluarën ligjore, si kujdestaria apo padi të pambyllura ende;
4. Njohja me të kaluarën penale, nëse ka;
5. Njohja me historikun e familjes dhe historikun social;
6. Njohja me të dhënat për nivelin arsimor dhe profesional.

Dokumentacioni i vlerësimit të parë futet në kartelën e pjesëmarrëses brenda pesë ditësh pune pas vlerësimit.

Në bazë të vlerësimit të parë dhe informacionit të marrë gjatë intervistës së pranimit, stafi do të përcaktojë nevojat dhe do të bëjë rekomandime në lidhje me vlerësimin pasardhës/shtesë. Rekomandimet për vlerësimet shtesë futen në kartelë brenda pesë ditësh pune pas pranimit dhe mund të përfshijnë:

1. Vlerësim psikiatrik ose psikologjik;
2. Ekzaminim fizik;
3. Ekzaminim neurologjik;
4. Analiza laboratorike;
5. Testim arsimor;
6. Vlerësime të terapisë profesionale ose rekreative;
7. Vlerësim profesional dhe riaftësues;
8. Vlerësim të sjelljes përshtatëse ose vëzhgim të drejtpërdrejtë të sjelljes;
9. Vlerësime të të folurit dhe të gjuhës;
10. Analiza për tuberkuloz dhe/ose virusin HIV.

Këtij procesi vlerësimi i bashkëngjitet edhe një listë kontrolli për vlerësimin e dhunës në Familje. Një model i saj paraqitet në vijim.

Listë kontrolli për vlerësimin e dhunës në familje

Viktima (mbiemër, emër, emër i ndërmjetëm) numër telefoni i sigurt #:	Adresë <i>E-mail</i> -i:
I dyshuari (mbiemër, emër, emër i ndërmjetëm)	Rasti nr. #:
Emri i punonjësit që raporton punonjësi #:	Datë:

	Kjo formë është për partnerin intim ku përfshihen: bashkëshorti/ish-bashkëshorti/tja, ish-partneri që kanë një fëmijë të përbashkët	PO	JO
1.	A ju ka dëmtuar ndonjëherë fizikisht partneri juaj? Nëse po, sa shpesh? ☐ 1-5 herë ☐ 6-10 herë ☐ 11 ose më shumë herë		
2.	A ka tentuar ndonjëherë partneri juaj t'ju zërë frymën?		
3.	A ju ka qëlluar ndonjëherë partneri juaj gjatë shtatzënisë tuaj?		
4.	A ju ka kërcënuar ndonjëherë partneri apo ka përdorur armë kundër jush? Nëse po, shënoni më çfarë: thikë pistoletë tjetër: _____		
5.	A ju ka mbajtur ndonjëherë partneri kundër dëshirës suaj?		
6.	A ka kërcënuar ndonjëherë partneri juaj se do të dëmtojë kafshët shtëpiake?		
7.	A mendoni se partneri juaj do t'ju vrasë?		
8.	A ju ka thënë ndonjëherë partneri juaj se planifikon t'ju vrasë?		

9.	A janë bërë dëmtimet fizike më të rënda gjatë viteve të fundit?		
10.	A ka ndodhur më shpesh dhuna fizike gjatë vitit të fundit?		
11.	A është trajtuar ndonjëherë partneri juaj për probleme të shëndetit mendor?		
12.	A jeni larguar apo keni diskutuar së fundmi për t'u ndarë nga partneri juaj?		
13.	A ju ka kërcënuar ndonjëherë partneri apo ka tentuar të kryejë vetëvrasje?		
14.	A ju ka ndjekur ndonjëherë apo mbajtur nën vëzhgim partneri juaj?		
15.	A ka qenë partneri juaj i dhunshëm apo ka kërcënuar se do të dëmtojë fëmijët?		
16.	A ju kontrollon partneri juaj gjatë aktiviteteve tuaja të përditshme?		
17.	A ka partneri jua histori të mëparshme të dhunës në familje ndaj partnerëve të tjera?		
18.	A ka armë zjarri të aksesueshme nga partneri juaj në shtëpi?		
19.	A reagon dhunshëm partneri juaj në prani të të tjerëve?		
20.	A pi vazhdimisht partneri juaj?		
21.	A ka qenë shumë i stresuar partneri juaj së fundmi (ka humbur punën, humbur dikë të dashur, është arrestuar etj. ...)?		
22.	A është partneri juaj vazhdimisht i dhunshëm dhe xheloz për ju? (p.sh. A ju thotë partneri juaj "Nëse nuk mund të kem unë, askush nuk do të mundet"?)		

ANEKSI 23 VLERËSIMI I NJË FËMIJE

Marrja në intervistë dhe vlerësimi i një fëmije, shpesh është diçka komplekse, e cila kërkon aftësi të posaçme. Ata që punojnë me fëmijët duhet të kenë formim dhe përvojë të specializuar. Fëmija mund të jetë viktimë e drejtpërdrejtë e dhunimit nga babai ose nëna, mund të ketë parë si është dhunuar nëna dhe, shpesh mund t'ia vërë fajin vetes për konfliktin brenda në familje.

Marrja në intervistë e një fëmije: (faktorët që duhen mbajtur parasysh)

1. Intervista duhet të jetë private.
2. Intervista duhet të jetë e sigurt. Në dhomë nuk duhet të qëndrojë asnjë person që e frikëson fëmijën.
3. Intervista duhet të mbahet e fshehtë – shpjegojini fëmijës çfarë mund të përdoret në gjykatë dhe çfarë nuk mund të përdoret.
4. Intervistuesi duhet të krijojë një marrëdhënie miqësore dhe të butë me fëmijën, përpara se t'i bëjë pyetje për krime apo vepra konkrete.
5. Mos lejoni të ketë asnjë orendi midis jush dhe fëmijës. Uluni në të njëjtën lartësi me fëmijën. Uluni në dyshe.
6. Silluni me edukatë dhe mirësi – flisni me fjalë të ngadalta dhe të thjeshta. Përdorni fjalët (gjuhën) e tyre për ngjarjet, pjesët e trupit dhe njerëzit.
7. Tregoni durim – nuk duhet të nguteni gjatë intervistës së fëmijës.
8. Përdorni metoda të tjera, përveç të folurit – i jepni fëmijës mundësi të vizatojë, të interpretojë, të përdorë lodra etj.
9. Shpjegoni se çfarë po ndodh dhe se çfarë do të ndodhë. I kërkon fëmijës t'i përsërisë fjalët, dhe jo thjesht të thotë 'po'.
10. Nëse fëmija qan ose inatoset, mos i thoni të ndalojë dhe mos u shqetësoni. Lëre të qajë. Jepi një shami. Lëre ta shprehë inatin. Ka arsye për të qenë i inatosur.
11. Mos i thuaj fëmijës se çdo gjë do të kalojë. Fëmija e njeh realitetin dhe e di se ju nuk mund ta mbron nga lëndimi i mëtejshëm. Informacioni dhe mirësia ndihmojnë më shumë se premtimet boshe.
12. Sigurohuni që fëmija të ketë mbaruar së foluri përpara se të mbarojë intervista. Pyeteni fëmijën nëse ka diçka tjetër që do t'ua thotë.

13. Mos bëni shaka dhe mos tregoni gëzim. Nëse veproni kështu do të duket sikur nuk po e merrni seriozisht fëmijën. Bëhet fjalë për diçka serioze. Kujdesuni që humori juaj të pasqyrojë atë të fëmijës.

14. Tregoni kujdes për çështjet gjinore. Nëse viktimë është vajzë, mund të duhet që intervistën ta bëjë një grua ose të paktën është mirë të ketë një grua në dhomë. Nëse vajza është abuzuar nga një burrë, ajo nuk duhet lënë vetëm në dhomë me një burrë.

Këshilla praktike për intervistat me fëmijët

Detaje për dhunuesin. Zakonisht, fëmija e di shumë mirë kush është dhunuesi, mirëpo për t'u siguruar që identifikimi është mjaftueshëm për t'u përdorur në gjykatë në të ardhmen, bëjini këto pyetje, sidoqoftë, për të shmangur çdo gabim. Sa i gjatë ishte dhunuesi në krahësim me fëmijën? A mbante syze? Ishte i shëndoshë apo i dobët? Ishte me trup me muskuj apo me trup të dobët? Çfarë rrobash kishte veshur? Çfarë lloj stolish: orë, unazë? A kishte shenja plage, tatuazh apo shenja të tjera?

Hollësi për vendin. Ku ndodhi abuzimi? Çfarë lloj shtëpie? Çfarë ngjyre? Sa kate? Me mur përreth? Kopsht? Brenda, sa dhoma, sa të mëdha, çfarë ngjyre kishin muret, çfarë ngjyre kishin dyshemetë, a ishte dyshemeja e shtruar me pllaka? Çfarë lloj dhe ngjyre ishte frigoriferi, shtrati, mbulesat e shtratit, divani, karriget. A kishte piktura apo fotografi në mur? Çfarë pikturash apo fotosh ishin? Çfarë lloj perdeshe? Ishin të hapura apo të mbyllura? Çfarë lloj dollapësh? Çfarë lloj televizori, radioje, kompjuteri? Çfarë po shfaqej në televizor, radio apo kompjuter?

Hollësi për ngjarjen. Në cilën orën të ditës u abuzua? Cilën ditë? Kush tjetër ishte atje? Çfarë po bënin? Çfarë rrobash kishte veshur dhunuesi, fëmija dhe personat e tjerë? A përdorën peshqirë? Çfarë ngjyre, çfarë madhësie? E njëjta vlen edhe për çarçafët. A përdori dhunuesi lubrifikant ose prezervativ?

Këto informacione janë të nevojshme për të vërtetuar se autori i veprës është personi në fjalë. Informacionet janë të nevojshme për shtëpinë dhe ngjarjet, për të treguar se fëmija thotë të vërtetën, sepse tregon informacion me hollësi, i cili mund të verifikohet nga policia dhe hetimi. Dhunuesi e ka shumë më të vështirë ta mohojë sjelljen e tij nëse dihen këto hollësi.

ANEKSI 23

LISTË E GJËRAVE QË DUHEN KONTROLLUAR PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË E EKSPOZUAR NDAJ DHUNËS

Ekspozimi ndaj dhunës dhe llojet e ekspozimit

A janë identifikuar faktorët e riskut për ekspozimin ndaj dhunës?

Ndër të tjera, faktorët e riskut përfshijnë:

- Dhunë kronike në komunitetin nga i cili është hequr (gjuajtje me armë, plagosje me thika, vrasje, plaçkitje me dhunë, shpërndarje droge, dhunë midis bandave etj.);

- Dhunë në familjen nga e cila është hequr fëmija ose në të cilën banon (për shembull: dhunë fizike, kërcënime, detyrim ose frikësim midis prindërve, një prind që jeton me dashnor, një vëlla ose motër kundër një prindi);

- Abuzim me drogë dhe/ose alkool nga prindërit ose kujdestari kryesor;

- Dhunë fizike ose presion psikologjik nga shokët në shkollën ku shkon ose ka shkuar fëmija;

- Dhunë fizike ose verbale në një marrëdhënie romantike midis adoleshentësh;

- Përzierja në një bandë ose lidhje të ngushta me persona që janë anëtarë të një bande;

- Fëmija/i riu ka kaluar kohë në rrugë si një i ri që është larguar nga shtëpia ose që është i pastrehë;

- Të tjera (përkrahësi)_____.

Identifikoni treguesit që provojnë se fëmija është ndikuar negativisht nga ekspozimi ndaj dhunës:

- Dhunë fizike kundër personave ose kafshëve;

- Tërheqje ose mungesë emocioni (depresion);

- Sjellje tejet e eksituar;
- Sjellje agresive;
- Vështirësi në rregullimin e sjelljes (për shembull, kontroll i dobët i impulseve);
- Ankth ose frikë e tepruar;
- Abuzim me drogat dhe/ose alkoolin nga fëmijët ose të rinjtë;
- Sjellje të rrezikshme (për shembull: marrëdhënie të shumta seksuale, përdorim drogash);
- Tentativa vetëvrasjeje ose sjellje të tjera vetëdëmtuese (për shembull: gjymtim ose prerje e vetvetes);
- Vështirësi për të treguar vëmendje;
- Probleme në shkollë (për shembull: lënie e orëve të mësimi, nota të dobëta, dënime në shkollë, pezullime, përjashtime, presion nga shokët ose ndaj shokëve etj.);

Tjetër
(përshtkruani)_____.

Nëse dihet, ndaj çfarë lloje dhune është ekspozuar fëmija/i riu (për shembull: dhunë në komunitet, dhunë në familje, dhunë në marrëdhënie dashurie midis adoleshentësh, dhunë në shkollë).

Si është ekspozuar ndaj dhunës fëmija (për shembull, ka dëgjuar incidentin e dhunshëm, e ka parë incidentin e dhunshëm, i kanë treguar për incidentin e dhunshëm, ka parë pasojat e incidentit të dhunshëm – qepje, hundë e thyer, mavijosje të prindërve ose anëtarëve të familjarëve)?

A ka qenë dhuna një incident i izoluar apo ka pasur disa incidente?

Nëse ka pasur disa incidente, a ka qenë i njëjtë dhunuesi për të gjitha?

Nëse ka pasur disa incidente, sa kohë ka qenë fëmija i ekspozuar ndaj incidenteve të dhunshme?

A ka fëmija/i riu një marrëdhënie të rëndësishme me dhunuesin?

A ka fëmija/i riu një marrëdhënie të rëndësishme me viktimën e drejtpërdrejtë të aktit ose akteve të dhunshme?

Ku ndodhi dhuna?

- Në shtëpinë e fëmijës/të riut me familjen biologjike;
- Në mjedisin ku është vendosur fëmija/i riu (familje kujdestare e përkohshme, fis ose jo);
- Në komunitet/lagje;
- Në shkollë;
- Në shtëpinë e një shoku/shoqeje;
- Tjetër.

A mundet prindi/kujdestari i fëmijës ta mbrojë atë nga abuzimi i mëtejshëm?

A është i frikësuar apo i kërcënuar kujdestari nga dhunuesi (nëse dihet)? ___po ___jo

A ka dëshirë dhe aftësi kujdestari të vërë në zbatim urdhrat e mbrojtjes? ___po ___jo

A jeton kujdestari në një lagje me probabilitet të lartë ekspozimi të fëmijës/të riut ndaj akteve të dhunës në komunitet? ___po ___jo

Nëse po, shihni pyetjet e tjera shtesë të lidhura me ekspozimin e fëmijëve ndaj dhunës.

A kanë qenë të përfshira forcat e ligjit gjatë/pas ekspozimit të fëmijës/të riut ndaj dhunës?

Nëse jo, a është gjëja e duhur të kontaktohen forcat e ligjit tani? ___po ___jo

Nëse po, a është bërë kallëzim në polici dhe a është arrestuar dhunuesi? ___po ___jo

A është ndjekur penalisht dhunuesi?

Nëse po, a është fëmija/i riu dëshmitar dhe/ose viktimë e çështjes? ___po ___jo

A ka fëmija një punonjës social të viktimës/dëshmitarit? ___po ___jo

A është nevojë për një urdhër mbrojtjeje për të minimizuar ose parandaluar traumën e mëtejshme? ___po ___jo

A është referuar fëmija për vlerësim psikologjik dhe/ose zhvillimor ose a i është nënshtruar vlerësimit që vlerëson nëse është ekspozuar apo jo fëmija ndaj formave të tjera të dhunës krahas çështjeve që e kanë nxjerrë familjen përpara gjykatës? ___po ___jo

A janë bërë rekomandime nga një klinikist i licencuar në lidhje me ndërhyrjet e nevojshme terapeutike për fëmijën/të riun? ___po ___jo

A kanë marrë në konsideratë rekomandimet moshën dhe fazën e zhvillimit të fëmijës/të riut ___po ___jo

A janë përshtatur ndërhyrjet në mënyrë specifike sipas origjinës kulturore dhe gjinisë së fëmijës?

___po ___jo

A janë bërë referimet për ndërhyrjet e rekomanduara terapeutike? ___po ___jo

A kanë marrë në konsideratë ndërhyrjet moshën dhe fazën e zhvillimit të fëmijës/të riut? ___po ___jo

A janë përshtatur ndërhyrjet në mënyrë specifike sipas origjinës kulturore dhe gjinisë së fëmijës?

___po ___jo

Nëse është në trajtim tani, a janë në dijeni ofruesit e trajtimit dhe shërbimit të tanishëm të fëmijës/të riut për ekspozimin e tij ndaj dhunës së përshtatshme më lart? ___po ___jo

A janë të përshtatshme këto ndërhyrje sipas moshës dhe zhvillimit? ___po ___jo

A i është dhënë mundësia viktimës në moshë të rritur për të kërkuar një urdhër mbrojtjeje? ___po ___jo

A është depozituar në gjykatë kërkesa për këtë? ___po ___jo

A është mbajtur parasysh siguria e viktimës në moshë të rritur gjatë marrjes së vendimit për çështjet e lidhura me mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijëve? ___po ___jo

A trajtojnë urdhrat e vizitave, konkretisht çështje të tilla, si: shkëmbim të sigurt dhe ruajtjen e fshehtësisë së informacionit për vendndodhjen e viktimave të rritura dhe të mitura? ___po ___jo

A mbahen seancat gjyqësore në mënyrë të tillë që të jenë të sigurta si për viktimat fëmijë ashtu edhe për ato në moshë të rritur? ___po ___jo

A kanë avokatë të ndryshëm prindërit dhe fëmijët?__po __jo

A është e mundur të mbahen seanca dëgjimore të veçanta për dhunuesin dhe viktimën?__po __jo

A po e bashkërendojnë punën e tyre, për atë që sa munden, punonjësit e mbrojtjes sociale dhe punonjësit kundër dhunës në familje?__po __jo

A u janë ofruar shërbime terapeutike dhe mbështetëse, që të jenë të përshtatshme nga ana kulturore, viktimave të mitura dhe të rritura?__po __jo

A janë lidhur viktimat e mitura dhe të rritura me një punonjës kundër dhunës në familje, i cili qëndron në komunitet?__po __jo

A ka ofruar stafi informim dhe edukim për dhunën në familje, efektin që ka te fëmijët ekspozimi ndaj dhunës në familje dhe për planifikimin e sigurisë?__po __jo

A është lëshuar një urdhër mbrojtjeje, a e zbaton këtë urdhër dhunuesi?__po __jo

Nëse jo, a i ka kontaktuar viktimat forcat e ligjit në lidhje me shkeljet e urdhrit?__po __jo

A ndodhet viktimat tani në një komunitet “të parrezikshëm” apo në një komunitet që është i mbushur me dhunë?__po __jo

Nëse viktimat nuk është në një komunitet “të parrezikshëm”, çfarë përpjekjesh po bëhen për të identifikuar një mjedis më të sigurt jetese, ose me të njëjtët kujdestarë ose me kujdestarë të tjerë?

A ka një kujdestar ose prind të gatshëm për të zhvilluar një marrëdhënie “kompetente, të ngrohtë, pozitive” me fëmijën për ta ndihmuar dhe mbështetur fëmijën t’i bëjë ballë dhe ta kapërcejë traumën nga dhuna?__po __jo

ANEKSI 24

RREGULLA PËR VIZITA NË STREHËZ

Strehëzat shpesh nxisin interes të madh në radhët e profesionistëve të fushës, përfaqësuesve të donatorëve, akademikëve dhe gazetarëve, të cilët mund të kërkojnë të vizitojnë strehëzën. Çështja është shumë e ndjeshme për sa i përket sigurisë, mirëqenies dhe privatësisë së përfituesve dhe stafit. Refuzimi i aksesit për të gjithë mund të jetë jo realist dhe madje mund të jetë kundërproduktiv për punën e organizatës. Pasi e udhëzimeve të qarta mund të ndihmojë të sigurojë që mirëqenia dhe privatësia e përfituesve është faktori kryesor në përgjigjen ndaj të gjithë kërkesave, e bën më të lehtë për stafin të adresojë kërkesat specifike, dhe e bën më të lehtë për donatorët dhe palët e tjera të interesuara të kuptojnë dhe të respektojnë politikat e miratuara të strehëzës. Politika e miratuar duhet të mbajë parasysh nevojën për:

- Mbrojtjen e vendndodhjes së strehëzës;
 - Mbrojtjen e strehëzës nga depërtimi i dhunuesve;
 - Respektimin e privatësisë së personave që qëndrojnë në strehëz, duke pranuar që strehëza shërben si shtëpia e tyre e përkohshme;
 - Mbrojtjen e identitetit të përfituesve dhe stafit;
 - Garantimin e mirëqenies dhe interesave më të mira të përfituesve.
- Më poshtë jepen udhëzime për vizitorët në strehëzat e trajtimit të viktimave të dhunës në familje, të cilat duhet të përshtaten në bazë të nevojave dhe profilit të secilës qendër:
- Një numër maksimal prej dy vizitorësh njëherësh do të lejohet në strehëzën;
 - Me synimin për të shkakuar shqetësimin minimal të rezidentëve në strehëz, vizitorët do të lejohen nga ora _____ në _____, në këto ditë: _____, dhe _____.
 - Kërkesat për të vizituar strehëzën duhet të bëhen me shkrim (përpara vizitës), dhe duhet të

përfshijnë emrin dhe rolin e secilit person që viziton, qëllimin e vizitës, emrin e personit me të cilin duan të takohen, dhe natyrën e pyetjeve që duan të bëjnë. Çdo kërkesë duhet të shqyrtohet paraprakisht dhe të miratohet nga drejtuesi i strehëzës.

- Përpara se të miratojë hyrjen në strehëz për një vizitë, psikologu dhe punonjësit socialë do të konsultohen për t'u siguruar që vizita nuk do të ketë pasoja psikologjike negative për përfitueset e akomoduar. Vizita do të autorizohet vetëm nëse përcaktohet që nuk do të ketë pasoja psikologjike negative për rehabilitimin e rezidentëve.

- Vizitori(ët) nuk duhet të marrin adresën e saktë të strehëzës dhe nuk duhet të lejohen të vijnë drejtpërdrejt në strehëz, por duhet të dërgohen në strehëz nga një anëtar i stafit të strehëzës.

Përfitueset duhet të informohen paraprakisht rreth vizitorëve, duke përfshirë informacion se kush janë, kur pritët të vijnë dhe qëllimin e vizitës. Përfitueset që nuk dëshirojnë të shihen apo intervistohen nga vizitorët duhet të lejohen të qëndrojnë në dhomat e tyre gjatë gjithë vizitës dhe vizitorët të ndalohen të hyjnë në këto dhoma.

- Gjatë gjithë vizitës, vizitori(ët) duhet të shoqërohen nga stafi i strehëzës.

- Asnjë vizitor nuk do të lejohet të takojë ose të flasë me një përfituese pa pëlqimin e shprehur të personit të interesuar dhe miratimin e psikologut të strehëzës. Nëse miratohet nga psikologu, psikologu i strehëzës ose stafi duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë këtij takimi.

- Vizitori(ët) nuk lejohen të sjellin kamera apo pajisje të tjera regjistruese në strehëzës. Kameran apo pajisjet regjistruese të sjella gabimisht në strehëzës do të mbahen nga stafi dhe të ruhen gjatë vizitës.

- Të gjitha vizitat nga të jashtëm duhet të regjistrohen me kujdes dhe regjistri i plotë duhet të mbahet nga drejtuesi i qendrës.

- Asnjë media apo gazetar nuk do të lejohen në strehëz në asnjë moment (shih shënimin më poshtë). Gazetarët, të cilët janë miratuar për të marrë intervista me stafin apo përfitueset duhet të orientohen drejt një vendndodhje të sigurt për kryerjen e intervistës.

Shënim. Aksesit i medias. Organizatat duhet të jenë shumë të kujdesshme në lidhje me përfaqësuesit e medias. Disa strehëza mund të vendosin të mos lejojnë aksesin e mediave në asnjë rrethanë, të tjera mund të dëshirojnë ta lejojnë në ndonjë rrethanë, nëse gazetarët njihen dhe janë të besueshëm. Nëse lejohen, duhet të zbatohen të gjithë rregullat e mësipërme, duke përfshirë dhe ndalimin e kamerave dhe pajisjeve regjistruese dhe rregullat për intervistat dhe bisedat me përfitueset.

ANEKSI 24-0

MARRËVESHJE KONFIDENCIALITETI PËR VIZITORËT

Unë _____, si vizitor i strehëzës për gra dhe vajza të abuzuara, viktimat të dhunës në familja (si një donator, përkthyes, kërkues, gazetarë ose tjetër), kuptoj rëndësinë e ruajtjes së fshehtësisë me qëllim mbrojtjen e sigurisë së qendrës rezidenciale, përfituesve dhe stafit të saj.

Unë do të ruaj fshehtësinë e informacionit të përfituesve dhe nuk do t'i jap askujt asnjë informacion personal që kam mësuar në kontekstin e kësaj vizite.

Unë nuk do të diskutoj çështjet e përfituesve, stafit apo funksionimit të strehëzës me mediat, të njohurit personale apo familjen, qoftë në publik apo privat.

Unë do t'i drejtoj çdo pyetje ose shqetësim në lidhje me konfidencialitetin drejtuesve të strehëzës.

Emri

Firma

Data

ANEKSI 25

Përfituesja _____, ka kërkuar apo ka rënë dakord të transferohet nga një qendër rezidenciale të kujdesi i një organizate tjetër ndihme. Për të lehtësuar dhënien e vazhdueshme të shërbimit për përfituesen, dosjet e mëposhtme transferohen nga _____ (emri i qendrës nga e cila transferohet përfituesja) tek _____ (emri i organizatës që merr përsipër ndihmën kryesore për përfituesen).

- Formulari i vlerësimit
- Listë kontrolli i formave të abuzimit
- Plani i plotë i ndihmës
- Raportet e progresit
- Dokumentacioni i kujdestarisë (nëse duhet)
- _____
- _____
- _____

Me nënshkrimin tim më poshtë, unë miratoj transferimin e këtyre dosjeve ndërmjet organizatave të mësipërme.

Përfutësja: _____ Emri

Firma	Data
-------	------

Unë i nënshkruari, si një përfaqësues i agjencisë sime, jam dakord me përdorimin e këtyre dokumenteve vetëm për ofrimin e ndihmës së vazhdueshme përfituese në fjalë. Agjencia do të ruajë konfidencialitetin në lidhje me përfituesen dhe informacionin e saj personal. Ne nuk do të ndajmë këto dokumente apo informacionin që ato përmbajnë me asnjë person, pa pëlqimin me shkrim të përfitueses:

Stafi i agjencisë referuese: Emri Firma/Data Emri i agjencisë	Stafi i agjencisë pritëse Emri Firma/data Emri i agjencisë
---	--

ANEKSI 26

RREGULLAT PËR PËRDORIMIN E DHOMAVE TË GJUMIT

Ju duhet:

- Të jeni të përgjegjshme si grup (të gjitha gratë/vajzat në një dhomë) për sendet e përbashkëta në dhomë dhe për atë që ndodh në dhomë.
- Të respektoni caktimin e dhomave dhe ndryshimet e mundshme të bëra nga stafi që është në turn. Stafi në turn do të informojë pjesën tjetër të stafit dhe drejtorin për ndryshimet.
- Bëni detyrën tuaj në pastrimin e dhomës, e cila pastrohet në bazë të një orari javor të përgatitur nga gratë/vajzat e dhomës, me mbështetjen e stafit.
- Përdorni ventilatorët, ngrohësit me gaz, kaloriferët ose kondicionerët në bazë të orarit të përcaktuar, sepse përdorimi i tepërt mund t'ju dëmtojë shëndetin. Orari përcaktohet nga punonjësja sociale dhe ajo informon drejtuesit.

Nuk lejohet:

- Kyçja e derës së dhomës;
- Pirja e duhanit në dhomë;
- Ngrënia apo mbajtja e ushqimeve në dhomë;
- Përdorimi i rrobave të njëra-tjetrës, sepse kjo nuk është higjienike. Prandaj, me qëllim që të parandalohet marrja e tyre pa leje, mbajini rrobat tuaja dhe sendet personale në raftet përkatëse dhe përdorni çelësin për t'i kyçur ato;
- Fjetja e më shumë se një personi në një shtrat. Shtretërit janë personalë;
- Vendosja e fotografive të revistave apo fotove personale drejtpërdrejt në mur, përveç rasteve kur janë në kornizë.

Rregullat për përdorimin e zyrës së stafit

Ju duhet:

- Të hyni në zyrë pasi të trokitni në derë dhe stafi ju fton brenda;
- Të ruani një largësi nga tavolinat e punës dhe dokumentet e ndryshme;
- Nëse gjeni në godinë sende që i përkasin zyrës së stafit apo stafit duhet të dorëzohen në zyrë;
- Sendet tuaja me vlerë mund të mbahen për t'u ruajtur në zyrën e stafit. Ato dorëzohen dhe merren me firmën e të dy palëve (përfitueses dhe stafit);
- Pajisjet logjistike (kompjuteri, interneti etj.) mund të përdoren nga përfitueset vetëm në rastet kur stafi vlerëson nevojën urgjente për përdorimin e tyre.
- Nuk lejohet:
- Hyrja në zyrë në rastet kur nuk ka staf të pranishëm;
- Prekja e sendeve në zyrë pa lejen ose kërkesën e stafit;
- Shikimi i dosjeve dhe dokumenteve që u përkasin përfitueseve të tjera.

Rregullat për përdorimin e dhomës së këshillimit

Ju duhet:

- Të paraqiteni në veshje të përshtatshme në një sesion këshillimi me punonjësën sociale;
- Të trokitni në derë të dhomës së këshillimit përpara se të hyni.

Nuk lejohet:

- Të hyni në dhomën e këshillimit në rastet kur është e zënë gjatë një sesioni këshillimi;
- Të ndërpritni një sesion këshillimi nëse nuk është një rast emergjence.

Rregullat për përdorimin e kuzhinës

Ju duhet:

- Kuzhina duhet të pastrohet pas çdo vakti nga përfitueset sipas orarit të pastrimit.
- Përdorni pajisjet e gatimit dhe ngrënies (lugë, pirun, thikë, gotë). Kjo mbron shëndetin tuaj.

Mos hani me duar.

- Përdorni detergjentin dhe ujë të nxehtë të bollshëm për të larë enët. Mbajini të pastra.
- Përdorni gotat për të pirë ujë ose lëngje. Mos pini drejtpërdrejt nga shishja.
- Lajini gjithmonë duart përpara dhe pas gatimit dhe ngrënies.
- Nëse keni nevojë të hani diçka ndërmjet vakteve, informoni stafin.
- Të gjithë ushqimet blihen për përfitueset. Ato nuk duhet të shpërdorohen dhe të merren pa lejen e stafit.

- Lajini frutat dhe perimet përpara përdorimit ose gatimit të tyre. Kjo ju mbron nga shumë sëmundje.

- Nëse ju dyshoni për pastërtinë e pjatës, lugës etj., mos hezitoni t'i lani ato.
- Nëse jeni alergjike ose nuk hani ushqime të caktuara, ju duhet të informoni stafin. Ata do të zgjidhin situatën tuaj pasi ta vlerësojnë atë.

- Ankesat në lidhje me gatimin apo mirëmbajtjen e kuzhinës duhet t'i drejtohen stafit, në zyrë.

Mos u përpiqni t'i zgjidhni këto me nismën tuaj.

Nuk lejohet:

- Qëndrimi në kuzhinë, përveçse për përfitueset që kanë orarin e gatimit ose të pastrimit të kuzhinës.

- Përdorimi i sobës me gaz apo elektrike nëse nuk e keni përdorur më përpara dhe nuk dini si ta përdorni. Kërkoni ndihmën e stafit në këto raste.

- Përgatitja e ushqimit tuaj pa lejen e shprehur të stafit.

- Marrja e ushqimit nga kuzhina pa lejen e shprehur të stafit.

Rregullat për përdorimin e dhomës së ndenjes

Ju duhet:

- Të përdorni dhomën e ndenjes që të pushoni si grup, të diskutoni probleme, të shikoni TV dhe të organizoni veprimtari të ndryshme.

- Të respektoni natyrën e përbashkët të dhomës së ndenjes dhe të përdorni dhomën për përfitim të të gjithë grupit.

Nuk lejohet:

- Pirja e duhanit.

- Varja e fotografive personale në muret e dhomës së ndenjes, me ose pa kornizë.

- Shkrimi mbi mure. Të gjitha dëmtimet e dhomës së ndenjes duhet të riparohen.

- Mbajtja e televizorit ndezur ose qëndrimi shtrirë gjatë veprimtarive të grupit.

- Ngritja e volumit të zërit të televizorit më shumë se niveli _____.

- Në rast të mosmarrëveshjeve për programin e TV-së, që dëshironi të shikoni, stafi do të ndërmjetësojë situatën me anë të zgjidhjes më të mirë.

Rregullat për përdorimin e banjave

Ju duhet:

- Të pastroni banjat sipas orarit të përgatitur nga përfitueset dhe stafi. Banjat duhet të pastrohen nga personi që e ka për detyrë, 2-3 herë në ditë për të ruajtur një higjienë të mirë.

- Të lani rrobat tuaja personale pas dushit. Mos i lini ato të shpërndara në banja.

- Të pastroni banjën përpara dhe pas përdorimit personal. Pastrim do të thotë shkarkimi i banjës, fshirja e dyshemesë etj.

- Të lani duart gjithmonë përpara se të dilni nga banja.

- Nëse gjeni në banjë sende që i përkasin një përfitueseje tjetër, ju duhet t'i dorëzoni ato te stafi.

Nuk lejohet:

- Hyrja e dy ose më shumë përfitueseve në banjë njëkohësisht.
- Larja në dush e dy ose më shumë përfitueseve në të njëjtën kohë.
- Hedhja e letrës higjienike në WC. Gjithmonë kujtohuni të përdorni koshat e mbeturinave në banjë.
- Hedhja e pecetave, çorapeve, të brendshmeve apo gjërave të tjera në WC. Nëse bie diçka në mënyrë të paqëllimshme në WC, ju duhet të njoftoni menjëherë stafin për të parë mundësinë e nxjerrjes së saj.

Rregullat për përdorimin e makinave larëse

Ju duhet:

- Të kërkonti gjithmonë ndihmën e stafit për përdorimin e makinës larëse përpara se ta përdorni për herë të parë.
- Të respektoni orarin e përdorimit të makinës larëse. Makina larëse do të përdoret vetëm nga ora _____ në orën _____.
- Të kurseni ujin dhe energjinë duke kombinuar rrobat tuaja me ato të përfitueseve të tjera, me qëllim që të lahet një ngarkesë e plotë çdo herë.
- Të hiqni rrobat tuaja nga makina larëse sapo të mbaroni me qëllim që të lirohet makina larëse për t'u përdorur nga të tjerat.

Nuk lejohet:

- Përdorimi i makinës larëse jashtë orarit të afishuar.
- Lënia e rrobave tuaja në makinën larëse pas përfundimit të ciklit të larjes.
- Lënia e rrobave tuaja në dhomën e makinës larëse. Ato duhet të hiqen menjëherë dhe të mos lihen rrotull.

Rregullat për përdorimin e mjediseve të jashtme (veranda, oborri, tarraca)

Ju duhet:

- Të përdorni ballkonet për nderjen e rrobave.
- Gjatë pasdites, çaji dhe kafeja do të shërbehen në këto mjedise, nëse e lejon moti.
- Të përdorni këto mjedise për të marrë ajër të pastër dhe për t'u ushtruar, me lejen e stafit.
- Të respektoni natyrën kolektive të këtyre mjediseve dhe t'i përdorni në përfitim të të gjithë grupit.
- Të pini duhan në vendet e përcaktuara.

Nuk lejohet:

- Për të mos shqetësuar fqinjët dhe për të mos tërhequr vëmendjen te streha, mos flisni me zë të lartë apo bërtitni gjatë përdorimit të këtyre mjediseve.
- Detyra e rojës është të ruajë ndërtesën. Mos e shpërqendroni nga detyra e tij, duke komunikuar me të. Ju duhet të komunikoni gjithçka që keni me stafin.

ANEKSI 27
FORMULARI I VLERËSIMI PËR SHËRBIMIN

Qëllimi i këtij pyetësoi është të sigurojë që shërbimet e ofruara në strehëz janë me cilësi të lartë dhe plotësojnë nevojat e pjesëmarrëseve në këtë shërbim. Pjesëmarrëseve ju kërkohet ta plotësojnë formularin në mënyrë anonime. Nëse është e mundur ky pyetësor mund të aplikohet edhe gjatë qëndrimit në strehëz. Bashkëpunimi juaj në plotësimin e formularit sa më sinqerisht i shërben vetëm përmirësimit të punës dhe shërbimit. Vërejtjet tuaja do të konsiderohen seriozisht dhe nuk do të përbëjnë rast për keqkuptime.

1) Shërbimet: Shënoni kutinë që i afrohet më shumë mendimit tuaj:

Shërbimi	Shumë e kënaqur	E kënaqur	E pakënaqur	Nuk zbatohet	Komente
Këshillimi/mbështetja psikosociale nga punonjëset sociale					
Regjistrimi në shkollë i fëmijëve					
Mbështetja e fëmijës në procesin e të mësuarit					
Mbështetja e pjesëmarrëses për të mësuar shkrim e këndim					
Veprimtaritë në strehëz (puna në grup, puna me fëmijët, diskutime të filmave, librave etj.)					
Ekskursione jashtë strehëzës					
Mbështetje për aftësi bazë për jetën (gatim, pastrim, higjienë personale, komunikim, zgjidhje konflikti etj.)					
Trajnim profesional					
Kujdes mjekësor					
Punësim					
Këshillim për punë					
Ndërmjetësim me Familjen time					
Ndihmë ligjore					
Gjenerim të ardhurash/mikrokredi					

Komente shtesë/sugjerime për përmirësimin e shërbimeve:

2. Kushtet në strehëz

Ju lutemi vlerësoni të mëposhtmet.

Aspekte	Shumë e kënaqur	E kënaqur	E pakënaqur	Komente
Cilësia e ushqimit				
Sasia e ushqimit				
Pastërtia e Strehëzës				
Mjediset kryesore të Strehëzës				
Hapësira për fëmijët				
Sasia e lojërave për fëmijët				

Komente shtesë/sugjerime për kushtet:

3. Trajtimi në strehëz

Aspekte	Gjithmonë	Zakonisht	Rrallë	Komente
A trajtoheni me respekt dhe drejtësi nga stafi?				
A mendoni që stafi kujdeset për ju dhe mirëqenien tuaj?				
A ju është dhënë informacion i mjaftueshëm rreth gjendjes së rastit tuaj?				
A merren parasysh dëshirat dhe këndvështrimet tuaja?				
A ju është dhënë informacion i mjaftueshëm rreth shërbimeve që ju mund të merrni?				
A janë rregullat e strehëz të qarta dhe të drejta?				
A është zbatimi i rregullave të strehëz i njëjlojtë dhe i drejtë?				

Komente shtesë/sugjerime për përmirësimin e trajtimit në strehëz:

Data kur plotësohet: _____

ANEKSI 28

DETYRIMET E STAFIT NDAJ PJESËMARRËSEVE

- Stafi ka për detyrë të trajtojë pjesëmarrëset me respekt dhe dinjitet pavarësisht nga mosha, origjina, gjinia, raca, etnia apo besimi i tyre fetare.
- Stafi nuk duhet të përdorë dhunë apo gjuhë fyese ndaj pjesëmarrëseve.
- Stafi ka për detyrë të ndihmojë pjesëmarrëset për t'u lidhur me burimet dhe shërbimet që janë të disponueshme për ta për të kapërcyer situatën e krizës.
- Stafi ka për detyrë t'u japë pjesëmarrëseve informacion të plotë dhe të hapur rreth kapërcimit të krizës, çështjeve ligjore, kujdesit mjekësor apo informacion tjetër personal për të cilin pjesëmarrëset kanë nevojë dhe personeli e ka këtë informacion.
- Stafi ka për detyrë të trajtojë të gjithë pjesëmarrëset me profesionalizëm. Anëtarët e stafit duhet të komunikojnë në mënyrë të qetë dhe profesionale, pa hyrë në konflikte personale me pjesëmarrëset apo anëtarët e tjerë të stafit.
- Stafi është i detyruar të vishet me profesionalizëm dhe në mënyrë të përshtatshme. Veshjet ekstravagante mund të bëhen shkak për pezullimin e përkohshëm apo të përhershëm nga puna.
- Stafi ka për detyrë të sigurojë fshehtësinë e informacionit që u është dhënë atyre nga pjesëmarrëset. Ky informacion mund të shkëmbehet me një palë të tretë vetëm me pëlqimin me

shkrim nga vetë pjesëmarrësja dhe për sa kohë që pjesëmarrësja e kupton qëllimin për të cilin pala e tretë do të përdorë informacionin.

Përfshirje

- Pjesëmarrëset e kuptojnë që në rastet kur dhënia e informacionit një palë të tretë është e nevojshme për të parandaluar dëme serioze, të parashikuara dhe reale të vetë pjesëmarrëses apo ndonjë personi tjetër të identifikueshëm, ky informacion do të shkëmbehet me ose pa pëlqimin e tyre.

- Pjesëmarrëset e kuptojnë që në rastet kur dhënia e informacionit kërkohet nga ligji apo institucionet ligjore, ky informacion mund të jepet pa pëlqimin e personit. Këto situata përfshijnë, për shembull, urdhrat e gjykatës dhe detyrime të tjera ligjore të ngjashme.

ANEKSI 29 PROCEDURAT E SIGURISË PËR STAFIN

- Mos i jepni askujt adresën apo vendndodhjen e strehëzës. Për individët që janë referuar rishtazi, gjeni një mënyrë për t'i takuar ata diku tjetër (linja e këshillimit, Drejtoria e Policisë, Zyra Rajonale e Shërbimit Social, shoqatat etj.) apo të shoqërohen deri në afërsi të strehëzës nga një ndërmjetës i njohur dhe i besuar, stafi i strehëzës, punonjësit e drejtësisë, punonjësit e policisë, stafi nga agjencia referuese etj.

- Mos e hapni derën e strehëzës për asnjë person që nuk pritet. Përpara se të hapni derën, shikoni nëpërmjet “syrit magjik” apo nëpërmjet kamerave (nëse ka) për t'u siguruar që personi është ai që pritet.

- Përpara se të largoheni nga strehëza për çdo lloj arsyeje, kontrolloni nëpërmjet “syrit magjik” ose kamerës (nëse ka) për t'u siguruar që nuk ka njeri prapa derës.

- Mos diskutoni rastet e dhunës në familje jashtë zyrës. Mos i bëni objekt diskutimi në publik ose me familjen apo miqtë rastet që janë strehuar dhe marrin shërbim në strehëz.

- Ndryshoni rrugën që ndiqni për në punë dhe kthim.

- Mos jepni intervista për gazetarët nga asnjë media pa lejen e shprehur të eprorit tuaj.

- Në strehëz përdorni vetëm emrin. Mos jepni mbiemrin e asnjë pjesëmarrëse apo stafi askujt, brenda apo jashtë strehës.

- Mos i jepni adresën tuaj pjesëmarrëseve. Mos i merrni pjesëmarrëset në shtëpi.

- Mos ndani eksperiencat tuaja personale me pjesëmarrëset.

- Mos i jepni pjesëmarrëseve numrin tuaj personal të kontaktit (numrin e telefonit të shtëpisë apo mobile).

- Gjithmonë qëndroni vigjilentë për rrethanat tuaja dhe raportoni çdo person apo veprimtari të dyshimta eprorit tuaj dhe/ose policisë.

- Mbani me vete ose në celularin tuaj kontaktet e një agjencie të ligjit për rastet e emergjencës.

- Mos sillni droga, alkool apo armë të asnjë lloji në strehëz.

- Punonjëseve të strehëzës nuk ju lejohej asnjë kontakt dhe komunikim privat me pjesëmarrëset. Në të kundërt, ato do të mbajnë përgjegjësi për situatat që mund të krijohen dhe do të penalizohen deri në largimin nga detyra.

ANEKSI 30 PROCEDURAT E SIGURISË PËR PJESËMARRËSET

- Mos i jepni askujt adresën apo vendndodhjen e strehëzës, përfshirë miqtë dhe familjen.

- Mos e hapni derën e strehëzës për asnjë person që nuk pritet. Përpara se të hapni derën, shikoni nëpërmjet “syrit magjik” apo nëpërmjet kamerave (nëse ka) për t'u siguruar që personi është ai që pritet.

- Përpara se të largoheni nga strehëza për çdo lloj arsyeje, kontrolloni nëpërmjet “syrit magjik” ose kamerës (nëse ka) për t'u siguruar që nuk ka njeri pas dere.

- Mos i jepni askujt emrin ose detajet personale të ndonjë pjesëmarrëse tjetër apo stafit të strehëzës.
- Në strehëz përdorni vetëm emrin. Mos i jepni mbiemrin e asnjë pjesëmarrëse apo stafi askujt, brenda apo jashtë strehëzës.
- Kur largoheni nga strehëza për në punë, shkollë apo trajnim, ndryshoni çdo ditë rrugën që ndiqni në mënyrë që askush të mos parashikojë lëvizjet tuaja.
- Gjithmonë qëndroni vigjilentë për rrethanat tuaja dhe raportoni çdo person apo veprimtari të dyshimta stafit dhe/ose policisë.
- Kur largoheni nga strehëza, mbani me vete një numër kontakti të strehëzës në rast të një emergjence.
- Nëse keni rënë dakord për të dhënë një intervistë me gazetarët, mos jepni informacion rreth pjesëmarrësve të tjera në strehëz apo anëtarëve të stafit të strehës.
- Në strehëz nuk lejohen celularët në asnjë moment. Celularët duhet të t'i dorëzohen stafit të strehëzës për ruajtje në momentin e hyrjes në strehëz. Ato do t'i kthehen pjesëmarrëses në momentin e largimit nga qendra.
- Telefonatat mund të bëhen vetëm me lejen e shprehur nga stafi i strehëzës.

ANEKSI 31

DALJA E PJESËMARRËSES NGA STREHËZA

Largimi i pjesëmarrëses nga strehëza mund të jetë vullnetar ose i detyruar. Largimi vullnetar nga shërbimi ndodh kur pjesëmarrësja vendos vetë të largohet nga programi. Largimi i detyrueshëm mund të ndodhë për mosrespektim të kërkesave minimale të shërbimit dhe ose kur është mbushur qëndrimi maksimal prej 180 ditësh. Vazhdimi i qëndrimit përtej 180 ditëve lejohet për rrethana të veçanta, si gjendja me foshnje, pamundësia e strehimit të sigurt, mungesa totale e burimeve materiale të jetesës, shkalla e lartë e rrezikut etj.

Shërbimi i strehëzës mund t'ju refuzohet individëve të cilët nuk janë në gjendje apo nuk kanë dëshirë të marrin pjesë në kërkesat e shërbimit. Kjo mund të përfshijë individë, të cilët janë aktualisht nën ndikimin e drogës apo alkoolit, të cilët shfaqin aktivisht simptoma psikoze, të cilët shprehin ide ose sjellje vetëvrasjeje ose vrasjeje, të cilët nuk janë në gjendje të kryejnë aktivitetet e jetës së përditshme dhe/ose nuk janë në gjendje të marrin vetë mjekimet.

Nëse një person largohet vullnetarisht ose me detyrim, duhet të plotësojë një formular vlerësimi në largim, i cili vendoset në dosjen e pjesëmarrëses.

Ndërprerja e shërbimeve

Një pjesëmarrëse mund të largohet nga programi për një sërë arsyesh, secila prej të cilave mund të kërkojë procedura të ndryshme largimi. Në vijim jepen disa arsye pse një banor mund të largohet nga shërbimi:

- Ka përfunduar së marri shërbimin dhe mund të ketë nevojë për të kaluar në një shërbim tjetër ose në jetë të pavarur;
- I ka mbaruar periudha e lejuar për të qëndruar në qendër;
- Nuk ka më nevojë për shërbime të tjera;
- Është kthyer në familje;
- Strehëza ka kërkuar largimin e saj;
- Është përkeqësuar gjendja e pjesëmarrëses dhe pjesëmarrësja ka nevojë për një nivel më të lartë shërbimi;
- Pjesëmarrësja përbën rrezik për stafin e qendrës apo pjesëmarrëset e tjera;
- Pjesëmarrësja largohet vullnetarisht nga një program pa dhënë njoftim paraprak.

Nëse është e mundur, stafi duhet të planifikojë një takim përpara largimit të saj nga qendra. Takimi në dalje është një shans për të finalizuar çdo planifikim të nevojshëm të sigurisë për largimin e saj, për të mbyllur procedurat me strehëzën, për të shqyrtuar arritjet ose përparimin e saj, si dhe për ta informuar për shërbimet që ka në dispozicion të cilat mund t'i duhen në të

ardhmen. Stafi mund ta përdorë këtë moment për të ofruar lidhje, burime ose referime të tjera që mund t'i duhen pjesëmarrëses pasi të largohet nga programi.

Ky është gjithashtu një moment i mirë për të marrë mendimet e pjesëmarrëses, duke i kërkuar të vlerësojë programin.

Intervista e fundit para daljes nga strehëza

Të gjitha strehëzat duhet të dokumentojnë përpjekjet për të bërë një intervistë në dalje me çdo banor para largimit të tyre. Strehëzat duhet hartojnë dhe të japin një formular për intervistën në dalje dhe të përditësojnë planin ekzistues të sigurisë për këtë proces. Kategoritë minimale të këtij formulari interviste në dalje përfshijnë:

1. Vlerësimin e programit dhe të shërbimeve; qasje të barabartë në shërbime pa diskriminim; vlerësimin e trajtimit me respekt nga stafi; njohuri për dinamikën dhe dhunën në familje; shërbimet për fëmijë; planifikimin e mbrojtjes; planifikimin e objektivave.

2. Të gjitha strehëzat duhet t'i asistojnë pjesëmarrëset për hartimin dhe rishikimin e planit të tyre të sigurisë. Plani duhet të jetë i tillë që t'i përmbushë nevojat dhe ta lidhë pjesëmarrësen me shërbimet e ofruara pas largimit nga strehëza.

3. Në vijim janë disa pyetje që mund të bëhen në intervistën përpara largimit. Intervista nuk duhet të bëhet nga personi, i cili ka punuar kryesisht me pjesëmarrësen gjatë qëndrimit të saj.

- Nga cila lloj mbështetjeje keni përfituar më së shumti?
- Si jeni ndjerë në lidhje me bisedat me punonjëset e strehëzës?
- Si jeni ndjerë në lidhje me ndërveprimin me gratë e tjera që qëndrojnë në strehëz?
- Me cilat çështjet praktike jeni marrë gjatë kohës në strehëz?
- Për cilat çështje keni pasur ndihmë nga punonjëset e strehëzës?
- A ju është dhënë ndonjë informacion i ri gjatë qëndrimit tuaj në strehëz?
- Cili lloj informacioni ka qenë më i vlefshëm për ju?
- Si do ta përmirësonit ju punën e strehëzës?
- A mendoni se keni përfituar nga qëndrimi juaj këtu?
- A ka shërbime, të cilat do të donit t'i vazhdonit pasi të largoheni?
- A ka problem nëse ju kontaktojmë pasi të largoheni? Nëse po, si?

Ndërprerja e shërbimit mund të ndodhë kur një pjesëmarrëse i ka përmbushur qëllimet e programit ose ka vendosur se është koha për t'u larguar nga programi. Ndërkohë që i ndihmon pjesëmarrëset të bëjnë planet për ndërprerjen e shërbimit për shkak të përmbushjes së synimeve të vendosura, stafi duhet të parashikojë afate kohore fleksible dhe të përshtatshme për të përmbushur qëllimet e përcaktuara, ndërkohë që monitoron kufizimet kohore.

Kur një individ është duke u përgatitur për t'u larguar nga strehëza, personeli mund të shqyrtojë të gjithë objektivat e vendosur të pjesëmarrëses për të përcaktuar nëse janë arritur apo jo këta objektiva gjatë qëndrimit në strehëz. Nëse nuk janë përmbushur të gjithë objektivat, stafi mund të rivlerësojë objektivat e papërmbushur së bashku me pjesëmarrësen. Ky mund të jetë momenti për të parë nëse është e sigurt apo jo për t'u larguar nga strehëza apo se çfarë pune mund të duhet të vazhdojë pasi të largohet. Në përgjithësi, personi duhet të largohet me një sistem të mbështetjes të ngritur dhe duke e ditur se mund të kthehet, nëse dëshiron.

Ndërprerja e detyrueshme e shërbimeve

Ndonjëherë qendrat e shërbimeve duhet të marrin vendime të vështira dhe të vlerësojnë nëse një pjesëmarrëse është ende e përshtatshme për të qenë në qendër. Ky vlerësim mund të jetë reagim ndaj sjelljes së një pjesëmarrëseje ose ndaj një problemi sigurie që ka lindur (p.sh., abuzimi me drogë ose alkoolin ose dhuna ndaj të tjerave).

Stafi i strehëzës duhet të vendosë se kur dhe si mund të shmanget largimi i detyrueshëm nga programi. Në momentin kur ndodh një incident ose lind një problem stafi duhet ta trajtojë këtë me banoren përpara se të kthehet në problem që çon në largimin e detyrueshëm. Nëse ka një problem midis banoreve dhe personelit, stafi që ndërhyrë duhet të përpiqet të përdorë teknikat e zgjidhjes së konfliktit për zgjidhjen e problemeve me palët e përfshira. Stafit mund t'i interesojë t'u kërkojë banoreve të cilat kanë marrë pjesë në zgjidhjen e suksesshme të konflikteve për të

ndihmuar banoret e tjera që këto ta zgjidhin në mënyrë të efektshme problemin në momentin që lind. Gjithashtu, kur ndërhyt në një konflikt, stafi duhet të paraqesë një shumëllojshmëri mundësish nga të cilat të mund të zgjedhë pjesëmarrësja me qëllim që të evitohet vazhdimi dhe/ose përshkallëzimi i konfliktit. Ofrimi i metodave për zgjidhjen e efektshme të konflikteve mund të ndihmojë jo vetëm për të shmangur një ndërprerje të mundshme të shërbimeve, por edhe për t'u mësuar pjesëmarrëseve si ta zgjidhin konfliktin e tyre në mënyrë të shëndetshme. Ky është një instrument shumë fuqizues.

Nëse zgjidhja e konfliktit nuk funksionon, personelit i mbetet të marrë vendimin për largimin e detyruar të pjesëmarrëses nga qendra e shërbimit. Një pjesë e procesit të vendimmarrjes duhet të përfshijë edhe banoren në fjalë. Përfshirja i jep një mundësi banores të marrë pjesë në një nivel të dytë të zgjidhjes së problemit. Më e rëndësishmja është se përfshirja pjesëmarrëses në këtë proces e bën atë më të përgjegjshme për jetën e saj. Në procesin e vendimmarrjes marrin pjesë administratori i rastit të banores, personeli administrativ, personeli për kujdesin e fëmijëve dhe persona të tjerë të përshtatshëm jashtë programit, për të vlerësuar nëse duhet të dalë nga programi banorja dhe, nëse po kur duhet të dalë.

Në përgjithësi, personeli duhet të hartojë një metodë të bazuar në konsensus lidhur me kohën dhe mënyrën e ndërprerjes së shërbimeve, pasi të jenë provuar mjetet e tjera të mundshme. Largimet e detyrueshme mund të jenë një mjet i fundit, nëse është shteruar çdo mundësi tjetër.

Nëse stafi ka vendosur t'i kërkojë banores të largohet, me gruan duhet të takohet një punonjës social për ta planifikuar largimin dhe për t'i dhënë informacion. Edhe pse bëhet fjalë për largim të detyrueshëm, kjo procedurë duhet t'i ofrojë mbështetje pjesëmarrëses. Banores dhe fëmijëve të saj duhet t'u jepen referimet e mundshme për strehim ose shërbime alternative.

Në dosje duhet të vendoset një përmbledhje e procedurës së largimit. Kjo përmbledhje duhet të përmbajë:

- Një përmbledhje të shërbimeve të ofruara;
- Problemet e trajtuara gjatë qëndrimit të pjesëmarrëses në strehëz;
- Arritjet e lidhura me planin e shërbimit;
- Çështjet e pazgjidhura që lidhen me planin e ndihmës;
- Arsye të largimit;
- Rekomandimin për ndjekjen e mëpasshme;
- Referimet e bëra.

Nëse pjesëmarrësja largohet me detyrim, përpara largimit të saj nga strehëza personeli duhet të shqyrtojë së bashku me pjesëmarrësen politikat dhe procedurat e ankimit dhe ta informojë pjesëmarrësen për mundësitë që mund të shfrytëzojë.

Aneksi 32

Ndjekja pas daljes

Një takim para daljes do ishte shumë e përshtatshme në mënyrë që të ruhen kontaktet me pjesëmarrësen. Ndjekja pas daljes mund të shërbejë për dy qëllime:

1. Për të vlerësuar me pjesëmarrësen nëse po merr apo ka nevojë për shërbime
2. Për të marrë informacion vlerësues mbi shërbimet që ka marrë

Takimi para daljes mund të bëhet në mënyra të ndryshme dhe mund të menaxhohet duke pasur parasysh sigurinë e pjesëmarrëses. Duhet pasur parasysh që jo të gjitha mund apo duhet të marrin shërbime pas daljes nga Strehëza. Disa pjesëmarrëse nuk mund të kontaktohet për shkak të situatave dhe disa të tjera nuk preferojnë të kontaktohen.

Çfarë duhet patur parasysh?

- **Telefonata** –Stafi mund ta telefonojë pjesëmarrësen për sa kohë që nuk vë në rrezik sigurinë e saj ose mund t'i kërkojë asaj të telefonojë në strehëz një herë në tre muaj përgjatë një periudhe gjashtë mujore.
- **Kontrolle sigurie tridhjetë ditore dhe gjashtë mujore** –Pjesëmarrëset marrin një letër postare pas daljes së tyre dhe ju kërkohet ta kthejnë përsëri me anë të postës. Letra postare mund të përbajë pyetje në qoftë se nuk duhet kontaktuar personi, ose në rast kontaktimi si mund të arrihet lehtësisht. Nëse ajo mund të kontaktohet, stafi mund ta vazhdojë procesin e ndjekjes pas daljes me anë të një pyetësoi që mund të jetë me anë të telefonit dhe ta pyesë se si po shkon dhe nëse ka nevojë për ndonjë lloj mbështetje të caktuar.

Kur ofrohet apo kryhet procesi ndjekjes pas daljes duhet siguruar që pjesëmarrësja është e sigurtë dhe t'i jepen shërbimet apo referencat e nevojshme. Bejani të ditur se deri kur mund të marrë shërbime nga strehëza. P.sh. nëse mund të vijë në grupe mbështetëse apo shërbime të tjera jo-rezidenciale.

Aneks 33

Standartet e përgjithshme për personelin

1. Programi ka përpiluar përshkrime të vendeve të punës për të gjithë stafin, si edhe dokumentacionin e diapazonit të pagave, ku përfshihen kushtet që duhen përmbushur, përgjegjësitë dhe hierarkia e llogaridhënies.
2. Evidencat e personelit mbahen në një vend të sigurt dhe të kyçur.
3. Programi ka një organigramë ku përcaktohet hierarkia e përgjegjësisë dhe e llogaridhënies, duke përfshirë Bordin, stafin dhe vullnetarët.
4. Nëse Programi ka staf që jep këshillim profesional ose terapeutik dhe/ose programim tjetër profesional, në dosjen e personelit duhen futur edhe kredencialet ose licencat e duhura;
5. Agjencitë me staf të licencuar kanë bërë hapat për të siguruar që licencat janë të vlefshme, që janë vendosur deklaratat e duhura për dhënien e informacionit apo që këto deklaratat t'u jenë vendosur në dispozicion përfituesëve të programit dhe që stafi i licencuar të ushtrojë aktivitetet brenda objektit të deklaruar të aktivitetit.
6. Mbledhjet e stafit zhvillohen në mënyrë të rregullt, gjithmonë jo më pak se një herë në muaj

Aneks 34

MBAJTJA E TE DHËNAVE PERSONALE TË PËRFITUESEVE

Filozofia:

Gjithmonë duhet treguar kujdes gjatë dokumentimit të informacionit për një përfituese. Dokumentimi nuk duhet ta vendosë përfituesen në rrezik dhe duhet ta minimizojë keqinterpretimin e informacionit.

Politika:

1. Duhet të mbahet sa më pak dokumentacion dhe në dosjen e përfitueses duhet të mbahet vetëm informacioni esencial.
2. Dokumentacioni nuk duhet të përmbajë diagnozë të shëndetit mendor apo etiketime të sjelljeve të përfitueses.
3. Dokumentacioni duhet të jetë faktik dhe të mos përfshijë opinione.
4. Dokumentacioni duhet të respektojë standardet e Strehëzës.
5. Mbledhja e stafit të rastit duhet të bëhet të paktën çdo 2 javë dhe në dosjen e përfitueses duhet të futet dokumentimi i plotë, duke përfshirë datën e mbledhjes, emrin e punonjësit dhe mbikëqyrësit të rastit dhe rezultatet. Këto mbledhje duhet të trajtojnë çështje të tilla si siguria e jetës, nevojat e përfitueses, përparimi drejt objektivave dhe pengesat e perceptuara.

Procedurat:

1. Dokumentacioni i përgjithshëm në dosje:
 - a. Stafi duhet të dokumentojnë të gjithë informacionin në dosjen e përfitueses brenda 24 orëve pas kontaktit.
 - b. Stafi duhet të regjistrojë një shënim për turn në dosjen e përfitueses. Nëse përfituesja nuk ndodhet në mjediset e strehëzës, stafi shënon “nuk ka pasur kontakt”.
 - c. Shënimet e këshillimit duhet të mbahen në një dosje krejt tjetër.
 - d. Dosjet e personave në moshë të rritur duhet të përmbajnë të paktën:
 - i. Të dhëna demografike
 - ii. Arsyen për referimin
 - iii. Vlerësimin e vdekshmërisë
 - iv. Planin e sigurisë
 - v. Përshkrimin e abuzuesit
 - vi. Planin individual i ndihmës
 - vii. Njoftimin e përjashtimeve nga fshehtësia e informacionit, duke i njoftuar përfitueses lidhur me detyrimin e stafit për të dhënë, në kushte të caktuara, informacion të mbajtur të fshehtë.
 - viii. Raportin e incidentit të abuzimit
 1. Raporton abuzimin me fëmijën
 2. Mbron nga rreziku që i kanoset vetes ose të tjerëve
 3. Kërkon shërbime urgjence për shëndetin dhe jetën e përfitueses
 4. Mban standardet e shëndetit dhe sigurisë që ka Strehëza
 - ix. Deklaratën e përjashtimit nga përgjegjësia

- x. Evidencat kronologjike të kontaktit me përfituesen
 - xi. Pëlqimin e informuar për dhënien e informacionit të fshehtë
 - xii. Rregulloren e Strehëzës, dokumentin e të drejtave dhe detyrimeve të përfitueses, që mban datën dhe nënshkrimin përkatës.
 - xiii. Intervistën e fundit para daljes nga Strehëza
 - e. Dosjet e fëmijëve duhet të mbahen më vete nga dosjet e personave në moshë të rritur:
 - i. Vlerësimin e fëmijëve (nëse ka)
 - ii. Lejen për shërbimet për fëmijët (nëse ka, në momentin e pranimin)
 - f. Formati i dokumentacionit: Në dosjen e përfitueses, të gjitha kontaktet me përfituesen duhet të dokumentohen në formë kronologjike. Informacioni duhet të përfshijë:
 - i. Llojin e kontaktit
 - ii. Përpjekjet për menaxhimin e shërbimit
 - iii. Shërbimet në emër të administrimit të rastit të personit të mbijetuar, shërbimet e komunitetit, domethënë të kuadrit fizik dhe social në të cilin jepen shumë shërbime, si mbështetja, nxitja, etj.
 - iv. Informacionin për kontaktet me palët e tjera, duke përfshirë referimet
 - v. Përmbledhje të shkurtër të kontaktit
 - vi. Nënshkrimin, emrin dhe mbiemrin dhe pozicionin/profilin profesional të stafit
2. Shënimet kronologjike: Këto shënime pasqyrojnë të gjitha kontaktet e bëra me përfituesen ose në emër të saj.
- a. Këto shënime duhet të hidhen në formularin “Shënime kronologjike” nga stafi i duhur.
 - b. Këto shënime duhet të përfshijnë një ditar të shërbimeve dhe lidhjen me formularët e duhur.
 - c. Data kur është ofruar shërbimi duhet të vendoset në hapësirën në dispozicion.
 - d. Ora kur është ofruar shërbimi duhet të vendoset në hapësirën në dispozicion.
 - e. Sasia e kohës së shpenzuar duhet të vendoset në rubrikën “Orë” në këtë mënyrë:
 - 0,08 = pesë minuta,
 - 0,16 = 10 minuta,
 - 0,25 = 15 minuta,
 - 0,33 = 20 minuta,
 - 0,4 = 25 minuta,
 - 0,50 = 30 minuta,
 - 0,75 = 45 minuta,
 - 1,00 = 60 minuta.

- f. Lloji i shërbimeve të ofruara duhet të vendoset në rubrikën “Shërbimet”:
 - i. TBB = takim balle per balle—kontakt për menaxhimin e rastit, avokatinë dhe takim i përgjithshëm
 - ii. KPT = kontakt përmes telefonit—çdo shërbim i ofruar përmes telefonit
 - iii. K=këshillim— ofruar vetëm nga stafi këshillues,
 - iv. KF= këshillim për fëmijët—ofrohet vetëm nga stafi këshillues
 - v. I/R = informim dhe referim
 - vi. GM = grup mbështetës—përfshin mbledhjet e shtëpisë, aftësitë për jetën, mbështetje dhe këshillim, takime edukative, etj.
- g. Rubrika “Shënime” duhet të përfshijë informacion lidhur me ndërveprimet, nevojat dhe informacion të përgjithshëm, etj., për përfituesen. Informacioni duhet të jetë faktik dhe të evitojë vlerësime apo gjykime.
- h. Nënshkrimi: Staf i ose këshilluesja duhet të nënshkruajë me emrin e plotë dhe me profesionin/pozicionin.

3. Dokumentimi i këshillimit: *bëhet vetëm nga stafi këshillues*

- a. Dokumentimin e këshillimit e bëjnë këshilluesit.
- b. Ky lloj dokumentimi duhet të bëhet në një dosje të veçantë këshillimi.
- c. Shënimi i këshillimit konsiston në
 - i. Emrin dhe numrin e kodifikuar të përfitueses
 - ii. Datën e kontaktit
 - iii. Orën e fillimit dhe përfundimit të seancës
 - iv. Llojin e kontaktit
 - v. Përmbledhjen e shkurtër të seancës
 - vi. Lidhjen e përmbajtjes së seancës me një objektiv specifik të identifikuar në planin e ndihmës
 - vii. Nënshkrimin e plotë të këshillueses së bashku me profesionin dhe pozicionin.
- d. Shënimi i përparimit të këshillimit duhet të mbahet në një dosje të veçantë të përfitueses në çdo kohë.

4. Regjistri i komunikimit

- a. Regjistri i komunikimit mbahet në zyrën e stafit.
- b. Regjistri i komunikimit duhet të dokumentohet çdo ditë nga stafi dhe këshilluesit.
- c. Incidentet, ngjarjet dhe informacioni i përgjithshëm për secilin të mbijetuar duhet të dokumentohen në regjistrin e komunikimit për të mundësuar komunikimin me të gjitha turnet në strehëz. Regjistri i

- komunikimit i jep mundësi stafit të vihet në dijeni për nevojat dhe vështirësitë e përfitueses.
- d. Në regjistrin e komunikimit mund të regjistrohen edhe informacione të tilla të stafit si ndryshimet e planifikuara, pushimet apo informacion i përgjithshëm.
 - e. Për çdo regjistrim duhet përdorur numri i përfitueses dhe jo emri i saj.
 - f. Numri i përfitueses mund të gjendet në një tabelë në pjesën e përparme të regjistrit apo të librit të përfitueseve.
 - g. Dokumentacioni: kur bëhet një regjistrim në regjistrin e komunikimit, ai duhet të përfshijë:
 - h. Datën
 - i. Përmbledhjen e ngjarjes duke përdorur vetëm numrin e përfitueses
 - j. Siglimin nga stafi, këshilluesi ose stafi që bën regjistrimin
 - k. Zëvendësimi i regjistrit të komunikimit
 - l. Kur një regjistër komunikimi mbushet plot duhet hequr tabela me numrin e përfitueses në pjesën e sipërme të regjistrit, regjistri i duhet dhënë përgjegjësit të strehëzës për t'u ruajtur dhe, më vonë, për t'u eliminuar.
 - m. Tabela e numrit të përfitueses duhet të vendoset në pjesën e sipërme të një regjistri të ri komunikimi.
 - n. Në çdo moment duhet të ekzistojnë vetëm dy regjistra komunikimi në të njëjtën kohë. Regjistri i komunikimit i cili është duke u përdorur për regjistrim të përditshëm dhe regjistri i fundit i cili i është dhënë përgjegjësit të strehëzës.
 - o. Kur një regjistër mbushet plot dhe kalon në kabinetin e dosjeve, çdo regjistër komunikimi që ndodhet aty që më parë duhet të hiqet dhe të grisët.

UDHËZIM

Nr. 816, datë 27.11.2018

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE DHE TË FUNKSIONIMIT TË QENDRAVE TË MENAXHIMIT TË KRIZËS, PËR RASTET E DHUNËS SEKSUALE

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 7, pika 2/1, germa “c” dhe 23, të ligjit nr. 47/ 2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunë në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”, dhe nenit 27, pika 3, të ligjit nr. 121/ 2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale, sipas tekstit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalet Rajonale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektoratet përgjegjëse për shëndetësisë dhe shërbimet shoqërore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE
E MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

STANDARDET E SHËRBIMIT
PËR QENDRAT E MENAXHIMIT TË KRIZËS PËR RASTET E DHUNËS SEKSUALE
(TË VENDOSURA PRANË QENDRAVE SPITALORE, SHËRBIM ME NJË NDALESË,
TË INTEGRUAR, 24/7, DHE AFATSHKURTËR)

Tiranë, nëntor 2018

Hyrje

Dokumenti i standardeve të shërbimit për “Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale” me fokus kryesor shërbimin emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë), për viktimat/ të mbijetuarit/rat e dhunës seksuale, si dhe për anëtarët e tjerë të familjeve të tyre, u përgatit me qëllim funksionimin sa më eficient të këtyre qendrave.

Ky dokument, i cili mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor, u përgatit përmes një procesi konsultimi me pjesëmarrjen e specialistëve/eve të Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, specialistëve/eve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në nivel qendror e vendor, përfaqësuesve/eve të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës me bazë gjinore, viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit dhe fëmijët e keqtrajtuar, si dhe shërbime të tjera mbështetëse për të mbijetuarat/it e dhunës, anëtar/eve të Mekanizmit të Referimit në Bashkinë Tiranë, përfaqësues/eve të organizatave ndërkombëtare¹, si dhe me mbështetjen e ofruar nga PNUD-i, përmes vënies në dispozicion të dy eksperteve², si dhe mbështetjes teknike e logjistike përgjatë gjithë procesit të hartimit, deri në finalizimin e dokumentit.

Standardet e shërbimit për “Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale” janë një parakusht për ofrimin e shërbimit në nivele profesionale, procesin e licencimit të këtij shërbimi, kontrollit dhe vlerësimit të tij, që mund të ofrohet në të ardhmen nga subjekte publike dhe jopublike. Në to theksohen kushtet minimale bazë për t’u përmbushur me qëllim ofrimin e shërbimit të menjëhershëm, emergjent dhe afatshkurtër, në rastet e dhunës seksuale dhe që për këtë arsye duhet të aplikohen detyrimisht nga të gjitha subjektet publike e jopublike që ofrojnë një shërbim të tillë.

Standardet e shërbimit për qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale synojnë mbrojtjen e jetës së viktimave, qofshin këta gra dhe vajza, djem e burra, fëmijë, të rritur dhe të mitur, si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, përmes një shërbimi emergjent, me një ndalesë, të integruar, 24/7, afatshkurtër (24 orë deri në 72 orë). Mbështetur në nevojat e të mbijetuarve/rave, pas trajtimit emergjent, ata/ato referohen për trajtime afatgjatë pranë qendrave të specializuara.

Të bazuara në praktikat më të mira në këtë fushë, këto standarde reflektojnë parimet ndërkombëtare të barazisë, respektimit dhe garantimit të vlerave dhe personalitetit të individit, të së drejtës për t’u mbrojtur, të mbrojtjes së informacionit për jetën vetjake, të dinjitetit dhe sigurisë etj. Prandaj dhe vënia në zbatim e tyre garanton ofrimin e një shërbimi cilësor të trajtimit emergjent të viktimave të dhunës seksuale, pavarësisht gjinisë, moshës, etnisë, nevojave të veçanta apo aftësive të kufizuara, përkatësisë fetare, identitetit gjinor apo orientimit seksual të tyre, si dhe për individët e tjerë, pjesëtarë të familjeve të tyre.

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shoqëria shqiptare është angazhuar në luftën ndaj dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe formave të tjera të tyre që në fillim të viteve ‘90. Përpjekjet për hartimin e një legjislacioni sa më bashkëkohor, të harmonizuar me atë ndërkombëtar, si dhe ratifikimi i një sërë konventash ndërkombëtare, hartimi i politikave sociale në mbrojtje të viktimave/të mbijetuarave /ve të abuzimit, ngritja e shërbimeve dhe praktikave eficiente për të mundësuar riintegrimin e viktimave dhe

¹ Një listë e plotë e institucioneve kontribuese dhe pjesëmarrës/eve në grupin e punës do të gjendet bashkëlidhur këtij dokumenti si shtojcë 1.

² Znj. Edlira Haxhiymeri dhe znj. Rajmonda Duka.

minimizimin e rasteve të tilla kanë qenë përpjekje të vazhdueshme në këto vite ku kanë kontribuar aktorë të qeverisjes qendrore dhe vendore, aktorë të shoqërisë civile, institucione publike dhe jopublike, partnerë vendas dhe të huaj.

Eksperienca e tre dekadave të fundit shënon disa pika kulmore siç janë:

- Ratifikimi i Konventës CEDAW në vitin 1993 dhe Protokollit Shtesë të saj në vitin 2003, edhe pse harmonizimi i legjislacionit dhe zbatimi i CEDAW në praktikë ka ende shumë për të bërë;
- Ratifikimi i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur, gjithashtu, si Konventa e Stambollit;
- Përditësime të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë;
- Ndryshime në Kodin e Procedurës Penale;
- Hartimi dhe përmirësimi i ligjit për masa parandaluese të dhunës në marrëdhëniet familjare (2006).

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje ose siç njihet ndryshe Konventa e Stambollit, në nenin 25 të saj “Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale”, thekson se “Palët marrin masa të nevojshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e një numri të mjaftueshëm të qendrave referuese të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme për dhunën seksuale ose krizën nga përdhunimi, për viktimat, për të parashikuar vizita mjekësore dhe mjeko-ligjore, mbështetje për traumat dhe këshillim për viktimat”.

Konventa e Stambollit kërkon, gjithashtu, ngritjen e qendrave të emergjencës për përdhunimin apo qendrave të referimit të viktimave të dhunës seksuale, të cilat të jenë të mjaftueshme në numër, të përshtatshme dhe lehtësisht të arritshme nga viktimat, për të siguruar ekzaminim mjekësor dhe mjeko-ligjor, mbështetje pas traumës dhe këshillim afatgjatë për viktimat (neni 25). Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit, në paragrafin 142, rekomandon se një qendër e tillë duhet të jetë në dispozicion për çdo 200,000 banorë dhe se përhapja gjeografike e tyre duhet të jetë e tillë që, këto qendra, të jenë të arritshme për viktimat në zonat rurale njëloj si për ato në qytete.

Konventa e Stambollit jo vetëm që përshkruan llojin e shërbimeve mbështetëse që duhet të jenë në dispozicion për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës, por, gjithashtu, vendos standarde për mënyrën se si duhet të ofrohen këto shërbime. Në nenin 18, paragrafi 3, Konventa e Stambollit kërkon që shërbimet mbështetëse: të bazohen në një kuptim të gjinizuar të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe të përqendrohen në të drejtat e njeriut dhe sigurinë e viktimës; të bazohen në një qasje të integruar e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, dhunuesve, fëmijëve, si dhe të mjedisit të tyre më të gjerë social; të synojnë shmangien e riviktimizimit; të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave viktimave të dhunës; të jenë të vendosura, kur është e mundur, në të njëjtat mjedise; të adresojnë nevojat e veçanta të personave vulnerabël, përfshirë fëmijët viktimë dhe të vihen në dispozicion për ta.

Për më tepër, ofrimi i shërbimeve nuk duhet të varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur padi apo për të dëshmuar kundër çdo dhunuesi (neni 18, paragrafi 4).

Rekomandimi urgjent i GREVIO-s për Shqipërinë (nr. 9) dërguar në janar 2018 dhe për të cilin qeveria shqiptare duhet të raportojë deri në 31 janar 2021, specifikon: “ngritjen e qendrave të trajtimit të krizave të përdhunimit dhe/ose të qendrave të referimit të dhunës seksuale në kuadër të një reagimi shumësektorial të komunitetit në përgjithësi, duke synuar thyerjen e tabuve ekzistuese në lidhje me dhunën seksuale, si dhe inkurajimin e raportimit të kësaj forme të dhunës (paragrafi 110)”.

Po kështu, Rekomandimi urgjent i GREVIO-s për Shqipërinë (nr. 12) dërguar në janar 2018 dhe për të cilin qeveria shqiptare duhet të raportojë deri më 31 janar 2021, thekson: “të ndryshohet përkufizimi i përdhunimit në mënyrë që të bazohet në mungesën e pëlqimit të dhënë lirisht, të mos kërkojë demonstrimin e përdorimit të forcës ose rezistencës dhe në rastin e përdhunimit të fëmijëve ndërmjet 14 dhe 18 vjeç, të mos varet nga fakti nëse viktimë ka arritur moshën e pjekurisë apo jo; të penalizohet sjellja seksuale jokonsensuale e përshkruar në paragrafin 1,

germat “b” dhe “c”, të nenit 36 të Konventës; të merren masat e nevojshme për të siguruar që çdo akt i dhunës seksuale ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve aktualë të kriminalizohet nga ligji i brendshëm (paragrafi 139)”

Të gjitha sa më sipër e detyrojnë palën shqiptare të shtojë përpjekjet e saj për të mbështetur, trajtuar dhe rehabilituar viktimat dhunës seksuale, ashtu sikurse dhe duhet punuar për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë formë të dhunës, e cila është prezente, si dhe të hidhen hapa për të ofruar përgjigje e shërbime efektive dhe të mirëkooor-dinuara. Edhe pse ka vite që flitet për forma të ndryshme të dhunës ndaj grave e vajzave, si dhe të dhunës në familje, duket se diskutimet rreth dhunës seksuale mbeten shumë më të ndryshuara e shpesh klasifikohen edhe si tabu. Ndjeshmëria për të folur rreth kësaj forme dhune ndjehet nëse bëhet fjalë kryesisht për abuzim dhe dhunë seksuale ndaj të mitur/ave. Por diskutimi mbi rastet e dhunës seksuale të rritur/at apo akoma dhe më tej dhuna seksuale ndërmjet partnerëve intimë ose përdhunimi martesor, ende mbeten në hije dhe nëse diskutohen, në mënyrë shumë tipike rrethohen nga paragjykimet dhe “fajësimi”, që sigurisht rëndojnë mbi viktimën. Një pjesë e madhe e anëtarëve të komunitetit ende nuk mund ta imagjinojnë ekzistencën e dhunës seksuale në çift apo përdhunimin martesor, pasi marrëdhëniet seksuale konsiderohen si pjesë e “kontratës martesore” dhe për këtë arsye janë brenda përgjegjësive të martesës³. Qëndrime të ngjashme ndeshen edhe mes profesionistëve, të cilat/ët jo në pak raste idenë e denoncimit të një përdhunimi apo dhune seksuale në çift, e konsiderojnë si “shumë larg kulturës dhe mentalitetit shqiptar”. Standardet e ofrimit të shërbimit në Qendrat e shërbimit të integruar për viktimat/të mbijetuarat/it e sulmit seksual synojnë të sigurojnë një shërbim profesional, cilësor, multidimensional dhe afektiv ndaj viktimave/të mbijetuarit/rave.

Standardet e shërbimeve reflektojnë parimet dhe standardet e Konventës së Stambollit për viktimat e dhunës seksuale.

II. BAZA LIGJORE

Baza ligjore kryesore mbi të cilën është mbështetur hartimi i standardeve të shërbimit në qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale (si ofrim i menjëhershëm, me një ndalesë, afatshkurtër ndaj viktimave/të mbijetuarve/are), listohet në vijim:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
2. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012⁴;
3. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
4. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar, maj 2018);
5. Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
6. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë””, të ndryshuar;
7. Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
8. Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
9. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
10. Ligji nr. 22/2018 “Për strehimin social”;
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.7.2011 për “Standardet e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje”, në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike;
12. Udhëzimi nr. 13, datë 17.12.2012, “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike”;
13. Standardet minimale të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në strehëzat emergjente (draft 2018);
14. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të

³ Material i UNWOMEN për modelin e qendrave të krizës për rastet e dhunës seksuale, 2018.

⁴ Si dhe regjistruar në faqen e Konventës në datën 4.2.2013 shiko:

<http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=&DF=&CL=ENG>

punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;

15. Marrëveshjet e bashkëpunimit për formalizimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të nënshkruara në nivel bashkie.

16. Vendimi nr. 425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”, i ndryshuar;

17. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 3.12.2014, Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”.

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Standardet e shërbimeve për Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale u referohen koncepteve dhunë, dhunë me bazë gjinore, dhunë seksuale, sulm seksual, ngacmim seksual, dhunë në familje, pjesëtarë të familjes etj., siç përkufizohen në Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, si dhe ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar), apo edhe në ligje e dokumente të tjera.

a) Dhunë ndaj grave kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, pavarësisht nëse ndodh në jetën publike ose private⁵;

b) Dhunë në familje nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën⁶;

c) Dhunë seksuale nënkupton çdo akt seksual të drejtpërdrejtë ose të nënkuptuar ndaj një personi tjetër, pa dëshirën dhe vullnetin e saj/tij. Dhunë seksuale konsiderohen jo vetëm sjelljet e drejtpërdrejta, por edhe ngacmimet, kërcënimet, gjymtimet gjenitale që mund të përdoren në rrethana të caktuara;

d) Sulm seksual konsiderohet çdo sjellje me nuancë seksuale që realizohet në mënyrë të papritur, dhe e gjen viktimën të papërgatitur për t’u mbrojtur nga sulmuesi;

e) Gjini nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë⁷;

f) Dhunë me bazë gjinore nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale⁸;

g) Viktimë nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat “a”, “b”, “c” dhe “d” më sipër;

h) Viktimë e dhunës seksuale mund të jetë një grua apo vajzë, një burrë apo djalë, një fëmijë që në rrethana të caktuara është objekt i sjelljes seksuale të dikujt;

i) Mbështetje për viktimat e dhunës seksuale – masa të nevojshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e një numri të mjaftueshëm të qendrave të shërbimeve të integruara, lehtësisht të aksesueshme për viktimat ose ngritjen e shërbimeve afatgjata për menaxhimin e krizës së përdhunimit. Shërbimet në fjalë nënkuptojnë vizita mjekësore dhe mjeko-ligjore, mbështetje për kapërcimin e traumës dhe këshillim për viktimat.

⁵ Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, neni 3 “Përkufizimet”.

⁶ Konventa e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, neni 3 “Përkufizimet”.

⁷ Ibidem.

⁸ Ibidem.

j) Mbrojtja dhe mbështetja për viktimat e mitur/fëmijë nënkupton masa për të garantuar që fëmijët, viktimat të dhunës seksuale janë të mbrojtur dhe mund të marrin shërbimet e nevojshme si trajtim mjekësor, këshillim, mbështetje psikoemocionale.

k) Mbrojtja dhe mbështetja për personat me aftësi të kufizuara nënkupton të gjitha llojet e shërbimeve të nevojshme për t'iu ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuara që janë bërë viktimat të dhunës seksuale.

l) Shërbime mbështetëse të specializuara nënkupton shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata, mbështetëse, të specializuara për çdo viktimitë që i nënshtrohet një akti dhune. Këto shërbime ofrohen nga specialistë/profesionistë të fushave të ndryshme.

m) Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale ofrojnë shërbim të menjëhershëm, të sigurt, afatshkurtër, mbështetës dhe të specializuar për çdo viktimitë të sulmit seksual, përfshirë fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara. Shërbimi i këtyre qendrave ofrohet për një periudhë 24–72 orë. Shërbimi që ofrohet në këto qendra është multidisiplinar. Në ofrimin e tij angazhohet një ekip multidisiplinar i përbërë nga mjekë gjinekologë, pediatër, mjekë ligjorë, psikiatër, psikologë, punonjës të policisë dhe të ligjit, punonjës socialë dhe infermierë. Llojet e shërbimeve që ofrohen në mjediset e qendrave janë kryesisht ato mjekësore, mjeko-ligjore, të këshillimit dhe referimit në shërbime të tjera afatgjata. Ato mund të ofrojnë shërbime vetëm nëse përmbushin standardet e përcaktuara në këtë dokument. Qendrat e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale mund të jenë qendra publike, të ngritura dhe menaxhuara nga institucionet publike qendrore dhe vendore, ose dhe jopublike, të ngritura dhe menaxhuara nga OJF-të e specializuara.

n) Qendrat e shërbimeve afatgjata janë shërbime të përkohshme, të specializuara, rezidenciale dhe jorezidenciale, që ofrojnë shërbim të specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim mund të ofrohet nga institucione publike dhe jopublike.

o) Mekanizmi i koordinuar i referimit kundër dhunës me bazë gjinore është një organizim i shërbimeve në nivel bashkie për t'ju ardhur në ndihmë në mënyrë sa më të shpejtë dhe eficiente viktimave të dhunës. Ky mekanizëm nënkupton bashkëpunimin midis institucioneve për të mundësuar plotësimin e nevojave të viktimës dhe rehabilitimin e tyre në kohën më të shkurtër të mundshme.

p) Përfitues/e i/e shërbimeve të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale janë individë gra e vajza, burra dhe djem, fëmijë, persona me aftësi të kufizuara, të cilët pavarësisht statusit të tyre, provojnë se janë viktimat të dhunës seksuale dhe si të tillë përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror sipas ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

q) Situatë emergjente është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese⁹.

r) Punonjës/e social/e e qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale është profesionist/ja, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në Qendër që bën pritjen e viktimave, njoftimin e ekipit multidisiplinar, dhe që do të jetë përgjegjës/e për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve¹⁰.

s) Punonjës/e i shërbimeve sociale është i/e punësuar/a në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.¹¹

t) Menaxhim i rastit është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror (në rastin tonë e viktimave të dhunës seksuale) në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre¹².

⁹ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 14.

¹⁰ Ibidem, neni 3, “Përkufizime”, pika 24.

¹¹ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 28.

¹² Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 25.

u) Fëmijë është çdo individ deri në moshën 18 vjeç.

v) Standardet e shërbimeve për Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale janë standardet bazë që duhet të synohet të plotësohen nga të gjitha shtetet dhe shërbimet. Standardet mundësojnë kufijtë dhe rregullat për ofruesit e shërbimeve, për sa i takon shtrirjes dhe miksimit të shërbimeve që duhet të jenë në dispozicion, kush duhet t'i ofrojë këto shërbime, si dhe parimet dhe praktikatat bazë me të cilat ato duhet të veprojnë. Këto standarde janë inspiruese, duke pasur parasysh që shumë shtete ende nuk kanë plotësuar numrin e duhur të shërbimeve të specializuara, apo shumë të tjera nuk arrijnë ende të plotësojnë standardet edhe thjesht sipas politikave të vendit, praktikave dhe burimeve në dispozicion. Gjithsesi, këto standarde përfaqësojnë nivelin dhe cilësinë e shërbimeve në të cilat duhet të kenë qasje dhe disponibilitet të gjitha viktimat e dhunës seksuale në Evropë.

IV. PARIMET THELBËSORE PËR TË GJITHA STANDARDET

Qendra e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale duhet të ofrojë shërbimin e saj të menjëhershëm, të integruar, të specializuar, afatshkurtër, në përputhje me parimet thelbësore të mëposhtme:

1. Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfitueses/it. Ofrimi i shërbimit në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale duhet të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar, përkatësisë etnike, identitetit gjinor apo orientimit seksual, respektimit dhe plotësimit të kushteve për trajtimin e paaftësive fizike e mendore apo nevojave të veçanta.

2. Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohej çdo formë e diskriminimit të viktimave/përfitueses/it të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

3. Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore dhe mbrojtjes sociale bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.¹³

4. Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit që trajtohet me shërbime të emergjencës pranë Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Koordinatori /ja e Qendrës, profesionistët e ekipit multidisiplinar pranë kësaj Qendre, punonjësi/ja social/e e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimit ndaj viktimës së sulmit seksual ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

5. Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e emergjencës për viktimat e dhunës seksuale ashtu sikurse të gjitha shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore¹⁴.

6. Siguria dhe dinjiteti njerëzor. Shërbimet që do të ofrohen në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale duhet të mundësojnë që të gjitha ndërhyrjet të prioritarizojnë sigurinë dhe dinjitetin e përdorueseve të shërbimeve dhe të personelit.

7. E drejta e marrjes së vendimit për ta përfituar shërbimin, bazuar në dhënien e një informacioni të plotë e të përditësuar. Janë viktimat, të mbijetuarat/it e dhunës seksuale ose përfaqësuesit e tyre ligjorë (në rastin e fëmijës apo personave me aftësi të kufizuara) që do të vendosin për jetën e tyre dhe sigurinë e jetës. Është e rëndësishme që viktimave/të mbijetuarve t'u jepet i gjithë informacioni i nevojshëm për të marrë vendime të drejta për mbështetjen afat shkurtër dhe afat gjatë.

¹³ Ligj nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 4 "Parimet", pika "dh".

¹⁴ Ligj nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", neni 4 "Parimet", pika "c".

8. Ofrimi i shërbimeve nuk duhet të varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur padi apo për të dëshmuar kundër çdo dhunuesi.

V. STANDARDET, KRITERET DHE TREGUESIT

STANDARDI 1

Shërbimet e ofruara në “Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale” (më pas “Qendra”) duhet të jenë në përputhje me natyrën e këtij lloji shërbimi, të menjëhershme, të integruara, multidisiplinare, me një ndalesë, gjatë të shtatë ditëve të javës, afatshkurtra, të ofruara në mënyrë profesionale nga një ekip multidisiplinar i përbërë nga mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të zbatimit të ligjit, dhe infermierë. Shërbimet e Qendrës ofrohen pa asnjë lloj diskriminimi, paragjykim apo “fajësimi” të viktimave për situatën e ndodhur dhe në respekt të dinjitetit të tyre njerëzor.

Shërbimi ofrohet për një periudhë të shkurtër nga 24–72 orë.

Rezultati i dëshiruar:

Shërbimet e ofruara demonstrojnë një qasje të përshtatshme dhe të informuar për përdorueset/it e shërbimit, që merr në konsideratë dinamikën dhe pasojat e dhunës seksuale të viktimat dhe familjarët e tyre.

STANDARDI 1.1

Shërbimi i ofruar në Qendër promovon të kuptuarit se dhuna seksuale ndaj çdo personi, pavarësisht gjinisë, racës, etnisë, moshës, besimit apo sjelljes seksuale është e papranueshme dhe shkelje e të drejtave të njeriut.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të ketë një dokument me përkufizime të qarta në lidhje me dhunën seksuale, si dhe dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, dhunën ndaj grave dhe vajzave, abuzimin e fëmijëve etj. - Stafit duhet të punësohet bazuar në qasjen dhe qëndrimin që mban ndaj këtyre formave të dhunës. - Aktivitetet për fuqizimin e kapaciteteve profesionale të personelit të Qendrës, të theksojnë vazhdimisht qasjen që duhet të udhëheqë punën në Qendër për menaxhimin e rasteve të viktimave të sulmit seksual. - Shërbimi i ofruar duhet ta reflektojë këtë qasje dhe përdorueset/it e shërbimit duhet ta kuptojnë se ajo që u ka ndodhur përbën shkelje të të drejtave të njeriut.	1.1.1 Ekziston një përkufizim mbi termat “dhunë seksuale”, “dhunë me bazë gjinore”, “dhunë në familje”, “dhunë ndaj grave dhe vajzave” dhe që është në përputhje me përkufizimet në legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar. 1.1.2 Rekrutimi i personelit bëhet duke u bazuar në qasjen që ata/o kanë mbi të kuptuarit e këtyre koncepteve. 1.1.3 Mënyra e mbajtjes së të dhënave nga personeli (dosja personale e çdo përfutuesi/se, ditari personal për çdo rast të trajtuar, shënimet mbi udhëzimet e dhëna dhe terapinë që duhet të ndiqet, shënimet mbi ecurinë e rastit dhe përmirësimet e vërejtura etj.) për rastin, si dhe informacioni i dhënë për përdorueset/et e shërbimit, tregojnë se personeli e mban dhe promovon qasjen e duhur në këtë drejtim. 1.1.4 Nëse lind nevoja, personeli i Qendrës sfidon institucionet e tjera në mënyrë konstruktive, nëse ndeshet me mite apo besime të rreme rreth “dhunës seksuale”, “dhunës me bazë gjinore”, “dhunës në familje”, “dhunës ndaj grave”. 1.1.5 Përdoruesit/et e shërbimit janë të vetëdijshme se shërbimi i ofruar siguron këtë qasje.	- Dokumenti duhet të përgatitet mbi bazën e përkufizimeve në kuadrin ligjor ekzistues kombëtar e ndërkombëtar. - Duhet punuar vazhdimisht si me personelin ashtu dhe me përdoruesit/et e shërbimit të Qendrës që kjo qasje të gjejë reflektimin e duhur në praktikë.

Shërbimet që do të ofrohen në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale duhet të kenë qasje dhe disponueshmëri për të gjithë viktimat, pavarësisht gjinisë, moshës, racës, etnisë, besimit fetar apo orientimit seksual, si dhe për të gjithë familjarët e tyre që kanë pësuar dhunë apo janë në rrezik për jetën e tyre; duhet të ofrojnë informacionin e nevojshëm për përfituesit/et e shërbimit dhe duhet të jenë të përshtatshme për të gjithë/a përdoruesit/et e shërbimeve.

Të kuptuarit e situatës së sulmit seksual, shkaqeve dhe pasojave të saj tek individë të natyrave të ndryshme, si dhe të nevojës për shërbime për viktimat, përbën një parakusht të rëndësishëm për mirëfunksionimin e kësaj Qendre.

Qendra ofron shërbime përmes një ekipi multidisciplinar që përbëhet nga mjekë gjinekologë, mjekë ligjorë, psikiatër, pediatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës policie, infermiere.

Qendra ka një ekip të punësuar me kohë të plotë që përbëhet nga një punonjës social (koordinator/menaxher i qendrës) dhe 5 infermiere/ë.

Personeli i specializuar ka një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën dhe është në dispozicion *on call*. Ata paguhën me kontratë shërbimi për punën e bërë në kuadër të Qendrës.

Menaxheri/ja e qendrës është një punonjës/e sociale që luan rolin edhe të menaxherit të rastit.

Ajo bëhet pjesë e strukturës së Qendrës Spitalore Universitare dhe paguhet me kohë të plotë.

Personeli i Qendrës duhet të jetë i trajnuar të ofrojë kujdes shëndetësor të nivelit të parë për viktimat e dhunës seksuale. Ekspertiza në këtë fushë zhvillohet me trajnime të vazhdueshme, mbështetje profesionale dhe duke pasur burime të mjaftueshme. Të gjithë punonjësit e Qendrës (d.m.th. infermieret, mjekët, punonjësit socialë, profesionistët e shëndetit mendor), që janë në kontakt me viktimat e dhunës seksuale, marrin trajnime të përshtatshme; kjo vlen veçanërisht për infermieret dhe mjekët që kryejnë ekzaminime fizike të viktimave të dhunës seksuale dhe atyre që i ofrojnë shërbime fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara. Përveç trajnimit fillestar, punonjësve të shërbimit shëndetësor u jepet mundësia për të vazhduar marrjen e njohurive dhe shprehive të specializuara për punën me viktimat e dhunës seksuale.

Ekipi i angazhuar në Qendër, ndër të tjera, duhet të kenë përfunduar arsimin përkatës, të jenë të pajisur me aftësitë e duhura, të jenë të ndjeshëm/me ndaj këndvështrimit gjinor, të njohin dhe respektojnë standardet e funksionimit të Qendrës, standardet ndërkombëtare, legjislacionin civil, administrativ dhe penal në mbrojtje të viktimave të dhunës seksuale, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë aktet nënligjore.

Në shumë mjedise, gjinia e punonjësit të shërbimit mund të jetë një çështje kritike. Drejtuesit e institucioneve të kujdesit shëndetësor duhet të sigurojnë që infermieret ose mjekët femra të jenë në dispozicion sa më shumë të jetë e mundur. Nëse është e nevojshme, përpjekjet për të rekrutuar ekzaminuese femra duhet të jenë prioritet.

STANDARDI 2

Shërbimet e ofruara në Qendër duhet të plotësojnë nevojat individuale të përfitues/eve si viktimat/të mbijetuar/a e dhunës seksuale, duke respektuar sigurinë dhe dinjitetin njerëzor të tyre.

Rezultati i dëshiruar:

Shërbimet e ofruara sigurojnë që të gjitha ndërhyrjet t'i japin përparësi sigurisë dhe dinjitetit të përdorues/eve të shërbimit duke marrë në konsideratë nevojat komplekse të tyre si viktimat/të mbijetuar/a e dhunës seksuale.

STANDARDI 2.1

Ofruesi i shërbimit të Qendrës ofron një paketë të plotë dhe efektive shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfitues/eve, viktimat/të mbijetuara të dhunës seksuale.

STANDARDI 2.2

Ofruesi i shërbimit të Qendrës prioritarizon shëndetin dhe mirëqenien e përdorueses/it të shërbimit. Sigurimi i shërbimeve mjeko-ligjore dhe shërbimeve të tjera mbështetëse merr rëndësi dytësore krahasuar me sigurimin e shërbimeve të përgjithshme të kujdesit shëndetësor (d.m.th. trajtimi i plagëve, vlerësimi dhe menaxhimi i shtatzënisë, testet për HIV/AIDS dhe infeksioneve seksualisht të transmetueshme). Kryerja e një ekzaminimi mjeko-ligjor pa trajtuar nevojat parësore të kujdesit shëndetësor të përfitueses/it është neglizhencë. Shqetësimi për mirëqenien e

përfitueses/it të shërbimit vazhdon deri në sigurimin që viktimat/përfituesi/ja mund të ruajë dinjitetin e saj/tij pas një sulmi që do t'i bënte ata të ndiheshin të poshtëruar dhe të degraduar.

STANDARDI 2.3

Shërbimet mjekësore, mjeko-ligjore dhe psikosociale ofrohen në mënyrë të tillë që të minimizohet numri i ekzaminimeve fizike dhe intervistave që viktimat duhet t'ju nënshtrohen. Personeli merr të gjitha masat për të shmangur riviktimizimin e viktimës.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të Qendrës ka një dokument të shkruar me misionin dhe objektivat e shërbimit, të cilat duhet të jenë të shkruara me gjuhë të kuptueshme dhe të afishuara në një vend të dukshëm. - Shërbimet parësorë të ofruara në qendër, janë: - shërbim shëndetësor; - shërbim mjeko ligjor; - mbështetje psikosociale; - veshmbathje, ushqim; - referim; - Shërbime të tjera shtesë që mund të ofrohen, ndër të tjera, janë: - shërbime strehimi në qendra rezidenciale; - shërbime psikologjie afatgjata; - shërbime mjekësore; - shërbime juridike.	2.1.1 Dokumenti në formë shkresore; 2.1.2 Dokumenti i afishuar; 2.1.3 Kontrata për personelin e punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme; 2.1.4 Kontrata për shërbimet në dosjen e përfitueses/it; 2.1.5 Deklarata e dakordësisë së përfitueses/it e firmosur brenda 24 orëve. 2.1.6 Formularët e pranimi, raportet e psikologes/punonjës sociale, vlerësimet e mjekut specialist dhe të mjekut ligjor, shërbimet e tjera ku referohet përfituesja/i, deklarata e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale etj., të plotësuara dhe vendosura në dosjet e përfitueses/it.	- Përfituesja/i bëhet pjesë e vlerësimit të nevojave dhe planit të ndihmës. - Përfituesja/i njihet me procedurat, rregullat, të drejtat dhe detyrimet ndaj Qendrës dhe personelit.
- Shërbimi i ofruar reflekton qartë parimet e sigurisë dhe dinjitetit. - Shërbimi i ofruar duhet të bazohet në një plan sigurie për çdo përfitues/e.	2.2.1 Ofruesi i shërbimit të Qendrës siguron që shërbimet e domosdoshme për trajtimin e dhunës seksuale ofrohen në një vend të sigurt, i vendos përfitueset/it në qendër të shërbimit; ofron shërbime në përputhje me nevojat e përfitueses/it; dhe respekton të drejtën e tyre për t'i pyetur nëse duan që shërbimi t'u ofrohet nga personel grua. 2.2.2 Procedurat për sigurinë dhe dinjitetin njerëzor, të shkruara dhe të afishuara për përdoruesit/et e shërbimit. 2.2.3 Personeli është në gjendje të përshkruajë nevojën se përse shërbimi i ofruar duhet të jetë i ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor.	- Personeli i Qendrës duhet të kujdeset dhe marrë masat e nevojshme që çdo përfitues/e të kuptojë të drejtat dhe detyrimet e tij/saj, si dhe parimet mbi të cilat mbështetet shërbimi i Qendrës. - Nëse përfituesi/ja e shërbimit të Qendrës kërcënohet ose vihet në rrezik për jetën gjatë kohës së qëndrimit në qendrën e menaxhimit të krizës, ai/ajo njofton menjëherë stafin e qendrës për vlerësimin e rrezikut dhe përditësimin e planit të sigurisë.

Për ofrimin e shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës seksuale duhen siguruar mjedise fizike që karakterizohet nga një sërë tiparesh kyç, domethënë, ato janë të arritshme/të aksesueshme, të sigurta, të pastra dhe private.

Për sa i përket akomodimit, mjedisi i vënë në dispozicion të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, do të ketë: një holl pritës për familjarë dhe shoqërues të viktimave, 2 dhoma hospitalizimi (me qasje në tualet), një dhomë ekzaminimi e pajisur me 2 shtretër profesionalë, një dhomë infermieri; një dhomë për psikologun, avokatin ose persona të tjerë që do të realizojnë intervista, këshillim etj.; një ambient magazinë ku do të vendosen kitet dhe veshjet e nevojshme.

Nëse objekti siguron shërbime për fëmijët, mjedisi fizik duhet të jetë i përshtatshëm për fëmijët dhe duhet të ketë pajisje të posaçme për intervistimin e fëmijës (p.sh. dhoma me xham ose kamera regjistruese). Nëse objekti ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara, patjetër që duhet të jetë i pajisur me pajisje që bëjnë të mundur aksesimin e tij nga kjo kategori.

Koha e ekzaminimit fizik diktohet kryesisht nga ajo që është më e mira për viktimën (sidomos kur kërkohet ndërhyrje për plagët), por për një sërë arsyesh, ekzaminimi fizik është më mirë të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur, pas paraqitjes së viktimës.

Shërbime të tjera të emergjencës si ekzaminime mjeko-ligjore për mbledhjen e provave, marrja e dëshmisë, fillimi i procedurave të drejtësisë penale, mbështetja psikologjike për përballimin e krizës, janë disa shërbime të tjera që ofrohen sipas një radhe të përcaktuara në Procedurat Standarde të Veprimit.

Duhet të theksojmë se në shumë raste viktimat paraqiten për trajtim pas një kohë të konsiderueshme të dhunës seksuale.

Punonjësit e ekipit multidisciplinar, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, duhet të jenë objektiv dhe sa më të çliruar nga çdo paragjykim apo anshmëri. Është e mundur që të ofrohet një shërbim objektiv pa sakrifikuar ndjeshmërinë ose dhembshurinë. Nevoja për paanshmërinë është veçanërisht e rëndësishme kur merret dëshmia.

Kujdesi ndaj viktimës duhet të jetë etik, me dhembshuri, objektiv dhe mbi të gjitha, duke pasur në qendër viktimën/të mbijetuarën/in.

Mbrojta, siguria dhe privatësia janë, gjithashtu, aspekte të rëndësishme të shërbimit.

Ekipi multidisciplinar i Qendrës që ofron shërbime për viktimat e dhunës seksuale bashkëpunon ngushtë me institucionet e zbatimit të ligjit, shërbimet sociale, qendrat e trajtimit afatgjatë të rasteve të përdhunimit, organizatat joqeveritare (OJQ) dhe agjencitë tjera që të mund të sigurohet jo vetëm përmbushja e të gjitha nevojave komplekse të viktimave, por dhe ofrimi i shërbimeve në vazhdimësi. Një rrjet ndërlidhës formal apo joformal që përfshin të gjithë përfaqësuesit e grupeve të tilla luan një rol të rëndësishëm edhe në mbikëqyrjen e ofrimit të shërbimeve, zhvillimin e trajnimeve të mundshme ndërlidhëse dhe identifikimin e problemeve në ofrimin e përgjithshëm të shërbimeve.

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (MKR) i menaxhuar nga njësitë e qeverisjes vendore është organizmi më efikas që mund t'i përgjigjet nevojave afatgjate të viktimave.

Bashkëpunimi i Qendrës me MKR-në është domosdoshmëri.

Rritja e ndërgjegjësimi për të tjera shërbime dhe ofrues shërbimesh në vendin tonë, ofron një sërë avantazhesh dhe përfitimesh si për specialistin/profesionistin ashtu edhe për viktimën/të mbijetuarin/en.

Marrja e njohurive për shërbime të tjera ndihmon në të kuptuarit më të mirë të roleve të tjera në këtë fushë. Takime të rregullta apo me raste me përfaqësues që ofrojnë shërbime të tjera, mund të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit. Në fund të fundit, qëllimi i këtij shërbimi është përmirësimi i shëndetit, mirëqenies dhe sigurisë të viktimave dhe komunitetit më të gjerë.

Mekanizmi i Koordinuar i Reagimit ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në këtë aspekt.

Shërbimi shëndetësor

Në Qendrën e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale prevalon kujdesi shëndetësor ndaj viktimës. Kjo do të thotë që shëndeti dhe mirëqenia e viktimës është shumë e rëndësishme. Është kjo arsyeja që këto qendra kërkohen të ngrihen pranë institucioneve shëndetësore ku ka qasje të menjëhershme të ekspertizës mjekësore. Për shembull, viktimat mund të paraqitet me probleme shëndetësore akute si plagosje, goditje në kokë, që kërkojnë ndërhyrje dhe trajtim mjekësor urgjent.

Shërbimi mjeko-ligjor

Në kushtet e një sulmi/dhune seksuale/ përdhunimi shërbimet për ekzaminimin mjeko-ligjore, si: mbledhja e provave, marrja e dëshmisë, fillimi i procedurave të drejtësisë penale janë vendimtare për të gjithë procesin e mbështetjes së viktimës dhe penalizimin e dhunuesit.

Vonesa në qasjen në këtë shërbim mund të rezultojë në:

- ndryshime në provat fizike (p.sh. shërimi i plagëve);
- humbja e materialit mjeko-ligjor (p.sh. dëshmi e kontaktit me sulmuesin përfshirë gjakun dhe spermën).

Shërbimet këshilluese, psikologjike dhe mbështetëse:

Qendra ofron këshillim psikologjik dhe mbështetje psikoemocionale për të gjitha viktimat e dhunës seksuale që paraqiten në qendër për ndihmë.

Ofrimi i këtij shërbimi bëhet me pëlqimin e viktimës/të mbijetuarit/res së dhunës seksuale.

Shërbimi psikologjik synon të rikthejë sigurinë, besimin, të kapërcejë traumën dhe efektet e sulmit seksual, të vendosë ekuilibrin emocional dhe funksional të individit.

Ky shërbim ofrohet nga psikologu klinik që ka marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën. Ai/ajo mund të jenë pjesë e stafit të Qendrës apo e ndonjë institucioni tjetër dhe ka pranuar të punojë për qendrën *on call*. Psikologu/ja klinik ka njohuri të punës me viktimat e dhunës seksuale, fëmijë, gra apo burra dhe njihet e respekton kodin e etik të fushës.

Shërbime ligjore

Viktimës/të mbijetuarës/it të dhunës seksuale, gjatë qëndrimit në Qendër i ofrohet ndihmë ligjore nga personeli i kontraktuar nga qendra ose nga ndonjë institucion tjetër që ofron ndihmë juridike si OJQ-të e specializuara në këtë fushë, klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë, avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë etj.

Shërbimi ligjor duhet të ofrohet në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive. Ndihma juridike ofrohet, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së viktimave/të mbijetuarve për shkak se përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike¹⁵. Të mbijetuarit/at e dhunës seksuale informohen si në lidhje me të drejtat ligjore bazuar në legjislacionin administrativo civil kundër të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore ashtu edhe në legjislacionin procedural penal¹⁶.

Është detyra e menaxherit/es së Qendrës të vendosë kontakte midis viktimës/të mbijetuarit/es dhe avokates/tit.

Mbështetja me veshje, ushqime etj.

Sipas rastit, viktimat/të mbijetuarit/arat e dhunës seksuale mbështeten me ushqim, veshmbathje dhe medikamente. Kjo bëhet e mundur përmes shërbimit të Qendrës si pjesë e institucionit të shërbimit shëndetësor ose të paketës së shërbimit që ofron qendra.

Nevojat e viktimave për ushqime dhe veshmbathje mund të plotësohen edhe nga fondi i qeverisë vendore ose përmes donacioneve.

Shërbime të tjera:

Shërbimet e mësipërme janë të gjitha në kushte të emergjencës dhe ofrohen për periudhë afatshkurtër nga 24 orë deri në 72 orë. Në rastin kur viktimat/ e/i/ mbijetuarit/ra e dhunës seksuale ka nevojë për trajtime afatgjata, atëherë Qendra bashkëpunon me Mekanizmin e Reagimit të Koordinuar në nivel vendor për të siguruar mbështetjen afatgjatë përmes bashkëpunimit me institucionet e specializuara publike dhe jopublike.

Në çdo rast, duhet mbajtur parasysh se ndihma, mbështetja që i ofrohet viktimës/të mbijetuarit/es nuk varet nga disponibiliteti i tij/saj për të denoncuar dhunuesin dhe as nga fakti që viktimat ka kërkuar apo jo UM apo UMM.

Është detyrë themelore e ekipit multidisiplinar që në procesin e ndihmës dhe mbështetjes së viktimës ata të përdorin aftësitë profesionale në mënyrë etike dhe të respektojnë ligjshmërinë.

STANDARDI 3

Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes/ ndihmës për përfituesin/in.

Rezultati i dëshiruar:

Nevojat e përfitueses/it, viktimë/e mbijetuar e sulmit seksual, të vlerësuara plotësisht dhe në

¹⁵ Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 11, “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”.

¹⁶ Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

mënyrë të efektshme, sipas moshës, gjinisë dhe specifikimeve të tjera, si dhe plani individual i përkujdesjes/ndihmës i hartuar në bazë të tyre.

STANDARDI 3.1

Koordinatori/ja e Qendrës vlerëson në mënyrë të menjëhershme dhe me efektivitet nevojat e përfitueses/it të shërbimit, duke marrë në konsideratë tërësinë e karakteristikave personale (seksi, moshë, etnia, raca, besimi fetar, sjellja seksuale, aftësia e kufizuar etj.).

STANDARDI 3.2

Koordinatori/ja e Qendrës harton në bashkëpunim me përfituesen/in e shërbimit planin individual të përkujdesjes/ndihmës për të, bazuar mbi nevojat individuale të vlerësuara.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Menjëherë pas pranimit të përfitueses/it në Qendër, duhet bërë me të vlerësimi i nevojave dhe orientimi. - Vlerësimi i nevojave të përfitueses/it duhet të bëhet brenda kohës më të shkurtër të mundshme (për nevojat emergjente), si dhe duhet të plotësohet më pas nga vlerësimi i nevojave afatgjata. Ky vlerësim bëhet në bashkëpunim me përfituesen/in dhe me mbështetjen / ndihmën e ekipit multidisiplinar të qendrës.	3.1.1 Formulari i pranimit së bashku me informacionin orientues të nënshkruara nga përfituesi/ja dhe të futura në dosjen e tij/saj. 3.1.2 Formulari i vlerësimit të nevojave (emergjente dhe afatgjata), i plotësuar dhe futur në dosjen e përfituesit/es.	- Duke qenë se flitet për shërbim dhe rast emergjent, duhet të merret në konsideratë fakti që përfituesi/ja mund të paraqitet në Qendër pa dokumente identifikimi. Pavarësisht kësaj, koordinatori/ja e Qendrës ka një formular regjistrimi /pranimi, i cili shoqërohet edhe me një informacion orientues, që duhet t'i vihen në dispozicion përfituesit/es dhe duhet të nënshkruhen edhe prej tij/saj.
- Ekipi multidisiplinar duhet të identifikojë nevojat e përfituesit/es dhe mbi këtë bazë koordinatori/ja që është edhe menaxheri/ja e rasteve harton planin e përkujdesjes/ndihmës individual të përfituesit/es, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e atij/asaj vet.	3.2.1. Plan individual i përkujdesjes, i hartuar dhe miratuar edhe nga vetë përfituesi/ja, bazuar në nevojat e saj/tij dhe i futur në dosjen e saj/tij personale.	- Ndërthurja e nevojave afatshkurtra dhe afatgjata në planin e përkujdesjes është domos-doshmëri.

Qendra ofron shërbime të specializuara, emergjente, afatshkurtra gjatë 24 orëve në të 7-të ditët e javës. Po kështu, Qendra ka infrastrukturë të përshtatur, si dhe personel të specializuar për të pranuar dhe trajtuar të mbijetuarat/it me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor, të moshave të vogla apo të varura nga substancat. Këshillohet që në ekipin e ndihmës të angazhohen sa më shumë gra dhe vajza specialiste. Kjo e lehtëson komunikimin me viktimat. Qendra duhet të ketë gjithnjë të gatshëm një plan për menaxhimin kufizimeve në shtretër. Pavarësisht këtyre kufizimeve, në asnjë rast një viktimë e dhunës seksuale, nuk mund të largohet pa marrë shërbimin e kërkuar. Në këtë rast, mund të bashkëpunohet me institucione të tjera të specializuara për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale në qark apo në nivel kombëtar.

Koordinatori/ja e Qendrës bashkëpunon me MKR-në në nivel vendor për të pasur më shumë informacion lidhur me mundësitë e ndihmës dhe të trajtimit të rastit nga ndonjë institucion tjetër.

Vendimmarrje nuk është personale. Koordinatorin/ja e Qendrës konsultohet me të paktën një prej specialistëve të qendrës (mjek, infermier, psikolog apo punonjës policie) përpara se të bëjë vendimin e referimit diku tjetër. Kur është e mundur, vendimi mund të merret me një konsultim më të gjerë të përfaqësuesve të MKR-së.

Menaxheri/ja e rastit (punonjës social) dëgjon me kujdes dhe pa paragjykim të mbijetuarin/en e dhunës seksuale. Që në fillim të bisedës punonjësi/ja e Qendrës e siguron përfituesin/en që i gjithë informacioni do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe do të mbetet anonim, me përjashtim të rasteve specifike kur ky konfidencialitet duhet të thyhet për arsye të sigurisë së përfituesit/es (rastet e thyerjes së konfidencialitetit duhet të jenë pjesë e manualit të politikave dhe procedurave të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale. Një plan sigurie i veçantë (i përkujdesjes individuale) bazuar në historinë e dhunës së pësuar, incidenteve, formave të dhunës etj., hartohet në bashkëpunim me aktorët e tjerë.

Përfituesi/ja e shërbimit do të informohet në një formë të shkruar mbi të drejtat dhe detyrimet e saj/tij gjatë kohës së qëndrimit në Qendër, si edhe pas largimit nga Qendra. Kjo formë do të firmoset nga përfituesi/ja nëse bie dakord me rregullat e parashikuara. Në rastet kur ndaj dhunuesit/es ka filluar procedimi penal, organi i prokurorisë informon viktimën/të mbijetuarin /ën e dhunës në lidhje me të drejtat bazuar në nenin 58, të Kodit të Procedurës Penale, “Të drejtat e viktimës së veprës penale” dhe nenit 58/1, “Të drejtat e viktimës së mitur”.

E/i mbijetuara/i e dhunës seksuale këshillohet nga stafi i Qendrës të mos ndajë informacionin me dhunuesin/en e saj/tij gjatë kohës së qëndrimit në qendër, sepse kjo mund të vërë atë dhe pjesëtarët e tjerë të familjes së saj/tij në rrezik. Viktima në qendër informohet në lidhje me fazat e procedimit penal, në rast se dhunuesi lihet i lirë etj. dhe ky informacion e ndihmon për një plan sigurie më efektiv dhe për përditësimin e vazhdueshëm të këtij plani.

Pjesë e planit individual të ndihmës do të jenë edhe identifikimi i shërbimeve të tjera të mundshme në komunitet, miqtë, anëtarët e familjes etj., të cilat/ët mund të shërbejnë për zbatimin e planit të përkujdesjes individual apo për trajtimin afatgjatë të viktimës/së mbijetuarës, edhe pas daljes nga Qendra.

STANDARDI 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesit/es

Rezultati i dëshiruar: Përfituesi/ja e shërbimit të Qendrës gëzon të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, trajtohet me dinjitet e respekt, si dhe mbrohet nga të gjitha format e abuzimit dhe diskriminimit gjatë kohës së qëndrimit në qendër.

STANDARDI 4.1

“Qendra e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale” ofron shërbimet për përfituesit/et me tolerancë dhe mirëkuptim, respekt, pa diskriminim për shkak të: racës, ngjyrës, kombësisë, gjuhës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzënisë, të qenit prind, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispo-zitave gjenetike, aftësive të kufizuara, përkatësisë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyesh të tjera.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Informimi i përfituesit/es me të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë kohës së qëndrimit në Qendër. - Duhet të ketë një mekanizëm ankimi për përfituesit/et dhe stafin, në rast të shkeljes së të drejtave të tyre. - Përfituesi/ja të trajtohet si pjesëmarrës/e në program.	4.1.1 Broshurë/fletëpalosje/dokument i afishuar që përfshin të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në Qendër, përfshirë të drejtën e përfitimit të shërbimeve pa diskriminim. 4.1.2 Procedurë ankimi me shkrim, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm nëse ankesën nuk e zgjidh Qendra, e shpallur dhe e njohur nga të gjithë/a përfituesit/et dhe stafi. 4.1.3 Procedura të qarta ankimimi në rast abuzimi nga stafi, kundrejt përfituesve të shërbimit në Qendër, apo në rast abuzimi ndaj fëmijëve të cilët janë të pashoqëruar nga prindërit/kujdestari ligjor.	- Është mirë të mbahet një bazë të dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për zgjidhjen që u është dhënë. - Pjesëmarrja e përfituesve/eve është thelbësore për të shkruar drejt vetë-mjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

Koha e qëndrimit në Qendër është e kufizuar. Ajo është nga 24 orë deri në 72 orë. Largimi i përfituesit/es nga qendra iu bëhet e ditur anëtarëve të MKR-së në nivel vendor, me qëllim që rasti të monitorohet.

Përfituesi/ja e shërbimit të Qendrës mund të zgjedhë të kthehet në familje (p.sh. kur është i mitur, apo kur dhuna seksuale ka ndodhur në mjedisë jashtë shtëpisë nga një i panjohur apo person jofamiljar). Në këtë rast i/e mbijetuari/a e dhunës seksuale ka familjen dhe të afërmit që mbështesin procesin e rikuperimit dhe shërimit nga abuzimi. Natyrisht, mbetet nevoja për shërbime të tjera afatgjata që ofrohen nga MKR-ja dhe aktorë të tjerë të specializuar në këtë fushë. Nevoja për t’ju rikthyer jetës mund të ketë të bëjë me nevojën për punësim, trajnim profesional, edukim, argëtim, mbështetje emocionale, psikologjike etj.

Bashkëpunimi i Qendrës me MKR-në e bën të mundshme plotësimin e nevojave dhe trajtimin e rastit të mësipërm.

Mund të ndodhë që përfituesi/ja e shërbimit të Qendrës ta ketë të pamundur kthimin në mjedisin familjar. Dhunuesi mund të ketë qenë në familje. Familja mund të mbajë qëndrime ekstreme dhe të papajtueshme ndaj viktimës. Në këtë rast, përfituesi/ja e shërbimit të Qendrës ka nevojë për strehim të përkohshëm apo të përhershëm, mbrojtje dhe siguri, nevojë për ushqim e mbështetje afatgjatë për t'iu rikthyer normalitetit. Referimi për strehim në strehëzat e të mbijetuarave të dhunës, mbështetja psikosociale, trajnimi profesional, punësimi, kujdesi për fëmijët, kthimi i fëmijëve në shkollë etj., janë shërbime afatgjata që mund të realizohen vetëm nëpërmjet bashkëpunimit të Qendrës me MKR-në.

Shërbimet për të mbijetuarat/it e dhunës seksuale sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër. Është e nevojshme që stafi që punon me këtë kategori sociale të ketë njohuri të mjaftueshme të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përfituesit/et të marrin njohuri mbi të drejtat që u burojnë nga legjislacioni kundër diskriminimit.

Shërbimet në Qendër ofrohen falas. Qendra duhet të jetë e aksesueshme nga viktimat e dhunës seksuale që iu përkasin grupeve të ndryshme të marginalizuara si përfaqësues nga komuniteti rom, egjiptian, personave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, persona nga zonat rurale, emigrante, azil kërkues, persona të komunitetit LGBT etj.

Në të gjitha rastet, duhet të merret në konsideratë edhe fakti që viktimat, në varësi të situatës, mund të mos ketë me vete mjet identifikimi.

Bashkëpunimi i Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale me MKR-në në bashkinë përkatëse bën të mundur plotësimin e dokumentacionit përkatës.

Qendra duhet të mbajë parasysh se në situata të veçanta mund t'i nevojitet edhe një përkthyes, kur viktima është një person me nënshtetësi të huaj dhe ndodhet në Shqipëri si vizitor, azil kërkues apo për çdo arsye tjetër.

Lista e personave *on call* duhet të ketë edhe disa përkthyes profesionistë.

Me qëllim aksesin e viktimave me aftësi të kufizuara, Qendra duhet të ketë në listën e saj të profesionistëve edhe specialistë të gjuhës së shenjave për personat që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi.

Në rastin e viktimave që ndodhen në zona të thella, në distancë nga Qendra, këshillohet bashkëpunimi me MKR-në në atë zonë për të mundësuar transportin e viktimës drejt qendrës më të afërt.

Kur provohet se viktima e dhunës seksuale ka probleme të rënda të shëndetit mendor, është në varësi të alkoolit apo substancave të tjera, bashkëpunohet me shërbimet e specializuara në nivel vendor apo kombëtar.

STANDARDI 5

Të dhënat personale të përfitueses/it dhe administrimi i tyre.

Rezultati i dëshiruar:

Të drejtat e përfitueses/it të shërbimit mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre, si dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e ofruesit të shërbimit të Qendrës, për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.

STANDARDI 5.1

Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale të përfitueseve/ve të shërbimit të Qendrës kryhet duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale. Ofruesi i shërbimit të Qendrës krijon kushtet në mënyrë që administrimi i të dhënave të bëhet në përputhje me kuadrin ligjor dhe të mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Dosja të jetë konfidenciale dhe të mund të shihet vetëm nga përfituesi/ja dhe punonjës/ja sociale ose administrator/ja e Qendrës. - Për identifikimin e përfitueses/it në dosje të përdoren vetëm numra të zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Për fëmijët, të mos përdoren inicialet, por fëmija 1, 2 etj. i prindit. - Në dosjen e përfitueses/it të përfshihen të gjitha dokumentet e mundshme që të përdoren në momentin e duhur në procesin gjyqësor. - Ofruesi i shërbimit të Qendrës ka një rregullore të qartë ku përkrahën saktësisht e me gjuhë të kuptueshme të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfitueses/it dhe detyrimi i stafit për të informuar përfitueset në lidhje me këto të drejta.	5.1.1 Të dhënat personale mbahen në dosje të mbyllura ose, nëse ruhen në kompjuter, mund të hapen vetëm me fjalëkalim nga personi përgjegjës. 5.1.2 Dokumentacioni mbështetës (prova, vizitë nga mjeku etj.) i përfshirë në dosjen e përfitueses/it dhe i gatshëm për t'u përdorur në procesin gjyqësor 5.1.3 Rregullorja me të drejtat dhe përgjegjësitë e përfitueses/it, e afishuar dhe e përgatitur me një gjuhë të qartë e të kuptueshme.	- Meqenëse këto janë raste emergjente, çdo provë e mbledhur ka rëndësi të veçantë dhe duhet të ruhet në mënyrë të duhur. - Ofruesi i shërbimit të Qendrës duhet të jetë në gjendje të vlerësojë se deri në cilën masë respektohet konfidencialiteti i të dhënave dhe duhet të njoftojë edhe përfituesen/in kur ky konfidencialitet duhet të thyhet. - Përfitueset/it informohen në lidhje me të drejtën e tyre për ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur cenohet konfidencialiteti i të dhënave.

Të dhënat e të mbijetuarave/ve të dhunës seksuale që do të përfitojnë nga shërbimet në Qendër do të ruhen në mënyrë konfidenciale dhe përfitueset/it e shërbimeve do të informohen nga stafi në lidhje me situatat në të cilat konfidencialiteti mund të kufizohet. Stafi i punësuar apo kontraktuar me kohë të pjesshme (ose *on-call*) në Qendër nënshkruan një deklaratë mbi respektimin e konfidencialitetit të të dhënave të viktimave/të mbijetuara/ve të dhunës, si dhe detyrime që lidhen me përpunimin e të dhënave dhe detyrime të tjera, të cilat burojnë nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

STANDARDI 6

Administrimi i brendshëm i Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale.

Rezultati i dëshiruar:

Përmes administrimit të brendshëm, ofruesi i shërbimit të Qendrës siguron shërbim dhe funksionim eficient për të arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e praktikës më të mirë në terren.

STANDARDI 6.1

Ofruesi i shërbimit të Qendrës ndërton mekanizmat e duhura formale të administrimit të brendshëm për funksionimin e Qendrës dhe sigurimin e cilësisë së shërbimeve që ofron.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Qendra e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale ka strukturën e nevojshme dhe stafin e kualifikuar/me përvojë për të realizuar shërbimet. - Stafi i punësuar të jetë i përshtatshëm për nevojat e përfitueseve/sve dhe të rekrutohet me procedurë të hapur e sipas legjislacionit në fuqi. - Ofrimi i trajnimeve për fuqizimin e kapacitetit të stafit, si dhe kryerja e vlerësimit të performancës së punës,	6.1.1 Organigrama e ofruesit të shërbimit të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale dhe lista e stafit (<i>on call</i>). 6.1.2 Procedura e rekrutimit të stafit e dokumentuar sipas të gjitha hapave të ndjekura. 6.1.3 Lista e trajnimeve të kryera, si dhe materialet përkatëse të ruajtura 6.1.4 Data bazë e stafit e plotësuar me trajnimet dhe kualifikimet e marra 6.1.5. Proces i vlerësimit me shkrim i dokumentuar dhe i kryer sipas	- Përzgjedhja e stafit të bëhet në përputhje me natyrën e shërbimit dhe parimet kryesore të ofrimit të tij. Për sa i takon numrit të anëtarëve të stafit që duhet të ketë një qendër e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, në varësi të institucionit ku ajo ndërtohet, kërkohet të ketë së paku 1 punonjës social si koordinator/ menaxher i qendrës, 5 infermierë që mbulojnë shërbimin 24/7 dhe një listë me specialistë të kualifikuar që punojnë <i>on call</i>.

ndihmojnë në përmirësimin e eficiencës dhe efektivitetit të ofruesit të shërbimit të Qendrës së shërbimeve të integruara për viktimat e sulmit seksual.	parimeve të vlerësimit të performancës në punë.	- Gjatë përzgjedhjes të mbahet në konsideratë edhe e drejta e përfitueses/it për të kërkuar ofrim të shërbimit nga staf i të njëjtës gjini. - Vlerësimi i nevojave të stafit për kualifikim dhe ofrimi i kualifikimit të munguar duhet të bëhen përpara procedurës së vlerësimit të performancës në punë.
---	---	--

“Qendra e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale” është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ajo ndërtohet pranë Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza. Ajo financohet me fonde publike, brenda buxhetit të QSUT-së.

Të tjera qendra të kësaj natyre mund të ngrihen edhe në qytete të tjera. Ato vendosen pranë qendrave spitalore ose sa më pranë tyre me qëllim që të kenë qasje sa më të shpejtë ndaj shërbimit të specializuar shëndetësor.

Qendrat e tjera mund të ngrihen me financime të njëjësive të qeverisjes vendore ose të OJF-ve që marrin përsipër të kontribuojnë në këtë shërbim.

Qendra merr përsipër të ofrojë shërbim shëndetësor, mjeko-ligjor, shërbim psikologjik, ligjor, ushqim, veshje etj.

Fondet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi social, mbështetja nga donatorë të ndryshëm, OJF-të, biznese lokale etj. janë disa nga burimet e financimit të këtij shërbimi.

Ndërkohë që anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit janë, gjithashtu, përgjegjës për sigurimin e shërbimeve afatmesme dhe afatgjata, si: shërbimi i strehimit, shërbimi psikologjik, mjekësor, ligjor, i punësimit, trajnimit etj., dhe këto përgjegjësi saktësohen në një marrëveshje specifike të nënshkruar midis anëtarëve të ndryshëm të MKR-së.

Për mirëfunksionimin e Qendrës kërkohet edhe angazhimi i një stafi të përherëshëm.

Qendra menaxhohet/koordinohet nga një punonjës social. Ai/ajo është edhe menaxher i rasteve. Merret me vlerësimin e menjëhershëm të nevojave dhe organizon personelin bazuar në këto nevoja.

Menaxheri/koordinatori i Qendrës mbështet-tet nga një ekip prej 5 infermierësh me kohë të plotë që mbulojnë shërbimin 24 orë në 7 ditët e javës.

Detyra e tyre është pritja dhe akomodimi i viktimës sipas rregullave të Qendrës.

Ekipi multidisiplinar i përbërë nga mjekë gjinekologë, ligjorë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, specialistë të ligjit, infermierë është i kontraktuar sipas nevojave. Ata janë specialistë *on call*. Paraqitja e tyre bëhet sipas një grafiku që hartohet nga menaxheri/ja.

Ata kanë marrëveshje bashkëpunimi dhe paguhen mbi bazë të një kontrate shërbimi.

Punësimi i tyre bëhet mbi bazë të një përzgjedhjeje paraprake duke vlerësuar jo vetëm aftësitë profesionale, por edhe qëndrimin për çështje të ndjeshme si ajo e dhunës me bazë gjinore, dhunës seksuale etj.

Personeli i nënshtrohet një trajnimit paraprak për t’u njohur me specifikat e dhunës seksuale, aftësitë e nevojshme, si dhe parimet e etikës, legjislacioni bazë, njohuritë për mirëfunksionimin e Qendrës dhe detyrimet që ata kanë ndaj institucionit, përfituesit dhe të tretëve.

Mjediset e Qendrës duhet të jenë të aksesueshme, të sigurta dhe të pastra.

Ato duhet të kenë mjedise të mjaftueshme për pritjen dhe trajtimin e viktimës, si dhe të familjarëve dhe specialistëve të tjerë.

Në rastin konkret parashikohet që mjedisi i vënë në dispozicion të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale, do të ketë: një holl pritës për familjarë dhe shoqëruar të viktimave, 2 dhoma hospitalizimi (me qasje në tualet), një dhomë ekzaminimi e pajisur me 2 shtretër profesionalë, një dhomë infermieri; një dhomë për psikologun, avokatin ose persona të tjerë që do të realizojnë intervista, këshillim etj.; një ambient magazinë ku do të vendosen kitet dhe veshjet e nevojshme.

Nëse Qendra siguron shërbime për fëmijët, mjedisi fizik duhet të jetë i përshtatshëm për fëmijët dhe duhet të ketë pajisje të posaçme për intervistimin e fëmijës (p.sh. dhoma me xham ose kamera regjistruese). Nëse objekti ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara, patjetër që duhet të jetë i pajisur me pajisje që bëjnë të mundur aksesimin e tij nga kjo kategori.

Nëse Qendra ka kufizime në shtretër, duhet të ketë gjithnjë një plan bashkëpunimi për të mundësuar vendosjen e viktimave në momentin e paraqitjes.

Në asnjë rast nuk mund të lejohet largimi i viktimave pa marrë shërbimin e nevojshëm.

Qendra duhet të jetë e pajisur me një sërë pajisjesh të cilat mundësojnë shërbimin e specializuar mjekësor dhe mjeko-ligjor, por edhe akomodimin e viktimave për një kohë të shkurtër (24–72 orë).

STANDARDI 7

Monitorimi dhe vlerësimi

Rezultati i dëshiruar:

Të garantohen shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.

STANDARDI 7.1

Ofruesi i shërbimit të Qendrës ofron shërbime cilësore për viktimat/të mbijetuar/at e sulmit seksual, edhe përmes procesit të monitorimit, vlerësimit dhe mësimit.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të Qendrës e vet së cilës i është ngarkuar detyra e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve që duhen përmbushur.	7.1.1 Personat përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin janë të identifikuar në organigramë dhe përshkrimet e punës. 7.1.2 Procedura e monitorimit dhe vlerësimit të kryer, e dokumentuar hap pas hapi.	- Është mirë të tregohet gjithmonë kujdes për zhvillimet në fushën e udhëzimeve për praktikatat më të mira dhe synimet e sigurisë, vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

Vlerësimi dhe monitorimi janë aspekte të rëndësishme të të gjitha formave të sigurimit të kujdesit për viktimat e dhunës seksuale dhe janë çelësi për ruajtjen e shërbimeve me cilësi të lartë dhe të një niveli të kënaqshëm kujdesi. Qëllimi i vlerësimit dhe monitorimit është vlerësimi i pikave të forta dhe atyre të dobëta të një objekti apo shërbimi. Rezultatet e të këtij procesi mund të përdoren për të modifikuar dhe përmirësuar shërbimet sipas nevojës. Ky lloj informacioni, gjithashtu, mund të jetë i dobishëm për administratorët dhe menaxherët e burimeve gjatë procesit të vendosjes se si duhen ndarë burimet e pakta.

Vlerësimi dhe monitorimi i shërbimit të Qendrës mund të jetë detyrim i SHSS/MKR/ Shërbimit Mjekësor etj.

Në çdo rast, vlerësimi dhe monitorimi mund të përdoren për të përcaktuar:

- Sa mirë po ofrohen shërbimet, duke anketuar ata që përdorin Qendrën (p.sh., duke përdorur anketat për kënaqësinë e përfituesve).

- Rezultatin, performancën dhe llojin e shërbimeve të ofruara (p.sh. numri i përfituesve në një muaj, numri i programeve të edukimit që ofrohen për komunitetin ose për profesionistët e shërbimit në Qendër).

- Rezultatet e përfituesve (p.sh. numri i përfituesve që kanë marrë SST si rezultat i dhunës seksuale, numri i shtatzënive që rezultojnë nga dhuna seksuale).

Planifikimi i një sistemi vlerësimi dhe monitorimi në përgjithësi përfshin këto hapa:

- Renditja e qëllimeve të institucionit të kujdesit për viktimat e dhunës seksuale;
- Identifikimi i pyetjeve, problemeve ose fushave të shqetësimit;
- Identifikimi i rezultateve të përfituesve që përdorin objektin/institucionin;
- Zhvillimi i pyetjeve për vlerësimin ose përdorimin e mjeteve ekzistuese të vlerësimit;
- Vendosja se çfarë lloj informacioni nevojitet për t'iu përgjigjur pyetjeve të vlerësimit;
- Përcaktimin e mënyrës së marrjes së informacionit;
- Përcaktimin se kush do të kryejë vlerësimin dhe analizimin e të dhënave;

- Përcaktimin e afatit kohor për mbledhjen e informacionit;
- Përcaktimin se si duhet të përdoret informacioni i mbledhur.

STANDARDI 8

Qasja e koordinuar shumësektoriale dhe bashkëpunimi midis aktorëve në nivel vendor.

Rezultati i dëshiruar:

Të garantohet ofrimi i shërbimeve dhe trajtimi i rasteve në mënyrë të koordinuar dhe përmes aplikimit të qasjes shumë sektoriale dhe bashkëpunimit të aktorëve në nivel vendor.

STANDARDI 8.1

Shërbimet që ofrohen në Qendër marrin në konsideratë dhe aplikojnë qasjen e koordinuar shumë sektoriale dhe parimin e bashkëpunimit, duke ndjekur modelin e Mekanizmit të Referimit të Koordinuar dhe trajtimit të rasteve të ngritur në nivel vendor.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të Qendrës të aplikojë tërësinë e shërbimeve të parashikuara, bazuar në qasjen shumë sektoriale të koordinuar (në përputhje me filozofinë e Mekanizmit të Referimit të Koordinuar, të ngritur në nivel vendor).	8.1.1 Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së shërbimit të integruar për viktimat/ të mbijetuarat/it e sulmit seksual dhe aktorëve në nivel vendor për trajtimin e rasteve të DHS-së, DHBGJ-së, DHF-së, MKR-së, e nënshkruar edhe nga Qendra si anëtare të këtij mekanizmi.	- Identifikimi i institucioneve dhe aktorëve përgjegjës në nivel vendor të cilët do të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit të Koordinuar dhe do të trajtojnë rastet sipas qasjes shumësektoriale, të bëhet bazuar në përmbajtjen e ligjit dhe VKM-së respektive.

Qendra e menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Qendra të tjera që mund të ngrihen ndërkohë janë në varësi të institucioneve që i ngrenë dhe që marrin përsipër të mbulojnë koston e funksionimit të tyre.

Ajo duhet të funksionojë me një koordinim të mirë me institucionet e linjës (mbi bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi) dhe të Mekanizmit të Reagimit të Koordinuar në nivel vendor (bazuar në Ligjin për Masat parandaluese për dhunën në marrëdhëniet familjare, 2006, i rishikuar), të formalizuar përmes një marrëveshjeje bashkëpunimi edhe me agjencitë e tjera të shërbimeve.

Marrëveshje bashkëpunimi lidhen edhe me të gjithë bashkëpunëtorët profesionistë (mjekë, psikologë, avokatë, përkthyes, infermierë etj.). Kjo marrëveshje qartëson llojin e bashkëpunimit (bashkëpunëtor *on call*) dhe mënyrën e shpërbimit/pagesës.

E gjithë veprimtaria e Qendrës përshkohet nga përgjegjësia ligjore e koordinimit të veprimeve dhe zbatimit të qasjes së koordinuar shumësektoriale me anëtarë të tjerë të MKR-së dhe trajtimit të rasteve të dhunës seksuale.

Po kështu, në këtë shërbim do të mbahen në konsideratë të gjitha parimet e ofrimit të shërbimeve sipas qasjes së koordinuar shumësektoriale, të cilat fillojnë që nga vendosja e viktimës/së mbijetuarës/it në qendër të shërbimeve, ofrimi i sigurisë dhe privatësisë, shërbime të koordinuara e cilësore të ofruara në kohë e me efektivitet, vendosja e dhunuesit përpara përgjegjësisë, trajtimi me kujdes dhe sipas nevojës në terma urgjente, afatmesme e afatgjata, mundësia e marrjes së vendimeve në bazë të informacionit të përditësuar mbi të drejtat e detyrimet e viktimave/ të mbijetuarave dhe shërbimet në dispozicion të tyre, trajtimi në një mjedis që siguron respekt, dinjitet e ndjeshmëri, si dhe sfidimi i tolerancës ndaj dhunës si një shkelje e të drejtave të njeriut.

Shoqërimi i viktimës për te Qendra mund të bëhet nga punonjësi i policisë, kur viktima paraqitet pranë komisarit të policisë, nga punonjësi i bashkisë kur rasti paraqitet pranë bashkisë ose nga çdo profesionist tjetër që është në kontakt me viktimën për arsye pune. Viktima mund t'i drejtohet edhe vetë Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale kur ka marrë informacione për funksionimin e saj. Në çdo rast, stafi i qendrës përgatit vlerësimin e nevojave të viktimës dhe nevojën për shërbime.

Shënim.

Për një funksionim sa më të mirë të Qendrës së menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale duhet të përshtaten dhe të aplikohen:

- Formularët e ofrimit të shërbimit;
- Kriteret e pranimit;
- Formularët e vlerësimit të nevojave;
- Formularët e referimit; dhe
- Formularët e vlerësimit të shërbimit nga ana e përfituesve.

Si modele të këtyre formularëve shërbejnë dokumentet e ngjashme të hartuara nga institucionet e shërbimit për viktimat e dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore etj.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 866, datë 20.12.2018

PËR PROCEDURAT DHE MODELIN E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR RASTET E DHUNËS NË FAMILJE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, si dhe të neneve 7, pika 1, shkronja “b”/1 e 25 pika 2, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

UDHËZOJNË:**I. Dispozita të përgjithshme**

1. Ky udhëzim përcakton procedurat për kryerjen e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe modelin e këtij vlerësimi.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtime si më poshtë vijon:

a) “Vlerësimi i riskut”, faza e menaxhimit të rastit të dhunës në familje, që kryhet menjëherë në mënyrë të shpejtë, pas identifikimit ose raportimit të rastit, me qëllim ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës përmes Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM).

b) UMPMM – urdhri i lëshuar nga Policia e Shtetit në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

c) UMM – Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

ç) UM – Urdhri i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

d) Punonjësi i policisë – punonjësi i policisë që do të kryejë vlerësimin e riskut dhe procedurat për lëshimin e UMPMM-së.

dh) Struktura përgjegjëse – struktura përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

e) Raporti – raporti për vlerësimin e riskut, i hartuar nga Policia e Shtetit.

II. Detyrat e Policisë së Shtetit për vlerësimin e riskut

3. Titullari i strukturës përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, menjëherë pas identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës në familje, ku është identifikuar ose raportuar rasti, merr të gjitha masat për të ndaluar dhunën dhe për të kryer procedurat për vlerësimin e riskut dhe lëshimin e UMPMM-së.

4. Struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit dhe koordinatori vendor afishojnë në vende të dukshme në ambientet përkatëse listën e personave të kontaktit dhe numrin e telefonit, për institucionet pjesë e mekanizmit të referimit. Koordinatori vendor përgatit dhe përditëson periodikisht këtë listë.

5. Punonjësi i Policisë së Shtetit i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit të riskut njofton koordinatorin vendor pranë njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore. Ky i fundit, mund të asistojë në hartimin e

raportit të vlerësimit të riskut për rastin e dhunës në familje. Në pamundësi për t'u paraqitur personalisht, zëvendësohet menjëherë nga një punonjës social i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

6. Struktura përgjegjëse pranë Policisë së Shtetit, në rastin kur fëmijët janë viktimë të dhunës së drejtpërdrejtë në familje, menjëherë pas marrjes në mbrojtje të fëmijës dhe referimit të rastit pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki / punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve në njësitë administrative të Bashkisë, harton raportin e vlerësimit të riskut në prani të përfaqësuesit të kësaj të fundit.

7. Mosparaqitja në kohë e koordinatorit vendor / punonjësit social të strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk përbën shkak për ndërprerjen e vlerësimit të riskut ose për vonesa në hartimin e raportit.

8. Nëse vendi ku është identifikuar ose raportuar rasti i dhunës në familje është i ndryshëm nga ai i vendbanimit të viktimës ose dhunuesit, punonjësi i policisë i ngarkuar të kryejë vlerësimin e riskut mund të kërkojë informacion nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit të vendbanimit të tyre.

9. Raporti për vlerësimin e riskut hartohet sipas aneksit, që është pjesë përbërëse e udhëzimit. Modeli i aneksit shërben për të siguruar kërkesat minimum të raportit për vlerësimin e riskut, i cili mund të përmbajë edhe elemente të tjera sipas rastit të dhunës që vlerësohet.

10. Raporti i vlerësimit të riskut shpreh nivelin e rrezikut për rastin konkret dhe sugjeron në proporcion me të, një ose disa nga masat e parashikuara në ligjin nr. 9669/2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", në fuqi.

11. Një kopje e raportit u njoftohet menjëherë titullarit të strukturës përgjegjëse dhe punonjësve që thirren për hartimin e këtij raporti.

III. Vlerësimi i riskut në rastin e dhunës në familje

12. Vlerësimi i riskut kryhet me shpejtësi, bazuar në informacionin që disponohet si rezultat i identifikimit ose raportimit të rastit të dhunës, si dhe të informacioneve të tjera që mund të mblidhen menjëherë nga pyetja e të dhunuarës, e dhunuesit ose e anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe nga institucionet, organizatat ose individët, që kanë dijeni për rastin.

13. Mbledhja e informacionit synon të krijojë të dhëna në lidhje me: disponimin e armëve, jo vetëm në rastet kur dyshohet për armëmbajtje pa leje, por edhe në rastet kur një e tillë disponohet me leje; rastet e përsëritura të dhunës në familje dhe burimit të saj, nëse ka pasur edhe më parë urdhra gjyqësorë të mbrojtjes apo masa të mbrojtjes së menjëhershme; qëndrimin e dhunuesit/es ndaj urdhrave të mëparshëm për mbrojtjen nga dhuna në familje; mbi vendimet gjyqësore penale ndaj tij; gjendjen psikologjike të dhunuesit/es, nëse është përdorues i lëndëve alkoolike, narkotike ose nëse përbën kërcënim për jetën, shëndetin a lirinë e viktimës, të fëmijëve ose të anëtarëve të tjerë të familjes.

14. Për hartimin e raportit për vlerësimin e riskut punonjësi i policisë analizon:

a) nivelin e rrezikut për një periudhë afatshkurtër për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes dhe dinamikën e mundshme të zhvillimit të tij;

b) nevojën për të marrë masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kohëzgjatjen e zbatimit të saj;

c) nevojën për të parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të dhunës, përmes ndalimit të veprimeve të dhunuesit.

15. Punonjësi i policisë, pasi ka analizuar vlerësimin e riskut sipas pikës 14 të këtij udhëzimi, harton raportin e vlerësimit të riskut. Këtë raport ia paraqet titullarit të strukturës vendore të policisë, duke sugjeruar:

a) miratimin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nëse është rasti;

b) marrjen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, që duhet të urdhërohen në UMPMM për ndalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimës, duke u bazuar në parimin e parandalimit të përshkallëzimit të dhunës dhe të proporcionalitetit me nivelin e rrezikut të dhunës, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, si edhe shmangien e lënies së fëmijëve pranë dhunuesit;

c) vendosjen e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence, e cila sugjerohet vetëm kur paraqitet e domosdoshme për shkak të riskut për jetën e saj, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijëve të mitur për të mos qëndruar me dhunuesin/en në mënyrë të pambikëqyrur, vullnetin e viktimës për t'u strehuar, si dhe legjislacionin në fuqi për standardet dhe procedurat për pranimin në këto qendra;

ç) vendosjen e viktimës pranë qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale;

d) zbatimin e UMPMM-së, në rastin e dhunës së ushtruar drejtpërdrejt mbi fëmijët në qasje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve, nën përgjegjësinë e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve;

dh) marrjen edhe të masave të tjera të nevojshme e të përshtatshme për menaxhimin e riskut dhe zbatimin e UMPMM-së, të cilat koordinohen me institucionet përkatëse nga koordinatori vendor dhe Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje;

e) lëshimi i UMPMM-së nuk pengon ndjekjen penale të dhunuesit, nëse është rasti.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Sandër Lleshaj

MINISTËR I SHËNDETËSISË

DHE MBROJTJES SOCIALE

Ogerta Manastirliu

ANEKS

MODEL I RAPORTIT PËR VLERËSIMIN E RISKUT PËR RASTIN E DHUNËS NË FAMILJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT

DREJTORIA VENDORE E POLICISË

KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më

_____._____

RAPORT

PËR VLERËSIMIN E RISKUT PËR RASTIN E DHUNËS NË FAMILJE

I. Të dhëna për raportin dhe hartuesit

	Data, ora, vendi, ku hartohet raporti
	Emri, mbiemri dhe detyra për punonjësin e policisë që vlerëson riskun.
	Persona të tjerë sipas këtij udhëzimi, (emri, mbiemri dhe detyra).

II. Burimet e marrjes së informacionit

	Rasti i identifikuar/raportuar, mënyra se si është identifikuar rasti dhe koha e identifikimit, vendi ku ka ndodhur rasti, adresa.
	Intervista me subjektin dhunues/të dyshuarin. Identiteti/Emri, mbiemri, atësia, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi adresa e saktë; Përshkrim i shkurtër:
	Intervista me viktimën. Identiteti/Emri, mbiemri, atësia, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi adresa e saktë; Përshkrim i shkurtër
	Intervista me persona të tjerë/ankuesin/raportuesin e dhunës. Identiteti/Emri, mbiemri, atësia, datëlindja dhe vendlindja, vendbanimi adresa e saktë; Përshkrim i shkurtër:
	Të dhëna të tjera të policisë ose të institucioneve të tjera.

III. Përmbledhje dhe përshkrim i historisë së dhunës

1. Përshkruaj ngjarjen e fundit.

Kur? _____

Kush? _____

Pse?
(shkaqe, qëllimi)

Ku? _____

Dëmi i ardhur _____

A janë dhunuar fëmijët? A është ushtruar dhunë në prani të tyre?

Të tjera.

2. Përshkruaj ngjarjet e kaluara.

Episodi 2 _____

Episodi 3 _____

IV. Faktorët e riskut nga dhunuesi/ja. Gjendja në të shkuarën dhe ajo aktuale

1. Konflikt me ligjin/dhunë seksuale/armëmbajtje pa leje/vepra të tjera penale,

2. Përsëritjet e dhunës dhe përshkallëzimi, _____

3. Probleme nga përdorimi i alkoolit/narkotikëve, _____

4. Probleme të shëndetit mendor, _____

5. Konsiderata të tjera, _____

V. Faktorët e riskut për viktimën. Gjendja në të shkuarën dhe ajo aktuale.

1. Frikë nga autori i krimit. _____

2. A është larguar nga shtëpia? A dëshiron të largohet nga shtëpia?

3. Probleme shëndetësore _____

4. Cila është gjendja e fëmijëve që kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës? Reagimi i tyre? _____

5. Konsiderata të tjera. _____

VI. Vlerësimi i riskut/Cilat janë masat më të përshtatshme?

A ka risk për të kryer dhunë në të ardhmen? Risk për jetën?	Urgjent I moderuar I ulët
A është e nevojshme të lëshohet UMPMM?	Po Jo Shënime:
Cila nga masat e parashikuara në ligj janë më të përshtatshme në këtë rast? <i>(plotëso më poshtë)</i>	
Shënime: <i>(Jepni sqarimet e nevojshme)</i>	a) urdhërimi i dhunuesin/es që të mos kryejë ose të mos kërcënojë se do të kryejë veprime të mëtejshme të dhunës në familje ndaj viktimës ose pjesëtarëve të

	tjerë të familjes së viktimës;
Shënime:	b) urdhërimi i dhunuesit/es që të mos cenojë, ngacmojë, kontaktojë ose të komunikojë drejtpërdrejt ose tërthorazi me viktimën ose pjesëtarë të familjes së viktimës;
Shënime:	c) ndalimi menjëherë i dhunuesin/es, që t'i afrohet: strehës, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës ose të banesës së personave të tjerë, dhe institucioneve arsimore, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimat, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;
Shënime:	ç) vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjence për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata;
Shënime:	d) urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës, sipas shkronjës “ç”, të kësaj pike;
Shënime:	dh) urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale;
Shënime:	e) ☐ bllokimi i çdo arme me leje që i përket dhunuesit gjatë kontrollit të kryer, sekuestrimi i çdo arme pa leje që i përket atij, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.
Sugjerime të tjera të përshtatshme për zbatimin e UMPMM-së	Shënime:

VII. Shënime të fundit

1. Hartoi raportin: _____ (emër, mbiemër, firmë) 2. Asistuan në përgatitjen e raportit (nëse ka): _____ emër, mbiemër, firmë. _____ Bashkëlidhur, dokumentet (nëse ka): 1. _____ 2. _____
--

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 912, datë 27.12.2018

**PËR PROCEDURAT DHE MODELIN E URDHËRIT PËR MASAT PARAPRAKE
TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, si dhe të neneve 13/1, pika 3 e 25 pika 2, e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

UDHËZOJNË:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim ka qëllim të përcaktojë procedurat, që ndiqen nga struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e “Urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”, si dhe modelin e tij.

2. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi, për referencë do të përdoren përkufizimet dhe shkurtime si më poshtë:

a) Koordinatori vendor – koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011.

b) Mekanizmi i referimit – mekanizmi i bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011.

c) Punonjësi i policisë – punonjësi i policisë, që do të kryejë vlerësimin e riskut dhe procedurat për lëshimin e UMPMM-së.

ç) Raporti – raporti për vlerësimin e riskut i hartuar nga Policia e Shtetit.

d) Struktura përgjegjëse – struktura përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit në bazë të ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

dh) UMPMM – urdhri i lëshuar nga Policia e Shtetit në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

e) UMM – Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

ë) UM – Urdhri i Mbrojtjes i lëshuar me vendim të gjykatës në bazë të ligjit nr. 9669/2006.

II. Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

3. UMPMM-ja nxirret nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit, në juridiksionin e së cilës është raportuar dhuna.

4. Pas përfundimit të vlerësimit paraprak të riskut, raporti i hartuar dhe të gjitha materialet e dosjes i kalojnë titullarit ose punonjësit të autorizuar prej tij, i cili nëse është rasti, nxjerr menjëherë UMPMM-në, sipas modelit të përcaktuar në aneksin e këtij udhëzimi, pjesë përbërëse e tij.

5. UMPMM-ja urdhëron një ose disa nga masat e parashikuara në nenin 13/1, pika 2, të ligjit 9669/2006 dhe përcakton strukturat, që do të zbatojnë UMPMM-në me afatet përkatëse. Titullari ose personi i autorizuar prej tij mban parasysh sugjerimet e raportit të vlerësimit të riskut, por ai mund të vendosë edhe masa të tjera të parashikuara nga ligji, që nuk janë përmendur në këtë raport, nëse i çmon të nevojshme për ndalimin e dhunës ose të përshkallëzimit të saj.

6. Në rastin kur i dhunuari është i mitur, UMPMM-ja që lëshohet ndaj dhunuesit/es së mitur ose që vendos në mbrojtje të miturin, nxirret pasi është vënë në dijeni Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki.

7. UMPMM-ja mund të vendosë viktimën në një qendër rezidenciale ose emergjente për viktimat e dhunës në familje, vetëm në rastin e rrezikut për jetën, duke marrë parasysh vullnetin e saj, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe duke respektuar legjislationin në fuqi për standardet e këtyre qendrave.

8. Brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri struktura përgjegjëse që trajton rastin e dhunës paraqet kërkesën për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme pranë gjykatës kompetente.

9. Zbatimi i UMPMM-së ndërpritet pas lëshimit të vendimit të gjykatës për vlerësimin tij.

III. Zbatimi i urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme

10. Zbatimi i UMPMM-së kryhet nga e njëjta strukturë e Policisë së Shtetit në bashkëpunim me koordinatorin vendor të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

11. Nëse vendi i raportimit të dhunës është i ndryshëm nga vendi i banimit të anëtarëve të familjes ku ka ndodhur dhuna, zbatimi i UMPMM-së kryhet nga struktura përgjegjëse, që ka nxjerrë urdhrin në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse në vendin e banimit, si dhe koordinatorin vendor përkatës.

12. Struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit ka detyrë të informojë personin ndaj të cilit është dhënë urdhri, në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja dhe detyrimin e tij për ta zbatuar atë vullnetarisht. Në rastin e mosekzekutimit vullnetar nga dhunuesi, struktura përgjegjëse e evidenton këtë fakt në kërkesën, që i drejton gjykatës KOMPETENTE për vlerësimin e UMPMM-së.

13. Struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit ka detyrë të informojë viktimën e dhunës në familje në lidhje me masat që parashikon UMPMM-ja.

14. Zbatimi i masave që vendos UMPMM-ja, monitorohet nga titullari i strukturës përgjegjëse të Policisë së Shtetit ose punonjësi i autorizuar prej tij, në bashkëpunim me koordinatorin vendor.

15. Mospërbushja e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim, përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor për personat përgjegjës, sipas legjislacionit përkatës.

IV. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

ANEKS MODEL I URDHRI PËR MASAT PARAPRAKE TË MBROJTJES SË MENJËHERSHME



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT
DREJTORIA VENDORE E POLICISË
KOMISARIATI I POLICISË _____

Nr. _____ prot.

Tiranë, më

_____._____

URDHËR

Nr. _____, datë _____

Për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nga dhuna në familje

Në bazë të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, të nenit 29, të Vendimit

të Këshillit të Ministrave, nr. 750, datë 16.9.2015, "Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit",

Nisur nga fakti që (përshkruaj shkurt ngjarjen/et):

Në datën, orën: _____

Vendi ku ka ndodhur ngjarja _____

Përshkrimi i shkurtimisht mënyrës se si është identifikuar/raportuar dhuna: _____

P.sh., shtetasi/ja (gjeneralitetet) është paraqitur/ka telefonuar në komisariatit e policisë _____ dhe ka denoncuar për dhunën ndaj tij/saj/fëmijëve (gjeneralitetet) _____, të ushtruar nga shtetasi/ja (gjeneralitetet) plota të dhunuesit(es) _____.

Në bazë të raportit për vlerësimin e riskut, datë _____. rezulton se të dëmtuarit/es mund t'i rrezikohet jeta dhe shëndeti... etj. Me qëllim ndalimin e dhunës nga shtetasi/ja/_____ dhe sigurimin e mbrojtjes së menjëhershme për shtetasin/shtetasen z/znj. _____/të miturit/ve (nëse ka fëmijë të përfshirë) _____,

URDHËROJ:

1. Marrihen e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme:

a) _____

b) _____ etj.

2. Një kopje e këtij urdhri u njoftohet menjëherë subjektit që ka ushtruar dhunën (dhunuesit/ses), subjektit të dhunuar (viktimit/së dhunës), së bashku me informacionin e nevojshëm për vijimin e procedurave të mëtejshme; koordinatori vendor të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, në njësinë përkatëse të vetëqeverisjes vendore (nëse ka fëmijë të përfshirë).

3. Brenda 48 orëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, struktura përgjegjëse/punonjësi i Policisë së Shtetit që trajton rastin e dhunës, paraqet kërkesën për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesëpadi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë _____.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet specialisti për krimet dhe ndihmës specialisti i policisë së zonës ku ka ndodhur ngjarja/ku ka vendbanimin i/e dhunuara (viktima e dhunës) _____.

5. Punonjësit e policisë që neglizhojnë zbatimin dhe monitorimin masave të parashikuara nga ky urdhër, kur sjellja e tyre nuk përbën vepër penale, ngarkohen me përgjegjësi disiplinore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Shefi i Komisarariatit

Emër mbiemër

Firma dhe vula e institucionit

UDHËZIM
Nr. 744, datë 15.11.2019

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE MINIMALE TË SHËRBIMEVE TË
PËRKUJDESJES SHOQËRORE PËR VIKTIMAT/TË MBIJETUARAT/IT E
DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE TË DHUNËS NË FAMILJE, NË QENDRAT
REZIDENCIALE EMERGJENTE (AFATSHKURTRA) PUBLIKE DHE JOPUBLIKE
(STREHËZAT EMERGJENTE)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3, të neneve 27 dhe 51, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente), sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.

3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror apo dhe/ose personave juridikë publikë/privatë, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

STANDARDET MINIMALE

**TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE PËR VIKTIMAT/TË
MBIJETUARAT/IT E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE TË DHUNËS NË FAMILJE
NË QENDRAT REZIDENCIALE EMERGJENTE (AFATSHKURTRA) PUBLIKE DHE
JOPUBLIKE (STREHËZAT EMERGJENTE)**

2019

Hyrje

Dokumenti i standardeve minimale për ofrimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, me **fokus kryesor strehimin e menjëhershëm dhe afatshkurtër në rastet emergjente**, në qendrat rezidenciale emergjente publike dhe jopublike (këtë e tutje “strehëzat emergjente”) për gratë dhe vajzat viktimat/të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe për anëtarët e tjerë viktimat/të mbijetuar të dhunës në familje, u përgatit me qëllim funksionimin me sa më eficiencë të këtyre strehëzave emergjente.

Ky dokument, që mbështetet në një kuadër të gjerë ligjor, u përgatit përmes një procesi konsultimi me pjesëmarrjen e specialisti/eve të sektorit të politikave dhe strategjive për përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, specialisti/eve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore në

nivel qendror e vendor, përfaqësuesi/eve të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime strehimi dhe shërbime të tjera mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, anëtarë/eve të mekanizmave të referimit në bashkitë Korçë, Kolonjë, Përmet, Pogradec, Roskovec, Sarandë, përfaqësuesi/eve të organizatave ndërkombëtare¹⁷, si dhe me mbështetjen e ofruar nga PNUD-i, përmes vënies në dispozicion të dy eksperteve¹⁸, si dhe mbështetjen teknike e logjistike përgjatë gjithë procesit të hartimit, deri në finalizimin e dokumentit.

Standardet minimale për strehëzat emergjente janë një parakusht për ofrimin e shërbimit, procesin e licencimit, kontrollit dhe vlerësimit të këtij shërbimi strehimi të menjëhershëm, për rastet emergjente dhe për një periudhë të shkurtër kohore, që mund të ofrohet nga subjekte publike dhe jopublike. Në to theksohen kushtet minimale bazë për t'u përmbushur me qëllim ofrimin e shërbimit të strehimit të menjëhershëm dhe afatshkurtër, në rastet emergjente, dhe për këtë arsye **duhet të aplikohen detyrimisht** nga të gjitha subjektet publike e jopublike që ofrojnë një shërbim të tillë.

Standardet minimale për strehimin emergjent synojnë mbrojtjen e jetës së grave dhe vajzave, si dhe anëtarëve të tjerë viktimat/të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, **për një periudhë relativisht të shkurtër kohore, të konsideruar si periudhë emergjente**, deri në sigurimin e një alternative më afatgjatë të trajtimit dhe zgjidhjes së problemit të strehimit, si dhe të dhunës së ushtruar.

Të bazuara në praktikat më të mira në këtë fushë, këto standarde reflektojnë parimet ndërkombëtare e kombëtare të barazisë, respektimit dhe garantimit të vlerave dhe personalitetit të individit, të së drejtës për t'u mbrojtur, të mbrojtjes së informacionit për jetën vetjake, të dinjitetit dhe të sigurisë etj. Prandaj dhe vënia në zbatim e tyre, garanton ofrimin e një shërbimi cilësor të strehimit emergjent për gratë dhe vajzat, pavarësisht moshës, etnisë, nevojave të veçanta apo aftësive të kufizuara, përkatësisë fetare, identitetit gjinor apo orientimit seksual të tyre, si dhe për individët e tjerë viktimat/të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, përfshirë fëmijët e dhunuar në mënyrë të drejtpërdrejtë, fëmijë që asistojnë në skena dhune në familje, fëmijë të neglizhuar, abuzuar etj.

TABELA E PËRMBAJTJES

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

II. BAZA LIGJORE

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

IV. PARIMET THELBËSORE PËR TË GJITHA STANDARDET

V. STANDARDET MINIMALE, KRITERET DHE TREGUESIT

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Gratë dhe vajzat, si dhe anëtarët e tjerë të familjes, të cilat/ët përballen me incidente të dhunës së ushtruar ndaj/në prani të tyre, kanë nevojë për një sërë shërbimesh dhe për mbështetje të specializuar, me qëllim që t'u sigurohet mbrojtje, trajtim dhe mundësi për zgjidhjen e situatës së tyre, deri në riintegrim të plotë. Shërbimet mbështetëse janë të shumëllojshme dhe në bazë të Konventës së Stambollit, ndahen në shërbime mbështetëse, të përgjithshme dhe të specializuara. Strehimi (edhe ai i menjëhershëm dhe afatshkurtër) në një vend të sigurt, i aksesueshëm 24 orë në 7 ditë të javës, është një nga shërbimet mbështetëse të specializuara, sipas Konventës së Stambollit, që sigurisht duhet të ofrohet në bazë të një sërë standardesh. Standardet minimale kërkojnë ofrimin e një shtrati në strehëz për 10.000 banorë¹⁹.

Sipas nenit 23 të Konventës së Stambollit: ... *"Shtetet palë duhet të marrin masat e nevojshme, përfshirë dhe ato legjislative, për të mundësuar ngritjen e strehëzave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme dhe në një*

¹⁷ Një listë e plotë e institucioneve kontribuese dhe pjesëmarrës/eve në tryezën konsultuese do të gjendet bashkëlidhur këtij dokumenti si shtojcë 1.

¹⁸ Znj. Monika Kocaqi dhe znj. Aurela Bozo.

¹⁹ Këshilli i Evropës/Task-forcë për të luftuar dhunën ndaj grave, duke përfshirë dhunë në familje (2008): Raporti përfundimtar, Strasburg: Standardi minimal i cituar në raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 2011.

numër të mjaftueshëm, për të ofruar akomodim të sigurt dhe për të arritur në mënyrë proaktive të viktimat/ të mbijetuarat, veçanërisht për gratë dhe fëmijët e tyre. Strehëzat duhet të sigurojnë akomodim të menjëhershëm, të sigurt dhe mundësisht gjatë 24 orëve për viktimat/ të mbijetuarat, në mënyrë të veçantë për gratë dhe fëmijët, kur nuk janë më të sigurt në shtëpitë e tyre. Vetëm strehimet e përkohshme apo strehëzat e përgjithshme, si p.sh., shtëpitë për të pastrehët, nuk janë të mjaftueshme. Strehëzat e specializuara për gratë janë të pajisura në mënyrën më të mirë të mundshme, për të trajtuar problemet e shumëllojshme të ndërthurura, me të cilat ndeshet njëherazi viktimat/ e mbijetuarat, duke bërë të mundur mbështetjen e grave dhe fëmijëve të tyre, për t'u përballur me eksperiencat traumatike, për t'u larguar nga një marrëdhënie e dhunshme, për të rifituar vetëbesimin dhe për të krijuar bazat e një jete të pavarur të zgjedhur nga vetë ato. Njëkohësisht, strehëzat e grave luajnë rol kryesor në krijimin e rrjeteve, mundësojnë bashkëpunimin ndërmjet agjencive dhe rritjen e ndërgjegjësimit në komunitetet respektive ...”.

Dy janë sfidat kryesore me të cilat përballemi, gjatë ofrimit të shërbimit të akomodimit të viktimave/ të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje në Shqipëri: i. rritja e numrit të shërbimeve në mbështetje të grave e vajzave, duke përfshirë edhe strehëzat afatgjata dhe strehëzat emergjente; si dhe ii. rritja e cilësisë së shërbimeve në mbështetje të grave, vajzave dhe anëtarëve të tjerë të familjes, viktimat/ të mbijetuarat të dhunës. Nevoja për shtimin e numrit të shtretërve dhe strehëzave në Shqipëri, si dhe për përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe efektivitetit të shërbimeve ekzistuese të strehimit, është identifikuar në një sërë studimesh apo dokumentesh të politikave në vend. Kështu, në studimin “Hartëzimi i shërbimeve për dhunën ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri”, realizuar në vitin 2015, me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe UN Women, theksohet se: “... duke marrë në konsideratë numrin ekzistues të shtretërve në kohën e zhvillimit të studimit, numrin e shtretërve që pritet të plotësohen deri në fund të vitit 2015, si edhe numrin e popullsisë, krabasuar me standardet sipas Këshillit të Evropës, Shqipëria duhet të sigurojë edhe të paktën 127 shtretër ...”. Ndërkohë që i njëjti shqetësim për plotësimin e numrit të shtretërve të disponueshëm, shprehet edhe në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016–2020, miratuar me VKM-në nr. 733, datë 20.10.2016²⁰.

Kjo nevojë është identifikuar, gjithashtu, edhe nga anëtarë të mekanizmave të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare në bashki të ndryshme, gjatë punës së tyre për trajtimin dhe menaxhimin me sukses të rasteve. Në kuadër të masave për të përmbushur nevojën për strehim, është shumë e rëndësishme të merret në konsideratë, gjithashtu, kërkesa në rritje nga të gjithë anëtarët e mekanizmave të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare (të ngritura aktualisht në 39 bashki të vendit) për të pasur më shumë strehëza emergjente (të cilat sigurojnë strehim të menjëhershëm dhe afatshkurtër) në dispozicion për adresimin e situatave emergjente të grave dhe vajzave të cilat kanë raportuar dhunën dhe/ose janë në procesin e marrjes së një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje. Gjithashtu, shërbimet e strehimit mbeten të paaksesueshme për disa nga grupet e grave dhe vajzave, sidomos për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor, me varësi nga substanca të ndryshme, gratë e moshuara, gratë dhe vajzat LGBTI, gratë dhe vajzat rome dhe egjiptiane, gratë dhe vajzat e zonave të thella rurale etj., kjo si për shkak të mungesës së informacionit për ekzistencën e shërbimeve të specializuara, mungesës së mbulimit territorial me shërbime të tilla, pamjaftueshmërisë së shtretërve në dispozicion, mospërshtatshmërisë infrastrukturore apo edhe për shkak të mungesës së stafit të kualifikuar për trajtimin e këtyre grupeve të grave e vajzave në qendrat ekzistuese.

II. BAZA LIGJORE

Baza ligjore kryesore mbi të cilën është mbështetur hartimi i standardeve minimale për ofrimin e shërbimit të strehimit të menjëhershëm dhe afatshkurtër në strehëzat emergjente, listohet në vijim:

²⁰ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/201-2016.pdf.

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë²¹;
2. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/201222, neni 22, “Shërbimet mbështetëse të specializuara” dhe neni 23, “Strehëzat”;
3. Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 17, “Strehëzat”.
4. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, ligjin nr. 10 329, datë 30.9.2010 dhe ligjin nr. 47/2018;
5. Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”;
6. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
7. Ligji nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
8. Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
9. Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
10. Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”;
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 13.7.2011, “Për standardet e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje”, në qendrat rezidenciale publike dhe jopublike;
12. Udhëzimi nr. 13, datë 17.12.2012, “Për zbatimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jo publike”;
13. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011 , “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”;
14. Marrëveshjet e bashkëpunimit për formalizimin e mekanizmit të referimit dhe i trajtimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, të nënshkruara në nivel bashkie;
15. Vendimi nr. 425, datë 27.6.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”, i ndryshuar;
16. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 839, datë 3.12.2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, ‘Për përcaktimin e kriterëve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore’”;
17. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative”.

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Standardet minimale të shërbimeve për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në strehëzat emergjente u referohen koncepteve dhunë, dhunë ndaj grave, dhunë në familje, pjesëtarë të familjes etj., siç përkufizohen në Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, si dhe ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar) apo edhe në ligje të tjera.

a) **“Dhunë”** është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik²³.

²¹ Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998; shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007; ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008; ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012; ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015; ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

²² Si dhe reregjistruar në faqen e Konventës në datën 4.2.2013.

(shiko: <http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=&DF=&CL=ENG>)

²³ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 1.

b) **“Dhunë ndaj grave”** kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private²⁴;

c) **“Dhunë në familje”** nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, që ndodhin brenda familjes ose nësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën²⁵.

d) **“Gjini”** nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë²⁶.

e) **“Dhunë gjinore kundër grave”** nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale²⁷.

f) **“Viktimë”** nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat “a” dhe “b”²⁸.

g) **“Urdhër mbrojtjeje”** është urdhri i lëshuar me vendim gjykatë, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit²⁹.

h) **“Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje”** është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykatë, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë³⁰.

i) **“Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”** është urdhri i arsyetuar dhe i lëshuar sipas parashikimeve të nenit 13/1 të këtij ligji, që përmban masat e menjëhershme për ndalimin e dhunës, që merren nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, deri në marrjen e vendimit nga gjykata.

j) **“Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje”** (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje³¹.

k) **“Njësi shtëpiake”** është banesa ose çdo mjedis i përdorur dhe i përshtatur si i tillë, pavarësisht nëse është në pronësi ose në përdorim të familjes³².

l) **“Shërbime rezidenciale”** janë shërbime të kujdesit njëzetekatërorësh dhe afatgjatë për individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike³³.

m) **“Strehëzat emergjente”** ofrojnë akomodim të menjëhershëm, të sigurt, afatshkurtër, mbështetës dhe të specializuar për çdo grua viktimë të dhunës, përfshirë dhunën në familje dhe/ose fëmijët e saj. Ato mund të ofrojnë shërbime, vetëm nëse përmbushin standardet e përcaktuara në këtë dokument dhe ky rregull duhet të aplikohet edhe në ambientet e ngritura deri tani për ofrimin e shërbimit të strehimit emergjent, në disa bashki në vend, ambiente këto publike (të ngritura apo që menaxhohen nga bashkitë) ose edhe jopublike (të ngritura ose që menaxhohen nga OJF-të e specializuara). Llojet e shërbimeve që do të ofrohen në këto ambiente dhe në strehëzat emergjente janë: shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat. Shërbimi në strehëza është shërbim i kujdesit shoqëror rezidencial, i ofruar në mënyrë të përkohshme, që përfshin shërbimin e specializuar, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuar dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim mund të ofrohet gjatë të gjitha ditëve të javës dhe përfshin edhe referimin në një shërbim tjetër shoqëror³⁴.

²⁴ Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, neni 3, “Përkufizimet”.

²⁵ Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, neni 3, “Përkufizimet”.

²⁶ Ibidem.

²⁷ Ibidem.

²⁸ Ibidem.

²⁹ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 10.

³⁰ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 11.

³¹ Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 5.

³² Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, neni 3, “Përkufizimet”, pika 6.

³³ Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

³⁴ Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 17.

n) **“Shërbime të specializuara”** në strehëzën emergjente janë shërbimet e ofruara nga profesionistë/e të profilizuar/a në specialitete të ndryshme. Këto shërbime do të ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie për gratë dhe vajzat e abuzuara, të dhunuara, si dhe për fëmijët e tyre të abuzuar, apo për anëtarët e tjerë të familjes që pësojnë dhunë.

o) **“Përfitues/e i/e shërbimeve të kujdesit shoqëror në strehëzat emergjente”** është individi, që sipas vlerësimit nga koordinatori/ja vendor/e kundër dhunës në familje dhe/ose punonjësi/ja social/e i/e njësish së vetëqeverisjes vendore përmbush kushtet e një viktime ose viktimë e mundshme, për të përfituar të drejtat nga shërbimi shoqëror, së bashku me fëmijët e tij/saj. **“Fëmijë përfitues”** është çdo individ deri në moshën 18 vjeç, përfitues i shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas nenit 3, pika 8, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

p) **“Situatë emergjente”** është një situatë kritike, e përkohshme ose jo, e shkaktuar nga faktorë shoqërorë, që sjellin apo mund të sjellin dëme të menjëhershme, të rënda ose që dëmtojnë seriozisht jetën, shëndetin apo mirëqenien e individit, në rast se nuk merren masa urgjente dhe ndaluese³⁵.

q) **“Punonjës/e social/e i/e njësish së vetëqeverisjes vendore”** është profesionisti/ja, sipas legjislacionit përkatës në fuqi, në njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rasteve, që do të jetë përgjegjës/e për identifikimin e nevojave, referimin, menaxhimin dhe ndjekjen në vazhdim të rasteve³⁶.

r) **“Punonjës/e i shërbimeve sociale”** është i/e punësuar/a në shërbim të kategorive përfituese të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si pjesë e sistemit publik dhe jopublik të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror³⁷.

s) **“Menaxhim i rastit”** është sigurimi dhe bashkërendimi i referimit të individëve në nevojë për kujdes shoqëror në të gjithë procesin e ofrimit të shërbimit, sa herë që të jetë e nevojshme, deri në integrimin e plotë të tyre³⁸.

t) **“Vend familjar”**, një vend që akomodon një grua me fëmijët e saj bazuar në numrin mesatar të fëmijëve për familje në vendin tonë. Kështu që ky do të jetë më shumë se një shtrat³⁹.

u) **“Fëmijë”** është çdo individ deri në moshën 18 vjeç.

v) **“Standardet minimale”** janë standardet më të ulëta apo standardet bazë që duhet të synohet të plotësohen nga të gjitha shtetet dhe shërbimet. Standardet mundësojnë kufijtë dhe rregullat për shtetet dhe ofruesit e shërbimeve, për sa u takon shtrirjes dhe miksimit të shërbimeve që duhet të jenë në dispozicion, kush duhet t’i ofrojë këto shërbime, si dhe parimet dhe praktikët bazë me të cilat ato duhet të veprojnë. Këto standarde minimale janë në një farë mënyre inspiruese, duke pasur parasysh që shumë shtete ende nuk kanë plotësuar numrin e duhur të shërbimeve të specializuara, apo shumë të tjera nuk arrijnë ende të plotësojnë standardet edhe thjesht sipas politikave të vendit, praktikave dhe burimeve në dispozicion. Gjithsesi, këto standarde përfaqësojnë nivelin dhe cilësinë e shërbimeve në të cilat duhet të kenë qasje dhe disponibilitet të gjitha gratë nëpër Evropë. Praktikët e mira duhet të përfshijnë standardet minimale, por edhe të shkojnë përtej tyre duke synuar maksimumin e qasjes, cilësisë dhe rezultateve pozitive⁴⁰.

IV. PARIMET THELBËSORE PËR TË GJITHA STANDARDET

Strehëzat emergjente për viktimat/të mbijetuarat e dhunës më bazë gjinore dhe të dhunës në familje, duhet t’i ofrojnë shërbimet e tyre të menjëhershme dhe afatshkurtra, në përputhje me parimet thelbësore të mëposhtme:

1. Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfitueses/it. Ofrimi i shërbimit të strehimit emergjent duhet të bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut,

³⁵ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 14.

³⁶ Ibidem, neni 3, “Përkufizime”, pika 24.

³⁷ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 28.

³⁸ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, “Përkufizime”, pika 25.

³⁹ [https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/source/eg-va8-conf\(2007\)study%20rev.en.pdf](https://www.coe.int/t/dg2/equality/domesticviolencecampaign/source/eg-va8-conf(2007)study%20rev.en.pdf)

⁴⁰ “Të luftosh dhunën ndaj grave: standardet minimale për shërbimet e specializuara”, prof. Liz Kelly dhe Lorna Dunois (2008). <http://www.coe.int/equality/>

integritetit të individit, besimit fetar, përkatësisë etnike, identitetit gjinor apo orientimit seksual, respektimit dhe plotësisë të kushteve për trajtimin e paaftësive fizike e mendore apo nevojave të veçanta, si dhe formimit të gjithanshëm të saj/tij.

2. Parimi i mosdiskriminimit. Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfitueses/it të shërbimeve të strehimit emergjent, bazuar në nenin 1, “Objekti”, të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

3. Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror⁴¹.

4. Parimi i konfidencialitetit dhe i mbrojtjes së të dhënave personale. Të dhënat personale të individit që trajtohet me shërbime të strehimit emergjent, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Koordinator/ia vendor/e kundër dhunës në familje, punonjësi/ia social/e i/e njësisë së vetëqeverisjes vendore, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimit të strehimit emergjent ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo të detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

5. Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore⁴².

6. Siguria dhe dinjiteti njerëzor. Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente duhet të mundësojnë që të gjitha ndërhyrjet të prioritarizojnë sigurinë dhe dinjitetin e përdoruesve/eve të shërbimeve dhe stafit.

7. E drejta e marrjes së vendimit për ta përfituar shërbimin, bazuar në dhënien e një informacioni të plotë e të përditësuar. Do të jenë gratë, të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje që do të vendosin për jetën e tyre dhe sigurinë e jetës. Është e rëndësishme t’i shpjegohet të së mbijetuarës së dhunës se ajo duhet të marrë vendimin për qëndrimin e saj në strehëzën emergjente, me qëllim dhënien fund dhunës dhe jo përfundimin e marrëdhënies me dhunuesin, anëtar i familjes. Vendosja e grave dhe e fëmijëve përfitues/e në strehëzat emergjente bëhet me pëlqimin e tyre me shkrim (ose të përfaqësuesit ligjor, në rastin e fëmijëve), pasi t’u jetë dhënë i gjithë informacioni i nevojshëm, si në lidhje me shërbimet që ofrohen në strehëzën emergjente, ashtu edhe mbi tërësinë e shërbimeve të akomodimit në dispozicion, qofshin këto shërbime emergjente apo afatgjata.

V. STANDARDET MINIMALE, KRITERET DHE TREGUESIT

STANDARDI 1

Shërbimet e ofruara në strehëzën emergjente duhet të jenë në përputhje me natyrën e këtij lloji shërbimi, të menjëhershëm e afatshkurtër, duke i dhënë rëndësi të kuptuarit të dhunës ndaj grave dhe vajzave, si shkak dhe pasojë e pabarazive dhe diskriminimit ndërmjet grave dhe burrave.

Rezultati i dëshiruar

Shërbimet e ofruara demonstrojnë një qasje të përshtatshme dhe të informuar për përdoruesit/et e shërbimit, që njeh dhe kupton dinamikën dhe ndikimet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, brenda barazisë dhe kuadrit të të drejtave të njeriut.

STANDARDI 1.1

Shërbimi i ofruar në strehëzën emergjente promovon të kuptuarit, se dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë të papranueshme dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

⁴¹ Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 “Parimet”, pika “dh”.

⁴² Ligj nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 4 “Parimet”, pika “c”.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të ketë një dokument me përkufizime të qarta në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave, dhunën në familje etj. - Stafi duhet të punësohet bazuar në qasjen dhe qëndrimin që mban ndaj këtyre formave të dhunës. - Aktivitetet për fuqizimin e kapaciteteve, të theksojnë vazhdimisht qasjen që duhet të udhëheqë punën në strehëzën emergjente. - Shërbimi i ofruar duhet ta reflektojë këtë qasje dhe përdoruesit/et e shërbimit duhet ta kuptojnë se ajo që u ka ndodhur përbën shkellje të të drejtave njerëzore.	1.1.1 Ekziston një përkufizim mbi termat “dhunë ndaj grave” dhe “dhunë në familje” që është në përputhje me përkufizimet në legjislacionin kombëtar e ndërkombëtar. 1.1.2 Rekrutimi i stafit bëhet duke u bazuar në qasjen njohuritë dhe që ata/o kanë mbi të kuptuarit e këtyre koncepteve. 1.1.3 Mënyra e mbajtjes së shënimeve nga stafi (ditari personal për çdo rast të trajtuar, shënimet mbi udhëzimet e dhëna dhe terapinë që duhet të ndiqet, shënimet mbi ecurinë e rastit dhe përmirësimet e vërejtura etj.) për rastin, si dhe informacioni i dhënë për përdoruesit/et e shërbimit, tregojnë se stafi e mban dhe promovon qasjen e duhur në këtë drejtim. 1.1.4 Nëse lind nevoja, stafi sfidon institucionet e tjera në mënyrë konstruktive, nëse ndeshet me mite apo besime të rreme rreth “dhunës ndaj grave” dhe “dhunës në familje”. 1.1.5 Përdoruesit/et e shërbimit janë të vetëdijshme se shërbimi i ofruar siguron këtë qasje.	- Dokumenti duhet të përgatitet mbi bazën e përkufizimeve, në kuadrin ligjor ekzistues kombëtar e ndërkombëtar. - Duhet punuar vazhdimisht, si me stafin ashtu dhe me përdoruesit/et e shërbimit të strehimit emergjent, që kjo qasje të gjejë reflektimin e duhur në praktikë.

Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente, duhet të kenë qasje dhe disponueshmëri për të gjitha gratë dhe vajzat dhe/ose fëmijët e tyre të dhunuar, si dhe për të gjithë anëtarët e familjes që kanë pësuar dhunë dhe janë në rrezik të lartë për sigurinë e jetës së tyre; duhet të ofrojnë informacionin e nevojshëm për përfutjesit/et e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe duhet të jenë të përshtatshme për të gjithë/a përdoruesit/et e shërbimeve. Njohja e dinamikave gjinore, efekteve dhe pasojave të dhunës ndaj grave në kuadrin e barazisë dhe të drejtave të njeriut, duke përfshirë kuptimin e dhunës ndaj grave si shkak dhe pasojë e pabarazive ndërmjet grave dhe burrave, si dhe nevojën për shërbime vetëm për gratë, përbën një parakusht të rëndësishëm për mirëfunksionimin e këtyre strehëzave emergjente. Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) pranë të cilave ngrihen këto strehëza emergjente duhet të sigurojnë të paktën numrin minimal të stafit të nevojshëm. ***Sigurohet qëndrimi/shoqërimi i të së mbijetuarës nga një punonjës/e e specializuar për këtë qëllim, përgjatë gjithë kohës së qëndrimit të së mbijetuarës në strehëzën emergjente, si dhe me tri turne (pra përgjatë gjithë harkut kohor 24-orësh).*** Anëtarët e stafit të strehëzave emergjente, ndër të tjera, duhet të kenë përfunduar arsimin përkatës, të jenë të pajisura me aftësitë e duhura, të jenë të ndjeshëm/me ndaj këndvështrimit gjinor, t’u mundësohen trajnime të vazhdueshme për këtë lloj shërbimi në mbështetje të viktimave të të gjitha formave të dhunës, të njohin dhe respektojnë standardet e funksionimit të strehëzës emergjente për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, standardet ndërkombëtare, legjislacionin civil, administrativ dhe penal në mbrojtje të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përfshirë aktet nënligjore, si: VKM-në nr. 334, datë 17.2.2011; vendimin nr. 425, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale, publike dhe jopublike, të përkujdesjes shoqërore”, të ndryshuar me VKM-në nr. 839, datë 3.12.2014; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 12.6.2018, “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësisve administrative” etj., si dhe të respektojnë konfidencialitetin e të dhënave të viktimës/të mbijetuarit/ës të/së çdo forme dhune, bazuar në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për

mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; të ofrojë shërbime pa diskriminim, duke zbatuar ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; të njohë dhe të zbatojë ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”; ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”; ligjin nr. 22/2018, “Për strehimin social” dhe aktet e tyre nënligjore etj.

STANDARDI 2

Shërbimet e ofruara në strehëzën emergjente duhet të plotësojnë nevojat individuale të përfituesit/eve si viktimat/të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore e të dhunës në familje, duke respektuar sigurinë dhe dinjitetin njerëzor të tyre.

Rezultati i dëshiruar

Shërbimet e ofruara sigurojnë që të gjitha ndërhyrjet t’u japin përparësi sigurisë dhe dinjitetit të përdoruesit/eve të shërbimit, duke marrë në konsideratë nevojat komplekse të tyre si viktimat/të mbijetuarat të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

STANDARDI 2.1

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron një paketë të plotë dhe efektive shërbimesh, në përputhje me nevojat gjinore komplekse të përfituesit/eve, viktimat/të mbijetuarat të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

STANDARDI 2.2

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent prioritarizon sigurinë dhe dinjitetin e përdoruesit/eve të shërbimit, si dhe pranon që përdoruesit/et e shërbimit, fëmijët e tyre, anëtarët e tjerë të familjes apo dhe stafi që punon me ata/ato, kanë të drejtë të jenë të mbrojtur nga dhuna dhe abuzimi, si dhe duhet të ndërmarrin veprime në përputhje me procedurat për ta mundësuar këtë gjë.

Fëmijët vendosen në përkujdesje alternative ose merren masa mbrojtëse emergjente, për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo, në rastin kur fëmijët jetojnë në familje ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

KRITERET	TREGUESIT	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë një dokument të shkruar me misionin dhe objektivat e shërbimit, të cilat duhet të jenë të shkruara me gjuhë të kuptueshme dhe të afishura në një vend të dukshëm. - Shërbimet minimale të ofruara në strehëzën emergjente duhet të jenë: - strehimi i sigurt; - veshja; - ushqimi; - mbështetje psikosociale; - referimi. - Shërbime të tjera shtesë që mund të ofrohen, ndër të tjera, janë: - shërbime psikologjike; - shërbime mjekësore; - shërbime ligjore; - shërbime financiare; - asistencë edukative/arsimore.	2.1.1 Dokumenti në formë shkresore. 2.1.2 Dokumenti i afishuar. 2.1.3 Kontrata për shërbimet në dosjen e përfituesit/es. 2.1.4 Deklarata e dakordësisë së përfitueses e firmosur brenda 24 orëve. 2.1.5 Formularët e pranimit, raportet e psikologes/punonjësës sociale, deklarata e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale etj., të plotësuara dhe vendosura në dosjet e përfituesit/eve.	- Përfituesi/ja të ketë nën kontroll fëmijët e saj, nëse ka. - Përfituesi/ja të marrë pjesë në administrimin e programit, duke u kujdesur për nevojat e saj, pra duke qenë përgjegjëse për hapësirën e saj, fëmijët e saj, gatimin, pastrimin, kujdesin ndaj fëmijës etj., personalisht ose në grup me përfituesit/et e tjerë/a. - Kur përfituesja është nënë me fëmijë, fëmija jeton në të njëjtën dhomë me nënën, pasi është bërë një vlerësim mjekësor dhe psikosocial i të dyve.

- Shërbimi i ofruar reflekton qartë parimet e sigurisë dhe dinjitetit. - Shërbimi i ofruar duhet të bazohet në një plan sigurie për çdo përfitues/e.	2.2.1 Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent siguron që shërbimet e domosdoshme për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, ofrohen në një vend të sigurt, i vendos përfituesit/et në qendër të shërbimit; ofron shërbime në përputhje me nevojat e përfituesit/eve; dhe respekton të drejtën e tyre për t'i pyetur nëse duan që shërbimi t'u ofrohet nga personel grua. 2.2.2 Procedurat për sigurinë dhe dinjitetin njerëzor janë të shkruara dhe të afishuara për përdoruesit/et e shërbimit. 2.2.3 Staf i është në gjendje të përshkruajë nevojën se përse shërbimi i ofruar duhet të jetë i ndjeshëm nga këndvështrimi gjinor.	- Staf duhet të kujdeset dhe marrë masat e nevojshme që çdo përfitues/e të kuptojë të drejtat dhe detyrimet e saj, si dhe parimet mbi të cilat mbështetet shërbimi i strehimit emergjent. Nëse përfituesja e shërbimeve kërcënohet ose vihet në rrezik për jetën gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, ajo njofton menjëherë stafin e strehëzës emergjente për vlerësimin e rrezikut dhe përditësimin e planit të sigurisë.
--	---	---

Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente duhet të mundësojnë që të gjitha ndërhyrjet të prioritarizojnë sigurinë dhe dinjitetin e përdoruesve/eve të shërbimeve dhe stafit. Kur nga kryerja e vlerësimit të riskut rezulton se dhuna e ushtruar paraqet rrezik për jetën, shëndetin dhe lirinë e anëtarëve të familjes, strukturat përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, marrin menjëherë masa paraprake të mbrojtjes së viktimës/ave dhe për ndalimin e dhunës⁴³, ndër të cilat vendosja menjëherë e viktimës në një qendër rezidenciale ose emergjente për viktimat e dhunës në familje deri në marrjen e vendimit nga gjykata⁴⁴; ndalimi menjëherë i dhunuesit/es, që t'i afrohet strehës⁴⁵; urdhërimi i një punonjësi të Policisë së Shtetit, që të shoqërojë viktimën në qendrën rezidenciale ose të emergjencës⁴⁶; urdhërimin e një punonjësi të Policisë së Shtetit që të shoqërojë viktimën deri në vendbanimin e tij/të saj dhe të mbikëqyrë marrjen e sendeve personale⁴⁷ etj.

Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë njësive për mbrojtjen e fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës⁴⁸. (Gjatë vlerësimit të plotë të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje, grupi teknik, ndërsektorial, në bashkëpunim me NJMF-në/PMF-në, ka detyrimin të bëjë vlerësimin e nevojës së marrjes së masës së mbrojtjes apo të një urdhri mbrojtjeje, në kuadër të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar⁴⁹.)

⁴³ Ligji nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 14, pika 1.

⁴⁴ Ligji nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 14, pika 1/"ç".

⁴⁵ Ligji nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 14, pika 1/"ç".

⁴⁶ Ligji nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 14, pika 1/"d".

⁴⁷ Ligji nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 14, pika 1/"dh".

⁴⁸ Ligji nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, neni 14, pika 4.

⁴⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 353, datë 12.6.2018, "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive administrative".

Organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, pranë Policisë së Shtetit, paraqesin përpara gjykatës kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe kërkesë-padi për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, brenda 48 orëve nga marrja e masave.

Stafi i strehëzës emergjente dhe aktorët në nivel vendor, pjesë e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të dhunës në familje dhe GTN-së për mbrojtjen e fëmijëve duhet të koordinojnë veprimet, me qëllim sigurinë e jetës së grave viktime/të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje dhe fëmijëve të tyre gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente. Me qëllim sigurinë e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe vlerësimin e rrezikut, sektori i shërbimeve sociale pranë bashkive, koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, policia dhe anëtarët e tjerë të mekanizmave të referimit, NJMF-të/PMF-të të bashkisë dhe/ose së njësisë administrative, duhet të marrin në konsideratë disa faktorë të rëndësishëm para sistemimit të së mbijetuarës së dhunës dhe/ose fëmijëve të saj në strehëzën emergjente. Disa nga këta faktorë janë: largësia e vendbanimit të së mbijetuarës së dhunës nga strehëza emergjente, historia e incidenteve të dhunës së pësuar nga dhunuesi, niveli i raportimit në të shkuarën dhe të dhëna të policisë ose të aktorëve të tjerë në nivel vendor, në lidhje me rastin, forma e dhunës së pësuar, kohëzgjatja e saj e të tjera. Siguria e përfituesit/eve do të kryhet përmes ruajtjes së adresës së strehëzës emergjente konfidenciale dhe/ose marrjes së masave të duhura të sigurisë dhe të monitorimit e mbikëqyrjes. Për të garantuar sigurinë e të së mbijetuarës së dhunës dhe fëmijëve të saj, ambienti duhet të ruhet me kamera, si dhe subjekti duhet të sigurojë monitorim të pamjeve dhe vendosje të një sistemi alarmi, për të siguruar mbrojtje të menjëhershme në rast rreziku. Në rastet kur vendndodhja e strehëzës emergjente nuk mund të mbahet sekret, bashkëpunimi me policinë dhe aktorët e tjerë, anëtarë të mekanizmit të referimit, merr një rëndësi të veçantë. Kur policia dhe anëtarë të tjerë të mekanizmit të referimit, në bashkëpunim me të mbijetuarën e dhunës me bazë gjinore apo të dhunës në familje, vlerësojnë se dhunuesi paraqet një rrezik të lartë, strehëza emergjente mbikëqyret nga një punonjës/e policie, si dhe sigurohet akomodimi në një strehëz sa më larg vendbanimit të së mbijetuarës së dhunës dhe dhunuesit, pas ditëve të qëndrimit në strehëzën emergjente⁵⁰. Viktima e dhunës në familje mund të akomodohet në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për Viktimat e Dhunës në Familje ose në strehëza të tjera të menaxhuara nga organizata të shoqërisë civile.

Për këtë vendim transferimi duhet të merret edhe mendimi i të së mbijetuarës së dhunës. Me qëllim sigurinë e viktimës/të së mbijetuarës së dhunës në familje, i ofrohet transporti falas dhe i sigurt për në strehëz ose në institucione të tjera, nga Sektori i Shërbimeve Sociale në bashki, koordinatori vendore kundër dhunës në familje në bashkëpunim me policinë dhe anëtarët e tjerë të mekanizmit të referimit.

Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktime dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim. Në këtë kuadër, bashkëpunimi i stafit të strehëzës emergjente me aktorët vendorë është shumë i rëndësishëm.

Shërbimet këshilluese, psikologjike dhe mbështetëse:

Strehëzat emergjente do të ofrojnë siguri, akomodim, këshillim dhe mbështetje për gratë, të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, si edhe për fëmijët e tyre. Do të përfitojnë nga këto shërbime gratë të mbijetuara të formës së dhunës fizike, seksuale, ekonomike, morale dhe emocionale të ushtruar nga partneri, bashkëshorti dhe/ose pjesëtarë të tjerë të familjes mbështetur në nenin 3, “Përkufizime”, p. 3, “Pjesëtarë të familjes” dhe në nenin 10, “Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje”, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Këto shërbime do të ofrohen me fonde të bashkisë, të pushtetit qendror ose/dhe në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse që punojnë në këtë fushë në nivel bashkie ose qarku.

⁵⁰ http://files.wave-network.org/trainingmanuals/Away_from_Violence_2004_English.pdf

Shërbimet e ofruara nga stafi i strehëzës emergjente përfshijnë:

- hartimin dhe zbatimin e një plani sigurie për çdo përfitues/e, në bashkëpunim me policinë, koordinatoren vendore kundër dhunës në familje dhe anëtarët e tjerë të mekanizmit të referimit;
- pjesë e këtij plani është edhe urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme. Ky plan sigurie do të përfshijë masa jo vetëm për ditët e qëndrimit të viktimës/ave në strehëzën emergjente, por edhe gjatë transferimit të viktimës për në strehëza të tjera, si dhe kthimin e saj në familje;
- këshillime psikologjike për gratë dhe fëmijët, të mbijetuar/a të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare;
- ndihmë juridike parësore dhe referim për ndihmë juridike dytësore, mbi përdorimin e mjeteve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, legjislacionin penal etj.;
- këshillime mbi mbështetjen financiare që përfitojnë të mbijetuarit/at e dhunës në marrëdhëniet familjare, në rastet kur janë të pajisura me UMM/UM gjatë kohës së vlefshmërisë së tyre, si dhe në rastet kur nuk kanë përdorur mjetet ligjore;
- referim të rastit në agjencitë e ndryshme në nivel vendor, që ofrojnë mundësi arsimimi për fëmijët, mundësi punësimi për gratë të mbijetuara të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje etj., shërbime këto që mund të përfitohen edhe pas përfundimit të afatit të qëndrimit në strehëzën emergjente;
- shoqërim i të mbijetuarit/ës të/së dhunës në polici për të raportuar dhunën e pësuar, përgatitjen e kërkesës për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe përgatitjen e kërkesës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;
- shoqërimi i të mbijetuar/ës të/së dhunës në familje në gjykatë për të marrë pjesë në seancat gjyqësore të çështjes, me objekt lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes për të mbijetuarit e dhunës në familje. Nëse rasti paraqet një rrezik të lartë, një punonjës/e policie, gjithashtu, merr pjesë në shoqërimin e viktimës/ave për në gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë;
- shoqërimi i të së mbijetuarës në zyrën e përmbarrimit dhe zyrën e shërbimeve sociale në bashkinë përkatëse, me qëllim sigurimin e zbatimit të UMM-së;
- shoqërimi i të së mbijetuarës në zyrën e shërbimeve sociale në bashki për të marrë ndihmën ekonomike të parashikuar në ligj/aktet nënligjore për të mbijetuarat e dhunës në familje të pajisura me urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje;
- e mbijetuara e dhunës në familje do të informohet nga stafi i strehëzës mbi të gjitha shërbimet e vlefshme për të dhe për fëmijët e saj, në nivel bashkie, qarku, në nivel qendror etj., bazuar në vlerësimin e nevojave;
- shërbime për fëmijët që janë të mbijetuar/a të dhunës në familje ose kanë asistuar në skena dhune në familje. Këto shërbime ofrohen në bashkëpunim me strukturën e shërbimeve shoqërore, NJMF/PMF në bashki dhe ose njësinë administrative dhe organizatat e shoqërisë civile;
- aktivitete plotësuese social-kulturore për fëmijët.

Mbështetja psikologjike do të ofrohet nga:

- një psikolog/e i bashkisë, në rastet kur psikologu/ia është pjesë e strukturës së bashkisë;
- përmes një marrëveshjeje me institucionet në nivel bashkie ose qarku që kanë psikolog/e në dispozicion;
- përmes një marrëveshjeje me organizatat e shoqërisë civile që ofrojnë shërbime psikologjike falas për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- nga psikolog/e të urdhrit të psikologut, përmes një marrëveshjeje me Urdhrin e Psikologut, me qëllim ofrimin e shërbimit falas;
- nga qendrat e shërbimeve publike;
- në të gjitha rastet e sipërpërmendura, përfituesit/et do të përfitojnë shërbim psikologjik falas, ndërkohë që psikologët/et që do ta ofrojnë këtë shërbim duhet të jenë patjetër të specializuara

për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, përfshirë dhunën ndaj fëmijëve;

- përmes “Shërbimit psikosocial shkollor” në rastin e fëmijëve të dhunuar. Përmes këtij shërbimi psikosocial shkollor do t’u ofrohet mbështetje fëmijëve/nxënësve për trajtimin e problematikave të ndryshme, sipas nevojave psikosociale. Ky shërbim do të ofrohet përmes bashkëpunimit me njësitë arsimore vendore.

Mbështetja ligjore, në formën e ndihmës juridike parësore do të ofrohet nga:

- punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar në qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë ose në ambiente të tjera të përshtatshme; organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, të autorizuar, bazuar në ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

- klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

Mbështetja ligjore në formën e ndihmës juridike dytësore do të ofrohet nga:

- avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të cilat/ët janë caktuar për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore nga organi procedues ose Dhoma Vendore e Avokatisë; në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

- ky shërbim do t’u ofrohet përfitueseve falas.

Ofrimi i këtij shërbimi do të mundësohet përmes Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur midis bashkisë dhe Dhomës Vendore të Avokatëve, institucioneve përgjegjëse për adresimin e dhunës në marrëdhëniet familjare në nivel bashkie, anëtarëve të MR-së. Marrëveshjet do të synojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive. Stafi i strehëzës emergjente informon viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje se ndihma juridike u ofrohet, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, për shkak se përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike⁵¹. Të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje informohen, si në lidhje me të drejtat ligjore, bazuar në legjislacionin administrativo-civil kundër dhunës në familje, ashtu edhe në legjislacionin procedural penal⁵². Gjithashtu, stafi lehtëson që avokati/ja të hyjë në marrëdhënie me personin, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe të fillojë dhënien e shërbimeve të kërkuara.

Shërbimi shëndetësor

Në rastet kur përfituesit/et do të kenë nevojë për shërbim shëndetësor, koordinatori vendore kundër dhunës në familje, në mbledhjen *ad hoc* të Ekipit Teknik Ndërdisciplinar prezanton rastin dhe kërkon nga spitali dhe/ose qendrat shëndetësore të ofrojnë shërbim shëndetësor falas për të mbijetuarin/ën e dhunës me bazë gjinore apo dhunës në familje.

Mbështetja me veshje, ushqime etj. do të mundësohet:

- nga fondi i bashkisë;

- nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse dhe aktorët e tjerë në nivel vendor dhe qendror. Koordinatorja vendore kundër dhunës në familje referon rastin pranë këtyre organizatave ose aktorëve dhe institucioneve të tjera, me qëllim sigurimin e ushqimeve dhe veshmbathjeve në rastet e akomodimit në strehëz të përfituesit/eve.

Shoqërimi i të mbijetuarit/ës të/së dhunës në polici, gjykatë, ose institucionet e tjera gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente.

E/i mbijetuar/a e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje do të shoqërohet në polici, gjykatë ose institucionet e tjera nga koordinatori vendore kundër dhunës në familje. Kur rasti është vlerësuar me një rrezik të lartë ose të mesëm, i mbijetuari/a i/e dhunës me bazë gjinore dhe i/e dhunës në familje shoqërohet për në institucionet e lartpërmendura nga policia dhe

⁵¹ Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, neni 11, “Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike”.

⁵² Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

koordinatorja vendore kundër dhunës në familje dhe/ose punonjësja e mbrojtjes së fëmijëve.

Gjatë kohës së qëndrimit të të/së mbijetuarit/ës të/së dhunës me bazë gjinore dhe të/së dhunës në familje në strehëzën emergjente, përgjegjësit e programit të rehabilitimit raportojnë përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike, si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit. Nëse dhunuesi/ja nuk merr pjesë në program, atëherë, me kërkesë të mbledhjes *ad-hoc* të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje ose të subjekteve të parashikuara nga neni 13, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, zbatohen dispozitat e Kodit Penal, për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për urdhrat e mbrojtjes. Koordinatori vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare njofton stafin e strehëzës emergjente, me qëllim sigurimin e jetës të/së të mbijetuarit/ës të/së dhunës me bazë gjinore dhe të/së dhunës në familje⁵³. Në rastin e programeve të rehabilitimit në nivel vendor, ata/o ftohen të jenë pjesë e mekanizmit të referimit dhe informojnë koordinatoren vendore për pjesëmarrjen e të paditurit në program dhe ecurinë e tij/saj, edhe në mbledhjet e ekipit teknik.

Nuk do të përbëjë kusht të pranimit të të/së mbijetuarit/ës të/së dhunës me bazë gjinore dhe të/së dhunës në familje, pajisja e saj me një urdher të menjëhershëm mbrojtjeje nga gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë. Pajisja me UMM nuk nënkupton daljen e menjëhershme të viktimës së dhunës nga strehëza emergjente, pa marrë të gjitha masat e nevojshme për sigurinë e jetës së saj jashtë ambienteve të strehëzës apo pa qenë të sigurt që alternativa e paraqitur për vazhdimin e jetës të/së përfituesit/es jashtë strehëzës emergjente, mundëson riintegrimin e ti/saj në jetën e përditshme (pra UMM zbatohet menjëherë dhe përfituesi/ja ka të garantuar strehimin, ofrohen shërbime të tjera mbështetëse etj.). Përjashtim këtu përbëjnë rastet, kur, për shkak të rrezikshmërisë së lartë vlerësohet si një alternativë më e përshtatshme akomodimi në Qendrën Kombëtare të Përkujdesjes Shoqërore për Viktimat e Dhunës në Familje ose në strehëza rajonale që ofrojnë këto shërbime. Gjithsesi, nuk duhet harruar që shërbimi i strehimit emergjent është afatshkurtër (maksimumi deri në shtatë ditë) ndaj dhe anëtarët e mekanizmit të referimit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme dhe duhet të angazhohen maksimalisht në gjetjen e një alternative afatgjatë dhe të qëndrueshme për zgjidhjen e situatës së paraqitur. Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM-në/UM-në, zyra e shërbimeve sociale e njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrat të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Stafi i strehëzës emergjente ruan një bashkëpunim të mirë me zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore, Policinë e Shtetit, koordinatoren vendore kundër dhunës në familje dhe anëtarët e tjerë të MR-së, përgjegjës për respektimin e UMM-së/UM-së, merr dhe jep informacion në lidhje me incidente dhune ose kërcënime për incidente dhune gjatë periudhës që e mbijetuara e dhunës akomodohet në strehëzën emergjente.

Trajnimi dhe kualifikimi

Stafi që punon në strehëzën emergjente duhet të marrë një minimum prej 30 orësh trajnim dhe ky trajnim duhet të mbulojë:

- një analizë gjinore të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës ndaj grave;
- teknika komunikimi dhe ndërhyrjeje;
- konfidencialiteti;
- mbrojtja e fëmijëve;
- akses në përkthim dhe shërbime për personat me aftësi ndryshe;
- bashkëpunimi dhe si të bëjnë referimet e duhura në aktorët e tjerë;
- informacion mbi traumën dhe mbijetesën;
- vlerësimin e riskut;

⁵³ Ligji nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, neni 11.

- mosdiskriminimin dhe diversitetin;
- fuqizimin;
- njohuri bazike mbi standardet ndërkombëtare e kombëtare, legjislacionin kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe standardet e shërbimit në strehëzat për viktimat/të mbijetuarit/at e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
- të drejtat e përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përfshirë të drejtën efektive për ankim.

Siguria

Kur e mbijetuara e dhunës në familje nuk mund të akomodohet në strehëzën emergjente për shkak të moshës së djalit që e shoqëron atë, stafi i strehëzës sigurohet që i mundëson një tjetër opsion akomodimi të sigurt për familjen. Çdo alternativë akomodimi duhet të vlerësohet nëse është në përputhje me sigurinë e strehëzave emergjente dhe me politikat e konfidencialitetit.

Nevojat për arsim të fëmijëve

Kur e mbijetuara e dhunës në familje është akomoduar në strehëzë së bashku me fëmijën/ët e saj atëherë stafi i strehëzës emergjente asiston në edukimin e fëmijëve. Kjo do të sigurohet përmes një protokolli me shkollat në nivel lokal, me qëllim përmbushjen e nevojave të fëmijëve. Gjithashtu, bashkitë duhet të sigurojnë që strehëzat emergjente kanë ambient të përshtatshëm me qëllim që fëmijët të kryejnë detyrat e shtëpisë gjatë kohës së qëndrimit në strehëz.

Aksesi në telefon

Përfituesit/et në strehëzën emergjente duhet të kenë akses në një telefon të qendrës ose një sistem që mundëson vetëm dhënien e një alarmi apo njoftimin urgjent të punonjësve/eve të policisë dhe/ose koordinatores vendore për një rrezik që u paraqitet. Kjo linjë telefonike nuk mundëson telefonata të tjera, me qëllim moszbulimin e vendndodhjes së strehëzës dhe mosvënien në rrezik të jetës së viktimave.

Një listë me numrat e telefonit të koordinatores vendore kundër dhunës në familje, punonjësit/es së policisë dhe punonjësit/es social/e pranë bashkisë publikohet në ambientet e strehëzës emergjente.

STANDARDI 3

Vlerësimi i nevojave dhe plani i përkujdesjes për përfituesin/en.

Rezultati i dëshiruar

Nevojat e përfituesit/es, viktimë/e mbijetuar e dhunës me bazë gjinore dhe e dhunës në familje, të vlerësuara plotësisht dhe në mënyrë të efektshme, sipas moshës, gjinisë dhe specifikimeve të tjera, si dhe plani individual i përkujdesjes i hartuar në bazë të tyre.

STANDARDI 3.1

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent vlerëson në mënyrë të menjëhershme dhe me efektivitet nevojat e përfituesit/es të/së shërbimit, duke marrë në konsideratë tërësinë e karakteristikave personale.

STANDARDI 3.2

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent harton në bashkëpunim me përfituesin/en e shërbimit planin individual të përkujdesjes për të, bazuar mbi nevojat individuale gjinore të vlerësuara.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Menjëherë pas pranimit të përfituesit/es në shërbimin e strehimit, duhet bërë me të vlerësimi i nevojave dhe orientimi. - Vlerësimi i nevojave të përfituesit/es duhet të bëhet brenda maksimumi 48 orëve (për nevojat emergjente), si dhe duhet të plotësohet më pas nga vlerësimi i nevojave afatgjata. Ky vlerësim bëhet në bashkëpunim me përfituesin/en dhe me mbështetjen/ ndihmën e grupit	3.1.1 Formulari i pranimit, së bashku me informacionin orientues të nënshkruar nga përfituesi/ja dhe të futura në dosjen e tij/e saj. 3.1.2 Formulari i vlerësimit të nevojave (emergjente dhe afatgjata), i plotësuar dhe i futur në dosjen e përfituesit/es.	- Duke qenë se flitet për shërbim dhe rast emergjent, duhet të merret në konsideratë fakti që përfituesi/ja mund të ketë dalë edhe pa dokumente identifikimi nga shtëpia. Pavarësisht kësaj, ofruesi i shërbimit të strehimit duhet të ketë një formular regjistrimi/pranimi, i cili shoqërohet edhe me një

vendimmarrës për trajtimin e rastit në këtë qendër.		informacion orientues, që duhet t'i vihen në dispozicion përfituesit/es dhe duhet të nënshkruhen edhe prej saj.
- Stafi i ofruesit të shërbimit emergjent duhet të planifikojë planin e përkujdesjes individuale të përfituesit/es, bazuar mbi vlerësimin e nevojave të tij/të saj.	3.2.1 Plani individual i përkujdesjes, i hartuar dhe i miratuar edhe nga vetë përfituesit/ja, bazuar në nevojat gjinore të tij/të saj dhe i futur në dosjen e tij/e saj personale.	- Lidhja e masave të planifikuara në planin e përkujdesjes, me nevojat e përfituesit/es (emergjente dhe afatgjata) është domosdoshmëri.

Shërbimet që do të ofrohen në strehëzat emergjente duhet të jenë të specializuara, si dhe të disponueshme gjatë 24 orëve në të 7 ditët e javës. Po kështu, strehëzat emergjente duhet të kenë infrastrukturë të përshtatur, si dhe staf të specializuar për të pranuar dhe për të trajtuar të mbijetuara me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor apo të varura nga substancat. Strehëzat emergjente do të sigurojnë që shërbimet për gratë dhe për vajzat e dhunuara ofrohen nga specialiste gra dhe vajza. Strehëzat emergjente duhet të kenë një plan se si të trajtojnë kufizimet në shtretër. Pavarësisht këtyre kufizimeve, në asnjë rast, një grua viktimë e dhunës me bazë gjinore apo e dhunës në familje, nuk mund të lihet pa iu ofruar shërbim në këtë strehëz emergjente ose në ndonjë tjetër strehëz tjetër të ngjashme, apo në një qendër rezidenciale që ofron shërbime të specializuara për gratë me aftësi të kufizuara, probleme të shëndetit mendor apo varësi nga substancat, në qark ose në nivel kombëtar. Asnjë e mbijetuar në rrezik të lartë për jetën, nuk mund të kthehet në shtëpi për të bashkëjetuar me dhunuesin në kushtet e mungesës së shtretërve në strehëzën emergjente, në kushte të mungesës së infrastrukturës (p.sh., aksesueshmëria për gratë me aftësi të kufizuara) apo të personelit të specializuar për trajtimin e grave me aftësi të kufizuara, me probleme të shëndetit mendor apo varësi nga substancat. Koordinatorja vendore kundër dhunës në familje, e emëruar si punonjëse me kohë të plotë pranë bashkisë, mund të marrë informacion, në lidhje me rastin: i. *drejtpërdrejt* - nëse e mbijetuar nga dhuna me bazë gjinore apo dhuna në familje i drejtohet asaj; ose ii. nga *aktorët të tjerë të mekanizmit të referimit* - ku e mbijetuar e dhunës e ka raportuar dhunën e pësuar. Koordinatori/ja vendor/e do të jetë personi kryesor përgjegjës për marrjen e vendimit për pranimin (ose jo) të së mbijetuarës së dhunës në strehëzën emergjente, **duke e marrë këtë vendim në bashkëpunim me të paktën një punonjës/e të policisë**. Kur është e mundur, ky vendim mund të merret edhe me praninë e specialistëve të tjerë, si: një punonjës/e social/e apo jurist/e i/e specializuar në çështje të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe një psikolog/e të specializuar (në rast të pranisë edhe të fëmijëve), të cilat mund të jenë të punësuar/a pranë institucioneve anëtare të mekanizmave të referimit. Ky grup bazë vendimmarrës (përbërja e të cilit varion, në varësi të numrit të anëtarëve të mekanizmit të referimit në secilën bashki, por që minimalisht përbëhet nga koordinatori/ja vendor/e dhe nga një punonjës/e policie) duhet të jetë i përgatitur për t'u mbledhur dhe për të vendosur në çdo kohë që rasti të paraqitet në 24 orë, në 7 ditët e javës. Prandaj dhe institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa që të mbështesin dhe lehtësojnë punën e atyre punonjësve/eve që do të përfshihen në grupin vlerësues për pranimin e rasteve të paraqitura në strehëzën emergjente.

Stafi i strehëzës emergjente dëgjon me kujdes dhe pa paragjykim të mbijetuarin/ën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Që në fillim të bisedës punonjësi/ja e strehëzës emergjente e siguron përfituesin/en që i gjithë informacioni do të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe do të mbetet anonim, me përjashtim të rasteve specifike kur ky konfidencialitet duhet të thyhet për të sigurinë e përfituesit/es (rastet e thyerjes së konfidencialitetit duhet të jenë pjesë e manualit të politikave dhe të procedurave të ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent). Një plan sigurie i veçantë (i përkujdesjes individuale), bazuar në historinë e dhunës së pësuar, incidenteve, formave të dhunës etj., do të hartohet në bashkëpunim me aktorët e tjerë. I/e mbijetuari/a i/e dhunës me bazë gjinore apo i/e dhunës në familje do të informohet në një formë të shkruar mbi të drejtat dhe detyrimet e saj/tij gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, si edhe pas daljes nga strehëza. Kjo formë do të firmoset nga përfituesi/ja, nëse bie

dakord me rregullat e parashikuara. Në rastet kur ndaj dhunuesit/es ka filluar procedimi penal, organi i prokurorisë informon viktimën/të mbijetuarin/en i/e dhunës, në lidhje me të drejtat, bazuar në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale, “Të drejtat e viktimës së veprës penale” dhe në nenin 58/1, “Të drejtat e viktimës së mitur”.

E/i mbijetuar/a e dhunës me bazë gjinore apo i/e dhunës në familje do të këshillohet nga stafi i strehëzës emergjente të mos ndajë informacionin me dhunuesin/en e tij/e saj gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, sepse kjo mund të vërë atë dhe fëmijët e saj në rrezik. Viktima në strehëzën emergjente duhet të marrë informacion në lidhje me fazat e procedimit penal, në rast se dhunuesi lihet i lirë etj. dhe ky informacion duhet të ndihmojë për një plan sigurie më efektiv dhe për përditësimin e vazhdueshëm të këtij plani.

Pjesë e planit individual do të jenë edhe identifikimi i miqve, i anëtarëve të familjes, shërbimeve komunitare etj., të cilët/at mund të shërbejnë për zbatimin e planit të përkujdesjes individuale apo për trajtimin afatgjatë të viktimës/të së mbijetuarës, edhe pas daljes nga strehëza emergjente. Roli i MR-së, pas daljes së viktimës nga strehëza emergjente, është shumë i rëndësishëm, me qëllim përmbushjen e nevojave të saj dhe të fëmijëve për mbështetje psikologjike, ligjore, ndihmë sociale, punë, banesë sociale etj.

STANDARDI 4

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesit/eve.

Rezultati i dëshiruar

Përfituesi/et e shërbimit të strehimit emergjent gëzojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligj, trajtohen me dinjitet e respekt, si dhe mbrohen nga të gjitha format e abuzimit dhe të diskriminimit gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente.

STANDARDI 4.1

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron shërbimet për përfituesin/et me tolerancë dhe mirëkuptim, respekt pa diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, kombësisë, gjuhës, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, bindjeve politike, fetare apo filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore apo shoqërore, shtatzënisë, të qenit prind, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozitave gjenetike, aftësive të kufizuara, përkatësisë në një grup të caktuar apo për çfarëdo arsyes të tjera.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Informimi i përfituesit/es me të drejtat dhe përgjegjësitë gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente. - Duhet të ketë një mekanizëm ankimi për përfituesit/et dhe stafin, në rast të shkeljes së të drejtave të tyre. - Përfituesi/ja të trajtohet si pjesëmarrës/e në program.	4.1.1 Broshurë/fletëpalosje/dokument i afishuar që përfaqëson të drejtat dhe detyrimet gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente, përfshirë të drejtën e përfitimit të shërbimeve pa diskriminim. 4.1.2 Procedurë ankimi me shkrim, që bën lidhjen me një sistem të jashtëm, nëse ankesën nuk e zgjidh strehëza emergjente, e shpallur dhe e njohur nga të gjitha përfituesit/et dhe stafi. 4.1.3 Procedura të qarta ankimi në rast abuzimi nga stafi, kundrejt përfituesve të shërbimit në strehëz, apo në rast abuzimi ndaj fëmijëve të cilët janë të pashoqëruar nga prindërit/kujdestari ligjor.	- Është mirë të mbahet një bazë të dhënash më vete për të gjitha ankesat e depozituara dhe për zgjidhjen që u është dhënë. - Pjesëmarrja e përfituesit/eve është thelbësore për të shkuar drejt vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

Koha e qëndrimit të një të mbijetuarë të dhunës me bazë gjinore apo të dhunës në familje në strehëzën emergjente është e kufizuar. Kjo kohë qëndrimi do të zgjasë maksimumi 7 (shtatë) ditë, me qëllim menaxhimin e situatës emergjente të së mbijetuarës së dhunës me bazë gjinore apo të dhunës në familje. Dalja e të së mbijetuarës nga strehëza emergjente do t'u njoftohet anëtarëve të mekanizmit të referimit dhe të trajtimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor, me qëllim që rasti të monitorohet nëse do të kthehet në ambient familjar (në zbatim të UMM-së/UM-së të lëshuar nga Gjykata) ose me qëllim që të sigurohet që e mbijetuara e dhunës ka kaluar nga

strehëza emergjente në një strehëz me qëndrim më afatgjatë. Nëse rasti kthehet në ambient familjar, menaxhimi i rastit nga bashkitë dhe anëtarët e mekanizmave të referimit përfshin edhe fuqizimin e grave përmes përgatitjes së një plani për punësimin, strehimin, mbështetjen psikosociale, ndihmat ushqimore emergjente etj., në varësi të nevojave të rastit dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore të mbështetura edhe nga ministria përgjegjëse për çështjet e strehimit marrin masa për sigurimin e banesave të specializuara për viktimat e dhunës në familje, sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social.

Shërbimet për të mbijetuarat e dhunës në familje sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësi të kufizuara, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër. Njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) sigurojnë që stafi që shërben në strehëzat emergjente ka njohuri të mjaftueshme të ligjit nr. 10 221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe përfitueset kanë njohuri mbi të drejtat që u burojnë nga legjislacioni kundër diskriminimit.

Shërbimet në këto strehëza emergjente do të ofrohen falas. Strehëzat duhet të jenë të aksesueshme nga gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje që u përkasin grupeve të ndryshme të marginalizuara, si grave nga komunitetet rome, egjiptiane, grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, grave nga zonat rurale, grave migrante, grave azilkërkuese, grave të komunitetit LGBTI etj. Në të gjitha rastet, duhet të merret në konsideratë edhe fakti që gratë mund të kenë dalë nga shtëpia e tyre pa asnjë lloj dokumenti identifikimi (në varësi të situatës dhe të dhunës së ushtruar). Nëse një grua e mbijetuar e dhunës me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje është referuar nga anëtarë të mekanizmit të referimit dhe nuk është pajisur me dokumentacionin ligjor prej tyre, i takon Sektorit të Shërbimeve Sociale në bashki dhe koordinatores vendore kundër dhunës në familje të koordinojë veprimet me anëtarët e tjerë, me qëllim pajisjen e të së mbijetuarës së dhunës me dokumentacionin përkatës ose vënien në dispozicion të këtij dokumentacioni stafit të strehëzës emergjente. Me qëllim aksesin e grave dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, strehëzat emergjente duhet të përmbushin parimin bazë të përshtatshmërisë së arsyeshme, si dhe interpretuesin/en e gjuhës së shenjave për personat që kanë nevojë për këtë lloj shërbimi. Masa duhet të merren për të pasur në dispozicion edhe një përkthyes/e për rastet e grave të huaja, me qëllim mundësimin e shërbimit në gjuhën e tyre. Me qëllim aksesin e grave të zonave rurale apo të grupeve të tjera që jetojnë në një distancë nga strehëza emergjente, anëtarët e mekanizmit të referimit duhet të sigurojnë transportin falas të tyre deri në ambientet e strehëzës (me burime nga bashkia, anëtarë të tjerë të MR-së ose burime të tjera, si: projekte, organizata ndërkombëtare, biznesi, OJF etj.) dhe duhet të bashkëpunojnë me SPZ-në, kryepleqtë ose stafin e njësive administrative përkatëse. Kur nga vlerësimi i rastit rezulton se të mbijetuarat e dhunës, përfshirë dhunën në familje kanë probleme të rënda të shëndetit mendor, janë në varësi të alkoolit, drogës etj., koordinatorja vendore kundër dhunës në familje referon rastin në shërbimet e specializuara në nivel vendor, nëse janë të vlefshme ose në ato në nivel kombëtar. Shërbimet në këto raste duhet të jenë të specializuara dhe të mbështetura si duhet. Nga ana tjetër, informohet policia dhe anëtarët e tjerë të ekipit teknik ndërdisiplinar, me qëllim që marrja e masave për ndjekjen e programeve të sipërpërmendura të përfshihet në kërkesë padinë për lëshimin e UMM-së/UM-së.

Strehëzat emergjente do të ofrojnë shërbime për viktimat dhe do të garantojnë sigurinë për to, pavarësisht vendbanimit ose vendqëndrimit të viktimës. Kjo mbrojtje nënkupton asistencën për strehim të përkohshëm, transportin drejt një strehimi të sigurt ose drejt shërbimeve të kërkuara, shoqërimin drejt urgjencës ose shërbimeve mjekësore të domosdoshme ose pranë shërbimeve të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

STANDARDI 5

Të dhënat personale të përfituesit/es dhe administrimi i tyre.

Rezultati i dëshiruar

Të drejtat e përfituesit/eve të shërbimit mbrohen nga legjislacioni në fuqi që rregullon të dhënat e kësaj natyre, si dhe rregullat e përcaktuara në rregulloren e ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent, për ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave.

STANDARDI 5.1

Mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale të përfituesit/eve të shërbimeve në strehëzën emergjente të kryhet duke siguruar përdorimin e tyre në mënyrë profesionale. Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ruan dhe përpunon të dhënat për rastet e dhunës në familje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbështetet në parimin e ruajtjes së fshehtësisë së të dhënave.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Dosja të jetë konfidenciale dhe të mund të shihet vetëm nga përfituesi/ja dhe punonjësi/ja sociale ose administratori/ja e strehëzës emergjente. - Për identifikimin e përfituesit/es në dosje të përdoren vetëm numra të zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Për fëmijët, të mos përdoren inicialet, por fëmija 1, 2 etj. i prindit. - Në dosjen e përfituesit/es të përfshihen të gjitha dokumentet e mundshme që të përdoren në momentin e duhur në procesin gjyqësor. - Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë një rregullore të qartë, ku të përshkruhen saktësisht e me gjuhë të kuptueshme të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përfituesit/es dhe detyrimi i stafit për të informuar përfitueset në lidhje me këto të drejta.	5.1.1 Të dhënat personale mbahen në dosje të mbyllura ose, nëse ruhen në kompjuter, mund të hapen vetëm me fjalëkalim nga personi përgjegjës. 5.1.2 Dokumentacioni mbështetës (prova, vizitë nga mjeku etj.), i përfshirë në dosjen e përfituesit/es dhe i gatshëm për t'u përdorur në procesin gjyqësor. 5.1.3 Rregullorja me të drejtat dhe përgjegjësitë e përfituesit/es, e afishuar dhe e përgatitur me një gjuhë të qartë e të kuptueshme.	- Meqenëse këto janë raste emergjente, çdo provë e mbledhur ka rëndësi të veçantë dhe duhet të ruhet në mënyrën e duhur. - Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent duhet të jetë në gjendje të vlerësojë se deri në cilën masë respektohet konfidencialiteti i të dhënave dhe duhet të njoftojë edhe përfituesin/en, kur ky konfidencialitet duhet të thyhet. Përfitueset informohen në lidhje me të drejtën e tyre për ankim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kur cenohet konfidencialiteti i të dhënave.

Të dhënat e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore apo të dhunës në familje që do të përfitojnë nga shërbimet në strehëzën emergjente do të ruhen në mënyrë konfidenciale dhe përfituesit/et e shërbimeve do të informohen nga stafi, në lidhje me situatat në të cilat konfidencialiteti mund të kufizohet. Stafi i punësuar apo i kontraktuar *on-call* në strehëzat emergjente nënshkruan një deklaratë mbi respektimin e konfidencialitetit të të dhënave të grave dhe të fëmijëve viktimë/të mbijetuara të dhunës, si dhe detyrime që lidhen me përpunimin e të dhënave dhe detyrime të tjera, të cilat burojnë nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

STANDARDI 6

Administrimi i brendshëm i strehëzës emergjente.

Rezultati i dëshiruar

Përmes administrimit të brendshëm, ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent siguron shërbim dhe funksionim eficient për të arritur qëllimin, vlerat dhe parimet e praktikës më të mirë në terren.

STANDARDI 6.1

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë mekanizmat e duhur formalë të administrimit të brendshëm për funksionimin e strehëzës emergjente dhe shërbimet që ofron.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të strehimit të ketë strukturën e nevojshme dhe stafin e kualifikuar, me përvojë për të realizuar shërbimet. - Stafi i punësuar të jetë i përshtatshëm për nevojat e përfituesit/eve dhe të rekrutohet me procedurë të hapur e sipas legjislacionit në fuqi. - Ofrimi i trajnimeve për fuqizimin e kapacitetit të stafit, si dhe kryerja e vlerësimit të performancës së punës, ndihmojnë në përmirësimin e eficiencës dhe të efektivitetit të ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent.	6.1.1 Organigrama e ofruesit të shërbimit të strehimit emergjent dhe lista e stafit (<i>on call</i>). 6.1.2 Procedura e rekrutimit të stafit e dokumentuar sipas të gjithë hapave të ndjekur. 6.1.3 Lista e trajnimeve të kryera për parandalimin dhe trajtimin e çështjeve të dhunës në familje, si dhe materialet përkatëse të ruajtura. 6.1.4 Databazë e stafit e plotësuar me trajnimet dhe kualifikimet e marra. 6.1.5 Procesi i vlerësimit me shkrim i dokumentuar dhe i kryer sipas parimeve të vlerësimit të performancës në punë.	- Përzgjedhja e stafit të bëhet në përputhje me natyrën e shërbimit dhe me parimet kryesore të ofrimit të tij. Për sa i takon numrit të anëtarëve të stafit që duhet të ketë një strehëz emergjente, kjo varion në bazë të kapacitetit të strehëzës dhe raportit të numrit të anëtarëve të stafit përkundrejt numrit të përfituesit/eve duhet të përcaktohet dhe në bazë të shërbimeve që ofron strehëza emergjente në tërësi. - Gjatë përzgjedhjes të mbahet në konsideratë edhe e drejta e përfituesit/es për të kërkuar ofrim të shërbimit nga staf i së njëjtës gjini. - Vlerësimi i nevojave të stafit për kualifikim dhe ofrimi i kualifikimit të munguar duhet të bëhen përpara procedurës së vlerësimit të performancës në punë.

Përgjegjësia për menaxhimin e strehëzave emergjente të ngritura pranë njërive të vetëqeverisjes vendore, është e këtyre të fundit, pra e bashkive. Bashkia duhet të sigurojë që shërbimet janë menaxhuar efektivisht dhe strehëza emergjente është e mbështetur financiarisht mjaftueshëm për të ofruar sigurinë e të mbijetuarave të dhunës dhe ofrimin e shërbimeve bazë, si: ushqim, veshje, shërbim psikologjik, ligjor, mjekësor, transport falas etj. Fondi social i bashkisë, mbështetja nga donatorë të ndryshëm, OJF, biznese lokale etj. janë disa nga burimet e financimit. Në bashkitë ku ekzistojnë strehëza emergjente që menaxhohen nga organizata të shoqërisë civile, pushteti vendor mund të kontrakttojë OJF-të lokale për ofrimin e këtij shërbimi. Ndërkohë që anëtarët e mekanizmit të referimit janë, gjithashtu, përgjegjës për sigurimin e shërbimeve të tilla, si: shërbimi psikologjik, mjekësor, ligjor etj., këto përgjegjësi saktësohen në një marrëveshje specifike të nënshkruar nga anëtarët për mirëfunksionimin e strehëzës emergjente. Shërbimi social shtetëror harton dokumentacionin tip për përfituesin/et e shërbimeve shoqërore në strehëzat emergjente për gratë, viktimat të dhunës me bazë gjinore e të dhunës në familje. Bashkia duhet të marrë masa dhe të sigurojë një minimum të stafit që duhet të jetë në dispozicion në momentin e akomodimit të një të mbijetuarit/e të dhunës me bazë gjinore apo të dhunës në familje në strehëz. Minimalisht duhet të llogaritet **qëndrimi/shoqërimi i të së mbijetuarës nga një punonjës/e i/e specializuar për këtë qëllim, përgjatë gjithë kohës së qëndrimit të së mbijetuarës në strehëzën emergjente, si dhe me tri turne (pra përgjatë gjithë harkut kohor 24-orësh).** Pra, viktimat/e mbijetuarat nuk mund të lihet vetëm në strehëzën e emergjencës dhe pa shoqërimin/mbikëqyrjen e një punonjësi/eje të specializuar. Bashkia mund ta sigurojë këtë shërbim, si përmes burimeve të veta dhe të kontraktimit të punonjësit/eve të specializuar/a për këtë qëllim, ashtu edhe përmes bashkëpunimit me OJF-të e specializuara që ofrojnë shërbime kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje (duke e blerë/prokuruar këtë shërbim). Po kështu, duhet të merren masa që të sigurohet edhe staf për kujdesin mjekësor, juridik etj., sipas nevojës të së mbijetuarës. Në rast të pranishmërisë së fëmijëve duhet të merren masa për të pasur të pranishëm edhe një specialist/e për trajtimin dhe mbështetjen psikosociale të fëmijëve të dhunuar. Këto shërbime mund dhe duhet të sigurohen në bashkëpunim dhe me institucione e organizata të tjera përgjegjëse dhe mund të jenë shërbime me kontratë e kohë të pjesshme. Kështu, shërbimi psikologjik falas për të miturit e dhunuar mund të sigurohet

nëpërmjet: bashkëpunimit me urdhrin e psikologut⁵⁴, psikologëve, anëtarë të stafit të specializuar në bashki, bashkëpunimit me psikologin e shkollave ose psikologe të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë këto shërbime të specializuara dhe falas. Edhe bashkëpunimi me urdhrin e punonjësve socialë⁵⁵ është i një rëndësie të veçantë. Gjithashtu, duhet të respektohet dhe e drejta e të pyeturit të viktimës/të së mbijetuarës nëse dëshiron që shërbimi t'i ofrohet patjetër nga një punonjëse grua. Anëtarë/et e stafit të strehëzës emergjente do të jetë/jenë përgjegjës/e për sigurinë e të së mbijetuarës së dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe fëmijëve të saj, si edhe ofrimin e shërbimeve me cilësinë e duhur nga një staf mbështetës dhe i mirëtrajnuar. Stafi i strehëzës emergjente ka një kulturë besimi dhe respekti ndaj të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje të akomoduar në strehëzën emergjente. Stafi trajnohet nga Shërbimi Social Shtetëror. Drejtori/ja/përgjegjësi/ja e Zyrës së Shërbimeve Sociale në bashki dhe shërbimi social monitorojnë dhe vlerësojnë shërbimet bazuar në standardet e miratuara dhe në vlerësim përfshijnë edhe mendimin e përfituesit/eve. Inspektorati i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror ka detyrën të kontrollojë zbatimin e kritereve dhe të kushteve, të inspektojë standardet e shërbimeve të ofruara dhe të përmbushë funksionet dhe kompetencat e përcaktuara në nenin 35, të ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Ambienti i strehëzës emergjente duhet të jetë një ambient i përshtatshëm dhe miqësor për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje dhe të fëmijëve të tyre, me qëllim që të ndihmojë për rikuperimin e eksperiencave traumatike. Fëmijët (djem dhe vajza) që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç të shoqëruar/a apo me lejen me shkrim nga një nga prindërit e tyre ose kujdestari/ja ligjor/e, apo me UPMM, do të mund të përfitojnë shërbime të sigurta gjatë kohës së qëndrimit në strehëzën emergjente. Në rastet kur fëmijët janë përfitues të shërbimeve të ofruara në strehëzat emergjente, stafi i strehëzave ka detyrimin të garantojë të gjitha të drejtat e fëmijëve dhe të përmbushë përgjegjësitë që burojnë nga ligji. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Fëmijët 0–18 vjeç të dhunuar në familje, të shoqëruar nga nëna ose të pashoqëruar nga prindërit, të identifikuar nga strukturat përgjegjëse si viktimat të dhunës në familje përfitojnë shërbime në strehëzat emergjente. Në rast të prindërve abuzues, atëherë akomodimi i fëmijës në strehëzën emergjente bëhet me miratimin me shkrim të Drejtorisë së Shërbimeve Shoqërore në bashki. Drejtori i strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore është përgjegjës për marrjen e vendimit për masat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në propozimin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijës dhe të grupit teknik ndërsektorial, siç parashikohet në ligjin nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Pranimi i viktimave të mitur në strehëzën emergjente shoqërohet me kryerjen e një raporti vlerësimi psikosocial për të mbijetuarin/ën e mitur.

Akomodimi i fëmijës në strehëzën emergjente, në këto raste, mund të bëhet edhe me UPMM-në e lëshuar kryesisht nga organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit. Organet përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pranë Policisë së Shtetit, kur vlerësojnë se dhuna ushtrohet ndaj fëmijëve, marrin masa të menjëhershme për ndalimin e dhunës dhe, kryesisht, nxjerrin urdhrin paraprak të mbrojtjes së menjëhershme, UPMM, i cili mund të përfshijë edhe masën e vendosjes së të miturit në strehëzën emergjente.

Nëse strehëza emergjente ka shtretër apo hapësira të kufizuara, të tilla që nuk mund të akomodohen njëkohësisht disa viktimat (pra ka më shumë trajtën e një dhome emergjente) dhe nuk janë miqësore për viktimat/të mbijetuar të mitur, atëherë punonjësit/et e strehëzës emergjente duhet të marrin masa që rastin ta strehojnë në një strehëz tjetër lokale apo kombëtare. Stafi i strehëzës emergjente duhet të ofrojë ose referojë fëmijët në shërbime të specializuara për fëmijë të mbijetuar të dhunës në familje ose që kanë asistuar në skena dhune mes anëtarëve të familjes së tyre.

Bashkia, si ofruese e këtij shërbimi për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, miraton një procedurë për ruajtjen e fshehtësisë së vendit të strehëzës emergjente, me

⁵⁴ Ligji nr. 40/2016, “Për urdhrin e psikologut në Republikën e Shqipërisë”, neni 12.

⁵⁵ Ligji nr. 163/2014, “Për urdhrin e punonjësve socialë në Republikën e Shqipërisë”.

qëllim sigurimin e jetës së viktimave dhe stafit të strehëzës. Po kështu, ajo merr të gjitha masat për planifikimin e burimeve të duhura financiare e njerëzore për vazhdimësinë e shërbimit të strehimit emergjent, si dhe kompletimin e tij me më shumë burime në dispozicion, qoftë përmes sigurimit të bashkëpunimit të qëndrueshëm me aktorët e tjerë në nivel vendor dhe qendror, qoftë edhe nëpërmjet përfshirjes së këtij grupi shpenzimesh, si pjesë e planeve buxhetore të bashkisë. Në rastin e strehëzave emergjente, çdo strehëz emergjente duhet të ketë një dhomë të veçantë të vlefshme për nënat me fëmijë, të cilat janë viktimat të abuzimit dhe të dhunës me bazë gjinore e të dhunës në familje. Pajisjet kryesore që duhet të përmbajë një strehëz emergjente përfshijnë, por nuk kufizohen, në: shtretër për të rritur dhe fëmijë, çarçafë, jorganë dhe jastëkë, pajisje kuzhine (për gatim dhe ngrënie), pajisje lavanderie (lavatriçe, detergjentë, tharëse, hekur etj.), tavolinë dhe karrige për t'u ulur për të ngrënë apo për të bërë fëmijët detyrat, televizor, frigorifer, dollap, abazhur, lodra për fëmijë, libra dhe informacion për të rritur etj. Po kështu, është mirë që strehëza të jetë e pajisur me sete të ndihmës emergjente që sigurojnë minimumin e veshjes dhe të kujdesit vetjak, si dhe me ushqime që mund të përdoren dhe gatohen në çdo kohë. Rregullat në lidhje me mirëmbajtjen e pajisjeve dhe përdorimin e tyre, veprimet në rast zjarri etj., publikohen në ambientet e strehëzës emergjente. Po këtu, publikohet edhe numri i telefonit të shërbimit të policisë dhe atij zjarrfikës.

STANDARDI 7

Monitorimi dhe vlerësimi.

Rezultati i dëshiruar

Të garantohen shërbime të cilësisë së lartë përmes monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të punës.

STANDARDI 7.1

Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent ofron shërbime cilësore për viktimat/të mbijetuarit/at e dhunës në familje, edhe përmes procesit të monitorimit, vlerësimit dhe mësimi.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të ketë strukturën e vet së cilës t'i jetë ngarkuar detyra e monitorimit dhe e vlerësimit të brendshëm, duke mbajtur në konsideratë standardet e cilësisë së shërbimeve që duhen përmbushur.	7.1.1 Personat përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin janë të identifikuar në organigramë dhe përshkrimet e punës. 7.1.2 Procedura e monitorimit dhe e vlerësimit të kryer, e dokumentuar hap pas hapi.	- Është mirë të tregohet gjithmonë kujdes për zhvillimet në fushën e udhëzimeve për praktikatat më të mira dhe synimet e sigurisë, vetëmjaftueshmërisë dhe fuqizimit.

STANDARDI 8

Qasja e koordinuar shumësektoriale dhe bashkëpunimi midis aktorëve në nivel vendor.

Rezultati i dëshiruar

Të garantohet ofrimi i shërbimeve dhe trajtimi i rasteve në mënyrë të koordinuar dhe përmes aplikimit të qasjes shumësektoriale dhe të bashkëpunimit të aktorëve në nivel vendor.

STANDARDI 8.1

Shërbimet që ofrohen në strehëzën emergjente marrin në konsideratë dhe aplikojnë qasjen e koordinuar shumësektoriale dhe parimin e bashkëpunimit, duke ndjekur modelin e mekanizmit të referimit dhe trajtimit të rasteve të ngritur në nivel vendor.

KRITERET	TREGUESI	UDHËZIMET
- Ofruesi i shërbimit të strehimit emergjent të aplikojë tërësinë e shërbimeve të parashikuara, bazuar në qasjen shumësektoriale të koordinuar (në përputhje me filozofinë e mekanizmit të referimit, të ngritur në nivel vendor) .	8.1.1 Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve në nivel vendor për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, e nënshkruar dhe me strehëzën emergjente të përfshirë si anëtare të këtij mekanizmi.	- Identifikimi i institucioneve dhe i aktorëve përgjegjës në nivel vendor, të cilët do të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit për mekanizmin e referimit dhe do të trajtojnë rastet sipas qasjes shumësektoriale, të bëhet bazuar në përmbajtjen e ligjit dhe të VKM-së respektive.

- E gjithë veprimtaria e strehëzës emergjente do të përshkohet nga përgjegjësia ligjore e koordinimit të veprimeve dhe e zbatimit të qasjes së koordinuar shumësektoriale me anëtarë të tjerë të mekanizmit të referimit dhe të trajtimit të rasteve të dhunës në familje në nivel bashkie. Po kështu, në këtë shërbim do të mbahen në konsideratë të gjitha parimet e ofrimit të shërbimeve sipas qasjes së koordinuar shumësektoriale, të cilat fillojnë që nga vendosja e viktimës/të së mbijetuarës në qendër të shërbimeve, ofrimi i sigurisë dhe i privatësisë, shërbime të koordinuara e cilësore të ofruara në kohë e me efektivitet, vendosja e dhunuesit përpara përgjegjësisë, trajtimi me kujdes dhe sipas nevojës në terma urgjentë, afatmesëm e afatgjatë, mundësia e marrjes së vendimeve në bazë të informacionit të përditësuar mbi të drejtat e detyrimet e viktimave/të mbijetuarave dhe shërbimet në dispozicion të tyre, trajtimi në një mjedis që siguron respekt, dinjitet e ndjeshmëri, si dhe sfidimi i tolerancës ndaj dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Shoqërimi i viktimës të strehëza emergjente do të bëhet nga një punonjës/e i/e policisë dhe/ose koordinatori/ja vendor/e, kur rasti është identifikuar nga anëtarët e mekanizmit të referimit. Punonjësja sociale, pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, mund të referojë rastin për akomodim në strehëzën emergjente. Viktimat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë viktimat e dhunës në familje, mund të paraqiten edhe vetë në ambientet e bashkisë, pasi kanë marrë informacion për funksionimin dhe shërbimet e strehëzës emergjente. Në këtë rast, përgatitet nga stafi i strehëzës emergjente një raport vlerësimi i situatës dhe i nevojave të viktimës/të së mbijetuarës nga dhuna me bazë gjinore. Në rastet kur një grua e dhunuar me fëmijët e saj vetëreferohen dhe kërkojnë akomodim, pasi ka marrë informacion nga media, stafi i strehëzës komunikon me SPZ-në e lagjes apo të fshatit, me koordinatoren vendore kundër dhunës në familje, për të marrë më shumë informacion rreth rastit, si edhe me policinë për vlerësimin e riskut dhe marrjen e një urdhri për masa paraprake të menjëhershme të mbrojtjes.

E RËNDËSISHME

PËR NJË FUNKSIONIM SA MË TË MIRË DHE MË EFICIENT TË STREHËZËS EMERGJENTE, DUHET TË MERREN NË KONSIDERATË DHE TË PËRSHTATEN APO TË APLIKOHEN FORMULARËT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT, KRITERET E PRANIMIT, FORMULARËT E VLERËSIMIT ETJ., SIÇ APLIKOHEN NË RASTIN E SHËRBIMIT TË STREHIMIT AFATGJATË.

Standardet e miratuara do të shoqërohen me një udhëzues për bashkitë, lidhur me administrimin e strehëzave. Në rast të evidentimit të problemeve në zbatimin e standardeve në praktikë, do të kryhet rishikimi i tyre.

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 9, datë 17.6.2020

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR KRIJIMIN E NJË BAZE TË DHËNASH TË POSAÇME PËR ÇËSHTJET E DHUNËS NË FAMILJE NË GJYKATA DHE UNIFIKIMIN E REGJISTRIMIT TË TYRE

(ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 17.6.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të germës “ç”, të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor

UDHËZOJNË:

1. Ky udhëzim përcakton rregulla për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata, subjektet që kanë detyrimin e popullimit të kësaj baze të dhënash, unifikimin e regjistrimit të tyre, si dhe mënyrën e përdorimit dhe të aksesit në to.

2. Baza e të dhënave të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata ka për qëllim:

a) pasqyrimin dhe gjenerimin e të dhënave për çështjet e dhunës në familje, si dhe për ekzekutimin e tyre;

b) unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon harmonizimin e të dhënave gjyqësore me ato të gjeneruara nga institucionet e tjera të parashikuara nga ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”;

c) përmirësimin periodik të bazës së të dhënave për të siguruar zbatimin e kërkesave që burojnë nga ndryshimi i legjislacionit përkatës ose nga ndryshimet në institucionet, që në bazë të ligjit në fuqi bashkërendojnë veprimtarinë e tyre kundër dhunës në familje;

ç) ofrimi i informacionit në kohën më të shpejtë për rastet me objekt gjykimi nga baza e të dhënave sipas këtij udhëzimi.

3. Të dhënat e ofruara nga gjykatat gjenerohen në përputhje me elementet që vendosen në këtë udhëzim, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Baza e të dhënave përmban këto elemente:

a) gjinia;

b) mosha;

c) statusi civil;

ç) niveli arsimor;

d) statusi i punësimit;

dh) lidhja familjare me dhunuesin;

e) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga vetë viktimat;

ë) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës;

f) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga prokuroria;

g) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/urdhër mbrojtjeje nga policia;

gj) kërkesë për vlerësimin e masave paraprake të mbrojtjes së menjëhershme nga policia;

h) kërkesë për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje nga subjekte të tjera (personi me të cilin viktimat ka marrëdhënie familjare; përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë bashkisë, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimat, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje etj.); kërkesë për urdhër mbrojtjeje të të miturit nga policia/prokuroria;

i) kërkesë për urdhër mbrojtjeje të të miturit nga subjekte të tjera (prindi ose kujdestari i të miturit; përfaqësuesi ligjor ose avokati i viktimës; të afërmit; përfaqësuesit e Zyrës së Shërbimeve Sociale pranë bashkisë, ku ka banimin e përhershëm apo të përkohshëm viktimë, që kanë dijeni për ushtrimin e dhunës; qendrat dhe shërbimet për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, të njohura/licencuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje; personat ligjërisht përgjegjës për fëmijët etj.);

j) kërkesa për ndryshimin, ndërprerjen ose vazhdimin e urdhrit të mbrojtjes;

k) urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, së viktimës të lëshuar me vendim gjykatë (gjykata e rrethit gjyqësor);

l) ankim ndaj urdhrit të mbrojtjes/urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

ll) vendim i gjykatës së apelit për lënien në fuqi/ndryshimin e vendimit për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes/urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes;

m) urdhra të mbartur; vendime të mëparshme të gjykatës lidhur me viktimën apo vendime për ndryshimin apo pezullimin e urdhrit të mbrojtjes;

n) kallëzim penal ndaj dhunuesit/es ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, për vepra penale në lidhje me dhunën në familje;

nj) vendim i gjykatës penale për dhunuesin/en ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes për vepra penale, në lidhje me dhunën në familje;

o) kallëzim penal ndaj dhunuesit/es, ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes për veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës;

p) vendim i gjykatës penale për dhunuesin/en ndaj të/së cilit/ës është kërkuar ose është lëshuar urdhri i mbrojtjes/urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, për vepra penale, në lidhje me veprime të kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës;

q) gjendja e ekzekutimit të urdhrit të mbrojtjes/urdhrit të menjëhershëm i mbrojtjes nga zyra e përmbarimit/zyra e përmbarimit në bashkëpunim me organe të tjera shtetërore (policia, bashkia etj.).

5. Subjektet, që kanë detyrimin e popullimit të kësaj baze të dhënash, janë:

a) kancelarët e gjykatave të rretheve gjyqësore;

b) kancelarët e gjykatave të apelit.

6. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës:

a) për gjenerimin e informacioneve statistikore të marra nga sistemi elektronik i teknologjisë së informacionit për të dhënat e dhunës në familje. Krijon akses të plotë për Ministrinë e Drejtësisë në të dhënat statistikore që rezultojnë nga sistemi i menaxhimit të çështjeve të dhunës në familje, të trajtuara nga gjykatat nëpërmjet kancelarëve;

b) për saktësinë e sigurinë e të dhënave, për mbrojtjen e të dhënave personale të përdorura dhe të ruajtura nga sistemi, si dhe për përbushjen e detyrave të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

c) Nxitjen e sekretarëve gjyqësorë në plotësimin e të gjithë informacionit të nevojshëm.

7. Detyrat e gjykatave dhe të kancelarit:

a) gjykatat e rretheve gjyqësore dhe ato të apelit japin të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë bazë të dhënash;

b) kancelari i gjykatës i siguron Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore, sipas formularëve, brenda datës 20 të muajit të dytë pasardhës për periudhën 3-mujore (tremujore), si dhe brenda datës 20 shkurt për të dhënat vjetore;

c) Kancelari koordinon punën me sekretarët gjyqësorë për të siguruar që të dhënat të jenë të plota dhe të sakta dhe i përcjell ato pranë strukturës përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë në format elektronik dhe shkresor.

8. Detyrat e Ministrisë së Drejtësisë:

a) harton një formular të posaçëm dhe të unifikuar me të dhëna që shërbejnë për regjistrimin e

çështjeve të dhunës në familje, sipas modelit të formularëve që gjenden bashkëlidhur;

b) kryen përpunimin e të dhënave statistikore për dhunën në familje mbi bazën e formularëve që dërgohen nga kancelari i gjykatave;

c) analizon të dhënat statistikore për dhunën në familje dhe i publikon në vjetarin statistikor;

ç) bashkëpunon me institucionet e tjera përgjegjëse për harmonizimin e këtyre të dhënave me të dhëna që gjenerohen prej tyre, në zbatim të legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

9. Autoritetet përgjegjëse për monitorimin dhe për zbatimin e këtij udhëzimi janë Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë.

10. Deri në krijimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit, grumbullimi dhe plotësimi i të dhënave për dhunën në familje do të plotësohen në format *Excel*, sipas formularëve bashkëlidhur këtij udhëzimi.

11. Ngarkohet Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor për njoftimin dhe për komunikimin e këtij udhëzimi pranë gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË

Etilda Gjonaj (Saliu)

KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Naureda Llagami

Formular nr. 1

(ndryshuar me udhëzimin nr. 7, datë 17.6.2020)

Formulari nr. 1

Ligji 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithësej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Neni	1	2	3	4	5	6	7
Vendime sipas Nenit 10							
Subjekte sipas Nenit 13							

Ligji 9669	Urdhëra mbrojtje	Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje	Gjithësej	Pranim i kërkesës	Pushimi i gjykimit	Rrëzimi i kërkesës	Shkelje e urdhërit të mbrojtjes
Neni 10, pikë 1	1	2	3	4	5	6	7
Pika 1.a							
Pika 1.b							
Pika 1.c							
Pika 1.ç							
Pika 1.d							
Pika 1.dh							
Pika 1.e							
Pika 1.ë							
Pika 1.f							
Pika 1.g							
Pika 1.gj							
Pika 1.h							
Pika 1.i							
Pika 1.j							
Pika 1.k							
Pika 1.l							
Pika 1.ll							
Pika 1.m							
Pika 1.m/1							
Neni 13	1	2	3	4	5	6	7
Pika 1.a							
Pika 1.b							
Pika 1.c							
Pika 2.a							
Pika 2.b							
Pika 2.c							
Pika 2.ç							
Pika 2.d							
Pika 2.dh							
Pika 2.e							
Pika 3.a							
Pika 3.b							
Pika 3.c							
Pika 3.ç							
Pika 3.d							
Pika 3.dh							

Formular nr. 2

Formular nr. 2							
TE DHËNAT STATISTIKORE PËR DHUNËN NË FAMILJE PËR VITIN 20							
VENDBANIMI	Qytet	Periferi	Fshat				
MOSHA	0-15	16-18	19-25	26-35	36-45	46-55	55+
GJINIA	Femër	Mashkull					
STATUSI CIVIL	Beqar/e	Martuar	Divorcuar	Bashkëjetesë	i/e ve		
NUMRI I FËMIJËVE	Asnjë	1 fëmijë	2 fëmijë	3 fëmijë	4+		
NIVELI ARSIMOR	Pa shkollë	Fillore (1-4 klasë)	9-vjeçare (1-9 klasë)	I mesëm	I lartë		
STATUSI I PUNËSIMIT	I papunë	I punësuar në sektorin publik	I punësuar në sektorin privat	I vetëpunësuar	Studente	Nxënëse	Pensionist
KËRKESË PËR URDHËR MBROJTJEJE	Pranuar	Hedhur poshtë	Pushuar				
LIDHJA FAMILJARE ME DHUNUESIN	Bashkëshorti/ja	Motra	Vëllai	Fëmija	Prindi	Të tjerë	
KËRKESË NGA PËRFAQËSUESI LIGJOR							
KËRKESË NGA PROKURORIA							
KËRKESË NGA POLICIA							
KËRKESË NGA BASHKITË, QËNDRA Të SOCIALE etj.							
KËRKESË PËR NDRYSHIM OSE NDËRPRERJE TË URDHËRIT TË MBROJTJES							
Kancelari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor							

LIGJ
Nr. 104/2012

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS “PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.11.2012

Shpallur me dekretin nr. 7821, datë 19.11.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KONVENTA
E KËSHILLIT TË EUROPËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E
DHUNËS KUNDËR GRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE

[Stamboll, 11.5.2011]

Hyrje

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe shtetet e tjera nënshkruese të kësaj Konvente,
duke rikujtuar Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (ETS nr. 5, 1950) dhe protokollet e saj, Kartën Sociale Europiane (ETS nr. 35, 1961, të rishikuar në 1996, ETS nr. 163), Konventën e Këshillit të Europës mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore (CETS nr. 197, 2005) dhe Konventën e Këshillit të Europës mbi mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (CETS nr. 201, 2007);

duke rikujtuar rekomandimet e mëposhtme të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare të Këshillit të Europës: rekomandimin Rec (2002)5 mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, rekomandimin CM/Rec (2007)17 mbi standardet dhe mekanizmat e barazisë gjinore, rekomandimin CM/Rec (2010)10 mbi rolin e burrave dhe grave në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes dhe rekomandime të tjera përkatëse;

duke marrë parasysh numrin në rritje të praktikave gjyqësore të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila cakton standarde të rëndësishme në fushën e dhunës kundër grave;

duke pasur parasysh marrëveshjen ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike (1966), Konventën ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (1966), Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave ("CEDAW", 1979) dhe protokollin e saj opsional (1999), si dhe rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 të Komitetit CEDAW mbi dhunën kundër grave, Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijëve (1989) dhe protokollet e saj opsionale (2000) dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (2006);

duke pasur parasysh Statutin e Romës të Gjykatës Ndërkombëtare Penale (2002);

duke rikujtuar parimet bazë të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe, veçanërisht Konventën e Gjenevës (IV) në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë lufte (1949) dhe protokollet e saj shtesë I dhe II (1977);

duke dënuar të gjitha format e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

duke pranuar se realizimi i barazisë *de jure* dhe *de facto* midis burrave dhe grave është një element kyç në parandalimin e dhunës kundër grave;

duke pranuar se dhuna kundër grave është manifestim i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, që kanë çuar në dominim dhe diskriminim të grave nga burrat dhe kanë penguar përparimin e plotë të grave;

duke pranuar natyrën strukturore të dhunës kundër grave, si dhunë gjinore dhe se dhuna kundër grave është një prej mekanizmave thelbësorë socialë, me të cilin gratë janë të detyruara të vendosen në një pozicion varësie në krahasim me burrat;

duke pranuar me shqetësim të thellë se gratë dhe vajzat janë shpesh të ekspozuara ndaj formave serioze të dhunës, si për shembull: dhuna në familje, ngacmimi seksual, përdhunimi, martesë e detyruar, krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit "nder" dhe gjymtimi i organeve gjinitale, që përbën shkelje të rëndë të të drejtave të grave dhe vajzave dhe pengesë kryesore për arritjen e barazisë midis burrave dhe grave;

duke pranuar shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut gjatë konflikteve të armatosura që prekin popullsinë civile, veçanërisht gratë, në formën e një përdhunimi të përhapur ose sistematik dhe dhunës seksuale dhe mundësisë për rritje të dhunës gjinore, si gjatë edhe pas konflikteve;

duke pranuar se gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat ndaj një rreziku më të lartë të dhunës gjinore;

duke pranuar se dhuna në familje prek gratë në mënyrë disproporcionale edhe se burrat, gjithashtu, mund të jenë viktimë të dhunës në familje;

duke pranuar se fëmijët janë viktimë të dhunës në familje, përfshirë rastet si dëshmitarë të dhunës në familje;

duke aspiruar të krijojnë një Europë pa dhunë kundër grave dhe pa dhunë në familje, kanë rënë dakord si më poshtë:

KAPITULLI I

QËLLIMET, PËRKUFIZIMET, BARAZIA DHE MOSDISKRIMINIMI, DETYRIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimet e Konventës

1. Qëllimet e kësaj Konvente janë:

a) mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimi, ndjekja penale dhe eliminimi i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

b) kontributi ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimi i barazisë thelbësore midis burrave dhe grave, duke përfshirë mënyrat me anë të fuqizimit të grave;

c) hartimi i një kuadri gjithëpërfshirës politikash dhe masash për mbrojtjen dhe ndihmën për të gjitha viktimat e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

d) nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar, me synim eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje;

e) ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

2. Me qëllim garantimin e zbatimit efektiv të dispozitave të saj nga palët, kjo Konventë krijon një mekanizëm specifik monitorimi.

Neni 2

Objekti i Konventës

1. Kjo Konventë zbatohet për të gjitha format e dhunës kundër grave, duke përfshirë dhunën në familje, e cila prek gratë në mënyrë disproporcionale.

2. Palët inkurajohen të zbatojnë këtë Konventë për të gjitha viktimat e dhunës në familje. Palët i kushtojnë vëmendje të veçantë grave viktimë të dhunës gjinore, në zbatim të dispozitave të kësaj Konvente.

3. Kjo Konventë zbatohet në kohë paqeje dhe në situata konflikti të armatosur.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Konvente:

a) “Dhunë kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private;

b) “Dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve, ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;

- c) “Gjini” nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për burrat dhe gratë;
- d) “Dhunë gjinore kundër grave” nënkupton dhunën që drejtohet kundër një gruaje për faktin se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale;
- e) “Viktimë” nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat “a” dhe “b”;
- f) “Gra” përfshin vajzat nën moshën 18 vjeç.

Neni 4

Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të promovuar dhe mbrojtur të drejtën për çdokënd, veçanërisht gratë, për të jetuar pa dhunë në sferën publike, si dhe në atë private.
2. Palët dënojnë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe marrin pa vonesë masat legislative dhe masa të tjera të nevojshme për t’i parandaluar, veçanërisht me anë të:
 - shprehjes së parimit të barazisë midis burrave dhe grave në kushtetutat e tyre kombëtare ose në ndonjë legjislacion tjetër përkatës, duke garantuar realizimin praktik të këtij parimi;
 - ndalimit të diskriminimit kundër grave, veçanërisht nëpërmjet ushtrimit të sanksioneve, sipas rastit;
 - shfuqizimit të ligjeve dhe praktikave që diskriminojnë gratë.
3. Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.
4. Masat e veçanta që janë të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna gjinore nuk konsiderohen diskriminim sipas kushteve të kësaj Konvente.

Neni 5

Detyrimet e shtetit dhe masat paraprake

1. Palët i shmangen përfshirjes në akte dhune kundër grave dhe garantojnë që autoritetet shtetërore, zyrtarët, agjentët, institucionet dhe aktorë të tjerë që veprojnë në emër të shtetit, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim.
2. Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë joshtetërorë.

Neni 6

Politikat me ndjeshmëri gjinore

Palët marrin përsipër të përfshijnë një perspektivë gjinore në zbatimin dhe vlerësimin e ndikimit të dispozitave të kësaj Konvente dhe të nxisin dhe të zbatojnë në mënyrë efektive politikat e barazisë midis burrave dhe grave, dhe fuqizimin e grave.

KAPITULLI II

POLITIKAT E INTEGRUARA DHE MBLEDHJA E TË DHËNAVE

Neni 7

Politikat gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të miratuar dhe për të zbatuar politika mbarëkombëtare efektive, gjithëpërfshirëse dhe të bashkërenduara që përfshijnë të gjitha masat përkatëse për të parandaluar dhe për të luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe që ofrojnë reagim holistik ndaj dhunës kundër grave.

2. Palët garantojnë që politikat e përmendura në paragrafin 1 të vendosin të drejtat e viktimës në qendër të të gjitha masave dhe të zbatohen me anë të bashkëpunimit efektiv ndërmjet të gjitha agjencive, institucioneve dhe organizatave përkatëse.

3. Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë, sipas rastit, të gjithë aktorët përkatës, si për shembull: agjencitë shtetërore, parlamentet dhe autoritetet kombëtare, rajonale dhe vendore, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile.

Neni 8

Burimet financiare

Palët shpërndajnë burimet e përshtatshme financiare dhe njerëzore për zbatimin e duhur të politikave, masave dhe programeve të integruara për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato që janë kryer nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile.

Neni 9

Organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile

Palët pranojnë, nxisin dhe mbështesin, në të gjitha nivelet, punën e organizatave përkatëse joqeveritare dhe të shoqërisë civile, aktive në luftën e dhunës kundër grave dhe krijimin e bashkëpunimit efektiv me këto organizata.

Neni 10

Organi bashkërendues

1. Palët caktojnë ose krijojnë një ose më shumë organe zyrtare përgjegjëse për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga kjo Konventë. Këto organe bashkërendojnë mbledhjen e të dhënave të përmendura në nenin 11, si dhe analizojnë dhe publikojnë rezultatet e tyre.

2. Palët garantojnë që organet e caktuara ose të krijuara sipas këtij neni të marrin informacion të një natyre të përgjithshme mbi masat e marra sipas kapitullit VIII.

3. Palët garantojnë që organet e caktuara ose të krijuara sipas këtij neni të kenë aftësinë për të komunikuar drejtpërdrejt dhe për të forcuar marrëdhëniet me homologët e tyre të palët e tjera.

Neni 11

Mbledhja dhe kërkimi i të dhënave

1. Për qëllim të zbatimit të kësaj Konvente, palët marrin përsipër:

a) të mbledhin të dhëna përkatëse të zbërthyera statistikore, në intervale të rregullta kohore, në lidhje me rastet e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente;

b) të mbështesin kërkimin në fushën e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, me qëllim shqyrtimin e arsyeve fillestare dhe pasojave, niveleve të shpeshhtësisë dhe dënimit, si dhe efikasitetit të masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

2. Palët përpiqen të kryejnë studime të bazuara në popullsi, në intervale të rregullta kohore, për të vlerësuar shpeshhtësinë dhe tendencat në të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

3. Palët sigurojnë grupin e ekspertëve të përmendur në nenin 66 të kësaj Konvente, me informacionin e mbledhur sipas këtij neni, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe mundësimin e vlerësimit krahasues ndërkombëtar.

4. Palët garantojnë që informacioni i mbledhur sipas këtij neni t'i vihet në dispozicion publikut.

KAPITULLI III PARANDALIMI

Neni 12

Detyrimet e përgjithshme

1. Palët marrin masat e nevojshme për të promovuar ndryshime në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes së grave dhe burrave, me synim çrrënjosjen e paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera që bazohen në idenë e inferioritetit të grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente nga çdo person fizik ose juridik.

3. Çdo masë e marrë sipas këtij kapitulli merr në konsideratë nevojat specifike të personave pa mbrojtje për shkak të rrethanave të veçanta dhe i japin prioritet të drejtave të të gjitha viktimave.

4. Palët marrin masat e nevojshme për të inkurajuar të gjithë anëtarët e shoqërisë, veçanërisht burrat dhe djemtë, që të kontribuojnë në mënyrë aktive në parandalimin e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

5. Palët garantojnë që kultura, zakonet, feja, tradita ose i ashtuquajturit “nder” të mos konsiderohen si justifikim për çdo akt dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente.

6. Palët marrin masat e nevojshme për të promovuar programe dhe aktivitete për fuqizimin e grave.

Neni 13

Rritja e ndërgjegjësimit

1. Palët promovojnë ose realizojnë rregullisht dhe në të gjitha nivelet, fushata ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit, duke përfshirë ato në bashkëpunim me institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut dhe organet e barazisë, shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare, veçanërisht organizatat e grave, sipas rastit, për të rritur ndërgjegjësimin dhe perceptimin nga publiku i gjerë, në lidhje me manifestimet e ndryshme të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, pasojat e tyre për fëmijët dhe nevojën për të parandaluar një dhunë të tillë.

2. Palët garantojnë nivel të lartë shpërndarjeje për publikun e gjerë, të informacionit mbi masat e vëna në dispozicion për parandalimin e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 14

Arsimi

1. Sipas rastit, palët marrin hapat e nevojshëm për të përfshirë materiale mësimore mbi çështje, të tilla si: barazia midis burrave dhe grave, rolet gjinore të pastereotipizuara, respekti i ndërsjellë,

zgjidhja e konflikteve pa dhunë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhuna gjinore kundër grave dhe e drejta për integritet personal, të përshtatura me kapacitetin në zhvillim të nxënësve në programet mësimore zyrtare dhe në të gjitha nivelet arsimore.

2. Palët marrin hapat e nevojshëm për të promovuar parimet e përmendura në paragrafin 1 në mjediset informale arsimore, si dhe në mjedise sportive, kulturore dhe argëtuese dhe media.

Neni 15

Trajnimi i profesionistëve

1. Palët sigurojnë ose forcojnë trajnimin e duhur për profesionistët përkatës që merren me viktimat ose autorët e të gjitha akteve të dhunës të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, mbi parandalimin dhe zbulimin e një shkeljeje të tillë, barazinë midis burrave dhe grave, nevojat dhe të drejtat e viktimave, si dhe mënyrën e parandalimit të viktimizimit dytësor.

2. Palët inkurajojnë që trajnimi i përmendur në paragrafin 1 të përfshijë trajnim për bashkëpunimin e bashkërenduar midis shumë agjencive, për të lejuar një trajtim gjithëpërfshirës dhe të duhur të referimeve në rastet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 16

Ndërhyrja parandaluese dhe programet e trajtimit

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe që synojnë edukimin e autorëve të dhunës në familje që të përdorin një sjellje jo të dhunshme në marrëdhëniet ndërpersonale, me synim parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe ndryshimin e modeleve të dhunshme të sjelljes.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të krijuar ose mbështetur programe trajtimi që synojnë parandalimin e autorëve, veçanërisht autorëve të krimeve seksuale, nga përsëritja e veprës.

3. Në marrjen e masave të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, palët garantojnë që siguria, mbështetja dhe të drejtat e viktimave të jenë shqetësim parësor dhe, sipas rastit, këto programe të krijohen dhe të zbatohen në bashkërendim të ngushtë me shërbimet mbështetëse të specialistëve për viktimat.

Neni 17

Pjesëmarrja e sektorit privat dhe medias

1. Palët nxisin sektorin privat, sektorin e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit dhe medias, në lidhje me lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e tyre, për të marrë pjesë në përpunimin dhe zbatimin e politikave dhe për të caktuar udhëzime dhe standarde vetërregullatore për parandalimin e dhunës kundër grave dhe rritjen e respektit për dinjitetin e tyre.

2. Palët zhvillojnë dhe promovojnë, në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat, aftësitë midis fëmijëve, prindërve dhe edukatorëve për mënyrën si të trajtojnë mjedisin e informacionit dhe komunikimit që ofron akses ndaj përmbajtjes degraduese të një natyre seksuale ose të dhunshme, e cila mund të ishte e dëmshme.

KAPITULLI IV MBROJTJA DHE MBËSHTETJA

Neni 18

Detyrimet e përgjithshme

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të mbrojtur të gjitha viktimat nga akte të mëtejshme dhune.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera në pajtim me ligjin e brendshëm, për të garantuar ekzistencën e mekanizmave të duhur për të parashikuar bashkëpunim efektiv midis të gjitha agjencive shtetërore përkatëse, duke përfshirë gjyqësorin, prokurorët publikë, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritetet vendore dhe rajonale, si dhe organizatat joqeveritare dhe organizata dhe ente të tjera përkatëse, në mbrojtje dhe mbështetje të viktimave dhe dëshmitarëve të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë ato me anë të referencës ndaj shërbimeve të përgjithshme dhe mbështetëse të specializuara, siç përcaktohen hollësisht në nenet 20 dhe 22 të kësaj Konvente.

3. Palët garantojnë që masat e marra sipas këtij kapitulli:

- të bazohen në një perceptim gjinor të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje dhe të fokusohen tek të drejtat e njeriut dhe siguria e viktimës;
- të bazohen në një përjasje të integruar, e cila merr parasysh marrëdhënien midis viktimave, autorëve të veprave penale, fëmijëve dhe mjedisit të tyre më të gjerë social;
- të synojnë shmangien e viktimizimit dytësor;
- të synojnë fuqizimin dhe pavarësinë ekonomike të grave, viktimat të dhunës;
- të lejojnë, sipas rastit, një gamë mbrojtjeje dhe shërbimesh mbështetëse që duhet të vendosen në të njëjtat ambiente;
- të trajtojnë nevojat specifike të personave të pambrojtur, duke përfshirë viktimat fëmijë dhe t'u vihen në dispozicion.

4. Sigurimi i shërbimeve nuk varet nga gatishmëria e viktimës për të ngritur akuza ose për të dëshmuar kundër një autori veprave penale.

5. Palët marrin masat e duhura për të ofruar mbrojtje konsullore dhe mbrojtje dhe mbështetje tjetër për shtetasit e tyre dhe viktimat të tjera që kanë të drejtën e kësaj mbrojtjeje, në përputhje me detyrimet e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare.

Neni 19

Informimi

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të marrin informacion të mjaftueshëm dhe në kohë, në një gjuhë që kuptojnë, në lidhje me shërbimet e disponueshme mbështetëse dhe masat ligjore.

Neni 20

Shërbimet e përgjithshme mbështetëse

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime, të tilla si: konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime sociale dhe në kujdes shëndetësor dhe që shërbimet të kenë burime të mjaftueshme dhe profesionistët të jenë trajnuar për të ndihmuar viktimat dhe për t'i drejtuar ata te shërbimet përkatëse.

Neni 21

Ndihma për ankesat individuale/kolektive

Palët garantojnë që viktimat të kenë informacion dhe akses në mekanizmat ndërkombëtarë të ankesave individuale/kolektive. Palët nxisin ofrimin e ndihmës sensitive dhe të specializuar për viktimat në paraqitjen e këtyre kërkesave.

Neni 22

Shërbimet mbështetëse të specializuara

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të siguruar ose caktuar, në një shpërndarje të mjaftueshme gjeografike, shërbime të menjëhershme, afatshkurtra dhe afatgjata mbështetëse të specializuara për çdo viktimë që i nënshtrohet një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente.

2. Palët sigurojnë ose caktojnë shërbime mbështetëse të specialisteve femra për të gjitha gratë, viktimat të dhunës dhe fëmijët e tyre.

Neni 23

Strehët

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e strehëve të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme e në numër të mjaftueshëm, për të ofruar strehim të sigurt dhe për të përdorur përjasje proaktive ndaj viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre.

Neni 24

Linjat telefonike të ndihmës

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të vendosur linja telefonike falas të ndihmës mbarëkombëtare të pandërprerë (24/7) për të ofruar konsulencë për telefonuesit, fshehtësi ose respektim të anonimitetit të tyre, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

Neni 25

Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale

Palët marrin masa të nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e një numri të mjaftueshëm të qendrave referuese të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme për dhunën seksuale ose krizën nga përdhunimi, për viktimat, për të parashikuar vizita mjekësore dhe mjekoligjore, mbështetje për traumat dhe këshillim për viktimat.

Neni 26

Mbrojtja dhe mbështetja për dëshmitarët fëmijë

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave, të merren në konsideratë të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2. Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë këshillimin e duhur psikosocial për dëshmitarët fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe marrin në konsideratë interesat më të mira të fëmijës.

Neni 27

Raportimi

Palët marrin masat e nevojshme për të inkurajuar çdo dëshmitar në kryerjen e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente ose që ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ky akt mund të kryhet, ose që priten akte të mëtejshme dhune, të njoftojë organizatat ose autoritetet kompetente.

Neni 28

Raportimi nga profesionistët

Palët marrin masat e nevojshme për të garantuar që rregullat e fshehtësisë të vendosura nga ligji i brendshëm mbi profesionistë të caktuar, sipas kushteve përkatëse, të mos pengojnë mundësinë e njoftimit të tyre pranë organizatave ose autoriteteve kompetente, nëse kanë arsye të mjaftueshme për të besuar se është kryer një akt i rëndë dhune i mbuluar nga objekti i kësaj Konvente dhe priten akte të mëtejshme të rënda dhune.

KAPITULLI V

LIGJI I SË DREJTËS DHE I DETYRIMEVE

Neni 29

Paditë civile dhe mjetet ligjore

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autorit të veprës penale.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për t'u ofruar viktimave, në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, mjete ligjore të mjaftueshme civile kundër autoriteteve shtetërore që nuk kanë mundur të përmbushin detyrën e tyre për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre.

Neni 30

Kompensimi

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë të drejtë për të kërkuar kompensim nga autorët për çdo shkelje të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë.

2. Kompensimi i mjaftueshëm nga shteti, u jepet atyre që kanë pësuar dëme të rënda trupore ose dëme ndaj shëndetit, në shkallën që dëmi nuk mbulohet nga burime të tjera, si për shembull: masa për autorët e veprave penale, sigurimin ose masa sociale ose shëndetësore të financuara nga shteti. Kjo nuk pengon palët që të kërkojnë kthim për kompensimin e dhënë nga autori i veprës penale, për sa kohë që i kushtohet rëndësia e duhur sigurisë së viktimës.

3. Masat e marra sipas paragrafit 2 garantojnë dhënien e kompensimit brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Neni 31

Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtave të vizitave të fëmijëve, të merren në konsideratë incidentet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që ushtrimi i vizitave ose të drejta të tjera kujdestarie të mos rrezikojnë të drejtat dhe sigurinë e viktimës ose fëmijëve.

Neni 32

Pasojat civile të martesave të detyruara

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që martesat e detyruara të mund të jenë të pavlefshme, të anulohen ose zgjidhen pa barra të papërshtatshme financiare ose administrative të vendosura ndaj viktimës.

Neni 33

Dhuna psikologjike

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e dëmtimit të qëllimshëm të integritetit psikologjik të një personi nëpërmjet shtrëngimit ose kërcënimeve.

Neni 34

Sjelljet kërcënuese

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e përfshirjes së qëllimshme e të vazhdueshme në sjellje kërcënuese të drejtuar ndaj një personi tjetër, që i shkakton atij ose asaj frikë për sigurinë personale.

Neni 35

Dhuna fizike

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e kryerjes së qëllimshme të akteve të dhunës fizike kundër një personi tjetër.

Neni 36

Dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

- a) përfshirja në depërtim të detyruar vaginal, anal ose oral të një natyre seksuale, në trupin e një personi tjetër me pjesë trupore ose objekte;
- b) përfshirja me një person në akte të tjera të detyruara të një natyre seksuale;
- c) nxitja që një person tjetër të përfshihet me një person të tretë në akte të detyruara të një natyre seksuale.

2. Pëlqimi duhet të jepet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit të vlerësuar në kontekstin e rrethanave më të afërta.

3. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që dispozitat e paragrafit 1 të zbatohen edhe për aktet e kryera kundër ish-bashkëshortëve/partnerëve ose bashkëshortëve/partnerëve aktualë, të njohur nga ligji i brendshëm.

Neni 37

Martesa e detyruar

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin, detyrimin të qëllimshëm, të një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e tërheqjes së qëllimshme të një të rrituri ose fëmije për të shkuar në territorin e një pale ose shteti të ndryshëm nga ai ku ai ose ajo banon, me qëllim detyrimin e një të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë.

Neni 38

Gjymtimi i organeve gjenitale femërore

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

a) prerja, infibulimi ose kryerja e ndonjë gjymtimi tjetër për të tërë ose një pjesë të buzëve të mëdha, buzëve të vogla ose klitorit të gruas;

b) shtrëngimi ose kërkesa ndaj një gruaje që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën "a";

c) provokimi, shtrëngimi ose kërkesa ndaj një vajze që t'i nënshtrohet ndonjë prej akteve të renditura në pikën "a".

Neni 39

Aborti dhe sterilizimi i detyruar

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar dënimin e sjelljeve të mëposhtme të qëllimshme:

a) kryerja e abortit të një gruaje pa pëlqimin e saj paraprak;

b) kryerja e një operacioni kirurgjikal që ka qëllimin ose efektin e ndërprerjes së kapacitetit të një gruaje për të qenë riprodhuese në mënyrë natyrale, pa pëlqimin e saj paraprak ose kuptimin e procedurës.

Neni 40

Ngacmimi seksual

Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, t'i nënshtrohet një sanksioni penal ose sanksioni tjetër ligjor.

Neni 41

Dhënia e ndihmës ose bashkëpunimi dhe tentativa

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar si veprë penale, kur kryhet qëllimisht, dhënien e ndihmës ose bashkëpunimin për kryerjen e veprave penale të përcaktuara në pajtim me nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të kësaj Konvente.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të përcaktuar si vepra penale, kur kryhen qëllimisht, tentativat për të kryer veprat penale të përcaktuara në pajtim me nenet 35, 36, 37, 38.a dhe 39 të kësaj Konvente.

Neni 42

Justifikimet e papranueshme për krime, duke përfshirë krimet e kryera në emër të të ashtuquajturit "nder"

1. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në procedimet penale të filluara pas kryerjes së një akti dhune të mbuluar nga objekti i kësaj Konvente, kultura, zakoni, feja, tradita ose i ashtuquajturi "nder" të mos konsiderohen si justifikime për këto akte. Kjo mbulon veçanërisht pretendimet që viktimat ka shkelur normat ose zakonet kulturore, fetare, sociale ose tradicionale të sjelljes së duhur.

2. Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që nxitja e një fëmije për të kryer ndonjë prej akteve të përmendura në paragrafin 1 të mos cenojë përgjegjësinë penale të atij personi për aktet e kryera.

Neni 43

Aplikimi i veprave penale

Veprat e përcaktuara në pajtim me këtë Konventë aplikohen pavarësisht nga natyra e marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe shkelësit.

Neni 44

Juridiksioni

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer:

- a) në territorin e tyre; ose
- b) në bordin e një anijeje që ngre flamurin e tyre; ose
- c) në bordin e një avioni të regjistruar sipas ligjeve të tyre; ose
- d) nga një prej shtetasve të tyre; ose
- e) nga një person i cili ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.

2. Palët përpigjen të marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi çdo vepër penale të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, kur vepra penale është kryer kundër një prej shtetasve të tyre ose një personi që ka vendqëndrimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e tyre.

3. Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre të mos varet nga fakti që veprat janë dënuar në territorin ku janë kryer.

4. Për ndjekjen penale të veprave të përcaktuara në përputhje me nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që juridiksioni i tyre në lidhje me pikat “d” dhe “e” të paragrafit 1 të mos varet nga fakti që ndjekja penale mund të fillojë vetëm pas kallëzimit nga viktimat të veprës penale ose parashtrimin të informacionit nga shteti i vendit ku është kryer vepra penale.

5. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të përcaktuar juridiksionin mbi veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë, në rastet kur autori i dyshuar është i pranishëm në territorin e tyre dhe ata nuk e ekstradojnë te një palë tjetër, vetëm për shkak të kombësisë së tij/të saj.

6. Kur më shumë se një palë kërkon juridiksion mbi një vepër të dyshuar të përcaktuar në pajtim me këtë Konventë, palët e përfshira, sipas rastit, konsultohen me njëra-tjetrën, me synim përcaktimin e juridiksionit më të përshtatshëm për ndjekje penale.

7. Pa cenuar rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, kjo Konventë nuk përjashton asnjë juridiksion penal të ushtruar nga një palë në pajtim me ligjin e saj të brendshëm.

Neni 45

Sanksionet dhe masat

1. Palët marrin masat e nevojshme ose masa të tjera për të garantuar që veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë, të dënohen me sanksione efektive, proporcionale dhe frenuese, duke marrë parasysh shkallën e kryerjes së tyre. Këto sanksione përfshijnë, sipas rastit, dënime që përfshijnë heqjen e lirisë, të cilat mund të përbëjnë shkak për ekstradim.

2. Palët mund të marrin masa të tjera në lidhje me autorët e veprave penale, të tilla si:

- monitorimi ose mbikëqyrja e personave të dënuar;
- tërheqja e të drejtave prindërore, nëse interesat më të mira të fëmijës, që mund të përfshijnë sigurinë e viktimës, nuk mund të garantohen në një mënyrë tjetër.

Neni 46

Rrethanat rënduese

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që rrethanat e mëposhtme, në masën që tashmë nuk janë elemente përbërëse të veprës penale, në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit të brendshëm, mund të merren në konsideratë si rrethana rënduese në përcaktimin e dënimit në lidhje me veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë:

- a) vepra penale është kryer kundër një ish-bashkëshorti ose partneri ose bashkëshorti ose partneri aktual të njohur nga ligji i brendshëm, nga një anëtar familjeje, një person që bashkëjeton me viktimën ose një person që ka abuzuar me autoritetin e tij ose të saj;
- b) vepra penale ose vepra penale të ngjashme janë kryer në mënyrë të përsëritur;
- c) vepra penale është kryer kundër një personi të pambrojtur për shkak të rrethanave të veçanta;
- d) vepra është kryer kundër ose në prani të një fëmije;
- e) vepra penale është kryer nga dy ose më shumë njerëz që veprojnë së bashku;
- f) vepra penale është paraprirë ose shoqëruar nga nivele ekstreme dhune;
- g) vepra është kryer me përdorimin ose kërcënimin e armës;
- h) vepra penale ka shkaktuar dëmtim të rëndë fizik ose psikologjik të viktimës;
- i) autori është dënuar më parë për vepra penale të një natyre të ngjashme.

Neni 47

Dënimet e dhëna nga pala tjetër

Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të parashikuar mundësinë e marrjes parasysh të vendimeve të formës së prerë të marra nga pala tjetër në lidhje me veprat penale të përcaktuara në pajtim me këtë Konventë në përcaktimin e dënimit.

Neni 48

Ndalimi i proceseve të detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve ose dënimit

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të ndaluar proceset e detyrueshme alternative të zgjidhjes së konflikteve, duke përfshirë ndërmjetësimin dhe pajtimin, në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që nëse urdhërohet pagesa e një gjobe, të merret në konsideratë aftësia e autorit të veprës penale për të marrë përsipër detyrimet e tij ose të saj financiare ndaj viktimës.

KAPITULLI VI

HETIMI, NDJEKJA PENALE, LIGJI PROCEDURAL DHE MASAT MBROJTËSE

Neni 49

Detyrimet e përgjithshme

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që hetimet dhe procedimet gjyqësore në lidhje me të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente të kryhen pa vonesë të panevojshme ndërsa merren parasysh të drejtat e viktimës gjatë të gjitha fazave të procedimeve penale.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera, në përputhje me parimet themelore të të drejtave të njeriut dhe duke marrë parasysh perceptimin gjinor të dhunës, për të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive të veprave penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 50

Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të përgjigjen ndaj të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme, duke ofruar mbrojtje të mjaftueshme dhe të menjëhershme për viktimat.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit të angazhohen menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme në parandalimin dhe mbrojtjen kundër të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, duke përfshirë përdorimin e masave parandaluese operationale dhe mbledhjen e provave.

Neni 51

Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që vlerësimi i përmendur në paragrafin 1 merr parasysh siç duhet, në të gjitha fazat e hetimit dhe zbatimit të masave mbrojtëse, faktin se autorët e akteve të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente zotërojnë ose kanë akses të armëve të zjarrit.

Neni 52

Urdhrat e jashtëzakonshëm të ndalimit

Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që autoriteteve kompetente u është dhënë fuqia për të urdhëruar, në situata të rrezikut të menjëhershëm, autorin e dhunës në familje që të lërë vendbanimin e viktimës ose personit në rrezik për një periudhë të mjaftueshme kohe dhe të ndalojë autorin të hyjë në vendbanimin e ose kontaktojë viktimën ose personin në rrezik. Masat e marra në zbatim të këtij neni, i japin përparësi sigurisë së viktimave apo personave në rrezik.

Neni 53

Urdhra shtrëngues dhe mbrojtës

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që urdhra të përshtatshëm shtrëngues dhe mbrojtës janë të vlefshme për viktimat e të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që urdhrat shtrëngues ose mbrojtës të përmendur në paragrafin 1 janë:

- të vlefshëm për mbrojtje të menjëhershme dhe pa barriera të panevojshme financiare apo administrative, të vendosura mbi viktimën;
- lëshohen për një periudhë të caktuar, ose derisa të modifikohen ose të përmbushen;
- kur është e nevojshme, lëshohen në bazë *ex parte* që ka efekt të menjëhershëm;
- të vlefshëm pavarësisht nga, ose krahas, procedimeve të tjera ligjore;
- lejohen të paraqiten në procedimet ligjore të mëtejshme.

3. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që shkeljet e urdhrave shtrëngues ose mbrojtës të nxjerra në pajtim me paragrafin 1 u nënshtrohen sanksioneve penale ose të tjera ligjore efektive, proporcionale dhe frenuese.

Neni 54

Hetimet dhe prova

Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që, në çdo procedim civil apo penal, provat në lidhje me historinë seksuale dhe sjellje të viktimës lejohen vetëm kur është e përshtatshme dhe e nevojshme.

Neni 55

Procedimet *ex parte* dhe *ex officio*

1. Palët sigurojnë që hetimet ose ndjekja penale e veprave penale të parashikuara në përputhje me nenet 35, 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente nuk do të jenë tërësisht të varura nga një raport ose ankesë e paraqitur nga një viktimë, nëse vepra penale ishte kryer tërësisht ose pjesërisht në territorin e saj dhe se procedimi mund të vazhdojë edhe nëse viktimat e tërheq deklaraten ose ankesën e tij ose të saj.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar, në përputhje me kushtet e parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, mundësinë për organizatat qeveritare dhe joqeveritare dhe këshilltarët mbi dhunën në familje për të ndihmuar dhe/ose mbështetur viktimat, me kërkesë të tyre, gjatë hetimeve dhe procedimeve gjyqësore në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

Neni 56

Masat e mbrojtjes

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e viktimave, duke përfshirë nevojat e tyre të veçanta si dëshmitarë, në të gjitha fazat e hetimeve dhe procedimeve gjyqësore, në veçanti:

a) duke ofruar mbrojtjen e tyre, si dhe atë të familjeve të tyre dhe të dëshmitarëve, nga hakmarrja, kërcënimi dhe viktimizimi i përsëritur;

b) duke siguruar që viktimat të informohen, të paktën në rastet kur viktimat dhe familja mund të jetë në rrezik, kur autori i veprës arratiset ose lirohet përkohësisht ose përfundimisht;

c) duke i informuar ata, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i brendshëm, për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre dhe shqyrtimin e ankesës së tyre, akuzat, ecurinë e përgjithshme të hetimit ose të procedimit dhe rolin e tyre në to, si dhe rezultatin e çështjes së tyre;

d) duke bërë të mundur që viktimat, në mënyrë të pajtueshme me rregullat procedurale të ligjit të brendshëm, të dëgjohen, të sigurojnë prova dhe të paraqesin pikëpamjet, nevojat dhe shqetësimet e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi, si dhe marrjen e tyre në shqyrtim;

e) duke u siguruar viktimave shërbime mbështetëse të duhura në mënyrë që të drejtat dhe interesat e tyre të paraqiten siç duhet dhe të merren parasysh;

f) duke siguruar që masat mund të miratohen për të mbrojtur jetën private dhe imazhin e viktimës;

g) duke siguruar që kontakti ndërmjet viktimave dhe autorëve të veprës brenda gjykatës dhe zyrave të agjencisë së zbatimit të ligjit të shmanget kur është e mundur;

h) duke u siguruar viktimave përkthyes të pavarur dhe kompetentë, kur viktimat janë palë në procedim ose kur ata sigurojnë prova;

i) duke bërë të mundur që viktimat të dëshmojnë, sipas rregullave të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm, në sallën e gjyqit pa qenë të pranishëm ose të paktën pa praninë e autorit të dyshuar të veprës, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përshtatshme të komunikimit, kur janë në dispozicion.

2. Një fëmijë viktimë dhe dëshmitar i dhunës kundër grave dhe dhunës në familje i sigurohen, kur është e përshtatshme, masa të posaçme mbrojtjeje duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës.

Neni 57

Ndihma ligjore

Palët sigurojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë ligjore falas për viktimat, sipas kushteve të parashikuara nga ligji i tyre i brendshëm.

Neni 58

Parashkrimi

Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe të tjera për të siguruar që parashkrimi për fillimin e çdo procedimi ligjor në lidhje me veprat penale të parashikuara në përputhje me nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente, do të vazhdojë për një periudhë kohore që është e mjaftueshme dhe proporcionale me seriozitetin e veprës në fjalë, për të lejuar fillimin efikas të procedimeve, pasi viktimat ka arritur moshën madhore.

KAPITULLI VII EMIGRIMI DHE AZILI

Neni 59

Statusi i vendbanimit

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimave, vendbanimi i të cilave varet nga statusi i bashkëshortit ose i partnerit, siç njihet nga ligji i brendshëm, në rast të zgjidhjes së martesës ose marrëdhënies, t'u jepet në rast të rrethanave veçanërisht të vështira, me kërkesë, një leje qëndrimi autonom, pavarësisht nga kohëzgjatja e martesës apo marrëdhënies. Kushtet në lidhje me dhënien dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit autonom parashikohen nga ligji i brendshëm.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të garantuar që viktimat mund të sigurojnë pezullimin e procedurave të dëbimit të filluara në lidhje me një status vendbanimi të varur nga ajo e bashkëshortit ose e partnerit siç njihet nga ligji i brendshëm për t'u dhënë atyre mundësinë që të aplikojnë për një leje qëndrimi autonom.

3. Palët lëshojnë një leje qëndrimi të rinovueshme për viktimat në një nga dy situatat e mëposhtme ose në të dyja:

a) kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm për shkak të situatës së tyre personale;

b) kur autoriteti kompetent gjykon se qëndrimi i tyre është i nevojshëm me qëllim të bashkëpunimit të tyre me autoritetet kompetente në hetim ose procedimin penal.

4. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e martesës së detyruar të sjella në një shtet tjetër, për qëllim martese dhe të cilat, si rezultat, kanë humbur statusin e tyre të vendbanimit në shtetin ku ata zakonisht banojnë, mund të rifitojnë këtë status.

Neni 60

Kërkesat për azil me bazë gjinore

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar se dhuna me bazë gjinore kundër grave mund të njihet si një formë persekutimi brenda kuptimit të nenit 1, A (2), të Konventës së vitit 1951 lidhur me statusin e refugjatëve dhe, si një formë e dëmtimit të rëndë që shkakton mbrojtje plotësuese/mbështetëse.

2. Palët sigurojnë që një interpretim me ndjeshmëri gjinore të jepet për secilin nga arsyet e Konventës dhe se aty ku është përcaktuar që persekutimi i mundshëm ndodh për një ose më shumë nga këto arsye, aplikuesve do t'u jepet statusi i refugjatëve në bazë të instrumenteve të zbatueshme përkatëse.

3. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të zhvilluar procedurat e pranimit dhe shërbime mbështetëse me ndjeshmëri gjinore për azilkërkuesit, si dhe udhëzimet gjinore dhe procedurat për azil me ndjeshmëri gjinore, duke përfshirë përcaktimin e statusit të refugjatëve dhe kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare.

Neni 61

Mbrojtja e refugjatëve

1. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të respektuar parimin e mbrojtjes së refugjatëve në përputhje me detyrimet ekzistuese sipas ligjit ndërkombëtar.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e dhunës ndaj grave që kanë nevojë për mbrojtje, pavarësisht nga statusi ose vendbanimi i tyre, nuk do të kthehen nën asnjë rrethanë në çdo vend ku jeta e tyre do të ishte në rrezik ose ku ata mund t'i nënshtronen torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues apo dënimit.

KAPITULLI VIII

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 62

Parimet e përgjithshme

1. Palët bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente dhe përmes zbatimit të instrumenteve përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale për bashkëpunimin në çështje civile dhe penale, marrëveshjeve të arritura në bazë të legjislacionit uniform ose reciprok dhe ligjeve të brendshme, në masën më të gjerë të mundshme, me qëllim:

a) parandalimin, luftën dhe ndjekjen penale të të gjitha formave të dhunës që mbulohen nga objekti i kësaj Konvente;

b) mbrojtjen dhe sigurimin e ndihmës për viktimat;

c) hetimin ose procedimin në lidhje me veprat penale të parashikuara në përputhje me këtë Konventë;

d) zbatimin e vendimeve përkatëse civile dhe penale, të lëshuara nga autoritetet gjyqësore të palëve, duke përfshirë urdhrat mbrojtës.

2. Palët marrin masat e nevojshme legislative apo të tjera për të siguruar që viktimat e një vepre penale të parashikuar në pajtim me këtë Konventë dhe të kryer në territorin e një pale, të ndryshëm nga ai ku ata banojnë, mund të bëjnë një ankesë para autoriteteve kompetente të shtetit të tyre të vendbanimit.

3. Nëse një palë që ofron ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale, ekstradimin ose zbatimin e vendimeve civile ose penale të dhëna nga një palë tjetër në këtë Konventë të kushtëzuar nga ekzistenca e një marrëveshjeje, merr një kërkesë për bashkëpunim të tillë juridik nga një palë, me të cilin nuk ka lidhur një marrëveshje të tillë, ajo mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështjet penale, ekstradimin ose zbatimin e vendimeve civile ose penale të dhëna nga pala tjetër në lidhje me veprat penale të parashikuara në pajtim me këtë Konventë.

4. Palët përpiqen të harmonizojnë, kur është e përshtatshme, parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në programe të asistencës për zhvillim të dhëna në interes të shteteve të treta, duke përfshirë lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe me shtete të treta me qëllim lehtësimin e mbrojtjes së viktimave në përputhje me nenin 18 paragrafi 5.

Neni 63

Masat që lidhen me personat në rrezik

Kur një palë, mbi bazën e informacionit në dispozicion të tij, ka arsye të mjaftueshme të besojë se një person është në rrezik të menjëhershëm për të qenë subjekt i ndonjë akti dhune të përmendur në nenet 36, 37, 38 dhe 39 të kësaj Konvente në territorin e një pale tjetër, pala që ka informacion inkurajohet ta transmetojë atë pa vonesë për këtë të fundit me qëllim që të sigurojë se masat e duhura të mbrojtjes janë marrë. Kur është e zbatueshme, ky informacion do të përfshijë detajet mbi dispozitat ekzistuese të mbrojtjes në interes të personit në rrezik.

Neni 64

Informimi

1. Pala e kërkuar informon menjëherë palën kërkuese për rezultatin përfundimtar të masës së ndërmarrë në këtë kapitull. Gjithashtu, pala e kërkuar informon menjëherë palën kërkuese për çdo rrethanë që e bën të pamundur realizimin e masës së kërkuar ose që mund ta vonojë atë në mënyrë të konsiderueshme.

2. Një palë mund, brenda kufijve të ligjit të tij të brendshëm, pa kërkesë paraprake, t'i përcjellë palës tjetër informacionin e marrë në kuadër të hetimeve të saj, kur ajo gjykon se zbulimi i informacioneve të tilla mund ta ndihmojë palën marrëse në parandalimin e veprave penale të parashikuara në përputhje me këtë Konventë ose në fillimin apo kryerjen e hetimeve ose të procedimeve në lidhje me vepra të tilla penale, ose mund të çojë në një kërkesë për bashkëpunim nga kjo palë sipas këtij kapitulli.

3. Një palë që merr çdo informacion në përputhje me paragrafin 2 ia paraqet këtë informacion autoriteteve kompetente të saj, në mënyrë që të ndërmerren procedime nëse ato konsiderohen të përshtatshme, ose që ky informacion të merret në konsideratë në lidhje me procedimet përkatëse civile dhe penale.

Neni 65

Mbrojtja e të dhënave

Të dhënat personale ruhen dhe përdoren në përputhje me detyrimet e ndërmarra nga palët në bazë të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale (ETS nr. 108).

KAPITULLI IX

MEKANIZMI I MONITORIMIT

Neni 66

Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

1. Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (më poshtë referuar si "GREVIO") monitoron zbatimin e kësaj Konvente nga palët.

2. GREVIO përbëhet nga një minimum prej 10 anëtarësh dhe një maksimum prej 15 anëtarësh, duke marrë parasysh një balancë gjinore dhe gjeografike, si dhe ekspertizën multidisiplinore. Anëtarët e saj zgjidhen nga komiteti i palëve nga radhët e kandidatëve të nominuar nga palët për një mandat prej katër vjetësh, i rinovueshëm një herë dhe zgjidhen nga shtetasit e palëve.

3. Zgjedhja fillestare e 10 anëtarëve, mbahet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Zgjedhja e 5 anëtarëve shtesë mbahet pas ratifikimit ose aderimit të 25-të.

4. Zgjedhja e anëtarëve të GREVIO-s bazohet në parimet e mëposhtme:

a) ata zgjidhen në bazë të një procedure transparente nga radhët e personave me karakter të lartë moral, të njohur për kompetencën e tyre të pranuar në fushën e të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ose të ndihmës dhe mbrojtjes së viktimave, ose që kanë demonstruar përvojë profesionale në fushat e mbuluara nga kjo Konventë;

b) dy anëtarë të GREVIO-s nuk mund të jenë shtetas të të njëjtit shtet;

c) ata duhet të përfaqësojnë sistemet kryesore ligjore;

d) ata duhet të përfaqësojnë aktorët dhe agjencitë përkatëse në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

e) ata veprojnë në kapacitetin e tyre individual dhe janë të pavarur dhe të paanshëm në ushtrimin e funksioneve të tyre, dhe janë në dispozicion për të kryer detyrat e tyre në mënyrë efektive.

5. Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të GREVIO-s përcaktohet nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit dhe marrjes së pëlqimit unanim të palëve, brenda një periudhe prej gjashtë muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

6. GREVIO miraton rregullat e veta të procedurës.

7. Anëtarët e GREVIO-s dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, siç përcaktohet në nenin 68 paragrafët 9 dhe 14, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në shtojcën e kësaj Konvente.

Neni 67

Komiteti i palëve

1. Komiteti i palëve përbëhet nga përfaqësuesit e palëve në Konventë.

2. Komiteti i palëve mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës. Takimi i tij i parë zhvillohet brenda një periudhe prej një viti pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në mënyrë që të zgjedhë anëtarët e GREVIO-s. Ai takohet më pas sa herë që një e treta e palëve, Presidenti i Komitetit të palëve ose Sekretari i Përgjithshëm e kërkojnë këtë.

3. Komiteti i palëve miraton rregullat e veta të procedurës.

Neni 68

Procedura

1. Palët i dorëzojnë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, bazuar në një pyetësor të përgatitur nga GREVIO, një raport mbi masat legislative dhe të tjera që i bëjnë dispozitat e kësaj Konvente të zbatueshme, për shqyrtim nga GREVIO-s.

2. GREVIO merr në shqyrtim raportin e paraqitur në përputhje me paragrafin 1 me përfaqësues të palës së interesuar.

3. Procedurat e vlerësimit të mëtejshëm ndahen në raunde, kohëzgjatja e së cilës përcaktohet nga GREVIO. Në fillim të çdo raundi, GREVIO zgjedh dispozitat e veçanta, mbi të cilat bazohet procedura e vlerësimit dhe dërgon një pyetësor.

4. GREVIO përcakton mjetet e duhura për të kryer këtë procedurë monitorimi. Ajo në veçanti mund të miratojë një pyetësor për çdo raund vlerësimi, i cili shërben si një bazë për procedurën e vlerësimit të zbatimit nga palët. Ky pyetësor u drejtohet të gjitha palëve. Palët i përgjigjen këtij pyetësori, si dhe çdo kërkesë tjetër për informacion nga GREVIO.

5. GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, si dhe nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

6. GREVIO shqyrton siç duhet informacionin ekzistues në dispozicion nga instrumentet dhe organet e tjera rajonale dhe ndërkombëtare në fushat që hyjnë brenda objektivit të kësaj Konvente.

7. Kur miratohet një pyetësor për çdo raund vlerësimi, GREVIO i kushton vëmendje të duhur mbledhjes së të dhënave ekzistuese dhe kërkimit shkencor nga palët, siç përmendet në nenin 11 të kësaj Konvente.

8. GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga Komisioneri i Këshillit të Europës për të Drejtat e Njeriut, Asambleja Parlamentare dhe organet përkatëse të specializuara të Këshillit të Europës, si edhe ato të krijuara në bazë të instrumenteve të tjera ndërkombëtare. Ankesat e paraqitura në këto organe dhe rezultati i tyre i vihen në dispozicion GREVIO-s.

9. GREVIO mund të organizojë, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe me ndihmën e ekspertëve të pavarur kombëtarë, vizita në vende, nëse informacioni i marrë është i pamjaftueshëm ose në rastet e parashikuara në paragrafin 14. Gjatë këtyre vizitave, GREVIO mund të asistohet nga specialistë në fusha të veçanta.

10. GREVIO përgatit një projektraport që përmban analizën e saj në lidhje me zbatimin e dispozitave mbi të cilat bazohet vlerësimi, si dhe sugjerimet dhe propozimet e saj në lidhje me mënyrën në të cilën pala e interesuar mund të trajtojë problemet që janë identifikuar. Projektraporti i dërgohet për komente palës që i nënshtrohet vlerësimit. Komentet e saj merren parasysh nga GREVIO kur miraton raportin e tij.

11. Në bazë të të gjitha informacioneve të marra dhe komenteve nga palët, GREVIO miraton raportin dhe konkluzionet e tij lidhur me masat e marra nga pala e interesuar për të zbatuar dispozitat e kësaj Konvente. Ky raport dhe konkluzionet i dërgohen palës së interesuar dhe Komitetit të palëve. Raporti dhe konkluzionet e GREVIO-s bëhen publike, që nga miratimi i tyre, së bashku me komentet e mundshme nga pala e interesuar.

12. Pa cenuar procedurën e paragrafëve 1 deri në 8, Komiteti i palëve mund të miratojë, në bazë të raportit dhe konkluzioneve të GREVIO-s, rekomandimet drejtuar kësaj pale: a) në lidhje me masat që duhen marrë për zbatimin e konkluzioneve të GREVIO-s, nëse është e nevojshme duke caktuar një datë për paraqitjen e informacioneve mbi zbatimin e tyre; dhe b) duke synuar nxitjen e bashkëpunimit me atë Palë për zbatimin e duhur të kësaj Konvente.

13. Në qoftë se GREVIO merr informacion të besueshëm që tregon një situatë ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve të rënda të Konventës, ajo mund të kërkojë paraqitjen e menjëhershme të një raporti të veçantë në lidhje me masat e marra për të parandaluar një model serioz, në masë ose të vazhdueshme të dhunës ndaj grave.

14. Duke pasur parasysh informacionin e paraqitur nga pala e interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të tij, GREVIO mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e tij për të kryer një hetim dhe për të raportuar menjëherë në GREVIO. Kur garantohet dhe me pëlqimin e palës, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e saj.

15. Pas shqyrtimit të rezultateve të hetimit të referuar në paragrafin 14, GREVIO ia transmeton këto rezultate palës së interesuar dhe, kur është e përshtatshme, Komitetit të palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës së bashku me komentet dhe rekomandimet.

Neni 69

Rekomandime të përgjithshme

GREVIO mund të miratojë, kur është e përshtatshme, rekomandime të përgjithshme mbi zbatimin e kësaj Konvente.

Neni 70

Përfshirja parlamentare në monitorim

1. Parlamentet kombëtare ftohen të marrin pjesë në monitorimin e masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente.

2. Palët paraqesin raportet e GREVIO-s në parlamentet e tyre kombëtare.
3. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës ftohet të bëjë rregullisht vlerësime mbi zbatimin e kësaj Konvente.

KAPITULLI X

MARRËDHËNIET ME INSTRUMENTET E TJERA NDËRKOMBËTARE

Neni 71

Marrëdhëniet me instrumentet e tjera ndërkombëtare

1. Kjo Konventë nuk i cenon detyrimet që rrjedhin nga instrumentet e tjera ndërkombëtare në të cilat palët në këtë Konventë janë palë ose bëhen palë dhe të cilat përmbajnë dispozita mbi çështje të rregulluara nga kjo Konventë.
2. Palët në këtë Konventë mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe me njëra-tjetrën në çështje që trajtohen në këtë Konventë, me qëllim plotësimin ose përforcimin e dispozitave të tij ose lehtësimin e zbatimit të parimeve të shprehura në të.

KAPITULLI XI

AMENDIMET E KONVENTËS

Neni 72

Amendimet

1. Çdo propozim për amendim të kësaj Konvente të paraqitur nga një palë i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës dhe u përcillet nga ana e saj apo e tij shteteve anëtare të Këshillit të Europës, çdo nënshkruesi, çdo pale, Bashkimit Europian, çdo shteti të ftuar për nënshkrimin e kësaj Konvente në përputhje me dispozitat e nenit 75, dhe çdo shteti të ftuar për aderim në këtë Konventë në përputhje me dispozitat e nenit 76.
2. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës shqyrton amendimin e propozuar dhe, pas konsultimit të palëve në këtë Konventë që nuk janë anëtarë të Këshillit të Europës, mund të miratojë amendimin me shumicën e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës.
3. Teksti i çdo amendimi të miratuar nga Komiteti i Ministrave, në përputhje me paragrafin 2, u përcillet palëve për pranim.
4. Çdo amendim i miratuar në përputhje me paragrafin 2 hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe njëmuajore pas datës në të cilën të gjitha palët kanë informuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin e tyre.

KAPITULLI XII

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 73

Efektet e kësaj Konvente

Dispozitat e kësaj Konvente nuk cenojnë dispozitat e ligjit të brendshëm dhe instrumentet detyruese ndërkombëtare, të cilat janë tashmë në fuqi ose mund të hyjnë në fuqi, sipas të cilave të drejta më të favorshme u janë dhënë ose do t'u jepen personave në parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Neni 74

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët në çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin ose interpretimin e dispozitave të kësaj Konvente, së pari duhet të kërkojnë ta zgjidhin atë me anë të bisedimit, pajtimit, arbitrazhit ose me çdo metodë tjetër të zgjidhjes paqësore të pranuar me marrëveshje të përbashkët ndërmjet tyre.

2. Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të përcaktojë procedurat e zgjidhjes që të jenë në dispozicion për përdorim nga palët në mosmarrëveshje nëse ata do të binin dakord për këtë.

Neni 75

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj dhe Bashkimi European.

2. Kjo Konventë u nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore, pas datës në të cilën 10 nënshkruesit, duke përfshirë të paktën 8 shtete anëtare të Këshillit të Europës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur nga Konventa në përputhje me dispozitat e paragrafit 2.

4. Në lidhje me çdo shtet të referuar në paragrafin 1 apo Bashkimin European, i cili shpreh më vonë pëlqimin e tij për t'u lidhur me të, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit ose aprovimit.

Neni 76

Aderimi në Konventë

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, pas konsultimit të palëve në këtë Konventë dhe marrjen e pëlqimit të tyre unanim, mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të Europës, i cili nuk ka marrë pjesë në hartimin e Konventës, për të aderuar në këtë Konventë me një vendim të marrë nga shumica e parashikuar në nenin 20.d të Statutit të Këshillit të Europës, dhe me votë unanime, të përfaqësuesve të palëve, të drejtë për t'u ulur në Komitetin e Ministrave.

2. Në lidhje me çdo shtet aderues, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe prej tre muajsh pas datës së depozitimit të instrumentit të aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 77

Zbatimi territorial

1. Çdo shtet apo Bashkimi European mund, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, të caktojë territorin ose territoret në të cilat zbatohet kjo Konventë.

2. Çdo palë mund, në çdo datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj Konvente në çdo territor tjetër të specifikuar në deklaratë dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilëve ajo është përgjegjëse ose në emër të të cilëve ajo është e autorizuar për të ofruar garanci. Në lidhje me këtë territor, Konventa hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së kësaj deklarate nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas dy paragrafëve të mësipërm mund, në lidhje me çdo territor të caktuar në atë deklaratë, të tërhiqet nëpërmjet një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Tërheqja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhe tremujore pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 78

Rezervat

1. Asnjë rezervë nuk mund të bëhet në lidhje me çdo dispozitë të kësaj Konvente, me përjashtimet e parashikuara në paragrafët 2 dhe 3.

2. Çdo shtet ose Bashkimi European mund, në kohën e nënshkrimit ose kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të mos zbatojë ose të zbatojë vetëm në raste ose kushte të caktuara dispozitat e parashtruara në:

- nenin 30 paragrafi 2;
- nenin 44 paragrafët 1.e, 3 dhe 4;
- nenin 55 paragrafi 1 në lidhje me nenin 35 për shkeljet e lehta;
- nenin 58 në lidhje me nenet 37, 38 dhe 39;
- nenin 59.

3 Çdo shtet ose Bashkimi European mund, në kohën e nënshkrimit apo kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të deklarojë që ai rezervon të drejtën të parashikojë sanksione jopenale, në vend të sanksioneve penale, për sjellje të referuara në nenet 33 dhe 34.

4. Çdo palë mund ta tërheqë tërësisht ose pjesërisht një rezervë me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Kjo deklaratë hyn në fuqi që nga data e marrjes së saj nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 79

Vlefshmëria dhe shqyrtimi i rezervave

1. Rezervat e përmendura në nenin 78 paragrafët 2 dhe 3, janë të vlefshme për një periudhë prej pesë vjetësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në lidhje me palën e interesuar. Sidoqoftë, këto rezerva mund të rinovohen për periudha me kohëzgjatje të njëjtë.

2. Tetëmbëdhjetë muaj para datës së mbarimit të afatit të rezervës, Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton për mbarimin e këtij afati palën e interesuar. Jo më vonë se tre muaj para mbarimit të afatit, pala njofton Sekretarin e Përgjithshëm se ajo do e mbajë, ndryshojë ose tërheqë rezervën e saj. Në mungesë të një njoftimi nga pala e interesuar, Sekretariati i Përgjithshëm informon atë palë se rezerva e saj konsiderohet të jetë zgjatur automatikisht për një periudhë prej gjashtë muajsh. Mosnjoftimi nga pala e interesuar për qëllimin e saj për të mbajtur ose modifikuar rezervën e saj para mbarimit të kësaj periudhe bën që rezerva të mos jetë më e vlefshme.

3. Nëse një palë bën një rezervë në përputhje me nenin 78 paragrafët 2 dhe 3, ajo jep, para rinovimit të saj ose me kërkesë, një shpjegim për GREVIO-n, mbi arsyet që justifikojnë vazhdimin e saj.

Neni 80

Denoncimi

1. Çdo palë mund, në çdo kohë, të denoncojë këtë Konventë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që pason mbarimin e një periudhë tremujore pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 81

Njoftimi

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës njofton shtetet anëtare të Këshillit të Europës, shtetet joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e saj, çdo nënshkrues, çdo palë, Bashkimin Europian, dhe çdo shtet të ftuar për aderim në këtë Konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) depozitim të çdo instrumenti të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenet 75 dhe 76;
- d) çdo amendim të miratuar në përputhje me nenin 72 dhe datën në të cilën ky amendim hyn në fuqi;
- e) çdo rezervë dhe tërheqje të rezervës të bërë në zbatim të nenit 78;
- f) çdo denoncim të bërë në zbatim të dispozitave të nenit 80;
- g) çdo akt tjetër, njoftim apo komunikim në lidhje me këtë Konventë.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Stamboll, më 11 maj 2011, në anglisht dhe frëngjisht, ku të dyja tekstet janë njëloj autentike, në një kopje të vetme, e cila depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës i transmeton kopje të vërtetuara secilit prej shteteve anëtare të Këshillit të Europës, shteteve joanëtare që kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj Konvente, Bashkimit Europian dhe çdo shteti të ftuar për aderim në këtë Konventë.

SHTOJCA

PRIVILEGJET DHE IMUNITETET (NENI 66)

1. Kjo shtojcë zbatohet për anëtarët e GREVIO-s të përmendur në nenin 66 të Konventës, si dhe për anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende. Për qëllim të kësaj shtojce, termi “anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende” përfshin ekspertë të pavarur vendas dhe specialistët të përmendur në nenin 68 paragrafi 9 të Konventës, anëtarët e stafit të Këshillit të Europës dhe përkthyesit e punësuar nga Këshilli i Europës që shoqërojnë GREVIO-n gjatë vizitave të saj në vende.

2. Anëtarët e GREVIO-s dhe anëtarët e tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në lidhje me përgatitjen dhe kryerjen e vizitave në vende, si dhe ndjekjen e tyre, dhe që udhëtojnë në lidhje me këto funksione, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitet ndaj arrestimit ose ndalimit dhe ndaj sekuestrimit të bagazheve të tyre personale, dhe imunitet ndaj procesit ligjor të çdo lloji në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha aktet e realizuara nga ata në cilësinë zyrtare;

b) përjashtim nga çdo kufizim të lirisë së lëvizjes në dalje nga dhe kthim në vendin e tyre të vendbanimit, dhe hyrjet e daljet nga vendi në të cilin ata ushtrojnë funksionet e tyre, dhe nga regjistrimi i të huajve në vendin, të cilin ata po vizitojnë ose nëpërmjet të cilit ata po kalojnë në ushtrim të funksioneve të tyre.

3. Gjatë udhëtimeve të ndërmarra në ushtrim të funksioneve të tyre, anëtarëve të GREVIO-s dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, në çështje të kontrollit doganor dhe të këmbimit, u jepen të njëjtat lehtësi si ato që u jepen përfaqësuesve të qeverive të huaja në detyrë të përkohshme zyrtare.

4. Dokumentet në lidhje me vlerësimin e zbatimit të Konventës të kryer nga anëtarët e GREVIO-s dhe anëtarë të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende janë të pacenueshme

për aq sa ato lidhen me aktivitetin e GREVIO-s. Asnjë pengesë apo censurë nuk zbatohet ndaj korrespondencës zyrtare të GREVIO-s ose komunikimeve zyrtare të anëtarëve të GREVIO-s dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende.

5. Për t'iu siguruar anëtarëve të GREVIO-s dhe anëtarëve të tjerë të delegacioneve që kryejnë vizita në vende, lirinë e plotë të fjalës dhe pavarësinë e plotë në përmbushjen e detyrave të tyre, imuniteti ndaj procesit ligjor në lidhje me fjalët e folura ose të shkruara dhe të gjitha veprimet e kryera prej tyre në përmbushjen e detyrave të tyre, vazhdon t'u jepet, pavarësisht se personat në fjalë nuk janë më të angazhuar me përmbushjen e detyrave të tilla.

6. Privilegjet dhe imunitetet u jepen personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce në mënyrë që të garantojnë ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre në interes të GREVIO-s dhe jo për përfitimin e tyre personal. Heqja e imuniteteve të personave të përmendur në paragrafin 1 të kësaj shtojce bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës në çdo rast kur, sipas mendimit të tij ose të saj, imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe kur ajo mund të hiqet pa cenuar interesat e GREVIO-s.

URDHËR
Nr. 100, datë 21.2.2020

**PËR PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV) PËR TRAJTIMIN E
RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA
PUNONJËSET/ PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR, NË
KUADËR TË BASHKËPUNIMIT SI ANËTARË TË MEKANIZMAVE TË
KOORDINUAR TË REFERIMIT(MKR)**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 104, datë 8.11.2012 “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, nenit 28, germa “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe VKM nr. 508, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmeve të Koordinuar të Referimit (MKR), sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe drejtuesit e shërbimeve shëndetësore e të mbrojtjes sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT
PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE
DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA PUNONJËSET DHE PUNONJËSIT
E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT
SI ANËTARË TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT
Shkurt, 2020

HYRJE

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat/cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR), u përgatitën nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), me mbështetjen e Zyrës së UNFPA-së Shqipëri përmes organizatës së saj partnere në zbatim “Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin”.

PSV-të adresojnë çështjet që duhet të njohin dhe hapat që duhet të ndjekin punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, që në këtë rast janë parë si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Përgatitja e PSV-ve për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror për trajtimin e rasteve në mënyrë shumësektoriale të koordinuar shërben, ndër të tjera, edhe si mjet për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të MKR-ve në vend.

PSV-të u përgatitën përmes një procesi të gjatë e gjithëpërfshirës konsultimi të udhëhequr nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku u angazhuan specialiste dhe specialistë të Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Shërbimeve Sociale, Shërbimit Social Shtetëror, si dhe specialistet e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; eksperte të fushës⁵⁶; si dhe anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të ngritura në nivel të vetëqeverisjes vendore. Të bazuara në praktikën më të mirë ndërkombëtare⁵⁷, këto PSV u përshtatën, u diskutuan dhe u përditësuan për të qenë lehtësisht të zbatueshme edhe në Shqipëri.

Siç parashikohet edhe në kuadrin ligjor, institucional dhe të politikave në Shqipëri, koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve e i burimeve, është domosdoshmëri për të përparuar në drejtim të përmbushjes së objektivave lidhur me parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore. Në nivel qendror, këtë rol parësor e luan autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, pra, aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në nivel të vetëqeverisjes vendore, trajtimi i rasteve të dhunës në familje, por edhe të dhunës me bazë gjinore, kryhet përmes qasjes shumësektoriale të koordinuar që merr jetë përmes ngritjes dhe funksionimit me efektivitet të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, pranë çdo bashkie në vend.

Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror përbën një komponent jetik të përgjigjeve të koordinuara shumësektoriale për gratë dhe vajzat, si dhe për cilindo individ në familje subjekt i dhunës. Shërbimet e kujdesit shoqëror përfshijnë një sërë shërbimesh, të cilat janë vendimtare për të mbështetur të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e grave, të rejave, vajzave, djemve, të rinjve e burrave që përjetojnë dhunë, duke përfshirë informacionin mbi çështjen, linjat e ndihmës, strehimin e sigurt, informacionin për të drejtat etj. Hulumtimi dhe praktika dëshmojnë se mënyra në të cilën ofrohen shërbimet ka ndikim të madh mbi efektivitetin e tyre⁵⁸.

⁵⁶ Znj. Irida Agolli, pedagoge në Fakultetin e Shkencave Sociale, znj. Lediona Asabella, punonjëse sociale në sistemin arësor dhe znj. Monika Kocaqi, eksperte për çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

⁵⁷ Versioni origjinal i tyre është përgatitur nga Instituti i Evropës Lindore për Shëndetin Riprodhues (EEIRH, Rumani) dhe botuar nga Zyra Rajonale e UNFPA-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (UNFPA EECARO) në vitin 2015 (me ISBN 978 – 973 – 87875 – 9 – 9).

⁵⁸ <http://www.popcouncil.org/research/expanding-the-evidence-base-on-comprehensive-care-for-survivors-of-sexual-v>

Shërbimet e kujdesit shoqëror, në të gjitha format e tyre, konsiderohen anëtarë shumë të rëndësishëm të MKR-ve. Madje roli i disa prej këtyre shërbimeve në trajtimin e rasteve emergjente (sidomos kur bëhet fjalë për strehim emergjent apo afatgjatë) është decisiv, pikërisht për shkak të rëndësisë së ndërhyrjes së tyre për të mundësuar strehim të sigurt. Njëlloj i rëndësishëm është edhe roli që luajnë shërbimet e kujdesit shoqëror kur flitet për trajtime të specializuara të viktimave etj.

Prandaj edhe zbatimi i këtyre PSV udhëhiqet si nga parimet bazë të shërbimeve të kujdesit shoqëror ashtu edhe nga parimet bazë të zbatimit të qasjes shumësektoriale të koordinuar, të cilat zbërthehen në pjesë të caktuara të dokumentit në vijim.

SHKURTIME

DHBGJ	Dhunë me bazë gjinore
DHF	Dhunë në familje
DHnGV	Dhunë ndaj grave dhe vajzave
KM	Këshilli i Ministrave
LGBTI	Lezbike, gei, biseksualë, transseksualë, interseksualë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (për rastet e dhunës në familje)
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizatë jofitimprurëse
PSV	Procedura Standarde të Veprimit
QSHPHZ	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

SHKURTIME

TABELA E PËRMBAJTJES

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

II. BAZA LIGJORE

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

IV. ZBATUESHMËRIA

V. PARIMET DREJTUESE

VI. ELEMENTET THEMELORE

VII. UDHËZIMET PËR SHËRBIMET THELBËSORE TË KUJDESIT SHOQËROR

VIII. PROCEDURAT

Identifikimi

Vlerësimi

Menaxhimi i rastit

Ndërhyrja

Këshillimi në rast krize

Strehim i sigurt

Mbështetje dhe këshillim psikosocial afatgjatë

Shërbime të tjera mbështetëse

Dokumentimi i DHF/DHBGJ

Referimi

Shih po ashtu: Arango, D, et al, Ndërhyrje për të parandaluar ose reduktuar dhunën ndaj grave dhe vajzave: *Një rishikim sistematik i rishikimeve*; seritë e dhunës ndaj grave dhe hulumtimet kërkimore të agjencive, 2014, nr. 10, Banka Botërore, dhe botimin nr. 6, dhjetor 2006; shërbimet për viktimat/të mbijetuarat e sulmeve seksuale; identifikimi i nevojave, ndërhyrjeve dhe ofrimi i shërbimeve në Australi, nga Jill Astbury
<http://www.aifs.gov.au/acssa/pubs/issue/i6.html>.

IX. RRETHANAT DHE SJELLJET QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHF/DHBGJ

Rrethanat që mund të tregojnë për ushtrimin e DHF/DHBGJ

Efekte specifike psikologjike më të zakonshme në rastet e dhunës seksuale

Sjellje e shoqëruar me DHF/DHBGJ

X. MJEDISI I PUNËS

XI. SI TË BASHKËVEPROJMË ME NJË VIKTIMË TË DHF/DHBGJ

XII. VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RASTIT

BIBLIOGRAFIA

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror përbën një nga komponentët thelbësorë të një reagimi shumësektorial të koordinuar kundër dhunës në familje (DHF) dhe dhunës me bazë gjinore (DHBGJ). Shërbimet e kujdesit shoqëror përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh, që janë tepër të rëndësishme për mbështetjen e të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies së grave, të rejave dhe vajzave, si dhe të cilatdo individit tjetër në familje, të cilët kanë përjetuar dhunë, duke përfshirë këtu informimin në situatë krize, linjat telefonike të ndihmës, strehim të sigurt, informim dhe këshillim mbi të drejtat e tyre e të tjera.

Ligi nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

VKM-ja nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”, përcakton se shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në:

- shërbime parashoqërore: informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *online*;
- shërbime në komunitet: shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët;
- shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) mundësojnë një përshkrim të qartë dhe të hollësishëm të veprimeve të përditshme të ofruesve dhe ofruesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të quajtur më poshtë si punonjëse dhe punonjës të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat/cilët mund të ofrojnë ndihmë dhe shërbime për viktimat e DHF/ DHBGJ.

Objektivat e PSV-së, për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbi mënyrën e ndërhyrjes së tyre një rast të DHF/DHBGJ, janë:

- të identifikojnë me efektivitet viktimat;
- të garantojnë dhe të rrisin sigurinë e viktimave në të gjitha fazat e ndërhyrjes;
- të sigurojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara, të cilat duhet të jenë të shpejta dhe profesionale;
- të lehtësojnë dokumentimin e përmirësuar dhe të koordinuar të mbledhjes së të dhënave mbi rastet e DHF/DHBGJ;
- të garantojnë konfidencialitetin dhe privatësinë e shërbimeve të ofruara për viktimat;
- të lehtësojnë referimin efektiv për viktimat brenda dhe jashtë sektorit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke ndjekur rastin në vazhdimësi për një periudhë kohore 6-mujore (gjashtëmujore) – 1-vjeçare (njëvjeçare);
- të kryejnë lidhjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror me shërbimet e tjera që u ofrohen viktimave të DHF/DHBGJ.

II. BAZA LIGJORE

Këto PSV mbështeten në një kuadër ligjor kombëtar të përditësuar e plotësuar dhe me një sërë dokumentesh ndërkombëtare të ratifikuara, ku ndër më kryesorët përmendim:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁵⁹;
2. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012⁶⁰;
3. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)⁶¹;
4. Deklarata e vitit 1993 për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave⁶²;
5. Deklarata e Pekinit e vitit 1995 dhe Platforma për Veprim⁶³;
6. Vendime të shumta të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, së bashku me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19, të Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
7. Konkluzionet e përbashkëta, miratuar nga Komisioni për Statusin e Grave në sesionin e tij të 57-të;
8. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9914/2008, ligjin nr. 10329/2010 dhe ligjin nr. 47/2018;
9. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
10. Ligji nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” etj.;
12. Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
13. VKM-ja nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;
14. Ligji nr. 47/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, ‘Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore’” etj.

Gjithashtu, PSV-të mbështeten dhe udhëhiqen edhe nga parashikimet në dokumente të rëndësishme strategjike apo të politikave, të tilla si:

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015–2020;
- Marrëveshjet e bashkëpunimit për formalizimin/vijimin e punës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të nënshkruara në nivel bashkie etj.

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Dhunë sipas ligjit nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, neni 3 përkufizohet “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

Viktimë sipas të njëjtit ligj, cituar më sipër, përkufizohet “Personi mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim i një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”. Përgjatë gjithë PSV-së, do t’i referohemi këtij përkufizimi ligjor (pra “viktimë”), pavarësisht se një sërë profesionistesh e profesionistësh apo institucionesh, që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, më së shumti përdorin termin “i/e mbijetuar” apo edhe “viktimë i/e mbijetuar”.

⁵⁹ Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, të Kuvendit. Miratuar me referendum më 22.11.1998. Shpallur me dekreten nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani. Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007. Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008. Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012. Ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015. Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

⁶⁰ Si dhe regjistruar në faqen e Konventës në datën 4.2.2013 (shiko: <http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=&DF=&CL=ENG>)

⁶¹ Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1993 dhe protokollin e saj shtesë në vitin 2003.

⁶² Vendim i Asamblesë së Përgjithshme 48/104.

⁶³ Raporti i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, Pekin, 4-15 shtator 1995 (botim i Kombeve të Bashkuara, nr. i botimit E.96.IV.13), kapitulli 1, vendimi 1, shtojca I dhe shtojca II.

Dhunë në familje, gjithashtu, në të njëjtin ligj sa më sipër, përkufizohet “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

“Pjesëtarë të familjes”, janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake; c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit; ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshttrin/ thjeshttrën, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi; d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es; e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues; ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje; f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuar dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes”.

Dhuna në familje është gjithashtu veprë penale e parashikuar në nenin 130/a, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si: “Rrahja, si edhe çdo veprë tjetër dhune ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet”; “Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues ose ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet”; “Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë, më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet”. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Dhunë fizike përkufizohet “Përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh, si: gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fyt, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytytjet. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër”.

Dhunë psikologjike përfshin “Një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë, poshtërojnë, mbajnë nën kontroll, izolojnë, trembin shkaktojnë frikë dhe të sulmojnë karakterin e një individi duke shkatërruar kështu ndjenjën e tij të vetëvlerësimit, vetëbesimit, dhe sigurisë. Fyerjet, poshtërimet, të folurit në një mënyrë që sulmon karakterin e individit, të shkaktuarit e ndjenjës së frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht një individ dhe/ose persona të tjerë të afërt me të dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të, janë disa prej formave të dhunës verbale, sulmit psikologjik e dhunës emocionale që përfshihen si pjesë e dhunës psikologjike.

Dhunë ekonomike “Mbajtja nën kontroll e parave nga një individ, pavarësisht nëse janë të fituara apo jo prej tij, ushtrimi i kontrollit dhe monitorimi i veprimeve të një individi kundrejt një individi tjetër mbi përdorimin dhe shpërndarjen e parave, përfshirë dhe ato të fituara prej punës së këtij të fundit, shpërdorimi për qëllime të kënaqësive vetjake nga ana e një individi, i parave të

domosdoshme për sigurimin e kushteve bazë të jetesës së familjarëve, kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike, detyrimi i një individi për të plotësuar të gjitha nevojat bazë të familjarëve për një periudhë të caktuar (p.sh. mujore), me një kuotë nën minimalen e parave që të nevojiteshin për këtë qëllim etj.”.

Dhunë seksuale “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose prekje seksuale të padëshiruara ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera – për shembull, kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mos marrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin – për shembull, kur është i dehur, droguar, në gjumë ose mendërisht i paaftë për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin **përdhunimin**, të përkufizuar si shtrëngim fizik ose penetrim duke përdorur shtrëngimin – edhe nëse në masë të vogël – të vulvës ose anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si **tentativë për përdhunim**. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si **përdhunim në grup**. Dhuna seksuale mund të përfshijë forma të tjera të sulmit mbi një organ seksual, duke përfshirë kontaktet e detyruara midis gojës dhe penisit, vulvës ose anusit. Termat sulm seksual, përdhunim, abuzim seksual dhe dhunë seksuale përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë”.

Dhuna seksuale është gjithashtu e parashikuar si vepër penale. Në nenin 107/a, të Kodit Penal theksohet se: “Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë ose kundër fëmijëve të moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet”. Po kështu, në Kodin Penal bëhen edhe një sërë parashikimesh të tjera lidhur me marrëdhëniet seksuale me dhunë. Konkretisht: në nenin 102 “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”; nenin 102/a “Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur”; nenin 103 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”; nenin 104 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës; nenin 105 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”; nenin 106 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari” etj. Parashikime në Kodin Penal bëhen edhe për vepra të tjera, si kryerja e marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale në vendet publike, si dhe për kryerjen e veprave të turpshme me të mitur apo përfshirjen e qëllimshme si dëshmitar të një të mituri në veprime me natyrë seksuale, pornografia etj.

Dhunë ndaj grave përkufizohet si “Shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna ndaj grave përfshin lloje të ndryshme të dhunës që pësojnë gratë, të reja dhe vajzat, si dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, dhunën seksuale nga një person jopartner intim, ngacmimin seksual, martesën e detyruar, abortin dhe sterilizimin e detyruar, përndjekjen, krimet në emër të nderit, trafikimin dhe praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjinitale femërore”.

Dhunë me bazë gjinore: “Çdo akt dhune që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon te gratë në mënyrë disproporcionale”. Një formë diskriminimi që pengon

seriozisht aftësinë e gruas për të gëzuar të drejta dhe liri të barabarta me burrat. Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdikriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

Ngacmim seksual përkufizohet si: “Çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes”.

Ngacmimi seksual është gjithashtu vepër penale dhe parashikohet në nenin 108/a të Kodit Penal të RSH-së sipas të cilit: “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Përndjekja si vepër penale, parashikohet në nenin 121/a të Kodit Penal sipas të cilit: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë”.

Marrëdhënia intime sipas ligjit nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2018, neni 3, përkufizohet si “Marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional”.

Dhunë nga partneri intim cilësohet si forma më e përhapur e dhunës e përjetuar nga gratë, të reja apo adoleshentet në të gjithë botën dhe përfshin “një sërë veprimesh shtrënguese seksuale, psikologjike dhe fizike nga një partner intim aktual ose i mëparshëm, pa pëlqimin e tyre”.

Dhuna nga partneri intim dhe dhuna seksuale. Sulmi seksual nuk ekziston në izolim, por brenda një problemi më të madh shoqëror të dhunës ndaj grave. Një numër i madh i grave që vuajnë nga dhuna nga partneri intim, gjithashtu, përjetojnë sulme seksuale, por ato e raportojnë rrallë dhunën seksuale. Disa gra mund të mos i konceptojnë sulmet seksuale brenda një marrëdhënieje intime si një krim. Përveç kësaj, sulmet seksuale janë shumë më të stigmatizuara se dhuna nga partneri intim, kështu që gratë mund të ndihen të paafta për ta adresuar edhe këtë formë dhune kur kërkojnë ndihmë. Megjithatë, termi “dhuna nga partneri intim” dhe “dhuna seksuale” nuk janë sinonime. Gratë që vuajnë nga dhuna nga partneri intim nuk janë domosdoshmërisht viktimat të dhunës seksuale si pjesë e asaj përvoje. Përveç kësaj, shumë gra vuajnë nga dhuna seksuale jashtë një marrëdhënieje me një partner intim.

Dhuna në takime/lidhje dashurie cilësohet si “Model i sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll te partneri në një takim apo lidhje dashurie”. Në mënyrë të ngjashme, Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) e përkufizon dhunën në një takim/lidhje dashurie si “lloji i dhunës nga partneri intim që ndodh midis dy personave në një marrëdhënie të ngushtë”.

Sulm seksual përkufizohet si “Akt seksual me apo pa kontakt fizik, i kryer nga një individ pa pëlqimin e viktimës ose, në disa raste, dhe veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijët, përmes manipulimeve emocionale ose shantazhit. Është një veprim që e detyron një person t’u nënshtrohet dëshirave të një personi tjetër përmes shpërdorimit të pushtetit, përdorimit të forcës, detyrimit ose kërcënimeve”. Sulmi seksual shkel të drejtat themelore të viktimës, përfshirë të drejtën për integritet fizik dhe psikologjik dhe sigurinë e personit. “Akt seksual me kontakt fizik” përfshin: përdhunimin/marrëdhënien seksuale me penetrim, përpjekjet për të kryer marrëdhënie

seksuale me penetrim/tentativë për përdhunim, prekjen/kontaktin seksual. “Akt seksual pa kontakt fizik”, përfshin: ngacmimin seksual, ekspozimin e detyruar ndaj akteve seksuale (pornografi apo një akt seksual që po kryhet), ekspozimin apo zbulimin e organeve gjenitale, nxitjen e një fëmije të prekë trupin e tij/saj apo të masturbohet, bërja e një regjistrimi vizual të një natyre seksuale të një fëmije.

Abuzim seksual i fëmijëve cilësohet si “Çdo aktivitet seksual midis një fëmije dhe anëtarit të ngushtë të familjes (incesti); ose midis një fëmije dhe një të rrituri; apo një fëmije dhe një fëmije më të rritur, joanëtar familjeje. Ai përfshin si rastet e përdorimit të forcës ose detyrimit, ashtu edhe rastet kur nuk mund të jepet pëlqimi nga viktima për shkak të moshës së tij ose të saj”.

Shfrytëzim seksual cilësohet si “Çdo abuzim aktual ose përpjekje për abuzim, për qëllime seksuale, nga një pozicion i pafavorshëm, ndryshimi në pushtet ose besimi, përfshirë, por pa u kufizuar te përfitimi monetar, në mënyrë shoqërore ose politike, nga shfrytëzimi seksual i tjetrit”.

“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

Elementet themelore janë tipare ose komponentë të shërbimeve thelbësore që zbatohen në çdo kontekst dhe sigurojnë funksionimin efektiv të shërbimit.

Shërbimet thelbësore përfshijnë një sërë shërbimesh bazë që ofrohen nga sektori i shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të kujdesjes shoqërore, policisë dhe drejtësisë. Shërbimet duhet minimalisht të garantojnë të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e cilësdo grua ose vajzë që ka përjetuar ose përjeton dhunë me bazë gjinore. Në Shqipëri, një pjesë e shërbimeve thelbësore kryesisht në nivel vendor, ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile, sidomos organizatat në mbrojtje të të drejtave të grave dhe të fëmijëve (shërbime të tilla si: strehimi emergjent dhe afatgjatë, këshillimi, mbështetja psikosociale dhe ligjore, ndjekja ligjore, shërbime për dhunuesit etj.). Në disa raste, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore mbështesin ofrimin e këtyre shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile, përmes mbulimit të një pjese të kostove të shërbimit, ofrimit të ambienteve falas etj.

Sektori i shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ofron një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme dhe fuqizimin e një popullsie të caktuar të shoqërisë. Shërbimet mund të jenë të karakterit të përgjithshëm ose të ofrojnë zgjidhje më të fokusuara për një çështje specifike, për shembull, për t’iu përgjigjur grave dhe vajzave ose cilitdo anëtarit të familjes të cilat/cilët kanë përjetuar dhunë. Shërbimet e kujdesit shoqëror për viktimat e dhunës përfshijnë shërbime të ofruara nga, ose të financuara nga qeveria (andaj të njohura si shërbime publike) ose shërbime të ofruara nga shoqëria civile dhe aktorë të komunitetit, përfshirë organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat me bazë fetare. Sipas ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”: “Shërbime të kujdesit shoqëror” janë një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Shërbimet e kujdesit shoqëror, që i përgjigjen dhunës ndaj grave dhe vajzave, janë të fokusuara veçanërisht te viktimat e dhunës. Ato janë të domosdoshme për të ndihmuar rimëkëmbjen e grave nga dhuna, fuqizimin e tyre, për të parandaluar përsëritjen e dhunës dhe në disa raste, për të punuar me pjesë të caktuara të shoqërisë ose të komunitetit për të ndryshuar qëndrimet dhe perceptimet për dhunën. Ato përfshijnë, por nuk kufizohen tek: ofrimi i këshillimit psikosocial, mbështetja financiare, informacioni në rast krize, strehimi i sigurt, shërbimet ligjore dhe avokuese, mbështetja në gjetjen e strehimit dhe të punësimit etj., për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë etj.

Udhëzuesit e cilësisë mbështesin ofrimin dhe zbatimin e elementeve themelore të shërbimeve thelbësore për të siguruar që ato janë efektive dhe me cilësinë e duhur për t’iu përgjigjur nevojave të grave dhe vajzave. Udhëzuesit e cilësisë shpjegojnë mënyrat se si duhet të

ofrohen shërbimet sipas qasjes që bazohet te të drejtat e njeriut, se si duhet të jenë të ndjeshme ndaj kulturës dhe si të fuqizojnë gratë. Ato bazohen dhe plotësojnë standardet ndërkombëtare, si dhe reflektojnë praktikën më të mira të përgjigjes ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

IV. ZBATUESHMËRIA

Kërkimi dhe praktika tregojnë se mënyra si ofrohen shërbimet ka një ndikim të rëndësishëm në efektivitetin e tyre. Çelësi për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe mbrojtjen e sigurisë dhe mirëqenies së tyre, është të kuptuarit e natyrës gjinore të dhunës, shkaqeve dhe pasojave të saj, si dhe ofrimi i shërbimeve përmes kulturës së fuqizimit të grave, pra që i ndihmon gratë dhe vajzat të marrin në konsideratë një tërësi zgjedhjesh që kanë në dispozicion, si dhe që mbështet vendimet e tyre. Për të ofruar shërbime thelbësore cilësore, anëtarët e MKR-së duhet të marrin në konsideratë parimet kryesore, si dhe ekzistencën e elementeve themelore që përforcojnë ofrimin e çdo shërbimi thelbësor.

PSV-të përcaktojnë procedura të qarta që rregullojnë hap pas hapi veprimet e përditshme, rolet dhe përgjegjësitë që duhen ndjekur dhe zbatuar nga punonjëset dhe punonjësit e çdo shërbimi të kujdesit shoqëror, në lidhje me viktimat e DHF/DHBGJ. Këto shërbime mund të ofrohen nga institucione shtetërore të kujdesit shoqëror ose nga shërbime të tjera mbështetëse të specializuara për viktimat e DHF/DHBGJ.

Shërbimet thelbësore të kujdesit shoqëror, që u duhen ofruar viktimave të DHF/DHBGJ, në mjedise dhe situata të ndryshme janë:

- informim në rast krize;
- këshillim në rast krize;
- linjë telefonike e ndihmës;
- strehim i sigurt;
- ndihmë materiale dhe financiare;
- përgatitje, rimarrje ose zëvendësim i dokumenteve të identifikimit;
- informim mbi të drejtat, këshillim dhe përfaqësim në sistemin gjyqësor;
- mbështetje dhe këshillim psikosocial;
- shërbime të menjëhershme, të aksesueshme e të disponueshme, të përshtatura për të gjitha grupet;
- shërbime të menjëhershme dhe të përshtatura për fëmijët, për cilindo fëmijë të prekur nga dhuna;
- informim mbi burimet mbështetëse apo shërbimet në komunitet dhe vendosja në kontakt me ta;
- mbështetje drejt pavarësisë ekonomike, rehabilitimit dhe riintegrit;
- sigurim dhe mirëmbajtje të provave;
- referim në shërbime të tjera që ofrohen nga anëtarët e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, përmes kontaktimit me koordinatorin/en vendor/e.

Ofrimi i shërbimeve thelbësore të kujdesit shoqëror duhet të mbështetet në disa elemente bazë që nuk duhet të mungojnë, të tilla si: marrja e pëlqimit/miratimit të informuar dhe ruajtja e konfidencialitetit; aksesueshmëria, referimi, vlerësimi dhe menaxhimi i rastit; punonjëse dhe punonjës të trajnuar veçanërisht për të punuar me viktimat e DHF/DHBGJ dhe ekspertë të fushës; monitorim dhe vlerësim, si dhe sistemi i koordinimit dhe llogaridhënies.

Shërbimet mbështetëse të specializuara për viktimat e DHF/DHBGJ mund të ofrohen nga institucione shtetërore qendrore apo vendore (shërbime publike); nga organizata joqeveritare jofitimprurëse (shërbime private); dhe në kuadrin e një kontrate midis një institucioni shtetëror dhe një organizate jofitimprurëse të specializuar për ofrimin e shërbimeve mbështetëse. Në çdo rast, subjektet që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara duhet të jenë të licencuara për këtë qëllim nga autoriteti përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi për licencat, si dhe në përputhje me parashikimet në nenin 27, të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Për një zbatim më të mirë të këtyre PSV-ve rekomandohet një trajnim bazë i punonjësve dhe i punonjësve të shërbimeve të kujdesit shoqëror të cilat/cilët trajtojnë rastet e DHF/DHBGJ.

Sugjerohet që trajnimi të jetë pjesë e një programi/kurrikule gjithëpërfshirëse, që të përmbajë gjithashtu edhe sesione mbi reagimin shumësektorial kundër DHF/DHBGJ, parimet bazë të ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e DHF/DHBGJ, të cilat duhet të reflektohen në shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen për këto viktimë, sesione mbi parandalimin dhe ndërgjegjësimin etj.

Këto PSV nuk përshkruajnë detyrat specifike të këshilluesve dhe këshilluesve apo të terapistëve dhe terapistëve në lidhje me procesin e këshillimit, terapitë apo ndonjë lloj tjetër ndihme të specializuar. Çdo procedurë tjetër specifike, që rregullohet nga legjislacioni i brendshëm, mund të bëhet pjesë e këtyre PSV-ve, pas miratimit të tyre.

V. PARIMET DREJTUESE

Qasja e bazuar te të drejtat. Lidhur me ofrimin e shërbimeve thelbësore cilësore, qasja që bazohet te të drejtat pranon se institucionet e kujdesit shoqëror kanë përgjegjësinë kryesore për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e grave dhe vajzave. Dhuna ndaj grave dhe vajzave përbën shkelje të rëndë të të drejtave njerëzore të tyre, veçanërisht të së drejtës për një jetë pa frikë dhe pa dhunë. Një qasje e bazuar te të drejtat e njeriut e vë theksin te shërbimet që kanë përparësi sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe vajzave dhe i trajton gratë dhe vajza me dinjitet, respekt dhe ndjeshmëri. Po kështu, një qasje e tillë e vë theksin te standardet më të larta të shërbimeve të kujdesit shoqëror (si dhe të shërbimeve të ofruara nga anëtarët e tjerë të MKR-së) – shërbime të cilësisë së lartë, të disponueshme, të aksesueshme dhe të pranueshme për gratë dhe vajzat⁶⁴.

Avancimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave. Kthimi i fokusit te pabarazia dhe diskriminimi gjinor, edhe si rrënjë të problemit dhe si pasojë të dhunës ndaj grave dhe vajzave, kërkon që shërbimet të garantojnë ndjeshmërinë gjinore dhe funksionimin e politikave dhe praktikave të përgjegjshme gjinore. Shërbimet duhet të sigurojnë që dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk do të falet, nuk do të tolerohet ose nuk do të përjetësohet.

Qasja me ndjeshmëri gjinore. Shërbimet e ofruara duhet të shfaqin një qasje që njeh dinamikën gjinore, efektet dhe pasojat e dhunës ndaj grave. Shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve specifike të grave, të rejave dhe vajzave, duke përfshirë edhe ato që u përkasin grupeve të marginalizuara (rom, egjiptian, LGBTI, migrantët, PAK, të moshuarit etj.). Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të respektojnë diversitetin e viktimave dhe të sillen në mënyrë jodiskriminuese ndaj tyre. Kjo nënkupton që të gjitha gratë, të rejat dhe vajzat viktimë, sikurse dhe të gjithë individët e tjerë të dhunuar në familje, kanë të drejta të barabarta dhe të plota në përdorimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe në marrjen e mbështetjes së të njëjtës cilësi.

Përshtatja sipas moshës dhe ndjeshmëria ndaj kulturës. Shërbimet thelbësore, të përshtatura sipas moshës dhe të ndjeshme ndaj kulturës, duhet t'u përgjigjen rrethanave individuale dhe përvojave jetësore të grave dhe vajzave, sikurse dhe të të gjithë individëve të tjerë të dhunuar në familje, duke marrë parasysh moshën e tyre, identitetin, kulturën, orientimin seksual, identitetin gjinor, etninë dhe preferencat gjuhësore. Shërbimet thelbësore duhet t'u përgjigjen në mënyrën e duhur gjithashtu edhe grave dhe vajzave që përballen me forma të ndryshme të diskriminimit të shumëfishtë – jo vetëm sepse janë gra, por edhe për shkak të racës, etnisë, kastës, orientimit seksual, fesë, aftësisë së kufizuar, gjendjes civile, punësimit ose karakteristikave të tjera të tyre – ose sepse kanë qenë viktimë të dhunës.

Qasja me në qendër viktimën. Qasjet me në qendër viktimën/të mbijetuarën i vendosin të drejtat, nevojat dhe dëshirat e grave dhe vajzave në qendër dhe fokus të ofrimit të shërbimit. Kjo nënkupton marrjen në konsideratë të nevojave të shumta të viktimave, rreziqet dhe cenueshmëritë e ndryshme, ndikimin që kanë vendimet dhe masat e marra, si dhe garantimin që shërbimet janë të përshtatura sipas nevojave të veçanta të secilës grua apo vajzë. Shërbimet duhet t'u përgjigjen kërkesave të viktimave dhe nevojave më urgjente të tyre (si largim nga dhunuesi,

⁶⁴ E/2013/27.

strehim, këshillim, ushqim, punësim etj.). Të gjithë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të angazhuar në reagimin shumësektorial kundër DHF-së dhe DHBGJ-së u japin përparësi të drejtave, nevojave dhe kërkesave të viktimës. Qasja me në qendër viktimën nënkupton një qasje të mbështetur te të drejtat e njeriut, që përcakton se të drejtat, nevojat dhe kërkesat e viktimës janë të një rëndësie parësore. Viktima ka të drejtë të:

- trajtohet me dinjitet dhe respekt, në vend që të bëhet objekt i sjelljeve që e fajësojnë atë;
- zgjedhë rrjedhën e veprimeve, për sa i përket trajtimit të dhunës së pësuar, në vend që të ndjehet e pafuqishme;
- ketë privatësi dhe mirëbesim, në vend që të bëhet objekt i fajësimeve;

- mos diskriminohet, në vend që të ketë diskriminim në bazë të seksit, moshës, racës, etnisë, (pa)aftësisë, orientimit seksual ndryshe, statusit të virusit HIV apo tipareve të tjera;

- marrë informacione gjithëpërfshirëse, për ta ndihmuar atë t'i marrë vetë vendimet, në vend që t'i thuhet se çfarë duhet të bëjë.

Siguria është e qenësishme. Siguria e grave dhe vajzave është e lartë dhe kryesore kur ofrohen shërbime thelbësore. Shërbimet thelbësore duhet ta venë përparësinë te siguria dhe mbrojtja e përdorueseve të shërbimit dhe të shmangin shkaktimin e një lëndimi të mëtejshëm të tyre. Siguria e viktimës dhe e punonjëses apo punonjësit të shërbimeve të kujdesit shoqëror që përfshihet në trajtimin e rastit, duhet të jetë përparësi gjatë kohës kur organizohet dhe ofrohet përkujdesja ndaj viktimave të DHF/DHBGJ. Vlerësimi i sigurisë së viktimës duhet të bëhet në momentin e identifikimit dhe kur personi tregon se ka qenë viktimë e DHF/DHBGJ. Po kështu, edhe vlerësimi i sigurisë personale duhet të jetë pjesë e çdo takimi/trajtimi. Kur fillon bashkëveprimi dhe këshillimi me një viktimë të DHF/DHBGJ, është e rëndësishme që të shqyrtohen edhe kërcënimet e mundshme (nga bashkëshorti ose anëtarët apo anëtarët e tjerë të familjes), në mënyrë që të garantohet se seanca do të kryhet pa ndonjë dëmtim të mundshëm të vetes, viktimës ose të kolegeve apo kolegëve të tjerë të përfshirë në trajtimin e rastit.

Konfidencialiteti dhe privatësia. Respektimi i konfidencialitetit është një masë e rëndësishme që duhet marrë për të garantuar sigurinë e viktimës dhe të punonjëses apo punonjësit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Konfidencialiteti i viktimës duhet të respektohet gjatë gjithë kohës. Kjo nënkupton përcjelljen te të tjerët vetëm të informacionit të domosdoshëm, vetëm në situatat që është e nevojshme ose e kërkuar (detyrim ligjor), si dhe vetëm me informimin e viktimës. Garantimi i privatësisë gjatë konsultës dhe i konfidencialitetit në mbledhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit zvogëlon rrezikun e ekspozimit si të viktimës, ashtu edhe të punonjëses apo punonjësit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ruajtja e konfidencialitetit garanton që viktima nuk do të përjetojë më kërcënime dhe/ose dhunë si rezultat i kërimit të ndihmës dhe, gjithashtu, mbron punonjësen dhe punonjësin e shërbimeve të kujdesit shoqëror nga kërcënimet e dhunuesve. Punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve të kujdesit shoqëror u lind nevoja e diskutimit të rastit me koleget dhe kolegët e tyre për të mundësuar ofrimin e tërësisë së shërbimeve të nevojshme – në këtë rast konfidencialiteti nuk mund të respektohet për disa informacione mbi viktimën. Informacioni mund të diskutohet me koleget dhe kolegët, nëse lind nevoja e referimit të viktimës/të mbijetuarës te një tjetër punonjëse apo punonjës i shërbimeve të kujdesit shoqëror, apo te koordinatori/ja vendor/e e MKR-së. Kjo duhet t'i shpjegohet viktimës paraprakisht dhe ajo duhet të jetë në dijeni të informacionit që do të jepet dhe kujt do t'i jepet, si dhe duhet të japë pëlqimin e saj për këtë. Nëse konfidencialiteti kufizohet nga rregullore që lidhen me raportimin e detyruar (si p.sh. kur flitet për raste të dhunës që përbëjnë veprë penale apo për detyrimin për të raportuar te koordinatori/ja vendor/e raste të DHF-së), viktima duhet të informohet menjëherë për këtë detyrim ligjor duke i shpjeguar që raportimi bëhet për marrjen e masave të duhura për garantimin e mbrojtjes së saj.

Zgjedhja e informuar. Me përjashtim të veprimeve që janë detyrime ligjore (raportimi i rastit në polici dhe te koordinatori/ja vendor/e) çdo veprim tjetër duhet të kryhet pas marrjes së

pëlqimit paraparak të informuar të viktimës, pra, pasi t'i jetë dhënë asaj informacioni i nevojshëm për të gjykuar dhe dhënë këtë pëlqim. Edhe në rast të veprimeve që duhet të kryhen, sepse janë detyrime ligjore, është shumë e rëndësishme që viktima të informohet për këtë detyrim ligjor dhe hapat që do të ndërmerren, përpara përmbushjes së detyrimit ligjor për raportim.

Mosdiskriminimi. Të gjitha viktimat e DHF/DHBGJ, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë të njëjtat të drejta për përfitimin e të gjitha shërbimeve të kujdesit shoqëror që mund të ofrohen nga punonjëset dhe punonjësit e këtyre shërbimeve, siç parashikohen në kuadrin ligjor ekzistues të përmirësuar, pavarësisht moshës, vendbanimit, racës, kombësisë, besimit fetar, përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, statusit martesor, arsimimit dhe statusit socio-ekonomik të tyre.

VI. ELEMENTET THEMELORE

Shërbimet thelbësore kanë disa tipare dhe veprime të përbashkëta. Këto janë të zbatueshme pavarësisht “sektorit” specifik që mund t’u përgjigjet grave dhe vajzave, apo individëve të tjerë të familjes të cilët/cilat përjetojnë dhunë. Të gjitha shërbimet dhe veprimet thelbësore duhet të jenë:

- të disponueshme;
- të arritshme (të aksesueshme);
- të përshtatshme;
- të pajtueshme;
- të kenë përparësi sigurinë;
- të garantojnë informimin në bazë të dhënies së pëlqimit të informuar dhe të ruajnë konfidencialitetin;
- të garantojnë komunikimin efektiv dhe pjesëmarrjen nga ana e palëve të interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve;
- të mundësojnë mbledhjen e të dhënave dhe menaxhimin e informacionit;
- të mundësojnë lidhjen me sektorët dhe agjencitë e tjera përmes koordinimit.

Disponueshmëria (shërbime të disponueshme). Shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të jenë të disponueshme, në sasinë dhe cilësinë e duhur, për të gjitha viktimat e DHF/DHBGJ pavarësisht vendbanimit të tyre, kombësisë, etnisë, statusit të emigrantëve/it ose refugjatëve/it, moshës, fesë, gjuhës dhe nivelit të shkollimit, orientimit seksual, gjendjes civile, aftësive të kufizuara ose çdo karakteristike tjetër të përmendur.

Udhëzime:

- ofrimi i shërbimeve duhet të ngrihet, të organizohet dhe të zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë qasjen e grave dhe vajzave, si dhe të individëve nga grupe të tjera të cenueshme në shërbime gjithëpërfshirëse, pa diskriminim, në të gjithë territorin e vendit, përfshirë në zonat e largëta, rurale ose të izoluara;

- shërbimet duhet të ofrohen në mënyrë të tillë që të arrijnë të gjithë popullatën, pa asnjë lloj diskriminimi, përfshirë grupet e përjashtuara, ata që jetojnë në zona të largëta, që janë vulnerabël ose të marginalizuar, pavarësisht rrethanave dhe përvojave jetësore individuale të grave dhe vajzave, duke përfshirë moshën e tyre, identitetin, kulturën, orientimin seksual, identitetin gjinor, etninë dhe preferencat gjuhësore;

- ofrimi i shërbimeve duhet të organizohet në mënyrë të tillë që t’u mundësojë grave dhe vajzave, por edhe individëve të tjerë të dhunuar, vazhdimësinë e kujdesit përgjatë gjithë rrjetit të shërbimeve dhe gjatë gjithë jetës së tyre;

- duhet të shqyrtohet mundësia e ofrimit të shërbimeve inovative në mënyrë që të zgjerohet shumëllojshmëria e shërbimeve të ofruara, si dhe përdorimi kreativ i zgjidhjeve moderne kompjuterike, kur është e mundur.

Aksesueshmëria (shërbime të arritshme/të aksesueshme). Aksesueshmëria kërkon që shërbimet të jenë të arritshme dhe të mund të përdoren nga të gjitha gratë dhe vajzat, djemtë e burrat pa paragjykim. Ato duhet të jenë fizikisht të arritshme, ekonomikisht të arritshme (të përballueshme) dhe të kapshme nga pikëpamja gjuhësore (informacioni të ofrohet në formate të ndryshme dhe në gjuhën e viktimës).

Udhëzime:

- gratë dhe vajzat, si dhe të gjitha viktimat e DHF/DHBGJ duhet të kenë mundësi të përdorin shërbimet pa u rënduar financiarisht ose nga pikëpamja administrative. Kjo do të thotë që shërbimet duhet të jenë të përballueshme, lehtësisht të arritshme nga pikëpamja administrative dhe në disa raste të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të jenë pa pagesë;

- shërbimet duhet të ofrohen sa më gjerësisht të jetë e mundur, duke marrë në konsideratë edhe nevojat gjuhësore të përdorues/eve të tyre (përfshirë këtu edhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara në dëgjim apo shikim, pra përdorimi i gjuhës së shenjave apo i alfabetit *braille*);

- procedurat e ofrimit të shërbimeve dhe informacionet e tjera rreth shërbimeve thelbësore duhet të jenë të disponueshme në formate të ndryshme (p.sh., me gojë, me shkrim, në mënyrë elektronike, me germa të mëdha lehtësisht të lexueshme etj.), si dhe miqësore ndaj përdorueses/it dhe të shprehura me një gjuhë të thjeshtë, për të rritur qasjen, lehtësuar përdorimin dhe plotësuar nevojat e grupeve të ndryshme.

Përshtatshmëria (shërbime të përshtatshme). Shërbimet thelbësore duhet të njohin ndikimet e ndryshme të dhunës te grupet e ndryshme të grave dhe komuniteteve. Ato duhet t'u përgjigjen nevojave të viktimave në një mënyrë që ndërthur të drejtat e njeriut me parimet e ndjeshmërisë kulturore.

Udhëzime:

- shërbimet duhet të kuptojnë dhe t'u përgjigjen rrethanave dhe nevojave individuale të çdo viktime;

- duhet të ofrohet një shumëllojshmëri shërbimesh për t'u dhënë mundësinë viktimave të kenë alternativa shërbimesh që u përshtaten më së miri rrethanave të tyre individuale.

Pajtueshmëria (shërbime të pajtueshme). Shërbimet thelbësore të përshtatshme për gratë dhe vajzat janë ato që ofrohen në atë mënyrë që është e pajtueshme për to: pra që respektojnë dinjitetin e tyre, garantojnë ruajtjen e konfidencialitetit, janë të ndjeshme ndaj nevojave dhe pikëpamjeve të tyre dhe zvogëlojnë mundësinë e viktimizimit dytësor⁶⁵.

Udhëzime:

- duhen bërë përpjekje për të zvogëluar viktimizimin dytësor, për shembull duke ulur numrin e herëve që gruaja/vajza/viktima duhet të ritregojë historinë e saj, numrin e njerëzve me të cilët duhet të përballlet, si dhe duke mundësuar trajnimin e punonjësve dhe punonjësve, kur është e mundur;

- viktimat duhet të ndihmohen që të kuptojnë plotësisht alternativat e tyre;

- viktimat duhet të fuqizohen që të kenë mundësi të ndihmojnë veten dhe të kërkojnë ndihmë;

- vendimet e viktimave duhet të respektohen pasi të jemi siguruar se i kanë kuptuar plotësisht alternativat në dispozicion të tyre;

- shërbimet duhet të ofrohen në mënyrë që t'u përgjigjen nevojave dhe shqetësimeve të viktimave, pa u cenuar autonominë.

Përparësia (prioritarizimi) e sigurisë – vlerësimi i riskut dhe planifikimi i sigurisë. Viktimat përballen me shumë rreziqe që kanosin sigurinë e tyre qoftë momentale apo edhe në vazhdimësi. Këto rreziqe janë të veçanta për rrethanat individuale të tyre. Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut mund të ulin nivelin e tij. Praktika më e mirë për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut është ajo që siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe të koordinuar ndërmjet sektorëve të kujdesit shoqëror, shëndetësor, të policisë dhe drejtësisë.

Udhëzime:

- shërbimet duhet të përdorin mjete për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të hartuara posaçërisht për t'u përgjigjur DHF/DHBGJ;

- shërbimet duhet të vlerësojnë vazhdimisht dhe sistematikisht, rreziqet individuale për çdo viktimë;

- shërbimet duhet të përdorin alternativa të ndryshme për menaxhimin dhe zgjidhjen e rrezikut, si

⁶⁵ Viktimizimi dytësor (sekondar) është përkufizuar nga strategjitë tip dhe masat praktike të përditësuara të KB-së, si viktimizimi që ndodh jo si rezultat i drejtpërdrejtë i aktit, por për shkak të përgjigjes së papërshtatshme të ofruar për viktimën/të mbijetuarën nga institucionet dhe individët.

dhe masa të ndryshme për të garantuar sigurinë e viktimave;

- ofruesit e shërbimeve duhet të garantojnë që viktimat harton një plan individual, të bazuar te pikat e saj të forta, që përfshin strategji për menaxhimin e riskut;

- shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të punojnë me të gjitha agjencitë, duke përfshirë shëndetësinë, drejtësinë dhe policimin, për të koordinuar vlerësimin e riskut dhe qasjet ndërdisiplinore për menaxhimin e tij. Në këtë kuadër, rëndësi merr koordinimi me anëtarët e MKR në nivel vendor, si dhe kryerja e procedurës së vlerësimit të riskut, siç parashikohet në ndryshimet më të fundit të legjislacionit për DHF (me ligjin nr. 47/2018 dhe udhëzimin përkatës).

Komunikimi efektiv dhe pjesëmarrja nga palët e interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve. Viktimat duhet ta dinë se po dëgjohej dhe se nevojat e tyre po kuptohen dhe po trajtohen. Informacioni dhe mënyra si ai komunikohet mund t'u japë forcë atyre që të drejtohen te shërbimet thelbësore. Të gjitha komunikimet me viktimat duhet të promovojnë dinjitetin e tyre dhe të tregojnë respekt ndaj tyre.

Udhëzime:

- ofruesit e shërbimeve nuk duhet të jenë paragjykses, por duhet të tregojnë mirëkuptim dhe mbështetje;

- viktimat duhet të kenë mundësi të tregojnë historinë e tyre, të dëgjohej dhe t'u regjistrohet historia me saktësi, të kenë mundësi të shprehin nevojat dhe shqetësimet e tyre sipas aftësisë, moshës, pjekurisë intelektuale dhe kapaciteteve në zhvillim;

- ofruesi i shërbimit duhet të vlerësojë shqetësimet dhe përvojat e viktimës duke e marrë seriozisht atë që ajo thotë, pa e fajësuar apo paragjykuar;

- ofruesit e shërbimeve duhet të mundësojnë informacion dhe këshillim që i ndihmon viktimat të marrin vendimet e tyre.

Informimi në bazë të dhënies së pëlqimit dhe ruajtja e konfidencialitetit. Të gjitha shërbimet thelbësore duhet të ofrohen në një mënyrë që mbron privatësinë e viktimës, garanton konfidencialitetin e saj dhe zbulimin e informacionit vetëm pasi ajo të jetë informuar dhe të ketë dhënë pëlqimin e saj nëse është e mundur. Informacioni rreth përvojës së dhunës mund të jetë tmerrësisht i ndjeshëm. Shpërndarja pa kujdes e këtij informacioni mund të ketë pasoja të rënda dhe të rrezikshme për jetën e viktimave, si dhe për njerëzit që i asistojnë ato.

Udhëzime:

- shërbimet duhet të kenë një kod etike për shkëmbimin e informacionit (në përputhje me legjislacionin në fuqi), përfshirë se çfarë informacioni do të përcillet/ndahet, si do të përcillet/ndahet ky informacion dhe me kë;

- ofruesit e shërbimeve që punojnë drejtpërdrejt me viktimat, duhet të informohen rreth kodit të etikës dhe të veprojnë në përputhje me të;

- informacioni specifik rreth viktimave duhet të trajtohet në mënyrë konfidenciale dhe të ruhet në një vend të sigurt;

- viktimat duhet të ndihmohen që të kuptojnë plotësisht alternativat e tyre dhe ndërlikimet që sjell zbulimi i tyre;

- ofruesit e shërbimeve duhet të kuptojnë dhe të veprojnë në përputhje me përgjegjësitë që kanë për ruajtjen e konfidencialitetit.

Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i informacionit. Mbledhja e vazhdueshme dhe e saktë e të dhënave për shërbimet që u ofrohen viktimave të DHF/DHBGJ është e rëndësishme për përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve. Shërbimet duhet të kenë procese të qarta dhe të dokumentuara që garantojnë regjistrimin e saktë dhe konfidencial, si dhe ruajtjen e informacionit rreth viktimave apo shërbimeve që u ofrohen atyre, në një vend/mënyrë të sigurt.

Udhëzime:

- punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të sigurohen se ka një sistem të dokumentuar dhe të sigurt për mbledhjen, regjistrimin dhe ruajtjen e të gjithë informacionit dhe të dhënave;

- i gjithë informacioni rreth viktimave që përdorin shërbimet duhet të ruhet në mënyrë të sigurt, duke përfshirë: dosjet e klientëve, raportet ligjore dhe mjekësore dhe planet e sigurisë;
- punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të garantojnë mbledhjen e saktë të të dhënave duke e ndihmuar stafin që të kuptojë dhe rëndësinë e sistemit për mbledhjen e të dhënave, si dhe duke u dhënë mjaftueshëm kohë për përcjellë të dhënat te koordinatori/ja vendor/e me qëllim që ato të regjistrohen në sistemin REVALB;
- punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të sigurohen që të dhënat shpërndahen ndërmjet anëtarëve të MKR-së vetëm duke përdorur protokolle të miratuara;
- punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të nxitin analizimin e të dhënave të mbledhura për të krijuar një ide për përhapjen e dhunës, tendencat në përdorimin e shërbimeve thelbësore, vlerësimin e shërbimeve ekzistuese dhe informimin për masat parandaluese.

Bashkëpunimi me sektorët e tjerë dhe agjencitë përmes referimit dhe koordinimit. Bashkëpunimi me sektorët dhe agjencitë e tjera nëpërmjet koordinimit dhe referimit, i ndihmon viktimat që të marrin shërbimet e përshtatshme, në kohën e duhur. Proceset e referimit duhet të përfshijnë standardet për dhënien e pëlqimit të informuar për ndarjen e informacionit. Për të garantuar referimin e sigurt nëpër shërbimet e ndryshme thelbësore për viktimat, duhet të përgatiten dhe zbatohen protokolle dhe marrëveshje për procesin e referimit me shërbimet përkatëse të kujdesit shoqëror, shëndetësore dhe ato të drejtësisë, ku të përfshihen qartësisht përgjegjësitë e secilit shërbim.

Udhëzime:

- procedurat ndërmjet shërbimeve për shkëmbimin e informacionit dhe referimin duhet të jenë të qëndrueshme, të njohura nga punonjëset dhe punonjësit e agjencisë/institucionit dhe të komunikuar saktë te gratë dhe vajzat;
- shërbimet duhet të kenë mekanizma për koordinimin dhe monitorimin e efektivitetit të proceseve të referimit;
- shërbimet duhet t'i referojnë fëmijët te shërbimet e posaçme për ta, sipas nevojës dhe kur kjo është e përshtatshme.

Që cilësia e shërbimeve të jetë e lartë, shteti dhe sektorët e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të garantojnë themele të forta për mbështetjen e këtyre përpjekjeve:

Legjislacion dhe kuadër ligjor gjithëpërfshirës. Kuadri ligjor gjithëpërfshirës ekzistues në Shqipëri për çështjet e barazisë gjinore, si dhe kundër dhunës në familje, i plotësuar edhe me legjislacionin dhe politikat specifike për shërbimet e kujdesit shoqëror, përbën bazën për ngritjen dhe funksionimin e këtyre të fundit.

Monitorimi, vlerësimi dhe llogaridhënia janë të nevojshme për të garantuar ofrimin e shërbimeve thelbësore cilësore. Në këtë kuadër është e rëndësishme që të shqyrtohen nëse dhe si këto udhëzime po zbatohen; duke përcaktuar cilësinë e standardeve të shërbimit, si dhe duke monitoruar pajtueshmërinë me këto standarde apo duke identifikuar mangësitë në hartimin dhe zbatimin e tyre. Gratë dhe vajzat, si dhe cilido anëtar tjetër në familje që mund të pësojë dhunë, duhet të marrin mbështetje kur shërbimet thelbësore u mohohen, u cenohen, u vonohen pa arsye ose nuk u ofrohen për shkak të neglizhencës. Llogaridhënia është themelore për të garantuar se shërbimet thelbësore janë të disponueshme, të aksesueshme, të përdorshme, të pajtueshme dhe të përshtatshme. Llogaridhënia forcohet nga pjesëmarrja e aktorëve dhe palëve të interesuara në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e shërbimeve. Përmirësimi i vazhdueshëm i sektorëve, i sugjeruar nga rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit sistematik, është i nevojshëm për ofrimin e shërbimeve cilësore për viktimat e DHF/DHBGJ. Kjo mbështetet te mbledhja, analizimi dhe publikimi i të dhënave gjithëpërfshirëse, në një mënyrë që mund të përdoret për të matur dhe nxitur ofrimin e shërbimeve cilësore. Sistemet e monitorimit dhe vlerësimit që janë të bazuara në një qasje me pjesëmarrje gjithashtu lejojnë një transparencë dhe llogaridhënie më të madhe. Prandaj, monitorimi dhe vlerësimi mund dhe duhet të integrohen në punën e përditshme të profesionistëve dhe profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Burimet dhe financimi janë të nevojshme për ngritjen dhe mbështetjen e çdo sektori dhe sistemi koordinimi të integruar që ka kapacitetin dhe aftësinë të ofrojë shërbime thelbësore cilësore, që u përgjigjen në mënyrë efektive dhe efikase dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Burimet financiare për këtë qëllim duhet të planifikohen që në fillim të vitit në buxhetin shtetëror vjetor apo në planet buxhetore afatmesme dhe duhet të mundësohet alokimi i tyre në kohë, me qëllim që të shmanget mungesa e disponueshmërisë së shërbimeve mbështetëse të specilizuara pikërisht nga mungesa e burimeve financiare.

Trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve garanton që agjencitë/institucionet anëtare të mekanizmave të koordinuar të referimit kanë një të kuptuar të përbashkët dhe aftësinë të ofrojnë shërbime cilësore, si dhe që ofruesit e shërbimeve kanë aftësitë e nevojshme për të përmbushur rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Të gjithë ofruesit e shërbimeve duhet të kenë mundësi të zhvillojnë aftësitë dhe ekspertizën e tyre, si dhe të garantojnë përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre.

Politika dhe praktika të ndjeshme gjinore. Politikat për shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë. Këto politika dhe praktika duhet të ndërthuren me Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2016–2020 dhe Planin e saj të Veprimit në nivel qendror. Ndërkohë që në nivel vendor, në ato bashki ku është nënshkruar Karta Evropiane për Barazi të Burrave dhe Grave në jetën vendore dhe ku është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2018–2020, politikat dhe mekanizmat e koordinimit duhet të lidhen edhe me këtë të fundit.

VII. UDHËZIMET PËR SHËRBIMET THELBËSORE TË KUJDESIT SHOQËROR

Sipas ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” parashikohen një sërë shërbimesh që duhet të përfitojnë kategoritë në nevojë dhe viktimat e dhunës. VKM-ja nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” përcakton se shërbimet e kujdesit shoqëror organizohen në:

- Shërbime parashoqërore: informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi *online*;
- Shërbime në komunitet: shërbimi në familje, alternativ, multifunksional, ditor dhe gjysmëditor, i emergjencës 72-orëshe, i strehimit të mbrojtur për të pastrehët.
- Shërbime rezidenciale afatgjata dhe shërbime të specializuara.

Shërbimet parashoqërore: janë shërbimet që mundësojnë rehabilitimin dhe riintegrimin e sa më të shpejtë të individëve apo familjeve në nevojë dhe përfshijnë:

- informimin dhe këshillimin, i cili siguron informimin mbi shërbimet që ekzistojnë në përputhje me nevojat, këshillimin, orientimin dhe referimin drejt shërbimeve specifike që synojnë rehabilitimin, riintegrimin, fuqizimin ekonomik dhe social dhe iu ofrohet edhe dhe viktimave të dhunës;

- shërbimi i këshillimit me telefon ose *online* siguron mbështetjen, këshillimin në krizë dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve. Ky shërbim ofrohet nëpërmjet:

- linjës telefonike 24 orë në 7 ditë të javës;
- faqes *online* të krijuar në nivel vendor dhe/ose kombëtar.
- Shërbimi i emergjencës 72 orë i ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë, që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur. Ky shërbim ngrihet për ato kategori të identifikuara në risk sipas Planit Social, por veçanërisht shërbime emergjence ngrihen edhe për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët;

- Shërbimi në strehëza, u siguron përfituesve shërbim specifik, strehimin, sigurinë fizike, ushqimin, kujdesin shëndetësor, rehabilitimin psikosocial, terapinë fizike, aktivitete profesionale, kalimin e kohës në komunitet, edukimin, në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit. Ky shërbim ofrohet në mënyrë të përkohshme edhe për: fëmijën dhe të rriturin

viktimë të dhunës në familje, abuzimit, viktimë të trafikimit apo viktimë të mundshme të trafikimit ose në rrezik të mundshëm për jetën;

- Rehabilitim për viktimat e abuzimit seksual ofrohet për viktimën e abuzimit seksual. Kur vlerësohet se jeta në familje mund të vijojë pa ndërprerje, shërbimet rehabilituese, terapitë për rehabilitim shëndetësor dhe psikologjik dhe çdo nevojë tjetër e identifikuar për viktimën e abuzimit seksual, ofrohen nga shërbimet ekzistuese komunitare. Shërbimi i specializuar siguron:

- strehimin;
- sigurinë fizike;
- ushqimin;
- terapi dhe rehabilitim psikologjik;
- kujdesin shëndetësor;
- asistencën juridike;
- shërbime riintegruese.

- Strehëza për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje ofron shërbim në mënyrë të përkohshme në varësi të nevojave të identifikuara dhe të zgjedhura nga përfituesit, viktimat të dhunës në familje që kanë marrë urdhër mbrojtje apo urdhër të menjëhershëm mbrojtje dhe siguron:

- strehimin;
- sigurinë fizike;
- ushqimin;
- kujdesin shëndetësor;
- asistencë juridike;
- rehabilitimin psikosocial;
- fuqizim për punësim.

Ndërkohë praktika ndërkombëtare jep një sërë udhëzimesh për mënyrën se si duhet të organizohen dhe mundësohen shërbimet thelbësore të kujdesit shoqëror, të cilat paraqiten në vijim:

SHËRBIMI THELBËSOR: 1. INFORMACIONI MBI KRIZËN	
Marrja e informacionit të saktë dhe të qartë mbi krizën për cilindo individ që ka përjetuar në të shkuarën, ose po përjeton aktualisht forma të dhunës fizike, seksuale, ose forma të tjera dhune, kudo që ndodhet, pavarësisht nëse është ditë apo natë, është jetike për mbështetjen e qasjes në shërbime për ta ndihmuar për sigurinë e tij. Informacioni mbi krizën përfshin informacione për të drejtat njerëzore, gamën dhe natyrën e shërbimeve që janë në dispozicion, dhe ofrohet në një mënyrë ku nuk fajësohet ose gjykohet askush. Informacioni duhet të ofrohet në mënyrë të tillë që t'u bëjë të mundur viktimave të marrin parasysh gamën dhe përzgjedhjet në dispozicion, dhe të bëjnë zgjedhjet e tyre. Informacioni mbi krizën duhet t'u vihet në dispozicion viktimave që përjetojnë dhunë, si dhe familjeve dhe miqve, kolegëve të punës, policisë dhe shërbimeve shëndetësore, të cilët mund të luajnë rol për t'u ardhur në ndihmë viktimave për t'i marrë këto shërbime në mënyrë të sigurt, kur zgjedhin ta bëjnë këtë gjë.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
1.1 Përmbajtja e informacionit	• Duhet të sigurohet që informacionet rreth krizave janë të qarta, koncize dhe të sakta; • Duhet të sigurohet që informacioni rreth krizave identifikon dhe i referohet gamës së shërbimeve ekzistuese për viktimat.
1.2 Ofrimi i informacionit	• Duhet të sigurohet që informacionet rreth krizave janë gjerësisht të disponueshme dhe që mund të përdoren nga të gjitha viktimat; • Duhet të sigurohet që informacioni të ofrohet në forma të ndryshme, në mënyrë që ai të jetë i përshtatshëm edhe për: - viktimat që vuajnë nga diskriminimi i shumëfishtë; - viktimat me aftësi të kufizuara; - fëmijët. • Duhet të sigurohet shpërndarja e gjerë e informacionit kulturalisht të ndjeshëm përmes mjeteve të ndryshme dhe të përshtatshme (në gjithë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në gjuhë të huaja, përfshirë gjuhën romisht, në alfabetin Braille, të mund të interpretohen me gjuhën e shenjave etj.), në shumë mjedise dhe në ambiente të ndryshme, në të gjithë rajonin/vendin.

SHËRBIMI THELBËSOR: 2. KËSHILLIMI NË RASTE KRIZASH	
Këshillimi në raste krizash është i domosdoshëm për t'i ndihmuar viktimat për të arritur sigurinë e menjëhershme, për të përdorur përvojën që kanë për të riafirmuar të drejtat e tyre dhe për t'u çliruar nga ndjenja e fajit dhe turpit.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
2.1 Disponueshmëria	- Duhet të ofrohet këshillim pa pagesë në raste krizash; - Duhet të sigurohet që viktimat të dëgjohen dhe besohen; - Duhet të sigurohet që viktimave t'u ofrohet një gamë opsionesh, duke përfshirë: - aksesin e menjëhershëm në akomodim të sigurt dhe të përshtatshëm; - akses të menjëhershëm në shërbimet e urgjencës dhe trajtimit të sigurt mjekësor, të tilla si spitalet⁶⁶; - mundësinë për të kontaktuar sërish me shërbimin, edhe nëse zgjedhin të mos përdorin asnjë prej opsioneve që u ofrohen; - Duhet të sigurohet që viktimat të mbështeten për të bërë zgjedhjet e tyre pasi kanë marrë të gjithë informacionin e nevojshëm.
2.2. Rëndësia	Duhet të sigurohet që këshillimi për raste krizash është i përshtatshëm për format e ndryshme të dhunës së përjetuar nga viktimat.
2.3. Akses	- Duhet të ofrohet këshillim për krizat përmes një morie metodash, duke përfshirë këshillimin ballë për ballë me personin, përmes telefonit fiks, telefonit celular, e-mail-it; - Duhet të sigurohet ofrimi i këshillimit për kriza në vende të ndryshme dhe në sfone të ndryshme.

SHËRBIMI THELBËSOR: 3. LINJAT TELEFONIKE TË NDIHMËS	
Linjat telefonike të ndihmës sigurojnë lidhjen e domosdoshme me informacionin, shërbimet e këshillimit dhe shërbimet mbështetëse, kryesisht për gratë dhe vajzat, por edhe individë të tjerë të cilët përjetojnë dhunë.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
3.1 Disponueshmëria	- Linjat telefonike të ndihmës duhet të përdoren pa pagesë ose pa nevojë për të përdorur xhetonë; - Duhet të ofrohen linjat telefonike të ndihmës mundësisht gjatë 24 orëve të ditës, 7 ditë në javë ose, të paktën, katër orë në ditë, duke përfshirë ditët e fundjavave dhe festave; - Duhet të sigurohet që stafi që u përgjigjet telefonatave të linjave telefonike të ndihmës ka njohuri, aftësi dhe trajnim të përshtatshëm; - Duhet të sigurohet që linjat telefonike të ndihmës të mund të bëjnë lidhjen me shërbimet e tjera të kujdesit shoqëror dhe me shërbimet shëndetësore, të policisë dhe drejtësisë për t'iu përgjigjur rrethanave individuale të grave dhe vajzave; - Duhet të sigurohet që linjat telefonike të ndihmës kanë akses në burime, kur është e nevojshme, për të garantuar sigurinë e grave dhe vajzave, duke përfshirë: - mbështetjen për transportin urgjent të viktimave në vende të sigurta, pavarësisht vendndodhjes; - sigurimin e artikujve të menjëhershëm bazë të kujdesit personal dhe shëndetësor, duke përfshirë ushqim dhe veshmbathje, qoftë drejtpërdrejt, ose përmes shërbimeve vendore; - lidhjen e menjëhershme dhe të përshtatshme me institucionet e policisë dhe drejtësisë, kur kërkohet, ose kur është e nevojshme.
3.2 Akses	- Duhet të sigurohet që informacioni rreth shërbimit dhe orarit të punës të komunikohet në mënyrë të qartë dhe të saktë, si dhe në kanalet e duhura; - Duhet të sigurohet që shërbimet telefonike të mund të merren dhe përmes telefonave celularë.

SHËRBIMI THELBËSOR: 4. STREHIMI I SIGURT	
Shumë gra dhe vajza apo individë të tjerë të dhunuar në familje duhet të largohen menjëherë nga ambientet ku jetojnë në mënyrë që të jenë të sigurt/a. Mbërritja në kohë në shtëpi, strehime, strehëza të sigurta për gratë, ose në	

⁶⁶ Shih: Përgjigja ndaj dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale, politika dhe udhëzimet klinike të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/85240/1/9789241548595_eng.pdf?ua=1) dhe udhëzimet klinike mbështetëse për profesionistët, të hartuar si pjesë e këtij programi të përbashkët, në adresën: http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/136101/1/WHO_RHR_14.26_eng.pdf?ua=1

hapësira të tjera të sigurta, mund t'u ofrojë atyre mundësi për strehim të menjëhershëm e të sigurt. Pas këtij strehimi të menjëhershëm, gratë dhe vajzat mund të kenë nevojë për përkrahje për sigurimin e strehimit për periudha afatmesme dhe afatgjata.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
4.1 Shtëpitë, strehimet dhe strehëzat e sigurta për gratë	• Duhet të sigurohet strehim i sigurt derisa të ketë përfunduar kërcënimi i menjëhershëm; • Duhet të sigurohen masat e sigurisë, duke përfshirë: - vendndodhje konfidenciale (aty ku është e mundur); - personel sigurie; - sisteme sigurie; • Duhet të sigurohet që të ketë një protokoll hyrjeje për njerëzit që hyjnë dhe dalin nga strehimi i sigurt; • Duhet të sigurohen nevojat bazë për strehim pa pagesë; • Duhet të sigurohet që të ketë një protokoll për fëmijët e pashoqëruar, duke përfshirë kujdesin alternativ afatgjatë, kur është e nevojshme dhe e përshtatshme, i cili të jetë në përputhje me legjislacionin ekzistues kombëtar dhe me standardet ndërkombëtare; • Duhet të sigurohet që strehimi të mund të përdoret nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe nga gratë dhe vajzat nga zonat rurale, rome dhe egjiptiane, nga komuniteti LGBTI etj.
4.2. Përgjigja	• Duhet të ofrohen hapësira që mundësojnë privatësi dhe konfidencialitet për gratë dhe vajzat, brenda ambienteve të strehimit; • Duhet të sigurohet që vendi i strehimit trajton në mënyrë të përshtatshme dhe nevojat e fëmijëve dhe është miqësor ndaj fëmijëve; • Duhet të ofrohet vlerësim i nevojave të menjëhershme; • Duhet të hartohet një plan mbështetjeje i individualizuar për gratë/fëmijët, në konsultim me to.

SHËRBIMI THELBËSOR: 5. NDIHMA MATERIALE DHE FINANCIARE

Në periudhën e menjëhershme të krizës duhet të prezumohet që viktimat kanë pak ose aspak akses në burimet materiale. Ndihma materiale dhe financiare përfshin mbështetje dhe burime për të mundësuar akses në informacione dhe këshillime rreth krizave, strehim të sigurt dhe ushqim.

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
5.1 Disponueshmëria	• Duhet të sigurohet mbështetje për qasje të menjëhershme për t'ju përgjigjur nevojave bazë individuale të viktimave duke përfshirë transportin e urgjencës, ushqimin, strehimin e sigurt pa pagesë; • Duhet të sigurohet që ndihma mbulon dhe nevojat e fëmijëve; • Duhet të ofrohen ndihma në natyrë dhe ndihma të tjera jomonetare, të tilla si, artikujt bazë të kujdesit personal dhe kujdesit shëndetësor; • Duhet të lehtësohet qasja ndaj mbrojtjes sociale, si për shembull, në transfertat e mjeteve financiare (parave), kur këto janë të disponueshme dhe duhet të sigurohet që paratë të mund të tërhiqen menjëherë pas njoftimit.
5.2. Aksesi	• Duhet të sigurohet një gamë të gjerë mjetesh për viktimat për të pasur qasje të sigurta ndaj ndihmës materiale dhe financiare.

SHËRBIMI THELBËSOR: 6. KRIJIMI, GJETJA, ZËVENDËSIMI I DOKUMENTEVE TË IDENTITETIT

Dokumentet e identitetit përfshijnë dokumentet që u nevojiten viktimave për të udhëtuar, për të mbajtur punën, ose për të kërkuar punësim, për të pasur akses në ndihmat qeveritare dhe shërbimet e kujdesit shoqëror, për të pasur akses në llogaritë bankare etj. Për shkak se shumë grave, të rejave dhe vajzave që përjetojnë dhunë u duhet të ikin pa këto dokumente, në mënyrë që jenë të sigurta, ato mund të kërkojnë mbështetje për krijimin, gjetjen ose zëvendësimin e dokumenteve të identitetit.

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
6.1. Disponueshmëria	• Duhet të ndihmohen gratë dhe vajzat të krijojnë, ose të ripërcaktojnë identitetin e tyre, në përputhje me specifikimet ligjore vendore ose protokollat ndërkombëtare, kur është e nevojshme; • Duhet të bëhet lidhja me shërbimet përkatëse të punëve të jashtme/shërbimet konsullare, kur është e nevojshme; • Duhet të ofrohet ndihmë për të krijuar, gjetur ose zëvendësuar dokumentet e identitetit, pa pagesë.

SHËRBIMI THELBËSOR: 7. INFORMACION LIGJOR DHE MBI TË DREJTAT, KËSHILLIM DHE PËRFAQËSIM, DUKE PËRFSHIRË DHE SISTEMET LIGJORE TË SHUMËFISHTA	
Shumë viktima ka të ngjarë të kenë njohuri të kufizuara në lidhje me të drejtat e tyre dhe gamën e mundësive që janë në dispozicion për to. Informacioni i saktë dhe në kohë mbi çështje, të tilla si: zgjidhja e martesës/ligjet e martesës, kujdestaria e fëmijëve, statusi i migracionit dhe ndihma për gjetjen e përgjigjeve të drejtësisë dhe policisë janë të rëndësishme për mbrojtjen e sigurisë sidomos të grave dhe vajzave.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
7.1. Disponueshmëria	• Duhet të ofrohet informacion për të drejtat; • Duhet të sigurohen informacione të qarta dhe të sakta, për: - masat e sigurisë që janë të disponueshme dhe që mund të parandalojnë dëmtime të mëtejshme nga të autorët e dyshuar; - procedurat dhe afatet kohore të përfshira në zgjidhjet kombëtare ose tradicionale të drejtësisë; • Duhet të ofrohet mbështetje kur nisin procedurat ligjore ose vihen në dispozicion zgjidhje juridike; • Duhet të sigurohet që informacioni dhe këshillat të përfshijnë referimin te shërbimet e domosdoshme, siç është rënë dakord dhe me pëlqimin e viktimës; • Duhet të jepen informacione ligjore dhe mbi të drejtat, për përfaqësime dhe këshillime falas; • Duhet të sigurohet mbështetje dhe përfaqësimin ligjor në emër të viktimave, kur udhëzohet prej tyre për ta bërë këtë gjë; • Duhet të dokumentohet i gjithë këshillimi ligjor për t'u ardhur në ndihmë viktimave për veprime të tjera në të ardhmen.
7.2. Aksesi	• Duhet të ofrohet informacion, këshillime dhe përfaqësim në kohë në lidhje me mundësitë për të mbështetur sigurinë e menjëhershme të viktimave, si për shembull, një urdhër mbrojtjeje, në mënyrë që autori i dhunës të qëndrojë larg saj; • Duhet të ofrohet informacion në formë të shkruar (dhe në një gjuhë që viktima mund ta kuptojë), me gojë dhe/ose në një formë që është e njohur për të; • Duhet të sigurohet informacion dhe këshilla në përputhje me disponueshmërinë e viktimës, domethënë në një kohë dhe vend që është i përshtatshëm për të.

SHËRBIMI THELBËSOR: 8. MBËSHTETJA DHE KËSHILLIMI PSIKOSOCIAL	
Këshillimi i specializuar mund të përmirësojë shumë këndvështrimin shëndetësor për viktimat, i cili, më pas çon rrjedhimisht në përmirësimin e aksesit të tyre në arsim dhe punësim.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME
8.1 Këshillimi individual dhe në grup	• Duhet të ofrohet këshillim individual dhe në grup, sipas rastit, nga profesioniste/profesionistë me trajnim të posaçëm në punën me viktimat e DHF/DHBGJ; • Duhet të sigurohet që viktimat të kenë qasje deri në një numër minimal të seancave të mbështetjes/këshillimit; • Duhet të merret në konsideratë mundësia e sigurimit të mbështetjes së grupeve të përbashkëta; • Duhet të sigurohet që këshillimi të bëhet në varësi të përvojës së dhunës; • Duhet të sigurohet që këshillimi të jetë i bazuar në të drejtat e njeriut dhe të jetë i ndjeshëm në aspektin kulturor.
8.2 Aksesi	• Duhet të ofrohet mbështetje/këshillim falas; • Duhet të ofrohet mundësi transporti për të mbështetur viktimat për të marrë pjesë në sesione; • Duhet të ofrohet këshillim në një kohë që është e përshtatshme për viktimën.

SHËRBIMI THELBËSOR: 9. MBËSHTETJA ME GRATË/VAJZAT NË QENDËR	
Njohja me gamën e shërbimeve, mundësitë dhe vendimet që janë në dispozicion mund të jetë eksperiencë e frikshme për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunë seksuale nga partnerët intimë dhe nga individë të tjerë, jopartnerë. Ndhima e kualifikuar nga stafi i trajnuar mund t'u vijë në ndihmë grave dhe vajzave për të pasur qasje në shërbime më të përshtatshme për to, dhe që të bëjnë zgjedhjet që kanë më shumë mundësi t'u ofrojnë siguri, t'i fuqizojnë dhe të mbrojnë të drejtat e tyre, pasi informohen plotësisht.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIME

9.1 Disponueshmëria	• Duhet të sigurohet disponueshmëria e mbështetjes së përqendruar te gratë dhe fëmijët përgjatë të gjithë rrugëtimit të tyre në sistem; • Duhet të sigurohet që stafi është i trajnuar për të punuar në emër të grave dhe vajzave, për të përfaqësuar interesat e tyre; • Duhet të sigurohet që stafi i respekton kërkesat, nevojat dhe vendimet e shprehura të grave dhe vajzave; • Duhet të sigurohet që çdo përfaqësim në emër të grave dhe vajzave kryhet me pëlqimin e informuar dhe të shprehur të tyre, pas marrjes së informacionit të nevojshëm.
---------------------	--

SHËRBIMI THELBËSOR: 10. SHËRBIMET PËR FËMIJËT PËR ÇDO FËMIJË TË PREKUR NGA DHUNA	
Efekti i pësimit të dhunës, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë, mund të ketë ndikim shkatërrues mbi fëmijët. Fëmijët kanë të drejtë të kenë akses në shërbimet që janë të përshtatshme për moshën e tyre, janë të ndjeshme dhe miqësore ndaj tyre.	
ELEMENTE THEMELORE	UDHËZIME
10.1. Disponueshmëria	• Duhet të ofrohet këshillim i përqendruar te fëmijët dhe të drejtat e tyre, si edhe mbështetje psikosociale specifike për ta; • Duhet të sigurohet që cilido fëmijë të ketë një plan të individualizuar kujdesi; • Duhet të ofrohen shërbime falas për fëmijët; • Duhet të lehtësohet akses i kujdesi urgjent dhe kujdesi alternativ dhe afatgjatë, nëse kërkohet, me ose pa praninë e prindërve/ kujdestareve/ kujdestarëve, sipas rastit, në përputhje me udhëzimet e kujdesit alternativ për fëmijët; • Duhet të lehtësohet akses i përfaqësimit i fëmijëve, aty ku kërkohet, si për shembull për një kujdestar/kujdestare (ligjore) nëse fëmija është i pashoqëruar; • Duhet të sigurohen referime në kohë dhe lehtësim i aksesit te shërbimet e nevojshme, për shembull, për mbrojtjen e fëmijëve, për të trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë, kujdesin shëndetësor dhe arsimin.
10.2. Akses	• Duhet të ofrohen shërbime që janë të përshtatshme, të ndjeshme ndaj fëmijëve, miqësore ndaj fëmijëve dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare; • Duhet të sigurohet marrja e trajnimit për stafin, lidhur me procedurat e ndjeshme dhe miqësore ndaj fëmijëve.

SHËRBIMI THELBËSOR: 11. INFORMIMI, EDUKIMI DHE VENDOSJA E KONTAKTIT ME KOMUNITETIN	
Organizatave e shoqërisë civile, grupet e grave, udhëheqëset/udhëheqësit e besimeve dhe të komunitetit shpesh luajnë një rol kyç për mobilizimin e përpjekjeve të komunitetit për rritjen e ndërgjegjësimit për prevalencën e DHF/DHBGJ dhe rolin e komunitetit për përgjigjet dhe parandalimin e saj.	
ELEMENTE THEMELORE	UDHËZIME
11.1. Informimi i komunitetit	• Duhet të sigurohet që informacioni që i jepet komunitetit përfshin informacion rreth të drejtave të viktimave dhe gamën e shërbimeve që janë në dispozicion për t'i mbështetur ato. • Minimalisht, informacioni i komunitetit duhet të përfshijë: - ku të shkosh për ndihmë; - çfarë shërbimesh janë të disponueshme dhe si mund të kesh qasje në to; - çfarë duhet të presin viktimat, duke përfshirë rolet, përgjegjësitë, konfidencialitetin. • Duhet të sigurohet që informacioni që i jepet komunitetit të zhvillohet dhe shpërndahet në një larmi formatesh, një sërë vendesh, në mënyrë të përshtatshme kulturore dhe të ndjeshme sipas specifikave të tyre. Për shembull, informacioni duhet: - të jetë në dispozicion në gjuhën/gjuhët që përdoren në komunitet, i shkruar në alfabetin Braille etj.; - të përfshijë ilustrime me figura.
11.2. Edukimi dhe mobilizimi i komunitetit	• Duhet të sigurohet që edukimi i komunitetit të bëhet në mënyrë të rregullt dhe të saktë; • Duhet të sigurohet që edukimi i komunitetit të përfshijë informacion mbi të drejtat e grave dhe vajzave; • Duhet të caktohen grupe specifike, të tilla si udhëheqëset/udhëheqësit e komunitetit apo komuniteteve fetare dhe të moshuarat/moshuarit, për të mbështetur ofrimin e shërbimeve; • Duhet të sigurohet trajnim i përshtatshëm për burrat që përkrahin të drejtat e grave për të shërbyer si modele për t'u ndjekur dhe si sisteme mbështetjeje;

	• Duhet të punohet me familjet për të siguruar mbështetje dhe qasje në shërbimet për gratë dhe vajzat; • Duhet të punohet me shoqatat lokale, mediat, shkollat, klubet sportive të komunitetit për të përpiluar mesazhet e edukimit të komunitetit dhe strategjitë e shpërndarjes sipas nevojës së tyre; • Duhet të zhvillohen protokolle të qarta për të mbështetur sigurinë e grave kur ato mund të kontaktohen nga mediat për të treguar historinë e tyre.
11.3. Vendorsja e kontaktit me komunitetin	• Shërbimet duhet të identifikojnë grupet e vështira për t'u arritur, ose të cenueshme dhe të kuptojnë nevojat e tyre specifike; • Duhet të përpilohet informacion dhe duhet të edukohet komuniteti sipas nevojave specifike të grupeve të vështira për t'u arritur, të cenueshme dhe të marginalizuara; • Duhet të ofrohet informacion dhe edukim për komunitetin në mënyra që janë të përshtatshme për grupet e vështira për t'u arritur, të cenueshme dhe marginalizuara.

SHËRBIMI THELBËSOR: 12. NDIHMA PËR TË ARRITUR PAVARËSINË EKONOMIKE, RIMËKËMBJEN DHE AUTONOMINË	
Të përjetuarit e dhunës njihet se ka pasoja afatgjata për shëndetin dhe mirëqenien e viktimave dhe ndikon ndjeshëm në aftësinë e tyre për pjesëmarrje të plotë në shoqëri. Viktimat mund të kërkojnë ndihmë afatgjatë për mbështetje për rimëkëmbje dhe për të jetuar jetë produktive.	
ELEMENTE THEMELORE	UDHËZIME
12.1. Disponueshmëria	• Duhet të ofrohet mbështetje e qëndrueshme për një rimëkëmbje të përgjithshme për të paktën gjashtë muaj; • Duhet të lehtësohet akses në ndihmë në të ardhura dhe mbrojtje sociale, kur është e nevojshme; • Duhet të lehtësohet akses te trajtimi profesional; • Duhet të ofrohet akses te mundësitë për nxjerrjen e të ardhurave, të tilla si fondet për nisjen e bizneseve të reja.
12.2. Akses	• Duhet të mbështetet riintegrimi i sigurt i grave dhe fëmijëve në komunitet, kur është e nevojshme, sipas dëshirave dhe nevojave të tyre të shprehura.

UDHËZIME PËR ELEMENTET THEMELORE SPECIFIKË PËR SHËRBIMET THELBËSORE TË KUJDESIT SHOQËROR

REFERIMI	
Përshkrimi	Standardet
Mënyrat e referimit i ndihmojnë viktimat të marrin shërbime mbështetëse të përshtatshme dhe në kohën e duhur. Proceset e referimit duhet të përfaqësojnë standardet për marrjen e pëlqimit të informuar, pra pasi është dhënë i gjithë informacioni i duhur.	• Shërbimet shoqërohen me protokolle dhe marrëveshje rreth procesit të referimit të shërbimit përkatës të kujdesit shoqëror, shëndetësor dhe të drejtësisë, duke përfshirë përgjegjësi të qarta të secilit shërbim; • Procedurat ndërmjet shërbimeve lidhur me shkëmbimin e informacionit dhe referimin janë të qëndrueshme, njihen nga stafi i institucionit/ agjencisë dhe u komunikohen qartë grave dhe vajzave; • Shërbimet kanë mekanizma për koordinimin dhe monitorimin e efektivitetit të proceseve të referimit; • Rastet u referohen edhe shërbimeve specifike të fëmijëve, sipas nevojës dhe kur del e nevojshme.

VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RISKUT	
Përshkrimi	Standardet
Gratë dhe vajzat përballen me shumë rreziqe për sa i përket sigurisë së menjëhershme dhe të vazhdueshme. Këto rreziqe janë specifike sipas rrethanave individuale të çdo gruaje dhe vajze. Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut mund të zvogëlojnë nivelin e rrezikut. Sipas praktikave më të mira, vlerësimi dhe menaxhimi i riskut përfshin qasje të qëndrueshme dhe të koordinuara brenda dhe ndërmjet sistemeve të	• Shërbimet përdorin instrumentet për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut që janë hartuar posaçërisht për t'u përgjigjur dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale nga një individ tjetër, jopartner. • Shërbimet vlerësojnë rregullisht dhe vazhdimisht rreziqet individuale për çdo grua dhe vajzë. • Shërbimet përdorin një gamë opsionesh për menaxhimin e riskut, për zgjidhjet dhe masat e sigurisë për të mbështetur sigurinë e grave dhe vajzave.

shërbimeve të kujdesit shoqëror, shëndetësore dhe gjyqësore.	• Gratë dhe vajzat marrin një plan të individualizuar sipas nevojave të tyre, të bazuar te të punuarit me pikat e forta, i cili përfshin strategji për menaxhimin e riskut. • Shërbimet punojnë me institucione/agjenci të tjera, duke përfshirë shërbimet shëndetësore dhe të drejtësisë, për të koordinuar vlerësimet e riskut dhe qasjet e menaxhimit.
--	--

STAFI I TRAJNUAR SIÇ DUHET DHE ZHVILLIMI I KAPACITETEVE TË PROFESIONISTËVE	
Përshkrimi	Standardet
Stafi me rrogë dhe vullnetar duhet të ketë aftësi dhe njohuri të specializuara për t'iu përgjigjur siç duhet grave dhe vajzave që përjetojnë dhunë. Stafi kërkon mundësi për të ndërtuar aftësitë dhe ekspertizën dhe për të siguruar përditësimin e njohurive dhe aftësive.	• Stafi me rrogë dhe vullnetaret/vullnetarët demonstrojnë se e kuptojnë mbizotërimin, natyrën dhe shkaqet e DHF/DHBGJ. • Stafi me rrogë dhe vullnetaret/vullnetarët demonstrojnë se e kuptojnë përgjigjen sipas “praktikave më të mira” dhe se kanë përvojë me to për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë. • Stafi me rrogë dhe vullnetaret/vullnetarët demonstrojnë se i kuptojnë përgjigjet e përshtatshme dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve që përjetojnë dhunë. • Stafi me rrogë dhe vullnetaret/vullnetarët marrin trajnime fillestare/bazë dhe të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve profesionale. • Stafi me rrogë dhe vullnetaret/vullnetarët përfitojnë mbështetje dhe mbikëqyrje të rregullt. • Programet e trajnimit përfshijnë dhe module për kujdesin vetjak për stafin dhe vullnetaret/vullnetarët; • Shërbimet ofrojnë një ambient pune të sigurt, mbështetës dhe të respektueshëm.

KOORDINIMI DHE LLOGARIDHËNIA E SISTEMIT	
Përshkrimi	Standardet
Qasja e integruar, shumësektorale, ose e bazuar në sisteme për ofrimin e shërbimeve mbledh së bashku një gamë shërbimesh dhe organizatash, të cilat kanë një grup të përbashkët objektivash për të siguruar përgjigje më të koordinuara ndaj dhunës ndaj grave dhe mbrojtjes së fëmijëve. Shërbimet e kujdesit shoqëror duhet të punojnë me dhe përgjatë shërbimeve shëndetësore dhe të drejtësisë për të ofruar përgjigje cilësore për gratë dhe vajzat. Shërbimet e kujdesit shoqëror mbajnë përgjegjësi për këtë sistem më të gjerë shërbimesh dhe japin llogari për të.	• Shërbimet veprojnë në mënyrë bashkëpunuese dhe mbështetëse me dhe përgjatë shërbimeve të tjera të kujdesit shoqëror, shëndetësore, policore dhe të drejtësisë. • Shërbimet zhvillojnë dhe rishikojnë rregullisht protokollet dhe marrëveshjet që dokumentojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e çdo institucioni/agjencie. • Shërbimet kërkojnë angazhimin e shërbimeve të tjera të kujdesit shoqëror, të institucioneve/agjencive shëndetësore dhe të drejtësisë në trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale, si dhe aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit. • Shërbimet dokumentojnë dhe mbështesin të drejtat e grave dhe vajzave, si dhe përmirësojnë në mënyrë sistematike llogaridhënien.

VIII. PROCEDURAT

Objektivi i përgjithshëm i shërbimeve të kujdesit shoqëror për viktimat e DHF/DHBGJ është t'i ndihmojë ato të rifitojnë respektin për veten dhe të marrin në kontroll jetën e tyre. Mbështetja përmes shërbimeve të kujdesit shoqëror mund të përfshijë veprime që zvogëlojnë vuajtjet, vetminë dhe izolimin social të viktimave, përmirësojnë gjendjen e tyre fizike, sigurojnë riintegrimin e tyre në familje dhe shoqëri, ofrojnë mbështetje ligjore ose socio-ekonomike. Në të gjitha fazat e ndihmës, pavarësia dhe ruajtja e konfidencialitetit të viktimës vijnë pas ofrimit të sigurisë dhe mbrojtjes së jetës së tyre.

Procedurat e prezantuara hap pas hapi në vijim, janë grupuar sipas llojit të veprimit që mund të kryhet dhe janë organizuar sipas këtyre seksioneve: identifikimi, vlerësimi, ndërhyrja, dokumentimi i DHF/DHBGJ, referimi dhe koordinimi për menaxhimin e rasteve. Radha e seksioneve dhe/apo e hapave, mund të ndryshojë gjatë ndërveprimit me një viktimë të

DHF/DHBJ, megjithatë, çdo ndihmë ndaj tyre fillon me identifikimin. Çdo punonjëse dhe punonjës i shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të zbatojë hapat e përshkruar në seksionet në vijim në përputhje edhe me statusin dhe kompetencat e saj/tij si profesionist/e dhe në varësi të pozicionit të saj/tij të punës (pra, në varësi edhe të standardeve të shërbimit që ka për detyrë të ofrojë). Nëse ka prova ose dyshime se një grua, e re apo vajzë ka vuajtur një formë të dhunës me bazë gjinore, punonjësja ose punonjësi i shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i siguruar personit të gjithë mbështetjen që i duhet.

Para çdo ndërhyrjeje që kryhet apo ndihme që i jepet viktimës, punonjësja apo punonjësi i shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të garantojë që të gjithë stereotipat apo barrierat e saj/tij personale (p.sh. bërja me faj e viktimës për dhunën etj.) të trajtohen dhe të zgjidhen, bashkë me përvojat e tyre me DHF/DHBJ, në mënyrë që të jenë neutralë dhe mbështetës.

Identifikimi

Hapi i parë në përgjigjen ndaj DHF/DHBJ është njohja/identifikimi i viktimës dhe i arsyeve për të filluar ndërhyrjen. Kjo mund të bëhet duke lehtësuar vetëraportimin e viktimës, ose duke e zbuluar vetë me anë të referimit apo raportimit (i detyrueshëm ose jo). Pavarësia dhe konfidencialiteti i viktimës vijnë pas mbrojtjes dhe sigurisë së jetës së saj. Ky hap mund të përfshijë marrjen e pëlqimit të informuar për shërbimet e menaxhimit të rastit, ose për referimin të shërbimeve të tjera kur është e nevojshme. Përparësi duhet t'i jepet trajtimit të nevojave shëndetësore që mund të venë në rrezik jetën ose integritetin e viktimave. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet t'i referojnë viktimat në gjendje të rëndë apo kërcënuese për jetën, për trajtim të menjëhershëm, përpara çdo hapi tjetër që ka të bëjë me adresimin e nevojave psikosociale përmes shërbimeve të kujdesit shoqëror. Punonjëset dhe punonjësit e kujdesit shoqëror duhet të mbajnë parasysht këto hapa gjatë procesit të identifikimit:

- të përshëndesin dhe mirëpresin viktimën me ngrohtësi;
- të prezantohen dhe të shpjegojnë shkurtimisht kompetencat/shërbimet e institucionit;
- t'i kërkojnë viktimës me mirësjellje të prezantojë veten;
- të shmangin çdo kontakt fizik me viktimën apo me personin shoqëruar, si dhe të shmangin lëvizjet e papritura. Kjo mund t'i shkaktojë stres viktimës, veçanërisht atyre që kanë përjetuar dhunë fizike;
- të ulen përballë viktimës duke respektuar një distancë minimalisht një metër;
- të pyesin viktimën nëse dëshiron të ndihmohet nga një punonjës/e e shërbimit të kujdesit shoqëror e të njëjtës gjini (veçanërisht në rastet kur viktimë ka pësuar dhunë seksuale);
- të përdorin terminologji të thjeshtë dhe të shmangin fjalët shkencore apo fjalitë e komplikuara gjatë komunikimit me viktimën, sidomos në momentet që sapo ka ardhur në institucion;
- t'i japin viktimës mundësinë që të pyesë për çdo gjë që mund ta konsiderojë të rëndësishme;
- të mbajnë në vëmendje nevojat e grupeve të ndryshme të popullatës (p.sh. të personave me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, të minoriteteve etnike, të personave nga komuniteti LGBTI etj.) dhe të bëjnë përpjekje për t'i adresuar ato;
- të krijojnë një ambient konfidencial dhe mikpritës, të dëgjojnë me kujdes viktimën dhe t'i japin mesazhe mbështetëse;
- të fitojnë besimin e viktimës;
- të mos i lenë viktimat vetëm, veçanërisht kur ka dyshime ose rrezik që mund të lëndojnë veten.

Vlerësimi

Pas identifikimit të një viktime të DHF/DHBJ, punonjësja apo punonjësi i shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të vendosë për hapat e mëtejshëm (mbështetje/këshillim, dokumentim të DHF/DHBJ, referim dhe bashkëpunim me koordinatorin/en vendor/e të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për menaxhimin e rastit), në varësi të burimeve, aftësive dhe kompetencave për të trajtuar në mënyrë efektive dhe sipas qasjes shumësektoriale viktimën e DHF/DHBJ.

Vlerësimi nënkupton mbledhjen dhe analizimin e informacionit rreth shëndetit fizik dhe psikologjik të viktimës, nivelit të rrezikut për jetën, marrëdhënieve sociale, situatës ekonomike, strehimit, situatës së fëmijëve (nëse ka) etj. I gjithë ky informacion do ta ndihmojë punonjësen apo punonjësën e shërbimeve të kujdesit shoqëror të përcaktojë ndërhyrjen më të mirë të mundshme, në përputhje me nevojat e viktimës, si dhe burimeve në dispozicion. Për të ofruar mbrojtje për viktimën e dhunës në të gjitha fazat e ndërhyrjes, duhet bërë vlerësimi i nivelit të rriskut me të cilin përballlet ajo.

Si kryhet procesi i vlerësimit?

Gjatë kryerjes së procesit të vlerësimit punonjëset apo punonjësët e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të mbajnë në konsideratë hapat në vijim:

- të marrin pëlqimin e miratuar të viktimës për shërbimet që do të ofrohen. Nëse viktimat nuk di të lexojë apo të shkruajë, asaj duhet t'i lexojnë me zë të lartë deklaratën e marrjes së pëlqimit dhe duhet t'i kërkojnë miratimin me gojë (kjo gjë duhet të përmendet në formularin e marrjes së pëlqimit të miratuar ose në ndonjë formular tjetër);
- t'u shpjegojnë të drejtën për të dhënë pëlqimin e tyre të pjesshëm aty ku ato mund të zgjedhin se cilat informacione mund të bëhen të ditura dhe cilat duhet të ruhen konfidenciale;
- t'u japin informacion të plotë për dhënien e pëlqimit të informuar. T'i informonë viktimat rreth ndërlikimeve që mund të vijnë si pasojë e ndarjes së informacionit rreth rastit të tyre me institucione apo shërbime të tjera;
- të informojnë viktimën për çdo detyrim ligjor që mund të kenë për raportimin e rastit të tyre në polici (kur dhuna e ushtruar përbën vepër penale) apo në institucione të tjera (si në rastin e raportimit të koordinatori/ja vendor/e nëse flitet për DHF), duke e siguruar se ky raportim bëhet për të mbrojtur dhe siguruar jetën e saj;
- t'u shpjegojnë viktimave se me to po punohet pa paragjykim, por me kujdes dhe mirëkuptim, si dhe se do të bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i ndihmuar ato;
- të ofrojnë përkujdesje dhe mbështetje të përshtatur sipas nevojave dhe pritshmërive të viktimave të DHF/DHBGJ, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja dhe trajtimi i tyre sipas standardeve.

Çfarë duhet vlerësuar/pyetur?

Punonjëset dhe punonjësët e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet:

- t'u kërkojnë viktimave të tregojnë me fjalët e tyre atë që ndodhi, të tregojnë rreth dhunuesit, formave të dhunës, historikut të dhunës (llojin e abuzimit, kohëzgjatjen, shpeshtësinë, intensitetin dhe episodin e fundit më të dhunshëm), si dhe përvojat e mëparshme me DHF/DHBGJ. Ato/ata duhet të nxitin viktimat që të tregojnë me detaje dhe nga pikëpamja personale;
- të vlerësojnë nivelin e rrezikut dhe të përcaktojnë disa rregulla për vetëmbrojtje;
- t'i pyesin viktimat për pasojat e DHF/DHBGJ në jetën e tyre;
- të marrin informacion rreth gjendjes psikologjike, fizike dhe sociale të viktimës dhe fëmijëve të saj (nëse ka);
- të marrin informacion mbi prejardhjen e familjes së origjinës së viktimës;
- të marrin informacion mbi rrethin shoqëror të ngushtë dhe atë më pak të frekuentuar;
- të pyesin viktimën rreth situatës ekonomike të familjes, varësisë apo pavarësisë së saj, si dhe kushteve të jetesës dhe banimit;
- të pyesin viktimën rreth përpjekjeve të mëparshme për të kapërcyer situatat e dhunës, strategjitë e ndjekura, tentativat e mëparshme për t'i shpëtuar abuzimit;
- të marrin informacion rreth situatës së fëmijëve (në lidhje me DHF/DHBGJ, marrëdhëniet e tyre me prindërit etj.);
- të eksplorojnë ndjenjat e viktimës rreth asaj që ka ndodhur;
- të marrin informacion mbi pritshmëritë dhe kërkesat e viktimës së DHF/DHBGJ (nga vetë ato, nga specialistet dhe specialistët që mund t'i kenë trajtuar më parë, nga dhunuesi, nga familjarët, miqtë etj.), si dhe mbi faktorët që e motivojnë atë të kërkojë ndihmë;
- ta pyesin dhe orientojnë për përgatitjen e një plani sigurie.

Menaxhimi i rastit

Menaxhimi i rastit është një proces bashkërendimi i vlerësimit, planifikimit, lehtësimit, koordinimit të kujdesit, vlerësimit të impaktit dhe avokimit për të plotësuar nevojat e gjera të një individi (apo familjeje) nëpërmjet komunikimit dhe burimeve të nevojshme për të nxitur sigurinë, cilësinë e kujdesit të ofruar dhe për arritjen e rezultateve efektive me një kosto sa më të ulët. Në rastin e një viktime të DHF/DHBGJ, menaxher/e rasti mund të jetë vetë punonjësja apo punonjësi i shërbimeve të kujdesit shoqëror që po e trajton atë, por mund të jetë edhe koordinatori/ja vendor/e e MKR-së apo specialist/ja për mbrojtjen e fëmijëve. Cilado/cilido prej tyre të ketë përgjegjësinë e menaxher/es së rastit, duhet patjetër të bëhet një koordinimin mes tyre dhe me të gjitha specialistet dhe specialistët e anëtarëve të tjerë të MKR-së, gjatë procesit të identifikimit, vlerësimit të riskut dhe nevojave të viktimave të DHF/DHBGJ, si dhe gjatë planifikimit të ndërhyrjeve, zbatimit të ndërhyrjeve të planifikuara, ofrimit të shërbimit dhe ndihmës, monitorimit, vlerësimit të ndërhyrjes, si dhe gjatë rishqyrtimit të situatës, për një menaxhim rasti me sa më kosto-efektivitet.

Ndërhyrja

Ndërhyrja nënkupton një tërësi shërbimesh bazë që janë gjithëpërfshirëse për viktimat e DHF/DHBGJ, që zvogëlojnë efektet dhe pasojat e përvojave të rënda dhe parandalojnë traumat e mëtejshme, duke përfshirë këtu edhe riviktimizimin. Ndërhyrja duhet të bëhet përmes një plani të përbashkët, i cili duhet të hartohet nga anëtarët e Ekipit Teknik Ndërdisciplinar të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, bazuar në nevojat e identifikuara dhe burimet e disponueshme. E gjithë veprimtaria e ndërhyrjes duhet të jetë e fokusuar te viktima, duhet zbatuar përmes qasjes shumësektoriale dhe gjithëpërfshirëse, si dhe duhet të jetë e përshtatshme dhe e qëndrueshme. Shërbimet e kujdesit shoqëror që mbështesin viktimat e DHF/DHBGJ duhet të marrin në konsideratë nevojat e fëmijëve që bëhen dëshmitarë të dhunës dhe të ofrojnë këshillim psikosocial të përshtatur sipas nevojave të tyre.

Këshillimi në rast krize

Këshillimi në rast krize synon të garantojë mbrojtjen e menjëhershme të viktimës, t'i japë kuptim përvojës që ka kaluar, të riafirmojë të drejtat e saj dhe të largojë ndjenjat e fajit dhe të turpit. Këshillimi në rast krize mund të zhvillohet përmes metodave të ndryshme, që përfshijnë këshillimin ballëpërballë, këshillimin nëpërmjet telefonit fiks apo celularit, ose këshillimin nëpërmjet postës elektronike, që realizohen në vende dhe mjedise të ndryshme.

Këshillimi afatgjatë, psikoterapia apo forma të tjera të mbështetjes/ndërhyrjes afatgjatë nuk mbulohen nga ky seksion.

Gjatë aplikimit të këshillimit në rast krize, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet:

- të adresojnë nevojat bazë (urinë etjen, gjumin) të viktimës;
- t'i kërkojnë viktimës të japë mendim për rezultatet, strategjinë e përballimit të situatës, si dhe burimet. Së bashku me viktimen punonjësja apo punonjësi i shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të shqyrtojë të gjitha mënyrat e zgjidhjes së situatës;
- të ofrojnë mbështetje psikologjike për t'iu përgjigjur nevojave të menjëhershme psikologjike të viktimës së DHF/DHBGJ;
- t'i shpjegojnë dhe/ose ofrojnë zgjedhje alternative viktimës: a) qasje të menjëhershme për strehim të sigurt; b) qasje të menjëhershme për shërbime të kujdesit shëndetësor të urgjencës; dhe c) mundësinë për të rikontaktuar shërbimin, në çfarëdo rrethane/zgjedhjeje;
- të diskutojnë dhe t'i shpjegojnë viktimës mundësinë për të përfituar një urdhër mbrojtjeje, një urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje apo një urdhër për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme;
- të asistojnë viktimen gjatë hartimit të një plani për të rritur sigurinë për veten dhe për fëmijët e saj, kur kjo është e nevojshme;
- t'i shpjegojnë domosdoshmërinë dhe të bien dakord për një plan sigurie afatgjatë, si dhe të shkëmbejnë kontaktet për të komunikuar në vazhdim.

Strehim i sigurt

Shpesh, viktimat e DHF/DHBGJ duhet të largohen menjëherë nga shtëpitë e tyre për të qenë të mbrojtura, pasi jeta e tyre apo e fëmijëve të tyre mund të jetë në rrezik. Në situata të tilla punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkëpunim me koordinatorin/en vendor/e duhet të mundësojnë strehimin e viktimës, si dhe të fëmijëve të saj në një strehëz emergjente, strehëz afatgjatë apo në hapësira të tjera të sigurta, për të cilat anëtarët e MKR-së kanë vendosur që të përdoren si alternativa për strehime të sigurta. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet që:

- në rast urgjence të ofrojnë strehim në një vend të sigurt dhe të mbrojtur mirë. Periudha e strehimit emergjent duhet të zgjatë derisa të mos ketë më rrezik të menjëhershëm, ose derisa të hyjnë në fuqi për t'u zbatuar masa të tjera që lidhen me lëshimin e një urdhri mbrojtjeje apo me strehimin për një periudhë më të gjatë në një strehëz që ofron shërbime më afatgjata;
- të garantojnë që masat e sigurisë janë funksionale, duke përfshirë këtu: ruajtjen e fshehtësisë së vendndodhjes (kur është e mundur), angazhimin e punonjëseve dhe punonjësve të sigurisë dhe specialisteve që do të ndjekin rastin gjatë gjithë periudhës kohore të strehimit në një strehëz emergjente apo afatgjatë, si dhe vënien në funksionim të sistemit të sigurisë;
- të garantojnë nevojat bazë të strehimit, duke përfshirë këtu edhe shmangien e qëndrimit vetëm (pra pa një specialiste të trajnuar) të viktimës;
- të mundësojnë shërbime të tjera bazë, të posaçme dhe plotësuese, sipas nevojave dhe zgjedhjes së viktimës: mbështetje/këshillim psikologjik, këshillim ligjor, mbështetje për riintegrim social etj.;
- të garantojnë sigurinë dhe plotësimin e nevojave të menjëhershme të fëmijëve shoqëruar me shërbime të përshtatura sipas moshës së tyre.

Mbështetje dhe këshillim psikosocial afatgjatë

Shërbimet këshilluese, formale apo joformale, kanë rezultuar të efektshme në trajtimin e nevojave psikologjike të viktimave që përjetojnë depresion, ankth dhe/ose çrregullime të stresit posttraumatik (PTSD). Disa nga shërbimet e kujdesit shoqëror përfshijnë grupet e mbështetjes, këshillim individual dhe një linjë telefonike të ndihmës në rast urgjence, që funksionon 24 orë në ditë në 7 (shtatë) ditë të javës. Shërbimet joformale të këshillimit funksionojnë në nivele të ndryshme brenda shumë komuniteteve, duke filluar nga grupet mbështetëse për viktimat e deri te grupet fetare ose ato komunitare. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të:

- fuqizojnë viktimat që të kenë mundësi të bëjnë zgjedhjet e tyre;
- zhvillojnë plane të ndërhyrjes për trajtimin e rasteve, si dhe të marrin masa duke vlerësuar dhe duke marrë në konsideratë nevojat vetjake të viktimave, mendimet dhe pikëpamjet e ndryshme, duke përfshirë këtu edhe shqyrtimin e mundësisë për të mos bërë asgjë ndërhyrje për këshillim apo mbështetje psikosociale dhe për t'i lënë gjërat ashtu siç janë. Në zhvillimin e planit të ndërhyrjes duhet të përfshijnë patjetër edhe vetë viktimat;
- mundësojnë ose mobilizojnë mbështetje sociale;
- ndërmarrin veprime specifike, që zvogëlojnë vuajtjet, vetminë dhe izolimin social, si dhe që rindërtojnë vetëbesimin te viktimat;
- forcojnë mekanizmat e vetëmbrojtjes dhe strategjitë e përballimit, duke e vënë theksin te burimet dhe kapacitetet e viktimave, me qëllim që t'i bëjnë ato të jenë të afta të menaxhojnë situata të dhunshme ose të rrezikshme në të ardhmen, pa u ndjerë të pafuqishme;
- pranojnë mundësinë që ndërhyrja dhe/ose veprimet e ndërmarra mund të dështojnë, t'ua ilustrojnë këtë viktimave, si dhe t'i ndihmojnë të reflektojnë mbi pasojat që mund të kenë, nëse kjo ndodh;
- shohin/pyesin nëse ka ndonjë çështje tjetër që viktimat duan të diskutojnë;
- shpjegojnë shkurtimisht se për çfarë u ra dakord në planin e ndërhyrjes dhe se çfarë veprimesh duhet të ndërmerren nga viktimat;

- shpjegojnë viktimave hapat e mëtejshëm dhe të shkëmbejnë kontaktet për të komunikuar në vazhdim;

- studiojnë gjatë takimeve në vijim ndryshimet që kanë ndodhur në situatat e viktimave, efektshmërinë e strategjive të përballimit, rezultatet e veprimeve që mund të jenë ndërmarrë nga viktimat;

- analizojnë vështirësitë me të cilat u përballën viktimat, si dhe t'i ndihmojnë ato për t'i trajtuar;
- ripërcaktojnë problemin, planin dhe veprimet e mëtejshme.

Shërbime të tjera mbështetëse

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror kanë përgjegjësi dhe për ofrimin e shërbimeve të tjera mbështetëse siç paraqiten në vijim:

- të ofrojnë ndihmë materiale dhe financiare: transport në raste urgjence, ushqim, strehim të sigurt, sende personale dhe sende për kujdesin shëndetësor bazë, transport nga dhe prej shërbimeve të tjera, ose mbulim të kostove të këtij shërbimi etj.;

- të ndihmojnë viktimat të rikenë identitetin e tyre duke i mbështetur që të krijojnë, të rimarrin apo të zëvendësojnë dokumentet e identifikimit;

- të ofrojnë informacion ligjor për viktimat e DHF/DHBGJ lidhur me të drejtat e tyre dhe mundësitë e ndryshme që mund të zgjedhin, siç janë aplikimi për një nga format e urdhrave mbrojtës që parashikon ligji, hedhja e hapave të caktuar për zgjidhje martese, marrja e kujdestarisë së fëmijëve etj.;

- të ofrojnë (ose të bëjnë referim në) shërbime të përshtatshme, të ndjeshme dhe miqësore ndaj fëmijëve, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare;

- të adresojnë rastet për kontaktim përmes linjave telefonike të ndihmës, të cilat duhet të jenë shërbime falas, në dispozicion 24 orë në ditë për 7 ditë të javës (ose në pamundësi, të jenë të paktën në dispozicion për një periudhë kohore 4 orë në ditë për 7 ditë të javës), përfshirë fundjavat dhe ditët e pushimit. Punonjëset dhe punonjësit të cilat/cilët do të përgjigjen në linjat telefonike të ndihmës duhet të kenë njohuritë dhe aftësitë e duhura dhe të jenë të mirëtrajnuar/a. Linjat telefonike të ndihmës (qoftë shërbim kombëtar apo vendor) duhet të ketë në protokollin e saj edhe lidhjen me shërbime të tjera të kujdesit shoqëror, shëndetësor dhe shërbime ligjore që u përgjigjen rrethanave individuale të grave, të rejave dhe vajzave.

Dokumentimi i DHF/DHBGJ

Çdo rast i DHF/DHBGJ duhet të dokumentohet nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe duhet t'i përcillet edhe për dijeni koordinatorit/es vendor/e të MKR-së. Dokumentimi përmban minimalisht një përshkrim të plotë të informacionit më të rëndësishëm rreth incidentit të veçantë të DHF/DHBGJ, nëse nuk ka historik. Dokumentimi i rastit të DHF/DHBGJ duhet të realizohet me anë të formularëve standard, shënimeve, grafikëve, fotove, regjistrave etj. Mbledhja e të dhënave të rëndësishme për secilin nga rastet e DHF/DHBGJ dhe përcjellja e tyre, në formatin standard të kërkuar, te koordinatori/ja vendore e MKR-së për pasqyrimin në sistemin elektronik të të dhënave (REVALB) mundëson: a) nxjerrjen e të dhënave për monitorimin dhe vlerësimin e menaxhimit të rasteve aktuale të DHF/DHBGJ; b) pasqyrimin e një pamjeje të qartë të rasteve të zbuluara në zona të caktuara; dhe c) vlerësimin e ecursisë së reagimit shumësektorial ndaj DHF/DHBGJ. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, duhet të:

- Mbledhin dhe regjistrojnë informacionin rreth rastit të viktimës së DHF/DHBGJ duke përfshirë: të dhëna demografike (p.sh. emrin, moshën, seksin), gjendjen civile, të dhëna për fëmijët që ka në kujdestari, kartelën e gjendjes mendore, konsumimin e substancave dhe të drogave, anëtarët e familjes dhe marrëdhëniet midis tyre, informacion mbi gjendjen socio-ekonomike të familjes së viktimës, si dhe të plotësojnë formularin për pëlqimin e informuar të viktimës.

- Mbledhin dhe regjistrojnë detajet e plota të incidentit të DHF/DHBGJ dhe historikun e dhunës, duke përfshirë:

- listimin e të gjitha provave që identifikojnë (duke bërë kujdes të mos cenojnë provat që mbështesin kryerjen e veprës penale);
- historikun e ndonjë incidenti tjetër, duke përfshirë ato me partnerë të mëparshëm;
- marrëdhënien e viktimës me dhunuesin;
- format e dhunës dhe shpeshtësinë e tyre;
- informacionin që mund të japë viktimë nëse janë përdorur armë (si dhe të çfarë lloji);
- dëshmitar/e të pranishëm gjatë incidentit, përfshirë fëmijët;
- përshkruajnë me hollësi pasojat/efektet që ka pasur dhuna (të natyrës fizike, psikologjike, mendore, shëndetësore dhe shoqërore);
- përshkruajnë faktorët e rrezikut dhe të mbrojtjes (personalë, familjarë dhe shoqërorë/mjedisorë);
- regjistrojnë veprimet e planifikuara ose të ndërmarra për të kapërcyer situatën e dhunës;
- pasqyrojnë planin e sigurisë dhe të ndërhyrjes (përfshirë dhe këshillat për ruajtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë), si dhe karakteristikat e rastit;
- mbledhin të dhëna që lidhen me zhvillimin e rastit, gjatë seancave të mëvonshme të këshillimit;
- mbajnë shënim ato çfarë viktimë tregon duke përdorur fjalët e saj;
- dokumentojnë dyshimet e tyre si punonjëse apo punonjës, si dhe provat ku mbështeten;
- informojnë viktimat për mundësinë e përdorimit të të dhënave të tyre dhe të marrin për këtë qëllim pëlqimin e informuar;
- ruajnë të gjitha të dhënat në një vend të sigurt. Për nivelin e informacionit dhe mënyrën e ruajtjes së tij të mbahen në konsideratë legjislacioni dhe standardet përkatëse të miratuara;
- planifikojnë mjaftueshëm kohë për të hedhur të dhënat në formularët përkatës të sistemit të regjistrimit të rasteve (REVALB), si dhe t'ia përcjellin ato në kohë koordinatorit/es vendor/e.

Referimi

Qëllimi i referimit është të trajtohen nevojat e menjëhershme dhe të shumta të viktimës, në mënyrë të atillë që të garantohet siguria pas denoncimit të rastit dhe kujdesi e trajtimi efektiv në përputhje me kërkesat e viktimës. Po kështu, referimi ka të bëjë me një qasje të bashkërenduar të ofrimit të shërbimit. Të gjithë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të jenë në dijeni të ekzistencës së Mekanizmave të Koordinuar të Referimit, si dhe të jenë të aftë të kryejnë referimin pavarësisht nëse janë ose jo pika e parë e kontaktit për viktimën. Një sistem referimi (apo dhe vetë Mekanizmi i Koordinuar i Referimit) nuk mund të jetë i efektshëm nëse informacioni dhe të dhënat, përfshirë dhe të dhënat për personat e kontaktit, rreth institucioneve apo organizatave ofruese të shërbimeve nuk janë të sistemuara dhe të shpërndara te të gjithë anëtarët e MKR-së apo edhe te të gjitha institucionet e rëndësishme. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror në bashkëpunim me koordinatorin/en vendor/e të MKR-së duhet të përgatisin një listë me institucionet dhe organizatat që mund të ofrojnë shërbimet për trajtimin e rasteve të DHF/DHBGJ, llojin e shërbimeve që ofrojnë, orarin dhe kushtet për ofrimin e këtyre shërbimeve gjatë 24-orëve, pagesat (nëse aplikohen), si dhe personat e kontaktit dhe mënyrën e kontaktimit (telefon, e-mail) të tyre. Kjo listë, me të dhëna të cilat duhet të përditësohen rregullisht në bazë mujore duhet të shpërndahet te të gjithë anëtarët e MKR-së me qëllim që në rast nevojë, referimi të kryhet sa më shpejt dhe më lehtë që të jetë e mundur.

Po kështu, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror duhet të:

- vlerësojnë se çfarë referimi mund të jetë i dobishëm për viktimën e DHF/DHBGJ, sipas nevojave dhe kërkesave të përcaktuara;
- informojnë viktimën rreth mundësisë për t'u referuar te shërbime të tjera, nëse kërkohet dhe/ose është e nevojshme;
- marrin pëlqimin e informuar të viktimës për të bërë referime, përpara se të hedhin hapa të tjerë;
- sqarojnë viktimën se çfarë informacioni do të ndahet me punonjëset dhe punonjësit e institucioneve/organizatave të shërbimeve të tjera ku po referohet rasti dhe çfarë informacioni do

të mbahet konfidencial (duke specifikuar nëse ka ndonjë detyrim ligjor për konfidencialitet të pjesshëm, pra kur flitet për vepër penale);

- japin viktimës informacion të plotë dhe të saktë rreth institucioneve/organizatave të shërbimeve të tjera, sipas pikave të shpjeguara më poshtë:

KUSH – cili institucion/organizatë ofron shërbime për viktimat e DHF/DHBGJ, shoqëruar me të dhënat e personit (emrin, numrin e telefonit) që mund të kontaktohet si pikë kontakti për atë shërbim.

ÇFARË – çfarë lloj mbështetjeje mund të presin të marrin nga ky institucion/kjo organizatë, së bashku me informacionin për kostot e këtij shërbimi (nëse ka).

KU – ku ndodhet saktësisht (adresa e saktë) institucioni/organizata që do të ofrojë shërbimin për të cilin po referohet.

- Bëjnë referimin në varësi të zgjedhjes së viktimës dhe të mos e nxitin viktimën të bëjë veprime për të cilat nuk ndjehet rehat.

- Shoqërojnë referimin me një raport të shkurtër me shkrim dhe një diskutim në telefon me punonjësën apo punonjësin tjetër të shërbimeve, me qëllim që viktimat të mos ketë nevojë ta përsërisë historinë dhe të mos u përgjigjet të njëjtave pyetjeve gjatë intervistave të shumta, për të shmangur traumën psikologjike të shkaktuar nga rritregimi i herëpashershëm i incidentit të DHF/DHBGJ.

- Nxisin pavarësinë e viktimës, duke e ndërgjegjësuar atë të bëjë vetë referimin.

- Shoqërojnë viktimën te shërbimit ku po referohet, nëse është e nevojshme dhe e mundur.

- Shpjegojnë se pse mund të jenë të rëndësishme/të dobishme të dhënat e mbledhura gjatë intervistimit mbi incidentin e DHF/DHBGJ, si dhe provat mbi këtë incident.

- Pyesin viktimën nëse dëshiron që të mblidhen të gjitha provat mbi dhunën dhe t'i rikujtojnë rëndësinë që ka mbledhja sa më e shpejt e këtyre provave, veçanërisht në disa prej formave të DHF/DHBGJ (p.sh. për dhunën seksuale), duke shpjeguar se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë duhet të shmangin në mënyrë që të ruhen/të mos shkatërrohen provat (p.sh. të mos lajnë/heqin rrobat).

- Referojnë viktimat në një shërbim tjetër për mbështetjen bazë, të tilla si:

- institucioni më i afërt që mund t'i ndihmojë në mbledhjen e provave;

- policia për të denoncuar;

- institucion shëndetësor për kujdes mjekësor;

- shërbime të tjera të kujdesit shoqëror;

- lidhin marrëveshje dhe protokolle për procesin e referimit me shërbime/institucione të rëndësishme, përfshirë përcaktimin e përgjegjësisë të qarta për secilin shërbim;

- sigurohen se procedurat midis shërbimeve/institucioneve për shkëmbimin e informacionit dhe referimet janë të njohura nga stafi dhe të bazuara në standardet e kërkuara.

IX. RRETHANAT DHE SJELLJET QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHF/DHBGJ

Efektet psikologjike të DHF/DHBGJ janë komplekse; shpesh, ndikimi traumatik mund të mos jetë i menjëhershëm, por për shkak të ripërsëritjes dhe natyrës së ashpër të DHF/DHBGJ, efektet janë kronike dhe të thella dhe mund të çojnë, në disa raste, në rezultate dramatike ose psikopatologji serioze.

Rrethanat që mund të tregojnë për ushtrimin e DHF/DHBGJ

Efektet më të zakonshme psikologjike dhe psikosomatike, janë:

- ndjenjat e fajit, turpit, inatit, mërzitjes, dëshpërimit, pazotësisë, mungesës së shpresës, boshllëkut, pafuqisë, mbytjes;

- ndjenja e vazhdueshme e të qenit në rrezik (të ndjerit gjithmonë vigjilent);

- frika nga gjithçka;

- pamundësia për t'u përkujdesur për veten ose për të tjerët;

- vështirësi në përqendrim;

- një ndjenjë e thellë vetmie (izolim);

- humbje e aftësisë për të planifikuar;
- humbje e dëshirës për aktivitete sociale me miqtë;
- mungesë e iniciativës, frikë për ta përballuar jetën vetëm, për të gjetur kuptimin dhe qëllimin e jetës;

- mungesë e vetëvlerësimit;
- shqetësim, nervozizëm;
- takikardi;
- sjellje që tregojnë fobi;
- çrregullime gastrointestinale;
- çrregullime të gjumit;
- çrregullime në të ngrënë;
- çrregullime të stresit postraumatik;
- dhimbje koke;
- dhimbje muskujsh;
- abuzim me substanca;
- depresion/shëndet jo i mirë mendor.

Efekte specifike psikologjike më të zakonshme në rastet e dhunës seksuale

- përhumbje në mendime;
- kthim në retrospektivë (kujtimet e traumës rikthehen papritmas në mendje në mënyrë shqetësuese);

- reagime fizike (dridhje ose vështirësi për të mbajtur mend ngjarjen traumatike);
- copëzim kujtese/kthime mbrapa në kohë;
- makthe.

Sjellje e shoqëruar me DHF/DHBGJ

- izolim që vjen nga shmangia e njerëzve, vendeve, aktiviteteve, sjelljeve dhe qëndrimeve që nuk i pëlqenin dhunuesit (si mbrojtje ndaj dhunës së përshkallëzuar);

- ndryshim i vazhdueshëm i vendit të punës;
- rrallimi i aktiviteteve sociale dhe argëtuese;
- shmangia e njerëzve, vendeve ose situatave që mund ta kujtojnë ose rikthejnë ngjarjen në mendjen e viktimës;

- humbja e aftësisë për të mbrojtur veten dhe fëmijën e saj të mitur;
- pavendosmëria;
- mohim dhe minimizim i ngjarjes dhe i pasojave.

X. MJEDISI I PUNËS

Përshtypjet e para kanë gjithnjë një ndikim të fortë dhe kuptimplotë. Përshtypjet e para të një viktime të DHF/DHBGJ e cila paraqitet apo referohet për të marrë një shërbim të kujdesit shoqëror fillojnë të krijohen që nga ndërtesa, korridori dhe i gjithë mjedisi ku ofrohen këto shërbime. Kjo përshtypje mund të ndikojë në reagimin dhe gatishmërinë e viktimës për t'iu nënshtruar veprimeve të tjera në të ardhmen, e për më tepër e gjitha kjo ndodh përpara se punonjësja apo punonjësi i shërbimeve të kujdesit shoqëror të ketë mundësinë ta përshëndesë dhe ta mirëpresë viktimën.

Diskutimi me viktimën e DHF/DHBGJ duhet të zhvillohet në një tavolinë të rrumbullakët, ose më mirë, pa tavolinë fare (por duke ruajtur një distancë të paktën një metër me të, në respektim të hapësirës personale). Ulja në dy anë të ndryshme të tavolinës mund të shërbejë si pengesë tjetër në komunikimin me viktimën e DHF/DHBGJ. Viktima e cila percepton se nuk është në pozita të barabarta me punonjësën apo punonjësin e shërbimit të kujdesit shoqëror mund të kufizojë sasinë e informacionit dhe mund të mos e ndërtojë besimin që nevojitet për një marrëdhënie korrekte e profesionale. Qëndrimi ekzaktësisht ballë për ballë dhe ngulja e vështirimit në sytë e viktimës, mund t'i krijojë asaj përshtypje të gabuar, sikur po e konfronton, siç vepron zakonisht dhunuesi. Vendosja e viktimës në një pozicion nga ku mund ta shikojë hyrjen/daljen nga ambienti ku po zhvillohet takimi/biseda mund t'i japë ndjesinë se e ka situatën në kontroll, ndryshe nga situata e zakonshme me dhunuesin ku viktima është e izoluar dhe nën kontroll.

Trajtimi i niveleve të sipërme të piramidës së hierarkisë së nevojave të Maslow⁶⁷ mund të jetë e vështirë nëse kërkesat fizike të mbijetesës njerëzore nuk plotësohen. Viktimës i duhen ofruar lëngje, ushqime dhe ujë pasi shumë prej tyre kanë pak ose aspak qasje në ushqim. Duhet të mbahet parasysh dhe fakti që disa institucione ofruese të shërbimeve nuk kanë fonde për pije freskuese dhe ushqim, prandaj kostot mund të duhet t'i përballojnë nga xhepi i tyre. Kjo nuk është e drejtë dhe duhet të adresohet në një formë apo një formë tjetër për të gjetur zgjidhje si pjesë e çështjeve që trajtohen dhe zgjidhen përmes MKR-së.

XI. SI TË BASHKËVEPROJMË ME NJË VIKTIMË TË DHF/DHBGJ

Të pyesësh mbi DHF/DHBGJ e ushtruar ndaj dikujt mund të jetë e vështirë për cilëndo/cilindo punonjëse/punonjës të një shërbimi të caktuar. Rekomandimet e mëposhtme i ndihmojnë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror të rrisin besimin e tyre kur shtrojnë pyetje për DHF/DHBGJ dhe gjithashtu të shmangin riviktimizimin.

- Të marrin nismën të pyesin rreth dhunës – të mos presin që t'ua tregojë vetë viktima. Marrja e nismës tregon që punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin përgjegjësi profesionale ndaj situatës së viktimës dhe ndihmon në krijimin e besimit.

- Të shmangin pyetjen e viktimës rreth DHF/DHBGJ në praninë e një anëtarit/anëtareje të familjes, të një miku, të fëmijëve apo të një personi tjetër.

Të tregohen të durueshëm me viktimat dhe të mbajnë parasysh që gjatë krizave ato mund të shfaqin ndjenja kontradiktore. Të mos ushtrorjnë presion mbi viktimën që ta bëjnë atë të flasë. Nëse ajo nuk flet, t'i tregojnë viktimës se çfarë i bëri të dyshonin për dhunë.

- Të shmangin ndërprerjet e panevojshme dhe të bëjnë pyetje për sqarime vetëm pasi viktima të ketë përfunduar rrëfimin.

- Të shmangin dëgjimin pasiv dhe moskomentimin. Kjo mund ta bëjë viktimën të mendojë se punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror nuk e besojnë atë dhe se ajo e ka gabim, ndërsa dhunuesi ka të drejtë. Të dëgjojnë me kujdes përjetimet e saj dhe ta sigurojnë që gjithçka ajo ndjen është e justifikueshme.

- Të përdorin të njëjtin gjuhë si ajo e viktimës; nëse viktima flet një gjuhë tjetër ndryshe nga ajo e punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të kërkohej ndihmë nga një ofrues tjetër shërbimi që flet të njëjtën gjuhë me viktimën/të mbijetuarën, ose një përkthyesje apo përkthyesi ta ndihmojë atë, ose të një specialisteje apo specialisti të gjuhës së shenjave në rast të personave me aftësi të kufizuara në dëgjim. Përdorimi i të njëjtës gjuhë me viktimën vlen edhe në rast të trajtimit të viktimave nga komuniteti Rom.

- Të përshtatin gjuhën ose fjalët sipas nivelit arsimor të viktimës. Të mos përdorin gjuhë profesionale dhe shprehje që mund ta ngatërrojnë viktimën.

- Të formulojnë pyetje dhe fjali në mënyrë të tillë që të përçojnë mesazhe mbështetëse dhe jo paragjyquese, duke folur me ton dashamirës. Të përdorin pyetje të hapura dhe të shmangin pyetjet që fillojnë me “pse”, që tentojnë t'ia hedhin fajin viktimës së DHF/DHBGJ.

- Të mos e fajësojnë viktimën. Të shmangin pyetje të tilla si “Pse qëndroni me të?”, “A patët ndonjë debat me njëri-tjetrin para se të ushtronte dhunë?”, “Çfarë po bënit jashtë e/i pashoqëruar?”, “Çfarë kishit veshur?” etj. Në vend të tyre të theksojnë që DHF/DHBGJ nuk mund të tolerohet.

⁶⁷ E prezantuar në 1943 nga psikologu humanist Abraham Maslow, koncepti i hierarkisë së nevojave sugjeron se njerëzit duhet të përmbushin nevojat bazë përpara se të kalojnë te të tjera nevoja më të avancuara. Kjo hierarki zakonisht shfaqet në formën e një piramide. Ekzistojnë pesë nivele të ndryshme në hierarkinë e nevojave të Maslowt:

1. Nevojat fiziologjike (ndryshe njihen edhe si nevojat bazë): nevojat jetësore si uji, ajri, ushqimi dhe gjumi.
2. Nevojat për siguri: punësim i qëndrueshëm, përkujdesje shëndetësore, lagje e sigurt, mbrojtje ndaj mjedisit, strehim.
3. Nevojat për përkatësi: nevojat për t'i përkitur dikujt, për dashuri, për afekcion, për shoqëri, për lidhje romantike, dhe familja ndihmon në plotësimin e nevojave për shoqërim dhe për pranim, njësoj si përfshirja në shoqëri, në komunitet apo në grupe fetare.
4. Nevojat për vlerësim: gjëra që ndikojnë në vetëbesim, në vlerësimin e vetvetes, në njohjen nga shoqëria dhe në arritjet në jetë.
5. Nevojat për vetaktualizim: vetëdije, shqetësim mbi rritjen personale, më pak i shqetësuar për mendimin e të tjerëve dhe interesimi në përmbushjen e potencialit të tyre, dëshirë për të dhënë kontribut për brezat e ardhshëm.

- Të përdorin pohime mbështetëse, të tilla si “Më vjen keq për çka ju ka ndodhur” ose “Me të vërtetë paskeni hequr shumë”, që mund të inkurajojnë viktimën të ndajë me punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror më shumë informacion.

- Të theksojnë se dhuna nuk ndodhi për fajin e viktimës dhe se vetëm dhunuesi/ja është përgjegjës/e për ushtrimin e saj.

- Të njohin viktimën me të drejtat dhe legjislacionin në fuqi, si dhe me mundësitë që kanë në dispozicion (domethënë, qëndrimi brenda marrëdhënies, planifikimi i sigurisë, qëndrimi te familjarët apo miqtë, marrja e shërbimeve mbështetëse të specializuara, kërkimi i një urdhri mbrojtjeje etj.).

- T’i shpjegojnë viktimës parimin e konfidencialitetit dhe privatësisë, si dhe rastet e kufizimit të konfidencialitetit për shkak të respektimit të kuadrit ligjor në fuqi.

- Ta shikojnë viktimën në sy aq sa është normale për kulturën shqiptare dhe ta përqendrojnë të gjithë vëmendjen tek ajo. Të shmangin plotësimin e dokumenteve në të njëjtën kohë që flasin me të, duke përdorur nëse është e mundur regjistrimin e bisedës. Në pamundësi të regjistrimit të bisedës, t’ia shpjegojnë viktimës shënimet që po mbajnë dhe dokumentet që po plotësojnë.

- Të jenë të vetëdijshëm për gjuhën e trupit. Mënyra se si qëndrojnë, mbajnë krahët dhe kokën, shprehja e fytyrës dhe toni i zërit të punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përcjellin një mesazh të qartë të viktimës për mënyrën se si e perceptojnë situatën e saj. Të mbajnë një qëndrim joparagjykses dhe mbështetës dhe të pajtohen me çfarë deklaron viktima, për të vijuar më tej me menaxhimin e rastit. Të shmangin gjuhën e trupit që mund të përcjellë mesazhe acarimi, mosbesimi, mospëlqimi apo zemërimi ndaj viktimës.

- Të mos e paragjykojnë sjelljen e viktimës mbi bazën e moshës, vendbanimit, etnisë, besimit fetar, aftësive të kufizuara, orientimit seksual, statusit socio-ekonomik etj.

XII. VLERËSIMI DHE MENAXHIMI I RASTIT

Vlerësimi dhe menaxhimi i rastit mund të zvogëlojë nivelin e rrezikut. Plani i sigurisë është pjesë e ndërhyrjes ndaj rastit që mund të parandalojë incidente dhune në të ardhmen ose të shmangë përshkallëzimin e situatës apo ballafaqimin me situata ekstreme. Plani i sigurisë duhet të përgatitet duke marrë në konsideratë faktorët e riskut dhe burimet në dispozicion.

Për të përgatitur një plan sigurie të efektshëm nevojitet identifikimi i faktorëve që mund të sjellin përsëritjen dhe përshkallëzimin e dhunës. Sa më shumë faktorë risku të identifikohen në një rast të DHF/DHBGJ aq më i madh është rreziku ndaj të cilit janë të ekspozuar viktimat e kësaj dhune.

Faktorë risku që mund të identifikohen:

- akte/incidente të mëparshme të DHF/DHBGJ ndaj viktimës, fëmijëve apo ndonjë pjesëtari tjetër të familjes. Histori abuzimesh, formash dhe lloje dhune të përdorura, dënime apo denoncime të mëparshme në polici, si dhe armët e përdorura, janë tregues për t’u marrë në konsideratë kur vlerësohet rrezikshmëria;

- sjellje të dhunshme jashtë familjes;

- ndarjet dhe zgjidhjet e martesave janë periudha kohore kur rreziku është i lartë;

- bashkëpunimi i pjesëtarëve të tjerë të familjes me dhunuesin;

- mbajtje me leje apo pa leje dhe/ose përdorim i armëve, ose kërcënim për t’i përdorur ato;

- konsumimi i alkoolit apo i drogave mund të mos frenojë sjelljet dhe mund të çojë në përshkallëzim të dhunës;

- kërcënime, në veçanti, kërcënimet me vdekje duhet të merren seriozisht;

- xhelozia dhe posesiviteti ekstrem;

- koncepte dhe qëndrime tërësisht patriarkale;

- persekutim dhe terror psikologjik (përndjekje);

- mospajtim me urdhrat e mbrojtjes të lëshuara nga gjykata apo policia (urdhri për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme);

- faktorë të tjerë nxitës që mund të çojnë në përshkallëzim të dhunës (ndryshim sjelljesh në marrëdhënie).

Përgatitja e një plani fillestar sigurie është e domosdoshme dhe nëse është e nevojshme brenda këtij plani duhet të propozohet edhe referimi, që duhet të organizohet në një mënyrë jostigmatizuese. Po kështu, nëse është e nevojshme duhet të mendohet zbatimi i këtij plani të sigurisë në mënyrë sa më të sigurt. Në këtë kuadër, viktimat duhet të:

- listojë personat (shoqet, shokët, fqinjët, të afërmit, familjarët), të cilat/cilët mund të merren në telefon në një situatë urgjence ose që mund të ofrojnë strehim për pak ditë;
- identifikojë një ose më shumë fqinjë, të cilave/cilëve mund t'u tregojë për dhunën dhe t'u kërkojnë ndihmë nëse dëgjojnë një zhurmë në shtëpinë e viktimës/të mbijetuarës;
- praktikojë si mund të dalë nga shtëpia në mënyrë të sigurt;
- bëjë gati një çantë sigurie me sendet e nevojshme dhe ta vendosë në një vend nga ku mund të merret lehtësisht në një situatë urgjente;
- përdorë instinktet dhe gjykimin e saj. Nëse situata është e rrezikshme, të ketë parasysh t'i japë dhunuesit atë që kërkon që ta qetësojë. Viktima ka të drejtë të mbrojë veten dhe fëmijët e saj;
- gjykojë për mundësinë për t'iu drejtuar për ndihmë në të ardhmen institucioneve të tjera të shërbimeve;
- mos harrojë, ajo nuk meriton që të goditet ose të kërcënohet.

BIBLIOGRAFIA

- Shqipëria: Raporti i GREVIOs për masat legjislative dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshilli të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”, publikuar më 24 nëntor 2017;
- Ligji nr. 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 ‘Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare’”, të ndryshuar;
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 912, datë 27.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”;
- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 866, datë 20.12.2018 “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”;
- Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;
- Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”;
- Komisioni për Statusin e Grave: Sesioni 57 (2013), konkluzionet e dakordësuara: Eliminimi dhe parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave (E/2013/27).
- IASC (2005), udhëzime për ndërhyrjet e dhunës me bazë gjinore në mjediset humanitare: fokusi te parandalimi dhe përgjigja ndaj dhunës seksuale në situata emergjence;
- UNFPA (2001), një qasje praktike ndaj dhunës me bazë gjinore: një udhëzues programi për ofrueset/it dhe menaxheret/ët e kujdesit shëndetësor;
- UNFPA, WAVE (2014), forcimi i përgjigjeve të sistemit shëndetësor për gratë dhe vajzat që kanë përjetuar dhunën. Standardet dhe udhëzimet e cilësisë;
- UN Women, UNFPA, UNDP, UNODC (2014), Strategjia për shërbimet ligjore bazë për t'iu përgjigjur dhunës ndaj grave dhe vajzave. Shërbimet dhe standardet e cilësisë bazë;
- OBSH (2013) Përgjigje dhunës dhe dhunës seksuale nga partneri intim ndaj grave: udhëzimet e OBSH-së për klinikat dhe politikat;
- (2010), Të ndihmojmë të mbijetuarit e dhunës në familje dhe dhunës seksuale: Një udhëzim prezantues për këshillimin për ofrueset/it e ndihmës;
- Larg dhunës: udhëzime për të ngritur dhe menaxhuar strehime për gratë, 2004, Zyra e Koordinimit të WAVE-it, Rrjeti i Strehëzave të Grave Austriake, Vjenë;
- Qendra e Ekselencës për Fëmijët nën Kujdes në Skoci, të ecësh më tej: Zbatimi i Udhëzimeve për Kujdesin Alternativ për Fëmijët 2012, mund ta gjeni në adresën: http://www.unicef.org/protection/files/Moving_Forward_Implementing_the_Guidelines_English.pdf;

- Qendra për Analizim të Shëndetit dhe temave të tjera të lidhura me të (2012): udhëzime etike për këshillimin e grave të dhunuara në familje, India. Departamenti i Zhvillimit Social, Republika e Afrikës së Jugut (2008): “Strehëzat për viktimat e dhunës në familje” standardet minimale për ofrimin e shërbimeve dhe fuqizimin e viktimave;

- Përcaktimi i Procedurave Standarde të Veprimit (PSV-ve) për Dhunën me Bazë Gjinore për parandalimin dhe përgjigjen shumësektoriale dhe ndërqeveritare të dhunës me bazë gjinore në ambientet humanitare. Për më shumë shih në adresën: <http://gbvaor.net/wp-content/uploads/sites/3/2012/10/Establishing-Gender-based-Standard-Operating-Procedures-SOPs-for-Multi-sectoral-and-Interorganisational-Prevention-and-Response-to-Genderbased-Violence-in-Humanitarian-Settings-ENGLISH.doc>;

- Shoqata e Qeverive Vendore, Ndihma e grave etj. (Mbretëria e Bashkuar): ‘Standardet dhe shërbimet’ në vizionin e shërbimeve për fëmijët dhe të rinjtë e dhunuar në familje (f. 13);

- UN Women, Qendra Virtuale e të Nxënës për t’i Dhënë Fund Dhunës kundër Grave dhe Vajzave, në adresën: <http://www.endvawnow.org/en/>

URDHËR **Nr. 101, datë 21.2.2020**

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV) PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA PUNONJËSET/PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT SI ANËTARË TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT (MKR)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 104, datë 8.11.2012, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”; të nenit 28, germa “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore të cilat/cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR), sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të kujdesit shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe drejtuesit e shërbimeve shëndetësore e të mbrojtjes sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

PROCEDURAT STANDARDE

TË VEPRIMIT PËR TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NGA PUNONJËSET DHE PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, NË KUADËR TË BASHKËPUNIMIT SI ANËTARË TË MEKANIZMIT TË KOORDINUAR TË REFERIMIT

Shkurt, 2020

HYRJE

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore të cilat/cilët trajtojnë rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR), u përgatitën nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), me mbështetjen e Zyrës së UNFPA-së, Shqipëri, përmes organizatës së saj partnere në zbatim, Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin.

PSV-të adresojnë çështjet që duhet të njohin dhe hapat që duhet të ndjekin punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pavarësisht nëse janë shërbime parësore, dytësore apo të nivelit të tretë (edhe pse këto të fundit ndeshen apo përfshihen më rrallë me trajtimin e këtyre rasteve). Shërbimet e kujdesit shëndetësor, në këtë rast, janë parë si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Përgatitja e PSV-ve për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe trajtimin e rasteve në mënyrë shumësektoriale të koordinuar shërben, ndër të tjera, edhe si mjet për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të MKR-ve në vend.

PSV-të u përgatitën përmes një procesi të gjatë e gjithëpërfshirës konsultimi të udhëhequr nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku u angazhuan specialiste dhe specialistë të Sektorit të Shëndetësisë, si dhe specialistët e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; eksperte dhe ekspertë të fushës⁶⁸, si dhe anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të ngritur në nivel të vetëqeverisjes vendore. Të bazuara në praktikën më të mirë ndërkombëtare⁶⁹, këto PSV u përshtatën, u diskutuan dhe u përditësuan për të qenë lehtësisht të zbatueshme edhe në Shqipëri.

Siç parashikohet edhe në kuadrin ligjor, institucional dhe të politikave në Shqipëri, koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve e burimeve është domosdoshmëri për të përparuar në drejtim të përmbushjes së objektivave, lidhur me parandalimin dhe luftën kundër dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore. Në nivel qendror, këtë rol parësor e luan autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, pra aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në nivel të vetëqeverisjes vendore, trajtimi i rasteve të dhunës në familje, por edhe të dhunës me bazë gjinore, kryhet përmes qasjes shumësektoriale të koordinuar që merr jetë përmes ngritjes dhe funksionimit me efektivitet të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, pranë çdo bashkie në vend.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor, në të gjitha nivelet e tyre, konsiderohen anëtarë shumë të rëndësishëm të MKR-ve dhe madje janë të përfshirë edhe në atë pjesë të Ekipit Teknik Ndërdisiplinar që aktivizohet menjëherë për çdo rast të paraqitur (i quajtur ndryshe edhe “Ekipi bërthamë”). Ky rol u bashkëlidhet pikërisht, për shkak të rëndësisë së ndërhyrjes së tyre për të siguruar vazhdimësinë e jetës, si dhe të jetuarit duke gëzuar shëndet të plotë fizik, mendor, seksual e riprodhues etj.

Prandaj edhe zbatimi i këtyre PSV udhëhiqet si nga parimet bazë të shëndetësisë ashtu edhe nga parimet bazë të zbatimit të qasjes shumësektoriale të koordinuar, të cilat zbërthehen në pjesë të caktuara të dokumentit në vijim.

⁶⁸ Z. Ramiz Kërnaja, mjek familjeje dhe znj. Monika Kocaqi, ekspertë për çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje.

⁶⁹ Versioni origjinal i tyre është përgatitur nga Instituti i Evropës Lindore për Shëndetin Riprodhues (EEIRH, Rumani) dhe botuar nga Zyra Rajonale e UNFPA-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (UNFPA EECARO), në vitin 2015 (me ISBN 978-973-87875-9-9).

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTIME

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

II. BAZA LIGJORE

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

IV. ZBATUESHMËRIA

V. PARIMET DREJTUESE

VI. ELEMENTET THEMELORE

VII. UDHËZIMET PËR SHËRBIMET THELBËSORE SHËNDETËSORE

VII. RRETHANAT DHE SJELLJET QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHF-së/DHBGJ-së

IX. SI TË BASHKËVEPRONI ME VIKTIMËN E DHF-së/DHBGJ-së

X. PROCEDURAT

Identifikimi

Vlerësimi

Ofrimi i shërbimeve/ndërhyrja

Vlerësimi dhe menaxhimi i shëndetit mendor/psikologjik

Mbledhja e provave

Dokumentimi i DHF-së/DHBGJ-së

Referimi

REFERENCA

SHKURTIME

DHBGJ	Dhunë me bazë gjinore
DHF	Dhunë në familje
DHnGV	Dhunë ndaj grave dhe vajzave
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisciplinar
KM	Këshilli i Ministrave
KVDHF	Koordinator/e vendor/e kundër dhunës në familje
LGBTI	Lezbike, gei, biseksualë, transseksualë, interseksualë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (për rastet e dhunës në familje)
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJVV	Njësi e vetëqeverisjes vendore
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizatë joqeveritare jofitimprurëse
PTSD	Çrregullime të stresit posttraumatik
PSV	Procedura standarde të veprimit
QSHPHZ	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë

I. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, përshkruajnë tërësinë e veprimeve dhe hapave thelbësorë që duhet të planifikohen, koordinohen, zbatohen, monitorohen dhe vlerësohen rregullisht, për ofrimin e kujdesit dhe ndihmës së duhur në situata të dhunës në familje dhe/ose dhunës me bazë gjinore. Me fjalë të tjera, PSV-të janë udhëzime të shkruara mbi atë se çfarë pritet dhe çfarë kërkohet nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për kryerjen e punës dhe ofrimin e ndihmës e mbështetjes së tyre, si anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (DHF), si dhe të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ).

Sistemi shëndetësor dhe punonjëset e punonjësit e shërbimeve shëndetësore luajnë një rol të rëndësishëm, për sa i përket identifikimit, vlerësimit, trajtimit, ndërhyrjes në situatë krize, dokumentimit, referimit dhe ndjekjes së rasteve të DHF-së/DHBGJ-së.

Një reagim cilësor i shërbimit shëndetësor kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave, si dhe ndaj cilësdo/cilitdo individ në familje është kritik, jo vetëm për t'u siguruar që viktimat e DHF-së/DHBGJ-së kanë akses në marrjen e kujdesit shëndetësor me standardet më të larta të arritshme, por edhe sepse ofruesit e kujdesit shëndetësor (të tillë si: infermieret dhe infermierët, mjeket dhe mjekët, si dhe të tjerë) ka të ngjarë të jenë kontakti i parë profesional për gratë të cilat kanë qenë subjekt i dhunës nga partneri intim ose i dhunës seksuale⁷⁰. Gratë dhe vajzat shpesh kërkojnë shërbime shëndetësore për dëmtimet e tyre edhe nëse nuk e tregojnë dhunën apo abuzimin e lidhur me këto dëmtime. Studimet tregojnë se gratë e abuzuara e përdorin më shumë shërbimin shëndetësor, se sa gratë ndaj të cilave nuk është ushtruar dhunë⁷¹. Ato, gjithashtu, i identifikojnë ofruesit e kujdesit shëndetësor si profesioniste dhe profesionistë, te të cilat/të cilët do të besonin më së shumti për zbulimin e rasteve të dhunës.

Konkluzionet e dakorduara të Komisionit të 57-të për Statusin e Grave, mbi eliminimin dhe parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave, bëjnë thirrje për veprime për: "... Adresimin e të gjitha pasojave shëndetësore, përfshirë pasojat shëndetësore fizike, mendore, seksuale dhe të shëndetit riprodhues, të dhunës ndaj grave dhe vajzave, duke ofruar shërbime shëndetësore të aksesueshme në përgjigje ndaj traumave dhe që përfshijnë: ilaçe të përballueshme, të sigurta, efektive dhe me cilësi të mirë, trajtim të plagëve dhe mbështetje për shëndetin psikosocial dhe mendor, kontraceptivin e emergjencës, abortin e sigurt (kur këto shërbime lejohen nga legjislacioni kombëtar), profilaksinë pas ekspozimit për infeksionin HIV, diagnostikimin dhe trajtimin për infeksionet seksualisht të transmetueshme, trajnimin e profesionisteve dhe profesionistëve të shërbimeve shëndetësore për të identifikuar dhe për të trajtuar në mënyrë efektive gratë e dhunuara, si dhe ekzaminimin mjekoligjor nga mjeke dhe mjekë ligjorë të trajnuar siç duhet ...".

PSV-të janë hartuar për të dhënë një përshkrim të qartë dhe të detajuar të veprimeve rutinë të punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore, të cilat/të cilët mund të ofrojnë ndihmë dhe shërbime për viktimat/të mbijetuarat e DHF-së/DHBGJ-së.

Objektivat e PSV-ve për ndërhyrjen e punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore në rastet e DHF-së/DHBGJ-së janë si vijojnë:

- të identifikojnë me efektivitet viktimat;
- të garantojnë dhe të rrisin sigurinë e viktimave në të gjitha fazat e ndërhyrjes;
- të sigurojnë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara, të cilat duhet të jenë të shpejta dhe profesionale;
- të lehtësojnë dokumentimin e përmirësuar dhe të koordinuar të mbledhjes së të dhënave mbi rastet e DHF-së/DHBGJ-së, duke mundësuar dhe përcjelljen e tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi dhe praktikave të dakordësuara në MKR;
- të garantojnë konfidencialitetin dhe privatësinë e shërbimeve të ofruara për viktimat, duke mos anashkaluar përgjegjësinë për të raportuar pranë policisë një rast të DHF-së/DHBGJ-së, kur ky përbën vepër penale, si dhe për të njoftuar edhe Koordinatorin/en Vendor/e kundër Dhunës në Familje të MKR-së, për rastet e DHF-së;
- të lehtësojnë referimin efektiv për viktimat brenda sektorit të shëndetësisë, si dhe te shërbimet e tjera jashtë këtij sektori;
- të kryejnë lidhjen e shërbimeve shëndetësore me shërbimet e tjera që u ofrohen viktimave, duke respektuar parimet e funksionimit të MKR-së dhe mënyrën e koordinimit të veprimeve mes anëtarëve të tij.

⁷⁰ OBSH: "Në përgjigje të dhunës nga partneri intim dhe të dhunës seksuale ndaj grave: Udhëzimet klinike dhe të politikave të OBSH-së". Gjenevë, OBSH, 2013, në faqen 1.

⁷¹ Po aty.

II. BAZA LIGJORE

Këto PSV mbështeten në një kuadër ligjor kombëtar të përditësuar e të plotësuar dhe me një sërë dokumentesh ndërkombëtare të ratifikuara, ku ndër më kryesoret përmendim:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë⁷²;
2. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar me ligjin nr. 104/2012⁷³;
3. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)⁷⁴;
4. Deklarata e vitit 1993 për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave⁷⁵;
5. Deklarata e Pekinit e vitit 1995 dhe Platforma për Veprim⁷⁶;
6. Vendime të shumta të Asamblesë së Përgjithshme dhe të Këshillit për të Drejtat e Njeriut, së bashku me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 19, të Komitetit për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave;
7. Konkluzionet e përbashkëta, miratuar nga Komisioni për Statusin e Grave në sesionin e tij të 57-të;
8. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9914/2008, me ligjin nr. 10329/2010 dhe me ligjin nr. 47/2018;
9. Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i procedurës penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
10. Ligji nr. 10221/2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”;
11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011, “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij” etj.

Gjithashtu, PSV-të mbështeten dhe udhëhiqen edhe nga parashikimet në dokumente të rëndësishme strategjike apo të politikave, të tilla si:

- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i saj i Veprimit, 2016–2020;
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2016–2020.
- Paketa Bazë e Kujdesit Shëndetësor Parësor⁷⁷, rishikuar dhe miratuar me VKM-në nr. 101, datë 4.2.2015;
- Marrëveshjet e bashkëpunimit për formalizimin/vijimin e punës së Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të nënshkruara në nivel bashkie etj.

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Dhunë, sipas ligjit 9669/2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3 përkufizohet: “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”.

Viktimë sipas të njëjtit ligj cituar më sipër, përkufizohet “Personi mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim i një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik”. Përgjatë gjithë PSV-ve, do t'i referohemi këtij përkufizimi ligjor (pra “viktimë”), pavarësisht se një sërë profesionistesh e profesionistësh apo institucionesh që ofrojnë shërbime mbështetëse të specializuara për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, më së shumti përdorin termin “i/e mbijetuar” apo edhe “viktimë i/e mbijetuar”.

⁷² Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit. Miratuar me referendum më 22.11.1998. Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani. Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007. Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008. Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.9.2012. Ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015. Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016.

⁷³ Si dhe regjistruar në faqen e Konventës, në datën 4.2.2013 (shiko:

<http://www.conventions.coe.int/Treaty/Commun/ChercheSig.asp?NT=210&CM=&DF=&CL=ENG>

⁷⁴ Shqipëria e ka ratifikuar këtë konventë në vitin 1993 dhe protokollin e saj shtesë në vitin 2003.

⁷⁵ Vendim i Asamblesë së Përgjithshme 48/104.

⁷⁶ Raporti i Konferencës së Katërt Botërore për Gratë, Pekin, 4–15 shtator 1995 (Botim i Kombeve të Bashkuara, nr. i botimit E.96.IV.13), kapitulli 1, vendimi 1, shtojca I dhe shtojca II.

⁷⁷ www.shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/02/Paketa_e_rishikuar_e_miratuar.pdf

Dhunë në familje, gjithashtu, në të njëjtin ligj sa më sipër, përkufizohet: “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, i ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

“Pjesëtarë të familjes” janë: a) bashkëshorti/ja ose bashkëjetuesi/ja apo ish-bashkëshorti/ja apo ish-partneri/ja bashkëjetues; b) vëllezërit, motrat, përfshirë, sipas rastit, edhe bashkëshortin/en ose bashkëjetuesin/en e tyre, si dhe nipin e mbesën, nëse këta të fundit janë anëtarë të njësisë shtëpiake; c) paraardhësit dhe pasardhësit në vijë të drejtë, pa kufizime, përfshirë edhe rastet kur kjo marrëdhënie krijohet nëpërmjet birësimit; ç) prindërit e bashkëshortit/es ose të bashkëjetuesit/es, përfshirë dhe thjeshtin/thjeshtren, edhe sikur kjo lidhje të burojë nga birësimi; d) gjinia në vijë të drejtë, përfshirë edhe prindërit, edhe fëmijët e birësuar të bashkëshortit/es ose bashkëjetuesit/es; dh) vëllezërit dhe motrat e bashkëshortit, bashkëshortes, bashkëjetuesit/es; e) fëmijët e bashkëshortëve ose partnerëve bashkëjetues; ë) personat, të cilët janë ose kanë qenë në marrëdhënie intime, jo domosdoshmërisht të shoqëruar me bashkëjetesë, gëzojnë të njëjtën mbrojtje; f) kujdestari dhe personi që ndodhet në kujdesin e tij gjatë kohës që vazhdon kujdestaria, sipas përcaktimeve të kujdestarisë mbi të miturit dhe kujdestarisë për personat me aftësi të kufizuara dhe personit që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar sipas dispozitave të Kodit të Familjes”.

Dhuna në familje është, gjithashtu, veprë penale e parashikuar në nenin 130/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si: “Rrahja, si edhe çdo veprë tjetër dhune ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet.”; “Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues ose ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet”; “Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë, më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet”. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Dhunë fizike përkufizohet: “Përdorimi i forcës fizike kundër dikujt në një mënyrë që lëndon, dëmton ose e rrezikon atë person. Dhuna fizike përfshin një gamë të gjerë sjelljesh, si: gërvishtjet, shtyrjet, hedhjet, kapjet me forcë, kafshimet, vënien e duarve në fyt, pickimet, shpimet, shkuljet e flokëve, përdredhjet e krahut, shuplakat, shtrëngimin me forcë, goditjet, rrahjet, goditjet me shkelma, djegiet, goditjet me thikë, shtrëngimi i fytyrës/mbytytjet. Dhuna fizike mund të përfshijë edhe përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës, mjeteve të kufizimit të lirisë dhe/ose armëve nga ana e një personi (p.sh., armë zjarri, thikë apo ndonjë objekt tjetër) për të fituar dhe mbajtur kontrollin mbi një person tjetër”.

Dhunë psikologjike përfshin: “Një gamë sjelljesh që kanë për qëllim të kritikojnë, poshtërojnë, mbajnë nën kontroll, izolojnë, trembin shkaktojnë frikë dhe të sulmojnë karakterin e një individi, duke shkatërruar kështu ndjenjën e tij të vetëvlerësimit, vetëbesimit dhe sigurisë. Fyerjet, poshtërimet, të folurit në një mënyrë që sulmon karakterin e individit, të shkaktuarit e ndjenjës së frikës nëpërmjet kërcënimeve për ta lënduar fizikisht një individ dhe/ose persona të tjerë të afërt me të dhe/ose për të shkatërruar diçka të rëndësishme për të, janë disa prej formave të dhunës verbale, sulmit psikologjik e dhunës emocionale që përfshihen si pjesë e dhunës psikologjike.

Dhunë ekonomike “Mbajtja nën kontroll e parave nga një individ, pavarësisht nëse janë të fituara apo jo prej tij, ushtrimi i kontrollit dhe monitorimi i veprimeve të një individi kundrejt një individi tjetër mbi përdorimin dhe shpërndarjen e parave, përfshirë dhe ato të fituara prej punës së këtij të fundit, shpërdorimi për qëllime të kënaqësive vetjake nga ana e një individi, i parave të

domosdoshme për sigurimin e kushteve bazë të jetesës së familjarëve, kërcënimi konstant për ndërprerjen e burimeve ekonomike, detyrimi i një individi për të plotësuar të gjitha nevojat bazë të familjarëve për një periudhë të caktuar (p.sh., mujore), me një kuotë nën minimalen e parave që të nevojiteshin për këtë qëllim etj.”.

Dhunë seksuale: “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose prekje seksuale të padëshiruara ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi, duke përdorur shtrëngim, nga cilido person pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion ose kërcënime të tjera, për shembull kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mosmarrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin, për shembull, kur është i dehur, i droguar, në gjumë ose mendërisht i paafte për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin përdhunimin, të përkufizuar si shtrëngim fizik ose penetrim, duke përdorur shtrëngimin - edhe nëse në masë të vogël - të vulvës ose anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si tentativë për përdhunim. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si përdhunim në grup. Dhuna seksuale mund të përfshijë forma të tjera të sulmit mbi një organ seksual, duke përfshirë kontaktet e detyruara midis gojës dhe penisit, vulvës ose anusit. Termat “sulm seksual”, “përdhunim”, “abuzim seksual” dhe “dhunë seksuale” përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë”.

Dhuna seksuale është, gjithashtu, e parashikuar si vepër penale. Në nenin 107/a të Kodit Penal theksohet se: “Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë ose kundër fëmijëve të moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet”. Po kështu, në Kodin Penal bëhen edhe një sërë parashikimesh të tjera lidhur me marrëdhëniet seksuale me dhunë. Konkretisht: në nenin 102, “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura”; nenin 102/a, “Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur”; nenin 103, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet”; nenin 104, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës; nenin 105, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”; nenin 106, “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari” etj. Parashikime në Kodin Penal bëhen edhe për vepra të tjera, si kryerja e marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale në vendet publike, si dhe për kryerjen e veprave të turpshme me të mitur apo përfshirjen e qëllimshme si dëshmitar të një të mituri në veprime me natyrë seksuale, pornografia etj.

Dhunë ndaj grave përkufizohet si: “Shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private. Dhuna ndaj grave përfshin lloje të ndryshme të dhunës që pësojnë gratë, të reja dhe vajzat, si dhunën në familje, dhunën nga partneri intim, dhunën seksuale nga një person jopartner intim, ngacmimin seksual, martesën e detyruar, abortin dhe sterilizimin e detyruar, përndjekjen, krimet në emër të nderit, trafikimin dhe praktika të dëmshme si gjymtimi i organeve gjinitale femërore”.

Dhunë me bazë gjinore: “Çdo akt dhune që drejtohet ndaj një gruaje për shkak se është grua ose që ndikon te gratë në mënyrë disproporcionale”. Një formë diskriminimi që pengon

seriozisht aftësinë e gruas për të gëzuar të drejta dhe liri të barabarta me burrat. Ajo përbën një shkelje të së drejtës themelore për jetesë, liri, siguri, dinjitet, barazi ndërmjet grave dhe burrave, mosdikriminim dhe integritet fizik dhe mendor.

Ngacmim seksual përkufizohet si: “Çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fyes”.

Ngacmimi seksual është, gjithashtu, vepër penale dhe parashikohet në nenin 108/a të Kodit Penal të RSH-së, sipas të cilit: “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Përndjekja si vepër penale parashikohet në nenin 121/a të Kodit Penal, sipas të cilit: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë”.

Marrëdhënia intime, sipas ligjit 9669/2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar me ligjin 47/2018, neni 3, përkufizohet si: “Marrëdhënia ndërpersonale që përfshin, intimitet fizik ose emocional”.

Dhunë nga partneri intim cilësohet si forma më e përhapur e dhunës e përjetuar nga gratë, të reja apo adoleshentet në të gjithë botën dhe përfshin “një sërë veprimesh shtrënguese seksuale, psikologjike dhe fizike nga një partner intim aktual ose i mëparshëm, pa pëlqimin e tyre”.

Dhuna nga partneri intim dhe dhuna seksuale. Sulmi seksual nuk ekziston në izolim, por brenda një problemi më të madh shoqëror të dhunës ndaj grave. Një numër i madh i grave që vuajnë nga dhuna nga partneri intim, gjithashtu, përjetojnë sulme seksuale, por ato e raportojnë rrallë dhunën seksuale. Disa gra mund të mos i konceptojnë sulmet seksuale brenda një marrëdhënieje intime si një krim. Përveç kësaj, sulmet seksuale janë shumë më të stigmatizuara se dhuna nga partneri intim, kështu që gratë mund të ndihen të paafta për ta adresuar edhe këtë formë dhune kur kërkojnë ndihmë. Megjithatë, termi “dhuna nga partneri intim” dhe “dhuna seksuale” nuk janë sinonime. Gratë që vuajnë nga dhuna nga partneri intim nuk janë domosdoshmërisht viktimat të dhunës seksuale si pjesë e asaj përvoje. Përveç kësaj, shumë gra vuajnë nga dhuna seksuale jashtë një marrëdhënieje me një partner intim.

Dhuna në takime/lidhje dashurie cilësohet, si: “Model i sjelljeve abuzive, përfshirë abuzimin emocional, fizik, seksual dhe financiar të përdorura për të ushtruar pushtet dhe kontroll të partneri në një takim apo lidhje dashurie”. Në mënyrë të ngjashme, Instituti Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE) e përkufizon dhunën në një takim/lidhje dashurie, si: “lloji i dhunës nga partneri intim që ndodh midis dy personave në një marrëdhënie të ngushtë”.

Sulm seksual përkufizohet, si: “Akt seksual me apo pa kontakt fizik, i kryer nga një individ pa pëlqimin e viktimës ose, në disa raste, dhe veçanërisht kur janë të përfshirë fëmijët, përmes manipulimeve emocionale ose shantazhit. Është një veprim që e detyron një person t’u nënshtrohet dëshirave të një personi tjetër përmes shpërdorimit të pushtetit, përdorimit të forcës, detyrimit, ose kërcënimeve”. Sulmi seksual shkel të drejtat themelore të viktimës, përfshirë të drejtën për integritet fizik dhe psikologjik dhe sigurinë e personit. “*Akt seksual me kontakt fizik*” përfshin: përdhunimin/marrëdhënien seksuale me penetrim, përpjekjet për të kryer marrëdhënie

seksuale me penetrim/tentativë për përdhunim, prekjen/kontaktin seksual. “*Akt seksual pa kontakt fizik*” përfshin: ngacmimin seksual, ekspozimin e detyruar ndaj akteve seksuale (pornografi apo një akt seksual që po kryhet), ekspozimin apo zbulimin e organeve gjenitale, nxitjen e një fëmije të prekë trupin e tij/të saj apo të masturbohet, bërja e një regjistrimi vizual të një natyre seksuale të një fëmije.

Abuzim seksual i fëmijëve cilësohet, si: “Çdo aktivitet seksual midis një fëmije dhe anëtarit të ngushtë të familjes (incesti); ose midis një fëmije dhe një të rrituri; apo një fëmije dhe një fëmije më të rritur, jo anëtar familjeje. Ai përfshin si rastet e përdorimit të forcës ose detyrimit, ashtu edhe rastet kur nuk mund të jepet pëlqimi nga viktima për shkak të moshës së tij ose të saj”.

Shfrytëzim seksual cilësohet, si: “Çdo abuzim aktual ose përpjekje për abuzim, për qëllime seksuale, nga një pozicion i pafavorshëm, ndryshimi në pushtet ose besimi, përfshirë por pa u kufizuar te përfitimi monetar, në mënyrë shoqërore ose politike, nga shfrytëzimi seksual i tjetrit”.

“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

Terapia e Njohjes së Sjelljes (TNS) bazohet në konceptin se mendimet, në vend të faktorëve të jashtëm, si: njerëzit apo ngjarjet, janë ato që diktojnë ndjenjat dhe sjelljen e dikujt. TNS-ja zakonisht ka një komponent njohës (duke ndihmuar personin të zhvillojë aftësinë për të identifikuar dhe sfiduar mendimet negative joreale), si dhe një komponent sjelljeje. TNS-ja ndryshon, në varësi të problemeve specifike të shëndetit mendor.⁷⁸

Elementet themelore janë tipare ose komponente të shërbimeve thelbësore që zbatohen në çdo kontekst dhe sigurojnë funksionimin efektiv të shërbimit.

Shërbimet thelbësore përfshijnë një sërë shërbimesh bazë që ofrohen nga sektori i shërbimeve shëndetësore, shërbimeve të kujdesjes shoqërore, policisë dhe drejtësisë. Shërbimet duhet minimalisht të garantojnë të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e cilëndo grua ose vajze që ka përjetuar ose përjeton dhunë me bazë gjinore. Në Shqipëri, një pjesë e shërbimeve thelbësore, kryesisht në nivel vendor, ofrohen nga organizatat e shoqërisë civile, sidomos organizatat në mbrojtje të të drejtave të grave dhe të fëmijëve (shërbime të tilla si: strehimi emergjent dhe afatgjatë, këshillimi, mbështetja psikosociale dhe ligjore, ndjekja ligjore, shërbime për dhunuesit etj.). Në disa raste, institucionet shtetërore qendrore dhe vendore mbështesin ofrimin e këtyre shërbimeve nga organizatat e shoqërisë civile, përmes mbulimit të një pjese të kostove të shërbimit, ofrimit të ambienteve falas etj.

Mbështetja e linjës së parë i referohet nivelit minimal të mbështetjes (parësore psikologjike) dhe vlefshmërisë së përjetimeve që duhet të merren nga të gjitha gratë që e tregojnë dhunën te një ofrues i kujdesit shëndetësor (ose te një ofrues tjetër shërbimesh). Kjo mbështetje ka shumë elemente të përbashkëta me atë që quhet “ndihmë e parë psikologjike”, në kontekstin e situatave emergjente që përfshijnë përvoja traumatike.⁷⁹

Sistemi shëndetësor u referohet: i. të gjitha aktiviteteve, qëllimi kryesor i të cilave është promovimi, rimëkëmbja dhe/ose kurimi i shëndetit; ii. njerëzve, institucioneve dhe burimeve të organizuara së bashku, në përputhje me politikat e hartuara, për të përmirësuar shëndetin e popullatës ku ata shërbejnë⁸⁰.

Ofrues i shërbimit shëndetësor një individ ose një organizatë që ofron shërbime të kujdesit shëndetësor në mënyrë sistematike. Një ofrues individual i kujdesit shëndetësor mund të jetë një profesioniste apo profesionit i kujdesit shëndetësor, një punonjëse apo punonjës i shërbimit shëndetësor në komunitet ose çdo person tjetër që është trajnuar dhe ka njohuri në shëndetësi.

⁷⁸ Po aty.

⁷⁹ OBSH, “Në përgjigje ndaj dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale ndaj grave: Udhëzimet klinike dhe të politikave të OBSH-së”. Gjenevë, OBSH, 2013, në fjalorth. Për detaje të tjera, gjithashtu, shikoni OBSH, UNË, UNFPA: Kujdesi shëndetësor për gratë subjekt i dhunës nga partneri intim ose dhunës seksuale: Manual klinik. Gjenevë”, OBSH, 2014.

⁸⁰ OBSH, “Fuqizimi i sistemit shëndetësor: Fjalor termash”, që mund të gjendet në: www.who.int/healthsystems/Glossary_January2011.pdf.

Organizatat shëndetësore përfshijnë spitalet, klinikat, qendrat e kujdesit parësor dhe pika të tjera të ofrimit të shërbimeve. Punonjëse apo punonjës të kujdesit shëndetësor parësor janë infermieret dhe infermierët, mamitë, mjeket dhe mjekët, ose të tjerë⁸¹.

Dëshmia mjekoligjore përdoret në këtë PSV, siç përcaktohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, si: “lëndime të dokumentuara shitesë dhe anogjenitale, gjendja emocionale, si dhe ato modele dhe mostra që merren nga trupi ose veshjet e viktimës vetëm për qëllime ligjore. Prova të tilla përfshijnë: pështymën, lëngun seminal, flokët e kokës, qimet pubike, gjakun, urinën, fibrat, mbeturinat dhe dheun”.⁸²

Udhëzuesit e cilësisë mbështesin ofrimin dhe zbatimin e elementeve themelore të shërbimeve thelbësore, për të siguruar që ato janë efektive dhe me cilësinë e duhur për t’iu përgjigjur nevojave të grave dhe vajzave. Udhëzuesit e cilësisë shpjegojnë mënyrat se si duhet të ofrohen shërbimet, sipas qasjes që bazohet te të drejtat e njeriut, se si duhet të jenë të ndjeshme ndaj kulturës dhe si të fuqizojnë gratë. Ato bazohen dhe plotësojnë standardet ndërkombëtare, si dhe reflektojnë praktikën më të mira të përgjigjes ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

IV. ZBATUESHMËRIA

Kërkimi dhe praktika tregojnë se mënyra si ofrohen shërbimet ka një ndikim të rëndësishëm në efektivitetin e tyre. Çelësi për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, si dhe mbrojtjen e sigurisë dhe të mirëqenies së tyre, është të kuptuarit e natyrës gjinore të dhunës, shkaqeve dhe pasojave të saj, si dhe ofrimi i shërbimeve përmes kulturës së fuqizimit të grave, pra që i ndihmon gratë dhe vajzat të marrin në konsideratë një tërësi zgjedhjesh që kanë në dispozicion, si dhe që mbështet vendimet e tyre. Për të ofruar shërbimeve thelbësore cilësore, anëtarët e MKR-së duhet të marrin në konsideratë parimet kryesore, si dhe ekzistencën e elementeve themelore që përforcojnë ofrimin e çdo shërbimi thelbësor.

Për mbështetjen e personave që kanë përjetuar DHF-në, apo të grave, të rejave dhe vajzave që kanë përjetuar DHBGJ-në kërkohen një sërë shërbimesh thelbësore shëndetësore. Pesë elemente themelore janë identifikuar si të nevojshme për një përgjigje të plotë dhe efektive të shërbimit shëndetësor klinik:

- mbështetja e vijës së parë (që përfshin edhe referimet);
- kujdesi për plagët apo edhe për problemet mjekësore emergjente;
- ekzaminimi dhe trajtimi për sulm seksual;
- vlerësimi i shëndetit mendor;
- menaxhimi i stresit.

Në këto PSV përshkruhen procedura të qarta që rregullojnë veprimtarinë rutinë hap pas hapi, rolet dhe përgjegjësitë që duhen ndjekur nga punonjëset dhe punonjësit e çdo institucioni që ofron shërbime shëndetësore. Ky mund të jetë institucion i kujdesit parësor, dytësor apo edhe i nivelit të tretë.

Për një zbatim më të mirë të këtyre PSV-ve rekomandohet një trajnim bazë i punonjësve dhe i punonjësve të shërbimeve shëndetësore, të cilat/të cilët trajtojnë rastet e DHF-së/DHBGJ-së. Sugjerohet që trajnimi të jetë pjesë e një programi/kurrikule gjithëpërfshirëse, që të përmbajë, gjithashtu, edhe sesione mbi reagimin shumësektorial kundër DHF-së/DHBGJ-së, parimet bazë të ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për viktimat e DHF-së/DHBGJ-së, të cilat duhet të reflektohen në shërbimet shëndetësore që ofrohen për këto raste, sesione mbi parandalimin dhe ndërgjegjësimin etj.

⁸¹ OBSH (2013), “Përgjigja ndaj dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale ndaj grave: Udhëzimet klinike dhe të politikave të OBSH-së”, në faqen vii.

⁸² Du Mont, Janice dhe D. White (2007), “Përdorimi dhe ndikimi i provave mjekoligjore në rastet e abuzimit seksual. Një rishikim global (OBSH: Gjenevë) dhe shiko, gjithashtu, OBSH-në. Udhëzime për kujdesin mjekoligjor për viktimat e dhunës seksuale. Gjenevë: OBSH, 2003.

PSV-të nuk përshkruajnë detyrat specifike të punonjësve dhe të punonjësve të shërbimeve shëndetësore, në lidhje me kujdesin për kushtet shëndetësore, të cilat janë të elaboruara mjaft mirë në protokollet përkatëse të shëndetësisë.

V. PARIMET DREJTUESE

Qasja e bazuar te të drejtat. Lidhur me ofrimin e shërbimeve thelbësore cilësore, qasja që bazohet te të drejtat pranon se institucionet e kujdesit shëndetësor kanë përgjegjësinë kryesore për të respektuar, për të mbrojtur dhe për të përmbushur të drejtat e grave dhe vajzave. Dhuna ndaj grave dhe ndaj vajzave përbën shkelje të rëndë të të drejtave njerëzore të tyre, veçanërisht të së drejtës për një jetë pa frikë dhe pa dhunë. Një qasje e bazuar te të drejtat e njeriut e vë theksin te shërbimet që kanë përparësi sigurinë dhe mirëqenien e grave dhe të vajzave dhe i trajton gratë dhe vajzat me dinjitet, respekt dhe ndjeshmëri. Po kështu, një qasje e tillë e vë theksin te standardet më të larta të shërbimeve shëndetësore (si dhe të shërbimeve të ofruara nga anëtarët e tjerë të MKR-së) – shërbime të cilësisë së lartë, të disponueshme, të aksesueshme dhe të pranueshme për gratë dhe vajzat⁸³.

Avancimi i barazisë gjinore dhe i fuqizimit të grave. Kthimi i fokusit te pabarazia dhe diskriminimi gjinor, edhe si rrënjë të problemit dhe si pasoja të dhunës ndaj grave dhe ndaj vajzave, kërkon që shërbimet të garantojnë ndjeshmërinë gjinore dhe funksionimin e politikave dhe praktikave të përgjithshme gjinore. Shërbimet duhet të sigurojnë që dhuna ndaj grave dhe ndaj vajzave nuk do të falet, nuk do të tolerohet ose nuk do të përjetësohet.

Qasja me ndjeshmëri gjinore. Shërbimet e ofruara duhet të shfaqin një qasje që njeh dinamikën gjinore, efektet dhe pasojat e dhunës ndaj grave. Shërbimet shëndetësore duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve specifike të grave, të rejave dhe vajzave, duke përfshirë edhe ato që u përkasin grupeve të marginalizuara (rome, egjiptiane, LGBTI, migrantët, PAK-të, të moshuarit etj.). Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të respektojnë diversitetin e viktimave dhe të sillen në mënyrë jodiskriminuese ndaj tyre. Kjo nënkupton që të gjitha gratë, të reja dhe vajzat viktimë, sikurse dhe të gjithë individët e tjerë të dhunuar në familje, kanë të drejtë të barabarta dhe të plota në përdorimin e shërbimeve shëndetësore, si dhe në marrjen e mbështetjes së të njëjtës cilësi.

Përshtatja sipas moshës dhe ndjeshmëria ndaj kulturës. Shërbimet thelbësore, të përshtatura sipas moshës dhe të ndjeshme ndaj kulturës, duhet t'u përgjigjen rrethanave individuale dhe përvojave jetësore të grave dhe vajzave, sikurse dhe të të gjithë individëve të tjerë të dhunuar në familje, duke marrë parasysh moshën e tyre, identitetin, kulturën, orientimin seksual, identitetin gjinor, etninë dhe preferencat gjuhësore. Shërbimet thelbësore duhet t'u përgjigjen në mënyrën e duhur, gjithashtu, edhe grave dhe vajzave që përballen me forma të ndryshme të diskriminimit të shumëfishtë, jo vetëm sepse janë gra, por edhe për shkak të racës, etnisë, kastës, orientimit seksual, fesë, aftësisë së kufizuar, gjendjes civile, punësimit ose karakteristikave të tjera të tyre, ose sepse kanë qenë viktimë të dhunës.

Qasja me në qendër viktimën. Qasjet me në qendër viktimën/të mbijetuarën i vendosin të drejtat, nevojat dhe dëshirat e grave dhe të vajzave në qendër dhe në fokus të ofrimit të shërbimit. Kjo nënkupton marrjen në konsideratë të nevojave të shumta të viktimave, rreziqet dhe cenueshmëritë e ndryshme, ndikimin që kanë vendimet dhe masat e marra, si dhe garantimin që shërbimet janë të përshtatura, sipas nevojave të veçanta të secilës grua apo vajzë. Shërbimet duhet t'u përgjigjen kërkesave të viktimave dhe nevojave më urgjente të tyre (si largim nga dhunuesi, strehim, këshillim, ushqim, punësim etj.) Të gjithë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve të angazhuar në reagimin shumësektorial kundër DHF-së dhe DHBGJ-së, u japin përparësi të drejtave, nevojave dhe kërkesave të viktimës. Qasja me në qendër viktimën nënkupton një qasje të mbështetur te të drejtat e njeriut, që përcakton se të drejtat, nevojat dhe kërkesat e viktimës janë të një rëndësie parësore. Viktima ka të drejtë të:

- trajtohet me dinjitet dhe respekt, në vend që të bëhet objekt i sjelljeve që e fajësojnë atë;

⁸³ E/2013/27.

- zgjedhë rrjedhën e veprimeve, për sa i përket trajtimit të dhunës së pësuar, në vend që të ndihet e pafuqishme;
- ketë privatësi dhe mirëbesim, në vend që të bëhet objekt i fajësimeve;
- mos diskriminohet, në vend që të ketë diskriminim në bazë të seksit, moshës, racës, etnisë, pa/aftësisë, orientimit seksual ndryshe, statusit të virusit HIV apo i tipareve të tjera;
- marrë informacione gjithëpërfshirëse, për ta ndihmuar atë t'i marrë vetë vendimet, në vend që t'i thuhet se çfarë duhet të bëjë.

Siguria është e qenësishme. Siguria e grave dhe e vajzave është e lartë dhe kryesore, kur ofrohen shërbime thelbësore. Shërbimet thelbësore duhet ta venë përparësinë te siguria dhe mbrojtja e përdorueseve të shërbimit dhe të shmangin shkaktimin e një lëndimi të mëtejshëm të tyre. Siguria e viktimës dhe e punonjësës apo e punonjësit të shërbimeve shëndetësore që përfshihet në trajtimin e rastit, duhet të jetë përparësi gjatë kohës kur organizohet dhe ofrohet përkujdesja ndaj viktimave të DHF-së/DHBGJ-së. Vlerësimi i sigurisë së viktimës duhet të bëhet në momentin e identifikimit dhe kur personi tregon se ka qenë viktimë e DHF-së/DHBGJ-së. Po kështu, edhe vlerësimi i sigurisë personale duhet të jetë pjesë e çdo konsulte. Kur fillon bashkëveprimi dhe konsulta me një viktimë të DHF-së/DHBGJ-së, është e rëndësishme që të shqyrtohen edhe kërcënimet e mundshme (nga bashkëshorti ose anëtarët apo anëtarët e tjerë të familjes), në mënyrë që të garantohet se konsulta do të kryhet pa ndonjë dëmtrim të mundshëm të vetes, viktimës ose të kolegeve apo kolegëve të tjerë të përfshirë në trajtimin e rastit.

Konfidencialiteti dhe privatësia. Respektimi i konfidencialitetit është një masë e rëndësishme që duhet marrë për të garantuar sigurinë e viktimës dhe të punonjësës apo punonjësit të shërbimeve shëndetësore. Konfidencialiteti i viktimës duhet të respektohet gjatë gjithë kohës. Kjo nënkupton përcjelljen te të tjerët vetëm të informacionit të domosdoshëm, vetëm në situatat që është e nevojshme ose e kërkuar (detyrim ligjor), si dhe vetëm me informimin e viktimës. Garantimi i privatësisë gjatë konsultës dhe i konfidencialitetit në mbledhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit zvogëlon rrezikun e ekspozimit, si të viktimës, ashtu edhe të punonjësës apo të punonjësit të shërbimeve shëndetësore. Ruajtja e konfidencialitetit garanton që viktima nuk do të përjetojë më kërcënime dhe/ose dhunë, si rezultat i kërkimit të ndihmës dhe, gjithashtu, mbron punonjësën dhe punonjësën e shërbimeve shëndetësore nga kërcënimet e dhunuesve. Punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore u lind nevoja e diskutimit të rastit me koleget dhe kolegët e tyre, për të mundësuar ofrimin e tërësisë së shërbimeve të nevojshme – në këtë rast konfidencialiteti nuk mund të respektohet për disa informacione mbi viktimën. Informacioni mund të diskutohet me koleget dhe kolegët, nëse lind nevoja e referimit të viktimës/të të mbijetuarës te një tjetër punonjëse apo punonjës i shërbimeve shëndetësore apo te koordinatori/ja vendor/e MKR-së. Kjo duhet t'i shpjegohet viktimës paraprakisht dhe ajo duhet të jetë në dijeni të informacionit që do të jepet dhe kujt do t'i jepet, si dhe duhet të japë pëlqimin e saj për këtë. Nëse konfidencialiteti kufizohet nga rregullore që lidhen me raportimin e detyruar (si, p.sh., kur flitet për raste të dhunës që përbëjnë vepër penale apo për detyrimin për të raportuar te koordinatori/ja vendor/e raste të DHF-së), viktima duhet të informohet menjëherë për këtë detyrim ligjor, duke i shpjeguar që raportimi bëhet për marrjen e masave të duhura për garantimin e mbrojtjes së saj.

Zgjedhja e informuar. Me përjashtim të veprimeve që janë detyrime ligjore (raportimi i rastit në polici dhe te koordinatori/ja vendor/e), çdo veprim tjetër duhet të kryhet pas marrjes së pëlqimit paraprak të informuar të viktimës, pra pasi t'i jetë dhënë asaj informacioni i nevojshëm për të gjykuar dhe dhënë këtë pëlqim. Edhe në rast të veprimeve që duhet të kryhen, sepse janë detyrime ligjore, është shumë e rëndësishme që viktima të informohet për këtë detyrim ligjor dhe hapat që do të ndërmerren, përpara përmbushjes së detyrimit ligjor për raportim.

Mosdiskriminimi. Të gjitha viktimat e DHF-së/DHBGJ-së duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë të njëjtat të drejta për përfitimin e të gjitha shërbimeve shëndetësore që mund të ofrohen nga punonjëset dhe punonjësit e këtyre shërbimeve, siç parashikohen në

kuadrin ligjor ekzistues të përmirësuar, pavarësisht moshës, vendbanimit, racës, kombësisë, besimit fetar, përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, statusit martesor, arsimimit dhe statusit socioekonomik të tyre.

VI. ELEMENTET THEMELORE

Në zbatim të parimeve të përgjithshme, ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet të kenë parasysh:

- Politikat shëndetësore kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje duhet të lidhen me politikën kombëtare; duhet të përfshijnë adresimin e dhunës në vendin e punës/dhunën institucionale, si dhe procedurat dhe protokollet shoqëruese. Kujdesi për gratë që përjetojnë dhunë nga partneri intim dhe dhunë seksuale duhet, sa më shumë që të jetë e mundur, të integrohet në shërbimet shëndetësore ekzistuese, më tepër se sa të qëndrojnë si një shërbim i vetëm.⁸⁴

- Zhvillimi i personelit në sektorin e shëndetësisë përfshin ndërtimin e kapaciteteve për këto çështje në shërbimin paraprak, si dhe nëpërmjet edukimit të vazhdueshëm dhe trajnimit duke ofruar shërbimin. Kjo, gjithashtu, kërkon ndërtimin e ekipeve ndërsektoriale; si dhe mbikëqyrjen dhe mentorimin e punonjëseve dhe të punonjësve të shëndetësisë. Përderisa ka nevojë për modele të shumëfishta të kujdesit për të mbijetuarat për nivele të ndryshme të sistemit shëndetësor, prioritet duhet t'u jepet ndërtimit të kapaciteteve dhe ofrimit të shërbimeve në nivelin e kujdesit parësor. Për më tepër, një ofrues i kujdesit shëndetësor (infermiere ose infermier, mjeke ose mjek apo në specialiste ose specialist një pozicion ekuivalent) i cili/e cila është trajnuar për dhënien e shërbimit dhe për kryerjen e ekzaminimeve të sulmeve seksuale me ndjeshmëri gjinore, duhet të jetë i/e disponueshëm/e gjatë gjithë kohës, ditën ose natën (në vend të caktuar ose në gatishmëri për thirrje) në nivel qyteti/bashkie.

- Angazhimi me komunitetin dhe avokimi për gratë dhe vajzat e reja, si dhe për të gjithë anëtarët e familjes viktime të dhunës, është një gur i rëndësishëm themeli për shërbimet thelbësore shëndetësore.

- Një tjetër gur i rëndësishëm themeli për shërbimet shëndetësore është disponueshmëria e produkteve/materialeve/seteve mjekësore, si dhe e aparaturave ekzaminuese. Kjo përfshin edhe sigurimin e mjeteve dhe të seteve të shëndetit riprodhues dhe një mjedis komod për të mundësuar konfidencialitetin, privatësinë dhe sigurinë e viktimës.

- Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve thelbësore shëndetësore kërkon sisteme të informacionit shëndetësor, masa të llogaridhënies, si dhe reagime dhe vlerësime të pacientëve.

VII. UDHËZIMET PËR SHËRBIMET THELBËSORE SHËNDETËSORE

SHËRBIMI THELBËSOR: 1. IDENTIFIKIMI I VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE APO TË DHUNËS ME BAZË GJINORE	
Ofruesit e shërbimeve shëndetësore është e rëndësishme të jenë të vetëdijshëm që problemet shëndetësore të një gruaje mund të shkaktohen ose të përkeqësohen nga dhuna. Gratë të cilat përjetojnë dhunë dhe dhunë seksuale në një marrëdhënie shpesh kërkojnë shërbime shëndetësore të lidhura me kushtet emocionale ose fizike të tyre, përfshirë lëndimet. Megjithatë, shpesh ato nuk u tregojnë ofruesve të shërbimeve për dhunën që kanë pësuar, për shkak të turpit ose të frikës se do të paragjykojnë, ose për shkak të frikës nga partneri i tyre. Një situatë e ngjashme mund të përjetojë edhe nga anëtarët e tjerë të dhunuar në familje.	
ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIMET
1.1 Informacioni	- Informacionet e shkruara mbi DHF-në/DHBGJ-në duhet të jenë të disponueshme në ambientet e kujdesit shëndetësor në formën e posterave dhe të broshurave apo të fletëpalosjeve të vëna në dispozicion në zona private, si: p.sh., në tualetet e grave (me paralajmërime të përshtatshme rreth rrezikut) për marrjen e tyre në shtëpi nëse kanë një partner abuziv.
1.2 Identifikimi i grave të cilat vuajnë nga dhuna nga	- Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet të pyesin për ekspozimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së gjatë vlerësimit të kushteve që mund të shkaktohen ose të komplikohen

⁸⁴OBSH (2013), "Duke iu përgjigjur dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale ndaj grave: Udhëzimet klinike dhe të politikave të OBSH-së". Gjenevë, OBSH, 2013. Rekomandimi 34.

partneri intim	nga dhuna e partnerit intim, me qëllim përmirësimin e diagnozës dhe të kujdesit të mëvonshëm. - Pyetja e grave rreth dhunës duhet të lidhet me një përgjigje efektive, që duhet të përfshijë një reagim përmes mbështetjes së linjës së parë, trajtimin dhe kujdesin e duhur mjekësor. sipas nevojës dhe referimin ose brenda vetë sistemit shëndetësor ose jashtë tij, për shërbime të tjera të specializuara. - “Shqyrtimi universal” ose “hetimi rutinë” (p.sh., të pyeturit e grave në të gjitha takimet e kujdesit shëndetësor) nuk duhet të zbatohet, pasi ndërkohë që mund të rrisë identifikimin e grave që vuajnë nga dhuna, nuk është provuar se përmirëson rezultatet shëndetësore apo edhe referimet. Kjo mënyrë e të pyeturit është sfiduese të zbatohet në mjedise me prevalencë të lartë të përhapjes së fenomenit, si dhe me burime apo mundësi referimi të kufizuara. - Para se të pyesë rreth dhunës, punonjësja apo punonjësi shëndetësor duhet të marrë masa për zbatimin e kërkesave minimale të mëposhtme: - sigurimi i një mjedisi privat; - ekzistenca e ofruesve të kujdesit shëndetësor, të cilët janë trajnuar të pyesin në mënyrë të përshtatshme (për shembull, në mënyrë empatike, pa gjykime) dhe si të reagojnë në mënyrën e duhur; - ekzistenca e një sistemi referimi; - ekzistenca e protokolleve/e procedurave standarde të veprimit.
1.2 (<i>vazhdim</i>) Identifikimi i grave të cilat vuajnë nga dhuna nga partneri intim	- Në rast se ofruesit e shërbimeve shëndetësore dyshojnë për dhunën, por gratë nuk e tregojnë atë: - Grave nuk u duhet bërë presion të tregojnë, por u duhet dhënë kohë. - Grave u duhet ofruar informacion në lidhje me: - shërbimet në dispozicion; - pasojat e dhunës në shëndetin e grave dhe shëndetin e fëmijëve të tyre. - Grave u duhet ofruar një vizitë pasuese.

SHËRBIMI THELBËSOR: 2. LINJA E PARË MBËSHTETËSE

Kur ofrohet ndihma përmes linjës së parë mbështetëse të një grua apo një tjetër individ subjekt i dhunës, duhet t'u kushtohet vëmendje katër lloj nevojave: 1. Nevojave të menjëhershme të shëndetit emocional/psikologjik; 2. Nevojave të menjëhershme të shëndetit fizik; 3. Nevojave e vazhdueshme për siguri; 4. Nevojave të shëndetit mendor dhe mbështetjes së vazhdueshme. Linja e parë mbështetëse siguron kujdes praktik dhe u përgjigjet nevojave emocionale, fizike, të sigurisë dhe mbështetjes së një gruaje/individit, pa ndërhyrë në privatësinë e saj/tij. Shpesh, ndihma përmes linjës së parë mbështetëse është kujdesi më i rëndësishëm që mund të ofrohet.

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIMET
2.1 Gratë në qendër të kujdesit	- Grave të cilat tregojnë për çdo formë dhune të pësuar nga një partner intim (ose anëtar tjetër i familjes) ose për sulm seksual nga cilido dhunues duhet t'u ofrohet mbështetje e menjëhershme. - Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet, së paku, të ofrojnë mbështetje përmes linjës së parë kur gratë pohojnë dhunën e ushtruar. Linja e parë mbështetëse përfshin: - të qenit jogjykses dhe mbështetës, si dhe të vlerësuarit e asaj çfarë po thotë grua; - sigurimin e kujdesit dhe të mbështetjes praktike që u përgjigjet shqetësimeve të gruas, por nuk ndërhyr në pavarësinë e saj; - të pyeturit rreth historisë së saj të dhunës, duke e dëgjuar me kujdes, por duke mos ushtruar presion tek ajo për të folur (kujdes duhet të tregohet gjatë diskutimit të temave të ndjeshme, kur përfshihen përkthyeset/it); - dëgjimi pa i ushtruar presion gruas për t'u përgjigjur ose për të dhënë informacion; - ofrimi i informacionit, duke e ndihmuar qasjen e gruas në informacionin rreth burimeve, duke përfshirë shërbimet ligjore dhe shërbime të tjera të cilat ajo mund t'i mendojë të dobishme, si dhe duke e ndihmuar atë për t'u lidhur me shërbimet e mësipërme dhe ato të kujdesit shoqëror; - sigurimi i informacionit me shkrim mbi strategjitë e përballimit/të trajtimit të stresit të rëndë (me paralajmërime të përshtatshme rreth rrezikut për marrjen e materialeve të printuara në shtëpi, nëse ka një partner abuziv atje); - ofrimi i ndihmës për të rritur sigurinë për veten dhe për fëmijët e saj, kur është e nevojshme; - ofrimi i rehatisë dhe i ndihmës për të lehtësuar ose për të zvogëluar ankthin e saj; - ofrimi ose mobilizimi i mbështetjes sociale (përfshirë referimet tek anëtarë e MKR-

	së). - Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet të garantojnë: - që konsultimi kryhet në mënyrë private; - t'i bëjnë të ditur gruas çështjen e konfidencialitetit, ndërkohë që e informojnë për kufijtë e konfidencialitetit (d.m.th., kur aplikohet raportim i detyrueshëm). - Nëse ofruesit e shërbimeve shëndetësore nuk janë në gjendje të mundësojnë linjën e parë mbështetëse, ata duhet të sigurojnë se dikush tjetër (brenda mjedisit të tyre të kujdesit shëndetësor ose një mjedis tjetër që është lehtësisht i aksesueshëm) është menjëherë në dispozicion për ta ofruar këtë.
2.2 Raportimi i detyrueshëm	- Raportimi i detyrueshëm në polici, i dhunës ndaj grave nuk rekomandohet të bëhet nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore. Megjithatë në Shqipëri raportimi i dhunës së identifikuar nga punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë, kur kjo formë dhune përbën vepër penale, është detyrim ligjor. Gjithashtu, edhe raportimi i rasteve të dhunës në familje te koordinatori/ja vendor/e. - Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet ta raportojnë incidentin tek autoritetet e duhura, duke përfshirë policinë, edhe nëse gruaja nuk e dëshiron këtë, duke e informuar paraprakisht atë. - Keqtrajtimi i fëmijëve dhe incidentet që kërcënojnë jetën duhet t'u raportohen autoriteteve përkatëse nga ofruesi i shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë këtu dhe njoftimin e njërive të mbrojtjes së fëmijëve.

SHËRBIMI THELBËSOR: 3. KUJDESI NDAJ LËNDIMEVE DHE ÇËSHTJET MJEKËSORE URGJENTE

Ekzaminimi dhe kujdesi për shëndetin fizik dhe emocional duhet të zhvillohen së bashku. Shërbimet këtu më poshtë janë ndarë për të dhënë udhëzime të qarta në aspektin e standardeve minimale.

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIMET
3.1 Historia dhe ekzaminimi	- Marrja e historisë duhet të ndjekë procedurat standarde mjekësore, por duke pasur parasysh se gratë që kanë përjetuar dhunë nga partneri intim ose dhunë seksuale ka gjasa të traumatizohen, prandaj duhet shqyrtuar çfarëdo letre/dokumenti që ajo mund të ketë dhe duhet shmangur bërja e pyetjeve për të cilat ajo është përgjigjur më parë. - Grave u duhet shpjeguar dhe më pas duhet siguruar firmosja e formularit të dhënies së pëlqimit të informuar për secilin aspekt: - ekzaminimin mjekësor; - trajtimin; - referimin për mbledhjen e provave mjekoligjore; - dhënien e informacionit palëve të treta, si policisë dhe gjykatave. - Nëse gratë duan dëshmi (prova) të grumbulluara, duhet t'u sigurohet ose duhet të referohen te një ofrues shërbimi posaçërisht i trajnuar që mund ta plotësojë këtë kërkesë. - Duhet të kryhet një ekzaminim i plotë fizik i gruas. Gjetjet dhe vëzhgimet duhet të regjistrohen në mënyrë të qartë. - Në çdo hap të ekzaminimit, duhet të sigurohet komunikimi me gruan dhe i duhet kërkuar leje paraprakisht.
3.2 Trajtimet emergjente	- Nëse një grua ka përjetuar kërcënim për marrjen e jetës ose dhunim në kushte të rënda, menjëherë duhet të referohet për trajtim emergjent.

SHËRBIMI THELBËSOR: 4. EKZAMINIMI DHE KUJDESI NDAJ SULMEVE SEKSUALE

Dhuna seksuale është një përvojë potencialisht traumatike që mund të ketë një tërësi pasojash negative në shëndetin mendor, fizik, seksual dhe riprodhues të grave, që nënkupton që ato mund të kërkojnë kujdes të menjëhershëm dhe në disa raste, kujdes afatgjatë, veçanërisht kujdes të shëndetit mendor.

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIMET
4.1 Historia e plotë	- Grave u duhet marrë një histori e plotë, duke shënuar ngjarjet për të përcaktuar se cilat ndërhyrje janë të përshtatshme, si dhe për të kryer një ekzaminim të plotë fizik (nga koka te këmbët, duke përfshirë organet gjenitale). - Historia duhet të përfshijë: - kohën që nga abuzimi dhe llojin e abuzimit; - rrezikun e shtatzënisë; - rrezikun e HIV-it dhe të infeksioneve/të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (STI);

	- statusin e shëndetit mendor.
4.2 Kontraceptivi i urgjencës	- Grave u duhet ofruar kontraceptivi i urgjencës për të mbijetuarat e abuzimit seksual që paraqiten brenda 5 ditëve nga sulmi seksual, në mënyrë ideale, sa më shpejt që të jetë e mundur pas sulmit, për të rritur maksimalisht efektivitetin. - Nëse një grua paraqitet pas kohës së kërkuar për kontraceptivin e urgjencës (5 ditë), atëherë ky kontraceptiv nuk vlen të përdoret dhe nëse gruaja është shtatzënë si rezultat i përdhunimit, asaj duhet t'i ofrohet abort i sigurt, në përputhje me ligjin kombëtar.
4.3 Profilaksia pas ekspozimit ndaj HIV	- Duhet të merret në konsideratë ofrimi i profilaksisë pas ekspozimit ndaj HIV (PPE) për gratë që paraqiten brenda 72 orëve nga abuzimi seksual. Duhet të përdoret vendimmarrja e përbashkët me viktimat, për të përcaktuar nëse profilaksia pas ekspozimit (PEP) ndaj HIV është e përshtatshme dhe duhet të ndiqen udhëzimet kombëtare për profilaksinë.
4.4 Profilaksia pas ekspozimit ndaj infeksioneve/SST	- Grave/të mbijetuarave nga abuzimi seksual duhet t'u ofrohet profilaksi për infeksionet më të shpeshta të transmetueshme seksualisht dhe vaksina të hepatitit B, sipas udhëzimeve kombëtare.

SHËRBIMI THELBËSOR: 5. VLERËSIMI DHE KUJDESI PËR SHËNDETIN MENDOR

Shumë gra që janë subjekt i dhunës nga partneri intim ose i dhunës seksuale, do të kenë si pasojë probleme emocionale ose të shëndetit mendor. Ka të ngjarë që, pasi të kalojë kohë nga ushtrimi i dhunës, përfshirë abuzimin seksual apo situata të ngjashme, këto probleme emocionale do të përmirësohen. Shumica e grave shërohen. Ka mënyra specifike se si ofruesit e shërbimeve shëndetësore mund të ndihmojnë gratë përmes teknikave të ndryshme që të zvogëlojnë stresin dhe të nxisin shërimin. Megjithatë, disa gra mund të vuajnë më shumë se të tjerat. Është e rëndësishme që punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë të jenë në gjendje t'i njohin këto gra dhe t'i ndihmojnë ato që të marrin kujdesin e nevojshëm.

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIMET
5.1 Kujdesi për shëndetin mendor për viktimat e dhunës nga partneri intim	- Gratë që përjetojnë dhunë duhet të vlerësohen për problemet e shëndetit mendor (simptoma të stresit akut/çrregullimeve të stresit posttraumatik - PTSD), depresion, probleme të përdorimit të alkoolit dhe drogës, tentativa për vetëvrasje ose vetëlëndim), si dhe duhet të trajtohen në përputhje me udhëzimet e ndërhyrjes sipas protokolleve klinike të OBSH-së, bazuar në evidencat për problemet e shëndetit mendor. - Kujdesi ndaj shëndetit mendor duhet të jepet nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore të cilët/të cilat e kuptojnë siç duhet dhunën ndaj grave.
5.2 Mbështetja psikosociale bazë	- Pas një abuzimi, mbështetja psikosociale bazë mund të jetë e mjaftueshme për 1–3 muajt e parë, duke monitoruar njëkohësisht për probleme më të rënda të shëndetit mendor. Kjo përfshin: - ndihmën për të forcuar metodat e përballimit pozitiv nga ana e gruas; - eksplorimin e disponueshmërisë së mbështetjes sociale; - mësimdhënien dhe demonstrimin e ushtrimeve të zvogëlimit të stresit; - sigurimin e ndjekjes së rregullt.
5.3 Probleme më të rënda të shëndetit mendor	- Kryerja e një vlerësimi të gjendjes mendore (në të njëjtën kohë me ekzaminimin fizik), duke vlerësuar rreziqet e menjëhershme për lëndimin e vetes ose vetëvrasjen, si dhe për çrregullime të rënda depresive të moderuara dhe PTSD. - Gratë me depresion dhe PTSD do të vazhdojnë të përfitojnë nga linja e parë mbështetëse, duke i ndihmuar ato të forcojnë mbështetjen sociale, të mësojnë të menaxhojnë stresin dhe të përkrahen në vazhdimësi. Nëse është e mundur të bëhet referimi te terapistë/terapiste të trajnuar/a. - Referohen si të nevojshme trajtimet e shkurtra psikologjike ose terapitë e njohjes së sjelljes.

SHËRBIMI THELBËSOR: 6. DOKUMENTIMI (MJEKËSOR DHE MJEKOLIGJOR)

Ofruesit e shërbimeve shëndetësore kanë detyrim profesional që të regjistrojnë detajet e çdo konsultimi me një pacientë. Shënimet duhet të pasqyrojnë atë që u tha, nga pacientja, me fjalët e saj, si dhe atë që është parë dhe bërë nga ofruesi i kujdesit shëndetësor. Në rastet e dhunës, marrja e shënimeve të sakta dhe të plota gjatë kohës së ekzaminimit është kritike, pasi të dhënat mjekësore mund të përdoren në gjykatë si dëshmi. Nëse gruaja pranon një ekzaminim mjekoligjor, lind nevoja të thirret një mjek ose mjekë ligjore. Në pamundësi për ta thirrur mjekun ligjor në spital, duhet të merren masa dhe të referohet gruaja sa më parë në ambientet e mjekësisë ligjore për të bërë ekzaminimin e duhur. Po kështu, gruas i duhen dhënë të gjitha udhëzimet e nevojshme që të mos dëmtojë provat në këtë rast (të mos lahet, të mos ndërrojë rrobat etj.).

ELEMENTET THEMELORE	UDHËZIMET
6.1 Dokumentacioni gjithëpërfshirës dhe i saktë	- Duhet të dokumentohen në dosjen mjekësore të gjitha ankesat shëndetësore, simptomat dhe shenjat, duke përfshirë një përshkrim të lëndimeve të gruas. - Mund të jetë e dobishme të theksohet shkaku ose shkaktori i dyshuar i këtyre lëndimeve ose i kushteve të tjera, duke përfshirë edhe atë që e ka lënduar. - Për ta shkruar këtë informacion në të dhënat e gruas, duhet të merret paraprkisht leje nga ana e saj (marrja e pëlqimit të informuar). - Është e rëndësishme të ndiqen dhe të plotësohen kërkesat dhe nevojat e saj.
6.2 Mbledhja dhe dokumentimi i mostrave mjekoligjore	- Kur një grua ka dhënë pëlqimin e informuar për mbledhjen e provave mjekoligjore, është me rëndësi që të bëhet mbledhja e këtyre provave nga mjeku ose mjekja ligjore dhe të ruhen në mënyrën e duhur. Punonjësja ose punonjësi i shëndetësisë duhet të bëjë në këtë rast referimin e gruas te shërbimi mjekoligjor, në pamundësi për ta bërë këtë ekzaminim në të njëjtin vend (ose në një qendër ku ka mundësi të ndiqen të gjitha procedurat njëkohësisht, siç është, p.sh., Qendra e Trajtimit të Viktimave të Sulmeve Seksuale “Lilium”)
6.3 Sigurimi i provave me shkrim dhe ndjekja në gjykatë	- Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet të njihen dhe familjarizohen me sistemin ligjor, të dinë si të shkruajnë një deklaratë të mirë, minimalisht dokumentin e përshkrimit të lëndimit ta përgatisin në mënyrë të plotë dhe të saktë, të bëjnë vëzhgime të sakta klinike dhe të bashkëpunojnë me mjekësinë ligjore për mbledhjen e provave nga viktimat.

VIII. RRETHANAT DHE SJELLJET QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHF-së/DHBGJ-së

Në vijim janë paraqitur lista të shkurtra të rrethanave klinike ose psikologjike dhe sjelljeve që mund të tërheqin vëmendjen e punonjësve dhe të punonjësve të shërbimeve shëndetësore, për të kërkuar për shenja të ekzistencës së DHF-së/DHBGJ-së. Nëse shumë prej tyre janë të pranishme mund të gjykohej që pacientja/i është subjekt i/e DHF-së/DHBGJ-së.

Rrethanat që mund të tregojnë për ushtrimin e DHF-së/DHBGJ-së:

- plagë të shumta, në faza të ndryshme të shërimit, në zona të shumta të trupit që nuk mund të jenë rezultat i rrëzimit;
- plagë të pashpjegueshme ose me shpjegime të paqarta/konfuze;
- plagë simetrike;
- mavijosje, shenja plagësh të shkaktuara nga armë, gërvishtje, kafshime, djegie në faza të ndryshme të shërimit, sidomos në krahë dhe në fytyrë;
- plagë të fshehura nën rroba;
- plagë që nuk janë në përputhje me shpjegimin e shkakut;
- simptoma gastrointestinale kronike të pashpjegueshme;
- simptoma riprodhuese të pashpjegueshme, duke përfshirë dhimbjen e legenit, mosfunksionimin seksual;
- pasoja negative të riprodhimit, duke përfshirë shtatzënitë e shumta të padëshiruara dhe/ose ndërprerjet e tyre, kujdesin e vonuar për shtatzëninë apo pasoja negative gjatë lindjes (te vajzat dhe te gratë);
- simptoma të pashpjegueshme gjenito-urinare, duke përfshirë infeksione të shpeshta në fshikëzën e urinës ose të veshkave, apo infeksione të tjera;
- Hemorragji vaginale e përsëritur dhe infeksione seksualisht të transmetueshme (te vajzat dhe te gratë);
- dhimbje kronike (e pashpjegueshme);
- probleme me sistemin nervor qendror: dhimbje koke, probleme konjitive (njohëse), humbje e dëgjimit;
- konsulta të përsëritura shëndetësore pa ndonjë diagnozë të qartë;
- partner ose bashkëshort që ndërhyjnë gjatë konsultave;
- mosparaqitje e shpeshtë në takimet e lëna me mjekun/un;
- mosmarrja rregullisht e mjekimit;
- dalja e parakohshme nga spitali;

- simptoma depresioni, ankthi, çrregullime të stresit posttraumatik (PTSD), çrregullime të gjumit;

- përdorim alkooli apo substancash të tjera.

Sjellje shoqëruese të DHF-së/DHBGJ-së:

- takime të shpeshta me punonjëset dhe me punonjësit e shërbimeve shëndetësore për simptoma të paqarta;

- personi përpqet të fshehë plagët ose të minimizojë shkallën e tyre;

- personi ngurron të flasë para partnerit ose të afërmit që e shoqëron apo duket e nënshtruar ose e frikësuar para partnerit ose të rriturve shoqërues;

- mosmarrja rregullisht e mjekimit;

- mosparaqitje e shpeshtë në takimet e lëna me mjekun;

- personi duket i frikësuar, tepër i shqetësuar ose e dëshpëruar;

- tentative për vetëvrasje ose për dëmtime të vetes;

- partneri është agresiv ose dominues, flet në emër të gruas ose refuzon të largohet nga dhoma;

- vizita tepër të rralla apo edhe mosshkuarje në klinikë para lindjes (te gruaja, vajza);

- dalje e parakohshme nga spitali.

IX. SI TË BASHKËVEPRONI ME VIKTIMËN E DHF-së/DHBGJ-së

Të pyesësh mbi DHF-në/DHBGJ-në e ushtruar ndaj dikujt mund të jetë e vështirë për cilëndo/cilindo punonjëse/punonjës të një shërbimi të caktuar. Rekomandimet e mëposhtme i ndihmojnë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore të rrisin besimin e tyre kur shtrojnë pyetje për DHF-në/DHBGJ-në dhe, gjithashtu, të shmangin riviktimizimin (sidomos të grave dhe të vajzave):

- të marrin nismën të pyesin rreth dhunës – të mos presin që t’ua tregojë vetë gruaja apo e reja apo personi. Marrja e nismës tregon që punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore marrin përgjegjësi profesionale ndaj situatës së viktimës he ndihmon në krijimin e besimit;

- të shmangin pyetjen e një gruaje apo të reje rreth DHF-së/DHBGJ-së në praninë e një anëtarit/anëtareje të familjes, të një miku, të fëmijëve apo të një personi tjetër;

- të tregohen të durueshëm me viktimën dhe të mbajnë parasysh që gjatë krizave ajo mund të shfaqë ndjenja kontraktore. Të mos ushtrojnë presion mbi viktimën që ta bëjnë atë të flasë. Nëse ajo nuk flet, t’i tregojnë viktimës se çfarë i bëri të dyshonin për dhunë;

- të shmangin ndërprerjet e panevojshme dhe të bëjnë pyetje për sqarime vetëm pasi viktimë të ketë përfunduar rrëfimin;

- të shmangin dëgjimin pasiv dhe moskomentimin. Kjo mund ta bëjë viktimën të mendojë se punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore nuk e besojnë atë dhe se ajo e ka gabim, ndërsa dhunuesi ka të drejtë. Të dëgjojnë me kujdes përjetimet e saj dhe ta sigurojnë që gjithçka ajo ndien është e justifikueshme;

- të përdorin të njëjtën gjuhë si ajo e viktimës; nëse viktimë flet një gjuhë tjetër ndryshe nga ajo e punonjëseve dhe e punonjësve të shërbimeve shëndetësore, të kërkohet ndihmë nga një ofrues tjetër shërbimi që flet të njëjtën gjuhë me viktimën, ose nga një përkthyes apo përkthyes ta ndihmojë atë, ose nga një specialiste apo specialist i gjuhës së shenjave në rast të personave me aftësi të kufizuara në dëgjim. Përdorimi i së njëjtës gjuhë me viktimën vlen edhe në rast të trajtimit të viktimave nga komuniteti rom;

- të përshtatin gjuhën ose fjalët sipas nivelit arsimor të viktimës. Të mos përdorin gjuhë profesionale dhe shprehje që mund ta ngatërrojnë viktimën;

- të formulojnë pyetje dhe fjali, në mënyrë të tillë që të përçojnë mesazhe mbështetëse dhe jo paragjyquese, duke folur me ton dashamirës. Të përdorin pyetje të hapura dhe të shmangin pyetjet që fillojnë me “pse”, që tentojnë t’ia hedhin fajin viktimës;

- të mos e fajësojnë gruan, të renë. Të shmangin pyetje, të tilla si: “Pse qëndroni me të?”, “A patët ndonjë debat me njëri-tjetrin para se të ushtronte dhunë?”, “Çfarë po bënit jashtë e pashoqëruar?” ,”Çfarë kishit veshur?” etj. Në vend të tyre të theksojnë që DHF-ja/DHBGJ-ja nuk mund të tolerohet;

- të përdorin pohime mbështetëse, të tilla si “Më vjen keq për çka ju ka ndodhur!” ose “Me të vërtetë paskeni hequr shumë!”, që mund të inkurajojnë gruan apo të renë të ndajë me punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore më shumë informacion;

- të theksojnë se dhuna nuk ndodhi për fajin e viktimës dhe se vetëm dhunuesi është përgjegjës për ushtrimin e saj;

- t’i shpjegojnë viktimës parimin e konfidencialitetit dhe privatësisë, si dhe rastet e kufizimit të konfidencialitetit, për shkak të respektimit të kuadrit ligjor në fuqi;

- ta shikojnë viktimën në sy aq sa është normale për kulturën shqiptare dhe ta përqendrojnë të gjithë vëmendjen tek ajo. Të shmangin plotësimin e dokumenteve në të njëjtën kohë që flasin me të, duke përdorur nëse është e mundur regjistrimin e bisedës. Në pamundësi të regjistrimit të bisedës, t’ia shpjegojnë viktimës shënimet që po mbajnë dhe dokumentet që po plotësojnë;

- të jenë të vetëdijshëm për gjuhën e trupit. Mënyra se si qëndrojnë, mbajnë krahët dhe kokën, shprehja e fytyrës dhe toni i zërit të punonjëseve dhe të punonjësve të shërbimeve shëndetësore, përcjellin një mesazh të qartë te gruaja apo e reja për mënyrën se si e perceptojnë situatën e saj; Të mbajnë një qëndrim joparagjykses dhe mbështetës dhe të pajtohen me çfarë deklaron viktima, për të vijuar më tej me menaxhimin e rastit. Të shmangin gjuhën e trupit që mund të përcjellë mesazhe acarimi, mosbesimi, mospëlqimi apo zemërimi ndaj viktimës;

- të mos e paragjykojnë sjelljen e viktimës mbi bazën e moshës, vendbanimit, etnisë, besimit fetar, aftësive të kufizuara, orientimit seksual, statusit socioekonomik etj.

X. PROCEDURAT

Procedurat e prezantuara hap pas hapi në vijim, janë grupuar sipas llojit të veprimit që mund të kryhet dhe janë organizuar sipas këtyre seksioneve: identifikimi, vlerësimi, ndërhyrja për ofrimin e shërbimeve shëndetësore (me pesë elemente themelore), mbledhja e provave, dokumentimi i DHF-së/i DHBGJ-së, referimi dhe koordinimi për menaxhimin e rasteve. Radha e seksioneve dhe/apo e hapave, mund të ndryshojë gjatë ndërveprimit me një viktimë, megjithatë, çdo ndihmë ndaj tyre fillon me identifikimin. Cilado/cilido punonjëse dhe punonjës i shërbimeve shëndetësore duhet të zbatojë hapat e përshkruar në seksionet në vijim, në përputhje edhe me statusin dhe kompetencat e saj/tij si profesionist dhe në varësi të pozicionit të saj/tij të punës (pra në varësi edhe të standardeve të shërbimit që ka për detyrë të ofrojë). Nëse ka prova ose dyshime se një grua, e re apo vajzë ka vuajtur një formë të dhunës në familje apo të dhunës me bazë gjinore, punonjësja ose punonjësi i shërbimeve shëndetësore duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t’i siguruar personit të gjithë mbështetjen që i duhet. Në të gjitha fazat e shërbimit, pavarësia e viktimës dhe konfidencialiteti renditen pas sigurisë dhe mbrojtjes së jetës së saj.

Identifikimi

Hapi i parë në çdo ndërhyrje është identifikimi i viktimës. Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme: identifikimi nga punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore, raportimi nga një tjetër ofrues shërbimesh apo nga një person tjetër dhe vetëdeklarimi nga viktima. Në rast të identifikimit në mjediset shëndetësore, përdoren dy qasje për të mundësuar pohimin e DHF-së/DHBGJ-së: ekzaminimi i përgjithshëm dhe gjetja e rastit.

Ekzaminimi i përgjithshëm kërkon që të pyeten për ekspozimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së të gjitha gratë dhe të rejat, por edhe individët e tjerë që vijnë në institucionet shëndetësore. Ekzaminimi i përgjithshëm mund të jetë ngarkesë e madhe në ambientet e shërbimeve shëndetësore, veçanërisht kur mundësitë e referimit të rasteve janë të kufizuara, si dhe kur ka kapacitete apo burime dhe ofrues shërbimesh të tjera të pamjaftueshme, për një përgjigje efektive për trajtimin e rasteve.

Gjetja e rastit i referohet pyetjes së grave dhe të të rejave apo të individëve të tjerë, për DHF-në/DHBGJ-në, në rast se paraqesin disa simptoma klinike për t’u ekzaminuar. Qasja e dytë e

bazuar në konsiderata klinike selektive dhe të kujdesshme është vërtetuar si më efektive, veçanërisht kur punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore janë trajnuar posaçërisht për mënyrën se si të veprojnë më mirë në situata të tilla dhe si t'i referojnë rastet.

Prioritet mbetet adresimi i nevojave shëndetësore që mund të kërcënojnë jetën ose integritetin e viktimës në çfarëdo situatë. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të referojnë menjëherë për shtrim në spital ato viktima të cilat janë në gjendje të rëndë dhe me rrezikshmëri për jetën.

Veprimet e mëposhtme duhen bërë për të lehtësuar zbulimin e DHF-së/DHBGJ-së, si dhe për të garantuar identifikimin pa rrezik dhe efektiv të viktimave ndaj të cilave është ushtruar dhunë. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet:

- të përshëndesin dhe mirëpresin viktimën me ngrohtësi;
- të prezantohen dhe të shpjegojnë shkurtimisht kompetencat/shërbimet e institucionit;
- t'i kërkojnë me mirësjellje viktimës të prezantohet (nëse nuk ka një gjendje shëndetësore që e kufizon këtë);
- ta pyesin viktimën nëse preferon të ekzaminohet nga një mjek/e i/e së njëjtës gjini (veçanërisht në rastet e dhunës seksuale);
- t'i japin viktimës mundësinë të bëjë pyetje rreth gjithçkaje që mund ta konsiderojë të rëndësishme;
- të mbajnë në vëmendje nevojat e grupeve të ndryshme të popullatës (p.sh., të personave me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, të minoriteteve etnike, të personave nga komuniteti LGBTI etj.) dhe të bëjnë përpjekje për t'i adresuar ato;
- të krijojnë një ambient konfidencial dhe mikpritës, të dëgjojnë me kujdes viktimën dhe t'i japin mesazhe mbështetëse;
- t'u kushtojnë vëmendje kushteve të ambientit ku janë, kur bëjnë pyetje për DHF-në dhe/ose DHBGJ-në (nëse, p.sh., ambienti është i ndarë me perde, sidomos në rastet e shërbimit shëndetësor spitalor, një person i tretë mund ta dëgjojë bisedën);
- para çdo ekzaminimi shëndetësor, ta informojnë dhe t'ia shpjegojnë viktimës se çfarë përfshin ai, pse bëhet dhe në ç'mënyrë, për të shmangur transformimin e ekzaminimit në një tjetër përjetim traumatik;
- të marrin me kujdes vendimin nëse është e përshtatshme të pyesin për ekspozimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së. Të mos harrojnë që personi shoqëruar mund të jetë vetë dhunuesi dhe pyetjet për ushtrim të dhunës mund t'i venë viktimat, në një situatë të rrezikshme;
- nëse dyshojnë për ushtrim të DHF-së/DHBGJ-së, të kontrollojnë historinë mjekësore të viktimës (nëse është e mundur) ose ta pyesin nëse gjendje të caktuara shëndetësore përsëriten herë pas here;
- të mos i lenë viktimat vetëm, veçanërisht, kur ka dyshime ose rrezik që mund të lëndojnë veten.

Vlerësimi

Pas identifikimit të një viktime të DHF-së/DHBGJ-së, punonjësja ose punonjësi i shërbimeve shëndetësore duhet të marrë një vendim për hapat që do të ndjekë (ofrimi i shërbimit të menjëhershëm, mbështetja, grumbullimi i provave të para, dokumentimi i rastit, duke përshkruar të gjitha të dhënat që lidhen me dhunën, njoftimi i policisë nëse është një incident i ndodhur rishtazi, si dhe referimi tek institucionet/shërbimet e tjera për një trajtim më të specializuar). Këta hapa ndiqen në varësi të burimeve, aftësive dhe kompetencave për të trajtuar efektivisht një rast të DHF-së/DHBGJ-së, si dhe lidhen shumë edhe me praninë e MKR-së në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Duhet të bëhet vlerësimi i nevojave të viktimave, si dhe i burimeve në dispozicion, pasi ky vlerësim është bazë për zhvillimin e hapave të mëtejshëm të shërbimit shëndetësor dhe të ndjekjes në vazhdim në mënyrë të koordinuar e përmes qasjes shumësektoriale. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet:

- të marrin miratimin e viktimës për shërbimet që do t'i ofrohen. Në rast se është fëmijë apo person me aftësi të kufizuara, duhet të marrin miratimin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë.

Përfashtim këtu përbëjnë rastet kur njoftimi i policisë apo raportimi i rastit në institucione të tjera është detyrim ligjor. Edhe në këto situata viktimë, prindërit ose kujdestarët ligjorë vihen në dijeni për hapat që po ndërmerren;

- t'i lexojnë viktimës me zë të lartë një deklaratë informuese dhe t'i kërkojnë miratimin me gojë, nëse ajo nuk di të lexojë apo të shkruajë (kjo duhet të përmendet në formularin e marrjes së pëlqimit të informuar ose në ndonjë formular tjetër);

- t'i shpjegojnë asaj të drejtën për të dhënë pëlqimin e saj të pjesshëm aty ku ajo mund të zgjedhë se cilat informacione mund të bëhen të ditura dhe cilat duhet të ruhen konfidenciale;

- t'i japin informacion të plotë për marrjen e pëlqimit. Të informojnë viktimën rreth ndërlikimeve që mund të vijnë si pasojë e ndarjes së informacionit rreth rastit të saj me institucione/shërbime të tjera;

- t'i japin viktimës informacion mbi DHF-në/DHBGJ-në dhe pasojat e saj mbi shëndetin;

- të sigurojnë viktimën për faktin që me të po punohet pa paragjykim, por me kujdes dhe mirëkuptim, si dhe që punonjëset apo punonjësit e shërbimeve shëndetësore do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ta ndihmuar atë;

- t'i kërkojnë viktimës të tregojë me fjalët e saj se çfarë ka ndodhur, të flasë për dhunuesin, llojet e dhunës, ashpërsinë dhe shpeshtësinë e saj. Nëse rasti është referuar nga ndonjë institucion apo organizatë tjetër ofruese shërbimesh, të marrin prej tyre atë pjesë të informacionit që mund të jetë tashmë i disponueshëm;

- të vlerësojnë nevojat dhe burimet, për të kuptuar kushtet shoqërore, familjare dhe individuale që ndikojnë në situatën e viktimës;

- të mbajnë në vëmendje që shërbimet dhe mbështetja që duhet t'i ofrohet viktimës/duhet të jetë e përshtatur, sipas nevojave, kërkesave dhe pritshmërive të saj, ku parësore mbeten siguria dhe mbrojtja e jetës.

Ofrimi i shërbimeve/ndërrhyrja

Pas identifikimit dhe vlerësimit të rastit, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të bëjnë ekzaminimin mjekësor dhe të ofrojnë shërbimin shëndetësor përkatës. Gjatë gjithë procesit të ekzaminimit dhe shërbimit shëndetësor, punonjëset dhe punonjësit përkatës duhet të kenë gjithnjë parasysh që viktimat mund të jenë shumë të tronditura emocionalisht.

Mbështetja e linjës së parë

Gjatë ofrimit të mbështetjes së linjës së parë, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet:

- të mos e paragjykojnë viktimën, të mbështesin dhe vlerësojnë atë që ajo thotë;

- të ofrojnë kujdes dhe mbështetje praktike që u përgjigjet shqetësimeve të viktimës;

- ta pyesin për historinë e dhunës, duke e dëgjuar me kujdes, por jo duke ushtruar presion ndaj viktimës që të flasë (të bëjnë kujdes kur të diskutojnë tema të ndjeshme/delicate, nëse janë të pranishëm edhe përkthyeset/përkthyesit);

- të ndihmojnë viktimën të marrë informacion për burimet, duke përfshirë shërbimet ligjore, si dhe shërbimet e tjera për të cilat ajo mund të ketë nevojë;

- të ndihmojnë viktimën të rrisë sigurinë për veten e saj, si dhe për fëmijët, kur është e nevojshme;

- të mobilizojnë ofrimin e mbështetjes sociale edhe përmes koordinimit me koordinatorin/en vendor/e kundër DHF-së në MKR-së vendore;

- të bëjnë konsultën privatisht;

- të respektojnë konfidencialitetin, duke e informuar viktimën, për kufijtë e konfidencialitetit (p.sh. kur është i detyrueshëm raportimi i rastit në polici).

Historia mjekësore dhe ekzaminimi

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet:

- t'i kërkojnë viktimës që të tregojë me fjalët e saj se çfarë ka ndodhur;

- të marrin një përshkrim të hollësishëm të dhunës, formave të saj, kohëzgjatjes, nëse janë përdorur armë, si dhe data dhe koha e incidentit/eve;

- të mbajnë parasysh që disa viktimë mund të shmangin qëllimisht, veçanërisht, detajet e sikletshme të incidentit;
- të kontrollojnë për ndonjë simptomë tjetër që mund të jetë shenjë e një forme të DHF-së/DHBGJ-së (p.sh., dehidratim , kequshqyerje etj.).
- Pas përfundimit të historisë, në bashkëpunim me mjeken/mjekun ligjor duhet të kryejnë një ekzaminim fizik të plotë (nga koka te këmbët) për dhunën seksuale, duke përfshirë edhe organet gjenitale, duke pasur parasysh parimet e mëposhtme:
 - t'i shpjegojnë viktimës se çfarë përfshin ekzaminimi mjekësor, pse bëhet dhe si bëhet, për të shmangur kthimin e këtij ekzaminimi në një përjetim tjetër traumatik. T'i japin mundësi viktimës të bëjë pyetje;
 - të pyesin viktimën nëse dëshiron një mjekë dhe jo mjek (sidomos në rastet e dhunës seksuale);
 - të mos e lenë viktimën vetëm (p.sh., kur ajo është duke pritur për ekzaminimin);
 - t'i kërkojnë me kujdes të zhveshë rrobat e saj dhe të veshë një rrobëdëshan të spitalit në mënyrë që të shihen plagët e fshehura;
 - gjatë ekzaminimit të pjesëve të trupit për shenjat fizike të dhunës, së pari të vërejnë pjesët e zbuluara dhe më pas, t'i kërkojnë me dashamirësi viktimës të zbulojë pjesët e tjera të trupit për t'i ekzaminuar. Të mos i kërkojnë të zbulojë të gjitha pjesët e trupit në të njëjtën kohë; të qenit e zhveshur plotësisht mund të jetë poshtëruese për viktimën;
 - të ekzaminojnë, veçanërisht, zonat e mbuluara me rroba dhe flokë;
 - nëse viktimë ka përjetuar dhunë seksuale, të ekzaminojnë të gjithë trupin e saj dhe jo vetëm organet gjenitale apo zonën e barkut;
 - të ekzaminojnë si plagët e rënda ashtu edhe ato të lehta;
 - të vërejnë edhe simptomat emocionale dhe psikologjike;
 - gjatë gjithë ekzaminimit fizik, të informojnë viktimën se çfarë planifikojnë të bëjnë më pas dhe t'i kërkojnë leje. Gjithmonë t'ia bëjnë të ditur se kur dhe ku do të preket në trup. T'i tregojnë dhe shpjegojnë mjetet dhe materialet përkatëse që përdoren gjatë ekzaminimit;
 - viktimë mund të refuzojë të gjithë ose një pjesë të ekzaminimit fizik. Lejimi i saj të ketë njëfarë kontrolli mbi ekzaminimin që i bëhet, është i rëndësishëm për shërimin e saj.

Kujdes! Tashmë që është vënë në funksionim Qendra e Shërbimeve për Viktimat e Sulmit Seksual (qendra “Lilium”), viktimë duhet të referohet në këtë qendër për kryerjen e ekzaminimit të plotë për dhunë seksuale. Mënyra se si do të bëhet ky referim duhet të rregullohet me procedurat e funksionimit të kësaj qendre, si dhe duhet të pasqyrohet më tej në të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të MKR-ve të atyre bashkive që do të bashkëpunojnë me qendrën “Lilium” për këtë qëllim.

Kujdesi klinik për plagë dhe probleme mjekësore urgjente

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet:

- Të trajtojnë plagët (lëndimet) më pak të rënda, për shembull, prerje, mavijosje dhe plagë sipërfaqësore. Çdo plagë duhet të pastrohet dhe trajtohet sipas nevojës.
- Mund të përdorin medikamentet e mëposhtme:
 - antibiotikë për të parandaluar infektimin e plagëve;
 - vaksina e tetanozit ose vaksina të tjera (sipas protokolleve vendore);
 - medikamente për lehtësimin e dhimbjes, ankthit ose pagjumësisë.
- Në raste të dhunës seksuale, në pamundësi për ta referuar viktimën në qendrën e specializuar për trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale (qendra “Lilium”), punonjëset e shërbimeve shëndetësore në bashkëpunim me specialiste dhe specialistë të tjerë të fushës, duhet të ofrojnë shërbim për:
 - ekzaminim lidhur me shtatzëni të mundshme;
 - parandalimin e shtatzënisë së padëshiruar, duke ofruar ose dhënë me recetë kontrceptivin e urgjencës, brenda 5 ditëve pas marrëdhënies seksuale me dhunë. Kontrceptivi i urgjencës do të ishte ideale të jepej sa më shpejt që të jetë e mundur pas aktit të dhunshëm, për të qenë të sigurt

për efektin e tij. Rekomandohet një dozë e vetme prej 1.5 mg levonorgestrel, pasi ajo është po aq e efektshme sa dy doza prej 0.75 mg dhënë 12–24 orë veç e veç. Nëse nuk disponohet levonorgestrel, mund të ofrohet regjimi i kombinuar i estrogen-progesteronit, i shoqëruar me antiemetikët nëse janë të disponueshëm. Nëse kontrceptivi oral nuk është i disponueshëm dhe nëse është e realizueshme, mund t'i vendoset në uterus një pajisje DIU prej bakri brenda 5 ditësh pas marrëdhënies seksuale me dhunë asaj viktime së cilës i lejohet nga ana mjekësore. Nëse marrëdhënia seksuale me dhunë ka ndodhur para më shumë se 5 ditëve apo nëse dështon kontrceptivi i urgjencës, viktimës duhet t'i ofrohet abort i sigurt, në përputhje me legjislacionin shqiptar;

- zvogëlimin e rrezikut të infektimit me HIV, duke administruar profilaksinë pas ekspozimit të viktime e cila paraqitet brenda 72 orëve pas aktit seksual me dhunë;

- trajtimin profilaktik për infeksionet seksualisht të transmetueshme (klamidia, gonorrhea, trichomonas, sifilizi). Për zgjedhjen e barnave dhe të regjimeve duhet të ndiqen udhëzimet kombëtare;

- vaksinimi për hepatitin B nëse antitrukat anti-HPV rezultojnë negativë, duhet ofruar sipas udhëzuesve kombëtarë. Statusi i hepatitit B duhet të vlerësohet përmes një mostre gjaku, para dhënies së dozës së parë të vaksinës. Nëse antitrukat rezultojnë pozitivë, nuk duhet të bëhet vaksinimi.

- Të sigurojnë ose të mobilizojnë mbështetjen sociale, nëse është e nevojshme ose me kërkesën e viktimës.

- Të ndihmojnë viktimën të rrisë sigurinë për veten e saj, si dhe për fëmijët, kur është e nevojshme.

- Të planifikojnë dhe të ofrojnë shërbimet shëndetësore në vazhdim, nëse duhet dhe sipas kërkesës.

Vlerësimi dhe menaxhimi i shëndetit mendor/psikologjik

Në rastet e ushtrimit të dhunës nga partneri intim dhe të dhunës seksuale, ndërhyrjet psikologjike të rekomanduara kryhen në varësi të momentit të ndërhyrjes:

- Menjëherë pas incidentit të dhunës: duhet të ofrohet mbështetje psikologjike për t'u përgjigjur nevojave psikologjike të menjëhershme të viktimës. Ndihma e parë psikologjike përfshin elementet e mëposhtme: ofrimin e kujdesit dhe të mbështetjes emocionale; vlerësimin e nevojave dhe të shqetësimeve; ofrimin e ndihmës për të zgjidhur nevojat bazë (për shembull, ushqimin dhe ujin, informacionin); dëgjimin aktiv të viktimës, pa i bërë presion që të flasë; qetësimin dhe mbështetjen e saj për t'u ndierë mirë; ndihmën për të marrë informacionin e duhur, shërbimet dhe mbështetjen sociale; mbrojtjen nga dëmtimi i mëtejshëm; dhe ofrimin e një informacioni të shkruar mbi strategjitë e përballimit të stresit të rëndë.

- Deri në 3 muaj pas traumës: të vazhdohet të ofrohet kujdes dhe mbështetje praktike pas vlerësimit të nevojave dhe pritshmërive. Të aplikohet "pritja vigjilente" për 1–3 muaj pas ngjarjes, nëse personi nuk është në gjendje depresive apo nuk ka probleme me përdorimin e alkoolit ose të drogës, nuk ka simptoma psikotike, apo nuk shfaq tentativa vetëvrasëse ose vetëdëmtuese, ose ka vështirësi në kryerjen e veprimeve nga dita në ditë. Nëse viktimë paraqet simptomat pas përdhunimit ose ndonjë problem tjetër të shëndetit mendor, ajo duhet të referohet te punonjëset dhe punonjësit e specializuar për shërbimet e ndërhyrjes mendore/psikologjike.

- Pas 3 muajve të traumës: të vlerësohet shëndeti mendor dhe të adresohet ndonjë problem i vërejtur ose të referohet viktimë te një specialiste apo specialist tjetër për shërbime të mëtejshme afatgjata.

Mbledhja e provave

Provat duhet të grumbullohen vetëm nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, të cilat/të cilët duhet të jenë të trajnuar posaçërisht për teknikat e mbledhjes së provave, në zbatim të legjislacionit dhe rregulloreve që përcaktojnë kompetencat e kryerjes së procedurave. Hapat e veçantë të mbledhjes së provave duhet të ndiqen sipas protokolleve të miratuara. Do të ishte mirë që të dyja llojet e provave, si ato mjekësore dhe ato mjekoligjore, të

mbledhen gjatë një procesi ekzaminimi. Provat mjekësore mbledhen nga personeli mjekësor i qendrave shëndetësore ose i spitaleve, kurse ato mjekoligjore nga personeli i mjekësisë ligjore.

Gjatë këtij procesi, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore dhe të atyre mjekoligjore duhet:

- t'i shpjegojnë viktimës se për çfarë qëllimi mund të jenë të rëndësishme/të dobishme provat e mbledhura;
- të pyesin viktimën nëse dëshiron që të mbledhen provat e ushtrimit të dhunës;
- të sigurohen që informacioni rreth mbledhjes së provave të jetë i përfshirë dhe i pohuar në formularin e dhënies së pëlqimit të informuar të viktimës ose në formularin e shërbimit shëndetësor;
- nëse kushtet e mësipërme për mbledhjen e provave nuk plotësohen dhe viktima shpreh dëshirën që të mbledhen provat, ta referojnë atë në institucionin më të afërt që mund ta ofrojë këtë shërbim, si dhe t'i japin viktimës informacion të saktë mbi shërbimin që duhet ta ndihmojë në këtë çështje;
- t'i kujtojnë viktimës rëndësinë e mbledhjes së provave sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti për forma të caktuara të dhunës (p.sh., dhunës seksuale);
- t'i shpjegojnë viktimës se çfarë duhet bërë dhe çfarë duhet të shmanget për të ruajtur/për të mos shkatërruar provat (p.sh., të mos i lajë/të mos i ndërrojë rrobat);
- të risigurojnë viktimën në lidhje me konfidencialitetin e informacionit/provave;
- të zvogëlojnë rrezikun e traumës dhe humbjes së kohës, përmes integritetit të procedurave të mjekësisë me ato të mjekësisë ligjore, nëse është e mundur.

Dokumentimi i DHF-së/DHBGJ-së

Çdo rast i DHF-së/DHBGJ-së duhet të dokumentohet nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, si dhe duhet t'i përcillet edhe për dijeni koordinatorit/es vendor/e të MKR-së. Dokumentimi përmban minimalisht një përshkrim të plotë të informacionit më të rëndësishëm rreth incidentit të veçantë të dhunës, nëse nuk ka historik. Dokumentimi i rastit duhet të realizohet me anë të formularëve standardë, shënimeve, grafikëve, fotove, hartave trupore, regjistrave etj. Mbledhja e të dhënave të rëndësishme për secilin nga rastet dhe përcjellja e tyre në formatin standard të kërkuar, te koordinatori/ja vendore e MKR-së për pasqyrimin në sistemin elektronik të të dhënave (REVALB) mundëson: a) nxjerrjen e të dhënave për monitorimin dhe për vlerësimin e menaxhimit të rasteve aktuale; b) pasqyrimin e një pamjeje të qartë të rasteve të zbuluara në zona të caktuara; dhe c) vlerësimin e ecures së reagimit shumësektorial. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të mbledhin dhe të regjistrojnë informacionin për viktimën, duke përfshirë: të dhënat demografike (p.sh., emri mbiemri, mosha, gjinia, adresa, numri i telefonit, data e paraqitjes), marrjen e miratimit, historinë (p.sh., historia mjekësore e përgjithshme dhe ajo gjinekologjike), përshkrimin e incidentit, rezultatet e ekzaminimit fizik, analizat dhe rezultatet e tyre, planin e trajtimit, medikamentet e dhëna ose të dhëna me recetë, arsimimin e viktimës, informacionin e dhënë dhe referimin. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të:

- Mbledhin dhe regjistrojnë detajet e plota duke përfshirë:
- prova që mbështesin kryerjen e shkeljes ligjore të pretenduar;
- historikun e ndonjë incidenti tjetër, duke përfshirë ato me partnerë të mëparshëm;
- marrëdhënien e viktimës me dhunuesin;
- llojin e dhunës së ushtruar;
- dëshmitarët e pranishëm gjatë incidentit, përfshirë fëmijët;
- nëse janë përdorur armë (si dhe çfarë lloji);
- përshkruajnë me hollësi çdo dëmtim që vërejnë. Për këtë qëllim, të përdorin formularët specifikë, hartat e trupit dhe regjistrat e veçantë për një paraqitje më të saktë;
- shënojnë edhe simptomat emocionale dhe psikologjike;
- shënojnë çfarë thotë vetë viktima duke përdorur fjalët e saj;

- dokumentojnë dyshimet e tyre si punonjëse dhe punonjës, si dhe provat mbi të cilat bazohen;
- informojnë viktimat për përdorimin e mundshëm të të dhënave të tyre dhe të marrin pëlqimin e informuar të tyre për këtë gjë;
- ruajnë të gjitha të dhënat në një vend të sigurt e konfidencial. Udhëzimet e përcaktuara nga kuadri ligjor dhe protokollat ekzistuese diktojnë se sa gjithëpërfshirës duhet të jetë informacioni;
- planifikojnë mjaftueshëm kohë për të hedhur të dhënat në formularët përkatës të sistemit të regjistrimit të rasteve (REVALB), si dhe t'ia përcjellin ato në kohë koordinatorit/es vendor/e.

Referimi

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore janë shpesh profesionistët e parë që janë në kontakt me viktimën. Prandaj, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore mund t'i referojnë viktimat te profesionistët dhe profesionistët e tjerë të shëndetësisë në të njëjtin institucion shëndetësor, në ndonjë institucion tjetër shëndetësor ose në shërbime të tjera (policia, shërbimet mbështetëse të specializuara, shërbime të tjera të kujdesit shoqëror etj.). Po kështu, punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore mund t'u duhet të asistojnë viktimat të referuara nga specialiste dhe specialistë të shërbimeve të tjera. Viktimat kanë nevojë komplekse, prandaj, për një përgjigje efektive ndaj dhunës, kërkojnë një sërë shërbimesh të disponueshme për një reagim të koordinuar shumësektorial, që mund të sigurohet nga një referim efektiv.

Referimet efektive kërkojnë që punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore:

- të jenë të aftë të njohin dhe të lehtësojnë zbulimin e dhunës së ushtruar, si dhe të ofrojnë mbështetjen e linjës së parë;
 - të jenë të aftë të vlerësojnë situatën individuale dhe nevojat e viktimës. Nëse rreziku vlerësohet si i lartë, viktimat kërkon ndërhyrje të menjëhershme, të tilla si ndihmë mjekësore ose psikologjike të menjëhershme dhe/ose strehim në një strehëz emergjence (ose edhe afatgjatë). Nëse rreziku nuk vlerësohet si i lartë, mund të jenë të përshtatshme referimet për mbështetje të tjera sociale, psikologjike ose ligjore.
 - të njohin legjislacionin, politikat dhe strategjitë ekzistuese për dhunën, duke përfshirë përkufizimet përkatëse për veprat penale, masat mbrojtëse në dispozicion dhe të gjitha detyrimet për raportimin e dhunës nga ana e tyre. Këto njohuri kërkojnë vetëm mbi bazën e detyrimeve profesionale përkatëse;
 - të marrin pëlqimin e informuar të viktimës përpara se të ndajnë informacionin rreth rastit të saj me institucionet e tjera ose organizatat ofruese të shërbimeve, si dhe të ndjekin procedurën që mbron konfidencialitetin e viktimës. Në rastin e konfidencialitetit të pjesshëm, pra që raportimi i rastit në polici dhe te koordinatori/ja vendor/e nga ana e punonjëses apo punonjësit të shërbimeve shëndetësore është detyrim ligjor, sërish është e rëndësishme që viktimat të njoftohen për këtë kufizim dhe për llojin e informacionit që do të përcillet, përpara raportimit të rastit.
- Hapat e mëposhtëm duhet të ndiqen për të siguruar një referim efektiv:
- të përditësohet regjistri me institucionet/organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat. Regjistri duhet të përfshijë emrin e institucionit, personin e kontaktit, adresën, të dhëna të tjera kontakti, si dhe listën e shërbimeve që ofrohen;
 - të vlerësohet se çfarë referimi mund të jetë i dobishëm për viktimat, sipas vlerësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre;
 - të informohet viktimat për mundësinë e referimit tek institucione apo organizata të tjera shërbimesh, sipas kërkesës ose nevojës;
 - të merret pëlqimi i informuar i viktimës për të bërë referimin, para çdo hapi tjetër të mëtejshëm;
 - të sqarohet viktimat se çfarë informacioni do të ndahet me specialistët dhe specialistët e tjerë të shërbimeve dhe çfarë informacioni do të mbahet konfidencial (të specifikohet nëse ka ndonjë rregullim ligjor/kufizim);
 - t'i jepet viktimës informacion i plotë dhe korrekt për institucionet dhe organizatat e tjera ofruese të shërbimeve, sipas skemës së përshkruar më poshtë:

KUSH - cili institucion/organizatë ofron shërbime për viktimat, shoqëruar me të dhënat e personit (emrin, numrin e telefonit) që mund të kontaktohet si pikë kontakti për atë shërbim;

ÇFARË - çfarë lloj ndihme mund të marrin nga ky institucion/kjo organizatë, së bashku me informacion për kostot e këtij shërbimi (nëse ka);

KU - ku ndodhet saktësisht (adresa e saktë) shërbimi i caktuar;

- të bëhet referimi sipas vendimit (zgjedhjes) të viktimës;
- të shoqërohet referimi me një raport të shkurtër me shkrim dhe një diskutim në telefon me specialistin apo specialistin tjetër të shërbimeve, si një metodë për të shmangur situatën, kur viktimë duhet ta përsërisë historinë dhe t'u përgjigjet të njëjtave pyetje gjatë intervistave të shumfishta, duke përjetuar përsëri traumë psikologjike të shkaktuar nga incidenti i DHF-së/DHBGJ-së;

- të nxitet pavarësia e viktimës duke e ndërgjegjësuar atë që ta bëjë vetë referimin;
- të shoqërohet viktimë tek institucioni apo organizata tjetër ofruese e shërbimit ku po referohet, nëse është e nevojshme dhe e mundur;

- t'i shpjegohet viktimës se mund të rikthehet te shërbimet shëndetësore për ndihmë të mëtejshme. Të parashtrohet çështja e takimit të ardhshëm;

- t'i shpjegohet viktimës plani i ndjekjes së mëtejshme të gjendjes shëndetësore të saj;

- t'i jepen detajet e kontaktit për ndjekjen në vazhdim;

- të përfundohet ndihma kur të arrihet rezultati më i mirë i mundshëm (p.sh., kur viktimë referohet për shërbime të tjera afatgjata pas shërimit në aspektin shëndetësor ose kur nevojat/kërkesat e viktimës ndryshojnë dhe nuk mund të adresohen më nga shërbimet shëndetësore);

- të lidhen marrëveshje dhe protokolle për procesin e referimit me shërbime/institucione të rëndësishme, përfshirë përcaktimin e përgjegjësive të qarta për secilin shërbim;

- të sigurohen që procedurat midis shërbimeve/institucioneve për shkëmbimin e informacionit dhe referimet janë të vazhdueshme dhe njihen nga personeli.

REFERENCA

- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2016–2020.

- Paketa Bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, rishikuar dhe miratuar me VKM-në nr. 101, datë 4.2.2015.

- Ligji nr. 141/2014, “Për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

- Shqipëria: Raporti i GREVIO-s për masat legjislative dhe të tjera që zbatojnë dispozitat e Konventës së Këshilli të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe dhunës në Familje”, publikuar më 24 nëntor 2017.

- Ligji nr. 47/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar.

- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 912, datë 27.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”.

- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 866, datë 20.12.2018, “Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje”.

- Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

- Ligji nr. 35/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’”.

- Komisioni për Statusin e Grave: Sesioni 57 (2013), Konkluzionet e dakordësuara: Eliminimi dhe parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe vajzave (E/2013/27).

- IASC (2005), Udhëzime për ndërhyrjet ndaj dhunës me bazë gjinore në mjediset humanitare: Fokusi te parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës seksuale në situata emergjence.

- UNFPA (2001), Një qasje praktike ndaj dhunës me bazë gjinore: një udhëzues programi për ofrueset/it dhe menaxherët e kujdesit shëndetësor.

- UNFPA, WAVE (2014), Forcimi i reagimit të sistemit shëndetësor ndaj dhunës me bazë gjinore në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, një paketë burimore.

- UN Women, UNICEF, UNFPA (2015), Shërbimet sociale thelbësore për gratë dhe për vajzat të cilët përjetojnë dhunë. Standardet dhe udhëzimet e cilësisë.

- UN Women (2014), Identifikimi i elementeve thelbësore të shërbimeve të domosdoshme shëndetësore për t'iu përgjigjur dhunës ndaj grave dhe vajzave. Rezultati i Konsultimit Teknik Global.

- OBSH (2013), Duke iu përgjigjur dhunës së partnerit intim dhe dhunës seksuale ndaj grave: Udhëzimet klinike dhe politikat e OBSH-së.

- OBSH dhe UNHCR (2015), Menaxhimi klinik i kushteve mendore, neurologjike dhe i përdorimit të substancave në kushte të emergjencave humanitare: Udhëzuesi i Ndërhyrjes Humanitare të mhGAP (mhGAP-HIG). Gjenevë, Zvicër.

- OBSH, UN Women dhe UNFPA (2014), Kujdesi shëndetësor për gratë subjekt i dhunës nga partneri intim ose i dhunës seksuale: Manual klinik. Gjenevë: Zvicër.

- OBSH (2013), Në përgjigje ndaj dhunës nga partneri intim dhe dhunës seksuale ndaj grave: Udhëzimet klinike dhe të politikave të OBSH. Gjenevë: Zvicër.

- OBSH, Fondacioni i Traumës së Luftës dhe *World Vision* Ndërkombëtar (2011). Ndihma e parë psikologjike: Udhëzues për punonjësit në terren.

- OBSH (2010), Udhëzuesi i ndërhyrjes mhGAP për çrregullime mendore, neurologjike dhe të përdorimit të substancave në mjedise shëndetësore të paspecializuara. Gjenevë, Zvicër.

- OBSH dhe ONP (2007), Udhëzimet e përbashkëta të OBSH/të ONP-së mbi profilaksinë pas ekspozimit (PPE) për parandalimin e infektimit me HIV (2007).

- OBSH, UNFPA dhe UNHCR (2004), Menaxhimi klinik i të mbijetuarave të përdhunimit.

- OBSH (2003), Udhëzime për kujdesin medikoligjor për viktimat e dhunës seksuale.

URDHËR

Nr. 102, datë 21.2.2020

PËR MIRATIMIN E “PËR PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV) PËR PUNONJËSET/PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, PËR ZVOGËLIMIN E RREZIKUT TË PËRJETIMIT TË DHUNËS NË FAMILJE E TË DHUNËS ME BAZË GJINORE, NË SITUATA TË EMERGJENCAVE CIVILE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 104 datë 8.11.2012, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”; të nenit 28, germa “d”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 508, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”,

URDHËROJ:

1. “Për Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore, në situata të emergjencave civile”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, drejtoritë rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, njësitë vendore të Kujdesit Shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, drejtoritë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe drejtuesit e shërbimeve shëndetësore e të mbrojtjes sociale për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT
PËR PUNONJËSET DHE PUNONJËSIT E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE
PËR ZVOGËLIMIN E RREZIKUT TË PËRJETIMIT TË DHUNËS NË FAMILJE DHE
TË DHUNËS ME BAZË GJINORE, NË SITUATA TË EMERGJENCAVE CIVILE
Shkurt, 2020

HYRJE

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile, u përgatitën nën kujdesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), me mbështetjen e zyrës së UNFPA-së, Shqipëri, përmes organizatës së saj partnere në zbatim Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin.

PSV-të u përgatitën përmes një procesi të gjatë e gjithëpërfshirës konsultimi të udhëhequr nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ku u angazhuan specialiste dhe specialistë të Sektorit të Menaxhimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave dhe specialistët e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; eksperte dhe ekspertë të fushës⁸⁵; si dhe anëtarë të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, të ngritura në nivel të vetëqeverisjes vendore. Të bazuara në praktikën më të mirë ndërkombëtare⁸⁶, këto PSV u përshtatën, u diskutuan dhe u përditësuan për të qenë lehtësisht të zbatueshme edhe në Shqipëri.

Megjithatë fokusohen vetëm te punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore dhe marrin në konsideratë hapat që duhet të ndiqen nga sektori i shëndetësisë për **planifikimin, për monitorimin, për koordinimin, për zbatimin dhe për vlerësimin e veprimeve bazë për parandalimin dhe për zvogëlimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile**, do të ishte mirë që këto PSV të kompletohen në të ardhmen me PSV të tjera të hartuara me të njëjtin fokus pune, por për të gjithë sektorët që bashkëpunojnë me sektorin e shëndetësisë për përballimin e situatave të emergjencave civile në Shqipëri. Gjithashtu, në këtë rast, mirë do të ishte që fokusi të shtrihej edhe përtej emergjencave civile, duke mbuluar të gjitha situatat e mundshme të krizave humanitare.

PSV-të në vijim janë udhëzime të shkruara mbi atë se çfarë pritet dhe çfarë kërkohet nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për kryerjen e punës dhe ofrimin e ndihmës e mbështetjes së tyre, në situata të emergjencave civile.

⁸⁵ Dr. Rakip Gjoni, ekspert në fushën e shëndetësisë dhe të emergjencave civile dhe znj. Monika Kocaqi, eksperte për çështjet e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje.

⁸⁶ “Udhëzimet për integrimin e ndërhyrjeve kundër dhunës me bazë gjinore në veprimet humanitare”, përgatitur nga IASC (*Inter-Agency Standing Committee*), si dhe në një sërë dokumentesh të tjera ndërkombëtare e kombëtare.

SHKURTIME

DHBGJ	Dhunë me bazë gjinore
DHF	Dhunë në familje
DHnGV	Dhunë ndaj grave dhe vajzave
DPEC	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile
DPPEC	Drejtoria e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile
GOMF	Grupi Operacional i Menaxhimit të Fatkeqësive
GJOGJF	Gjymtimi i organeve gjenitale femërore
HIV	Virusi i imuno-deficiencës njerëzore
IASC	<i>Inter-Agency Standing Committee</i> (Komiteti i Përhershëm i Agjencive)
IST	Infeksione Seksualisht të Transmetueshme
KM	Këshilli i Ministrave
KPPEC	Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile
LGBTI	Lezbike, gei, biseksualë, transseksualë, interseksualë
MISP	Standarde minimale të paketës së shërbimit fillestar
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit (për rastet e dhunës në familje)
MM	Ministria e Mbrojtjes
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizatë joqeveritare jofitimprurëse
PKPSHSHF	Plani Kombëtar i Përgjigjes së Shërbimit Shëndetësor ndaj Fatkeqësive
PSV	Procedura standarde të veprimit
PPE	Profilaksitë postekspozuese
QKOE	Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile
QSHPHZ	Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZIMEK	Zyra e Informacionit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE

SHKURTIME

I. QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV-ve)

II. PARIMET DHE STANDARDET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR TË MBIJETUARAT SUBJEKT I DHBGJ-së.

III. GJUHA DHE TERMINOLOGJIA

IV. PËRSE RRITET RREZIKU I TË QENIT SUBJEKT I DHBGJ-së NË SITUATA KRIZE?

V. PËRSE ADRESIMI I DHUNËS ME BAZË GJINORE PËRBËN SHQETËSIM THEMELOR PËR SHËRBIMET SHËNDETËSORE?

VI. ZBATUESHMËRIA

VII. KOORDINIMI ME SEKTORË TË TJERË HUMANITARË

VIII. RRETHANA DHE SJELLJE QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHBGJ-së

IX. SI TË BASHKËVEPRONI ME TË MBIJETUARËN QË ËSHTË SUBJEKT I DHBGJ-së

X. PROCEDURAT

I. QËLLIMI I PROCEDURAVE STANDARDE TË VEPRIMIT (PSV)

Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në situata të emergjencave civile, **përshkruajnë tërësinë e veprimeve dhe të hapave thelbësorë që duhet të planifikohen, monitorohen, koordinohen, zbatohen dhe vlerësohen rregullisht, në mënyrë korrekte dhe logjike prej tyre, për të parandaluar, si dhe për të ofruar kujdesin dhe ndihmën e duhur për të mbijetuarat/it subjekt i dhunës në familje dhe i dhunës me bazë gjinore (DHF/DHBGJ)⁸⁷, si dhe për të zvogëluar rrezikun e përjetimit të DHF-së/DHBGJ-së, gjatë përballimit të situatave të ndryshme të emergjencave civile në Shqipëri, nga gatishmëria deri në rimëkëmbje.** Me fjalë të tjera, PSV-të janë udhëzime të shkruara mbi atë se çfarë pritet dhe çfarë kërkohet nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për kryerjen e punës dhe ofrimin e ndihmës e mbështetjes së tyre, në situata të emergjencave civile.

Objektivat e PSV-së për ndërhyrjen e punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore në rastet e DHF-së/DHBGJ-së, në situata të emergjencave civile, janë:

- të ndihmojnë për identifikimin me efektivitet të të mbijetuar/ave subjekt i kësaj forme dhune;
- të sigurojnë dhe/ose të rrisin sigurinë e të mbijetuar/ave në të gjitha fazat e ndërhyrjes;
- të sigurojnë vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve cilësore;
- të sigurojnë mbledhjen e të dhënave për dokumentimin e koordinuar dhe të përmirësuar;
- të garantojnë konfidencialitetin e shërbimeve të ofruara për të mbijetuarat/it;
- të mundësojnë referimin me efektivitet të të mbijetuar/ave brenda sektorit të shëndetësisë;
- të lidhin institucionet e shërbimeve shëndetësore me shërbimet e tjera që ofrohen për të mbijetuarat/it.

PËRKUFIZIM PËR “EMERGJENCAT CIVILE”

Sipas nenit 2, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, të ndryshuar:

1. “Emergjencë civile” kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

2. “Emergjencë civile kombëtare” kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohshme, që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetaseve dhe të shtetasve të Republikës së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të vetëqeverisjes vendore, për ta përballuar atë ose kërcënon seriozisht mundësinë e qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.

3. “Fatkeqësi natyrore” kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësirat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortelet, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.

4. “Fatkeqësi të tjera” kuptohen aksidentet rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, shpërthimet, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore, ekologjike ose industriale dhe çdo lloj tjetër aksidenti të shkaktuar nga veprimi njerëzor, nga luftërat ose gjendjet e emergjencës, si dhe format e tjera të dhunës masive.

5. “Fatkeqësi” kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera të parashikuara në këtë ligj, të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë

⁸⁷ **Shënim i rëndësishëm.** Në diskutimet për dhunën me bazë gjinore, zakonisht përdoret më së shumti termi “viktimë/e mbijetuar”, me qëllim që të tregohet se një grua edhe pse viktimë e dhunës, e ka gjithmonë forcën brenda vetes derisa ka mbijetuar në atë situatë dhe ka arritur ta denoncojë dhunën e ushtruar ndaj saj. Në këtë dokument, duke marrë në konsideratë specifikat e terminologjisë që përdoret në situata të emergjencave civile (ku “viktimë” nënkupton një person që e ka humbur jetën), termi “viktimë/e mbijetuar”, do të zëvendësohet me termin “i/e mbijetuar subjekt i DHF-së/DHBGJ-së”.

jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore e materiale-teknike.

12. “Rrezik” kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

II. PARIMET DHE STANDARDET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PËR TË MBIJETUARAT SUBJEKT I DHF-së/DHBGJ-së

Qasja e bazuar te të drejtat e njeriut

Qasja e bazuar te të drejtat e njeriut kërkon të analizojë shkaqet rrënjësore të problemeve dhe të korrigjojë praktika diskriminuese që pengojnë ndërhyrjen humanitare. Kjo qasje është shpesh në kontrast me qasjen e bazuar te nevojat, sipas së cilës ndërhyrjet synojnë të adresojnë problemet praktike, nevojat urgjente dhe afatshkurtra, përmes ofrimit të shërbimit. Edhe pse qasja e bazuar te nevojat përfshin popullatat e prekura në proces, shpesh e ndalon adresimin e politikave dhe rregulloreve që mund të kontribuojnë në ndryshimin sistematik të qëndrueshëm. Në të kundërt, qasja e bazuar në të drejtat e njeriut e sheh popullsinë si “mbartëse e së drejtës” dhe pranon se këto të drejta, mund të realizohen vetëm duke mbështetur në terma afatgjatë fuqizimin e popullatave të prekura, nëpërmjet zgjidhjeve të qëndrueshme. Kjo qasje kërkon që vetë grupet e prekura nga emergjencat civile të informohen mbi kuadrin ligjor dhe shërbimet ekzistuese, si dhe të marrin pjesë në përcaktimin dhe adresimin e nevojave të tyre. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut kërkon nga planifikueset dhe planifikuesit, si dhe nga zbatueset dhe zbatuesit e programeve dhe shërbimeve që lidhen me DHF-në/DHBGJ-në, të:

- vlerësojnë kapacitetin e bartëseve dhe të bartësve të të drejtave për të kërkuar të drejtat e tyre (identifikimi i të drejtave, shkaqet themelore dhe strukturore për mosrealizimin e tyre), si dhe për të marrë pjesë në zhvillimin e zgjidhjeve që ndikojnë në jetën e tyre në mënyrë të qëndrueshme;
- vlerësojnë kapacitetet dhe kufizimet e bartëseve dhe të bartësve të detyrimeve për të përmbushur detyrimet e tyre;
- zhvillojnë strategji të qëndrueshme për ndërtimin e kapaciteteve dhe kapërcimin e këtyre kufizimeve nga zbatueset dhe zbatuesit e së drejtës;
- monitorojnë dhe vlerësojnë rezultatet dhe proceset, të udhëhequr nga standardet e të drejtave të njeriut, si dhe duke përdorur qasjet pjesëmarrëse;
- sigurojnë që planifikimi dhe hartimi i strategjive të ndërhyrjes të bazohen te rekomandimet e organeve dhe mekanizmave të të drejtave ndërkombëtare të njeriut.


Qasja me ndjeshmëri gjinore

Shërbimet e ofruara duhet të demonstrojnë një qasje që njeh dinamikën gjinore, ndikimet dhe pasojat e dhunës ndaj grave. Shërbimet shëndetësore duhet të marrin parasysh nevojat e grupeve të veçanta të grave, të rejave dhe të vajzave, duke përfshirë ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara (si: rome, egjiptiane, komuniteti LGBTI, PAK etj.). Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të respektojnë shumëllojshmërinë e përdoruesve dhe përdoruesve të shërbimeve dhe të zbatojnë një qasje jodiskriminuese. Kjo nënkupton që të gjitha gratë, të reja dhe vajzat e mbijetuara duhet të kenë qasje të barabartë dhe të plotë në shërbimet shëndetësore, njëlloj si të gjithë burrat, të rinjtë dhe djemtë. Shërbimet shëndetësore duhet të ofrohen me të njëjtin nivel cilësie për të gjithë njerëzit që kanë nevojë për to, pavarësisht gjinisë, moshës, vendbanimit, përkatësisë fetare, përkatësisë etnike, aftësive të kufizuara apo orientimit seksual ndryshe.

Qasja me në qendër të mbijetuarën/in subjekt i DHF-së/DHBGJ-së

Gjatë ndërhyrjes në incidentet apo rastet e DHF-së/DHBGJ-së, qasja më e mirë në mënyrë që të krijohet një mjedis ku i/e mbijetuari/a të ndihet i/e pranuar, është respektimi i të drejtave dhe i dinjitetit të saj/të tij. Kjo e ndihmon të mbijetuarën/in në identifikimin e nevojave emergjente dhe marrjen e vendimeve së bashku me punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë, si dhe me specialistet e specialistët e shërbimeve të tjera mbështetëse, për mënyrën se si duhet vepruar.

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të tregojnë kujdes maksimal për mbështetjen e të mbijetuarave/ve subjekt i DHF-së/DHBGJ-së dhe shmangien e rrezikut të riviktimizimit të tyre gjatë marrjes së shërbimeve. Shërbimet shëndetësore duhet të ofrohen, duke mbajtur në konsideratë parimet që paraqiten në skemën në vijim:



Qasja e përqendruar te të mbijetuarat/it mund të udhëheqë profesionistët dhe profesionistët - pavarësisht nga roli i tyre - në angazhimin direkt me personat që janë subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Ajo synon të krijojë një mjedis mbështetës ku të respektohen të drejtat e të mbijetuarave subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, të ofrohet siguri për to, si dhe trajtim me dinjitet e respekt. Qasja ndihmon për të promovuar shërimin e një të mbijetuarit/e subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, si dhe për të forcuar aftësinë e saj për të identifikuar dhe për të shprehur nevojat; ajo gjithashtu përforcon aftësinë e personit për të marrë vendime, së bashku me punonjëset dhe punonjësit e shëndetësisë, për ndërhyrjet e mundshme.

E RËNDËSISHME PËR T'U MBAJTUR NË KONSIDERATË Elementet thelbësore të qasjes me në qendër të mbijetuarën/in subjekt i DHF-së/DHBGJ-së: 1. Siguria: Siguria dhe mbrojtja e të mbijetuarës/it dhe të tjerëve, si të fëmijëve të saj/tij dhe të njerëzve që e kanë ndihmuar atë, duhet të jetë prioriteti numër një për të gjithë aktorët. Individët të cilët tregojnë apo denoncojnë një incident të DHF-së/DHBGJ-së ose një histori abuzimi, shpesh janë në rrezik të lartë të dhunës së mëtejshme nga autori i veprës penale ose nga të tjerët rreth tyre. 2. Konfidencialiteti: Konfidencialiteti pasqyron besimin se njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin se kujt do t'ia tregojnë ose nuk do t'ia tregojnë historinë e tyre. Ruajtja e konfidencialitetit do të thotë të mos zbulohet asnjë informacion në asnjë kohë dhe nga asnjë palë pa marrë pëlqimin/ miratimin e informuar të personit në fjalë. Konfidencialiteti nxit sigurinë, besimin dhe fuqizimin. 3. Respekti: I/e mbijetuarit/a është aktoria kryesore dhe roli i ndihmësve dhe i ndihmësve (punonjëseve dhe punonjësve) është të lehtësojnë shërimin dhe të sigurojnë burime për zgjidhjen e problemeve. Të gjitha veprimet e ndërmarra duhet të udhëhiqen nga respekti për zgjedhjet, nevojat, si dhe të drejtat dhe dinjitetin e të mbijetuarës/it. 4. Mosdiskriminimi: Të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së duhet të marrin trajtim të barabartë dhe të drejtë, pa marrë parasysh moshën, vendbanimin, fenë, kombësinë, përkatësinë etnike, orientimin seksual ose çdo karakteristikë tjetër të tyre.
--

Mbrojtja dhe siguria

Siguria e të mbijetuarës/it si dhe e punonjësës apo punonjësit të shërbimeve shëndetësore duhet të jetë përparësi, kur organizohet dhe ofrohet përkujdesja për të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Vlerësimi i nivelit të sigurisë së të mbijetuarës/it duhet të bëhet në momentin e identifikimit si dhe kur ajo/ai pohon se ka qenë apo është subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Gjithashtu, vlerësimi i sigurisë personale duhet të jetë pjesë e çdo konsulte. Me nisjen e konsultës me një të mbijetuar subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, është e rëndësishme të mbahen parasysh kërcënimet e mundshme (nga dhunuesi, që mund të jetë bashkëshorti, një pjesëtar tjetër i familjes, një i njohur, një i panjohur apo edhe një specialist që ofron shërbime përkujdesjeje) për të garantuar një mjedis ku konsulta mund të bëhet pa dëmtuar veten, të mbijetuarën ose koleget apo kolegët e tjerë.

Konfidencialiteti dhe privatësia

Respektimi i konfidencialitetit është një masë e rëndësishme që duhet marrë për të garantuar sigurinë e të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së dhe punonjësës apo punonjësit të shërbimeve shëndetësore. Konfidencialiteti i të mbijetuarës/it duhet të respektohet gjatë gjithë kohës. Kjo nënkupton përcjelljen te të tjerët vetëm të informacionit të domosdoshëm, si dhe vetëm në situatat që është e nevojshme ose e kërkuar (detyrim ligjor), dhe vetëm me informimin e të mbijetuarës/it. Garantimi i privatësisë gjatë konsultës (identifikimi dhe menaxhimi klinik) dhe i konfidencialitetit në mbledhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, raportimin dhe shkëmbimin e informacionit, zvogëlon rrezikun e ekspozimit si të të mbijetuarës/it ashtu edhe të punonjësëve e punonjësve të shërbimeve shëndetësore. Ruajtja e konfidencialitetit garanton që i/e mbijetuari/a nuk do të përjetojë më kërcënime dhe/ose dhunë si rezultat i kërimit të ndihmës dhe, gjithashtu, mbron punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore nga kërcënimet e dhunuesve. Punonjësëve dhe punonjësve të shëndetësisë u lind nevoja e konsultimit me koleget dhe kolegët e tyre për një trajtim shëndetësor më të specializuar të të mbijetuarës/it – në këtë rast konfidencialiteti nuk mund të respektohet për disa informacione mbi të mbijetuarën/in. Informacioni mund të ndahet me koleget dhe kolegët nëse ekziston një arsye mjekësore për të dhe nëse punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore e referon të mbijetuarën/in te një tjetër institucion i shërbimeve shëndetësore. Kjo duhet t'i shpjegohet të mbijetuarës/it paraprakisht dhe i/e mbijetuari/a duhet të jetë në dijeni të informacionit që do të jepet dhe kujt do t'i jepet. Ndërkohë, nëse i/e mbijetuari/a tregon se është subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, raportimi i këtij rasti në polici nga ana e punonjësëve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore është detyrim ligjor (kur rasti përbën vepër penale) dhe konfidencialiteti nuk mund të respektohet. Është e rëndësishme që i/e mbijetuari/a të informohet menjëherë për këtë detyrim ligjor, duke i shpjeguar që njoftimi i policisë bëhet për marrjen e masave për mbrojtjen e saj/tij dhe ruajtjen nga përsëritja e dhunës e dëmtimi në vazhdimësi.

Zgjedhja e informuar

Me përjashtim të veprimeve që janë detyrime ligjore (raportimi i rastit të DHF-së/DHBGJ-së, kur përbën vepër penale, në polici) çdo veprim tjetër duhet të kryhet pas marrjes së pëlqimit paraprak të informuar të të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, pra pasi t'i jetë dhënë asaj informacioni i nevojshëm për të gjykuar dhe dhënë këtë pëlqim. Edhe në rast të veprimeve që duhet të kryhen, sepse janë detyrime ligjore, është shumë e rëndësishme që i/e mbijetuari/a subjekt i DHF-së/DHBGJ-së të informohet për këtë detyrim ligjor dhe hapat që do të ndërmerren.

Mosdiskriminimi

Të gjitha/gjithë të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të kenë të njëjtat të drejta për përfitim të shërbimeve shëndetësore, pavarësisht moshës, vendbanimit, racës, kombësisë, besimit fetar, përkatësisë etnike, orientimit seksual, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, statusit martesor, arsimimit dhe statusit socioekonomik të tyre.

E RËNDËSISHME PËR T'U MBAJTUR NË KONSIDERATË

Pëlqimi i informuar

Gjatë shqyrtimit nëse një veprim është kryer kundër vullnetit të një personi, është e rëndësishme të merret parasysh dhënia e pëlqimit të informuar. Pëlqimi i informuar jepet vullnetarisht dhe falas, bazuar në një vlerësim të qartë dhe kuptim të mirë të fakteve, ndikimeve dhe pasojave të këtij veprimi në të ardhmen. Për të dhënë pëlqimin mbi veprimet që do të ndërmerren, në lidhje me rastin e saj/të tij, një e/i mbijetuar subjekt i DHF-së/DHBGJ-së duhet të ketë paraprakisht të gjitha informacionet e rëndësishme dhe faktet mbi situatën, si dhe duhet të jetë në gjendje të vlerësojë dhe të kuptojë pasojat e këtij veprimi. Ai/ajo, gjithashtu, duhet të jetë i/e vetëdijshëm/me dhe të ketë fuqinë për të ushtruar të drejtën e saj/të tij për të refuzuar të angazhohet në një veprim dhe/ose për të mos qenë e/i detyruar (të mos bindet thjesht nga ushtrimi i forcës ose kërcënimeve). Fëmijët, përgjithësisht, konsiderohen të paafte për të dhënë pëlqimin e informuar, për shkak se nuk kanë aftësinë dhe/ose përvojën për të parashikuar ndikimet dhe pasojat e një veprimi dhe nuk mund ta kuptojnë ose nuk janë mjaftueshëm të fuqizuar për të ushtruar të drejtën e tyre për të refuzuar. Ka edhe raste kur dhënia e pëlqimit nuk është e mundur, për shkak të dëmtimeve njohëse dhe/ose fizike, ndijore apo aftësi të kufizuara zhvillimore.

Qasja e bazuar në komunitet

Një qasje e bazuar në komunitet këmbëngul që grupet e prekura duhet të jenë udhëheqëse dhe partnere kryesore në zhvillimin e strategjive që lidhen me ndihmën dhe mbrojtjen e tyre. Duke filluar nga faza më e hershme e emergjencës, të gjithë ata dhe ato që preken duhet të “marrin pjesë në marrjen e vendimeve që ndikojnë në jetën e tyre” dhe “kanë të drejtën për informacion dhe transparencë” nga ata dhe ato që japin ndihmë.

Qasja e bazuar në komunitet:

- lejon një proces konsultimi të drejtpërdrejtë dhe dialogu me të gjithë anëtarët dhe anëtarët e komuniteteve, duke përfshirë gratë, të rejat, vajzat dhe grupet e tjera në rrezik;
- angazhon grupe që shpesh neglizhohen, si partnerë aktivë dhe të barabartë në planifikimin, monitorimin, koordinimin, zbatimin dhe vlerësimin e ndihmës;
- siguron që të gjithë anëtarët dhe anëtarët e komunitetit të jenë më të mbrojtur/a, të zhvillojnë aftësinë e tyre për të identifikuar zgjidhjet, si dhe të mbështetin përdorimin efektiv të burimeve humanitare.

III. KONCEPTE DHE PËRKUFIZIME

Dhuna me bazë gjinore (DHBGJ) është term gjithëpërfshirës për çdo lëndim që i bëhet një personi kundër vullnetit të tij; që ka ndikim negativ në shëndetin, zhvillimin, identitetin fizik dhe psikologjik të një personi; dhe që është rezultat i marrëdhënieve të gjinizuara të pushtetit që shfrytëzon pabarazitë dhe marrëdhëniet e nënshtrimit ndërmjet burrave dhe grave. Megjithatë nuk kufizohet vetëm te gratë, te të rejat dhe te vajzat, DHBGJ-ja kryesisht ndikon te ato në të gjitha kulturat. Dhuna mund të jetë fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike ose social-kulturore. Kategoritë e dhunuesve mund të përfshijnë anëtarë të familjes, anëtarë të komunitetit, si dhe ata që veprojnë në emër të/ose, në përputhje me mospërfilljen e institucioneve kulturore, fetare, shtetërore ose private. Termi “DHBGJ” zakonisht përdoret për të nënvizuar se si pabarazia sistematike mes grave dhe burrave – që ekziston në çdo shoqëri në botë – vepron si një karakteristikë unifikuese dhe themelore e shumicës së formave të dhunës të ushtruara ndaj grave, të rejave dhe vajzave. Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave (1993) përkufizon dhunën ndaj grave, si: “çdo akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton ose ka të ngjarë të rezultojë në dëmtime fizike psikologjike apo seksuale ose vuajtje për gratë”. Kjo deklaratë thekson, se: “dhuna është manifestimi i marrëdhënieve historikisht të pabarabarta të pushtetit midis burrave dhe grave, të cilat kanë çuar në dominimin dhe në diskriminimin e grave nga burrat dhe në parandalimin e përparimit të plotë të grave”.

Disa nga format e dhunës me bazë gjinore

Dhunë seksuale “Çdo akt seksual, përpjekje për të kryer një akt seksual, komente ose prekje seksuale të padëshiruara, ose çdo veprim tjetër kundrejt seksualitetit të një personi, duke përdorur shtrëngim, nga cildo person, pavarësisht nga marrëdhënia e tyre me viktimën, në çdo mjedis, duke përfshirë por pa u kufizuar në shtëpi dhe punë. Shtrëngimi mund të mbulojë një spektër të tërë të shkallëve të forcës. Përveç forcës fizike, mund të përfshijë kërcënime psikologjike, presion

ose kërcënime të tjera, për shembull kërcënimi i dëmit fizik, largimi nga puna ose mosmarrja e një pune që kërkohet. Mund të ndodhë edhe kur personi i sulmuar nuk është në gjendje të japë pëlqimin, për shembull, kur është i dehur, droguar, në gjumë ose mendërisht i paafte për të kuptuar situatën. Dhuna seksuale përfshin **përdhunimin**, të përkufizuar si shtrëngim fizik ose penetrim, duke përdorur shtrëngimin – edhe nëse në masë të vogël – të vulvës ose anusit, duke përdorur një penis, pjesë të tjera të trupit ose një objekt. Përpjekja për ta bërë këtë njihet si **tentativë për përdhunim**. Përdhunimi i një personi nga dy ose më shumë autorë është i njohur si **përdhunim në grup**. Dhuna seksuale mund të përfshijë forma të tjera të sulmit mbi një organ seksual, duke përfshirë kontaktet e detyruara midis gojës dhe penisit, vulvës ose anusit. Termat “sulm seksual”, “përdhunim”, “abuzim seksual” dhe “dhunë seksuale” përdoren shpesh në mënyrë të ndërsjellë.

Ngacmim seksual përkufizohet, si: “Çdo formë sjelljeje e padëshiruar verbale, joverbale ose fizike e një natyre seksuale, me qëllimin ose efektin e shkeljes së dinjitetit të një personi, veçanërisht, kur krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose fytes”. **Ngacmimi seksual është, gjithashtu, vepër penale** dhe parashikohet në nenin 108/a të Kodit Penal të RSH-së, sipas të cilit: “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet”.

Abuzim seksual i fëmijëve cilësohet, si: “Çdo aktivitet seksual midis një fëmije dhe anëtarit të ngushtë të familjes (incesti); ose midis një fëmije dhe një të rrituri; apo një fëmije dhe një fëmije më të rritur, jo anëtar familjeje. Ai përfshin si rastet e përdorimit të forcës ose detyrimit, ashtu edhe rastet kur nuk mund të jepet pëlqimi nga viktimja për shkak të moshës së tij ose të saj”.

Dhunë në familje, gjithashtu, në të njëjtin ligj sa më sipër, përkufizohet: “Çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën”.

Aborti dhe sterilizimi i detyruar. Aborti i detyruar është heqja e embrionit apo e fetusit nga trupi i gruas ose i të resë pa pëlqimin e saj paraprak; sterilizimi i detyruar është kryerja e një operacioni kirurgjikal që ka qëllimin ose efektin e ndërprerjes së kapacitetit të një gruaje ose të reje për riprodhim në mënyrë natyrale, pa pëlqimin e saj paraprak ose pa i shpjeguar kuptimin e procedurës.

Martesa e detyruar. Përdorimi i qëllimshëm i kërcënimeve apo detyrimi i një të rriture apo i të rrituri ose fëmije për të lidhur martesë. Termi “detyrim” i referohet forcës fizike dhe psikologjike ku përdoret shtrëngimi dhe presioni.

Krimet në emër të “nderit”. Çdo lloj akti dhune apo kërcënimi ku kultura, zakonet, besimi, tradita apo i ashtuquajtur i “nder”, përdoren si justifikim për veprime të tilla. Kjo mbulon në veçanti, deklaratimet që viktimja ka shkelur normat tradicionale, kulturore, fetare, sociale apo zakonet e të sjellurit në mënyrën e duhur.

Përndjekja si vepër penale parashikohet në nenin 121/a të Kodit Penal sipas të cilit: “Kërcënimi ose ngacmimi i personit me anën e veprimeve të përsëritura, me qëllimin për t’i shkaktuar një gjendje të vazhdueshme dhe të rëndë ankthi apo frike për sigurinë vetjake, të një të afërmi ose të një personi, me të cilin ka lidhje shpirtërore, apo për ta detyruar të ndryshojë mënyrën e tij të jetesës, dënohet me burgim nga gjashtë muaj gjer në katër vjet. Kur kjo vepër kryhet nga ish-bashkëshorti, ish-bashkëjetuesi apo personi që ka pasur lidhje shpirtërore me të dëmtuarin, dënimi rritet me një të tretat e dënimit të dhënë. Kur kjo vepër kryhet ndaj të miturit, gruas shtatzënë ose një personi të pazotë për t’u mbrojtur, si dhe kur kryhet nga një person i maskuar ose shoqërohet me mbajtjen ose me përdorimin e armëve, dënimi rritet deri në një të dytën e dënimit të dhënë”.

Trafikim i genieve njerëzore. Rekrutimi, transferimi, transportimi, strehimi ose marrja e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo të formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur, apo dhënia ose marrja e pagesave ose përfitimeve për të mbështetur një person që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin minimalisht shfrytëzimin e të tjerëve për qëllime prostitucioni, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikën e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.

E RËNDËSISHME PËR T’U MBAJTUR NË KONSIDERATË

“Parandalimi” dhe “zvogëlimi” i DHF-së/DHBGJ-së: Në këtë PSV i referohemi si “parandalimit” ashtu edhe “zvogëlimit” të rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Ndonëse në mënyrë të pashmangshme ka mbivendosje midis këtyre dy veprimeve, parandalimi, përgjithësisht, i referohet marrjes së masave për të ndaluar një episod të DHF-së/DHBGJ-së që nga shfaqja e parë (p.sh., rritja e aktiviteteve që promovojnë barazinë gjinore, puna me komunitetet, veçanërisht burrat, të rinjtë dhe djemtë, për të trajtuar praktikën që kontribuojnë në DHF/DHBGJ etj.). “Zvogëlimi” i referohet zvogëlimit të rrezikut të ekspozimit ndaj DHF-së/DHBGJ-së (p.sh., duke siguruar adresim të menjëhershëm nëpërmjet strategjive për reduktimin e rrezikut; duke siguruar ndriçim të mjaftueshëm dhe patrulla të sigurisë që nga fillimi i trajtimit dhe përgjatë gjithë rrugës për zhvendosjen në kampe/qendra të trajtimit të emergjencave civile etj.) Në këtë rast, edhe sektori i shëndetësisë mund të ndërmarrë aktivitete që lidhen me përkujdesjen dhe ndihmën e të mbijetuarave, bazuar në rekomandimet që lidhen me reagimin shumësektorial të koordinuar në ofrimin e shërbimeve.

IV. PËRSE RRIKET RREZIKU I TË QENIT SUBJEKT I DHF-së/DHBGJ-së NË SITUATA KRIZE?

Në kohë dhe situata krize, shumë faktorë të lidhur me DHF-në/DHBGJ-në kontribuojnë në rritjen e rrezikut dhe cenueshmërisë së qytetareve dhe qytetarëve, veçanërisht grave, të rejave e vajzave. Të tillë faktorë mund të përmendim:

- zhvendosja e grupeve të dëmtuara deri në mjediset përkatëse të siguruar;
- mungesa e burimeve bazë në komunitet (strehimi, ushqimi, uji etj.);
- mungesa e mbrojtjes brenda në/dhe nga komuniteti;
- ndërprerja e shërbimeve sociale;
- infrastruktura e dëmtuar ose e dobësuar;
- ndryshimi i normave kulturore dhe gjinore etj.

Shkaqet themelore të dhunës janë të lidhura me qëndrimet, besimet, normat dhe strukturat që nxisin dhe/ose falin diskriminimin gjinor dhe ndarjen jo të barabartë të pushtetit, qoftë gjatë emergjencave apo gjatë kohës së stabilitetit. Lidhja e DHF-së/DHBGJ-së me rrënjët e saj në diskriminimin gjinor dhe pabarazinë gjinore kërkon që jo vetëm të punohet për të përmbytur nevojat e menjëhershme të popullatave të prekura, por edhe të hartohen strategjitë e zbatimit – sa më herët të jetë e mundur – në çdo veprim humanitar. Këto strategji duhet të promovojnë ndryshime afatgjata shoqërore dhe kulturore drejt barazisë gjinore. Strategji të tilla përfshijnë sigurimin e lidershit dhe angazhimit aktiv të grave, të rejave dhe të vajzave, së bashku me burrat, të rinjtë dhe djemtë; avokimit për të promovuar të drejtat e të gjitha popullatave të prekura, si dhe dhënies përparësi të punësimit dhe angazhimit të grave dhe të rejave në çdo sektor të shërbimeve, duke përfshirë edhe në pozita udhëheqëse, qoftë gjatë emergjencave apo edhe gjatë kohës së stabilitetit.

Faktorët kontribues në DHF/DHBGJ	
Faktorët në nivel të shoqërisë	- Mungesa e respektimit të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. - Mungesa e kornizës ligjore dhe/ose moskriminalizimi i të gjitha formave të DHF-së/DHBGJ-së - Mosndëshkimi i dhunuesve; mungesa e informacionit se format e ndryshme të DHF-së/DHBGJ-së janë të ndëshkueshme. - Kufijtë e pamonitoruar; mungesa e ndërgjegjësimit për rreziqet e trafikimit. - Ndjeshmëria shumë e lartë ndaj qëndrimeve patriarkale; promovimi dhe

	shpërblimi për normat/sjelljet e dhunshme të burrave, të rinjve dhe djemve. - Mungesa e mekanizmave të sigurisë dhe/ose të paralajmërimit të hershëm. - Mungesa e përfshirjes së krimeve seksuale të kryera gjatë një emergjence civile në dëmshpërblimet dhe programet mbështetëse afatgjata të të mbijetuarave/ve (përfshirë fëmijët e lindur nga përdhunimi). - Pabarazitë ekonomike, sociale dhe gjinore. - Mungesa e pjesëmarrjes kuptimplotë dhe aktive të grave dhe të rejave në udhëheqje, ndërtimin e paqes, proceset dhe reformën e sektorit të sigurisë. - Mungesa e prioriteteve për ndjekjen penale të krimeve seksuale; theks i pamjaftueshëm në qasjen në shërbimet e riintegritetit; dhe mungesa e parashikimit apo përjashtimi për fëmijët e lindur si rezultat i përdhunimit, veçanërisht lidhur kjo dhe me paragjykimin e tyre nga shoqëria. - Mosadresimi i faktorëve që kontribuojnë në dhunë të tilla si humbja e aftësive, mjeteve të jetesës, pavarësisë dhe/ose roleve të caktuara.
Faktorët në nivel komunitar	- Projekte jo të mirëplanifikuara të kampeve, strehimeve, ambienteve të tualetit dhe higjienës personale, si dhe infrastrukturës në përgjithësi për rastet e emergjencave civile (përfshirë për personat me aftësi të kufizuara, persona të moshuar dhe grupe të tjera në rrezik). - Mungesa e qasjes në arsim për gratë, të reja dhe vajzat, sidomos në arsimin e mesëm për vajzat adoleshente. - Mungesa e strehëzave të sigurta për gratë, të reja, vajzat dhe grupet e tjera në rrezik. - Mungesa e trajnimit, supervizimit dhe mbikëqyrjes për stafin humanitar. - Mungesa e alternativave ekonomike për popullatat e prekura, veçanërisht për gratë, të reja, vajzat dhe grupe të tjera në rrezik. - Kalimi i përgjegjësisë të mekanizmat mbrojtës të komunitetit dhe mungesa e mbrojtjes reale të komuniteteve/mungesa e sanksioneve që kanë të bëjnë me mosangazhimin në trajtimin e rasteve të DHF-së/DHBGJ-së. - Mungesa e mekanizmave të raportimit për të mbijetuarat/it dhe ato në rrezik të DHF-së/DHBGJ-së, si dhe shfrytëzimi dhe abuzimi seksual i kryer nga personeli humanitar. - Mungesa e shërbimeve të aksesueshme dhe të besueshme shumësektoriale për të mbijetuarat/it (shërbime shëndetësore, psikosociale, shërbime të mbrojtjes dhe sigurisë, shërbime ligjore etj.). - Mungesa/numri i vogël i stafit të përbërë nga gra dhe të reja në pozicionet kryesore (drejtuese) të ofruesve të shërbimeve (në shëndetësi, ambientet e paraburgimit, polici, drejtësi etj.). - Të drejta pronësore dhe mbi vendbanimin apo tokën, të papërshtatshme apo të pazbatueshme (ose të mohuara) për gratë, të reja, vajzat, fëmijët e lindur nga përdhunimi, si dhe për grupe të tjera në rrezik. - “Fajësimi i të mbijetuarës/it” ose qëndrime të tjera të dëmshme ndaj të mbijetuar/ave subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. - Mungesa e konfidencialitetit për të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së. - Pranimi i dhunës në mbarë komunitetin. - Mungesa e mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve.
Faktorët individualë, familjarë	- Mungesa e nevojave bazë të mbijetesës/të furnizimeve për individët dhe familjet ose mungesa e qasjes së sigurt në këto nevoja/furnizime për mbijetesë (ushqim, ujë, strehim, furnizime higjienike etj.). - Shpërndarja e pabarabartë gjinore e burimeve familjare. - Mungesa e burimeve apo aftësive të prindërve për të siguruar fëmijët dhe personat e moshuar (burimet ekonomike, aftësia për t'i mbrojtur etj.), veçanërisht për gratë kryefamiljare dhe fëmijët e tyre. - Mungesa e njohurive/e ndërgjegjësimit mbi standardet e pranueshme të sjelljes nga personeli humanitar. - Përdorimi i alkoolit/i drogës. - Moshë, seksi, arsimi, aftësia e kufizuar. - Historia familjare e dhunës. - Të qenit dëshmitare apo dëshmitar në incidente dhune.

E RËNDËSISHME PËR T'U MBAJTUR NË KONSIDERATË

Gratë dhe emergjencat civile

Në shumë situata, gratë, të rejat dhe vajzat preken në mënyrë joproporcionale nga emergjencat civile. Si përgjegjëse kryesore të detyrimeve që lidhen me punën shtëpiake, bujqësinë dhe prodhimin e ushqimit, gratë dhe të rejat mund të kenë shumë më pak qasje në burimet për trajtim dhe riaftësim. Po kështu, atyre mund t'u kërkohej të marrin përsipër edhe përgjegjësi të reja në familjen e tyre gjatë situatave të emergjencave (p.sh., nëse burrat e shtëpisë duhet të largohen nga familjet e tyre, gratë duhet të përballen me menaxhimin e situatës në familje, duke përfshirë këtu edhe detyrimet dhe përgjegjësitë që mbanin më parë burrat, deri në momentin e rikthimit të tyre). Nëse ligji dhe rendi prishen ose nëse mbështetja sociale dhe sistemet e sigurisë (të tilla si familja e madhe) dështojnë, gratë, të rejat dhe vajzat janë, gjithashtu, në rrezik më të madh ndaj DHBGJ-së dhe diskriminimit.

1. GRUPET MË TË CENUESHME NGA DHUNA SEKSUALE, DHUNA NË FAMILJE DHE DHUNA ME BAZË GJINORE NË SITUATA TË EMERGJENCAVE CIVILE

Në çdo emergjencë ka grupe individësh më të prekshëm nga dëmtimi se anëtarët e tjerë të popullsisë. Kjo ndodh shpesh, sepse këto grupe individësh kanë më pak fuqi në shoqëri, janë më të varur nga të tjerët për mbijetesë, janë më pak të dukshëm për punonjëset dhe punonjësit që ofrojnë ndihmë ose, nëse mund ta përmbledhim ndryshe, janë grupe të cenueshme. Kur burimet e cenueshmërisë, të tilla si: mosha, aftësia e kufizuar, orientimi seksual, feja, përkatësia etnike etj., ndërthuren me diskriminimin gjinor, gjasat e ekspozimit të grave, të rejave dhe vajzave ndaj DHF-së/DHBGJ-së mund të përshkallëzohen. Për shembull, vajzat adoleshente të cilat detyrohen t'i nënshtrohen martesës së hershme – një formë e DHBGJ-së – mund të jenë në rrezik më të madh ndaj dhunës nga partneri intim, krahasuar me të rejat apo gratë e rritura. Në rastin e burrave, të rinjve dhe djemve, normat e pabarazisë gjinore që lidhen me maskulinitetin dhe feminitetin mund të rrisin ekspozimin e tyre ndaj disa formave të dhunës seksuale. Për shembull, burrat, të rinjtë dhe djemtë në paraburgim të cilët konsiderohen nga të burgosurit si, veçanërisht, të dobët (ose “femërorë”) u nënshtrohen ngacmimit seksual, dhunës seksuale dhe përdhunimit. Në disa mjedise konfliktuale, disa grupe të djemve, të rinjve dhe të burrave mund të mos jenë të mbrojtur nga dhuna seksuale, pasi ata supozohet se nuk janë në rrezik, për shkak të privilegjeve që gëzojnë gjatë kohës së paqes.

Jo të gjitha grupet e listuara më poshtë janë gjithmonë në rrezik të lartë për të pësuar dhunë me bazë gjinore apo dhunë në familje. Megjithatë, shpesh këto grupe janë në rrezik të lartë të dëmtimit në mjediset humanitare apo aty ku ofrohet trajtim në kuadër të emergjencave civile. Sa herë që të jetë e mundur, përpjekjet për të trajtuar DHF-në/DHBGJ-në duhet të drejtojnë vëmendjen dhe të promovojnë mbrojtjen e të drejtave dhe të nevojave të këtyre grupeve. Puna me grupe të veçanta në rrezik duhet të organizohet në bashkëpunim me institucionet, agjencitë dhe organizatat që kanë ekspertizë në adresimin e nevojave të tyre.

Grupet e cenueshme	Shembuj të formave të dhunës ndaj të cilave mund të ekspozohen këto grupe	Faktorët që kontribuojnë në rritjen e rrezikut ndaj dhunës
Vajzat adoleshente	- Sulmi seksual - Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual - Martesë në fëmijëri/martesa e detyruar - Mungesa e qasjes në arsim	- Mosha, seksi dhe statusi social i kufizuar - Rritja e përgjegjësisë brenda familjes, që i mbajnë vajzat e izoluar në shtëpi - Shkatërrimi i strukturave normale të mbështetjes dhe mbrojtjes së komunitetit - Mungesa e qasjes në informacione të kuptueshme për shëndetin, të drejtat dhe shërbimet (përfshirë shëndetin riprodhues) - Dekurajimi apo pengesa (moslejimi) për të ndjekur shkollën - Shtatzënitë e hershme dhe amësia - Angazhimi në aktivitete të pasigurta të jetesës - Humbja e menjëhershme e anëtarëve të familjes,

		sidomos e kujdestarëve - Varësia nga marrëdhëniet shfrytëzuese ose jo të shëndetshme, për plotësimin e nevojave bazë
Gratë e moshuara	- Shfrytëzim dhe abuzim nga kujdestaret dhe kujdestarët - Mohimi i të drejtave për strehim dhe për pronën - Sulmi seksual - Shfrytëzim dhe abuzim seksual	- Moshë, seksi dhe statusi social i kufizuar - Gjendje fizike e dobësuar, aftësi të kufizuara fizike ose shqisore dhe sëmundje kronike - Izolimi dhe rreziku më i lartë i varfërisë - Lëvizja e kufizuar - Mosplotësimi i nevojave shëndetësore dhe për ushqim - Mungesa e qasjes në informacione të kuptueshme për të drejtat dhe shërbimet
Gratë kryefamiljare dhe fëmijët e tyre	- Sulmi seksual - Shfrytëzim dhe abuzim seksual - Martesë në fëmijëri dhe/ose martesë e detyruar (përfshirë mungesa e trashëgimisë nga ana e gruas) - Mohimi i të drejtave për strehim dhe pronë	- Moshë, seksi dhe statusi social i kufizuar - Rritja e përgjegjësisë familjare që i mbajnë ato të izoluara në shtëpi - Shkatërrimi i strukturave normale të mbështetjes dhe mbrojtjes së komunitetit - Varësia nga marrëdhëniet shfrytëzuese ose jo të shëndetshme për të siguruar nevojat bazë - Angazhimi në aktivitete të pasigurta të jetesës
Vajzat, të rejat dhe gratë të cilat mbajnë fëmijët e konceptuar nga përdhunimi, si dhe fëmijët e tyre të lindur nga përdhunimi	- Sulmi seksual - Shfrytëzim dhe abuzim seksual - Dhuna nga partneri intim dhe forma të tjera të dhunës në familje - Mungesa e qasjes në arsim - Përfshirje sociale	- Moshë, seksi dhe statusi social - Stigma sociale dhe izolimi - Përfshirje ose përzierje nga shtëpitë, familjet dhe komunitetet e tyre - Varfëria, kequshqyerja dhe problemet e shëndetit riprodhues - Mungesa e qasjes në kujdesin mjekësor - Nivelet e larta të mosndëshkimit për krimet kundër tyre - Varësia nga marrëdhëniet shfrytëzuese ose jo të shëndetshme për të siguruar nevojat bazë - Angazhimi në aktivitete të pasigurta të jetesës
Personat LGBTI (lezbiket, homoseksualët, biseksualët, transgjinatorët dhe personat interseks)	- Përfshirje sociale - Sulmi seksual - Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual - Dhuna në familje (p.sh., dhuna ndaj fëmijëve LGBTI nga ana e prindërve të tyre) - Mohimi i shërbimeve - Ngacim/dhunë seksuale - Përdhunimi (për t'i ndëshkuar për orientimin seksual të tyre)	- Diskriminimi i bazuar në orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor - Nivelet e larta të mosndëshkimit për krimet kundër tyre - Statusi i kufizuar social - Personave transgjinatorë nuk u njihet ligjrisht apo publikisht identifikimi i gjinisë së tyre - Përfshirje nga strehimi dhe qasja në shërbimet shëndetësore apo shërbime të tjera - Përfshirje të personave transgjinatorë nga strehëzat e ndara, sipas seksit, tualetet dhe ambientet shëndetësore - Izolimi/refuzimi social nga familja ose komuniteti - Angazhimi në aktivitete të pasigurta të jetesës
Vajzat, djemtë dhe jetimët apo jetimet e pashoqëruar/a	- Sulmi seksual - Shfrytëzim dhe abuzim seksual - Martesë në fëmijëri dhe/ose martesë e detyruar - Punë e detyruar - Mungesa e qasjes në arsim	- Moshë, seksi dhe statusi social i kufizuar - Mosplotësimi i nevojave shëndetësore dhe për ushqim - Angazhimi në aktivitete të pasigurta të jetesës - Varësia nga marrëdhëniet shfrytëzuese ose jo të shëndetshme për nevojat themelore - Shtatzënitë e hershme dhe amësia - Stigma sociale, izolimi dhe refuzimi nga komunitetet - Përgjegjësi e parakohshme “prindërore” për motrat e vëllezërit
Gratë, të rejat, burrat dhe të rinjtë e përfshirë në prostitucion të detyruar dhe	- Shtrëngimi, përfshirje sociale - Sulmi seksual - Dhuna fizike - Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual - Mungesa e qasjes në arsim	- Varësia nga marrëdhëniet shfrytëzuese ose jo të shëndetshme për plotësimin e nevojave bazë - Mungesa e qasjes në informacione dhe shërbime të shëndetit riprodhues - Shtatzënitë e hershme dhe amësia

fëmijët viktima të shfrytëzimit seksual		- Izolimi dhe mungesa e mbështetjes sociale/grupeve të bashkëmoshatarëve/eve - Paragjykimet, izolimi dhe refuzimi nga komunitetet - Ngacmimi dhe abuzimi nga zbatueset dhe zbatuesit e ligjit - Mungesa e mbrojtjes sipas ligjit dhe/ose ligjeve që kriminalizojnë punonjëset dhe punonjësit e seksit
Gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë e ndaluar (në arrest)	- Sulmi seksual si dënim ose torturë - Dhuna fizike - Mungesa e qasjes në arsim - Mungesa e qasjes në shërbimet shëndetësore dhe të mbështetjes psikosociale, duke përfshirë ndihmën e parë psikologjike	- Higjiena e dobët dhe mungesa e kanalizimeve - Mbipopullimi i ambienteve të paraburgimit - Pengesat për raportimin e incidenteve të dhunës (sidomos dhunës seksuale) - Frika për të folur kundër autoriteteve - Traumata e mundshme nga dhuna dhe abuzimet e pësura para ndalimit
Gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë që jetojnë me HIV	- Ngacmimi dhe abuzimi seksual - Diskriminimi dhe përjashtimi social - Abuzim verbal - Mungesa e qasjes në arsim - Humbja e mjeteve të jetesës - Pengesa për të kontaktuar me fëmijët e tyre	- Paragjykimi, fajësimi, izolimi dhe rreziku më i lartë i varfërisë - Humbja e tokës, pasurisë dhe sendeve personale - Reduktim i kapacitetit të punës - Stresi, depresioni dhe/ose vetëvrasja - Shkatërrimi i familjes - Shëndeti i dobët fizik dhe emocional - Përdorimi i dëmshëm i alkoolit dhe/ose i drogës
Gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë me aftësi të kufizuara	- Diskriminimi dhe përjashtimi social - Sulmi seksual - Shfrytëzimi dhe abuzimi seksual - Dhuna nga partneri intim dhe forma të tjera të dhunës në familje - Mungesa e qasjes në arsim - Mohimi i qasjes në strehim dhe pronësi	- Lëvizshmëri, dëgjim dhe vizion i kufizuar, që rezultojnë në mbështetje më të madhe të ndihmës dhe kujdesit nga të tjerët - Izolimi dhe mungesa e mbështetjes sociale/rrjeteve apo grupeve të bashkëmoshatarëve/eve - Përfshirja nga marrja e informacionit dhe marrja e udhëzimeve, për shkak të barrierave fizike, teknologjike dhe të komunikimit - Përjashtimi nga qasja në ambientet e sigurimit të higjienës personale, për shkak të mungesës së infrastrukturës - Barrierat fizike, të komunikimit dhe të qëndrimeve në raportimin e dhunës - Barriera për të marrë pjesë në komunitetet e tyre dhe për të fituar mjetet e jetesës - Mungesa e qasjes në shërbimet e kujdesit mjekësor dhe të rehabilitimit - Nivelet e larta të mosndëshkimit për krimet kundër tyre - Mungesa e qasjes në informacione dhe shërbime të shëndetit seksual e riprodhues
Gratë, të rejat, vajzat, burrat, të rinjtë dhe djemtë viktima të dhunës	- Diskriminimi dhe përjashtimi social - Dhuna dytësore si rezultat i dhunës parësore (abuzim nga ata kundër të cilëve raportojnë; vrasjet për nder pas sulmeve seksuale; martesat e detyruara me një dhunues etj.) - Cenueshmëria e rritur ndaj përsëritjes së dhunës, duke përfshirë dhunën seksuale, dhunën nga partneri intim, shfrytëzimin dhe abuzimin seksual etj.	- Gjendja fizike e dobët, aftësitë e kufizuara fizike ose ndijore, shqetësime psikologjike dhe sëmundje kronike - Mungesa e qasjes në shërbimet shëndetësore, duke përfshirë pengesat dhe mospërfilljen për raportimin e incidenteve të dhunës - Shkatërrimi i familjes - Izolimi dhe rreziku më i lartë i varfërisë

2. CILËT JANË FAKTORËT KRYESORË TË EKSPOZIMIT NDAJ DHUNËS SEKSUALE, DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE NË SITUATA TË EMERGJENCIVE CIVILE?

Faktorët e rrezikut në kontekstin e personave:

- mungesa e mundësive për të përmbushur nevojat themelore (ushqim, ujë, higjienë, sende personale, gjumë etj.);
- mungesa dhe/ose humbja e dokumenteve ligjore (në lidhje me identitetin, prindërimin, pronën, etj.);
- mungesa e fondeve;
- numri i vogël apo edhe mungesa e pranisë së burrave (që do të siguronte mbrojtjen, të drejtat e trashëgimisë, pranimin shoqëror nga komuniteti);
- mungesa e detyrimeve ndaj familjes/komunitetit.

Faktorët e rrezikut në lidhje me mjedisin e jashtëm:

- Mungesa e qasjes në informacion;
- Transport i pasigurt duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - transport me automjete publike të mbipopulluara, si: trena dhe autobusë, pa mbikëqyrje;
 - transport me automjete private pa mbikëqyrje (taksi);
 - transporti i paligjshëm (trafikimi);
 - kalimi i segmenteve të caktuara në këmbë, pa mbikëqyrje;
- Shpërdorimi i autoritetit (privimi i paligjshëm i lirisë, paaftësia e ndihmës juridike etj.);
- Siguri e pamjaftueshme në qendrat tranzitore apo qendrat e improvizuara të shërbimeve shëndetësore, duke përfshirë por pa u kufizuar në:
 - vende të mbipopulluara;
 - vende të errëta dhe të izoluara;
 - mungesa e shërbimeve/objekteve për burra, gra, të reja e të rinj, fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara (tualetet, hapësira gjumi, vendet për shpërndarjen e ushqimit);
 - mungesa e mbikëqyrjes së të gjitha ambienteve;
 - sjellje të papërshtatshme nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, përfshirë ngacmimet dhe abuzimin seksual.

V. PËRSE ADRESIMI I DHUNËS NË FAMILJE DHE I DHUNËS ME BAZË GJINORE PËRBËN SHQETËSIM THEMELOR PËR SHËRBIMET SHËNDETËSORE?

Shërbimet shëndetësore shpesh janë të parat – dhe ndonjëherë, pika e vetme e kontaktit për të mbijetuarat/it subjekt i dhunës me bazë gjinore, të cilat/të cilët kërkojnë ndihmë. Për të lehtësuar kujdesin, të mbijetuarat/it duhet të kenë qasje të sigurt në ambientet shëndetësore (transport të sigurt në/nga ambientet; ndriçim të duhur në ambiente; pikat hyrëse/pritëse/të kontaktit të parë në shërbimet shëndetësore, të cilat duhet të jenë joparagjyquese dhe konfidenciale; shërbime pa kosto; etj.). Është, gjithashtu, e rëndësishme që punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore që punojnë në situata emergjencash, të jenë të kompletuar/a me njohuri për të ofruar shërbime shëndetësore jodiskriminuese dhe cilësore për të mbijetuarat/it. Shumë të mbijetuar/a nuk e tregojnë incidentin e dhunës te një punonjëse apo punonjësi të shërbimeve shëndetësore (ose ndonjë punonjëseje apo punonjësi tjetër shërbimesh), për shkak të frikës ndaj pasojave, paragjykimeve nga shoqëria, refuzimit nga partnerët/familjet, si dhe për arsye të tjera. Nëse punonjësit dhe punonjëset e shërbimeve shëndetësore nuk janë të trajnuar/a mirë, ata/ato mund të mos jenë në gjendje të zbulojnë treguesit për një dhunë të mundshme te një person. Të mbijetuarat/it mund të dekurajohen pa dashje nga të kërkuarit e ndihmës për problemet shëndetësore të lidhura me DHF-në/DHBGJ-në. Kjo mund të ndodhë nëse punonjësja ose punonjësi i shërbimeve shëndetësore nuk parashtron pyetjet e duhura; nëse materialet informuese në ambientet e shërbimeve shëndetësore nuk bëjnë të qarta llojet e shërbimeve që janë në dispozicion, si dhe nëse këto shërbime nuk janë të disponueshme e të aksesueshme nga të gjithë; ose nëse punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore bën vërejtje apo reagon në ndonjë

mënyrë tjetër, që lë të nënkuptojë se identifikimi/zbulimi i rasteve të DHF-së/DHBGJ-së nuk do të shoqërohet me respekt, profesionalizëm dhe konfidencialitet.

Emergjencat e shtojnë stresin në shërbimet shëndetësore që janë shpesh të mbingarkuara. Por, paravësisht kësaj, të neglizhosh ndikimet që sjell DHF-ja/DHBGJ-ja në shëndetin fizik dhe mendor nuk është vetëm një mundësi e humbur: kjo është një shkelje e etikës mjekësore. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore mund të dështojnë në ofrimin e shërbimeve të domosdoshme, madje edhe për shpëtimin e jetës, shërbim ky i lidhur me profilaksitë postekspozuese (PPE) për HIV; kontraceptivin e urgjencës; trajtimin për infeksione seksualisht të transmetueshme (IST); shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale, si dhe me rekomandimet e duhura ligjore dhe shërbime të tjera që mund të mbështesin të mbijetuarat dhe parandalimin e riviktimizimit të tyre. Për më tepër, kur punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore nuk janë të trajnuar/a mbi udhëzimet thelbësore për të punuar me të mbijetuarat/it (si në raste të tilla kur ato/ata nuk respektojnë konfidencialitetin e të mbijetuarës/it ose nuk kuptojnë se si të adresohen nevojat e veçanta të fëmijëve), të mbijetuarat/it mund të jenë në rrezik të lartë të përjetimit të dhunës shtesë nga partnerët, anëtarët e familjes dhe/ose anëtarët e komunitetit.

Që në fazat më të hershme të një emergjence, shërbimet shëndetësore duhet të jenë të gatshme për të ofruar shërbime me cilësi të mirë, për të ofruar kujdes klinik për sulme seksuale ndaj të mbijetuarës/it, sipas Standardeve Minimale të Paketës së Shërbimit Fillestar (MISP). Përveç kësaj – dhe sa më shpejt të jetë e mundur në emergjencë – punonjësit dhe punonjëset e shërbimeve shëndetësore duhet të jenë të pajisur/a për të ofruar kujdes klinik për forma të tjera të DHF-së/DHBGJ-së (lëndimet dhe komplikime të shtatzënisë si pasojë e dhunës nga partneri intim, efektet shëndetësore të sulmit seksual dhe shtatzënieve të hershme lidhur me martesat e fëmijëve etj.). Është thelbësore që të informohen komunitetet rreth përfitimeve dhe vendndodhjeve se ku duhet kërkuar shërbim shëndetësor, menjëherë sapo të jenë ngritur këto shërbime.

Shërbimet e duhura shëndetësore janë jetësore jo vetëm sepse kujdesen për jetën e grave, të rejave, vajzave dhe grupeve të tjera në rrezik, por edhe sepse janë shërbime kyçe për çdo aktor që kërkon të kapërcejë shkatërrimin nga emergjencat civile. Kur shërbimet shëndetësore janë të sigurta, konfidenciale, të hartuara në mënyrë efektive, të ndjeshme, të arritshme (në aspektin e vendndodhjes dhe qasje fizike) dhe me cilësi të mirë, ato mund të:

- lehtësojnë kujdesin e menjëhershëm për të mbijetuarat/it,
- fillojnë një proces shërimi, që jo vetëm që shkakton përfitime fizike dhe mendore për të mbijetuarat/it, por që sjell përfitime të gjera për familjet, komunitetet dhe shoqëritë.

Veprimet e ndërmarra nga sektori i shëndetësisë për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur DHF-së/DHBGJ-së duhet të bëhen në koordinim me specialiste dhe specialistë të këtyre formave të dhunës dhe aktorë që punojnë në sektorë të tjerë humanitarë. Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, gjithashtu, duhet të koordinohen me partnerët që adresojnë çështjet e përkatësisë gjinore, shëndetit mendor, mbështetjes psikosociale, HIV, moshës dhe mjedisit (aty ku ekzistojnë).

Në vijim paraqitet një informacion i përgjithshëm mbi organizatat kryesore me të cilat mund të bashkëpunojnë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore në situata të emergjencave civile, në Shqipëri.

Emri i organizatës/ofrueses së shërbimit	Lloji i shërbimeve që ofron
Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave Tiranë (nën varësi të MSHMS-së)	Strehim të menjëhershëm, akomodim dhe trajtim të rasteve, kryesisht të familjeve rome dhe egjiptiane (por jo vetëm) të prekura nga situatat e emergjencave civile.
Shërbimi Social Shtetëror Tiranë	Akses të gjitha zyrat rajonale dhe vendore të këtij shërbimi, që siguron informacion, mbrojtje dhe ndërhyrje të menjëhershme për trajtimin e rasteve të DHF-së/DHBGJ-së, kryesisht përmes referimit në qendra të tjera më të specializuara shërbimesh, sidomos kur flitet për raste të fëmijëve.
Komisioneri/ja për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tiranë	Praktika për mbrojtjen nga diskriminimi, mbështetje konkrete, adresim i rasteve në instanca më të larta, ofrim informacioni dhe kujdesi ligjor falas etj. Lobim dhe avokim për ndryshim/përmirësim politikash antidiskriminuese, sidomos për rastet e ndeshura të DHF-së/DHBGJ-së.
Avokati/ja e Popullit, Tiranë	Informacion dhe ndihmë konkrete, kryesisht të natyrës ligjore, për rastet e ndeshura, mbështetje institucionale, adresim të rasteve për zgjidhje të mëtejshme etj. Lobim dhe avokim për zgjidhje afatgjata, monitorim të shërbimeve të ofruara nga pikëpamja ligjore dhe përputhja me kërkesat e standardet në fuqi etj.
Qendra Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje, Tiranë	Strehim të menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje, trajtim psikoemocional të tyre, referim në institucione të tjera për shërbime të specializuara, koordinim për ofrim të shërbimeve ligjore, aktivitete rehabilituese dhe riintegruese.
Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Tiranë	Strehim të menjëhershëm të viktimave të trafikimit, trajtim psikoemocional të tyre, referim në institucione të tjera për shërbime të specializuara, koordinim për ofrim të shërbimeve ligjore, aktivitete rehabilituese dhe riintegruese.
Qendra “Lilium”	Qendër kombëtare për trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale.
Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Tiranë	Shërbim ligjor falas për rastet e DHF-së/DHBGJ-së (jo vetëm në Tiranë), plotësim i dokumentacionit ligjor të domosdoshëm për ndjekjen e rastit në rrugë ligjore, shoqërim i viktimave dhe mbrojtje e rastit të tyre në gjykatë, lobim dhe avokim për gjykim të drejtë dhe për dëshmipërbllim të viktimës, referim të rastit në shërbime të tjera të specializuara etj.
Qendra “Të ndryshëm dhe të barabartë”, Tiranë	Trajtim me përparësi dhe mbulim i nevojave emergjente për strehim, akomodim dhe trajtim emergjent të rasteve të trafikimit të grave, të rejave dhe vajzave, mbulim i nevojave të strehimit dhe të rikuperimit afatgjatë për viktimat e formave të tjera të DHBGJ-së, referim i menjëhershëm në shërbimin mjekësor, mbështetje psikoemocionale dhe trajtim i stresit posttraumatik dhe i formave të tjera të traumës, aktivitete riintegruese dhe fuqizuese nga pikëpamja ekonomike dhe nxitja e pavarësisë së viktimave etj.
Strehëza për Gratë dhe Vajzat, Tiranë (trajton raste jo vetëm nga Tirana)	Strehim i menjëhershëm i rasteve të DHF-së/DHBGJ-së në rrezik për jetën; trajtim me mbështetje emocionale dhe seanca/terapi për përmirësimin e situatës psikologjike të të mbijetuarës; ndërmjetësim për punësim dhe për formim profesional; referim të rasteve për ndihmë të specializuar ligjore apo edhe për shërbime të tjera të domosdoshme etj.
Rrjeti i qendrave komunitare “Sot për të ardhmen”, Tiranë, Durrës, Pukë, Mat	Mbështetje ligjore dhe psikologjike për viktimat e DHF-së/DHBGJ-së, linjë telefonike të ndihmës falas për menaxhimin e rasteve të raportuara, referim në institucione/organizata të tjera për ndihmë më të specializuar, informacion mbi të drejtat dhe mbështetje psikoemocionale etj. Në Durrës (zona e Kënetës), qendra komunitare ofron një sërë programesh rehabilitimi e riintegrimi, si dhe akses në

	shërbime bazë të domosdoshme.
Qendra “Të drejtat e njeriut në demokraci” në Tiranë e Tropojë	Mbështetje ligjore dhe psikosociale për rastet e DHF-së/DHBGJ-së, përfaqësim ligjor falas në gjykatë etj.
Linja Kombëtare e Këshillimit ALO 116 117, Tiranë	Shërbim kombëtar falas për referimin e rasteve të DHF-së/DHBGJ-së, ngritur sipas kërkesave dhe standardeve të linjave telefonike të ndihmës, siç citohen në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).
Qendra “Gruaja te gruaja”, Shkodër	Këshillim psikosocial dhe mbështetje emocionale për viktimat e DHF-së/DHBGJ-së, përfaqësim ligjor dhe informacion mbi të drejtat, menaxhim i rasteve. Së fundmi ka hapur edhe programin e këshillimit të dhunuesve (Qendra e Këshillimit për Djemtë dhe Burrat), si dhe një strehëz emergjente për trajtimin e rasteve emergjente për një periudhë 3–5 ditore, deri në dhënien e UMM-së/UM-së.
Forumi i Gruas Elbasan	Shërbime psikosociale dhe mbështetje emocionale për rastet, informacion dhe shërbim ligjor, përfaqësim në gjykatë, strehim për rastet emergjente të DHF-së/DHBGJ-së deri në marrjen e një UMM-së/UM-së, referim dhe menaxhim të rastit etj.
Shoqata “Unë, gruaja”, Pogradec	Mbështetje psikoemocionale, informacion dhe shërbim ligjor, ndjekje e rasteve dhe ofrimi i ndihmës edhe përmes referimit në institucione/organizata të tjera të specializuara, menaxhim i rastit, ndërgjegjësim dhe informim i komunitetit në përgjithësi dhe i viktimave të DHF-së/DHBGJ-së etj.
Qendra “Vatra”, Vlorë	Shërbime të menjëhershme dhe afatgjata për viktimat/të mbijetuarat e trafikimit, strehim i menjëhershëm, trajtim i traumës, referim në organizata/institucione të tjera për shërbime të specializuara, menaxhim i rastit, ndërmjetësim dhe bashkëpunim me drejtësinë dhe policinë, ndërgjegjësim, aktivitete riintegruese etj.
Qendra e Këshillimit për Djemtë dhe Burrat, Tiranë	Program për trajtimin dhe këshillimin e djemve dhe të burrave që kanë tendenca të ushtrojnë sjellje të dhunshme, si dhe programe specifike që duhet të ndiqen nga dhunuesit, në bazë të vendimeve që lëshon gjykata, me qëllim menaxhimin e sjelljes së tyre dhe zbutjen e zemërimit dhe faktorëve të tjerë që i çojnë drejt ushtrimit të dhunës.
“Tjetër vizion”, Elbasan	Strehim emergjent për rastet e viktimave të trafikimit, shërbime psikosociale dhe ligjore, informacion dhe ndërgjegjësim, referim i rastit në shërbime më të specializuara, monitorim dhe menaxhim i rasteve në vazhdimësi.
Shërbime Sociale për Gruan (<i>Bethany</i>) Tiranë	Familje mbështetëse për vajzat nëna në situata emergjente, këshillim psikoemocional, ofrim i mbështetjes emocionale si dhe shërbime të kujdesit shëndetësor për gratë dhe fëmijët, mbështetje për vajzat nëna etj.
Qendra “Aulona”, Vlorë	Këshillim dhe informacion për IST-në, kujdesin para dhe gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gj, të drejtat dhe detyrimet lidhur me shëndetin seksual riprodhues, kujdes mjekësor për rastet e paraqitura, lobim dhe informim për të drejtat në fushën e shëndetit riprodhues, menaxhim i rasteve dhe adresim në shërbime të mëtejshme të specializuara etj.
CARITAS, Tiranë	Strehim për gratë dhe fëmijët, mbulim i nevojave bazë emergjente etj.
<i>Terre des Hommes</i> , Tiranë	Mbështetje emocionale dhe shërbim ligjor për fëmijët, informacion dhe ndërgjegjësim për të drejtat e tyre.
Shoqata “Gruaja, paqja, siguria” (ish-Shoqata e Grave me Probleme Sociale), Durrës	Mbështetje për zbatimin e agjendës “Gruaja, paqja, siguria” etj.
Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), me degë në Tiranë, Durrës, Fier, Lushnjë, Elbasan e Berat	Mbështetje për raste të ndryshme që përbëjnë vepra civile apo penale, përfshirë rastet e DHF-së/DHBGJ-së (shërbime të përgjithshme përfshirë dhe shërbime specifike për gratë).

Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD), Tiranë	Shërbime të kujdesit shëndetësor, kryesisht në drejtim të informimit dhe të ndërgjegjësimit për të drejtat në fushën e shëndetit riprodhues, lobim për trajtim efektiv të rasteve të DHF-së/DHBGJ-së etj.
Nisma për ndryshim ARSIS, Tiranë	Strehim emergjent për rastet e fëmijëve dhe nënave të tyre në rrezik, për një periudhë deri në 72 orë, referim dhe trajtim për shërbime më të specializuara etj.
Aleanca kundër diskriminimit të LGBTI-së, Tiranë	Shërbime informuese dhe trajtim të rasteve të shkeljes së të drejtave të komunitetit LGBTI, menaxhimi i strehëzës për LGBTI-në, ndërgjegjësim dhe avokim për të drejtat e këtij komuniteti etj.
Shoqata për kulturë dhe edukim për jetën (SHKEJ)	Trajtim të rasteve të fëmijëve në situatë rruge, referim i tyre në shërbime të tjera të domosdoshme.

VI. ZBATUESHMËRIA

Në vijim, paraqiten disa nga veprimet që duhet të ndërmerren për parandalimin dhe për reagimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së, në situata të emergjencave civile, duke filluar nga hartimi i politikave, programimi i shërbimeve shëndetësore, si dhe informimi mbi këto shërbime. Këto veprime duhet të përshtaten në bazë të kontekstit të emergjencës civile dhe gjithmonë duhet të marrin parasysh të drejtat themelore, nevojat e shprehura dhe burimet e identifikuara në komunitetin e synuar.

1. INTEGRIMI I PARANDALIMIT DHE REAGIMIT NDAJ DHF-së/DHBGJ-së, NË PROGRAMIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE

1.1 Përfshirja e grave, të rejave, vajzave adoleshente dhe grupeve të tjera në rrezik në hartimin dhe shpërndarjen e programimit të shërbimeve shëndetësore (me kujdesin e duhur në situata kur kjo paraqet një rrezik të mundshëm ose rrit rrezikun e DHF-së/DHBGJ-së):

- Punësoni gra dhe të reja në stafin klinik dhe joklinik dhe siguroni baraspeshë gjinore në të gjitha aspektet e programimit dhe të parashikimit të shërbimeve shëndetësore për të mbijetuarat/it. Gratë dhe të reja të punësuar në shërbimet shëndetësore duhet të marrin trajnime formale dhe në vendin e punës, për të qenë të përgatitura për këto situata.

- Siguroni pjesëmarrjen aktive dhe udhëheqjen e grave dhe të rejave në komitetet dhe grupet vendore shëndetësore. Jini të vetëdijshëm për tensionet që mund të shkaktohen nga përpjekja për të ndryshuar rolin e grave dhe të të rejave në komunitet dhe, sipas nevojës, angazhohuni në dialog me burrat dhe të rinjtë për të siguruar mbështetjen e tyre.

- Kushtojini vëmendje trajtimit në mënyrën e duhur të faktorëve që rritin rrezikun e cenueshmërisë nga DHF-ja/DHBGJ-ja.

1.2 Rritja e aksesueshmërisë së ambienteve shëndetësore për ofrimin e shërbimeve të integruara të lidhura me DHBGJ-në:

- Krijoni sigurinë maksimale brenda dhe rreth ambienteve shëndetësore. Kjo mund të përfshijë, ndër të tjera, instalim të ndriçimit të përshtatshëm; punësim të grave e të rejave police për sigurinë në ambiente; sigurim të tualeteve të përshtatshme të mbyllura dhe të ndara sipas seksit, si dhe të mjeteve të higjienës intime; lidhjen me punonjëset dhe punonjësit shëndetësorë të komunitetit për t'u siguruar të mbijetuar/ave shoqërim të sigurt dhe konfidencial brenda ambienteve apo gjatë transferimit në ambiente të tjera shëndetësore.

- Sigurohuni që objektet janë të aksesueshme nga të gjithë personat e moshuar dhe personat me aftësi të kufizuara.

- Siguroni praninë e punonjëseve dhe punonjësve të shëndetësisë që flasin në të njëjtën gjuhë me të mbijetuarat/it, kur është e mundur. Siguroni përkthyes dhe përkthyes, si dhe interpretuese dhe interpretues të gjuhës së shenjave të trajnuar/a mbi parimet bazë për kujdesin ndaj të mbijetuarave. Sidomos në rastet e dhunës seksuale, mos harroni të respektoni të drejtën e të mbijetuarës/it për t'u trajtuar dhe intervistuar nga punonjës/e e/i së njëjtës gjini.

- Siguroni integrimin e shërbimeve për të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së dhe shërbimeve të shëndetit riprodhues në mjediset ekzistuese (spitale, qendra shëndetësore) dhe/apo

në qendra të pavarura. Merrni në konsideratë paragjykimet dhe frikën që mund të dekurajojë të mbijetuarat/it nga hyrja në objekte ku mund të identifikohen lehtësisht.

- Merrni masa dhe vendosni klinika të lëvizshme në zona të largëta.

1.3. Zbatimi i strategjive që rrisin në maksimum cilësinë e shërbimeve në dispozicion për të mbijetuarat/it në objektet shëndetësore:

- Sigurohuni që punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore të kenë njohuri dhe t'u përmbahen udhëzimeve të standardizuara për kujdesin klinik të të mbijetuar/ave të sulmeve seksuale. Kujdes duhet treguar për të:

- marrë miratimin e pëlqimit të informuar para kryerjes së një ekzaminimi fizik;
- kryer ekzaminime fizike dhe siguruar trajtim (duke përfshirë PPE për ekspozimin ndaj HIV-it, kontraceptivin e urgjencës, parandalimin e IST-së dhe trajtimin sindromik, kujdesin për plagët dhe komplikimet kërcënuese për jetën, si dhe këshillimin për shtatzëninë);
- siguruar ndihmën e parë psikologjike dhe të kujdesit të shëndetit mendor e psikosocial, me në qendër të mbijetuarën/in (të përshtatur me kontekstin vendor dhe të monitoruar për përfitimet dhe efektet negative);
- dokumentuar lëndimet dhe mbledhur provat minimale për mjekësinë ligjore bazuar në kërkesat ligjore (vetëm nëse i/e mbijetuar/a e lejon dhe jep pëlqimin pasi është informuar për këtë hap);

- mundësuar referime të sigurt dhe konfidenciale në shërbimet e tjera, sipas nevojës (për shembull, ku tregohet kujdes më afatgjatë ose i specializuar);

- regjistruar me kujdes me shkrim të gjitha veprimet dhe referimet (mjekësore, të shëndetit mendor dhe mbështetjes psikosociale), për të lehtësuar ndjekjen në vazhdimësi të rastit. Sigurohuni që dokumentacioni të jetë në dispozicion për ndjekje penale nëse e/i mbijetuar/a vendos të denoncojë dhe nëse fillojnë procedurat e ndjekjes penale.

- Merrni në konsideratë masat e veçanta për të plotësuar nevojat e grupeve të ndryshme në rrezik (fëmijët, LGBTI-të, personat me aftësi të kufizuara etj.).

- Krijoni dhoma të veçanta për konsultim dhe ekzaminim, ku mund të ruhet privatësia dhe siguria e të mbijetuar/ave që kërkojnë kujdes.

- Kompletoni qendrat shëndetësore me pajisjet mjekësore dhe medikamentet e urgjencës për të siguruar ndihmën dhe kujdesin ndaj të mbijetuar/ave të DHF-së/DHBGJ-së:

- furnizoni me sasi të domosdoshme të barnave të urgjencës, atyre mjekuese, si dhe të pajisjeve mjekësore për kujdesin klinik të: sulmit seksual, lëndimeve dhe ndërlikimeve të shtatzënisë, si pasojë e dhunës nga partneri intim, pasojave në shëndetin riprodhues që lidhen me martesën e fëmijëve dhe shtatzënitë e hershme, si dhe problemeve shëndetësore të lidhura me forma të tjera të DHF-së/DHBGJ-së;

- pajisini ambientet e konsultimit për fëmijët me lodra për ta;

- siguroni mbledhjen e të dhënave të standardizuara brenda ambienteve shëndetësore dhe mbani të sigurt dokumentacionin, duke përfshirë kodimin e dosjeve për të ruajtur konfidencialitetin dhe shënimet mjekësore;

- siguroni ndjekjen në vazhdimësi të kujdesit që ofrohet për të mbijetuarat/it. Kjo mund të përfshijë trajtimin e plotë të PPE-së kundër HIV-it; testimin vullnetar dhe këshillimin në intervale të caktuara; si dhe mbështetjen psikosociale apo të shëndetit mendor, afatgjatë dhe sipas nevojës.

1.4. Rritja e kapacitetit të punonjësve dhe të punonjësve të shërbimeve shëndetësore për të ofruar shërbim cilësor për të mbijetuarat/it, përmes trajnimit, mbështetjes dhe mbikëqyrjes:

- Trajtoni të gjithë personelin e institucioneve shëndetësore (përfshirë administratën, rojet e sigurisë, recepsionistet dhe recepsionistët etj.) dhe punonjëset e punonjësit e shërbimeve shëndetësore në komunitet, në çështjet gjinore, DHF/DHBGJ, të drejtat e grave/të njeriut, përjashtimin social, seksualitetin dhe ndihmën e parë psikologjike, për të siguruar një mjedis pranues për të mbijetuarat/it. Përdorni mbikëqyrjen për të adresuar qëndrimet diskriminuese mes stafit që mund të pengojnë kujdesin etik për të mbijetuarat/it. Sigurohuni që i gjithë stafi i

institucioneve shëndetësore e kupton dhe ka nënshkruar një kod të sjelljes për parandalimin e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual.

- Trajnoni, veçanërisht, punonjëset dhe punonjësit që kujdesen drejtpërsëdrejti për të mbijetuarat/it (punonjëset dhe punonjësit e kujdesit klinik, shëndetit mendor dhe mbështetjes psikosociale).

- Idealisht, duhet të trajnohet një grup i gjerë punonjësesh dhe punonjësish të shërbimeve shëndetësore për të ofruar shërbime të specializuara për të mbijetuarat/it e DHF-së/DHBGJ-së, për të përballuar qarkullimin e madh të stafit dhe parandaluar frikën e të mbijetuarës/it që ka qasje në shërbime nga një punonjëse apo punonjës i vetëm.

- Trajnoni dhe siguroni supervizimin e vazhdueshëm të punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore të specializuara (mjeket, mjekët dhe infermieret, infermierët që kryejnë ekzaminimet e të mbijetuar/ave; psikiatrit, psikiatret, psikologet, psikologët dhe punonjëset sociale e punonjësit socialë) mbi protokollet e veçanta të kujdesit të dhembshur dhe konfidencial.

- Ku është e mundur, përfshini një eksperte apo ekspert të çështjeve të DHF-së/DHBGJ-së në ekipet dhe ambientet shëndetësore për të ofruar kujdes dhe mbështetje për të mbijetuarat/it.

- Merrni në konsideratë trajnimin e punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore në identifikimin e dhunës seksuale dhe formave të tjera të DHF-së/DHBGJ-së.

- Zbatoni trajnimin e ndërsjellë ndërmjet punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore, si dhe punonjësve e punonjësve të tjerë, brenda përgjigjes shumësektoriale, duke përfshirë policinë dhe shërbimet ligjore, për të rritur koordinimin dhe bashkëpunimin.

- Ofrojuni mundësi punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore për të diskutuar ndikimin emocional të të punuarit me të mbijetuarat/it, duke adresuar çështjet e “konsumimit profesional”.

2. INTEGRIMI I PARANDALIMIT DHE I REAGIMIT NDAJ DHF-së/DHBGJ-së NË POLITIKAT SHËNDETËSORE

2.1 Zhvillimi dhe/ose standardizimi i protokolleve dhe i politikave për programet shëndetësore të lidhura me DHF-në/DHBGJ-në, që sigurojnë shërbime konfidenciale dhe cilësore për të mbijetuarat/it dhe mënyra të referimit për mbështetje shumësektoriale:

- Hartoni protokolle për kujdesin klinik të të mbijetuar/ve të sulmeve seksuale, që plotësojnë standardet ndërkombëtare dhe sigurohuni që këto protokolle të shpërndahen dhe të zbatohen gjerësisht.

- Konsultohuni me specialistet dhe specialistët e çështjeve të DHF-së/DHBGJ-së për të zhvilluar sisteme të standardizuara të kujdesit (mënyrat e referimit) dhe procedura që, në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale, lidhin të mbijetuarat/it me shërbime shtesë (mbështetje ligjore, psikosociale, shërbimet e drejtësisë etj.). Këto sisteme dhe procedura duhet të jetë të përshtatshme për zbatim në nivel vendor dhe të miratuara nga autoritetet përkatëse në fushën e shëndetësisë.

- Pajisini të gjithë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore të cilat/të cilët angazhohen me popullatat e prekura, me informacione të shkruara se ku duhet të referohen të mbijetuarat/it për shërbime. Përditësoni rregullisht informacionin rreth institucioneve të referimit.

2.2. Avokimi për reforma dhe ligje kombëtare, si dhe politika vendore që mundësojnë qasjen në shërbime shëndetësore cilësore dhe shërbime të tjera, të të mbijetuar/ave subjekt ose në rrezik nga DHF-ja/DHBGJ-ja, si dhe që caktojnë fonde për qëndrueshmërinë:

- Avokoni për të drejtat e të mbijetuar/ave subjekt i DHF-së/DHBGJ-së për të marrë shërbime shëndetësore të sigurta dhe etike. Mbështesni autoritetet kombëtare dhe vendore, OJF-të dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe palët e interesuara në zhvillimin dhe në zbatimin e planeve kombëtare të veprimit (strategjitë shëndetësore) që integrojnë veprimet kundër DHF-së/DHBGJ-së.

- Punoni me Fakultetet e Mjekësisë, Fakultetet e Shkencave Mjekësore Teknike, si dhe me aktorë të tjerë kryesorë për të siguruar që shërbimet shëndetësore për format e ndryshme të DHF-së/DHBGJ-së të integrohen në kurrikulat e këtyre fakulteteve dhe në programet e edukimit të vazhdueshëm.

3. INTEGRIMI I PARANDALIMIT DHE REAGIMIT NDAJ DHF-së/DHBGJ-së NË KOMUNIKIMIN DHE NË NDARJEN E INFORMACIONIT SHËNDETËSOR

3.1 Sigurimi që ndarja e informacionit dhe raportimeve të rasteve të DHF-së/DHBGJ-së brenda sektorit të shëndetësisë ose me partnerët në komunitetin më të madh humanitar, bëhet në mënyrë të sigurt dhe sipas standardeve etike:

- Zhvilloni standarde të ndarjes së informacionit ndërmjet dhe brenda institucioneve, në atë mënyrë që nuk zbulohet identiteti ose që nuk paraqet rrezik sigurie për të mbijetuarat/it, familjet e tyre ose komunitetin më të gjerë.

3.2 Përfshirja e mesazheve kundër DHF-së/DHBGJ-së në takimet me komunitetin dhe aktivitetet ndërgjegjëse:

- Punoni me specialiste dhe specialistë të çështjeve të DHF-së/DHBGJ-së për të hartuar dhe integruar informacionet në lidhje me DHBGJ në nismat e shtrirjes së informimit për shërbimet shëndetësore dhe çështjet të shëndetit në përgjithësi, në komunitet (seminare, diskutime, takime në komunitet)

- Sigurohuni që kjo rritje e ndërgjegjësimit të përfshijë informacion rreth rreziqeve dhe faktorëve të DHF-së/DHBGJ-së, fajësimit, refuzimit, izolimit të të mbijetuar/ave, disponueshmërisë së shërbimeve për gra dhe burra, rëndësisë së shërbimeve të shpejta dhe të aksesueshme në raste të sulmit seksual, shërbimeve shumësektoriale; mesazheve parandaluese, si dhe të drejtave të të mbijetuar/ave, duke përfshirë konfidencialitetin në shërbim.

- Përdorni formate dhe mjete informuese të përshtatura në gjuhë të shumta (*Braille*, gjuha e shenjave, mesazhe të thjeshtuara si piktura dhe fotografi etj.), për të siguruar qasje të gjithë banoreve dhe banorëve të komunitetit.

- Angazhoni gra, të reja, vajza, burra, të rinj dhe djem (veçmas kur është e nevojshme) në hartimin e mesazheve, me qëllim që të jenë të përshtatshme sipas moshës, seksit dhe kulturës.

- Trajtoni punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore në çështjet e barazisë gjinore, DHF/DHBGJ, të drejtave të grave, të drejtave të njeriut, përjashtimit social, seksualitetit dhe ndihmës së parë psikologjike (si të angazhohen në ndihmë të të mbijetuarës/it dhe të japin informacion në një mënyrë etike, të sigurt dhe konfidenciale rreth të drejtave të tyre, mundësive për të raportuar rrezikun dhe aksesin në shërbimet e kujdesit).

- Ofrojeni burrave, të rinjve dhe djemve adoleshentë informacione rreth rreziqeve shëndetësore të dhunës seksuale (për vetë ata por edhe për gratë, të reja dhe vajzat), si dhe për rëndësinë e qasjes në kujdes të të mbijetuar/ave.

- Siguroni për anëtarët dhe anëtarët e komunitetit informacion rreth kodeve ekzistuese të sjelljes për personelin shëndetësor, si dhe ku të raportojnë shfrytëzimin seksual dhe abuzimin e kryer nga personeli shëndetësor.

VII. KOORDINIMI ME SEKTORË TË TJERË HUMANITARË

Si hap i parë në koordinim, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të kërkojnë dhe marrin informacion se ku ekzistojnë Mekanizmat e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje, si dhe shërbime të tjera për rastet e DHF-së/DHBGJ-së në vend. Mund të krijohet një listë e specialisteve dhe specialistëve për çështje të DHF-së/DHBGJ-së, për të ndihmuar punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për të:

- hartuar dhe kryer vlerësime shëndetësore që shqyrtojnë rreziqet e DHF/DHBGJ në lidhje me shëndetin, si dhe për të planifikuar veprime të përbashkëta me punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, rreth mënyrave se si mund të zbuten këto rreziqe;

- siguruar trajnime për personelin shëndetësor (përfshirë personelin mjekësor dhe jo mjekësor) në çështjet e DHF/DHBGJ, të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut, si dhe për të siguruar shërbime cilësore dhe konfidenciale për të mbijetuarat/it;

- zhvilluar një mënyrë referimi standarde për të mbijetuarat subjekt i DHF-së/DHBGJ-së që mund ta tregojnë rastin te punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, si dhe për të siguruar trajnim për referime të sigurt, etike dhe konfidenciale;
- identifikuar udhëzimet dhe protokollet ekzistuese shëndetësore kombëtare për kujdesin klinik të rasteve të DHF-së/DHBGJ-së, si dhe për të avokuar, sipas nevojës, për të siguruar që këto protokolle të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- kryer trajnime dhe rritje të ndërgjegjësimit për komunitetin mbi çështjet e DHF-së/DHBGJ-së dhe mënyrës se si ato lidhen me shëndetin.

Spektori i shëndetësisë duhet të koordinohet edhe me këta sektore të tjerë, për trajtimin me sukses të situatave të emergjencave civile:

Spektori e koordinimit dhe menaxhimit

Vlerësohet disponueshmëria e shërbimeve shëndetësore dhe referimet për popullatat e prekura; Planifikohet vendndodhja dhe sigurohet akses i në objekte shëndetësore bazuar në ruajtjen e sigurisë dhe adresimin e nevojave të të mbijetuar/ave subjekt dhe atyre në rrezik të DHF-së/DHBGJ-së. Nëse është e përshtatshme, zbatohet një plan për klinikat e lëvizshme që vizitojnë qendrat e evakuimit.

Spektori e mbrojtjes së fëmijëve

Sigurimi i trajnimit për punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore për mbrojtjen e fëmijëve, DHF/DHBGJ, shëndetin mendor dhe mbështetjen psikosociale. Sigurimi i shërbimeve miqësore në objektet shëndetësore, për fëmijët subjekt i DHF-së/DHBGJ-së.

Sigurimi i ushqimit

Sigurimi i ndihmës ushqimore, sipas nevojës, për të mbijetuarat/it subjekt i DHF/DHBGJ. Avokimi për kohë fleksibël të shpërndarjes së ushqimeve për të mbijetuarat/it subjekte të DHF/DHBGJ të hospitalizuara

Arsimi


Integrimi i informacionit mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, planifikimin familjar, parandalimin e infektimit me HIV dhe DHF-së/DHBGJ-së në kurrikulën arsimore dhe komunikimin masiv, si fushatat në shkollë. Sensibilizimi i mësuesve dhe mësuesve, nxënësve dhe nxënësve, prindërve dhe komunitetit në çështje të shëndetit dhe DHF-së/DHBGJ-së.

Shtëpia, toka dhe pasuria

Lidhja me aktorët që mundësojnë pronësinë mbi shtëpinë, tokën dhe pasurinë për të zvogëluar ndikimet e padëshiruara dhe negative të përdorimit të tokës apo objekteve publike si qendra të përkohshme të kujdesit shëndetësor

Mjetet e jetesës

Puna me hartuesit e politikave për të siguruar para dhe punë për të mbijetuarat/it dhe ato/ata që janë në rrezik të DHF-së/DHBGJ-së, si dhe për mbështetjen e punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore (sigurimi i pagës së barabartë për gratë dhe burrat në të njëjtat pozicione pune)



VIII. RRETHANA DHE SJELLJE QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHF-së/DHBGJ-së

Në vijim janë paraqitur lista të shkurtra të rrethanave klinike ose psikologjike dhe sjelljeve që mund të tërheqin vëmendjen e punonjësve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore, si shenja të ekzistencës së DHF-së/DHBGJ-së. Nëse shumë prej tyre janë të pranishme mund të gjykohet që e/i mbijetuar/a është subjekt i DHF-së/DHBGJ-së.

RRETHANAT QË MUND TË TREGOJNË PËR USHTRIMIN E DHF-së/DHBGJ-së

- Plagë të shumta, në faza të ndryshme të shërimit, në zona të shumta të trupit që nuk mund të jenë rezultatit i rrëzimit;
- Plagë të pashpjegueshme ose me shpjegime të paqarta/konfuze;
- Plagë simetrike;
- Mavijosje, shenja plagësh të shkaktuara nga armë, gërvishtje, kafshime, djegie në faza të ndryshme të shërimit, sidomos në krahë dhe në fytyrë;
- Plagë të fshehura nën rroba;
- Plagë që nuk janë në përputhje me shpjegimin e shkakut;
- Simptoma gastrointestinale kronike të pashpjegueshme;
- Simptoma riprodhuese të pashpjegueshme, duke përfshirë dhimbjen e legenit, mosfunksionimin seksual;
- Pasoja negative të riprodhimit, duke përfshirë shtatzënitë e shumta të padëshiruara dhe ose ndërprerjet e shtatzënive, kujdesin e vonuar për shtatzëninë, pasoja negative të lindjes (te vajzat dhe gratë);
- Simptoma të pashpjegueshme gjenito-urinare, duke përfshirë infeksione të shpeshta në fshikëzën e urinës ose të veshkave, apo infeksione të tjera;
- Hemorragji vaginale e përsëritur dhe infeksione seksualisht të transmetueshme (te vajzat dhe gratë);
- Dhimbje kronike (e pashpjegueshme);
- Probleme me sistemin nervor qendror – dhimbje koke, probleme konjitive (njohëse), humbje e dëgjimit;
- Konsulta të përsëritura shëndetësore pa ndonjë diagnozë të qartë;
- Partner ose bashkëshort që ndërhyjnë gjatë konsultave;
- Mosparaqitje e shpeshtë në takimet e lëna me mjekun apo mjekun;
- Mosmarrja rregullisht e mjekimit;
- Dalja e parakohshme nga spitali;
- Simptoma depresioni, ankthi, çrregullime të stresit posttraumatik (PTSD), çrregullime të gjumit;
- Përdorim alkooli apo substancash të tjera.

SJELLJE SHOQËRUESE TË DHF-së/DHBGJ-së

- Takime të shpeshta me personelin shëndetësor për simptoma të paqarta;
- Përpjekja për të fshehur plagët ose të minimizuar shkallën e tyre;
- Ngurrimi për të folur para partnerit ose të afërmit që e shoqëron, apo sjellje e nënshtruar ose e frikësuar para partnerit ose të rriturve shoqërues;
- Mosmarrja rregullisht e mjekimit;
- Mosparaqitje e shpeshtë në takimet e lëna me mjeken apo mjekun;
- Personi duket i frikësuar, tepër i shqetësuar ose i dëshpëruar;
- Tentativë për vetëvrasje ose dëmtime të vetes;
- Partneri është agresiv ose dominues, flet në emër të gruas ose refuzon të largohet nga dhoma;
- Vizita tepër të rralla apo edhe mos-shkuarje në klinikë para lindjes (për gratë);
- Dalje e parakohshme nga spitali.

IX. SI TË BASHKËVEPRONI ME TË MBIJETUARËN/IN QË ËSHTË SUBJEKT I DHF-së/DHBGJ-së

Të pyesësh për DHF-në/DHBGJ-në mund të jetë e vështirë për çdo ofruese dhe ofrues shërbimi. Rekomandimet e mëposhtme i ndihmojnë punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore që të rrisin besimin e tyre kur shtrojnë pyetje për DHF-në/DHBGJ-në, si dhe që të shmangin riviktimizimin.

- Merrni nismën që të pyesni rreth dhunës – mos prisni që t’ua tregojë vetë gruaja/personi. Kjo tregon që ju merrni përgjegjësi profesionale ndaj situatës së saj/tij dhe ndihmon në krijimin e besimit.

- Shmangni pyetjen e një gruaje/personi rreth DHF-së/DHBGJ-së në praninë e një anëtari apo anëtareje të familjes, miqve apo fëmijëve.

- Tregohuni të durueshëm me të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së dhe kujtoni se gjatë krizave ato/ata mund të shfaqin ndjenja kontradiktore. Mos ushtroni presion mbi të mbijetuarën/in që të flasë. Nëse ajo/ai nuk flet, tregojini se çfarë ju bëri të dyshonit se mbi të është ushtruar dhunë.

- Shmangni ndërprerjet e panevojshme dhe bëni pyetje për sqarime vetëm pasi ajo/ai të ketë përfunduar rrëfimin e saj.

- Shmangni dëgjimin pasiv dhe moskomentimin. Kjo mund ta bëjë atë të mendojë se ju nuk e besoni dhe se ajo/ai e ka gabim, ndërsa dhunuesi ka të drejtë. Dëgjoni me kujdes përjetimet e saj/tij dhe sigurojeni që gjithçka ajo/ai ndjen është e justifikueshme.

- Përdorni të njëjtën gjuhë si e/i mbijetuar/a subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Nëse ajo/ai flet një gjuhë tjetër ndryshe nga juaja, kërkon ndihmën e një përkthyesje apo përkthyesi (kjo vlen edhe për gjuhën Rome) dhe në rastin e të mbijetuarës/it me aftësi të kufizuara në të folur, kërkon ndihmën e një specialisteje apo specialisti të gjuhës së shenjave.

- Përshtatni gjuhën ose fjalët sipas nivelit të të kuptuarit që ka e/i mbijetuar/a subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Mos përdorni fjalor tepër profesional dhe shprehje që mund ta ngatërrojnë atë.

- Pyetjet dhe fjalitë formulojini në mënyrë të tillë që të përçojnë mesazhe mbështetëse dhe jo paragjyquese, duke folur me ton dashamirës. Përdorni pyetje të hapura dhe shmangni pyetjet që fillojnë me “përse”, që tentojnë ta hedhin fajin mbi të mbijetuarën/in subjekt i DHF-së/DHBGJ-së.

- Mos e fajësoni gruan për atë çfarë i ka ndodhur. Shmangni pyetje të tilla si “Pse qëndroni me të?”, “A patët ndonjë debat me njëri-tjetrin para se të ushtronte dhunë?”, “Çfarë po bënit jashtë e/i pashoqëruar?”, “Çfarë kishit veshur?” etj. Në vend të tyre, theksoni që DHF-ja/DHBGJ-ja nuk mund të tolerohet.

- Përdorni me masë pohime mbështetëse, të tilla si “Më vjen keq për çka ju ka ndodhur!” ose “Me të vërtetë paskeni hequr shumë!”, të cilat mund ta inkurajojnë gruan/personin të ndajë me ju më shumë informacion.

- Theksoni se dhuna nuk ndodhi për fajin e të mbijetuarës/it dhe vetëm dhunuesi/ja është përgjegjës për ushtrimin e saj.

- Shpjegojuani se ju e ruani konfidencialitetin, por theksoni gjithashtu edhe që ka kufizim të mundshëm të tij, sidomos në rastin kur dhuna përbën vepër penale, ka ndodhur rishtazi, apo kur ka shumë gjasa të ripërsëritet në situatën në të cilën ndodhet e/i mbijetuar/a. Mos harroni ta sqaroni gjithashtu që njoftimi i policisë bëhet që të mbrohet jeta e saj dhe që t'i jepet mundësia të marrë të gjithë trajtimin e specializuar për të cilin ka nevojë. Po për të njëjtën gjë vlen edhe njoftimi i koordinatori/es vendor/e kundër Dhunës në Familje, në Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor.

- Shikojeni në sy aq sa është normale për kulturën shqiptare dhe përqendrojeni të gjithë vëmendjen tek e/i mbijetuar/a subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Shmangni plotësimin e dokumenteve në të njëjtën kohë që flisni me të.

- Jini të vetëdijshëm për gjuhën e trupit tuaj. Mënyra se ju qëndroni dhe mbani krahët dhe kokën, shprehja juaj e fytyrës dhe toni i zërit, të gjitha këto përcjellin një mesazh të qartë te personi për mënyrën se si ju e perceptoni situatën e tij. Mbani një qëndrim joparagjykses dhe mbështetës. Shmangni gjuhën e trupit që mund të përcjellë mesazhe acarimi, mosbesimi, mospëlqimi apo zemërimi ndaj të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së.

- Mos e paragjykoni sjelljen e të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së mbi bazën e kulturës, besimit fetar, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, apo mbi bazën e çdo karakteristike tjetër individuale.

X. PROCEDURAT

Nëse ka ndonjë provë apo dyshim që një e/i mbijetuar po përjeton një formë të DHF-së/DHBGJ-së, punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për t'i siguruar personit të gjithë mbështetjen që i duhet, paralelisht me plotësimin e detyrimit ligjor për njoftimin e policisë, kur kjo formë dhune përbën vepër penale, si dhe njoftimin e koordinatori/es vendor/e kundër DHF-së në nivel vendor, për rastet e DHF-së. Në të gjitha fazat e ndihmës, pavarësia e të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së dhe ruajtja e konfidencialitetit, renditen pas sigurisë (mbrojtjes) së saj/tij.

Identifikimi

Hapi i parë në çdo ndërhyrje për DHF-në/DHBGJ-në është identifikimi i të mbijetuarës/it subjekt i kësaj dhune. Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme: identifikimi nga punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore, raportimi nga një tjetër ofrues shërbimesh apo nga një person tjetër dhe vetëdeklarimi nga e/i mbijetuar/a subjekt i dhunës. Në rast të identifikimit në mjediset shëndetësore, përdoren dy qasje për të mundësuar pohimin e DHF-së/DHBGJ-së: ekzaminimi i përgjithshëm dhe gjetja e rastit.

Ekzaminimi i përgjithshëm kërkon që të pyeten të gjithë individët që vijnë në institucionet shëndetësore për ekspozimin e tyre ndaj DHF-së/DHBGJ-së. Ekzaminimi i përgjithshëm mund të jetë ngarkesë e madhe në ambientet e shërbimeve shëndetësore, veçanërisht, kur mundësitë e referimit të rasteve janë të kufizuara, si dhe kur ka kapacitete apo burime dhe ofrues shërbimesh të tjera të pamjaftueshme, për një përgjigje efektive për trajtimin e rasteve.

Gjetja e rastit i referohet pyetjes së individëve për DHF-në/DHBGJ-në, në rast se paraqesin disa simptoma klinike për t'u ekzaminuar. Qasja e dytë e bazuar në konsiderata klinike selektive dhe të kujdesshme është vërtetuar si më efektive, veçanërisht, kur punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore janë trajnuar posaçërisht për mënyrën se si të veprojnë më mirë në situata të tilla dhe si t'i referojnë rastet.

Prioritet mbetet adresimi i nevojave shëndetësore që mund të kërcënojnë jetën ose integritetin të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së në çfarëdo situatë. Referojini menjëherë për shtrim në spital ato/ata të mbijetuar/a që janë në gjendje të rëndë dhe me rrezikshmëri për jetën.

Veprimet e mëposhtme shërbejnë për të lehtësuar zbulimin e DHF-së/DHBGJ-së dhe për të garantuar identifikimin pa rrezik dhe efektiv të të mbijetuar/ave ndaj të cilave/cilëve është ushtruar dhunë.

- Përshëndeteni dhe mirëpriteni të mbijetuarën/in me ngrohtësi.
- Prezantohuni dhe shpjegojini asaj/atij shkurtimisht kompetencat/shërbimet e institucionit.
- Kërkojini me mirësjellje të mbijetuarës/it të prezantohet (nëse nuk ka një gjendje shëndetësore që e kufizon këtë).
- Pyeteni të mbijetuarën/in nëse preferon të ekzaminohet nga një mjek/e së njëjtës gjini (kjo është veçanërisht e domosdoshme në rastet e dhunës seksuale).
- Jepini të mbijetuarës/it mundësinë të bëjë pyetje rreth gjithçkaje që mund ta konsiderojë të rëndësishme.
- Kini parasysh nevojat e grupeve të ndryshme të popullsisë (p.sh. personat me aftësi të kufizuara fizike ose mendore, besimtarët dhe pakicat etnike) dhe bëni përpjekje t'i adresoni ato.
- Krijoni një mjedis konfidencial dhe mikpritës, dëgjojeni në mënyrë aktive të mbijetuarën/in dhe jepini mesazhe mbështetëse.
- Kushtojuni vëmendje kushteve të ambientit ku jeni kur bëni pyetje për DHF-në/DHBGJ-në (nëse, p.sh., ambienti është i ndarë me perde, sidomos në rastet e shërbimit shëndetësor spitalor, një person i tretë mund ta dëgjojë bisedën).
- Para çdo ekzaminimi shëndetësor, informojeni dhe shpjegojani të mbijetuarës/it se çfarë përfshin ai, pse bëhet dhe në ç'mënyrë, për të shmangur transformimin e ekzaminimit në një tjetër përjetim traumatik.
- Merrni me kujdes vendimin nëse është e përshtatshme të pyesni për ekspozimin ndaj DHF-së/DHBGJ-së. Mos harroni se personi shoqëruar mund të jetë vetë dhunuesi/ja dhe pyetjet për ushtrim të DHF-së/DHBGJ-së mund t'i venë të mbijetuarat/it subjekt i kësaj dhune, në një situatë të rrezikshme.
- Nëse dyshoni për ushtrim të DHF-së/DHBGJ-së, kontrolloni historinë mjekësore të të mbijetuarës/it (nëse është e mundur) ose pyeteni nëse gjendje të caktuara shëndetësore përsëriten herë pas here.
- Mos i lini të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së vetëm, veçanërisht kur ka dyshime ose rrezik që ato/ata mund të lëndojnë veten.

Vlerësimi

Pas identifikimit të një të mbijetuar/e që është subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore duhet të marrë një vendim për hapat që do të ndjekë (ofrimi i shërbimit të menjëhershëm, mbështetja, grumbullimi i provave të para, dokumentimi i rastit duke përshkruar të gjitha të dhënat që lidhen me DHF-në/DHBGJ-në, njoftimi i policisë nëse është një incident që përbën vepër penale, si dhe referimi tek institucionet/shërbimet e tjera për një trajtim më të specializuar). Këta hapa ndiqen në varësi të burimeve, aftësive dhe kompetencave për të trajtuar efektivisht një rast të DHF-së/DHBGJ-së. Duhet të bëhet vlerësimi i nevojave të të mbijetuar/ave subjekte të DHF-së/DHBGJ-së si dhe i burimeve në dispozicion, pasi ky vlerësim është bazë për zhvillimin e hapave të mëtejshëm të shërbimit mjekësor dhe ndjekjes në vazhdim në mënyrë të koordinuar e përmes qasjes shumësektoriale.

- Merrni miratimin e të mbijetuarës/it për shërbimet që do t'i ofrohen. Në rast se është fëmijë apo person me aftësi të kufizuara, merrni miratimin e prindërve ose kujdestarëve ligjorë. Përfshijini këtu përbëjnë rastet kur njoftimi i policisë është detyrim ligjor (pra për rastet që përbëjnë vepra penale). Edhe në këto situata e/i mbijetuar/a, prindërit ose kujdestarët ligjorë vihen në dijeni për hapat që po ndërmerren.

- Informojini të mbijetuarat/it rreth ndërlikimeve të mundshme si pasojë e ndarjes së informacionit mbi rastin e tyre me institucione/shërbime të tjera.

- Jepini të mbijetuarës/it informacion mbi DHF-së/DHBGJ-së dhe pasojat e saj mbi shëndetin.

- Sigurojeni të mbijetuarën/in për faktin që me të po punohet pa paragjykim, por me dhembshuri dhe mirëkuptim, si dhe që do të bëhen të gjitha përpjekjet për ta ndihmuar atë.

- Kërkojini të mbijetuarës/it të tregojë me fjalët e saj/tij se çfarë ka ndodhur, të flasë për dhunuesin/en, llojet e dhunës dhe shpeshtësinë e incidenteve etj. Nëse rasti është përcjellë te ju

për shërbime shëndetësore nga një institucion tjetër, kërkojini institucionit referues informacionin që ka mbledhur, me qëllim që të mos ripyetet e/i mbijetuar/a për informacionin që mund të jetë i disponueshëm.

- Vlerësoni nevojat dhe burimet për të kuptuar kushtet shoqërore, familjare dhe individuale që ndikojnë në situatën e të mbijetuarës/it.

- Kini në vëmendje përkujdesjen dhe mbështetjen që duhet t'u ofrohet të mbijetuar/ave subjekte të dhunës, në përshtatje me nevojat e tyre.

Ofrimi i shërbimeve/ndërhyrja

Pas identifikimit dhe vlerësimit të rastit të DHF-së/DHBGJ-së, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të bëjnë ekzaminimin mjekësor dhe të ofrojnë shërbimin shëndetësor përkatës. Gjatë gjithë procesit të ekzaminimit dhe shërbimit shëndetësor, punonjëset dhe punonjësit përkatës duhet të kenë gjithnjë parasysh që të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së mund të jenë shumë të tronditur/a emocionalisht.

Mbështetja e linjës së parë

- Mos i paragjykoni të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, mbështetini dhe vlerësojeni atë që thonë.

- Ofroni kujdes dhe mbështetje që u përgjigjet shqetësimeve të të mbijetuar/ave subjekte të DHF-së/DHBGJ-së.

- Pyetini për historinë e dhunës, duke i dëgjuar me kujdes, por jo duke ushtruar presion ndaj tyre që të flasin. (Duhet pasur kujdes kur diskutoni tema të ndjeshme/delikate kur janë të pranishëm edhe përkthyeset apo përkthyesit)

- Ndihmojini të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së të sigurojnë informacion për burimet, duke përfshirë shërbimet ligjore si dhe shërbimet e tjera të cilat të mbijetuarat/it mund t'i konsiderojnë të dobishme.

- Ndihmojini të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së të rritin sigurinë për veten si dhe për fëmijët kur është e nevojshme.

- Bëjeni konsultën privatisht.

- Respektoni konfidencialitetin, duke i informuar të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së për kufijtë e konfidencialitetit (kur është i detyrueshëm raportimi).

Historia mjekësore dhe ekzaminimi

- Kërkojuni të mbijetuar/ave subjekte të DHF-së/DHBGJ-së të tregojnë me fjalët e tyre se çfarë ka ndodhur.

- Duhet të merret një përshkrim i hollësishëm i dhunës, kohëzgjatja e saj, nëse janë përdorur armë, si dhe data dhe koha e incidentit/incidenteve.

- Kini parasysh që disa të mbijetuar/a subjekte të DHF-së/DHBGJ-së mund të shmangin qëllimisht veçanërisht detajet e sikletshme të incidentit.

- Kontrolloni për ndonjë simptomë tjetër që mund të jetë shenjë e një forme të DHF-së/DHBGJ-së (dehidratim, kequshqyerje etj.).

- Pas përfundimit të tregimit të historisë nga të mbijetuarat/it, profesionistët dhe profesionistët, si dhe punonjëset e punonjësit e shërbimeve shëndetësore duhet të kryejnë një ekzaminim fizik të plotë (nga koka te këmbët) për dhunën seksuale, duke përfshirë edhe organet gjenitale duke pasur parasysh parimet e mëposhtme:

- Shpjegojuni se çfarë përfshin ekzaminimi mjekësor, pse bëhet dhe si bëhet për të shmangur kthimin e këtij ekzaminimi në një përjetim tjetër traumatik.

- Jepuni mundësi të mbijetuar/ave të bëjnë pyetje.

- Pyetini të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së nëse dëshirojnë një mjek/e (sidomos në rastet e dhunës seksuale).

- Mos i lini të mbijetuarat/it vetëm (kur janë duke prituri për ekzaminimin).

- Kërkojuni të zhveshin rrobat e tyre dhe të veshin një rrobëdëshanë e spitalit në mënyrë që të shihen plagët e fshehura

- Gjatë ekzaminimit të pjesëve të trupit për shenjat fizike të DHF-së/DHBGJ-së, së pari vëreni pjesët e zbuluara dhe më pas, kërkojuni me dashamirësi të mbijetuar/ave të zbulojnë pjesët e tjera të trupit për t'i ekzaminuar. Mos u kërkonit të zbulojnë të gjitha pjesët e trupit në të njëjtën kohë: të qenit të zhveshur/a plotësisht mund të jetë poshtëruese për të mbijetuarat/it.

- Ekzaminoni veçanërisht zonat e mbuluara me rroba dhe flokë.

- Nëse ato/ata kanë përjetuar dhunë seksuale, ekzaminojuni të gjithë trupin jo vetëm organet gjenitale apo zonën e barkut.

- Ekzaminoni si plagët e rënda ashtu edhe ato të lehta.

- Vëreni edhe simptomat emocionale dhe psikologjike.

- Gjatë gjithë ekzaminimit fizik, informojini të mbijetuarat/it se çfarë planifikoni të bëni më pas dhe kërkojuni leje. Gjithmonë bëjuani të ditur se kur dhe ku do të preken në trup. Tregojuni dhe shpjegojuni instrumentet dhe materialet përkatëse.

- Të mbijetuarat/it mund të refuzojnë të gjithë ose një pjesë të ekzaminimit fizik. Lejimi i tyre të kenë një farë kontrolli mbi ekzaminimin që u bëhet është i rëndësishëm për shërimin e tyre.

Kujdesi klinik për plagë dhe probleme mjekësore urgjente

- Trajtojini plagët (lëndimet) më pak të rënda (prerje, mavijosje dhe plagë sipërfaqësore). Çdo plagë duhet të pastrohet dhe trajtohet sipas nevojës.

- Mund të përdoren medikamentet e mëposhtme:

- antibiotikë për të parandaluar infektimin e plagëve;

- vaksina e tetanozit ose vaksina të tjera (sipas protokolleve vendore);

- medikamente për lehtësimin e dhimbjes, ankthit ose pagjumësisë.

- Në raste të dhunës seksuale, punonjësja apo punonjësi i shërbimeve shëndetësore duhet të ofrojë shërbimin ose ta referojë të mbijetuarën/in te specialistë të tjerë të fushës për:

- Ekzaminim lidhur me shtatzëni të mundshme (në rastin e vajzave dhe grave);

- Parandalimin e shtatzënisë të padëshiruar duke ofruar ose dhënë me recetë kontrceptivin e emergjencës brenda 5 ditëve pas marrëdhënies seksuale me dhunë. Kontrceptivi i urgjencës duhet të jepet sa më shpejt që të jetë e mundur pas aktit të dhunshëm, për të maksimizuar efektivitetin. Rekomandohet një dozë e vetme prej 1.5 mg levonorgestrel, pasi është po aq i efektshëm sa dy doza prej 0.75 mg dhënë 12-24 orë veç e veç. Nëse nuk disponohet levonorgestrel, mund të ofrohet regjimi i kombinuar i estrogjen - progesteronit, i shoqëruar me antiemetikët nëse janë të disponueshëm. Nëse kontrceptivi oral nuk është i disponueshëm dhe nëse është e realizueshme, rekomandohet t'u vendoset në uterus një pajiste DIU prej bakri brenda 5 ditësh pas marrëdhënies seksuale me dhunë atyre të mbijetuarave subjekte të DHBGJ-së të cilave u lejohet nga ana mjekësore. Nëse marrëdhënia seksuale me dhunë ka ndodhur para më shumë se 5 ditëve, apo nëse dështon kontracepsioni i urgjencës, të mbijetuarave subjekte të DHBGJ-së duhet t'u ofrohet abort i sigurt, në përputhje me legjislacionin shqiptar (në rastin e vajzave dhe grave).

- Zvogëlimin e rrezikut të infektimit me HIV duke administruar profilaksinë pas-ekspozimit të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së që paraqiten brenda 72 orëve pas aktit seksual me dhunë.

- Trajtimin profilaktik për infeksionet seksualisht të transmetueshme (klamidia, gonorrhea, trichomonas, sifilizi). Për zgjedhjen e barnave dhe regjimeve duhet të ndiqni udhëzimet kombëtare.

- Vaksinimi për hepatitin B nëse antitruapat anti HPV rezultojnë negative, duhet ofruar sipas udhëzuesve kombëtarë. Statusi i hepatitit B duhet të vlerësohet përmes një mostre gjaku, para dhënies së dozës së parë të vaksinës. Nëse antitruapat rezultojnë pozitivë, nuk duhet të bëhet vaksinimi.

- Siguroni ose mobilizoni mbështetjen sociale, nëse është e nevojshme, ose me kërkesën e të mbijetuar/ave subjekte të DHF-së/DHBGJ-së.

- Ndhijmohini të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së të rrisin sigurinë për veten e tyre si dhe për fëmijët, kur është e nevojshme.

- Planifikoni dhe ofroni shërbimin shëndetësor në vazhdim, nëse duhet dhe sipas kërkesës.

Vlerësimi dhe menaxhimi i shëndetit mendor dhe psikologjik

Në rastet e ushtrimit të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile, ndërhyrjet psikologjike të rekomanduara kryhen në varësi të momentit të ndërhyrjes:

- Menjëherë pas incidentit të DHF-së/DHBGJ-së, duhet të ofrohet mbështetje psikologjike për t'iu përgjigjur nevojave psikologjike të menjëhershme të të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Ndiqja e parë psikologjike përfshin elementet e mëposhtme: ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes praktike pa ndërhyrje, vlerësimin e nevojave dhe shqetësimeve, ofrimin e ndihmës për të zgjidhur nevojat bazë (ushqimin, ujin, informacionin), dëgjimin e të mbijetuar/ave por jo duke u bërë presion që të flasin, qetësimin dhe mbështetjen e tyre për t'u ndierë mirë, ndihmën për të marrë informacionin e duhur, shërbimet dhe mbështetjen sociale, mbrojtjen nga dëmtime të mëtejshme, si dhe ofrimin e një informacioni të shkruar mbi strategjitë e përballimit të stresit të rëndë.

- Deri në 3 muaj pas traumave: vazhdoni të ofroni kujdes dhe mbështetje praktike pas vlerësimit të nevojave dhe pritshmërive. Aplikoni “pritjen vigjilente” për 1-3 muaj pas ngjarjes, nëse personi nuk është në gjendje depresive, apo nuk ka probleme me përdorimin e alkoolit ose drogës, simptoma psikotike, apo nuk shfaq tentativa vetëvrasëse ose vetë-dëmtuese, ose nëse nuk ka vështirësi në kryerjen e veprimeve nga dita në ditë. Nëse e/i mbijetuar/a paraqet simptoma pas përdhunimit ose ndonjë problem tjetër të shëndetit mendor, referojeni atë te punonjëset apo punonjësit e shërbimeve shëndetësore të specializuara për shërbimet e ndërhyrjes mendore/psikologjike.

- Pas 3 muajve të traumës: vlerësoni shëndetin mendor dhe për problemet që janë të pa stabilizuara, referojeni të mbijetuarën/in te një specialiste apo specialist përkatës (neurologe, neurolog, psikiatër apo psikiatre).

Mbledhja e provave

Provat për DHF-në/DHBGJ-në duhet të grumbullohen vetëm nga punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore, të cilat/cilët duhet të jenë të trajnuar posaçërisht për teknikat e mbledhjes së provave, në zbatim të legjislacionit dhe rregulloreve që përcaktojnë kompetencat e kryerjes së procedurave. Do të ishte mirë që, të dy llojet e provave si ato mjekësore dhe ato mjeko-ligjore, të mbledhen gjatë një procesi ekzaminimi. Provat mjekësore mbledhen nga personeli mjekësor i qendrave shëndetësore ose i spitaleve, kurse ato mjeko-ligjore nga personeli i mjekësisë ligjore.

- Shpjegojani të mbijetuarës/it se për çfarë qëllimi mund të jenë të rëndësishme/të dobishme provat e mbledhura.

- Pyeteni të mbijetuarën/in nëse dëshiron që të mbledhen provat e ushtrimit të dhunës (nga ana mjekoligjore).

- Nëse kushtet për mbledhjen e provave nuk plotësohen dhe e/i mbijetuar/a shpreh dëshirën që të mbledhen provat, referojeni atë në institucionin më të afërt që mund ta ofrojë këtë shërbim. Jepini të mbijetuarës/it informacion të saktë mbi shërbimin që duhet ta ndihmojë në këtë çështje.

- Shpjegojani të mbijetuarës/it rëndësinë e mbledhjes së provave sa më shpejt të jetë e mundur në veçanti për disa situata të ushtrimit të DHF-së/DHBGJ-së (dhunës seksuale).

- Shpjegojani se çfarë duhet bërë dhe çfarë duhet të shmangët për të ruajtur/për të mos shkatërruar provat (të mos i lajë/të mos i ndërrojë rrobat).

- Risigurojeni të mbijetuarën/in në lidhje me konfidencialitetin e informacionit/provave, duke i shpjeguar edhe rastet e mos ruajtjes së këtij konfidencialiteti kur flitet për detyrimin ligjor për ta raportuar rastin në polici).

- Zvogëloni rrezikun e traumës dhe humbjes së kohës përmes integritetit të procedurave të mjekësisë me ato të mjekësisë ligjore, nëse është e mundur – p.sh., duke e referuar rastin te Qendra “Lilium”, si e vetmja qendër shtetërore e specializuar aktualisht për ekzaminimin dhe trajtimin e rasteve të sulmeve seksuale.

Dokumentimi i DHF-së/DHBGJ-së

Mblidhni dhe regjistroni informacionin për të mbijetuarën/in subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, duke përfshirë: të dhënat demografike (emri, mbiemri, mosha, gjinia, adresa, numri i telefonit, data e paraqitjes), marrjen e miratimit, historinë (historia mjekësore e përgjithshme dhe ajo gjinekologjike), përshkrimin e incidentit, rezultatet e ekzaminimit fizik, analizat dhe rezultatet e tyre, planin e trajtimit, medikamentet e dhëna ose të përshkruara për t'u dhënë me recetë, arsimimin e viktimës, informacionin e dhënë dhe referimin.

- Mblidhni dhe regjistroni detajet e plota të DHF-së/DHBGJ-së duke përfshirë:
- prova që mbështesin kryerjen e shkeljes ligjore të pretenduar;
- historikun e ndonjë incidenti tjetër, duke përfshirë ato me partnerë të mëparshëm;
- marrëdhënien e viktimës me dhunuesin;
- llojin e dhunës së ushtruar;
- dëshmitarët e pranishëm gjatë incidentit, përfshirë fëmijët;
- nëse janë përdorur armë (si dhe çfarë lloji).
- Përshkruani me hollësi çdo dëmtim që vëreni. Për këtë qëllim, përdorni formularë specifikë të përshtatur dhe harta të trupit për një paraqitje më të saktë;
- Shënoni edhe simptomat emocionale dhe psikologjike;
- Shënoni çfarë thotë vetë e/i mbijetuar/a duke përdorur fjalët e saj;
- Dokumentoni dyshimet tuaja dhe provat mbi të cilat bazohen;
- Informoni të mbijetuarat/it për përdorimin e mundshëm të të dhënave të tyre dhe merrni miratimin paraprak për këtë.
- Ruajini të gjitha të dhënat në një vend të sigurt e konfidencial;
- Planifikoni kohë të mjaftueshme për të hedhur të dhënat në sistemin e mbledhjes së të dhënave.

Referimi

Punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore janë shpesh profesionistët dhe profesionistët e parë në kontakt me të mbijetuarën/in subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Prandaj, punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore mund t'i referojnë të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së te profesionistët dhe profesionistët e tjerë të shëndetësisë në të njëjtën institucion shëndetësor, në ndonjë institucion tjetër shëndetësor, ose në shërbime të tjera (policia, shërbimet e specializuara, mbrojtja sociale etj.). Po kështu, punonjëseve dhe punonjësve të shërbimeve shëndetësore mund t'u duhet t'i asistojnë të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së të referuara nga punonjëse dhe punonjës të shërbimeve të tjera. Të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së kanë nevojë komplekse, prandaj për një reagim efektiv ndaj DHF/DHBGJ kërkojnë një sërë shërbimesh të disponueshme për një qasje të koordinuar shumë-sektoriale, që mund të sigurohet nga një referim efektiv.

Referimet efektive kërkojnë që punonjëset dhe punonjësit e shërbimeve shëndetësore:

- Të jenë të afta/afte të njohin dhe lehtësojnë zbulimin e DHF-së/DHBGJ-së së ushtruar, si dhe të ofrojnë mbështetjen e linjës së parë.
- Të jenë të afta/afte të vlerësojnë situatën individuale dhe nevojat e të mbijetuarës/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së. Nëse rreziku vlerësohet si i lartë, e/i mbijetuar/a ka nevojë për ndërhyrje të menjëhershme, të tilla si ndihmë mjekësore, shtrim në spital ose ndihmë psikologjike të menjëhershme dhe/ose strehim në një strehëz. Nëse rreziku nuk vlerësohet si i lartë, mund të jenë të përshtatshme referimet për mbështetje të tjera sociale, psikologjike ose ligjore.
- Të njohin ligjshmërinë për DHF-në/DHBGJ-në, duke përfshirë përkufizimet përkatëse për veprat penale, masat mbrojtëse në dispozicion dhe të gjitha detyrimet për raportimin nga ana e tyre. Këto njohuri kërkojnë vetëm mbi bazën e detyrimeve profesionale përkatëse.
- Të marrin miratimin e të mbijetuarës/it përpara se të ndajnë informacionin rreth rastit të saj/tij me agjencitë e tjera ose punonjëset e punonjësit e shërbimeve dhe të ndjekin procedurën që mbron konfidencialitetin e të mbijetuarës/it. Ka edhe situata në të cilat duhet të përcillet informacioni edhe nëse e/i mbijetuar/a nuk jep miratim (kur raportimi i rastit në polici është

detyrim ligjor, për shkak se dhuna e ushtruar përbën vepër penale).

Hapat e mëposhtëm duhet të ndiqen për të siguruar një referim efektiv:

- Përditësoni listën me institucionet/organizatat që ofrojnë shërbime për të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së. Lista duhet të përfshijë emrin e institucionit, personin e kontaktit, adresën, të dhëna të tjera të kontaktit, si dhe listën e shërbimeve që ofrohen.

- Vlerësoni se çfarë referimi mund të jetë i dobishëm për të mbijetuarat/it subjekte të DHF-së/DHBGJ-së, sipas vlerësimit të nevojave dhe kërkesave të tyre.

- Informojeni të mbijetuarën/in subjekt i DHF-së/DHBGJ-së për mundësinë e referimit të shërbimeve të tjera, sipas kërkesës ose nevojës.

- Merrni miratimin e të mbijetuarës/it për të bërë referimin, para çdo hapi tjetër të mëtejshëm.

- Sqaroni të mbijetuarën/in se çfarë informacioni do të ndahet me institucionet e tjera të shërbimeve dhe çfarë informacioni do të mbahet konfidencial (specifikoni nëse ka ndonjë rregullim ligjor/kufizim).

- Jepini të mbijetuarës/it informacion të plotë dhe korrekt për institucionet që ofrojnë shërbime të tjera, sipas skemës së përshkruar më poshtë:

KUSH - cili institucion/organizatë ofron shërbime për të mbijetuarat/it subjekt i DHF-së/DHBGJ-së, shoqëruar me të dhënat e personit (emrin, numrin e telefonit) që mund të kontaktohet si pikë kontakti për atë shërbim.

ÇFARË - çfarë lloj ndihme mund të presin të marrin nga ky institucion, së bashku me informacion për kostot e këtij shërbimi.

KU - ku ndodhet saktësisht (adresa e saktë) shërbimi i caktuar.

- Bëjeni referimin sipas vendimit (zgjedhjes) të të mbijetuarës/it.

- Shoqërojeni referimin me një raport të shkurtër me shkrim dhe një diskutim në telefon me punonjësen apo punonjësin e shërbimeve të tjera, si një metodë për të shmangur situatën kur e/i mbijetuar/a duhet ta përsërisë historinë dhe t'u përgjigjet të njëjtave pyetje gjatë intervistave të shumëfishta, duke përjetuar përsëri traumë psikologjike të shkaktuar nga incidenti i DHF-së/DHBGJ-së.

- Nxisni pavarësinë e të mbijetuarës/it duke e ndëgjegjësuar atë që ta bëjë vetë referimin (nëse është e mundur).

- Shoqërojeni të mbijetuarën/in tek institucioni ku po referohet, nëse është e nevojshme dhe e mundur.

- Shpjegojani të mbijetuarës/it se mund të rikthehet për ndihmë të mëtejshme. Parashtroni çështjen e takimit të ardhshëm.

- Shpjegojani të mbijetuarës/it planin e ndjekjes së mëtejshme të gjendjes shëndetësore të saj.

- Jepini detajet e kontaktit për ndjekjen në vazhdim.

- Përfundojeni ndihmën kur të arrihet rezultati më i mirë i mundshëm (e/i mbijetuar/a i referohet institucioneve të tjera të shërbimeve), ose nevojat/kërkesat e të mbijetuar/ave ndryshojnë.

- Lidhni marrëveshje dhe protokolle për procesin e referimit me shërbime/institucione të rëndësishme, përfshirë përcaktimin e përgjegjësive të qarta për secilin shërbim.

- Sigurohuni që procedurat midis shërbimeve/institucioneve për shkëmbimin e informacionit dhe referimet janë të vazhdueshme dhe njihen nga personeli.

SHTOJCË 1 BAZA LIGJORE PËR EMERGJENCAT CIVILE

I. Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, ndryshuar neni 29, pika 1

Në nenet e këtij ligji jepen:

Qëllimi: Planifikimi dhe Përballimi i Emergjencave Civile (PPEC), si detyra të shtetit shqiptar për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim, apo fatkeqësi e mundshme, që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën etj.

Përkufizime: Ku sqarohet kuptimi i termave.

Parime të përgjithshme: Ku sqarohen detyrat dhe përgjegjësitë e organeve shtetërore dhe strukturave të tjera të ngritura, në bazë të këtij ligji, për parandalimin, përballimin dhe riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga një fatkeqësi e mundshme (ose emergjencë civile).

Strukturat e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile:

Strukturat në nivel qendror:

- Këshilli i Ministrave (KM);
- Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile (pranë KM);
- Ministria e Mbrojtjes (MM);
- Drejtoria e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile (DPPEC) në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile atashuar në MM.
- Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (QKOEC) në Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, atashuar në Ministrinë e Mbrojtjes:
- Komisioni Teknik Këshillimor i specialistëve (pranë DPPEC);
- Ministritë e linjës;
- Entet e ndryshme publike.

Strukturat në nivel vendor:

- Prefekti, që është përgjegjës për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile (PPEC) në qarkun përkatës, krijon dhe drejton Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile të qarkut.
- Kryetari i Bashkisë, që është përgjegjës për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashkinë dhe njësitë administrative përkatëse, krijon dhe drejton Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile të bashkisë.

Strukturat operative:

- Baza e mbrojtjes civile, forcat e armatosura, policia e shtetit, sistemi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, shërbimi i urgjencës mjekësore, shërbimi vullnetar.

Subjektet që përfshihen në PPEC: Këtu jepet detyrimi i shtetasve për pjesëmarrjen e tyre në situatat e përballimit të emergjencave civile, rastet e përjashtimit nga ky detyrim, si dhe detyrimet e personave fizikë e juridikë që përdorin, prodhojnë, transportojnë etj., substanca të rrezikshme, për të planifikuar dhe përballuar me shpenzimet e veta rastet e emergjencave civile të mundshme në zonën e tyre të veprimtarisë.

Së fundi: jepen burimet financiare që do të përdoren në rastet e emergjencave civile, si dhe sanksione e dispozita të fundit.

II. VKM-ja nr. 655, datë 18.12.2002, “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile”

Në këtë vendim përcaktohen detyrimet për disa dikastere kryesore, si Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë etj., si dhe për pushtetin vendor, si vijon:

- Brenda strukturave të tyre të përfshihet ngritja e sektorit të planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile, si dhe vendosjen (emërimin) në këtë sektor të specialistëve për planifikimin dhe përballimin e emergjencave civile.

- Pranë këtyre dikastereve të funksionojë Komisioni i Planifikimit dhe i Përballimit të Emergjencave Civile (KPPEC), detyrat e të cilit përcaktohen në shtojcën bashkëlidhur këtij vendimi.

- Ngritja dhe funksionimi në strukturën e Ministrisë së Mbrojtjes, i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe në përbërje të saj, Drejtoria e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile si dhe Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile

- Ngritja dhe funksionimi i zyrës (sektorit) të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në bazë prefekturale (nivel qaraku), i zyrës së (sektorit) të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në bazë bashkie.

- Ngritja dhe funksionimi i zyrës (sektorit) të ZIMEK-ut (Zyra e Informacionit dhe Menaxhimit të Emergjencave Civile dhe Krizave), në bazë të VKM-së nr. 965, datë 2.12.2015, “Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave”.

- Së fundi, në këtë vendim jepen dhe mënyrat e rekrutimit dhe trajnimit të personelit të strukturave të emergjencave civile.

III. VKM-ja nr. 663, datë 18.12.2002, “Për përbërjen, funksionimin dhe përgjegjësitë e Komisionit Teknik Këshillimor të Specialistëve për Emergjencat Civile”

Në këtë vendim përcaktohet detyrimi i Ministrisë së Mbrojtjes, për:

- Ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Teknik Këshillimor të Specialistëve për Emergjencat Civile, që do të thirret dhe drejtohet nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile.

- Ky komision do të ketë përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, dikasteret, institucionet shkencore, Kryqi i Kuq, OJF-të etj. Gjithashtu jepen edhe detyrat e përgjegjësitë e funksionimit të tij.

IV. VKM-ja nr. 664, datë 18.12.2002, “Për kriteret dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së Emergjencës Civile”

Në këtë vendim përcaktohen të gjitha kriteret e procedurat se kur duhet të shpallet gjendja e jashtëzakonshme për Emergjencat Civile, si dhe detyrimet e dikastereve për zbatimin e tij.

V. VKM-ja nr. 531, datë 1.8.2003, “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile”

Në këtë vendim përcaktohet funksionimi i Shërbimit të Emergjencave Civile përmes 3 strukturave bazë operative, që janë:

- a) strukturat monitoruese – njoftuese;
- b) strukturat vepruese – aktive;
- c) strukturat vepruese – mbështetëse.

Në këtë vendim jepen gjithashtu sqarimet përkatëse mbi përbërjen e këtyre strukturave, mënyra e veprimit të tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë e disa dikastereve e strukturave vendore për zbatimin e tij.

VI. Urdhri i ministrit të Shëndetësisë nr. 130, datë 15.5.2007. “Mbi ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Shëndetësisë”

Ky urdhër ka dalë në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, për krijimin e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në Ministrinë e Shëndetësisë, i cili drejtohet nga zëvendësministri i Shëndetësisë dhe ka anëtarë gjithë drejtorët e drejtorive, si dhe disa drejtues të institucioneve kryesore shëndetësore kombëtare.

VII. Urdhri i ministrit të Shëndetësisë nr. 297, datë 30.7.2007, “Mbi ngritjen dhe funksionimin në nivel rrethi të Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”

Ky urdhër ka dalë po në zbatim të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, për krijimin e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel rrethi, ku përcaktohet detyrimi për të gjitha Drejtoritë e Shëndetit Publik (DSHP-të) e rretheve, për krijimin

e këtij komisioni, që do të drejtohet nga drejtori i DSHP-së dhe që ka anëtarë specialistë të higjienës – epidemiologjisë, mjekësisë familjare etj.

VIII. Ligji nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”

Në kreun I: “Dispozita të përgjithshme”, neni 3, pika 12, jepet përkufizimi i “Gjendjes së emergjencës shëndetësore”.

Në kreun VIII: “Kujdesi shëndetësor në gjendjet e emergjencës shëndetësore”, nenet 34, 35 dhe 36 jepen masat për përballimin e emergjencave shëndetësore dhe shërbimet që ofrohen në rastet e emergjencave civile.

IX. Miratim me nr. 2584 prot., datë 14.7.2011, për dokumentin “Platforma e përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për Menaxhimin e Riskut dhe Fatkeqësive”

Element të përgjithshëm të platformës

Platforma e PPEC-së mbështetet në disa koncepte dhe parime bazë të cilat duhet të reflektohen në të gjithë përbërësit e saj:

- bazën legjislative;
- politikën e MSHMS-së ndaj PPEC-së;
- programet e menaxhimit të rrezikut;
- planet e emergjencave;
- trajnimin e personelit, si dhe në të gjithë procesin e përgjigjes dhe rikuperimit të efekteve të fatkeqësive të mundshme.

REFERENCA

- Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001, “Për emergjencat civile”, i ndryshuar;
- Platforma e Përgjithshme e Ministrisë së Shëndetësisë për Menaxhimin e Riskut dhe të Fatkeqësive me nr. 2584 prot., datë 14.7.2011;
- Plani Kombëtar për Emergjencat Civile, 2004;
- Broshura: “Çfarë duhet të dimë rreth dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale në kushte krizash/emergjencash”, përgatitur nga UNFPA, Shkup;
- Udhëzues për Integrimin e ndërhyrjeve kundër dhunës me bazë gjinore në veprimet humanitare”, përgatitur nga IASC, 2015;
- Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor, si pjesë e reagimit shumësektorial ndaj Dhunës me Bazë Gjinore (DHBGJ) – Procedurat Standarde të Veprimit, përgatitur nga Instituti i Evropës Lindore për Shëndetin Riprodhues (EEIRH, Rumanë) dhe botuar nga Zyra Rajonale e UNFPA-së për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (UNFPA EECARO), 2015.

II. Barazia gjinore
Mbrojtja nga diskriminimi

LIGJ
Nr. 9970, datë 24.7.2008

PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë;
- b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet;
- c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.

Neni 3
Parimet themelore

- 1. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.
- 2. Dispozitat e këtij ligji nuk duhet të interpretohen apo zbatohen në mënyrë që të kufizojnë apo reduktojnë garancitë për arritjen e barazisë gjinore, të shprehura në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, *acquis communautaire* të Bashkimit Europian, konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Barazi gjinore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfituar njëloj nga arritjet e zhvillimit të saj.

2. “Përkatësi gjinore” janë mundësitë dhe atributet shoqërore, të lidhura me të qenit femër apo mashkull, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

3. “Diskriminim për shkak të gjinisë” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.

4. “Integrim gjinor” është procesi që zhvillohet ndërmjet femrave dhe meshkujve, si një proces që nuk i përket vetëm njëres gjini si grup i veçuar, por shoqërisë në tërësi. Si i tillë, integrimi gjinor është rruga për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese.

5. “Përfaqësim i barabartë gjinor” është përfaqësimi i secilës prej gjinive me jo më pak se 30 për qind në një institucion, në nivel drejtues, organ të emëruar, parti politike.

6. “Masa të veçanta të përkohshme” janë masat e ndërmarra nga organet shtetërore, që synojnë përsheptimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve në shoqëri.

7. “Nëpunës që merret me çështjet e barazisë gjinore” është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e barazisë gjinore dhe ia kushton kohën e punës arritjes së barazisë gjinore dhe integritit gjinor në sektorin apo territorin që mbulon.

8. “Punë me vlerë të barabartë” është veprimtaria e paguar, e cila, e krahasuar me të njëjtët tregues ose njësi matëse të një veprimtarie tjetër, pasqyron njohuritë e ngjashme ose të barabarta dhe aftësitë profesionale në realizimin e një sasive të barabartë dhe të përafërt të përpjekjeve fizike e intelektuale.

9. “Ngacmim për shkak të përkatësisë gjinore” është çdo formë sjelljeje e padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes.

10. “Shqetësim seksual” është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike dhe simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes.

Neni 5

Zbatimi i ligjit

1. Ky ligj mbron nga diskriminimi për shkak të gjinisë të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

Neni 6

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë

1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet.

2. Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kriterëve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njërës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Nga ky ndalim bëjnë përjashtim rastet kur këto dispozita, kushte, kriterë apo praktika justifikohen nga një qëllim i përligjur dhe mjetet apo rrugët për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme.

Neni 7

Masat e nevojshme për sigurimin e barazisë gjinore

Për sigurimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, organet shtetërore, në bazë të kompetencave të tyre:

1. Sigurojnë, përmes masave legislative ose me mjete të tjera të përshtatshme, zbatimin praktik të parimit të barazisë gjinore.

2. Sigurojnë, përmes masave legislative ose me mjete të tjera të përshtatshme, të shoqëruar edhe me sanksione, kur është rasti, ndalimin e çdo diskriminimi për shkak të gjinisë.

3. Sigurojnë, përmes rregullimeve ligjore dhe nënligjore ose me mjete të tjera të përshtatshme, ndryshimin ose shfuqizimin e çdo akti ligjor, zakoni apo praktike, që përbën diskriminim për shkak të gjinisë.

4. Marrin të gjitha masat e përshtatshme, për të krijuar lehtësitë e nevojshme e të përligjura objektivisht, për mundësi të barabarta dhe akses të barabartë për të dyja gjinitë.

5. Sigurojnë, përmes institucioneve publike dhe gjykatave kombëtare, mbrojtjen efektive të të dyja gjinive ndaj çdo veprimi diskriminues.

Neni 8

Masat e veçanta të përkohshme

1. Masat e veçanta të përkohshme përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njërës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër.

2. Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur organet shtetërore marrin masa të veçanta të përkohshme, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përsheptimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve. Këto masa duhet të pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar.

Neni 9

Masat e veçanta

Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur shteti merr masa të veçanta, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë:

a) mbrojtjen e posaçme të grave gjatë shtatzënisë dhe lindjes, të nënave të reja, si dhe të prindërve të rinj, për shkak të lindjes natyrore ose të adoptimit të fëmijës, duke krijuar kushte për

mbrojtjen dhe lehtësimin e tyre në punë; në sigurimet shoqërore e ndihmat sociale; në sigurimin e ndihmës së nevojshme shëndetësore për nënën dhe fëmijën; në sigurimin dhe nxitjen e sistemit të shërbimeve sociale, duke favorizuar zhvillimin e rrjetit të çerdheve e kopshteve;

b) lehtësimin e ndihmën për personat, që kanë përgjegjësi të veçanta në familje, për shkak të përkujdesjes së përditshme ndaj anëtarëve të paaftë të familjes, për shkak të moshës, paaftësisë fizike apo mendore ose për shkaqe të tjera paaftësie.

c) kufizimet për të punuar në disa sektorë të punëve të rënda dhe të rrezikshme për gratë shtatzëna dhe ato me fëmijë në gj. Këto kufizime do të rishikohen periodikisht, në varësi të njohurive shkencore e teknike dhe sipas nevojave që paraqiten.

PJESA II ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBARËVAJTJEN E BARAZISË GJINORE DHE DETYRAT E TYRE

Neni 10

Këshilli i Ministrave

1. Këshilli i Ministrave miraton strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri.

2. Projektligjet e përgatitura nga Këshilli i Ministrave, që i paraqiten Kuvendit për miratim, nëse është rast, duhet të shoqërohen edhe me një vlerësim të efekteve për secilën gjini.

Neni 11

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore

1. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e barazisë gjinore. Përbërja e tij miratohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë, sipas përkatësisë gjinore.

2. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe në përbërje ka dhjetë përfaqësues të përcaktuar nga Qeveria dhe tre nga shoqëria civile. Përfaqësuesit nga shoqëria civile duhet të jenë shtetas shqiptarë, me arsim të lartë dhe të njohur, për shkak të veprimtarisë së tyre në fushën e barazisë gjinore.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë ndalohej.

4. Rregullat procedurale të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe shpërblimi i anëtarëve të tij miratohen nga Këshilli i Ministrave në Rregulloren e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Neni 12

Detyrat e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore

Detyrat e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore janë:

a) këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore, me përjashtim të çështjeve që merren në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Punës. Për çështje të një rëndësie të veçantë, Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore mund të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me Këshillin Kombëtar të Punës;

b) siguron integrimin gjinor në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore;

c) i propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen dhe arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;

ç) vlerëson gjendjen konkrete të barazisë gjinore në vend, duke dalë me udhëzime për strukturën e çështjeve të barazisë gjinore në ministrinë që mbulon çështjet e barazisë gjinore, si dhe propozime e rekomandime për Qeverinë, për përmirësimin e gjendjes;

d) miraton raportin vjetor për çështjet e barazisë gjinore të ministrisë që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

Neni 13

Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, si dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

2. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore:

a) zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore;

b) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe të të drejtave të grave, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera, që synojnë të zhdukin dallimet ndërmjet gjinive në gëzimin e të drejtave dhe ofrimin e mundësive, pasi këshillohet me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore;

c) bashkëpunon dhe u ofron mbështetje organizatave jofitimprurëse, aktive në fushën e barazisë gjinore;

ç) organizon edukimin dhe përgatitjen profesionale të nëpunësve për çështjet e barazisë gjinore;

d) ndërton mekanizmat e mbledhjes së statistikave, të ndara sipas gjinisë, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre;

dh) organizon grumbullimin, analizën dhe përhapjen e informacionit për problemet e përkatësisë gjinore;

e) vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera, ndërton dhe realizon veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe punonjësve e funksionarëve të administratës publike e sistemit gjyqësor mbi konceptin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin e gruas, eliminimin e stereotipave gjinorë, kuptimin e drejtë të rolit të femrës e të mashkullit, të nënës e të babait në familje dhe shoqëri;

ë) brenda tremujorit të parë të çdo viti, i paraqet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, ecurinë e punës për arritjen e barazisë gjinore, problemet e hasura dhe rrugët për kapërcimin e tyre;

f) organizon mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe përgatit materialet, aktet dhe dokumentet e nevojshme që paraprijnë ose pasojnë këto mbledhje.

3. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin përkatës, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri emërohet një nëpunës që merret me çështjet e barazisë gjinore.

4. Ministri realizon detyrat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, si dhe mbikëqyr veprimtarinë për çështjet e barazisë gjinore nëpërmjet strukturës që ai ka për këtë qëllim. Drejtuesi i kësaj strukture drejton këtë veprimtari, si dhe e përfaqëson strukturën në marrëdhëniet me të tretët.

5. Ministria për çështjet e barazisë gjinore ka burime financimi:

a) Buxhetin e Shtetit;

b) donatorë të ndryshëm.

Neni 14

Organet e qeverisjes vendore

1. Organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me organet e qeverisjes qendrore për zbatimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore.
2. Organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme, në territorin që mbulojnë.
3. Organet e qeverisjes vendore kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë.
4. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të barazisë gjinore, pranë tyre.

PJESA III

PJESËMARRJA E BARABARTË GJINORE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES

Neni 15

Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes

1. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:
 - a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;
 - b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;
 - c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;
 - ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.
2. Partitë politike përcaktojnë mënyrat dhe masat për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.
3. Partitë politike paguajnë një gjobë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, nëse shkelin dispozitat e këtij neni, deri në ndreqjen e shkeljes.

PJESA IV

MBROJTJA DHE TRAJTIMI I BARABARTË, NË BAZË TË PÛRKATËSISË GJINORE, NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 16

Detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës

Punëdhënësi dhe çdo individ, që vepron në emër dhe për llogari të tij, me cilësinë e ndërmjetësit, të agjentit apo të përfaqësuesit, detyrohet që, për promovimin e barazisë gjinore para dhe gjatë marrëdhënieve të punës:

1. Të mos përfshijë elemente të diskriminimit në bazë të gjinisë në shpalljen e vendit të lirë të punës dhe të sigurojë mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt për të aplikuar në vendet e lira të punës.

Kur për një vend të lirë pune ose për një kategori të caktuar pune ka një shpërndarje të pabarabartë të femrave dhe meshkujve, nuk përbën diskriminim nëse shpallja vë në dukje qëllimin e vendosjes së parimeve të barazisë.

2. Të zbatohet kriteret e njëjta në të gjitha procedurat e rekrutimit, me përjashtim të rasteve të veçanta, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji.

Punëdhënësi nuk mund të disfavorizojë një punëkërkuar, duke vendosur rregulla, kriteret ose metoda procedurale, që në dukje janë neutrale, por që në praktikë janë më pak të favorshme për personat e gjinisë tjetër, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme.

3. Të punësojë pa diferencim gjinor, në çdo pozicion ose vend të lirë, në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale.

4. Të promovojë shpërndarje të barabartë, ndërmjet femrave dhe meshkujve, në lloje të ndryshme të vendeve të punës dhe brenda kategorive të ndryshme të punëmarrësve, përmes trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale e të masave të tjera të përkohshme.

5. Të krijojë kushte pune të barabarta dhe të përshtatshme, mundësi të barabarta për informacion, trajnim e kualifikim dhe trajtim të barabartë të punëmarrësve gjatë marrëdhënieve të punës.

6. Të zbatohet kriteret e barabarta në vlerësimin e cilësisë së punës. Punëdhënësi nuk mund të zbatohet një kriter vlerësues, në dukje neutral, por që në praktikë është në disavantazh të personave të gjinisë tjetër.

7. Të japë pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë.

8. Të marrë masa për ndalimin e diskriminimit, ngacmimeve dhe shqetësimeve seksuale ndaj punëmarrësit.

9. Të mos vendosë në pozitë të disfavorshme ose të mos marrë masa disiplinore ndaj punëmarrësit, i cili kundërshton ose ankohet për diskriminim, ngacmim ose shqetësim seksual, si edhe ndaj punëmarrësit që dëshmon për veprime diskriminuese, ngacmim ose shqetësim seksual, të kryera prej punëdhënësit ose punëmarrësve të tjerë.

Neni 17

Veprimet diskriminuese të punëdhënësit

1. Veprimet e punëdhënësit në sektorin publik ose privat janë diskriminuese, nëse, për shkak të gjinisë:

a) përdor standarde ose/dhe procedura të diferencuara ndaj punëmarrësve për rekrutimin, trajnimin dhe ritrajnimin, promovimin në detyrë, nxitjen profesionale, menaxhimin dhe shpërndarjen e punës, kohëzgjatjen dhe kushtet e provës, sigurimet shoqërore dhe përfitimet në rastet e daljes në pension, papunësisë, sëmundjes, invaliditetit, paaftësisë për punë, të drejtën e lejes dhe të lejes së paguar, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë, pagesën për punë me vlerë të barabartë, pjesëmarrjen në organizatat sindikale, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, të parashikuara në nenin 9 të këtij ligji;

b) krijojë kushte pune të diferencuara për punëmarrësit e të njëjtit nivel;

c) ndërmerr dënim disiplinor ndaj punëmarrësit, ndryshon kushtet e punës, e transferon në një punë tjetër, shkurton vende pune, pushon apo largon nga puna ose përfundon kontratën e punës;

ç) vendos në pozitë të disfavorshme punëmarrësin, për shkak të një ankese ndaj veprimeve të mësipërme të punëdhënësit.

2. Ndalohet diskriminimi në përzgjedhjen e një kandidati për punë dhe përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëmarrësi për shkaqe të mëmësisë, mundësisë për shtatzënësi në të ardhmen, shtatzënësisë, përgjegjësisë prindërore, gjendjes civile, përgjegjësisë familjare. Nuk përbën diskriminim nëse vendi i punës është përcaktuar nga Këshilli i Ministrave si i vështirë ose i rrezikshëm për shëndetin e nënave me fëmijë në gjë dhe për gratë shtatzëna.

3. Gjatë proceseve të riorganizimit dhe reformimit të vendeve të punës, punëdhënësi respekton rregullat e përfaqësimit të barabartë gjinor në përfundimin e marrëdhënieve të punës.

Neni 18

Përgjegjësitë e punëdhënësit për mbrojtjen e punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimi dhe shqetësimi seksual

1. Çdo diskriminim, ngacmim apo shqetësim seksual në vendin e punës nga punëdhënësi dhe/ose punëmarrësi është i ndaluar.

2. Punëdhënësi, për të mbrojtur punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimi e, veçanërisht, nga shqetësimi seksual, detyrohet:

a) të marrë masa parandaluese dhe të përcaktojë masa (sanksione) disiplinore në rregulloren e brendshme, për ndalimin e ngacmimeve dhe të shqetësimeve seksuale ndaj punëmarrësit, në përputhje me këtë ligj;

b) nëse merr dijeni, në mënyrë të tërthortë ose me ankesë nga një punëmarrës, i cili pretendon se është diskriminuar, ngacmuar ose shqetësuar seksualisht nga një punëmarrës tjetër, pasi bindet, merr masat e duhura organizative për ndalimin e vazhdimet dhe parandalimin e diskriminimit, të ngacmimit ose shqetësimit seksual dhe zbaton sanksionet disiplinore;

c) të informojë të gjithë punëmarrësit për ndalimin e diskriminimit, të ngacmimit dhe shqetësimit seksual në vendin e punës.

3. Punëdhënësi vendos në kontratën kolektive të punës rregulla për të parandaluar diskriminimin për shkak të gjinisë dhe për mënyrën e zgjidhjes së ankesave të bëra prej personave të dëmtuar nga akte të tilla.

4. Çdo marrëveshje individuale ose kontratë kolektive, që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, është e pavlefshme.

5. Dispozitat e këtij ligji i shtrijnë efektet e tyre edhe tek të vetëpunësuarit, si dhe për punëmarrësit, për punët që kryhen në kushtet e shtëpisë.

Neni 19

Autoriteti publik përgjegjës për barazinë gjinore në fushën e punës

1. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore është autoriteti publik përgjegjës për të zbatuar dhe kontrolluar respektimin e këtij ligji në fushën e punës dhe të punësimit.

2. Me qëllim që të zbatojnë masat për përmirësimin e mundësive të barabarta ndërmjet femrave dhe meshkujve, për eliminimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për shkak të përkatësisë gjinore, ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore organizon mbikëqyrjen dhe ushtron kontroll ndaj institucioneve që varen prej tij, të cilat ndjekin problemet e barazisë gjinore, si më poshtë:

a) Shërbimi Kombëtar i Punësimit siguron zbatimin e masave për mbikëqyrjen e mundësive dhe të trajtimit të barabartë ndërmjet burrit dhe gruas në fushën e shërbimit të punësimit dhe të formimit profesional, si dhe në mbështetjen me të ardhura nga papunësia, kontrollon marrjen dhe zbatimin e masave të veçanta, të përkohshme, nga punëdhënësi, si dhe i paraqet ministrit që mbulon çështjet e barazisë gjinore propozime për ndryshime në ligje e akte nënligjore, çdo nismë e projekte, studime e bashkëpunime të tjera në fushën e barazisë gjinore;

b) Inspektorati Shtetëror i Punës siguron kontrollin dhe zbatimin e masave për respektimin e barazisë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës e të punësimit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të sigurisë në punë prej punëdhënësit dhe personave të punësuar në sektorin publik e privat, si dhe kontrollon marrjen dhe zbatimin e masave të veçanta të përkohshme nga punëdhënësi;

c) Shërbimi Social Shtetëror inspekton dhe përgjigjet për zbatimin e masave për respektimin e primeve të barazisë gjinore në fushën e zbatimit të politikave dhe të legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror në të gjithë vendin.

3. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore bashkëpunon me Ministrin e Financave, me qëllim që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të sigurojë zbatimin e masave për mbikëqyrjen e barazisë gjinore në fushën e administrimit dhe të menaxhimit të sistemit publik të pensioneve dhe të të drejtave të tjera të sigurimit shoqëror.

4. Mënyrat, format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit në fushën e barazisë gjinore ndërmjet institucioneve, në varësi të ministrisë që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe ministrive të tjera, përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 20

Njoftimet diskriminuese

1. Përbën diskriminim një njoftim pune, arsimimi, kualifikimi ose trajnimi, kur në të përcaktohen kërkesa ose preferenca, të cilat i japin përparësi aplikuesit të një gjinie të caktuar, me përjashtim të rasteve të veçanta, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, për shkak të natyrës së veçantë të punës.

2. Përbën diskriminim një njoftim pune/arsimimi, i cili përmban kërkesa, që nuk kanë lidhje me vendin e punës/arsimit ose që mund të përjashtojë një femër/mashkull nga aplikimi, ose që të lë përshtypjen e parapëlqimeve ndaj një gjinie të caktuar, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme.

3. Përbën diskriminim specifikimi në njoftim i kërkesave ose parapëlqimeve, që kanë të bëjnë me gjendjen familjare e martesore apo me detyrimet familjare.

4. Në njoftimet e punës është e ndaluar të kërkohet nga njoftuesi informacion rreth jetës private ose familjare të aplikuesit.

5. Njoftimi nuk është diskriminues nëse gjinia e përfaqësuar në nivelin më të ulët (duke pasur parasysh vendin e punës dhe postin) nxitet të aplikojë.

Neni 21

Të drejtat e punëmarrësit për respektimin e parimeve të barazisë gjinore

Punëmarrësit femra dhe meshkuj kanë të drejtë që pa asnjë diskriminim për shkak të gjinisë:

a) të zgjedhin lirisht profesionin dhe vendin e punës, sistemin e përgatitjes dhe përsosjes profesionale dhe të kualifikimit të pandërprerë, të mësimin të zanateve, të ngrihen në përgjegjësi, të kenë punë të qëndrueshme;

b) të kenë të njëjtat mundësi punësimi, përfshirë zbatimin e të njëjtave kritere të përzgjedhjes për punësim;

c) të informohen nga punëdhënësi për vendet e lira të punës dhe të drejtat e tyre mbi mundësitë e barabarta në marrëdhëniet e punës;

ç) të kenë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, përfshirë shpërblimet, për trajtim të barabartë për punë me vlerë të barabartë, si dhe për trajtim të barabartë lidhur me vlerësimin e cilësisë së punës;

d) të kenë sigurime shoqërore, veçanërisht në rastet e daljes në pension, të papunësisë apo të humbjes së aftësisë së përkohshme për punë;

dh) të kenë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë, përfshirë ruajtjen e funksionit të riprodhimit;

e) të mos diskriminohen ose pushohen nga puna për shkak të martesës ose gratë për shkak të shtatzënësisë ose amësisë dhe të garantohet e drejta efektive për punë;

ë) të kenë të drejtë të përfitojnë kompensime për fëmijët që kanë në ngarkim;

f) të kenë mbështetjen dhe inkurajimin e sistemit të shërbimeve sociale të nevojshme, për t'u lejuar prindërve punëmarrës të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë profesionale;

g) të marrin informacion me shkrim nga punëdhënësi, pas paraqitjes së një kërkesë, lidhur me natyrën dhe qëllimin e trajnimit, eksperiencën në punë dhe të kualifikimeve të tjera që pati personi i gjinisë tjetër, i cili fitoi të drejtën, u përzgjedh, u promovua në një pozicion ose vend të lirë pune;

gj) të anëtarësohen dhe të aktivizohen në organizatat sindikale dhe në çdo organizatë tjetër profesionale.

Neni 22

Masat e veçanta të përkohshme në fushën e marrëdhënieve të punës

1. Për të siguruar përfaqësim të barabartë në fushën e marrëdhënieve të punës, nuk përbën diskriminim nëse shpallja për një vend të lirë pune deklaron parapëlqim për kandidatin e gjinisë më pak të përfaqësuar.

2. Për të siguruar përfaqësim të barabartë në fushën e marrëdhënieve të punës, në procesin e përzgjedhjes për marrjen në punë, ngritjen në detyrë, zhvillimin e aftësive profesionale, kur kandidatët kanë rezultate ose nivele të barabarta, punëmarrësi i jep përparësi kandidatit të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Neni 23

Vlerësimi i punës së papaguar

1. Puna e papaguar e femrave dhe e meshkujve vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, në rast kur ai/ajo:

- a) kujdeset për mirëqenien e familjes;
- b) kujdeset për fëmijët;
- c) kujdeset për anëtarë të tjerë të familjes;
- ç) punon në bujqësi dhe ekonomi familjare.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të formimit profesional në bazë të legjislacionit në fuqi.

PJESA V

TRAJTIMI I BARABARTË DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË NË ARSIM DHE KUALIFIKIM

Neni 24

Ndalimi i pabarazisë për shkak të përkatësisë gjinore

1. Ndalohet diskriminimi, për shkak të përkatësisë gjinore, ndaj personave nga/në institucionet arsimore të të gjitha niveleve, publike ose private.

2. Përbëjnë diskriminim rastet kur:

a) parashikohen norma kufizuese, bazuar në dallime gjinore dhe pengohet krijimi i lehtësive të nevojshme për t'u arsimuar pranë institucioneve shtetërore ose private, që ofrojnë arsimim apo shërbime të tjera kualifikimi e trajnimi;

b) krijohen mundësi të ndryshme e të pajustificuara objektivisht ndaj burrit dhe gruas, për zgjedhjen e një fushe të veçantë studimi, trajnimi, diplomimi, si dhe për kohëzgjatjen e mësimit.

Neni 25

Edukimi i barazisë gjinore

1. Subjektet, që ofrojnë arsimim, kualifikim e trajnim, si dhe ata që formulojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë mësimdhënien e

njohuri të nevojshme dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, të stereotipave negative, paragjytimeve dhe praktikave zakonore ose të çdo lloji tjetër, që cenojnë parimet e barazisë gjinore.

2. Institucionet e arsimit të lartë, në mënyrë të veçantë, sipas fushave përkatëse, ndërmarrin nisma për kryerjen e studimeve në fushën e barazisë gjinore, ose e përfshijnë atë në studimet e kryera, për të siguruar materiale me informacionin përkatës, si dhe për t'i paraprirë zhvillimit praktik e shkencor të kësaj fushe.

PJESA VI TRAJTIMI I BARABARTË DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË NË MEDIA

Neni 26

Barazia gjinore në media

1. Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve:

- a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore;
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;
- c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.

2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëjës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

PJESA VII ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE SANKSIONET

Neni 27

Masat disiplinore

Shkelja e nenit 18 pika 2 shkronja “b” të këtij ligji sjell përgjegjësi disiplinore. Masat disiplinore jepen nga eprori i drejtpërdrejtë, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 28

Gjoba

1. Shkelja e neneve 16, 17, 18 pika 2 shkronjat “a” dhe “c” dhe 20 pika 3 të këtij ligji dënohen me gjobë nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

2. Shkelja e neneve 24 pika 2 dhe 26 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

3. Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:

- a) personi fizik, nga 30 000 deri 60 000 lekë;
- b) personi juridik nga 60 000 deri 100 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri 80 000 lekë.

4. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 29
Shpërblimi i dëmit

Shpërblimi për dëmin material dhe moral, të shkaktuar nga cenimi i dispozitave të këtij ligji, përfshirë rikthimin e të drejtave të shkelura, bëhet në rrugë gjyqësore në bazë të Kodit Civil.

Neni 30
Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo ankesë për shkeljen e barazisë gjinore, sipas këtij ligji, shqyrtohet ose gjykohet nga organet administrative, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Organet administrative vendosin sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Palët, sipas zgjedhjes së tyre të lirë, kur është rasti, mund të përmbushin çdo procedurë ndërmjetësimi ose të zgjidhjes me pajtim, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, për të adresuar shkeljet në bazë të këtij ligji. Përmbushja e këtyre procedurave nuk i heq të drejtën ankuesit ta ndjekë çështjen pranë organit administrativ ose gjykatës kompetente.

3. Nëse shkelja është bërë nga nëpunësit e administratës publike, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësitë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

4. Organizatat jofitimprurëse, të licencuara për ofrim shërbimi social, mund të përfaqësojnë ose të mbështesin në procese ligjore, në emër ankuesit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

PJESA VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 31
Shfuqizimet

Ligji nr.9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Neni 32
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 13 shkronja “d” dhe të nenit 19 pika 4 të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 pikat 1 dhe 4 të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5850, datë 30.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

UDHËZIM
Nr.1220, datë 27.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË VLERËSIMIT DHE TË
MONITORIMIT TË TREGUESVE TË BARAZISË GJINORE DHE DHUNËS NDAJ
GRAVE, PËRFSHIRË DHUNËN NË FAMILJE, MBIKËQYRJEN, MBLEDHJEN
DHE PËRPUNIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 13, shkronjat “d”, “dh”, dhe të nenit 32, pika 1 të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”,

UDHËZOJ:

1. Monitorimi dhe vlerësimi i monitorimit të treguesve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, realizohen në nivel vendor e kombëtar dhe ka për qëllim:

a) monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të objektivave, të masave e veprimeve në zbatim të legjislationit, strategjive dhe programeve për barazi gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje;

b) vlerësimin e efektivitetit të zbatimit të politikave dhe programeve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje;

c) vlerësimin e ndikimit të politikave në uljen e dhunës, shmangien e përjashtimit shoqëror dhe garantimin e mundësive të barabarta;

d) hartimin e rekomandimeve dhe të politikave për mbështetjen e programeve të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje.

2. Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes, struktura për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, vlerëson të dhënat statistikore, si dhe harton raporte në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, për:

i) mekanizmat ligjorë dhe institucionalë;

j) fuqizimin e grave nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre më të madhe në vendimmarrje;

k) fuqizimin ekonomik të grave dhe mundësive të tyre në rritje për punësim dhe trajnime profesionale;

l) promovimin e së drejtës së grave e vajzave të reja për arsim cilësor;

m) përmirësimin e qasjes ndaj shërbimeve cilësore sociale për gratë e vajzat në rrezik;

n) përmirësimin e shëndetit të popullsisë, duke siguruar një përgjigje më të mirë të sistemit shëndetësor ndaj nevojave të femrave;

o) përditësimin e rolit të medias në përparimin e barazisë gjinore në shoqëri;

p) eliminimin e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje.

3. INSTAT-i mbledh të dhënat administrative nga burimet e veta, nga ministritë e linjës, si dhe institucionet e tjera të përcaktuara në formularin nr.1, për të dhënat e parashikuara në përmbajtjen e këtij formulari bashkëlidhur udhëzimit.

4. Ministritë e linjës/institucionet qendrore të parashikuara në formularët 2/1-2/11, çdo vit, brenda datës 10 të muajit shkurt të vitit pasardhës, dërgojnë të dhënat e përpunuara në INSTAT, sipas formularëve nr.2/1 deri 2/11 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Me kërkesë të MPCSSH-së, INSTAT-i përcjell në strukturën e statistikave të kësaj ministrie të dhënat e grumbulluara për indikatorët e barazisë gjinore dhe dhunës në familje sipas formularit nr.1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

6. Ministritë/institucionet qendrore të parashikuara në formularët 3, 3/1-3/4, çdo vit brenda datës 10 të muajit shkurt të vitit pasardhës përpunojnë dhe dërgojnë në strukturën e statistikës në MPCSSHB, të dhëna statistikore sipas formularit nr.3 dhe formularëve nr.3/1 deri 3/4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7. Struktura e statistikës në MPCSSH, grumbullon dhe përpunon të dhënat nga institucionet qendrore sipas pikës 6 të këtij udhëzimi.

8. Drejtoria e Politikave për Shanset e Barabarta dhe Familjen në MPCSSH, të dhënat e grumbulluara në përputhje me procedurat e përcaktuara, pasi i vlerëson, harton raporte për realizimin e qëllimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

Formulari nr.1

Instituti i Statistikës (INSTAT) mbledh treguesit e përpunuar, të listuar si më poshtë si pjesë e detyrimeve që janë aktualisht në fuqi sipas shpeshhtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme dhe i dërgon ato në strukturën që mbulon çështjet e statistikës në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPCSSH).

Drejtimi : FUQIZIMI I GRAVE NËPËRMJET PJESEMARRJES SË TYRE MË TË MADHE NË VENDIMMARRJE

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshhtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve në shërbimin civil, në katër nivelet më të larta të mbajtjes së detyrave.	%	INSTAT, marrë nga DAP	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve të punësuar në sektorin publik, në nivel administrativ dhe menaxherial.	%	INSTAT, marrë nga DAP	Vjetore

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshhtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve kandidatë/e në listat partiake vendore.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve kandidatë/e në listat partiake kombëtare.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve drejtues/e në partitë politike.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve të regjistruar si votues.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve (me të drejtë vote) që votojnë.	%	INSTAT, marrë prej KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e listave zonale për zgjedhjet kombëtare që përmbushin kuotat.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Numri mesatar i kandidateve femra në listat partiake kombëtare.	Numër	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Numri mesatar i kandidateve femra në listat partiake vendore.	Numër	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve në KQZ dhe në komisionin zonal administrativ rajonal.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e listave zonale për zgjedhjet vendore që përmbushin kuotat.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve gjyqtarë sipas niveleve.	%	INSTAT marrë nga Ministria e Drejtësisë	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve prokurorë sipas niveleve.	%	INSTAT, marrë nga Ministria e Drejtësisë	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve të përfshirë në strukturat policore sipas gradave.	%	INSTAT marrë nga Ministria e Brendshme	Vjetore

Drejtimi : FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE DHE MUNDËSITË E TYRE NE RRIJTJE PËR PUNËSIM DHE TRAJNIMET PROFESIONALE

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave/meshkujve të punësuar në tregun formal të punës, të ndarë sipas moshës, nivelit arsimor dhe vendndodhjes (rurale/urbane).	%	INSTAT-AFP ⁸⁸	3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Shkalla e papunësisë sipas seksit.	%	INSTAT/AFP	Vjetore-3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Përqindja e femrave/meshkujve të pushuar nga puna sipas seksit, vendbanimit (rurale/urbane) dhe llojit të aktivitetit ekonomik.	%	INSTAT-AFP	3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Përqindja e femrave/meshkujve që përfitojnë pagesë papunësie.	%	INSTAT - AFP	Vjetore dhe 3-mujore
Përqindja e femrave që zotërojnë biznese të vogla/mesme/mëdha.	%	INSTAT-ASN	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve që janë të punësuar në mënyrë informale (15 vjeç e lart), sipas zonave të banimit dhe moshës.	%	INSTAT - AFP	Vjetore – tremujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Përqindja e femrave/meshkujve që kanë mundësi të kenë trajnime profesionale në punë.	%	INSTAT-AFP	Vjetore-3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Dallimet midis rrogave/pagesa të femrave dhe meshkujve sipas të njëjtit profesion dhe të njëjtit nivel të ushtrimit të profesionit në të njëjtin sektor.	%	INSTAT-AFP	Vjetore-3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Përqindja e femrave/meshkujve të papunë gjatë 4 javëve të fundit e ndarë sipas moshës, nivelit arsimor, vendbanimit dhe numrit të fëmijëve, sipas metodologjisë së LSMS-së.	%	INSTAT-AFP	Vjetore-3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Numri i orëve të shpenzuara për aktivitete që paguhen dhe nuk paguhen në javë, sipas seksit dhe vendbanimit (rural/urban).	Orë	INSTAT - APK	Çdo 5 vjet
Numri i orëve të shpenzuara për fëmijët dhe të rriturit (që kanë nevojë për përkujdesje) në javë, sipas seksit dhe vendbanimit (rural/urban).	Orë	INSTAT, vërtetimi mbi përdorimin e kohës	Çdo 5 vjet
Përdorimi i kohës së femrave/meshkujve në aktivitetet e përzgjedhura (përfshirë përkujdesin ndaj shtëpisë të papaguar dhe atë ndaj fëmijëve)	Aktivitet	INSTAT, vërtetimi mbi përdorimin e kohës	Çdo 5 vjet
Përqindja e femrave/meshkujve që kryejnë punë të papaguar në familje sipas moshës dhe vendbanimit (rurale/urbane).	%	INSTAT-AFP	Vjetore/3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010

⁸⁸ Anketa e Forcave të Punës

Përqindja e femrave/meshkujve të cilët punojnë në sektorin privat jobujqësor; sipas vendbanimit (rurale/urbane) dhe moshës.	%	INSTAT-AFP	Vjetore/3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Përqindja e femrave/meshkujve që i drejtohen zyrove të punësimit në nivel vendor sipas moshës dhe nivelit arsimor.	%	INSTAT-AFP	Vjetore/3-mujore pas tremujorit të dytë të vitit 2010
Përqindja e femrave/meshkujve të cilët gëzojnë të drejtën e pasjes së lejes së lindjes.	%	INSTAT e merr nga ISSH	Vjetore
Përqindja e grave dhe burrave përfitues/e të lejes së lindjes të pjeshme ndaj periudhës totale të vendosur në ligj.	%	INSTAT - ISSH	Vjetore
Përqindja e femrave/meshkujve që përfitojnë pagesë papunësie.	%	INSTAT marrë prej, ISSH	Vjetore
Përqindja e femrave/meshkujve që marrin pension sipas vendbanimit (urbane/rurale) ndaj totalit të kësaj grupmoshe.	%	INSTAT marrë nga ISSH	Vjetore

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve që kanë qasje ndaj huave të biznesit dhe mikrokredive të ndara sipas moshës, nivelit arsimor dhe vendndodhjes (rural/urban).	%	INSTAT, marrë nga Banka e Shqipërisë	Vjetore
Përqindja e femrave që përfitojnë nga fondet/kreditë shtetërore sipas vendndodhjes (rural/urban), gjendjes ekonomike dhe asaj martesore.	%	INSTAT, marrë nga Banka e Shqipërisë/METE	Vjetore

Drejtimi: PROMOVIMI I SË DREJTËS SE GRAVE DHE VAJZAVE TË REJA PËR NJË ARSIMIM CILËSOR

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Braktisja e shkollës nga femrat/meshkujt në arsimin e detyrueshëm (5 deri 16 vjeç).	%	MASH	Vjetore
Braktisja e shkollës nga femrat/meshkujt me aftësi të kufizuara në arsimin e detyrueshëm (5 deri 16 vjeç).	%	MASH	Vjetore
Numri i viteve të arsimimit të kryer, sipas nivelit arsimor, seksit dhe vendbanimit (rurale/urbane).	Numër vitesh	INSTAT - AFP	Vjetore
Përqindja bruto e regjistrimit i nxënësve në nivelin e parë arsimor për femra/meshkuj.	%	INSTAT	Vjetore
Përqindja e popullsisë së grupmoshës 15-24 vjeç që mund të lexojnë dhe shkruajnë, të ndarë sipas seksit.	%	INSTAT-ABF	
Raporti femra/meshkuj të cilët janë drejtues/e të institucioneve arsimore sipas niveleve (parë, të dytë dhe atë universitar), si dhe drejtues të drejtorive arsimore rajonale.	%	MASH	Vjetore
Raporti femra/meshkuj midis mësuesve në nivelin e parë arsimor (klasa 1-5), të dytë (atij të ulët klasa 6-9 dhe atij mbi 10 e lart) dhe atë të arsimimit universitar.	%	INSTAT, marrë nga MASH	Vjetore
Raporti i regjistrimit të femrave dhe meshkujve në sistemin arsimor të niveli të parë dhe të dytë.	%	MASH	INSTAT - AFP
Raporti i regjistrimit të femrave dhe meshkujve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor të niveli të parë dhe të dytë.	%	MASH	INSTAT - AFP
Raporti mes femrave dhe meshkujve të cilët janë diplomuar sipas degëve në universitetet publike.	%	MASH	Vjetore
Përqindja e të diplomuarve meshkuj/femra sipas nivelit të arsimimit (gjithsej dhe të ndarë sipas vendbanimit urban/rural).	%	MASH	Vjetore

Shpenzimet për librat, shpenzimet subvencionuese të akorduara nga bordi i shkollës, si mirëmbajtja e klasës, etj. Kostot sekondare për arsimimin e popullsisë më të varfër.	Lekë	MASH INSTAT-LSMS	Vjetore
Raporti femra dhe meshkuj që ndjekin arsimin profesional të specializuar, në nivelin e dytë arsimor dhe më lart sipas profilit të specializimit.	%	MASH	Vjetore
Raporti femra dhe meshkuj me aftësi të kufizuar që ndjekin arsimin profesional të specializuar, në nivelin e dytë arsimor dhe më lart sipas profilit të specializimit.	%	MASH	Vjetore
Përqindja e buxhetit të vënë në dispozicion për arsimimin e femrave dhe meshkujve.	%	MASH	
Raporti i regjistrimit të femrave dhe meshkujve në sistemin arsimor të shkallës së tretë dhe diplomave të universitetit nivelit të dytë profesional dhe universitar sipas profilit të specializimit, vendbanimit dhe rajonit.	%	MASH	Vjetore
Raporti i diplomimit të femrave dhe meshkujve në mastera.	%	MASH	Vjetore
Raporti mes femrave dhe meshkujve që po mbrojnë grada shkencore si, DSH, ASPROF, PROF.	%	MASH	
Përqindja e të diplomuarve sipas seksit, nivelit të arsimit (gjithsej dhe sipas vendbanimit urban/rural)	%	INSTAT-LSMS dhe MASH	Vjetore
Numri i trajnimeve mbi edukatën seksuale në programet e trajnimit të vazhdueshëm (Instituti i Kurrikulës) të shkollave të ciklit të dytë.	%	MASH	Vjetore

Drejtimi: PËRMIRËSIMI I QASJES NDAJ SHËRBIMEVE KUALITATIVE SOCIALE PËR GRATË DHE VAJZAT E REJA NË RREZIK

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e varfërisë absolute sipas seksit, vendbanimit dhe statusit ekonomik.	%	INSTAT-LSMS	Çdo 3 vjet
Përqindja e varfërisë ekstreme sipas seksit, vendbanimit dhe statusit ekonomik.	%	INSTAT-LSMS	Çdo 3 vjet
Përqindja e varfërisë absolute sipas gjinisë së kryefamiljarit/es.	%	INSTAT-LSMS	Çdo 3 vjet
Përqindja e varfërisë relative sipas seksit, vendbanimit dhe statusit ekonomik.	%	INSTAT-LSMS	Çdo 3 vjet
Përqindja e femrave dhe meshkujve përfitues të strehimit social.	%	INSTAT, marrë nga bashkitë	Vjetore

Drejtimi: PËRMIRËSIMI I SHËNDETTIT TË POPULLSISË DUKE SIGURUAR NJË PËRGJIGJE MË TË MIRË TË SISTEMIT SHËNDETËSOR NDAJ NEVOJAVE TË VEÇANTA TË FEMRAVE DHE MESHKUJVE

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Shkalla e vdekshmërisë nga SIDA sipas seksit.	%	INSTAT-skedar e vdekjes	Vjetore
Vdekshmëria sipas seksit dhe sipas qarkut.	%	INSTAT – skedarët e vdekjeve	Vjetore
Jetëgjatësia, sipas seksit dhe sipas qarkut.	%	INSTAT sektori demografik	Vjetore

Përqindja e lindjeve nën kujdesin e një mjeku/e, mamie, apo ndihmësi/eje të trajnuar.	%	INSTAT, mbledhur nga MSH –format e lindjes	Vjetore
Vdekshmëria e nënave (për 100 000 lindje të gjalla).	Numri për 100 000 lindje	Formulari i vdekjeve, INSTAT	Vjetore
Shkalla e vdekshmërisë foshnjore sipas seksit.	Numri për 1000 lindje të gjalla	Formulari i vdekjeve, INSTAT	Vjetore
Shkalla e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës sipas vendndodhjes dhe moshës.	%	INSTAT-skedat e vdekjeve	Vjetore
Përqindja e aborteve të kryera sipas standardeve, sipas moshës, nivelit arsimor, profesionit dhe vendbanimit (fshat/qytet); dhe sipas institucionit privat/publik.	%	INSTAT, marrë nga /ISHP	Vjetore
Shpeshësia e SST-ve sipas vendbanimit (urban/rural).	%	INSTAT, marrë nga ISHP	Vjetore
Përhapja e HIV/AIDS-it sipas moshës dhe seksit.	%	INSTAT, marrë nga ISHP	Tremujore
Përqindja e të rriturve dhe fëmijëve me një fazë të përparuar të infeksionit HIV/AIDS që i nënshtrohen trajtimit antiretroviral, sipas seksit dhe vendbanimit (fshat/qytet).	%	INSTAT, marrë nga ISHP	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve që përfitojnë lehtësira në kujdes shëndetësor.	%	INSTAT, marrë nga ISKSH	Vjetore
Numri i shërbimeve, diagnozave që i përkasin shëndetit riprodhues dhe janë mbuluar nga skema e sigurimeve.	Numer	INSTAT, marrë nga MSH/ISKSH	Vjetore
Përqindja e grave të diagnostikuara me kancer të qafës së mitrës dhe kancerin e gjirit.	%	MSH-regjistri i sëmundjeve	Vjetore
Numri i vizitave obstetrikale të ndara sipas javëve të shtatzanisë: 0-13 javë/ 13 – 28javë/ dhe mbi 28 javë.	%	MSH	Vjetore
Numri i qendrave shëndetësore që ofrojnë paketa të plota të kujdesit para lindjes sipas vendndodhjes dhe pronësisë/menaxhimit publike.	Numer	MSH	Vjetore

Formulari 2/1

Ministria e Mbrojtjes Për treguesit e mëposhtëm nuk ka burim të dhënash për momentin, por është rënë dakord me institucionin që të mblidhen në të ardhmen. Mbështetje për mbledhjen e metadatave të këtyre treguesve do të jepet sipas kërkesës.

Drejtimi 2: FUQIZIMI I GRAVE NËPËRMJET PJESËMARRJES SË TYRE MË TË MADHE NË VENDIMMARRJE

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshësia e mbledhjes së të dhënave	Shënime
Përqindja e femrave dhe meshkujve të përfshira në forcat e armatosura, sipas gradave.	%	INSTAT, marrë nga Ministria e Mbrojtjes	Vjetore	

Formulari 2/2

Departamenti i Administratës Publike dërgon treguesit e përpunuar, të listuar si më poshtë tek INSTAT sipas shpeshhtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit bazë	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshhtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve në shërbimin civil, në katër nivelet më të larta të mbajtjes së detyrave.	%	INSTAT, marrë nga DAP	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve të punësuar në sektorin publik, në nivel administrativ dhe menaxherial.	%	INSTAT, marrë nga DAP	Vjetore

Formulari 2/3

Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dërgon treguesit e përpunuar, të listuar si më poshtë tek INSTAT, sipas shpeshhtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshhtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e aborteve të kryera sipas standardeve, sipas moshës, nivelit arsimor, profesionit dhe vendbanimit (fshat/qytet); dhe sipas institucionit privat/publik.	%	INSTAT, marrë nga ISHP	Vjetore
Shpeshhtësia e SST-ve sipas vendbanimit (urban/rural).	%	INSTAT, marrë nga ISHP	Vjetore
Përhapja e HIV/AIDS-it sipas moshës dhe seksit.	%	ISHP	Tremujore
Përqindja e të rriturve dhe fëmijëve me një fazë të përparuar të infeksionit HIV/AIDS, që i nënshtrohen trajtimit antiretroviral, sipas seksit dhe vendbanimit, (fshat/qytet).	%	ISHP	Vjetore

Formulari 2/4

Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) dërgon treguesit e listuar si më poshtë tek INSTAT sipas shpeshhtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshhtësia e mbledhjes së të dhënave
Numri i shërbimeve, diagnozave që i përkasin shëndetit riprodhues dhe janë mbuluar nga skema e sigurimeve.	Numër	MSH/ISKSH	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve që përfitojnë lehtësira në kujdes shëndetësor.	%	INSTAT, marrë nga ISKSH	Vjetore

Formulari 2/5

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dërgon treguesit e listuar si më poshtë tek INSTAT-i, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit bazë	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave/meshkujve të cilët gëzojnë të drejtën e pasjes së lejes së lindjes.	%	INSTAT, marrë nga ISSH	Vjetore
Përqindja e grave dhe burrave përfitues/e të lejes së lindjes të pjesshme ndaj periudhës totale të vendosur në ligj.	%	INSTAT, marrë nga ISSH	Vjetore
Përqindja e femrave/meshkujve që përfitojnë pagesë papunësie.	%	INSTAT, marrë prej ISSH	Vjetore
Përqindja e femrave/meshkujve që marrin pension sipas vendbanimit (urbane/rurale) ndaj totalit të kësaj grupmoshe.	%	INSTAT, marrë nga ISSH	Vjetore

Formulari 2/6

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dërgon treguesit të listuar si më poshtë tek INSTA-i, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve kandidatë/e në listat partiake vendore.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve kandidatë/e në listat partiake kombëtare.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve drejtues/e në partitë politike.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve të regjistruar si votues.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve (me të drejtë vote) që votojnë.	%	INSTAT, marrë prej KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e listave zonale për zgjedhjet kombëtare që përmbushin kuotat.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Numri mesatar i kandidateve femra në listat partiake kombëtare.	Numër	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Numri mesatar i kandidateve femra në listat partiake vendore.	Numër	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e femrave dhe meshkujve në KQZ dhe në Komisionin Zonal Administrativ Rajonal.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale
Përqindja e listave zonale për zgjedhjet vendore që përmbushin kuotat.	%	INSTAT, marrë nga KQZ	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dërgon treguesit e listuar si më poshtë tek INSTAT-i, sipas shpeshhtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshhtësia e mbledhjes së të dhënave
Braktisja e shkollës nga femrat/meshkujt në arsimin e detyrueshëm (5 deri 16 vjeç).	%	MASH	Vjetore
Braktisja e shkollës nga femrat/meshkujt me aftësi të kufizuara në arsimin e detyrueshëm (5 deri 16 vjeç).	%	MASH	Vjetore
Numri i viteve të arsimimit të kryer, sipas nivelit arsimor, seksit, dhe vendbanimit (rurale/urbane).	Vite	INSTAT - AFP	Vjetore
Përqindja bruto e regjistrimit i nxënësve në nivelin e parë arsimor për femra/meshkuj.	%	INSTAT	Vjetore
Përqindja e popullsisë së grupmoshës 15-24 vjeç që mund të lexojnë dhe shkruajnë, të ndarë sipas seksit.	%	INSTAT-ABF	
Raporti femra/meshkuj të cilët janë drejtues/e të institucioneve arsimore sipas niveleve (parë, të dytë dhe atë universitar), si dhe drejtues të drejtorive arsimore rajonale.	%	MASH	Vjetore
Raporti femra/meshkuj midis mësuesve në nivelin e parë arsimor (klasa 1-5), të dytë (atij të ulët klasa 6-9 dhe atij mbi 10 e lart) dhe atë të arsimimit universitar.	%	INSTAT, marrë nga MASH	Vjetore
Raporti i regjistrimit të femrave dhe meshkujve në sistemin arsimor të niveli të parë dhe të dytë.	%	MASH	INSTAT - AFP
Raporti i regjistrimit të femrave dhe meshkujve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor të niveli të parë dhe të dytë.	%	MASH	INSTAT - AFP
Raporti mes femrave dhe meshkujve të cilët janë diplomuar sipas degëve në universitetet publike.	%	MASH	Vjetore
Përqindja e të diplomuarve meshkuj/femra sipas nivelit të arsimimit (gjithsej dhe të ndarë sipas vendbanimit urban/rural).	%	MASH	Vjetore
Shpenzimet për librat, shpenzimet subvencionuese të akorduara nga bordi i shkollës, si mirëmbajtja e klasës, etj. kostot sekondare për arsimimin për popullsinë më të varfër.	Lekë	MASH dhe INSTAT-LSMS	Vjetore
Raporti femra dhe meshkuj që ndjekin arsimin profesional të specializuar, në nivelin e dytë arsimor dhe më lartë sipas profilit të specializimit.	%	MASH	Vjetore
Raporti femra dhe meshkuj me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin profesional të specializuar, në nivelin e dytë arsimor dhe më lartë sipas profilit të specializimit.	%	MASH	Vjetore
Përqindja e buxhetit të vënë në dispozicion për arsimimin e femrave dhe meshkujve.	%	MASH	
Raporti i regjistrimit të femrave dhe meshkujve në sistemin arsimor të shkallës së tretë dhe diplomave të universitetit nivelit të dytë profesional dhe universitar sipas profilit të specializimit, vendbanimit dhe rajonit.	%	MASH	Vjetore
Raporti i diplomimit të femrave dhe meshkujve në mastera.	%	MASH	Vjetore
Raporti mes femrave dhe meshkujve që po mbrojnë grada shkencore si, DSH, ASPROF, PROF.	%	MASH	Vjetore
Përqindja e të diplomuarve sipas seksit, nivelit të arsimit (gjithsej dhe sipas vendbanimit urban/rural).	%	INSTAT-LSMS dhe MASH	Vjetore
Numri i trajnimeve mbi edukatën seksuale në programet e trajnimit të vazhdueshëm (Instituti i Kurrikulës) të shkollave të ciklit të dytë.	%	MASH	Vjetore

Formulari 2/8

Ministria e Drejtësisë dërgon treguesit e listuar si më poshtë tek INSTAT-i, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit bazë	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve gjyqtarë sipas niveleve.	%	INSTAT, marrë nga MD	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve prokurorë sipas niveleve.	%	INSTAT, marrë nga MD	Vjetore

Formulari 2/9

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) dërgon treguesit e listuar si më poshtë tek INSTAT-i, shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave që përfitojnë nga fondet/kreditë shtetërore sipas vendndodhjes (rural/urban), gjendjes ekonomike dhe asaj martesore.	%	INSTAT, marrë nga METE	Vjetore

Formulari 2/10

Ministria e Shëndetësisë dërgon treguesit e listuar si më poshtë tek INSTAT-i, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Shkalla e vdekshmërisë nga SIDA sipas seksit.	%	INSTAT-skedat e vdekjes	Vjetore
Vdekshmëria sipas seksit dhe sipas qarkut.	%	INSTAT – skedarët e vdekjeve	vjetore
Jetëgjatësia, sipas seksit dhe sipas qarkut.	%	INSTAT, sektori demografik	vjetore
Përqindja e lindjeve nën kujdesin e mjekut/es, mamisë ose ndihmësit/es së trajnuar.	%	MSH, registri i lindjeve	Vjetore
Vdekshmëria e nënave për 100,000 lindje të gjalla.	Numër për 100 000 lindje të gjalla	INSTAT-skedat e vdekjes dhe MSH	Vjetore
Shkalla e vdekshmërisë foshnjore sipas seksit.	Numri për 1000 lindje të gjalla	Formulari i vdekjeve INSTAT	Vjetore
Shkalla e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës sipas vendndodhjes, moshës.	%	INSTAT-skedat e vdekjeve	vjetore
Përqindja e grave të diagnostikuara me kancer të qafës së mitrës dhe kancerin e gjirit.	%	MSH-regjistri i sëmundjeve	Vjetore
Numri i vizitave obstetrikale të ndara sipas javëve të shtatzanisë: 0-13javë/ 13 – 28javë/ dhe mbi 28 javë.	%	MSH	Vjetore
Numri i qendrave shëndetësore që ofrojnë paketa të plota të kujdesit para lindjes sipas vendndodhjes dhe pronësisë/menaxhimit publike.	Numer	MSH	Vjetore

Ministria e Brendshme dërgon treguesit e si më poshtë tek INSTAT-i, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve të përfshirë në strukturat policore sipas gradave.	%	INSTAT, marrë nga Ministria e Brendshme	Vjetore

Formulari nr.3

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si edhe institucionet e tjera në varësi të saj bien mbledh treguesit e përpunuar, të listuar si më poshtë, si pjesë e detyrimeve që janë aktualisht në fuqi.

Drejtimi: MEKANIZMAT LIGJORË DHE INSTITUCIONALË TË CILËT SIGUROJNË BARAZINË GJINORE

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Ekzistenca e legjislacionit dytësor për eliminimin e dhunës në familje dhe LBGJ-së, që përfshijnë:	Cilësor	MPÇSSHB	Vjetore
Shërbime ligjore falas;	Cilësor	MPÇSSHB	Vjetore
Funksionimin e strehëzës kombëtare;	Cilësor	MPÇSSHB	Vjetore
Koordinimin ndërinstitutional;	Cilësor	MPÇSSHB	Vjetore
Strehimi.	Cilësor	MPÇSSHB	Vjetore
Monitorimi i angazhimeve të barazisë gjinore, duke përfshirë këtu grumbullimin e të dhënave statistikore të nevojshme.	Cilësor	INSTAT dhe MPÇSSHB	Vjetore
Përqindja e politikave kombëtare dhe sektoriale ekzistuese dhe legjislacioni që integron barazinë gjinore, duke përdorur standarde dhe norma ndërkombëtare.	%	MPÇSSHB	Vjetore
Pjesa e buxheteve në sektorët e gjerë të politikave/legjislacionit të cilët mbështesin barazinë gjinore.	%	MPÇSSHB	Vjetore
Shkalla e zbatimit të masave të veçanta në politikat kombëtare dhe legjislacionit për të mbështetur barazinë gjinore.	Cilësore	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i debateve parlamentare lidhur me barazinë gjinore, të drejtat njerëzore të grave dhe dhunës në familje për vit.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i: a) ministrive, b) agjencive qeveritare, të cilat kanë vendosur nëpunës të barazisë gjinore me a) kohë të plotë, b) kohë të pjesshme në departamentet përkatëse të politikave.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i njësive të administratës publike lokale që kanë punësuar nëpunës të barazisë gjinore: a) me kohë të plotë, b) me kohë të pjesshme.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore

Numri i vendimeve marrë nga Këshilli Kombëtarë mbi Barazinë Gjinore dhe alokimet buxhetore për të mbështetur zbatimin e vendimeve.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i raporteve: a) qeveritare; b) sektoriale; c) të donatorëve që shpjegojnë gjendjen e grave dhe barazinë gjinore.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i veprimeve të përbashkëta të marra nga institucionet përgjegjëse kombëtare që varen nga LBGJ-ja me nëpunësit gjinorë.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i veprimeve të përbashkëta të koordinuara mes qeverisë dhe organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe të drejtat e njeriut e të grave.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i fushatave sensibilizuese në nivel vendor mbi barazinë gjinore dhe dhunën në familje.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore

Drejtimi: FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE DHE MUNDËSITË E TYRE NË RITJE PËR PUNËSIM DHE TRAJNIMET PROFESIONALE

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave që trajnohen në DRFPP-të, si dhe të atyre që përfitojnë formim profesional me tarifa të reduktuara dhe falas.	%	MPÇSSHB/ SHKP	Vjetore
Përqindja e femrave të punësuar nëpërmjet formimit profesional.	%	MPÇSSHB/ SHKP	Vjetore
Rishikim dhe mundësisht përmirësim i Kodit të Punës për të siguruar përputhje me normat dhe direktivat ndërkombëtare (CEDAW, BE, Këshilli i Evropës) lidhur me barazinë gjinore në vendin e punës.	Cilësore	MPÇSSHB	Vjetore Një herë
Përqindja e femrave/meshkujve kryefamiljarë/e që përfitojnë ndihmë ekonomike.	%	MPÇSSHB marrë nga SHSSH	Vjetore

Drejtimi: PËRDITËSIMI I ROLIT TË MEDIAS NË PËRPARIMIN E BARAZISË GJINORE NË SHOQËRI, DUKE PËRFSHIRË PJESËMARRJEN NË RITJE TË GRAVE DHE VAJZAVE TË REJA NË MEDIA

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Ndarja e hapësirës për trajtimin e çështjeve mbi gratë në median: a) e shkruar, b) audio dhe c) vizive.	%	MPÇSSHB	Çdo tre vjet dhe/ose menjëherë pas zgjedhjeve
Ndarja e mediave të shkruara, audio dhe vizive, të cilat sistematikisht përdorin gjuhë jo të duhur duke iu referuar seksit femër.	%	MPÇSSHB	Çdo tre vjet dhe/ose menjëherë pas zgjedhjeve
Ndarja e hapësirës për trajtimin e çështjeve mbi gratë në median e shkruar/audio dhe vizive.	Cilësore	MPÇSSHB	Çdo tre vjet dhe/ose menjëherë pas zgjedhjeve
Kategorizimi i mediave të shkruara/audio dhe vizive të cilat sistematikisht përdorin gjuhë jo të duhur duke iu referuar seksit femër.	Cilësore	MPÇSSHB	Çdo tre vjet dhe/ose menjëherë pas zgjedhjeve
Numri i gazetarëve dhe anëtarët e stafit redaksional dhe shpërndarja e tyre sipas seksit, nivelit, llojit dhe medias.	Numër	MPÇSSHB	Çdo tre vjet dhe/ose menjëherë pas zgjedhjeve
Numri i grave të përfaqësuara në një mënyrë të barabartë në median e shkruar/audio dhe vizive.	Numër	MPÇSSHB	Çdo tre vjet dhe/ose menjëherë pas zgjedhjeve

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Numri i bashkive që kanë marrëveshje të nënshkruara me aktorët vendorë për t'iu përgjigjur, ndihmuar dhe monitoruar rastet e dhunës në familje në rajonet e tyre.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i bashkive me sistem të ngritur të monitorimit të përhapjes së dhunës në familje.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i strukturave/njësive në nivel vendor dhe kombëtar që merren me eliminimin e dhunës në familje, sipas llojit të organizmit (polici, gjyqësor, shëndetësi, arsim, mbrojtje sociale, etj.).	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i gjyqtarëve të përfshirë në kurse të vazhdueshme trajnimi për ligjin kundër dhunës në familje dhe për barazinë gjinore në Shkollën e Magjistraturës.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i qendrave (private dhe publike) që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në familje, sipas burimit të ndihmës.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i shtretërve/vendeve që ekzistojnë në qendrat që ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës në familje, sipas 12 qarqeve.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i qendrave që ofrojnë shërbime sociale dhe rehabilitime për viktimat e dhunës në familje, si edhe për ushtruesit e dhunës, sipas 12 qarqeve.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore
Numri i OJF-ve që punojnë për eliminimin e dhunës në familje, sipas 12 qarqeve.	Numër	MPÇSSHB	Vjetore

Formulari 3/1

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) dërgon treguesit e listuar si më poshtë te sektori i statistikës në MPÇSSHB, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e vendeve të mbajtura nga femrat dhe meshkujt në pozicione të zgjedhura vendore dhe kombëtare.	%	MPÇSSHB marrë nga KQZ	Pas çdo zgjedhjeje vendore apo kombëtare
Numri i rasteve kur organizmat administrativë ndërmarrin sanksione siç parashikohen nga LBGJ dhe Kodi Zgjedhor në mbështetje të kuotave, siç aplikohet për pozicionet e zgjedhura dhe emëruara në nivel kombëtar dhe vendor.	Numër	MPÇSSHB në bashkëpunim me KQZ-në dhe Kuvendin	Zgjedhjet kombëtare dhe lokale

Formulari 3/2

Ministria e Shëndetësisë dërgon treguesit e listuar si më poshtë te sektori i statistikës në MPCSSHB sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Numri i grave dhe vajzave që marrin ndihmë në qendrat e kujdesit shëndetësor si pasojë e dhunës në familje sipas rajonit moshës, nivelit arsimor, gjendjes martesore dhe profesionit.	Numër	MPÇSSHB/ MSH	Vjetore

Formulari 3/3

Departamenti i Administratës Publike dërgon treguesit e listuar si më poshtë te sektori i statistikës në MPCSSHB, sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme.

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Përqindja e femrave dhe meshkujve në vendet e emëruara në organizmat e niveleve kombëtare dhe vendore qeveritare.	%	MPÇSSHB marrë nga DAP	Vjetore
Përqindja e femrave dhe meshkujve në shërbimin civil, në katër nivelet më të larta të mbajtjes së detyrave.	%	MPÇSSHB marrë nga DAP	Vjetore

Formulari 3/4

Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë së Shtetit dërgojnë treguesit e listuar si më poshtë te sektori i statistikës në MPCSSHB sipas shpeshtësisë së mbledhjes së treguesve në tabelën e mëposhtme:

Treguesit	Njësia e matjes	Burimi i të dhënave	Shpeshtësia e mbledhjes së të dhënave
Numri i rasteve të regjistruara të dhunës në familje, sipas llojit, seksit, moshës, nivelit arsimor, statusit të punësimit, statusit civil, shtetësisë, minoritetit, dhe vendbanimit (urbane/rurale).	Numër	MPÇSSHB/ Drejtoria e Policisë së Shtetit	Çdo 6 muaj/çdo 5 vjet
Numri i punonjësve të Policisë së Shtetit të trajnuar për zbatimin e ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, duke zbatuar procedura standarde për trajtimin dhe mbrojtjen e viktimave.	Numër	MPÇSSHB/ Drejtoria e Policisë së Shtetit	Vjetore
Numri i veprimeve të kryera nga punonjësve të policisë së shtetit për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje, si këshillime, kërkesëpadi për urdhër mbrojtjeje, referime në prokurori.	Numër	MPÇSSHB/ Drejtoria e Policisë së Shtetit	Vjetore

LIGJ
Nr.10 221, datë 4.2.2010

PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI⁸⁹
(ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

Në mbështetje të neneve 18, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

(ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

⁸⁹. Përafruar plotësisht me:

1. 32000L0043, Direktivën e Këshillit 2004/43/KE të 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”.
2. 32000L0078, Direktivën e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
3. 32004L0113, Direktivën e Këshillit 2004/113/KE të 13 dhjetorit 2004 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”.
4. 32006L0054, Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Neni 3

Përkufizimet

(ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

4. “Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.

6. “Diskriminim strukturor” është ajo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.

7. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme, për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshtruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

9. “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

10. “Nxitja ose ndihma për diskriminim” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një ose më shumë persona nxisin ose ndihmojnë një ose më shumë persona të tjerë, duke përfshirë edhe financimin e tyre, me qëllim për të diskriminuar, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

11. “Organizatata me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.

12. “Qëllimi i shpallur për diskriminim” është ajo formë diskriminimi që ndodh bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, edhe në mungesë të një viktime konkrete.

13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

14. “Shqetësim seksual” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të.

15. “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

16. “Veçimi” është ajo formë diskriminimi, e cila ndodh në rastet kur një person ose grup personash ndahen nga të tjerët pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, dhe kjo ndarje bëhet për të paktën një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji.

17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.

Neni 3/1

Format e rënda të diskriminimit

(shtuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasojë veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.

Neni 4

Subjektet

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

Neni 5

Ndalimi i diskriminimit

(hequr pika 2 me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 6
Trajtimi i ndryshëm i përligjur

1. Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

2. Trajtimi i ndryshëm që bazohet në një karakteristikë të lidhur me shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, nuk përbën diskriminim kur për shkak të natyrës së aktiviteteve profesionale, ose të kushteve në të cilat profesioni ose veprimtaria ushtrohet, këto karakteristika përbëjnë një kërkesë të vërtetë dhe profesionale të domosdoshme, me kusht që qëllimi i trajtimit të ndryshëm të jetë i përligjur dhe kërkesa të mos kapërcejë atë çfarë është e domosdoshme për realizimin e saj.

Neni 7
Mbrojtja nga diskriminimi
(shtuar pika 3 me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 8
Reklamat diskriminuese

Ndalohet publikimi i reklamave dhe njoftimeve të ndryshme, nëse ato paraqesin, haptazi apo në mënyrë të nënkuptuar, qëllim për të diskriminuar, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 9
Pjesëmarrja në politikë

Ndalohet diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 10
Ndërgjegjja dhe feja

1. Ndalohet diskriminimi lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe fesë, veçanërisht kur ka të bëjë me shprehjen e tyre individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve.

2. Përjashtimi nga kjo dispozitë mund të lejohet vetëm kur ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive. Megjithatë, në çdo rast, lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë mund të vendoset vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të

drejtave të të tjerëve. Përjashtimi për këtë shkak duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar nevojën për diskriminimin. Në çdo rast lejimi i diskriminimit për shkak të ushtrimit të lirisë së ndërgjegjes dhe fesë nuk mund të cenojnë thelbin e lirisë dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 11

Veprime pozitive

Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

KREU II

MBROJTA NGA DISKRIMINIMI NË PUNËSIM

Neni 12

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

- a) shpalljen e vendeve të lira të punës;
- b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve;
- c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës;
- ç) anëtarësinë në sindikata dhe mundësinë për të përfituar nga lehtësitë që siguron kjo anëtarësi.

2. Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, nga punëdhënësi përkundërt një punëmarrësi ose një kërkuesi për punë ose midis punëmarrësve.

3. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përsheptimin e barazisë në fushën e punësimit, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen në mënyrë të përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe masat e posaçme ndërpritën kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Neni 13

Detyrimet e punëdhënësit

1. Punëdhënësi është i detyruar:

- a) të zbatojë, të mbrojë e të nxisë parimin e barazisë dhe të ndalimit të çdo lloji diskriminimi;
- b) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dënjesisë;
- c) t'u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre.

2. Punëdhënësi detyrohet të rrisë ndërgjegjësimin për këtë ligj edhe duke e afishuar atë në mjediset publike të vendit të punës, si dhe të mundësojë kuptimin e plotë të tij me mjetet e veta ose me ndihmën e subjekteve të specializuara.

Neni 14

Detyrat e Këshillit të Ministrave, ministrit përgjegjës për punën dhe çështjet sociale dhe ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme

Këshilli i Ministrave, ministri përgjegjës për punën dhe çështjet sociale dhe ministri përgjegjës për çështjet e brendshme janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për punësim. Masat që merren, ndër të tjera, janë:

- a) rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj te punëmarrësit dhe punëdhënësit, ndër të tjera, duke dhënë informacion për këtë ligj;
- b) vendosja e politikave të posaçme dhe të përkohshme, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim nxitjen e barazisë, në veçanti midis burrit dhe gruas, si dhe midis personave me aftësi të plotë fizike dhe atyre me aftësi të kufizuara.

Neni 15

Të drejtat e punëmarrësit

1. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit.

2. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.

3. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit.

4. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për atë kohë sa është e nevojshme për t'u mbrojtur nga diskriminimi. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi i pretenduar nuk rezulton i vërtetuar me vendim të formës së prerë.

Neni 16

Zbatimi i ligjit për personat e vetëpunësuar

Dispozitat e kreut II të këtij ligji zbatohen në lidhje me kushtet për pranimin në profesion dhe marrjen e lejeve të ushtrimit të profesionit, sidomos në rastet kur personat janë të vetëpunësuar.

KREU III

MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI NË FUSHËN E ARSIMIMIT

Neni 17

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

- a) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- b) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- c) përmbajtjen e parimeve dhe kriterëve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;
- ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.

2. Ndalohet t'i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion

arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

3. Ndalohej çdo lloj shqetësimi, veçanërisht shqetësimi seksual, i studentëve, nxënësve dhe punëmarrësve në institucionet arsimore.

4. Zbatimi i masave të posaçme dhe të përkohshme, bazuar në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, me qëllim përshpejtimin e barazisë në arsim, nuk konsiderohet diskriminim. Zbatimi i masave të tilla, në asnjë rast, nuk mund të nënkuptojë mbajtjen e përhershme të standardeve të pabarabarta ose të ndryshme dhe këto masa ndërpriten kur arrihet objektivi i trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta.

Neni 18

Detyrat e Këshillit të Ministrave dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe shkencën

1. Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe shkencën janë secili përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.

2. Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe shkencën, ndër të tjera, marrin secili masa për:

a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj në sistemin arsimor, ndër të tjera duke përfshirë informacion për të në programet mësimore;

b) përfshirjen në programet mësimore të koncepteve dhe veprimeve kundër modeleve të sjelljes diskriminuese;

c) arsimimin e të gjithë popullsisë, në mënyrë të veçantë, duke marrë masa në favor të grave dhe vajzave, pakicave, personave me aftësi të kufizuara, si dhe personave që janë, ose kanë më shumë mundësi të jenë objekt i diskriminimit, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

ç) respektimin dhe sigurimin e së drejtës për arsimim në gjuhët e pakicave, si dhe në mënyrat e përshtatshme për persona me aftësi të kufizuara.

Neni 19

Detyrat e drejtuesit të institucionit arsimor

Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë:

a) rritja e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda institucionit, ndër të tjera duke afishuar ligjin në një vend të dukshëm;

b) lufta kundër modeleve të sjelljes diskriminuese që përbëjnë ose nxisin diskriminim brenda institucionit;

c) të marrë masat e nevojshme, përfshirë dhe masa disiplinore, për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi dhe viktimizimi, brenda një muaji nga marrja e dijenisë;

ç) trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij;

d) vendosja e masave disiplinore ndaj çdo personi që verifikohet të ketë kryer një veprim diskriminues kur një gjë e tillë është e përshtatshme, proporcionale dhe në përputhje me kompetencat e drejtorit.

KREU IV
NDALIMI I DISKRIMINIMIT
NË FUSHËN E TË MIRAVE DHE TË SHËRBIMEVE

Neni 20

Të mirat dhe shërbimet

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato:

a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

a) mundësi për të hyrë në një vend ku publiku lejohet të hyjë ose për të përdorur një vend, i cili lejohet për t'u përdorur nga publiku;

b) mundësi për të marrë ose për të përfitur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;

c) kontributin dhe mundësinë për të përfitur të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

ç) mundësi për të përdorur ose për të hyrë në një institucion arsimor;

d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim;

dh) shitjen ose dhënien me qira të banesave dhe të mjediseve të tjera;

e) shërbimet e bankës dhe mundësi për të siguruar grante, huadhënie, depozita bankare ose financim;

ë) lehtësi për argëtim, çlodhje e freskim;

f) lehtësi për transport ose udhëtim;

g) shërbimet e profesioneve të lira.

3. Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit.

5. Nuk përbëjnë diskriminim dallimet në shpërblime dhe përfitime, të vendosura për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, kur këto dallime janë të arsyeshme dhe në përpjesëtim me një rrezik, i cili vlerësohet në bazë të të dhënave aktuale dhe statistikore të vërtetueshme dhe të lidhura ngushtë me rrezikun.

6. Kostot lidhur me shtatzaninë dhe amësinë nuk mund të rezultojnë shkak për dallime në shpërblimet dhe përfitimet e individit.

7. Ndalimi i diskriminimit nuk zbatohet për caktimin e një moshe të veçantë për mundësi të përfitimeve sociale, të të mirave, lehtësive dhe shërbimeve, nëse ekzistojnë kritere të arsyeshme e objektive për caktimin, pa cenuar thelbin e së drejtës për përfitime dhe kur caktimi synon të arrijë një qëllim të ligjshëm për një interes publik, ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, gjithmonë në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar caktimin.

KREU V KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Neni 21 **Komisioneri**

1. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më poshtë komisioneri, siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri është person juridik publik.

2. Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (zyra). Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

3. Kuvendi vendos për pagën e komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Punonjësit e kësaj zyre gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

4. Komisioneri ka buxhetin e vet të pavarur, i cili financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga donacione të ndryshme.

Neni 22 **Statusi**

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 23 **Mënyra e zgjedhjes së komisionerit**

1. Komisioneri zgjidhet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
2. Kandidatët e mundshëm për komisioner i propozohen Kuvendit nga një grup deputetësh.
3. Para marrjes ose rimarrjes së detyrës, komisioneri bën betimin para Kuvendit.
4. Formula e betimit është: “Betohe se gjatë kryerjes së detyrave të mia do të mbroj kurdoherë parimin e barazisë, në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 24 **Kushtet për t’u zgjedhur komisioner**

(ndryshuar fjalë në pikat “a”, shtuar fjalë në shkronjën “b” dhe ndryshuar shkronja “c” me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

- Komisioner mund të zgjidhet çdo shtetas shqiptar që plotëson kërkesat e mëposhtme:
- a) të ketë integritet të lartë moral e veprimtari të shquar në komunitet;
 - b) të ketë një diplomë universitare të ciklit të dytë ose diplomë të njësuar me të, në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi;
 - c) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;
 - ç) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - d) të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit që bën propozimin ose zgjedhjen e tij.

Neni 25
Kohëzgjatja në detyrë

Komisioneri zgjidhet për një mandat prej pesë vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

Neni 26
Raportimi

Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara komisioneve të Kuvendit. Raporti përfshin analizë për zbatimin e këtij ligji në përgjithësi, si dhe për punën e komisionerit dhe të zyrës.

Neni 27
Mbarimi i mandatit

Mandati i komisionerit mbaron kur:

- a) mbaron afati 5-vjeçar;
- b) shkarkohet;
- c) i paraqet Kuvendit dorëheqje me shkrim;
- ç) vdes.

Neni 28
Rastet e shkarkimit nga detyra të komisionerit
(ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Komisioneri shkarkohet nga detyra vetëm në rastet kur:
 - a) është dënuar me një vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën për më shumë se tre muaj;
 - c) kryen veprimtari në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, me Kushtetutën ose me legjislacionin në fuqi.
2. Mocioni për shkarkimin e komisionerit propozohet nga jo më pak se 1/3 e deputetëve të Kuvendit. Vendimi për shkarkimin nga detyra të komisionerit merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Neni 29
Zgjedhja e komisionerit

Kuvendi zgjedh komisionerin e ri brenda një muaji të mbetjes së vendit vakant. Kur mbaron mandati 5-vjeçar i komisionerit, ai qëndron në detyrë derisa të zgjidhet komisioneri i ri.

Neni 30
Papajtueshmëria me funksionin e komisionerit

Komisioneri ndalohet të bëjë pjesë në parti apo organizata politike, të kryejë veprimtari politike, shtetërore e profesionale, si dhe të marrë pjesë në organet drejtuese të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare. Komisioneri mund të ushtrojë mësimdhënie dhe botimin e veprave letrare dhe shkencore, pa cenuar ushtrimin e funksioneve të tij në mënyrë normale.

Neni 31

Sigurimi i punës së mëvonshme të komisionerit

Me mbarimin e funksionit, sipas shkronjave “a” e “c” të nenit 27 të këtij ligji komisioneri, i cili, në kohën e emërimit, kishte punuar në funksion shtetëror ose punë publike, ka të drejtë të rimarrë funksionin ose punën që kishte para zgjedhjes si komisioner. Kur kjo nuk është e mundur, atij i sigurohet një punë e barasvlefshme me atë që ai kishte përpara zgjedhjes në detyrën e komisionerit.

Neni 32

Kompetencat

(ndryshuar fjalë në pikat 1, 3 dhe 4, ndryshuar pika 2 me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Komisioneri ka kompetencë:

- a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- ç) të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- d) të nxisë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- dh) të monitorojë zbatimin e këtij ligji, si dhe të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- e) të kryejë sondazhe në lidhje me diskriminimin;
- ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- f) të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- g) t’i drejtohet drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- gj) me kërkesën e gjykatës që shqyrton çështjen, të parashtrojë mendim me shkrim për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- h) të kontribuojë në raportimet dhe sipas rastit të paraqesë raporte para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë;
- i) të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- i/1) të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;
- j) të informojë për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- k) të zhvillojë dialogun e rregullt në lidhje me çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- l) të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.

3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në

Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

4. Detyrimi i përmendur në pikën 2 të këtij neni përmbushet në përputhje me legjislacionin që rregullon të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 33

Procedurat

(ndryshuar pika 2, shfuqizuar shkronja "a", ndryshuar shkronja "db" të pikës 4, ndryshuar fjalë në pikat 5 dhe 7, shtuar 7/1, 7/2, 7/3, 7/4, ndryshuar fjalë në pikat 10, 11, 12, ndryshuar pikat 16, 17 dhe shtuar pika 18 me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal.

2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.

3. Ankesa përmban, të paktën:

- a) emrin e ankuesit;
- b) shpjegimin se si mund të kontaktohet ankuesi;
- c) subjektin që pretendohet të ketë kryer diskriminimin, ose shpjegim për pamundësinë e identifikimit të tij;
- ç) shpjegimin e diskriminimit të pretenduar;
- d) masat që kërkojnë nga komisioneri;
- dh) datën dhe firmën e ankuesit ose të përfaqësuesit të tij.

4. Ankesa nuk pranohet nëse:

- a) Shfuqizuar;
- b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;
- c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një ankese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja;
- ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;
- d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji;
- dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese.

5. Personat fizikë ose juridikë, kundër të cilëve është paraqitur ankesa, njoftohen me shkrim nga komisioneri brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankesës.

6. Komisioneri nuk i ngarkon ankuesit me ndonjë tarifë për shqyrtimin e ankesës.

7. Me regjistrimin e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t'u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve pune nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.

7/1 Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.

7/2 Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e ankesës, kërkojnë njohuri të posaçme, Komisioneri mund të kërkojë mendim të specializuar nga ekspertë të fushave të caktuara.

7/3 Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, drejtuar të njëjtut subjekt, kanë të

njëtin objekt, mund të bashkohen në një ankesë të vetme.

7/4 Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.

8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.

9. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

10. Komisioneri shprehet me vendim, i cili u njoftohet palëve brenda 90 ditëve nga dita e regjistrimit të ankesës ose nëse është zhvilluar një seancë dëgjimore publike, brenda 90 ditëve nga dita e seancës. Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre.

11. Nëse komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për subjektin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

12. Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë:

a) e efektshme dhe parandaluese; dhe

b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës. Nëse vendoset gjobë, komisioneri përcakton shumën e gjobës duke marrë parasysh:

i) natyrën dhe fushën e veprimit të shkeljes dhe ndikimin mbi viktimën; dhe

ii) rrethanat personale e financiare të shkelësit, veçanërisht duke marrë në konsideratë të gjitha burimet e të ardhurave dhe nëse shkelja kryhet nga një person juridik privat, merren parasysh aktivet e bilancit dhe fitimi, si dhe pagat totale të paguara punonjësve;

c) nëse e njëjta shkelje diskriminon disa persona, vendoset vetëm një gjobë, por duke marrë parasysh kërkesat e shkronjës “b” të këtij neni.

13. Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:

a) personi fizik, nga 10 000 deri në 60 000 lekë;

b) personi juridik nga 60 000 deri në 600 000 lekë;

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri në 80 000 lekë.

d) personi fizik ose juridik, i cili kryen një ose më shumë nga format e rënda të diskriminimit, dyfishin e masës së gjobës së parashikuar përkatësisht në shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 13, të nenit 33.

14. Vendimi për vënien e një mase ndëshkimore me gjobë cakton gjithashtu afatin e arsyeshëm, brenda të cilit paguhet gjoba.

15. Si mjet të fundit, veçanërisht kur subjekti fizik ose juridik nuk i përmbahet vendimit të komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, komisioneri mund t’u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij.

16. Në rastet kur vendimi i Komisionerit kthehet mbrapsht nga posta me shënimin “destinacion i panjohur” ose “destinacioni nuk gjendet” dhe për rrjedhim ankuesi dhe subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa nuk mund të marrin dijeni për masat e marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmbledhja e vendimit afishohet në ambientet e Komisionerit për

Mbrojtjen nga Diskriminimi.

17. Operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt gjuhën e urrejtjes.

18. Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankimohen në gjykatën kompetente sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 33/1

Ekzekutimi i gjobave dhe vendimeve të Komisionerit

(shtuar me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi jo më vonë se 45 ditë nga komunikimi i tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit, me kërkesë të Komisionerit.

2. Gjoba arkëtohet në buxhetin e shtetit.

KREU VI

PROCEDURAT PËRPARA GJYKATËS

Neni 34

Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim

(ndryshuar pika 3 dhe shtuar pika 4 me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale.

2. Paraqitja e ankimit përpara komisionerit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesëpadi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale.

3. Një organizatë me interes të ligjshëm mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit, ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi.

4. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizatat me interesa legjitime kanë të drejtë të paraqesin padi përpara gjykatës kompetente në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për çështje që lidhen me interesa kolektive.

Neni 35

Përgjegjësia individuale

Çdo person mban përgjegjësi në bazë të dispozitave të këtij ligji, kur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka kryer një akt diskriminues në kuptimin e këtij ligji. Përgjegjësia individuale nuk e përjashton përgjegjësinë e shtetit ose të personit juridik privat.

Neni 36

Procedura para gjykatës

(ndryshuar fjalë në pikën 6 me ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020)

1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më

vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijeni për këtë sjellje.

2. I dëmtuari nuk ka detyrim të njoftojë komisionerin para se të paraqesë një padi për diskriminim në gjykatë.

3. Gjykata e njofton komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim.

4. Gjykata mund t'i kërkojë komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen.

5. Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme që mund të provojë sjelljen diskriminuese.

6. Pasi paditësi paraqet fakte, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.

Neni 37

Vendimi i gjykatës

1. Vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit.

2. Vendimi i gjykatës u komunikohet të gjitha palëve të interesuara, përfshirë komisionerin.

3. Vendosja e masave, sipas këtij ligji, nuk përjashton vendosjen e masave sipas ligjeve të tjera.

Neni 38

Dëmshpërblimi

Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 39

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet komisioneri të nxjerrë rregulloren e funksionimit të zyrës brenda 3 muajve nga data e emërimit të tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6433, datë 24.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Qendra e Botimeve Zyrtare

Përmbledhëse legjislacioni për barazinë gjinore,
mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhunën në familje /
Qendra e Botimeve Zyrtare. - Tiranë : QBZ, 2021
... f. ; ... cm.

ISBN 978-9928-01-134-3

- 1.E drejta familjare
- 2.Legjislacioni
- 3.Marrëdhënie familjare
- 4.Dhuna në familje
- 5.Diskriminimi
- 6.Shqipëri

347.61(496.5) (094.5)

